REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

UDHËRRËFYES

PËR JURISPRUDENCËN E GJYKATËS KUSHTETUESE

1998-2023

LIDHUR ME ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

UDHËRRËFYES (GUIDË)
PËR JURISPRUDENCËN E GJYKATËS KUSHTETUESE
LIDHUR ME ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL
1998-2023

PRILL, 2024

Të drejtat e autorit: © Gjykata Kushtetuese

Hartimi i Udhërrëfyesit (Guidës) për jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese lidhur me ankimin kushtetues individual, si dhe publikimi i tij, është mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në kuadër të Projektit "Forcimi i shtetit të së drejtës dhe promovimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet mbështetjes për Gjykatën Kushtetuese", financuar nga Misioni i SHBA-së në OSBE, Misioni i Përhershëm i Italisë në OSBE dhe Ambasada e Greqisë në Shqipëri. Përmbajtja e Udhërrëfyesit nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

U.S. Mission to the OSCE

Permanent Mission of Italy
OSCE

EMBASSY OF GREECE
IN ALBANIA

Ribotimi i këtij Udhërrëfyesi u mundësua me financimin e Konrad-Adenauer-Stiftung, Zyra e Shqipërisë.

KONRAD
ADENAUER
STIFTUNG

Ky udhërrëfyes do të përditësohet dhe pasurohet në vijimësi.
Versioni më i fundit gjendet në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese

Hyrje/ Sqarim për përdoruesit e Udhërrëfyesit

Ky Udhërrëfyes synon të rrisë transparencën dhe aksesueshmërinë në drejtësinë kushtetuese si dhe eficiencën në vendimmarrjet gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)*, në funksion të forcimit të shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri.

Jurisprudenca kushtetuese e përmbledhur dhe e referuar në këtë Udhërrëfyes lidhet me ankimin kushtetues individual, për të drejtat kushtetuese për një proces të rregull ligjor përpara ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016[1,] dhe për të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë pas këtyre ndryshimeve. Për strukturimin dhe grupimin e standardeve dhe precedentëve të zhvilluar nga jurisprudenca e Gjykatës janë mbajtur parasysh dhe ndjekur si modele orientuese guide-at e ngjashme të botuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)*.

Jurisprudenca kushtetuese për secilën të drejtë në krerët II, III, IV, V dhe VI (duke filluar nga 1992 deri në 2023) është ndarë në dy pjesë kryesore: a) kuptimi, parimet dhe standardet përkatëse; b) dhe precedentët ku është vënë në diskutim çështja e cenimit të së drejtës përkatëse. Në pjesën e parë prezantohen vetëm kuptimi dhe standardet e zhvilluara nga jurisprudenca e GJK-së për atë të drejtë, pa përmendur rastet dhe faktet konkrete të çështjeve ku janë evidentuar/zhvilluar këto standarde. Kjo është bërë për të lehtësuar qartësinë/lexueshmërinë dhe referimin nga ana e Gjykatës te këto standarde, në çështje ku pretendohet cenimi i së drejtës përkatëse. Për çdo standard janë referuar 3-4 vendime kryesore. Te këto referenca përfshihen vendimi ku është evidentuar për herë të parë ai standard dhe vendimi/e ku është zhvilluar, duke filluar nga vendimi më i fundit.

Në pjesën e dytë, për precedentët, në krerët II, III dhe IV, jurisprudenca është ndarë sipas fushave civile, penale dhe administrative, ndërsa kreu V është tërësisht penal. Për çdo fushë precedentët janë grupuar në dy nënndarje: a) për gjykatat e faktit; b) dhe për Gjykatën e Lartë. Çdo rast/precedent i përmendur nga jurisprudenca përmban pretendimin e ngritur (arsyet për pretendimin e cenimit të së drejtës përkatëse), konkluzionin e Gjykatës për pranimin ose jo të pretendimit dhe arsyet kryesore të Gjykatës (zbatimi i standardeve te faktet e çështjes). Te precedentët nuk përmenden standardet, për të mos rënë në përsëritje dhe për të mos e ngarkuar dokumentin. Është menduar se këto tre elemente, të evidentuar

[1] Ndryshuar shkronja "f" e nenit 131 të Kushtetutës, me ligjin kushtetues nr. 76, datë 22.07.2016. Përpara ndryshimeve kushtetuese të ligjit nr. 76/2016, Gjykata Kushtetuese vendoste për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

te precedentët shërbejnë për Gjykatën dhe për të interesuarit për të identifikuar qëndrimet në jurisprudencën kushtetuese për raste të ngjashme. Kuptohet, për të krijuar një ide më të qartë për qëndrimin dhe argumentet e Gjykatës, i interesuari duhet të konsultohet më pas me vendimin e plotë.

Në kreun VI, janë evidentuar standardet dhe precedentët për tri të drejta substanciale, në lidhje me ankimin kushtetues individual: a) kufizimi i lirisë; e drejta e pronës; e drejta e jetës private.

Standardet dhe precedentët/ rastet nga gjykimi kushtetues të referuara përfshijnë jo vetëm ato të evidentuara dhe të shqyrtuara nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual, por edhe ato të kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/akteve normave, që lidhen me të drejtat përkatëse objekt i këtij Udhërrëfyesi. Ligjet/aktet normative, objekt shqyrtimi ose të referuara tek precedentët përkatës, janë ato akte të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e shqyrtimit të këtyre çështjeve.

Udhërrëfyesi, i shërben stafit gjyqësor të Gjykatës për të lehtësuar dhe përmirësuar kapacitetet për kërkimin, analizën dhe shkrimin e projektakteve gjyqësore. Njëkohësisht, ai do të ndihmojë për të qartësuar dhe unifikuar standardet dhe precedentët në jurisprudencën e Gjykatës, në funksion të ruajtjes së koherencës dhe sigurisë ligjore.

Gjithashtu, Udhërrëfyesi i shërben avokatëve, praktikantëve të së drejtës dhe studiuesve për të njohur, referuar dhe vlerësuar në mënyrë efektive dhe kritike jurisprudencën e Gjykatës. Tek e fundit, pritet që kjo të reflektohet në përmirësimin e cilësisë në ankimet kushtetuese individuale, duke kontribuar në rritjen e aksesit të qytetarëve në kontrollin kushtetues dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Udhërrëfyesi u hartua me asistencën dhe mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, nëpërmjet Projektit *"Forcimi i shtetit të së drejtës dhe promovimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet mbështetjes për Gjykatën Kushtetuese"*. Për përgatitjen e këtij materiali u angazhuan në cilësinë e ekspertëve të nivelit të lartë Dr. Sokol Berberi, ish-anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe Dr. Arjana Fullani, ish-anëtare e Gjykatës së Lartë, të cilët u asistuan gjatë punës së tyre nga specialistët ligjorë znj. Aida Maho dhe znj. Kristel Haxhia. Një kontribut mbështetës kanë dhënë znj. Kaliona Nushi dhe znj. Noela Ruço, këshilltare ligjore pranë Njësisë së Shërbimit Ligjor të Gjykatës Kushtetuese.

PËRMBAJTJA

Hyrje/ Sqarim për përdoruesit e Udhërrëfyesit 5

I. **Ankimi kushtetues individual: juridiksioni, fusha e zbatimit dhe kushtet e legjitimimit 13**

1. **Juridiksioni & fusha e zbatimit: kuptimi dhe standardet 13**
a. **Shtrirja e kontrollit kushtetues 13**
b. Aktet që mund t'i nënshtrohen kontrollit 16
- *Rishikimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë 17*
- *Kontrolli kushtetues i aktit të pushtetit publik 17*
- *Kërkesa lidhur me vendimmarrje të mëparshme të Gjykatës 18*
- *Kontrolli kushtetues i rishikimit gjyqësor të formës së prerë 18*
- *Kontrolli kushtetues i vendimeve gjyqësore të ndërmjetme/jo përfundimtare 18*
- *Kontrolli kushtetues ndaj ankimeve kundër vendimeve të shkarkimit të gjyqtarëve 18*
- *Ankimi kushtetues individual për çështje që lidhen me kryerjen e rivlerësimit kalimtar 19*

c. Kufiri ndarës midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të zakonshëm gjyqësor 20
- *Marrja dhe vlerësimi i provave 22*

2. Ankimi kushtetues individual: kushtet e legjitimimit 23
a. Ratione personae 23
- *Ratione personae dhe statusi i viktimës 24*

b. Shterimi i mjeteve 25
- *Shterimi i mjeteve juridike efektive në substancë 26*
- *Lidhur me të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm 27*

c. Ratione temporis 30
- *Ratione temporis dhe mjetet e jashtëzakonshme të ankimit 31*

ç. Ratione materiae 32
- *Kërkesa lidhur me një vendim të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese 33*

II. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit) 35
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 35
- *Garancitë për të drejtën e aksesit në gjykatë 35*
- *E drejta efektive e aksesit në gjykatë 37*
- *E drejta e aksesit në procesin administrativ 37*
- *E drejta e aksesit në gjykatë e lidhur me ankimin në kuptimin substancial 37*
- *Kufizimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës 39*
- *Kufizimi i së drejtës së aksesit në gjykatë nga afatet ligjore 40*
- *E drejta e aksesit në gjykatë dhe kërkesa për rishikim 41*

b. Precedentët ku çështja e cenimit të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës është vënë në diskutim 41
A- **Civile 41**

a) Për gjykatat e faktit 41
b) Për Gjykatën e Lartë 47
▪ *E drejta e aksesit në gjykatë e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor 47*
▪ *Kërkesa për rishikim në Gjykatën e Lartë 49*
▪ *Kufizimi i së drejtës së aksesit në gjykatë për shkak të imunitetit 53*
▪ *Shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë 53*
▪ *Paraqitja e rekursit brenda afatit ligjor dhe e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë 56*
▪ *E drejta e aksesit dhe kërkesa për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë 58*
B- Penale 59
a. Për gjykatat e faktit 59
b. Për Gjykatën e Lartë 61
• *Mosshqyrtimi i rekursit për shkak të mospërfaqësimit me mbrojtës 61*
C- Administrative 71
a) Për gjykatat e faktit 71
b) Për Gjykatën e Lartë 75

III. E drejta për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj: garancitë e përgjithshme/kërkesat institucionale 83
A. Pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës 83

1. Gjykatë e pavarur 83
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 83
• *Pavarësia në raport me pushtetet e tjera 83*
• *Pavarësia e brendshme institucionale 88*
b. Precedentë/raste të gjykimit kushtetues ku çështja e cenimit të pavarësisë është vënë në diskutim 89
• *Pavarësia e brendshme institucionale 97*

2. Gjykatë e paanshme 98
a. E drejta për gjykim nga një gjykatë e paanshme: Kuptimi, parimet dhe standardet përkatëse 98
b. Precedentë/ raste nga gjykimi kushtetues ku çështja e cenimit të paanësisë është vënë në diskutim 100
A- Juridiksioni civil 100
a) Për gjykatat e faktit 100
• *Për pjesëmarrjen dhe rolet e gjyqtarit në procedime/gjykime të mëparshme të lidhura 100*
• *Për shkaqe të tjera që lidhen me raportet dhe sjelljen e gjyqtarit 103*
b) Për Gjykatën e Lartë 105
• *Për pjesëmarrjen dhe rolet e gjyqtarit në procedime/gjykime të mëparshme në gjykatat e faktit 105*
• *Për pjesëmarrjen dhe rolet e gjyqtarit në procedime/gjykime të mëparshme në Gjykatën e Lartë 110*
• *Për shkaqe të tjera që lidhen me raportet dhe sjelljen e gjyqtarit 114*

B- Juridiksioni penal 116
a) Për gjykatat e faktit 116
• *Për pjesëmarrjen dhe rolet e gjyqtarit në procedime/gjykime të mëparshme të lidhura 116*
• *Për shkaqe të tjera që lidhen me raportet dhe sjelljen e gjyqtarit..... 121*
b) Për Gjykatën e Lartë 124
• *Për pjesëmarrjen dhe rolet e gjyqtarit në procedime/gjykime të mëparshme në gjykatat e faktit **124***
• *Për pjesëmarrjen dhe rolet e gjyqtarit në procedime/gjykime të mëparshme në Gjykatën e Lartë **126***
• *Për shkaqe të tjera që lidhen me raportet dhe sjelljen e gjyqtarit..... 129*
C- Juridiksioni Administrativ 131
a) Për Gjykatën e Lartë 131

3. E drejta për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj 134
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 134
b. Precedentë/ raste nga gjykimi kushtetues ku çështja e cenimit të gjykatës së caktuar me ligj është vënë në diskutim 136
A- Juridiksioni civil..... 136
a) Për gjykatat e faktit 136
• *Kompetenca 136*
• *Formimi i trupit gjykues..... 137*
b) Për Gjykatën e Lartë 138
• *Kompetenca 138*
• *Formimi i trupit gjykues..... 142*
B- Juridiksioni penal 143
a) Për gjykatat e faktit 143
• *Kompetenca 143*
• *Formimi i trupit gjykues..... 147*
b) Për Gjykatën e Lartë 147
• *Kompetenca 147*
C- Juridiksioni administrativ 150
a) Për gjykatat e faktit 150
• *Kompetenca 150*
b) Për Gjykatën e Lartë 150
• *Kompetenca 150*
• *Formimi i trupit gjykues..... 154*

IV. Garancitë e përgjithshme (penale/ civile): kërkesat procedurale 157
A. Proces i drejtë 157

1. E drejta për t'u njoftuar 157
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 157
b. Precedentët ku çështja e cenimit të së drejtës për t'u njoftuar është vënë në diskutim .. 160
A- **Civile..... 160**
a) Për gjykatat e faktit 160
b) Për Gjykatën e Lartë 160
• *Kërkesa për rishikim 160*
B- Penale..... 161

a) Për gjykatat e faktit 161
b) Për Gjykatën e Lartë 162
C- Administrative 163
a) Për gjykatat e faktit.....163
b) Për Gjykatën e Lartë 164

2. E drejta për t'u dëgjuar 167
a. **Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 167**
b. Precedentët ku çështja e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar është vënë në diskutim 168
A- Për organet e administratës publike 168
B- Civile..... 170
a) Për Gjykatën e Lartë 170
• *Kërkesa për rishikim 170*
C- **Penale..... 171**
a) Për Gjykatën e Lartë 171
Ç- Administrative 172
a) Për Gjykatën e Lartë 172

3. E drejta për t'u mbrojtur 173
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 173
b. Precedentët ku çështja e cenimit të së drejtës për t'u mbrojtur është vënë në diskutim 176
A - Civile..... 176
a) Për Gjykatën e Lartë 176
B - Penale..... 179
a) Për gjykatat e faktit 179
b) Për Gjykatën e Lartë 181
C - Administrative..... 182
a) Për gjykatat e faktit.....182
b) Për Gjykatën e Lartë 183
• *Me avokat të zgjedhur ose të caktuar kryesisht.....184*
a) Për gjykatat e faktit.....184
b) Për Gjykatën e Lartë 185
• *Personalisht.....188*
a) Për Gjykatën e Lartë 188
• *Standardet e gjykimit në mungesë.....190*
a) Për gjykatat e faktit 190
b) Për Gjykatën e Lartë 190

4. Parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit 192
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 192
b. Precedentët ku çështja e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është vënë në diskutim.....193
A – Civile 193
a) Për Gjykatën e Lartë 193
B - Penale..... 195
a) Për gjykatat e faktit 195
b) Për Gjykatën e Lartë 196
C - Administrative..... 197
a) Për gjykatat e faktit.....197

b) Për Gjykatën e Lartë 198
5. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore 201
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 201
b. Precedentët ku çështja e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është vënë në diskutim 202
• *Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike 202*
A – Civile 202
a) Për Gjykatën e Lartë 202
B - Penale 204
a) Për Gjykatën e Lartë 204
C - Administrative 205
a) Për gjykatat e faktit 205
b) Për Gjykatën e Lartë 206
• *Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial 207*
A – Civile 207
a) Për gjykatat e faktit 207
b) Për Gjykatën e Lartë 208
• *Kërkesa për rishikim 209*
B – Penale 212
a) Për gjykatat e faktit 212
b) Për Gjykatën e Lartë 214
• Depozitimi i rekursit brenda afatit 215
C – Administrative 216
a) Për gjykatat e faktit 216
b) Për Gjykatën e Lartë 217
• *Shqyrtimi i shkaqeve të papretenduara në rekurs me nismë të Gjykatës së Lartë 217*
• *Për cenimin e standardit të arsyetimit lidhur me zbatimin e parimit të gjësë së gjykuar 219*
A – Civile 219
a) Për Gjykatën e Lartë 219
B - Administrative 220
a) Për Gjykatën e Lartë 220
• *Për cenimin e lirisë personale të individit në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit 221*
A – Penale 221
a) Për Gjykatën e Lartë 221

6. Parimi i gjësë së gjykuar (res judicata) 225
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 225
b. Precedentët ku çështja e cenimit të parimit të gjësë së gjykuar është vënë në diskutim . 225
A- Civile 225
a) Për gjykatat e faktit 225
b) Për Gjykatën e Lartë 226
B- Penale 226
a) Për Gjykatën e Lartë 226
C- Administrative 227
a) Për gjykatat e faktit 227

b) Për Gjykatën e Lartë 227
7. Parimi i sigurisë juridike 229
a. **Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 229**
b. Precedentët ku çështja e cenimit të parimit të sigurisë juridike është vënë në diskutim.. 230
A- Civile 230
a) Për Gjykatën e Lartë 230
• *Lënia në fuqi e vendimeve gjyqësore që disponojnë në mënyra të ndryshme . 230*
• *Vendimi i formës së prerë: mosshqyrtimi i pretendimeve ose prishja e tyre ... 232*
A- **Civile 232**
B- **Penale 235**
a) Për Gjykatën e Lartë 235
C- Administrative 235
a) Për gjykatat e faktit 235
b) Për Gjykatën e Lartë 236
8. Barazia para ligjit dhe ndalimi i diskriminimit 237
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 237
b. Precedentët ku çështja e cenimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit është vënë në diskutim 238
A– Civile 238
a) Për Gjykatën e Lartë 238
B – Administrative 238
a) Për Gjykatën e Lartë 238

9. E drejta e ankimit 240
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 240
b. Precedentët ku çështja e cenimit të së drejtës së ankimit është vënë në diskutim 241
A- Civile 241
a) Për gjykatat e faktit 241
b) Për Gjykatën e Lartë 241
B- Penale 242
a) Për gjykatat e faktit 242
b) Për Gjykatën e Lartë 243
C- Administrative 244
a) Për gjykatat e faktit 244
b) Për Gjykatën e Lartë 245

10. Procedimi/seanca publike 247
a. Precedentët ku çështja e cenimit të së drejtës për seancë publike është vënë në diskutim 247
B. Afati i arsyeshëm për gjykimin dhe për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë 248
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 248
B.1 - Përcaktimi i kohëzgjatjes së procedimeve 249
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 249
b. Precedentët ku çështja e cenimit të afatit së arsyeshëm është vënë në diskutim 250
• *Sjellja e kërkuesit 250*
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 250
b. Precedentët ku sjellja e kërkuesit është vënë në diskutim 251
• *Kompleksiteti i çështjes 252*

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 252
b. Precedentët ku kompleksiteti i çështjes është vënë në diskutim 252
• *Sjellja e autoriteteve 254*
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 254
b. Precedentët ku sjellja e autoriteteve është vënë në diskutim 255
• *Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi 256*
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 256
b. Precedentët ku vlerësimi i interesit të kërkuesit dhe rrezikut që pasjell tejzgjatja e procedurave është vënë në diskutim 257
B.2 Vlerësimi i afatit të arsyeshëm 259
a. Precedentët ku vlerësimi i afatit të arsyeshëm është vënë në diskutim 259
B.3 Efektiviteti i mjeteve të reja juridike 260
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 260
b. Precedentët ku efektiviteti i mjeteve të reja juridike është vënë në diskutim 261
C. Fuqia detyruese e vendimeve: 262
C.1. të Gjykatës Kushtetuese 262
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 262
b. Precedentët ku fuqia detyruese e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është vënë në diskutim 263
C.2. të GJEDNJ-së 266
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 266
b. Precedentët ku çështja e fuqisë detyruese të vendimeve të GJEDNJ-së është vënë në diskutim 267

V. Garancitë në aspektin penal: kërkesat procedurale 269
A. Garancitë e Përgjithshme 269

1. E drejta për të qëndruar në heshtje dhe për të mos u vetakuzuar 269
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 269
b. Precedentët ku e drejta për të qëndruar në heshtje dhe për të mos u vetakuzuar është vënë në diskutim 269

2. Ligjshmëria e marrjes së provave 270
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 270
b. Precedentët ku deklarimi fajtor dhe dënimi mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme është vënë në diskutim 271

B. Garanci specifike 275
1. Mosdënimi pa ligj 275
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 275
b. Precedentët ku çështja e mosdënimit pa ligj është vënë në diskutim 276
a) Për Gjykatën e Lartë 276
2. Fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues 278
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 278
b. Precedentët ku çështja e përfitimit nga fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues është vënë në diskutim 278
a) Për gjykatat e faktit 278
b) Për Gjykatën e Lartë 279

3. Prezumimi i pafajësisë 282
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 282
b. Precedentët ku çështja e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë është vënë në diskutim 283
a) Për gjykatat e faktit 283
b) Për Gjykatën e Lartë 284

4. Mosgjykimi dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*) & Gjëja e gjykuar (*res judicata*) në aspektin penal. 289
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 289
b. Precedentët ku çështja e cenimit të parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale dhe i gjësë së gjykuar është vënë në diskutim 290
a) Për gjykatat e faktit 290
b) Për Gjykatën e Lartë 291

5. Mosrëndimi i pozitës së të pandehurit (Ndalimi i *reformatio in peius*) 294
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 294
b. Precedentët ku çështja e cenimit të parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit është vënë në diskutim 295
a) Për Gjykatën e Lartë 295

VI. Garanci specifike në lidhje me të drejtat substanciale 299
1. Kufizimi i lirisë 299
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 299
- *1.a - Kontrolli gjyqësor i masave të sigurimit që kufizojnë lirinë 300*
- *1.b - Dyshimet e arsyeshme për kryerjen e veprës penale 300*
- *1.c - Kufizimi i lirisë si sanksion penal 301*

b. Precedentët ku çështja e heqjes së lirisë është vënë në diskutim 301
a) Për Gjykatën e Lartë 301

2. E drejta e pronës 304
a. E drejta e pronës: kuptimi dhe standardet 304
- *Për kuptimin e nenit 41 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së 304*
- *Lidhur me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave 308*
- *Lidhur me shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik 312*

b. Precedentë ku çështja e cenimit të së drejtës së pronës është vënë në diskutim 315
- *E drejta e pronës e lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës për një proces të* rregullt lig*jor 315*
- *Lidhur me shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik 320*
- *Lidhur me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave 324*

3. E drejta e jetës private 333
a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse 333
b. Precedentë ku çështja e cenimit të së drejtës për jetë private është vënë në diskutim . 335

I. Ankimi kushtetues individual: juridiksioni, fusha e zbatimit dhe kushtet e legjitimimit

Kushtetuta
Neni 131[2]
1. Gjykata Kushtetuese vendos për:
...
f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

Neni 134[3]
1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të:
…
i) individëve.
2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët "d", "dh", "e", "ë", "f", "g", "gj", "h" dhe "i" të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

1. Juridiksioni & fusha e zbatimit: kuptimi dhe standardet[4]

a. Shtrirja e kontrollit kushtetues[5]

1. Juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, i cili përcakton funksionin themelor të saj, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese *(shih vendimet nr. 4, datë 08.02.2023, paragrafi 17; nr. 38, datë 09.12.2022, paragrafi 17; nr. 36, datë 04.11.2021, paragrafi 32; nr. 29, datë 30.06.2011, paragrafi4, të GJK-së)*. Interpretimi përfundimtar i ligjit themelor të shtetit është ndër funksionet më të rëndësishme të kësaj

[2] Ndryshuar shkronja "f" me ligjin kushtetues nr. 76/2016, datë 22.7.2016.
[3] Po aty.
[4] Standardet e përmendura në këtë pjesë përfshijnë standardet e evidentuara në jurisprudencën e Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/akteve normave dhe ato nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual.
[5] Përpara ndryshimeve kushtetuese të ligjit nr. 76/2016, Gjykata Kushtetuese vendoste për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Gjykate, të cilin ajo e ushtron sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese. Nëpërmjet interpretimit që u bën normave ose termave konkretë të Kushtetutës, Gjykata përcakton standardet kushtetuese mbi të cilat duhet të mbështetet veprimtaria e organeve kushtetuese dhe kërkesat në ushtrimin e veprimtarisë së tyre vendimmarrëse *(shih vendimet nr. 38, datë 09.12.2022, paragrafi 17; nr. 36, datë 04.11.2021, paragrafi 32; nr. 29, datë 21.10.2009, paragrafi 5, të GJK-së)*.

2. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 134, pika 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (*ligji nr. 8577/2000*), çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Objekt i gjykimit kushtetues mund të jetë çdo akt i pushtetit publik ose vendim gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë (*shih vendimin nr. 17, datë 09.02.2021, parag.6, të Mbledhjes së Gjyqtarëve të GJK-së*).

3. Gjykata ka theksuar se natyra e pretendimeve të ngritura para saj është një nga elementet përcaktuese të juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e një çështjeje dhe se, në përputhje me kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta, ajo e përcakton vetë juridiksionin e saj gjatë shqyrtimit të çështjeve, rast pas rasti (*shih vendimet nr. 4, datë 08.02.2023, paragrafi 17; nr. 38, datë 09.12.2022, paragrafi 17; nr. 7, datë 23.02.2021, paragrafi 18, të GJK-së*).

4. Neni 124 i Kushtetutës përcakton funksionin themelor të saj, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese, ndërkohë që juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës, ku veçanërisht neni 131 parashikon kompetencën kushtetuese sipas natyrës së çështjes, por pa u kufizuar në të, për sa kohë që Gjykata ka për detyrë të vendosë edhe për çështje që janë të parashikuara shprehimisht në norma të tjera kushtetuese. Neni 131 i Kushtetutës, që përcakton kompetencat kryesore të Gjykatës, dhe neni 134, që përcakton subjektet që e vënë në lëvizje, nuk mund të lexohen të shkëputura nga dis pozitat e tjera kushtetuese materiale ose procedurale, të cilat përkufizojnë kompetencën, si dhe përcaktojnë mekanizmin dhe procedurën për vënien në lëvizje të kësaj Gjykate. Kjo sepse normat kushtetuese nuk mund të interpretohen si norma të izoluara, por duhen parë në harmoni me normat e tjera kushtetuese. Në leximin e Kushtetutës nevojitet harmonizimi i tekstit të saj integral dhe pajtimi i atyre dispozitave që mund të duket se krijojnë përplasje mes tyre (*shih vendimet nr. 38, datë 09.12.2022, paragrafi 18; nr. 7, datë 24.02.2016, parag. 9; nr. 29, datë 30.06.2011, paragrafi 4, të GJK-së*).

5. Kontrolli kushtetues, në çdo rast, nuk mund të bëhet pa interpretimin e kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim (*shih vendimet nr. 36, datë 04.11.2021, paragrafi 32; nr. 7, datë 24.02.2016, paragrafi 10; nr. 29, datë 30.06.2011, paragrafi 5, të GJK-së*). Veçanërisht në rastet kur bëhet fjalë për të drejtat themelore të

njeriut, interpretimi përfundimtar i normës kushtetuese është në kompetencë të GJK-së (*shih vendimin nr. 62, datë 26.05.2022, paragrafi 14, të Mbledhjes së Gjyqtarëve të GJK-së; vendimin nr. 20, datë 01.06.2011 të GJK-së*).

6. Nisur nga tagrat që i jep neni 124 i Kushtetutës, roli dhe funksioni i Gjykatës Kushtetuese është që, nëpërmjet vendimeve, të transformojë dispozitat kushtetuese nga abstrakte-metafizike, në substanciale dhe konkrete, duke i garantuar mbrojtje kushtetuese situatave juridike në të cilat ndodhen individët. Për shkak te vetë formës ekstremisht koncize që kanë dispozitat kushtetuese, nëpërmjet vendimeve, pra interpretimit që bën Gjykata, bëhet e mundur që Kushtetuta të jetë "e gjallë", që do të thotë se Gjykata i përshtatet evolucionit që bëjnë vlerat në vendin tonë, duke garantuar që vlera të reja, të cilat ndoshta nuk ishin në vëmendje të hartuesve të Kushtetutës, të marrin dinjitet, njohje dhe, mbi të gjitha, mbrojtje kushtetuese. Për vetë faktin se norma kushtetuese bëhet realitet gjatë interpretimit, pra, gjatë procesit vendimmarrës të Gjykatës, e bën këtë të fundit pa diskutim burim të së drejtës, për më tepër e bën atë një burim parësor të saj, duke pasur parasysh se neni 4 i Kushtetutës parashikon se Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuptim mund të themi se Gjykata ka dy funksione themeltare: atë shtytës-evolutiv të përshkruar më sipër, i cili shpesh është rrjedhojë e vlerës që kanë vendimet e GJEDNJ-së dhe faktit se Gjykata mund të përdorë në mbështetje të arsyetimeve të veta qëndrimet që kanë mbajtur Gjykatat homologe evropiane dhe më gjerë dhe, nga ana tjetër, funksionin mbrojtës-konservativ, duke garantuar pandryshueshmërinë e mbrojtjes kushtetuese për ato vlera që konsiderohen si kryesore nga populli i Republikës së Shqipërisë, vullnetin e të cilit interpreton Gjykata Kushtetuese. Të dyja këto funksione janë njëherazi të rëndësishme dhe të barasvlershme. (*shih vendimin nr. 20, datë 01.06.2011, të GJK-së*). Natyra e pretendimeve të ngritura para saj është një nga elementet përcaktuese të juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e një çështjeje dhe se, në përputhje me kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta, ajo e përcakton vetë juridiksionin e saj gjatë shqyrtimit të çështjeve, rast pas rasti (*shih vendimet nr. 38, datë 09.12.2022, paragrafi 19; nr. 7, datë 23.02.2021, paragrafi 18; nr. 4, datë 15.02.2021, paragrafi 27, të GJK-së*).

7. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 27, datë 27.10.2022, paragrafi 11; nr. 63, datë 31.07.2017, paragrafi 18; nr. 3, datë 23.02.2016, paragrafi 12, të GJK-së*).

8. Gjykata ka të drejtë që, në rast se ajo vërteton se shkelja e një të drejte ose lirie kushtetuese themelore nuk ka ardhur si pasojë e përmbajtjes së normës ligjore, por për shkak të mosveprimit të ligjvënësit për rregullimin e një çështjeje të caktuar, në rolin e saj si ligjvënës negativ, ajo jo vetëm konstaton boshllëkun, por, në përputhje me nenin 76, pika 5, të ligjit nr. 8577/2000, vendos detyrimin e ligjvënësit për të plotësuar kuadrin ligjor brenda një afati të caktuar. Në të tilla gjykime konstatimi i Gjykatës nuk është formal, pasi një qëndrim i tillë nuk përputhet me funksionin e kësaj Gjykate, por është rezultat i

shqyrtimit të pasojave të ardhura në aspektin kushtetues në të drejtat dhe liritë themelore, pra duke iu nënshtruar edhe këto çështje juridiksionit kushtetues (*shih vendimin nr. 38, datë 09.12.2022, paragrafi 23, të GJK-së*).

9. Fillimisht, kërkesat për gjykimin ose ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm nuk janë pranuar për shqyrtim nga Gjykata, me arsyetimin se nuk hynin në juridiksionin kushtetues. Gjykata e ndryshoi jurisprudencën e saj në vitin 2006, pas vendimit të GJEDNJ-së në çështjen Qufaj kundër Shqipërisë, datë 18.09.2004, duke e konsideruar ekzekutimin e vendimeve brenda afatit të arsyeshëm si pjesë të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) (*shih vendimin nr. 6, datë 31.03.2006 të GJK-së*). Në vijim, Gjykata, në bazë të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ka vlerësuar, gjithashtu, se mund të merren në shqyrtim prej saj edhe kërkesat e individëve për cenimin e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre ende nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr.44, datë 26.09.2023, paragrafi 28; nr. 12, datë 05.03.2012 të GJK-së*).

b. Aktet që mund t'i nënshtrohen kontrollit

10. Objekt kundërshtimi, brenda juridiksionit të Gjykatës, mund të jetë çdo vendim gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pra, çdo proces gjyqësor përmes të cilit pretendohet se janë cenuar garancitë kushtetuese të individit, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 62, datë 26.05.2022, paragrafi17, të Mbledhjes së Gjyqtarëve të GJK-së*).

11. Bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja "e" dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual, krahas vendimit gjyqësor, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, nisur nga përmbajtja e normave kushtetuese dhe atyre ligjore, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kritere: (i) legjitimimi ratione personae, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimimi ratione temporis, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) dhe legjitimimi ratione materiae, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023, paragrafi 28; nr. 31, datë 04.10.2021, paragrafi 20, të GJK-së*).

- ***Rishikimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë***

12. Jurisprudenca e GJEDNJ-së ka theksuar se garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së nuk gjejnë zbatim në rastet e gjykimeve të kërkesave për rishikim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat nuk pranohen nga gjykatat, pasi ky nen nuk garanton të drejtën për rihapje të procedurave gjyqësore. Megjithatë, gjykimi i ri, pas riçeljes së procedurave, përfshihet në mbrojtjen e nenit 6 të KEDNJ-së, pasi, përmes tij, vendoset për të drejta dhe detyrime civile ose për një akuzë penale. Në këtë kuptim, një kërkesë për rishikim, e cila nuk pranohet nga gjykatat, ratione materiae, nuk vendos për të drejta dhe detyrime civile ose një akuzë penale (*shih vendimet e GJEDNJ-së Rizi kundër Shqipërisë, datë 08.11.2011, §§ 47-48; Alekseyenko kundër Rusisë, datë 08.01.2009, § 55*). Duke përcaktuar të drejtën e individit për të kundërshtuar çdo vendim gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë e tij, Kushtetuta ka përcaktuar një standard edhe më të lartë se GJEDNJ-ja lidhur me garancitë dhe të drejtat themelore të individit të njohura e të garantuara me Kushtetutë dhe me ligj (*shih vendimin nr. 62, datë 26.05.2022, paragrafi 18, të Mbledhjes së Gjyqtarëve të GJK-së*).

- ***Kontrolli kushtetues i aktit të pushtetit publik***

13. Koncepti kushtetues i aktit të pushtetit publik, që mund të jetë objekt i ankimit kushtetues individual, përfshin edhe ligjin, por kur plotësohet kriteri i veçantë për pranueshmërinë e ankimit, i parashikuar nga neni 49, pika 3, shkronja "e", i ligjit nr. 8577/2000, ai i zbatueshmërisë së drejtpërdrejtë të ligjit të kundërshtuar. Karakteristika e zbatimit të drejtpërdrejtë të ligjit lidhet me aftësinë që ka ligji i kundërshtuar për të cenuar në mënyrë po të drejtpërdrejtë të drejtën themelore individuale dhe, për këtë arsye, bëhet fjalë për ato raste kur ligji nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e tij. Kjo nënkupton që ligji i shkakton pasojat e tij ndaj të drejtave kushtetuese individuale pa pasur nevojën e detajimit të rregullave shtesë në formën e akteve nënligjore (*shih vendimin nr. 46, datë 18.03.2021, paragrafi 10, të Mbledhjes së Gjyqtarëve të GJK-së*).

14. Gjykata është kompetente për shqyrtimin e procesit ligjor, me karakter administrativ, edhe kur ky proces kryhet me anë të procedurave parlamentare (*shih vendimet nr. 21, datë 01.10.2008;nr. 76, datë 25.04.2002 të GJK-së*).

15. Si rregull, normat juridike i nënshtrohen kontrollit kushtetues nëse janë në fuqi në kohën e kontrollit ose, e thënë ndryshe, nëse janë akte të vlefshme që prodhojnë pasoja juridike (*shih vendimet nr. 4, datë 08.02.2023, paragrafi 21; nr. 38, datë 09.12.2022, paragrafi 26; nr. 9, datë 19.03.2008 të GJK-së*). Përjashtimisht, kontrollit kushtetues i nënshtrohen edhe normat juridike të shfuqizuara, kur këto, si pjesë e së drejtës pozitive, duhet të zbatohen për rregullimin e pasojave juridike që zgjasin në kohë dhe janë të lidhura me ekzekutimin periodik ose me afat të detyrimeve juridike civile që rrjedhin nga marrëdhënie juridike të krijuara në kohën e ligjit të shfuqizuar (*shih vendimet nr. 4, datë 08.02.2023, paragrafi 21; nr. 8, datë 07.02.2017, paragrafi 17; nr. 2, datë 31.01.2003 të GJK-së*).

- ***Kërkesa lidhur me vendimmarrje të mëparshme të Gjykatës***

16. Një prej kritereve që përcakton kufijtë e juridiksionit të Gjykatës parashikohet nga shkronja "dh" e pikës 2 të nenit 31/a të të njëjtit ligj, sipas së cilës kur kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës vendoset moskalimi i çështjes në seancë plenare. Ky rregull ligjor synon të garantojë sigurinë juridike, duke parandaluar kërkesat drejtuar Gjykatës për rishqyrtimin e vendimmarrjes së mëparshme të saj nga të njëjtët kërkues, për të njëjtat fakte dhe për të njëjtat pretendime (*shih vendimin nr. 155, datë 16.11.2022, paragrafi 10, të Mbledhjes së Gjyqtarëve të GJK-së*).

- ***Kontrolli kushtetues i rishikimit gjyqësor të formës së prerë***

17. Vlerësimi i respektimit të standardeve kushtetuese gjatë procesit të rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë i nënshtrohet juridiksionit kushtetues (*shih vendimet nr. 11, datë 10.03.2023, paragrafi 29; nr. 5, datë 01.03.2018, paragrafi 12; nr. 49, datë 10.07.2015, paragrafi 32, të GJK-së*).

- ***Kontrolli kushtetues i vendimeve gjyqësore të ndërmjetme/jo përfundimtare***

18. Gjykata nuk vë në dyshim karakterin e ndërmjetëm të vendimit të sekuestrimit të pasurisë, në kuptim të rolit që ky vendim luan në procedurën dhe vendimmarrjen përfundimtare për konfiskimin e pasurisë. Megjithatë, në raste përjashtimore, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore të ndërmjetme, nëse plotësohen njëherazi tre kushte: (i) kur shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; (ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) dhe vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022, paragrafi 21; nr. 14, datë 11.03.2021, paragrafi 33, të GJK-së*).

- ***Kontrolli kushtetues ndaj ankimeve kundër vendimeve të shkarkimit të gjyqtarëve***

19. Juridiksioni i Gjykatës për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të shkarkimit të gjyqtarëve i ka kaluar juridiksionit disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (*KPA*), gjatë periudhës së funksionimit të tij sipas mandatit përkatës. Për rrjedhojë, pretendimet që lidhen me procedurat e shkarkimit të gjyqtarëve dhe të subjekteve të barazuar me ta nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese. Nga kjo pikëpamje, si dhe duke mbajtur në konsideratë mënyrën se si është konceptuar përgjegjësia disiplinore e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit në Kushtetutë dhe ligj, pra, procedura e shqyrtimit të shkeljes disiplinore, organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre, kompetencat që ushtrojnë ato organe, baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari dhe të drejtat që gëzojnë personat që i nënshtrohen procedimit disiplinor, Mbledhja e

Gjyqtarëve vlerëson se Kushtetuta, duke barazuar statusin e Komisionerit Publik me atë të anëtarit të Gjykatës së Lartë dhe duke deleguar njëherazi rregullimin me ligj të përgjegjësisë së tij disiplinore, ka ngarkuar KPA-në të jetë organi, i cili duhet të ofrojë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt ligjor, përfshirë të drejtën e ankimit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 17, datë 09.02.2021, paragrafët 15-16, të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

20. Në kushtet kur vetë Kushtetuta në nenin 179, pika 7, fjalia e parë, ka përcaktuar juridiksionin disiplinor të KPA-së ndaj gjyqtarëve të Gjykatës, anëtarëve Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGJ*), anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (*ILD*), kompetenca për të marrë në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të ILD-së me natyrë disiplinore, qofshin ato vendime për fillimin e procedimit disiplinor ose për arkivimin e ankesës, përgjatë gjithë periudhës së mandatit 9-vjeçar të funksionimit të KPA-së, i është dhënë shprehimisht kësaj të fundit (*shih vendimin nr. 86/1, datë 28.09.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

- ***Ankimi kushtetues individual për çështje që lidhen me kryerjen e rivlerësimit kalimtar***

21. Juridiksioni i Gjykatës, në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual për çështje që lidhen me kryerjen e rivlerësimit kalimtar, është i kufizuar nga vetë Kushtetuta, e cila në Aneksin e saj këto kompetenca ua ka deleguar organeve të rivlerësimit. Kështu, neni 179/b, pika 2, i Kushtetutës parashikon se procesi i rivlerësimit, që realizohet nga KPK-ja dhe KPA-ja, do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt ligjor, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit. Ndërsa në Nenin A, pika 1, të Aneksit të Kushtetutës parashikohet se me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i ankimit individual kushtetues kufizohet pjesërisht për subjektet e rivlerësimit, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës. Gjithashtu, Neni F, pika 8, i Aneksit të Kushtetutës parashikon se subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në GJEDNJ, pra duke përjashtuar kështu të drejtën për ankim kushtetues individual (*shih vendimin nr. 110, datë 28.09.2021, paragrafi17, të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

22. Gjykata evidenton se përpara ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, mosmarrëveshjet e ngritura në bazë të ankimeve ndaj vendimeve të KLD-së për shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve përfshiheshin në juridiksionin gjyqësor (fillestar) të Gjykatës së Lartë, ku kompetenca lëndore dhe ajo funksionale për shqyrtimin e tyre u përkiste Kolegjeve të Bashkuara të saj. Ndërsa, pas ndryshimeve të vitit 2016, mosmarrëveshjet e ngritura në bazë të ankimeve kundër vendimeve disiplinore në përgjithësi ndaj gjyqtarëve, përfshirë edhe shkarkimin e tyre nga detyra, u përfshinë në juridiksionin kushtetues. Thënë ndryshe, pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, Gjykatës së Lartë i është hequr e drejta për të shqyrtuar dhe zgjidhur mosmarrëveshjet e ngritura mbi ankimet kundër vendimeve të shkarkimit të gjyqtarëve, duke rënë për pasojë edhe kompetenca e saj lëndore për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të kësaj natyre. Gjithashtu, referuar përmbajtjes së dispozitave kushtetuese, gjatë periudhës kalimtare të

ushtrimit të mandatit nga KPA-ja, juridiksioni gjyqësor disiplinor i përket ekskluzivisht kësaj të fundit dhe, vetëm në përfundim të këtij mandati kushtetues, ky juridiksion do të ushtrohet nga Gjykata (*shih vendimin nr. 36, datë 24.11.2022, paragrafi 31, të GJK-së*).

c. Kufiri ndarës midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të zakonshëm gjyqësor

23. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 01.03.2018, paragrafi 23; nr. 23, datë 20.04.2016, paragrafi 15, të GJK-së*). Interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 42, datë 25.05.2017, paragrafi 8; nr. 23, datë 17.05.2011 të GJK-së*). Edhe sipas GJEDNJ-së, funksioni i saj nuk është të zgjidhë gabimet në 'ligj' ose 'fakt' të gjykatave vendase, përveçse nëse ato cenojnë të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa, si për shembull procesin e rregullt ligjor, të garantuar nga neni 6 i KEDNJ-së ... Ajo nuk funksionon si gjykatë e katërt, për rrjedhojë nuk vë në diskutim, sipas nenit 6/1, vlerësimin e gjykatave vendase, përveçse nëse gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare dhe haptazi të paarsyeshme (*shih vendimin e GJEDNJ-së për çështjen Tommaso kundër Italisë, datë 23.02.2017, § 170; shih vendimin nr. 62, datë 26.05.2022, paragrafi 43, të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

24. Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor, të cilat nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit gjyqësor (*shih vendimin nr. 45, datë 26.03.2015, paragrafi 14, të mbledhjes së Gjyqtarëve;; vendimet nr. 19, datë 02.04.2012, paragrafi 16; nr. 7, datë 27.04.2005; nr. 106, datë 01.08.2001 të GJK-së*).

25. Jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, për të investuar Gjykatën për zgjidhjen e tyre sa herë shfaqet prezenca e shkeljes së normave procedurale dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe çdo të drejtë tjetër të njohur me Kushtetutë dhe me ligj (...) Detyra e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë (*shih vendimin nr. 20, datë 08.02.2013, paragrafi 11, të Mbledhjes së Gjyqtarëve; vendimet nr.40, datë 22.09.2011, paragrafi 31; nr.7, datë 28.02.2000; nr.25, datë 28.10.2005 të GJK-së*).

26. Nuk i takon Gjykatës të verifikojë nëse zbatohen ose jo udhëzimet e kolegjeve të Gjykatës së Lartë ndaj gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit. U takon pikërisht këtyre kolegjeve të verifikojnë zbatimin e udhëzimeve të tyre e jo Gjykatës (*shih vendimin nr. 22, datë 06.06.2011 të GJK-së*).

27. Kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Gjykata ka theksuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023, paragrafi 25; nr. 38, datë 02.12.2021, paragrafi 26; nr. 9, datë 26.03.2018, paragrafi 11, të GJK-së*).

28. Kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimin nr. 41, datë 29.12.2005, të GJK-së*).

29. Gjykata, siç është përcaktuar në nenin 131/f të Kushtetutës, ka në juridiksion të vlerësojë vetëm zbatimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor. Kjo Gjykatë nuk mund ta bëjë objekt të shqyrtimit të saj vlerësimin ligjor të bërë nga Gjykata e Lartë lidhur me ligjshmërinë e pretendimeve për rishikim të palëve për sa kohë, nuk konstaton se nga ky vlerësim preket e drejta kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 8, datë 21.02.2007 të GJK-së*).

30. E drejta për një proces të rregullt ligjor është e drejtë kushtetuese e individit që lidhet me rregullsinë e procesit në sistemin gjyqësor. Por, duke zbatuar kompetencën e saj për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e kësaj të drejte, Gjykata Kushtetuese nuk mund ta shtrijë kontrollin e saj mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse kjo i takon juridiksionit gjyqësor. Në shqyrtimin e ankesave për shkelje të tilla, kjo Gjykatë kontrollon nëse janë respektuar nga gjykatat e sistemit gjyqësor parimet themelore të procesit sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 32, datë 09.07.2007 të GJK-së*).

31. Interpretimi dhe zbatimi i ligjit, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Gjykata ndërhyn në ato raste kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave

të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 12, datë 15.03.2023, paragrafi 25; nr. 43, datë 27.12.2022, paragrafi 32; nr. 3, datë 23.02.2016, paragrafi 12; nr. 31, datë 05.07.2011; nr.22, datë 22.07.2009 të GJK-së*).

32. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 49, datë 29.09.2014, paragrafi11; nr. 58, datë 24.12.2012, paragrafi 21; nr. 4, datë 28.02.2006 të GJK-së*).

33. Kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme dhe se raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme udhëhiqen nga parimi i subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 45, datë 03.07.2017 të GJK-së*).

- ***Marrja dhe vlerësimi i provave***

34. Marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre, është në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugën e mënyrën e marrjes dhe fiksimit të provave, por jo të vlerësimit të tyre (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022, paragrafi 34; nr. 83, datë 30.12.2016, paragrafi 12, të GJK-së*). Mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material është, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues. Detyra e Gjykatës është që të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i Gjykatës nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme (*shih vendimet nr. 26, datë 09.05.2014; nr. 19, datë 02.04.2012; nr. 47, datë 07.11.2011; nr. 22, datë 22.07.2009 të GJK-së*).

35. Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar dhe riparuar nga Gjykata e Lartë. Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 49, datë 29.09.2014, paragrafi 12; nr. 4, datë 28.02.2006 të GJK-së*).

36. Çështja e çmuarjes së provave dhe interpretimit të ligjit u përket gjykatave të zakonshme. Kjo Gjykatë ka pohuar gjatë jurisprudencës së saj se, si rregull, interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues Megjithatë, kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues. (*shih vendimet nr. 4, datë*

21.02.2022, paragrafi 56; nr. 62, datë 23.09.2015, paragrafi 22; nr. 16, datë 19.04.2013, paragrafi 23, të GJK-së).

2. Ankimi kushtetues individual: kushtet e legjitimimit

1. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kritereve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues (*shih vendimin nr. 34, datë 12.06.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

2. Bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja "e" dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual, krahas vendimit gjyqësor, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, nisur nga përmbajtja e normave kushtetuese dhe atyre ligjore, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kritere: (i) legjitimimi ratione personae, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimimi ratione temporis, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) dhe legjitimimi ratione materiae, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të GJK-së*).

a. Ratione personae

3. Në lidhje me legjitimimin ratione personae, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë

legjitimitetin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimin nr. 44, datë 26.09.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

4. Kushtetuta, në nenin 16,[6] ka lejuar ushtrimin e ankimit kushtetues nga personat juridikë privatë e publikë, për aq sa të drejtat, liritë themelore, si dhe detyrimet përputhen me thelbin si dhe me qëllimet e përgjithshme të këtyre subjekteve. Personat juridikë publikë legjitimohen të vënë në lëvizje një gjykim kushtetues kur ata marrin pjesë në qarkullimin civil dhe cenohen njëlloj si të ishin qytetarë të thjeshtë, si dhe në rastet kur janë ngarkuar drejtpërdrejt me mbrojtjen e një fushe të caktuar të drejtash themelore që shërbejnë direkt për të forcuar autonominë e tyre. Në këtë vështrim, personat juridikë publikë do të trajtohen si individë, në kuptim të nenit 134/1, shkronja "g", në lidhje me nenin 16/2 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 19, datë 21.01.2014 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; vendimin nr. 39, datë 23.12.2003 të GJK-së*). Nisma për një gjykim kushtetues nuk kushtëzohet nga karakteri i personit juridik, publik a privat, por nga natyra e pretendimeve që parashtrohen në kërkesën drejtuar Gjykatës, të cilat duhet të kenë lidhje me cenimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës (*shih vendimin nr. 19, datë 21.01.2014 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; vendimin nr. 14, datë 03.06.2009 të GJK-së*).

- ***Ratione personae dhe statusi i viktimës***

5. Gjykata, referuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, ka mbajtur qëndrimin se një vendim ose masë e favorshme, parimisht, është e mjaftueshme për të përjashtuar statusin e "viktimës" vetëm nëse autoritetet kombëtare kanë njohur në mënyrë të shprehur dhe në thelb shkeljen dhe e kanë riparuar atë (shih Simaldone kundër Italisë, nr. 22644/03, datë 31.03.2009). Në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave, çështja nëse kërkuesi ka marrë riparim për dëmin e shkaktuar, që krahasohet me shpërblimin e drejtë, sipas nenit 41 të Konventës, është një çështje e rëndësishme. Aty ku autoritetet vendase kanë gjetur shkelje dhe vendimet e tyre përbëjnë korrigjim të mjaftueshëm, pala e interesuar nuk mund të pretendojë më se është viktimë në kuptim të nenit 34 të Konventës. Për këtë qëllim GJEDNJ-ja ka përcaktuar disa karakteristika që një mjet i tillë korrigjues duhet të ketë, duke pasur parasysh faktin se pretendimi për statusin e viktimës do të varet nga korrigjimi që mjeti i brendshëm do t`i ketë dhënë kërkuesit (*shih Apicella kundër Italisë DhM], nr. 64890/01, §§ 70-71; Scordino kundër Italisë (nr. 1) DhM], nr. 36813/97, § 182, GJEDNJ-ja 2006V- shih vendimin nr. 44, datë 26.09.2023, paragrafi 20, të GJK-së*).

6. Gjykata çmon se pozita procedurale e personave të dëmtuar nga vepra penale ose e trashëgimtarëve të tyre rregullohet nga nenet 58-68 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

[6] Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve.

Sipas nenit 58 të KPP-së mbi të drejtat e personit të dëmtuar nga vepra penale, i dëmtuari nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të kërkojnë procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit. Personi i dëmtuar ka të drejtë të parashtrojë kërkesa në organin procedues dhe të kërkojë marrjen e provave. Kur kërkesa e tij nuk pranohet nga prokurori, ai ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja dijeni. Neni 59 i KPP-së parashikon se ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuar nga nenet 90, 91, 92, 112,/1, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, 148, 149 dhe 254 të KP-së ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë, për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Nëse kërkuesi nuk i ka paraqitur organit procedues ndonjë kërkesë në bazë të nenit 58 të KPP-së dhe nuk ka qenë palë në gjykimin e çështjes penale objekt i kërkesës, ai nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën lidhur me këtë çështje (*shih vendimin nr. 59, datë 07.06.2011 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

b. Shterimi i mjeteve

7. Detyrimi për shterimin e mjeteve juridike efektive, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, është trajtuar nga Gjykata si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 8, datë 19.03.2018 të GJK-së*), ashtu edhe të atyre të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 28, datë 23.06.2011 të GJK-së*).

8. Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në zbërthim të këtij parashikimi, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se individi mund t'i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 53, datë 22.12.2011; nr. 28, datë 23.06.2011; nr. 27, datë 20.06.2007 të GJK-së*). Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës , duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 60, datë 21.09.2015; nr. 17, datë 16.05.2011; nr. 1, datë 25.01.2010; nr. 1, datë 19.01.2009 të GJK-së*). Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr.17, datë 16.05.2011; nr.1, datë 25.01.2010; nr.17, datë 18.07.2005 të GJK-së*).

9. Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe të frytshëm të mundshëm. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Dhunimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i

garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeleve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e dhunimit të kësaj të drejte (*shih vendimin nr. 28, datë 23.06.2011 të GJK-së*). Vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar dhe kthimin e çështjes në atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit, nuk mund të konsiderohet si një vendim përfundimtar për qëllimet e nenit 131/f të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023, paragrafi 15; nr.39, datë 06.07.2026; nr.48, datë 06.07.2015; vendimin nr. 119, datë 10.06.2014 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*). Përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, kontrollit kushtetues mund t'i nënshtrohen edhe vendime të tjera me natyrë jo përfundimtare, që jepen gjatë një procesi gjyqësor, nëse plotësohen disa kritere që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj së drejtës kushtetuese të individit. Gjykata ka vlerësuar në një rast se shkelja e pretenduar lidhet pikërisht me faktin se, edhe pse gjykimi për objektin e padisë është ende në shqyrtim në gjykatën e apelit, për rrjedhojë vendimi i kundërshtuar nuk konsiderohet përfundimtar në atë drejtim, është natyra e pretendimit të ngritur, përkatësisht shkelja e parimit res judicata, që justifikon shqyrtimin e kësaj çështjeje në nivel kushtetues. Për sa kohë që një shkelje e tillë dhe pasojat e saj nuk mund të riparoheshin më gjatë rigjykimit të çështjes, pra në procesin gjyqësor që ishte duke u zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm, Gjykata vlerësoi se kërkuesi nuk kishte mjete të tjera ligjore efektive në dispozicion për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara, ndaj e legjitimoi atë për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023, paragrafi 16, të GJK-së*).

10. Për sa i përket kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese (*shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 5, datë 22.02.2022 të GJK-së*).

- ***Shterimi i mjeteve juridike efektive në substancë***

11. Një kriter tjetër është shterimi i mjeteve juridike efektive, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000. Duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike efektive, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të GJK-së*).

12. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura

nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 5, datë 09.02.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018; nr. 31, datë 25.05.2015; nr. 6, datë 04.03.2010; nr. 32, datë 28.12.2009 të GJK-së*).

- ***Lidhur me të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm***

13. Pas ndryshimeve që iu bënë Kodit të Prodecurës Civile (KPC) me ligjin nr. 38/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" (ligji nr. 38/2017), Gjykata ka vlerësuar se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e së drejtës kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe se individi duhet t'i shfrytëzojë ato përpara se t'i drejtohet asaj (*shih vendimin nr. 3, datë 11.02.2021 të GJK-së*). Megjithatë, duke qenë këto mjete të reja, si dhe duke pasur parasysh qëndrimin e GJEDNJ-së për çështje të kësaj natyre, Gjykata e ka konsideruar të shteruar këtë kriter si në rastet kur Gjykata e Lartë është shprehur me vendim *(shih vendimet nr. 13, datë 26.05.2022; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të GJK-së)*, ashtu edhe në rastet e mungesës së një vendimi të saj (*shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; vendimet nr. 39, datë 09.12.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të GJK-së*).

14. Si rregull, shqyrtimi i çështjeve dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Në analizë të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata ka pranuar se në parim mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të GJK-së*). Sipas Gjykatës, vetëm në raste të veçanta, kur vihet në dyshim efektiviteti i këtij mjeti, kërkuesi mund t'i drejtohet drejtpërsëdrejti kësaj Gjykate me ankim kushtetues individual për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave (*shih vendimet nr. 39, datë 09.12.2021; nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të GJK-së*).

15. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 17, datë 16.05.2011 të GJK-së*). Në thelb, ky rregull synon t'u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimin nr. 10, datë 07.03.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; vendimin nr. 25, datë 13.10.2022 të GJK-së*).

16. Detyrimi për shterimin e mjeteve juridike efektive, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, është trajtuar nga Gjykata si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 8, datë 19.03.2018 të GJK-së*), ashtu edhe të atyre të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 28, datë 23.06.2011 të GJK-së*). Lidhur me këto të fundit, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit "Arresti në burg", duke arsyetuar se karakteri i këtij vendimi, që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 19 datë 04.04.2023, paragrafi 23; nr. 40, datë 18.07.2012; nr. 28, datë 23.06.2011 të GJK-së*).

17. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 56, datë 25.07.2017; nr. 56, datë 21.07.2015 të GJK-së*).

18. Mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të GJK-së*). Thënë ndryshe, ky rregull nënkupton që kërkuesi duhet të shterojë vetëm mjetet juridike "efektive", përpara se t'i drejtohet Gjykatës, në kuptimin e shterimit vetëm të atyre mjeteve juridike, të afta për të rivendosur të drejtën, që pretendohet se është shkelur. Në të kundërt, vetë Gjykata rrezikon të mos konsiderohet si një "mjet efektiv" (*shih vendimin nr. 44, datë 26.09.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; vendimin nr. 33, datë 01.11.2021 të GJK-së*).

19. Sipas GJEDNJ-së, t`i kërkosh kërkuesit të paraqesë një kërkesë të re për t`u ankuar për kohëzgjatjen e tepruar të zbatimit të vendimit që ka dhënë një masë korrigjuese/kompensuese, do të ishte njësoj si ta mbyllje atë në një rreth vicioz në të cilin mosfunksionimi i një mjeti juridik do ta detyronte atë të inicionte një tjetër. Një përfundim i tillë do të ishte i paarsyeshëm dhe do të përbënte një pengesë joproporcionale për ushtrimin efektiv nga kërkuesi të së drejtës së tij të ankimit individual, siç përcaktohet në nenin 34 të Konventës (*shih vendimin nr. 44, datë 26.09.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; shih Vaney kundër Francës, nr. 53946/00, § 53, datë 30.11.2004; Simaldone kundër Italisë, nr. 22644/03, datë 31.03.2009*).

20. E drejta për proces të rregullt ligjor garantohet nga neni 42 i Kushtetutës dhe cenimi i saj mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeleve, kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e dhunimit të kësaj të drejte (*shih vendimin nr. 19, datë 3.02.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; vendimet nr. 29, datë 30.03.2017; nr. 28, datë 23.06.2011 të GJK-së*).

21. Si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individi duhet, së pari, t'i kundërshtojë ato para gjykatave kompetente, duke

shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon legjislacioni i brendshëm. Kjo ka rëndësi edhe për të provuar se kërkuesi është prekur personalisht, drejtpërdrejt dhe realisht (*shih vendimin nr. 47, datë 20.04.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të GJK-së*).

22. Si rregull, individi mund t`i drejtohet Gjykatës për kontrollin e kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor, i cili ka vendosur në mënyrë përfundimtare mbi të drejtën kushtetuese që pretendohet të jetë cenuar. Megjithatë, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, përjashtimisht nga ky rregull, kontrollit kushtetues mund t'i nënshtrohet edhe vendimi gjyqësor që nuk i jep zgjidhje themelit të çështjes, nëse shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të kundërshtuar, pra kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes së të drejtës kushtetuese (*shih vendimin nr. 61, datë 24.05.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të GJK-së*).[7]

23. Gjykata lidhur me interpretimin e rregullit të shterimit të mjeteve juridike, si dhe së drejtës individuale për të pasur një mjet juridik efektiv (neni 13 i Konventës), i është referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së për nenet 13 e 35 të KEDNJ-së. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, efekti i nenit 13 të Konventës kërkon parashikimin e një mjeti juridik të brendshëm për të trajtuar themelin e një "ankese të pranueshme" dhe për të dhënë një kompensim të përshtatshëm (shih Gjyli kundër Shqipërisë, aplikimi nr.32907/07, paragrafi 53). Fushëveprimi i detyrimit të shteteve anëtare, në bazë të nenit 13, ndryshon në varësi të natyrës së ankesës së aplikantit (shih Kudla v. Poland, datë 26.10.2000, apl. nr.30210/96, paragrafi 157). Megjithatë, ekzistenca e këtyre mjeteve juridike duhet të jetë mjaftueshmërisht e qartë, jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, në të kundërt atyre do t'u mungojë kushti i aksesit dhe i efektivitetit (shih vendimin e pranueshmërisë në çështjen Lehtinen v. Finland, aplikimi nr. 39076/97, paragrafi 5). Gjithashtu, "autoriteti", të cilit i referohet neni 13 i Konventës, nuk duhet domosdoshmërisht të jetë një autoritet gjyqësor, por në qoftë se ky autoritet nuk është i tillë, pushtetet/kompetencat e tij dhe garancitë që ai ofron janë të rëndësishme për të përcaktuar nëse ky autoritet përbën një mjet efektiv. Gjithashtu, edhe sikur një mjet i vetëm të mos i plotësojë kërkesat e nenit 13, tërësia e mjeteve të ofruara në bazë të së drejtës së brendshme mund t'i plotësojë (shih Silver and Others v. UK, apl. nr.5947/73, paragrafi 113). Gjykata ka vlerësuar se detyrimi i ankuesve për shterimin e mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131/1/f të Kushtetutës, kërkon që këto mjete të jenë të pranishme në sistemin juridik të vendit, si dhe të përmbushin kriteret që kërkon KEDNJ-ja. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 48, datë 06.07.2015; nr. 17, datë 16.05.2011 të GJK-së; vendimet nr. 232, datë 23.10.2017 nr.27, datë 25.03.2009, të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

24. Gjykata ka vlerësuar se në rastet kur kundërshtohet procesi i rishikimit i zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për vetë specifikën e këtij lloj gjykimi, duke qenë se është mjet i jashtëzakonshëm dhe vendimi i Gjykatës së Lartë është përfundimtar, kërkuesi nuk ka

[7] Shih parag. 1.18. më sipër.

mjet tjetër për të goditur vendimin që ka pranuar kërkesën për rishikim dhe ka vendosur prishjen e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimet nr. 17, datë 18.07.2005; nr. 5, datë 26.01.2007; nr. 6, datë 16.02.2007; nr. 38, datë 05.07.2012, nr. 17, datë 24.03.2014 të GJK-së*). Në të njëjtin përfundim ka arritur kjo Gjykatë edhe në rastet kur Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar kërkesën për rishikim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin nr. 17, datë 24.03.2014 të GJK-së*).

c. Ratione temporis

25. Në lidhje me legjitimimin ratione temporis, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Afati 4-mujor i përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, që lidhet me konstatimin e cenimit, duhet të përllogaritet në atë mënyrë e cila bën të mundur garantimin e së drejtës së aksesit në Gjykatë të individit (*shih vendimin nr. 189, datë 20.12.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

26. Lidhur me legjitimimin ratione temporis, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata e ka llogaritur afatin 4-mujor duke filluar nga data e shpalljes së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, pra nga organi gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme. Gjithashtu, në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së dhe qëndrimit të saj në çështjen "Supergrav Albania" sh.p.k. kundër Shqipërisë (aplikimi nr. 20702/18, datë 09.05.2023), në drejtim të përcaktimit të momentit nga i cili fillon të llogaritet afati ligjor 4-mujor, Gjykata vlerëson se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, ndërsa atëherë kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023, paragrafi22 të GJK-së; vendimin nr. 19, datë 04.04.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

27. Në lidhje me verifikimin e kriterit ratione temporis, Gjykata vëren se sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa paraqitet brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Gjykata, bazuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, ka mbajtur qëndrimin se në rastet kur është e qartë se kërkuesi nuk ka asnjë mjet juridik efektiv, afati për t`iu drejtuar asaj fillon nga data e aktit të kundërshtuar ose data në të cilën ai është prekur drejtpërdrejt ose ka marrë dijeni për efektet negative të aktit (shih Mandija kundër Shqipërisë, nr. 60262/10, datë 19.01.2023). Për më tepër, kur shkelja e pretenduar përbën një situatë të vazhdueshme kundër së cilës nuk ka mjete juridike të brendshme, afati i ankimit fillon të ecë vetëm kur kjo situatë përfundon (shih Sabri Güneş kundër Turqisë DhM], nr 27396/06, § 54, datë 29.06.2012). Për sa kohë që situata vazhdon, ky rregull nuk është i zbatueshëm (shih Iordache kundër Rumanisë, § 50; Oliari dhe të tjerët kundër Italisë, §§ 96-97). Fakti që një ngjarje ka pasoja të rëndësishme me kalimin e kohës, nuk do të thotë se ngjarja ka prodhuar një "situatë të vazhdueshme" (shih Iordache kundër Rumanisë, § 49; Călin etj. Rumanisë, §§ 58-60). Megjithatë, një situatë e vazhdueshme nuk mund të shtyjë për një kohë të pacaktuar zbatimin e afatit të paraqitjes së kërkesës (shih Varnava etj. kundër Turqisë DhM], §§ 159-172; Sargsyan kundër Azerbajxhanit DhM], §§ 124-148; Sokolov etj. kundër Serbisë, §§ 31-36) (*shih vendimin nr. 44, datë 26.09.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

- ***Ratione temporis dhe mjetet e jashtëzakonshme të ankimit***

28. Lidhur me pretendimin se afati i ankimit kushtetues individual duhet llogaritur duke filluar nga dita e përdorimit prej kërkuesit të mjetit të jashtëzakonshëm të ankimit, rishikimit, GJEDNJ-ja, duke vlerësuar shterimin e mjeteve juridike dhe afatin e paraqitjes së ankimit pranë saj, është shprehur se, si rregull, neni 35, paragrafi i parë, i KEDNJ-së nuk kërkon nga ankuesit të paraqesin kërkesa për riçelje të procedurave ose të përdorin mjete të ngjashme të jashtëzakonshme, si dhe nuk lejon që afati i paraqitjes së ankimit të zgjatet për shkak të përdorimit të mjeteve të tilla (shih Berdzenishvili k. Rusia, vendim 29.01.2004; Tucka k. Mbretërisë së Bashkuar, 18 janar 2011; Haász dhe Szabó k. Hungarisë, 13 tetor 2015). Paraqitja e një kërkese për rishikim, që nuk pranohet nga gjykata, nuk përcakton ditën se kur bëhet përfundimtar vendimi gjyqësor i themelit, që kërkohet të rishikohet, me qëllim përllogaritjen e afatit ligjor 4 – mujor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Ky përfundim bazohet në faktin se kërkesa për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, kur nuk pranohet nga Gjykata, nuk prek zgjidhjen përfundimtare të një procesi gjyqësor. Në vijim të këtij arsyetimi, duhet theksuar se ashtu siç individëve iu kërkohet që për efekte të shterimit të mjeteve juridike të përdorin vetëm mjetet normale të ankimit, duke mos i detyruar të përdorin mjete të jashtëzakonshme ankimi (sikurse është edhe kërkesa për rishikim), në të njëjtën linjë, ata nuk mund të pretendojnë përmbushjen e afatit ligjor 4 - mujor për paraqitjen e ankimeve kushtetuese, duke u bazuar në përdorimin e mjeteve të jashtëzakonshme të ankimit, të cilat janë refuzuar nga Gjykata si haptazi të pabazuara në ligj (*shih vendimin nr. 12, datë 02.02.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

ç. Ratione materiae

29. Për sa i takon legjitimimit ratione materiae, Gjykata thekson se sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur. Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm, por Gjykata mund t'i marrë në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore, duke bërë vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të GJK-së*).

30. Standardet kushtetuese që garantojnë procesin e rregullt ligjor dhe gjykimin e drejtë, janë ngushtësisht të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi edhe i vetëm njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave (*shih vendimet nr. 7, datë 21.02.2023; nr. 40, datë 22.12.2022 të GJK-së*).

31. Kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh, që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor dhe marrja e vendimit për çështje kushtetuese kushtëzohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 27 datë 18.05.2023; nr. 20, datë 22.09.2022; nr. 39, datë 05.05.2017 të GJK-së*). Ky kontroll është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 27 datë 18.05.2023; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të GJK-së*).

32. Interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 30 datë 29.05.2023; nr. 6, datë 16.02.2021 të GJK-së*). Megjithatë, Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 2 datë 11.02.2021; nr. 7, datë 07.02.2017; nr. 6, datë 16.02.2015 të GJK-së*).

33 Në lidhje me legjitimimin ratione materiae, sipas jurisprudencës kushtetuese, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Gjykata ka theksuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimin nr. 189, datë 20.12.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të GJK-së*).

34. Gjykata ka theksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e Gjykatës është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme (*shih vendimin nr. 135, datë 02.12.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; vendimet nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 40, datë 25.06.2015; nr. 4, datë 05.02.2014; nr. 34, datë 12.07.2013 të GJK-së*).

35. Në lidhje me legjitimimin ratione materiae, kërkuesi, ndër të tjera, duhet të plotësojë kriterin kushtetues të "detyrimit për të justifikuar interesin", i cili është përcaktues i ndarjes së rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori, subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Individi, si një nga subjektet e kushtëzuara, ka legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tij (*shih vendimin nr. 59, datë 23.07.2015 të GJK-së*). Në këtë kuptim, individi ka detyrimin të provojë se në ç`mënyrë ai është prekur në të drejtat e tij kushtetuese si pasojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Interesi i tij për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak, dhe ai duhet të konsistojë tek e drejta e shkelur dhe te dëmi real i shkaktuar (*shih vendimin nr. 22, datë 24.02.2016 të Mbledhjes së Gjyqtaërve*).

- ***Kërkesa lidhur me një vendim të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese***[8]

36. Një prej kritereve që përcakton kufijtë e juridiksionit të Gjykatës parashikohet nga shkronja "dh" e pikës 2 të nenit 31/a të të njëjtit ligj, sipas së cilës kur kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të GJK-së-, vendoset moskalimi i çështjes në seancë plenare. Në këto lloj rastesh, merr rëndësi të analizohet thelbi i kërkesës, me qëllim për të evidentuar nëse ajo përmban ndonjë informacion, fakt ose rrethanë të re, e cilat nuk është shqyrtuar më parë nga Gjykata. Megjithatë, jo çdo fakt ose rrethanë e ndodhur pas dhënies së vendimit të Gjykatës ka rëndësi të mjaftueshme për të ndryshuar arsyet që kanë qëndruar në themel të vendimmarrjes së mëparshme të saj, në kuptimin që kërkesa e re të kalojë për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimin nr. 56, datë 20.05.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

[8] Shih parag. 1.16, më sipër.

37. Gjykata, në kushtet kur ajo vihet në lëvizje për interpretimin e një vendimi të saj, në kuptim të nenit 80 të ligjit nr. 8577/2000 ajo ka në kompetencë të interpretojë vendimin e saj në rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje për kuptimin e tij, por pa ndryshuar përmbajtjen e tij, kur kjo kërkohet nga palët pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes *(shih vendimet nr. 6, datë 05.03.2008; nr. 23, datë 23.04.2012 të GJK-së)*. Gjithashtu, Gjykata ka të drejtë të plotësojë vendimin apo të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në të (*shih vendimin nr. 113, datë 11.10.2013 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

II. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit)

Neni 42, pika 2, i Kushtetutës:

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse[9]

1. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje Gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 31, datë 3.11.2022, paragrafi 25; nr. 22, datë 29.04.2021, paragrafi 23; nr. 3, datë 23.02.2016, paragrafi 15, të GJK-së*).

- ***Garancitë për të drejtën e aksesit në gjykatë***

2. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 29 datë 01.11.2022, paragrafi 26; nr. 52, datë 14.11.2014, paragrafi 11; nr. 7, datë 11.03.2008 të GJK-së*).

3. Sipas GJEDNJ-së do të ishte e pakonceptueshme që neni 6/1 të përshkruajë në detaje garancitë procedurale që u ofrohen palëve gjatë një procesi dhe të mos mbrojë, në radhë

[9] Standardet e përmendura në këtë pjesë përfshijnë standardet e evidentuara në jurisprudencën e Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/akteve normave dhe ato nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual.

të parë, atë që në fakt bën të mundur përfitimin e garancive të tilla, që është aksesi në një gjykatë. Karakteristikat e procedurave gjyqësore, të tilla si: rregullsia, publiciteti dhe shpejtësia, nuk do të kenë fare vlerë nëse nuk ka procedura gjyqësore. Pra, duke bërë një interpretim të të "drejtave efektive", GJEDNJ-ja ka përcaktuar se garancitë e procesit të rregullt ligjor, të parashikuara në detaje nga neni 6 i KEDNJ-së, do të ishin të pavlefshme nëse do të ishte i pamundur fillimi i një procesi gjyqësor. E drejta e aksesit është një aspekt i pandarë i garancive të mishëruara në nenin 6, duke iu referuar parimeve të shtetit të së drejtës dhe të shmangies së pushtetit arbitrar, që qëndrojnë në themel të Konventës. Kështu, neni 6/1 i siguron gjithsecilit të drejtën për të pasur çfarëdo pretendimi në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile përpara një gjykate. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata ka theksuar se në aspektin kushtetues dhe në këndvështrimin e mjetit efektiv, e drejta e aksesit hyn në të drejtat themelore të individit, të cilat në çdo rast duhet të garantohen nga gjykatat. Çdo mosmarrëveshje ose kundërshti ndërmjet organeve shtetërore dhe individit duhet të ketë si destinacion përfundimtar gjykatat, të cilat duhet t'u japin përgjigje pretendimeve të tyre. Në këtë kuptim, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, brenda hapësirës së juridiksionit të tyre dhe në respekt të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, si dhe të parimit të kushtetutshmërisë, janë të detyruara të zbatojnë të drejtat dhe standardet kushtetuese gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve (*shih vendimin nr. 29, datë 30.03.2017, paragrafi 20; nr.25, datë 10.05.2016, paragrafët14-16, të GJK-së*).

4. Rregullat që disiplinojnë hapat formalë për paraqitjen e një ankimi, synojnë të sigurojnë miradministrimin e drejtësisë. Thelbi i së drejtës së aksesit në gjykatë cenohet kur rregullat procedurale pushojnë së shërbyeri qëllimit të administrimit të duhur të drejtësisë dhe formojnë një lloj pengese që pengon palën ndërgjyqëse që çështja e tij/saj të vendoset në themel nga gjykata kompetente. Në veçanti, çështja e administrimit të duhur të drejtësisë është element kryesor për të bërë dallimin midis formalizmit të tepruar dhe zbatimit të pranueshëm të formaliteteve procedurale. (*shih vendimin nr. 32, datë 03.11.2022, paragrafi 23; nr. 6, datë 22.02.2022, paragrafi 31 të GJK-së*).

5. Në kuadër të garantimit të një gjykimi të drejtë, e drejta e kërkuesit për akses dhe për të marrë pjesë në gjykim është e lidhur ngushtësisht me ushtrimin e të drejtave të tij për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur. Këto standarde kushtetuese janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerëve (*shih vendimin nr. 12, datë 24.05.2022, paragrafi 44; nr. 8, datë 23.02.2021, paragrafi 24 të GJK-së*).

6. E drejta e aksesit është garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022, paragrafi 53; nr. 12, datë 09.03.2021; nr.76, datë 22.12.2015 të GJK-së*).

- ***E drejta efektive e aksesit në gjykatë***

7. Detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë edhe ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesi në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera (*shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022, paragrafi 54; nr. 12, datë 15.02.2017; nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 67, datë 17.11.2015 të GJK-së*).

8. Gjykata ka theksuar se personi që ushtron ankim/rekurs është i interesuar të ndjekë fatin e ankimit të tij, por kjo nuk nënkupton se i takon vetëm atij përgjegjësia të ndjekë pafundësisht fatin e dosjes gjyqësore, e cila administrohet nga gjykata dhe jo nga kërkuesi *(shih vendimet nr.16, datë 27.03.2012, paragrafi 11; nr.22, datë 26.07.2006; nr.4, datë 10.02.2005 të GJK-së)*. Për këtë arsye, Gjykata ka përcaktuar se i takon dhe administratës gjyqësore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të njoftojë në kohë kërkuesin jo vetëm për përmbajtjen e vendimit gjyqësor por edhe për plotësimin e kërkesave të ushtrimit të rekursit, duke qenë se ajo administronte dhe dosjen gjyqësore me vendimin ndaj të cilit ushtrohej rekursi *(shih vendimin nr.32, datë 22.07.2011 të GJK-së)*. Në këtë këndvështrim, ajo ka çmuar se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë, nuk mund t'i cenohen kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimet nr.16, datë 27.03.2012, paragrafi 11; nr.5, datë 02.03.2011; nr.22, 26.07.2006 të GJK-së*).

- ***E drejta e aksesit në procesin administrativ***

9. E drejta e individit për proces të rregullt ligjor nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ. Në këtë kuptim, çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike që lidhen me procesin e rregullt, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit me faktet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për proces të rregullt. E drejta për t'u dëgjuar, si pjesë e së drejtës së mbrojtjes, garantohet edhe në procesin administrativ përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimit të argumenteve prej tij ose avokatit të zgjedhur (*shih vendimet nr. 23 datë 10.10.2022, paragrafi 48; nr. 25, datë 10.05.2021; nr.29, datë 27.06.2013 të GJK-së*).

- ***E drejta e aksesit në gjykatë e lidhur me ankimin në kuptimin substancial***

10. Çështja e pranisë së dy vendimeve diametralisht të kundërta është vlerësuar nën dritën e së drejtës së aksesit dhe asaj të ankimit në kuptimin substancial, si edhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor *(shih vendimet nr. 30, datë 30.03.2017, paragrafi 11; nr.73, datë 16.12.2016 të GJK-së)*. Roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre

të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të ngritura (*shih vendimet nr. 30, datë 30.03.2017, paragrafi 13; nr. 42, datë 07.07.2014; nr. 4, datë 05.02.2014 të GJK-së*).

11. Përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimues, në formë e në përmbajtje, siç sanksionohet në legjislacionin procedural, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Në përputhje me këtë, neni 31 i KPC-së e ka përkufizuar padinë si të drejtën për t'u dëgjuar të personit që ngre pretendimin, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo në fakte e në ligje, kurse neni 32, shkronja "a", parashikon se padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur (*shih vendimet nr. 22, datë 29.04.2021, paragrafi 26; nr. 38, datë 30.06.2014; nr. 5, datë 20.03.2006 të GJK-së*).

12. Mostrajtimi i mjetit procedural në mënyrë substanciale cenon të drejtën e mbrojtjes së të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr. 28, datë 30.03.2017, paragrafi 15; nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 21, datë 24.07.2006 të GJK-së*).

13. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit ose të personave juridikë, duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të procesit (*shih vendimet nr. 70, datë 24.11.2016, paragrafi 5; nr. 10, datë 04.04.2007 të GJK-së*).

14. Në vështrim të garantimit të standardit të aksesit në gjykatë, dispozitat e KPP-së nuk mund të interpretohen nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në një mënyrë të tillë të ngushtë, që cenon thelbin e së drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykate (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022, paragrafi 30; nr. 5, datë 02.03.2011 të GJK-së*). Rekursi është akti procedural në të cilin parashtrohen shkaqet për të cilat kundërshtohet një vendim, sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së, që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në atë gjykatë. Gjykata ka vlerësuar se mbrojtja me avokat e të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Lartë është kërkesë e nevojshme në funksion të garantimit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale që është në interes të drejtësisë. Kërkesa për nënshkrimin e rekursit nga mbrojtësi, me pasojë mospranimin e tij, e parashikuar nga neni 435 i KPP-së, ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikojnë dispozitat procedurale (*shih vendimet nr. 56, datë 9.11.2023, paragrafi 19; nr. 6, datë 22.02.2022, paragrafi 30; nr. 53, datë 05.12.2012; nr. 38, datë 30.12.2010 të GJK-së*).

15. Gjykata, në funksion të kontrollit të respektimit të standardit për akses në gjykim, ka ritheksuar se e drejta e përfitimit nga efekti prapaveprues i ligjit penal favorizues, e sanksionuar në nenin 29/3 të Kushtetutës, është një parim themelor që ka të bëjë me thelbin e një procesi të drejtë penal dhe, si i tillë, është i rëndësishëm për respektimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 12, datë 15.02.2017, paragrafi 18; nr. 14, datë 17.04.2007; nr. 35, datë 20.12.2005 të GJK-së*).

16. Pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor dhe se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Gjykatës së Lartë, krijon dyshime, ndër të tjera, edhe për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuesve. Mosparaqitja e shkaqeve të parashtruara në vendim, përveçse është një e metë serioze e arsyetimit, lë shkas për ekuivoke e dyshime në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin e pretendimeve të kërkuesit nga ana e Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 3, datë 23.02.2016, paragrafi 21; nr. 29, datë 22.05.2015 të GJK-së*).

- ***Kufizimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës***

17. Gjykata ka theksuar se e drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve (veçanërisht lidhur me kushtet e pranimit të një apelimi), por këto kufizime duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe mjetet e përdorura duhet të jenë përpjesëtimore me qëllimin që kërkohet të arrihet. Detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Asnjëherë nuk përjashtohet mundësia që interesat e administrimit të drejtë të drejtësisë mund të justifikojnë një kufizim në të drejtën e aksesit në gjykatë. Megjithatë, duke pasur parasysh vendin e rëndësishëm që zë e drejta e aksesit në një shoqëri demokratike, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë aksesin në një mënyrë apo shkallë që dëmton thelbin e kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 67, datë 17.11.2015, paragrafi 14; nr. 7, datë 27.02.2013 të GJK-së*).

18. Mundësia financiare e aplikantit për të paguar tarifën dhe faza e procesit gjyqësor në të cilin është vendosur ky kufizim, merren në konsideratë si faktorë materialë për të përcaktuar nëse aplikanti e ka gëzuar të drejtën e aksesit (*shih vendimet nr. 67, datë 17.11.2015, paragrafi 14; nr.7, datë 27.02.2013 të GJK-së*).

19. E drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 40 datë 22.12.2022, paragrafi 18; nr. 18, datë 31.03.2014; nr. 17, datë 19.06.2009 të GJK-së*).

20. GJEDNJ-ja është shprehur se interpretimi i ngushtë i së drejtës së aksesit, që garantohet nga neni 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së, nuk është në përputhje me objektin dhe qëllimin e këtij parashikimi. Rëndësia e ushtrimit të të drejtave procedurale ndryshon në varësi

të qëllimit të veprimeve, të cilat personi në fjalë synon t'i ushtrojë para gjykatave (*shih vendimin nr. 67, datë 17.11.2015, paragrafi 15, të GJK-së*).

- ***Kufizimi i së drejtës së aksesit në gjykatë nga afatet ligjore***

21. Gjykata ka theksuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve ligjore të përcaktuara. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në funksion të parimit të sigurisë juridike. Mospërcaktimi i këtyre afateve do të çonte në një situatë të tillë ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment, një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej ose prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë (*shih vendimet 56, datë 14.11.2023, paragrafi 20; nr. 29, datë 15.05.2014, paragrafi 14; nr. 5, datë 02.03.2010; nr. 32, datë 02.12.2005 të GJK-së*).

22. Kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor mbi masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, konkretisht me lirinë e personit dhe se këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura sipas llojit të privimit të lirisë (*shih vendimet nr. 40, datë 18.07.2012, paragrafi 19; nr. 28, datë 23.06.2011 të GJK-së*).

23. Në përputhje me parimet e sanksionuara në nenin 42 të Kushtetutës, KPC-ja rregullon/implementon të drejtën e aksesit në një sërë dispozitash të saj. Kështu, kodi rregullon të drejtën që ka çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë, e cila duke pasur parasysh natyrën e saj si arbitër, nuk procedon me nismën e vet, nëse nuk vihet në lëvizje nga palët (neni 2 i KPC). Në çdo rast, është pala iniciuese ajo që tregon objektin e gjykimit dhe gjykata, e cila gjykon mosmarrëveshjen, duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet (neni 6 i KPC). Përveç këtyre, KPC-ja parashikon një tërësi rregullimesh të tjera parimore dhe specifike, si parakushte për realizimin e së drejtës individuale të aksesit në një gjykatë (*shih vendimin nr. 18, datë 08.07.2009 të GJK-së*).

24. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës të kërkesave individuale në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën në një instancë të zakonshme, gjë e cila nuk është funksioni i saj. Gjykata rithekson se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur

dy gjykata i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të ngritura. Duke iu referuar dyshimit për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuesit, Gjykata thekson se është detyrë e Gjykatës së Lartë të bëjë të mundur realizimin efektiv të së drejtës së aksesit, pa lënë shkas për ekuivoke në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin nga ana e saj të pretendimeve të ngritura në rekurs (*shih vendimet nr.3, datë 23.02.2016, paragrafi 22; nr. 62, datë 23.09.2015 të GJK-së*).

- ***E drejta e aksesit në gjykatë dhe kërkesa për rishikim***

25. Kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Kërkesa për rishikim ushtrohet për shkaqe që qëndrojnë jashtë procesit të themelit, që do të thotë për fakte, prova, rrethana ose ngjarje për të cilat pala nuk kishte dijeni, nuk kishin ndodhur ose nuk ishin vërtetuar gjatë procesit gjyqësor dhe që kanë ndikuar në dhënien e vendimit në fjalë. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse (neni 494 i KPC) (*shih vendimet nr. 17, datë 24.03.2014, paragrafi 20; nr. 36, datë 26.07.2011 të GJK-së*).

b. Precedentët ku çështja e cenimit të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës është vënë në diskutim[10]

A - CIVILE

a) Për gjykatat e faktit

26. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë nga Gjykata e Apelit Vlorë, pasi kërkuesit kanë marrë dijeni për vendimin (e themelit) nr. 752, datë 29.03.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë më 01.05.2013, datë nga e cila u ka lindur e drejta dhe ka filluar afati për të paraqitur ankim. Edhe pse ky ankim është depozituar në sekretarinë e asaj gjykate, më 14.05.2013, dhe është paguar tarifa përkatëse, ai nuk është administruar në dosjen gjyqësore nga sekretaria gjyqësore. Vetëm pas kërkesës së kërkuesve, ai i është dërguar me shkresë përcjellëse Gjykatës së Apelit Vlorë, ndërkohë kjo gjykatë nuk është shprehur për ankimin ndaj vendimit të themelit, por vetëm për ankimin e veçantë të ushtruar ndaj vendimit për ndreqjen e gabimeve.

[10] Precedentët/rastet nga gjykimi kushtetues të përmendura në këtë pjesë, ku çështja e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë është vënë në diskutim, përfshijnë jo vetëm ato të shqyrtuara nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual, por edhe ato nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/akteve normave. Ligjet/aktet normative objekt shqyrtimi ose të referuara në precedentët/rastet nga gjykimi kushtetues janë ato akte që kanë në fuqi në kohën e shqyrtimit të këtyre çështjeve.

Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, rezulton se për shkak të pakujdesisë së administratës gjyqësore, e cila e ka dërguar me vonesë ankimin e kërkuesve në lidhje me vendimin e themelit të çështjes, ai nuk i është bashkëlidhur dosjes gjyqësore, për rrjedhojë nuk është marrë në shqyrtim nga gjykata e apelit. Edhe pse sekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e vënë në lëvizje nga kërkuesit, e ka dërguar ankimin në gjykatën e apelit, nuk rezulton që ankimi të jetë administruar në dosjen gjyqësore dhe të jetë marrë në shqyrtim nga trupi gjykues që ka shqyrtuar çështjen në gjykatën e apelit. Janë pikërisht mangësitë ose gabimet e administratës gjyqësore që kanë shkaktuar mosshqyrtimin në gjykatën e apelit të ankimit të paraqitur nga kërkuesit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë (*shih vendimin nr. 31 datë 03.11.2022, paragrafët 23-34 të GJK-së*).

27. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë , pasi gjykata e shkallës së parë nuk e ka shqyrtuar çështjen në themel. Po kështu, gjykata e apelit, për shkak të shkeljeve të evidentuara, duhej ta prishte vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ta dërgonte çështjen për rishqyrtim në po atë gjykatë ose të përsëriste hetimin gjyqësor, gjë që nuk e ka bërë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, nga leximi gjithëpërfshirës i vendimeve gjyqësore, kërkuesi ka pasur akses në gjykatë, duke marrë pjesë në gjykim dhe duke parashtruar pretendimet e tij nëpërmjet përfaqësuesit ligjor. Gjithashtu, ai ka pasur mundësi të ushtrojë të drejtën e ankimit dhe të rekursit për të kundërshtuar vendimet gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit. Fakti që Gjykata e Lartë nuk ka marrë vendim për prishjen e dy vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, nuk është argument bindës në mbështetje të pretendimit të tij për cenimin e së drejtës së aksesit (*shih vendimin nr. 19, datë 01.04.2021, paragrafët 37-41 të GJK-së*).

28. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë dhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Apelit Durrës nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit. Gjithashtu, ky standard është cenuar edhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, sepse vendimi i mospranimit të rekursit nuk përmbushte as kërkesat e arsyetimit minimalist. Gjykata, pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit, e ka vlerësuar të bazuar. Sipas saj, ky Kolegj duhej të kishte vlerësuar bazueshmërinë e pretendimit të ngritur në rekurs nga kërkuesi dhe të jepte në përfundim një vendim të arsyetuar në lidhje me të për sa i përket "gjykatës së caktuar me ligj", si pretendim i natyrës kushtetuese. Në këtë mënyrë, do të garantohej e drejta e tij për akses efektiv në gjykatë dhe, lidhur me të, edhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimin nr. 13, datë 09.03.2021, paragrafët 20-30 të GJK-së*).

29. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi gjykatat, pa zhvilluar hetim gjyqësor, kanë rrëzuar kërkesëpadinë me arsyetimin se i mungon legjitimimi aktiv dhe se dokumenti arkivor i paraqitur prej kërkuesit nuk përbën provë për ta legjitimuar. Ky qëndrim i gjykatës është i gabuar, pasi legjitimimi aktiv nuk ka lidhje me bazueshmërinë në prova të padisë, por kjo e fundit lidhet me shqyrtimin e padisë në themelin e saj. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj,

ndër të tjera, kërkuesi (paditësi në procesin gjyqësor), në mbështetje të pretendimit të ngritur në padi, për të vërtetuar pronësinë, ka paraqitur një dokument arkivor, i cili, sipas gjykatës së zakonshme, nuk ka qenë i mjaftueshëm për ekspertin e caktuar prej saj për të konkluduar në lidhje me vendin se ku ndodhet prona e përcaktuar në dokumentin arkivor. Për këtë vlerësim, gjykata, duke iu referuar normave ligjore që lidhen me të provuarit e interesit të ligjshëm për të ngritur padinë, ka arritur në përfundimin se kërkuesi nuk ka legjitimimin aktiv në ngritjen e padisë në shqyrtim. Kërkuesi, lirisht, ka ushtruar të drejtën e ngritjes së padisë dhe përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes, me vendim përfundimtar ka marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e tij, përfshirë edhe atë të legjitimimit aktiv (*shih vendimin nr.12, datë 09.03.2021, paragrafët 15-20 të GJK-së*).

30. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi Gjykata e Apelit Shkodër jo vetëm e ka zhvilluar gjykimin në mungesë të kërkuesit, por edhe nuk ka e zbardhur në kohë dhe nuk i ka komunikuar vendimin e arsyetuar, në mënyrë që të paraqiste në Gjykatën e Lartë një rekurs të plotë me të gjitha argumentet kundër atij vendimi. Sipas kërkuesit, ishte detyrë e administratës gjyqësore të njoftonte atë dhe t`i komunikonte vendimin, veçanërisht në kushtet kur gjykimi është bërë në mungesë dhe pa dijeninë e tij. Gjykata nuk është shprehur konkretisht në lidhje me pranimin ose jo të këtij pretendimi, por ka vlerësuar se duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur, pa u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura nga kërkuesi, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Sipas saj, ndër të tjera, duke iu referuar dyshimit për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuesit, është detyrë e Gjykatës së Lartë të bëjë të mundur realizimin efektiv të së drejtës së aksesit, pa lënë shkas për ekuivoke në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin nga ana e saj të pretendimeve të ngritura në rekurs (*shih vendimin nr. 3, datë 23.02.2016, paragrafët 14-23 të GJK-së*).

31. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi edhe pse kanë kaluar 4 vjet nga shpallja e vendimit, kërkuesi ende nuk ka një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili të jetë i ekzekutueshëm me qëllim rivendosjen e së drejtës së cenuar. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim. Sipas saj, ndër të tjera, kërkuesi është pajisur pas përfundimit të gjykimit me një shkurtim të vendimit gjyqësor, i cili përmban vetëm dispozitivin e tij dhe deri në momentin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, për shkak të shkarkimit nga detyra të gjyqtarit të çështjes, i cili e ka shqyrtuar atë si gjyqtar i vetëm, nuk ka ende një vendim përfundimtar të formës së prerë, i cili të jetë i ekzekutueshëm, çka në thelb i ka cenuar atij të drejtën e aksesit. Ajo ka theksuar në jurisprudencën e saj se u takon organeve shtetërore që të gjejnë mjetin e përshtatshëm efektiv për të rivendosur të drejtat e cenuara të individëve, në rast se ky cenim ka ardhur si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të këtyre organeve (*shih vendimin nr. 5, datë 23.02.2016, paragrafët 9-17 të GJK-së*).

32. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë për arsye të mosreflektimit në bazën ligjore të kontratës së shitjes të ligjit nr.7698, datë 15.04.1993

"Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" dhe, po ashtu, i mosmarrjes në konsideratë nga autoritetet shtetërore dhe gjykatat e zakonshme të rregullimeve të këtij ligji mbi të drejtën e parablerjes. Kjo ka sjellë si pasojë mospërfitimin e fryteve pasurore që burojnë nga e drejta e parablerjes. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, ky pretendim ka të bëjë me çështje të interpretimit të ligjit dhe të zbatimit të tij në çështjet konkrete, si dhe me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave dhe, si i tillë, i takon juridiksionit të gjykatave të zakonshme (*shih vendimin nr.64, datë 4.11.2016, paragrafët 17-19 të GJK-së*).

33. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë nga Gjykata e Apelit Tiranë, pasi nuk ka respektuar dispozitat procedurale të njoftimit për ditën dhe orën e zhvillimit të gjykimit. Sipas kërkueses, nga ana e sekretarisë së kësaj gjykate, nuk është publikuar data dhe ora e gjykimit, duke rezultuar në zhvillimin e gjykimit në mungesë të kërkueses. Gjithashtu, vendimi i gjykatës së apelit është marrë nëpërmjet një procesi të parregullt, për shkak të mosnjoftimit të Avokaturës së Shtetit, sipas nenit 79/a të KPC-së. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim haptazi të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, duke e vlerësuar procesin si një i tërë, kërkuesja ka qenë në dijeni të zhvillimit të gjykimit në apel, nëpërmjet shpalljes së datës 19.09.2011 dhe interesat e saj janë përfaqësuar në shkallët e tjera nga Avokatura e Shtetit *(shih vendimin nr. 26, datë 29.05.2014, paragrafët 17-22 të GJK-së*).

34. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi data e zbardhjes së vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër nuk iu është bërë e ditur dhe se sekretaria gjyqësore ka vepruar në kundërshtim me nenin 476/2 të KPC-së, pasi nuk i ka kërkuar atyre të bëjnë plotësimet përkatëse në rekursin që kishin paraqitur për zënien e afatit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, duke marrë në konsideratë harkun e gjatë kohor nga dhënia e vendimit të apelit (2008) deri në marrjen e vendimit të mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë (2011), krijon bindjen se kërkuesit dhe mbrojtësi i tyre kanë pasur të gjitha mundësitë për të kontrolluar dosjen e tyre gjyqësore dhe ecurinë e procesit. Si pasojë, mungesa e depozitimit të rekursit të plotë ka ardhur si rezultat i neglizhencës ose mosinteresimit të kërkuesve (*shih vendimin nr. 37, datë 30.06.2014, paragrafët 24-28 të GJK-së*).

35. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi në procesin e rigjykimit të çështjes, gjykatat e dy shkallëve të para analizojnë vetëm situatën faktike të problemit, nëse është kthyer ose jo fizikisht trualli dhe jo pretendimet e parashtruara në kërkesëpadi në lidhje me pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit dhe të kontratave së shitjes, si akte të cilat kanë cenuar interesat e tij të ligjshëm pronësorë. Arsyetimi i gjykatave se paditësit i mungon interesi i ligjshëm për ngritjen e padisë, pasi mungon vendimi i marrë nga organi kompetent për kthimin fizik të sendit, është i pabazuar, për rrjedhojë cenon të drejtën e aksesit në gjykatë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, kërkuesi jo vetëm e ka ushtruar lirisht dhe pa pengesa të drejtën e ngritjes së padisë, duke parashtruar pretendimet përkatëse, por padia e tij është marrë në shqyrtim si nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, ashtu

edhe Gjykata e Apelit Tiranë. Argumentet e parashtruara nga kërkuesi në mbështetje të pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë kanë të bëjnë më çështje të interpretimit të ligjit dhe të vlerësimit të provave, dhe, si të tilla, ato i takojnë juridiksionit të gjykatave të zakonshme (*shih vendimin nr. 38, datë 30.06.2014, paragrafët 13-18 të GJK-së*).

36. Përpara Gjykatës, në rrugën e kontrollit incidental, është pretenduar se neni 11/2 i ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar *(ligji nr.9975/2008)* nuk është në pajtim me Kushtetutën, pasi e kushtëzon aksesin në gjykatë me parapagimin e plotë të tarifës për shërbime gjyqësore dhe nuk parashikon përjashtime në rastet e pamundësisë financiare për kryerjen e kësaj pagese. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në bazë të nenit 11/2 të ligjit nr. 9975/2008, përcaktimi i niveleve minimale të tarifave të shërbimit, ku përfshihen *inter alia* edhe tarifat për veprime e shërbime të administratës gjyqësore, bëhet me anë të udhëzimit të përbashkët të ministrit të Financave dhe institucioneve përkatëse. Nga përmbajtja normative e nenit, kjo është një dispozitë deleguese, e cila i jep ministrit të Financave dhe institucioneve përkatëse të drejtën të përcaktojnë me udhëzim nivelet minimale të tarifave të shërbimit, të përkufizuara në ligj. Kjo normë nuk e pengon aksesin e individit në gjykatë, por vetëm delegon kompetencën për përcaktimin e niveleve minimale të tarifave të shërbimit te institucionet përkatëse të administratës publike. Nëpërmjet interpretimit sistematik të dispozitave të mësipërme të KPC-së si dhe analogjisë me ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike" (përkatësisht nenet 2,10,13,14), arrihet qartësisht në përfundimin se qëllimi i këtij kuadri ligjor është të garantojë aksesin në gjykatë për të gjithë individët që i drejtohen gjykatës. Në funksion të këtij garantimi, si dhe të frymës që ligjvënësi ka dashur të përçojë në këtë kontekst ligjor, Gjykata ka theksuar se i takon gjyqtarit të hetojë, mbi bazën e dokumentacionit provues të pamundësisë ekonomike të paraqitur nga paditësi, dhe të vlerësojë, duke iu referuar legjislacionit procedural civil dhe rregullimeve ligjore përkatëse, nëse është rasti për përjashtimin e paditësit nga pagesa e tarifës për shërbime gjyqësore (*shih vendimin nr. 7, datë 27.02.2013, paragrafët 21-28 të GJK-së*).

37. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi në Gjykatën e Apelit Durrës gjykata ka keqinterpretuar nenin 450/ç të KPC-së, duke ngatërruar konceptin e legjitimitetit me përfaqësimin në gjykatë, pasi çështja e ekzistencës ose jo të legjitimitetit nuk ngrihet për avokatin që ka formuluar ankimin, por thjesht dhe vetëm mbi personin në emër dhe për interes të të cilit bëhet ankimi. Edhe pse ankimi është bërë nga avokati L.M., për zënie afati, ai është bërë në emër dhe për llogari të kërkuesit I.P., përfaqësuesit e të cilit, me pjesëmarrjen e tyre në gjykimin e çështjes në apel, kanë deklaruar se janë dakord me ankimin dhe e pranojnë atë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, edhe pse gjykata e apelit ka orientuar procesin në drejtim të shqyrtimit gjyqësor substantiv të çështjes, duke u dhënë mundësi palëve të realizojnë mbrojtjen e tyre në respekt të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, vendimmarrjen e saj e ka bazuar në moslegjitimimin e kërkuesit, duke u kufizuar në vlerësimin nga ana formale të ankimit dhe pa shqyrtuar çështjen në themel. Gjykata e apelit duhej të arsyetonte në mënyrë ezauruese mospranimin e ankimit, duke shpjeguar nëse ky i fundit është bërë nga një person që nuk legjitimohej ose nuk është bërë

në formën e kërkuar nga ligji për shkak të mungesës së nënshkrimit nga vetë pala apo avokati i papajisur me prokurë. Referuar paragrafit "b" të nenit 455 të KPC-së, gjykata e apelit ka pasur detyrimin ligjor për të njoftuar palën që të ndreqte të metat brenda 5 ditëve, dhe vetëm në rast të mosplotësimit të këtij detyrimi mund të kthente ankimin në bazë të kësaj dispozite (*shih vendimin nr. 55, datë 23.12.2013, paragrafët 8-15 të GJK-së*).

38. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi gjykata e apelit, duke keqinterpretuar ligjin për sa u takon rregullave për përfaqësimin, ka refuzuar të shqyrtojë në themel ankimin e tij. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, dispozitat specifike të nenit 97 të KPC-së kërkojnë që delegimi te një përfaqësues i tagrave për të bërë ankim ndaj një vendimi gjyqësor duhet bërë detyrimisht në mënyrë të shprehur. Mbështetur në dosjen gjyqësore, edhe pse kërkuesi gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka marrë pjesë në disa seanca gjyqësore, nuk rezulton që të ketë kërkuar të shprehet ose të jetë shprehur se i delegonte avokates, me deklarim përpara gjykatës, të drejtën për të bërë ankim . E drejta e ankimit në funksion të së drejtës së aksesit nuk i është cenuar kërkuesit në thelb, pasi mosshqyrtimi i ankimit të tij ka ardhur si pasojë e drejtpërdrejtë e mosveprimit të tij për të deleguar te përfaqësuesi tagrat e nevojshme në kohën e duhur. Kërkuesi nuk sjell asnjë pretendim ose provë për të justifikuar objektivisht këtë mosveprim (*shih vendimin nr. 36, datë 05.06.2012, paragrafët 15-27 të GJK-së*).

39. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë njoftuar Avokaturën e Shtetit për të marrë pjesë në gjykim, në përputhje me nenin 79/a të KPC-së, duke mos shqyrtuar rekursin e paraqitur nga Avokatura e Shtetit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, nuk rezulton që gjykata e apelit, në gjykimin dhe marrjen e vendimit nr. 847, datë 24.06.2009, të ketë plotësuar standardet e gjykimit në drejtim të dhënies së mundësisë Avokaturës së Shtetit për të siguruar mbrojtjen e interesave të shtetit. Kjo e fundit nuk është njoftuar e nuk i janë dërguar aktet për gjykimin në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e apelit duhej të vlerësonte pretendimet e të gjitha palëve, duke njoftuar e duke ia dërguar aktet e gjykimit edhe Avokaturës së Shtetit, e cila, sipas nenit 1, pika 3, të ligjit nr. 8551, datë 18.11.1999 dhe ligjit nr. 10018, datë 23.11.2008, ushtron përfaqësimin në gjyq pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit (*shih vendimin nr. 42, datë 29.09.2011, paragrafët 8-18 të GJK-së*).

40. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi Gjykata e Apelit Durrës, në gjykimin e padisë për kërkimin e shpërblimit të drejtë për shkak të shpronësimit për interes publik të truallit në bashkëpronësi, i ka nxjerrë kërkuesit, bashkëpronarët Z., jashtë afatit dhe ka vendosur rrëzimin e kërkesës pa e zgjidhur çështjen në themel. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në vështrim të nenit 162 të KPC-së, në rastin e shpronësimit për interes publik të një pasurie të paluajtshme, e cila figuron në bashkëpronësi të disa subjekteve, padia për kërkimin e një shpërblimi të drejtë, është një rast i bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme. Kjo do të thotë se kjo padi ngrihet nga të gjitha subjektet/bashkëpronarët, të cilëve iu drejtohet

akti. Me gjithë këtë, edhe në rast se padia ngrihet nga njëri ose disa prej bashkëpronarëve, në kuptim të dispozitave të mësipërme të KPC-së, ajo ka efekt edhe për bashkëpronarët e tjerë, që nuk janë paraqitur në gjykatë ose që nuk kanë kryer ndonjë veprim në afatin e caktuar. Në rigjykimin e çështjes, Gjykata e Apelit Durrës duhej të kishte zbatuar dispozitat e neneve 161 dhe 162 të KPC-së, duke i konsideruar veprimet e kryera nga A.D. si të kryera edhe prej bashkëpronarëve të tjerë, të cilët nuk kishin paraqitur ankim në afatin e caktuar dhe nuk kishin marrë pjesë në gjykimin në shkallë të parë (*shih vendimin nr. 18, datë 08.07.2009 të GJK-së*).

41. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi vendimi i pushimit nga Gjykata e Apelit Korçë me përfundimin se "(…) padia e ngritur nga paditësi nuk mund të ngrihet, aq më shumë kundër bashkisë" është i pabazuar në ligj. Vendimi i Komisionit të Kthimit të Pronave parashikonte se Bashkia Korçë ishte autoriteti përgjegjës për pagimin e detyrimit financiar për kompensimin e vlerës së banesës. Vendimi për pushimin e gjykimit nga gjykata e apelit është një konkluzion i gabuar për shkak të interpretimit të gabuar të ligjit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në vendimin e saj, gjykata e apelit, ku shprehet se, "(…) padia e ngritur nga paditësi nuk mund të ngrihet, aq më shumë kundër Bashkisë Korçë, (...)", me këtë arsyetim jo të plotë dhe të dykuptimshëm, ka vënë në diskutim të drejtën e kërkuesit për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje për themelin e pretendimit të tij dhe ka lënë të nënkuptohet që ai nuk ka një bazë ligjore ku mund ta mbështesë padinë e tij. Ajo e ka vlerësuar këtë pretendim të lidhur me parimin e deklaruar nga neni 1 i KPC-së: "Gjykata nuk mund të refuzojë, të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë". Sipas këtij parimi, gjykata, për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, ka detyrën funksionale për të kryer interpretime të ndryshme në lidhje me kuptimin e normave, me kërkimin e normave që rregullojnë rastet analoge apo me identifikimin e parimeve të përgjithshme dhe të jurisprudencës kushtetuese. Gjykata e Apelit Korçë nuk ka respektuar detyrimet e evidentuara më sipër, që rrjedhin nga parimi i parashikuar në nenin 1 të KPC-së dhe nga e drejta e kushtetuese për t'iu drejtuar gjykatës. Ajo është mjaftuar duke u shprehur se padia e kërkuesit nuk mund të ngrihet (...), duke i cenuar këtij të fundit të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të marrë një përgjigje nga gjykata për themelin \e pretendimit të tij (*shih vendimin nr. 28, datë 16.12.2008 të GJK-së*).

b) Për Gjykatën e Lartë

- ***E drejta e aksesit në gjykatë e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor***

42. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor i lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmban një analizë juridiko-ligjore dhe i mungon tërësisht arsyetimi. Ajo ka cituar faktet dhe ligjin e aplikueshëm, por nuk ka bërë një interpretim ligjor të konfliktit, objekt

gjykimi, në raport me faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm dhe nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të palëve. Palët kanë pranuar, gjatë gjykimit në shkallë të parë, t'ia nënshtrojnë zgjidhjen e konfliktit juridiksionit gjyqësor shqiptar, duke e konsideruar aktmarrëveshjen si heqje dorë nga arbitrazhi, gjë e cila nuk është marrë parasysh nga Gjykata e Lartë. Gjykata ka konkluduar se është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pa vijuar me analizën e bazueshmërisë së pretendimit lidhur me cenimin e së drejtës së aksesit, për sa kohë çështja do të kthehej për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 23, datë 29.04.2021, paragrafët 16-28 të GJK-së*).

43. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit dhe arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar shkaqet e mospranimit të rekursit. Në rekurs ishin parashtruar shkaqe, të cilat duhet të shqyrtoheshin në seancë plenare. Gjykata i ka vlerësuar pretendimet të bazuara. Sipas saj, ndër të tjera, në çështjen në shqyrtim, për shkak të problematikës lidhur me cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, duke qenë se sipas objektit të padisë, është pretenduar se kompetente për shqyrtimin e çështjes ka qenë Gjykata Administrative e Apelit, si dhe qenies përballë dy vendimeve të ndryshme të Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës e Apelit Tiranë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në respektim edhe të parimit të subsidiaritetit, duhet të arsyetonte vendimin e tij (*shih vendimin nr. 74, datë 17.11.2017, paragrafët 5-12 të GJK-së*).

44. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit, pasi vendimi i Kolegjit Civil, duke pushuar çështjen, i ka mohuar kërkueses edhe të drejtën e pasjes së një vendimi përfundimtar që do t'i jepte përgjigje për sa ajo kërkon. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar (*shih vendimin nr.2 , datë 29.01.2016, paragrafi 19 të GJK-së*).

45. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë dhe i ankimit, me argumentin se Gjykata e Lartë nuk është shprehur për asnjë nga pretendimet e rekursit. Duke mos e kaluar çështjen në seancë i ka mohuar kërkueses të drejtën për t`u dëgjuar e gjykuar dhe atë të aksesit. Është cenuar edhe e drejta e ankimit, pasi në prani të dy vendimeve të kundërta, që i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme çështjes, në kushtet kur e vetmja shkallë ankimi ishte ajo në Gjykatë, si dhe nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, Gjykata e Lartë duhej të mbante një qëndrim të shprehur në lidhje me to. Gjykata i ka vlerësuar pretendimet të pabazuara. Sipas saj, ndër të tjera, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs, ka vlerësuar se ato nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së. Vetëm fakti i ekzistencës së dy vendimeve të kundërta të dhëna nga gjykatat e faktit apo i mospranimit të rekursit në dhomën e këshillimit nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të vënë në dyshim procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për sa kohë që në procesin gjyqësor të kundërshtuar ajo nuk ka konstatuar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në ndonjë nga elementet e tij (*shih vendimin nr. 9, datë 26.03.2018, paragrafët 15-19 të GJK-së*).

46. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi, edhe pse kërkuesit, bazuar në nenin 472 të KPC-së, kanë ngritur në rekurs pretendime për cenimin e së drejtës kushtetuese të pronës private, Kolegji Civil ka vendosur mospranimin e tij, edhe pse gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrime diametralisht të kundërta për këto çështje, duke dhënë zgjidhje të ndryshme. Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe parimin e subsidiaritetit duhej të investohej në shqyrtimin e tyre dhe të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me to. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, kërkuesit e kanë ushtruar lirisht të drejtën e aksesit dhe të ankimit nëpërmjet paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë, por kjo e drejtë nuk presupozon që gjykata duhet ta kalojë çështjen në seancë ose të pranojë kërkimet e palëve në çdo rast. Sipas nenit 480 të KPC-së, është në kompetencë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimin nr. 66, datë 10.11.2017, paragrafët 21-26 të GJK-së).*

4. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi interpretimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me zbatimin e neneve 31 dhe 32 të Konventës së Vjenës dhe, për rrjedhojë, përjashtimi i Ambasadës së Turqisë nga procesi gjyqësor u ka cenuar atyre të drejtën e pronës private dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Ambasada e ka pranuar juridiksionin e gjykatave shqiptare në kontratën e shitblerjes të lidhur mes palëve të paditura, dhe, në këtë mënyrë, ka hequr dorë vullnetarisht nga imuniteti. Në kuptim të Konventës së Vjenës, pasuria objekt konflikti, edhe pse është e regjistruar në ZRPP-në Tiranë në emër të Ambasadës së Turqisë, nuk rezulton të jetë vendi ku agjenti diplomatik ushtron aktivitetin e tij. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, për sa kohë çështja e themelit është ende në shqyrtim në gjykatat e faktit dhe nuk ka një vendim përfundimtar, për sa u takon kërkimeve të ngritura në kërkesëpadi, kërkuesit kanë të drejtën dhe mundësinë të përdorin mbrojtjen juridiksionale për sa u takon pretendimeve të tyre në lidhje me të drejtën kushtetuese të pronës private, të sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës, dhe të marrin një përgjigje përfundimtare nga gjykata e faktit në lidhje me këto pretendime, në kuptim të së drejtës së aksesit në gjykatë, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 29, datë 30.03.2017, paragrafët 16-23 të GJK-së*).

➢ *Kërkesa për rishikim në Gjykatën e Lartë*

48. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi edhe pse kërkesa për rishikim ishte përpiluar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit, si nga ana formale, ashtu edhe në përmbajtje, Gjykata e Lartë nuk e ka marrë atë në shqyrtim në seancë gjyqësore. Në këtë mënyrë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit ka marrë atributet e seancës gjyqësore, pasi ka shqyrtuar nëse shkaqet e

paraqitura përbëjnë arsye për rishikimin e vendimit të formës së prerë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit është ndalur vetëm në analizën e përmbushjes së kushtit që provat e reja "të mos kenë qenë e as mund të ishin në dijeni të kërkuesit", duke arritur në përfundimin se ky kusht nuk plotësohet. Nisur nga roli i Gjykatës së Lartë që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, Gjykata ka çmuar se në çështje të kësaj natyre, në drejtim të respektimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, por edhe të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, përmbushja e kritereve që duhet të plotësojë prova e re në kërkesën për rishikim, të përcaktuara nga vendimi unifikues, duhet të shqyrtohet në seancë dëgjimore, pra në seancë gjyqësore. Gjykata e Lartë nuk duhet të mjaftohet me një trajtim formal të çështjes, por duhet që, pavarësisht situatës juridike, të merrte të gjitha masat që e drejta e aksesit të garantohej efektivisht. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë, në rastin në shqyrtim, ishte e detyruar ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimin nr. 52, datë 24.07.2017, paragrafët 19-31, të GJK-së*).

49. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar dhe të së drejtës së aksesit, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2014-3420, datë 25.11.2014 nuk ka arsyetuar mbi shkaqet e mospranimit të rekursit. Ajo nuk i ka dhënë përgjigje çështjes së juridiksionit të ngritur prej saj gjatë gjykimit në themel të mosmarrëveshjes. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkueses në lidhje me çështjen e juridiksionit. Kjo e fundit, me vendimin nr. 00-2013-460 (91), datë 05.02.2013, duke e shqyrtuar çështjen në themel dhe duke e rikthyer atë për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e ka konsideruar në kompetencë të saj zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe në këtë mënyrë ka shqyrtuar kryesisht edhe çështjen e juridiksionit. Vendimi i Gjykatës së Lartë i ka përmbushur elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit. Edhe pse nëpërmjet një arsyetimi të kufizuar, Gjykata e Lartë, pasi ka vlerësuar shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuesja, ka arritur në përfundimin se ato nuk plotësojnë kërkesat ligjore për kalimin në seancë gjyqësore të çështjes, duke i dhënë përgjigje asaj edhe për pretendimin për çështjen e juridiksionit, në respekt të parimit kushtetues të gjykatës së caktuar me ligj (*shih vendimin nr. 81, datë 19.12.2016, paragrafët19-23 të GJK-së*).

50. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs për cenimin e parimeve të procesit të rregullt ligjor në gjykatën e apelit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, duke iu referuar dyshimit për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuesit, është detyrë e Gjykatës së Lartë të bëjë të mundur realizimin efektiv të së drejtës së aksesit, pa lënë shkas për ekuivoke në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin nga ana e saj të pretendimeve të ngritura në rekurs (*shih vendimin nr. 3, datë 23.02.2016, paragrafët 20-22 të GJK-së*).

51. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar dhe të së drejtës së aksesit, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh

pretendimet në lidhje me shkeljet e ligjit procedural dhe material të gjykatës së apelit, si dhe nuk ka arsyetuar shkaqet e ngritura në rekurs, duke shkelur parimin e arsyetimit të vendimit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhej ta kalonte çështjen në seancë plenare në zbatim të vendimit të Gjykatës. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, Gjykata e Lartë nuk i ka përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimet që rrjedhin nga vendimi nr. 42, datë 07.07.2014 për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor gjatë rigjykimit të çështjes në po atë gjykatë. Në këto kushte, duke mbajtur në konsideratë edhe efektin detyrues të vendimeve të Gjykatës, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit është i bazuar dhe se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet (*shih vendimin nr. 44, datë 29.06.2015, paragrafët 12-17 të GJK-së*).

52. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar dhe të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi, ndonëse në datën 27.06.2012 kërkuesja ka depozituar në Gjykatën e Lartë kopjen e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 493, datë 10.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, që e ka konstatuar si të pavërtetë përmbajtjen e certifikatës së përbërjes familjare nr. 22/30, datë 01.08.1991, Kolegji Civil nuk e ka analizuar këtë provë të re dhe ka vendosur rrëzimin e kërkesës për rishikimin e vendimeve gjyqësore që kanë pasur për objekt konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitblerjes. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, mospasqyrimi dhe mosanalizimi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i vendimit nr. 493, datë 10.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, që ka vendosur konstatimin si të pavërtetë të certifikatës së përbërjes familjare nr. 22/30, datë 01.08.1991, i cili ka qenë i administruar në dosje në kohën e shqyrtimit të çështjes, e bën vendimmarrjen objekt kundërshtimi të vesuar në drejtim të mosrespektimit të standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit, si dhe ngre dyshime serioze edhe për cenimin e aksesit efektiv në atë gjykim. Mospranimi i kërkesës për rishikim, si rrjedhojë e zhvillimit të një procesi gjyqësor në cenim të garancive të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i ka hequr përfundimisht kërkueses mundësinë për rivendosjen e së drejtës së cenuar, që në thelbin e vetë ka pasur për objekt të drejtën e pronësisë (*shih vendimin nr. 75, datë 16.12.2016, paragrafët 16-25 të GJK-së).*

53. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar dhe kjo e fundit nuk është shprehur lidhur me shkeljet e gjykatave më të ulëta, si dhe nuk ka paraqitur në vendim shkaqet e rekursit, duke i cenuar në këtë mënyrë kërkuesit edhe të drejtën e aksesit në gjykatë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor. Është detyrë e Gjykatës së Lartë të bëjë të mundur realizimin efektiv të së drejtës së aksesit, pa lënë shkas për ekuivoke në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin e pretendimeve të kërkuesve nga ana e saj (*shih vendimin nr.51, datë 12.11.2014, paragrafët 12-17 të GJK-së*).

54. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin në dhomë këshillimi, me arsyetimin se rekursi nuk përmban

shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit në lidhje me interpretimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e dy shkallëve të para, të cilat janë parashtruar edhe në rekurs. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, pretendimet e kërkuesit për interpretimin e gabuar, nga ana e gjykatave më të ulëta, mbi momentin e fillimit të afatit 3-vjeçar të parashkrimit të padisë dhe gjënë e gjykuar dhe, për rrjedhojë, sipas tij, cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të mosgarantimit të aksesit në gjykatë, edhe pse përfshihen në parashikimet e nenit 472 të KPC-së, nuk rezulton të kenë marrë një përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë. Gjykata e Lartë duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 52, datë 02.12.2013, paragrafët 15-17 të GJK-së*).

55. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke referuar zgjidhjen e çështjes te shkronja "ç" e nenit 494 të KPC-së, nuk i ka dhënë zgjidhje asaj, duke i mohuar të drejtën që çështja e tij të dëgjohet nga një gjykatë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, kërkesa për rishikim e paraqitur nga kërkuesi është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila ka analizuar pretendimet e tij dhe është shprehur për thelbin e tyre. Vetë kërkuesi ka pasur mundësi t'i parashtrojë pretendimet e tij gjatë seancës gjyqësore. Kërkuesi e ka realizuar të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë, si nga pikëpamja formale, duke përdorur mjetin procedural ankimues të përshtatshëm (rishikimin), ashtu edhe në aspektin substancial, duke pasur parasysh se pretendimet e tij janë shqyrtuar në seancë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i cili i ka dhënë çështjes një përgjigje përfundimtare. Pretendimet e ngritura nga kërkuesi që kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave nuk përbëjnë objekt shqyrtimi kushtetues (*shih vendimin nr.20, datë 13.04.2012, paragrafët 10-15 të GJK-së*).

56. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit) për shkak të keqinterpretimit të nenit 349 të Kodit Civil *(KC)* nga Gjykata e Lartë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, interpretimi i ligjit është, para së gjithash, detyrë e organeve që e zbatojnë atë. Në çështjen konkrete, Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim në përputhje të plotë me interpretimin konstant që ajo i bën ndër vite nenit 349 të KC-së. Vendimi objekt kërkese rezulton se është në koherencë me vendimin nr. 19, datë 15.03.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 1743, datë 28.10.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 1267, datë 26.07.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 00-2007-1553 të vendimit (1254), datë 06.11.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe me vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 31.05.2011. Në vlerësimin nëse ky interpretim konstant i nenit 349 të KC-së nga Gjykata e Lartë u mohon kërkuesve të drejtën e aksesit, Gjykata mban parasysh ekzistencën e mjeteve të tjera procedurale në dispozicion të tyre. Gjykata e Lartë ka vlerësuar në vendimin objekt kërkese (fq. 8 dhe 9) se kërkuesit kishin në dispozicion padinë e rivendikimit të parashikuar nga neni 296 i KC-së. Kjo padi mund të ngrihet nga çdo subjekt që pretendon se është pronar i një sendi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues ose mbajtës. Në

vijim të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 31.05.2011, kjo padi është e paparashkrueshme dhe për këtë arsye mund të ushtrohet në çdo kohë. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se vendimi objekt kërkese nuk cenon të drejtën e aksesit të kërkuesve, pasi në përputhje me qëndrimin e Gjykatës së Lartë, ata mund të ushtrojnë në çdo kohë padinë e rivendikimit të parashikuar nga neni 296 i KC-së për të mbrojtur të drejtat e tyre. Mosshqyrtimi i disa pretendimeve të ngritura në rekurs e ka origjinën te vetë sjellja e kërkuesve, të cilët nuk kanë ushtruar padinë e përshtatshme për mbrojtjen e pronësisë së tyre (*shih vendimin nr. 39, datë 18.07.2012, paragrafët 11-19 të GJK-së*).

➢ *Kufizimi i së drejtës së aksesit në gjykatë për shkak të imunitetit*

57. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit, pasi Gjykata e Lartë, duke nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar, nuk ka arsyetuar se përse subjekti i interesuar pengohet në gëzimin e imunitetit të tij diplomatik nëse çështja gjykohet nga gjykatat shqiptare. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, ishte detyrë e Gjykatës së Lartë që, në zbatim të parimeve të jurisprudencës së GJEDNJ-së, të hetonte dhe të jepte përgjigje në vendim nëse kontrata e punës, objekt shqyrtimi, hyn në sferën e veprimeve "të lidhura direkt" me përmbushjen e misionit ose funksionit diplomatik sipas Konventës së Vjenës ose në kuptim të nenit 11 të Konventës së Kombeve të Bashkuara të 2004, si dhe nëse kërkuesja ka pasur "përgjegjësi shtesë" të bazuara në prova, të cilat mund të cenonin parimin e imunitetit diplomatik të subjektit të interesuar. Gjykata e Lartë duhej të sqaronte paqartësitë që rezultojnë nga formulimi i nenit 9 të kontratës së punës së lidhur ndërmjet palëve, sipas të cilit në rast mosmarrëveshjeje mbi interpretimin ose zbatimin e saj, nëse palët nuk e zgjidhin atë miqësisht "objekti i mosmarrëveshjes do t'i kalohet autoritetit gjyqësor kompetent", pa përcaktuar se për kë autoritet gjyqësor bëhet fjalë. Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke mos e arsyetuar vendimin për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar i ka mohuar kërkueses edhe të drejtën e aksesit në gjykatë, si dhe të drejtën për të pasur një vendim përfundimtar që do t'u jepte përgjigje pretendimeve të saj (*shih vendimin nr. 18, datë 15.03.2016, paragrafi 31, të GJK-së*).

➢ *Shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë*

58. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar dhe të së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit, është i paarsyetuar, duke legjitimuar shkeljet e kryera në shkallët e tjera të gjykimit. Në rastin konkret, plotësohen kushtet për t`iu drejtuar Gjykatës, në kuptim të nenit 187 të ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Gjykata i ka vlerësuar këto pretendime të pabazuara. Sipas saj, ndër të tjera, bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë, arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Vetëm kur konstatohen shkelje të parimeve të procesit të rregullt

ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar dhe riparuar nga Gjykata e Lartë, vendimi për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr.34, datë 15.06.2016, paragrafët 13-18 të GJK-së*).

59. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi gjatë gjykimit në këtë gjykatë kërkuesi nuk ka marrë dijeni për rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar. Dëftesa e komunikimit të rekursit nuk është nënshkruar prej tij, por prej të atit të tij dhe mungon data e marrjes dijeni. Në dëftesë është vetëm nënshkrimi i personit që ka bërë njoftimin, por nuk mund të identifikohet emri i tij. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, bazuar në procesverbalin e seancës së datës 22.11.2012, të zhvilluar në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, rezulton se kërkuesi ka marrë dijeni rregullisht për njoftimin e shpalljes së datës 07.11.2012 dhe nuk është evidentuar asnjë shkak për mosparaqitje. Bazuar në materialet e dosjes gjyqësore rezulton se adresa në të cilën është komunikuar ankimi është e njëjtë me adresën ku është komunikuar rekursi. Fletëthirrja për ankimin është nënshkruar nga nëna e tij, ndërsa fletëthirrja e komunikimit të rekursit është nënshkruar prej të atit të kërkuesit (*shih vendimin nr. 53, datë 20.07.2015, paragrafët 10-13 të GJK-së*).

60. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs për cenimin e parimeve të procesit të rregullt ligjor në gjykatat e faktit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, që lidhen me cenimin e të drejtave të fituara, si edhe bazuar në faktin se gjykatat më të ulëta i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme mosmarrëveshjes civile në fjalë, Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhej t`u jepte përgjigje këtyre pretendimeve. Duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pa u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura prej tij, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës (*shih vendimin nr.62, datë 23.09.2015, paragrafët 23-26 të GJK-së*).

61. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar dhe të së drejtës së aksesit, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mos i dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesit se nuk ka pasur dijeni për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Vlorë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, vendimi i Kolegjit Civil për mospranimin e rekursit, në pjesën hyrëse, përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit, si dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit ka paraqitur rekurs kërkuesi. Ky vendim nuk pasqyron në pjesën hyrëse të gjitha shkaqet e parashtruara në rekurs nga kërkuesi, konkretisht pretendimin e tij në lidhje me mosnjoftimin për zhvillimin e gjykimit në gjykatën e apelit. Mosdhënia përgjigje nga Kolegji Civil mbi pretendimin kryesor të kërkuesit që lidhet me aksesin në gjykatë, i ka cenuar atij të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar në përputhje me

nenin 142/2 të Kushtetutës dhe po ashtu të drejtën për akses efektiv në Gjykatën e Lartë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së (*shih vendimin nr.82, datë 28.12.2015, paragrafët 10-18 të GJK-së*).

62. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit çështja në shqyrtim ka pasur për objekt vetëm konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik, nuk është i bazuar në të dhënat që përmban kërkesëpadia, pasi, sipas kërkueses, kërkimi i saj nuk është vetëm pavlefshmëria e kontratës së shitblerjes, por edhe kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, kërkuesja nuk ka marrë një përgjigje përfundimtare në lidhje me pretendimet e saj, sepse Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2013-1279 (210), datë 21.03.2013, ka vendosur pushimin e gjykimit me arsyetimin se objekti i padisë është kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik, i cili nuk mund të bëhet si kërkim i mëvetësuar. Në rastin në shqyrtim, nga tërësia e përmbajtjes së kërkesëpadisë dhee të gjitha akteve të tjera të depozituara në dosjen gjyqësore, kërkimi përfundimtar i kërkueses dhe i përfaqësuesit të saj është pavlefshmëria e kontratës së shitjes dhe kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme. Përfundimi i Gjykatës së Lartë, se pretendimi i kërkueses për pavlefshmërinë absolute të kontratës nuk është shoqëruar me zgjidhjen e pasojave të ardhura nga ekzekutimi i tij dhe, si i tillë, nuk mund të ngrihet, bie ndesh me përcaktimet e vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 29.03.2012, dhe në aspektin kushtetues, i ka cenuar asaj të drejtën për të marrë një përgjigje përfundimtare nga gjykata për pretendimet e ngritura (*shih vendimin nr. 22, datë 16.04.2014, paragrafët 15-23 të GJK-së*).

63. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh pretendimet në lidhje me arsyetimin e gabuar të gjykatës së apelit mbi vlerën juridike të deklaratës noteriale të vitit 2008, përmes së cilës ka hequr dorë nga pasuria në bashkëpronësi, e më pas e ka revokuar, në kuptim të nenit 191 të KC-së. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, nisur nga detyrimi që ka Gjykata e Lartë që rast pas rasti t'u japë përgjigje problemeve ligjore që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit material, po edhe për shkak të natyrës të së drejtës së pretenduar, siç është e drejta e pronësisë, për sa kohë kërkuesja nuk ka marrë përgjigje për pretendimet me natyrë kushtetuese të parashtruara në rekurs, asaj i është mohuar e drejta e aksesit në kuptimin substancial (*shih vendimin nr.42, datë 7.07.2014, paragrafët 9-19 të GJK-së*).

64. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi Kolegji Civil ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes me arsyetimin se depozitimi i rekursit ka qenë i panënshkruar nga vetë palët dhe as nga mbrojtësit e tyre me prokurë të posaçme. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, kërkesa e nenit 474 të KPC-së për nënshkrimin e rekursit civil duhet të vlerësohet në harmoni me tërësinë e elementeve të tjera që duhet të verifikohen paraprakisht me qëllim sigurimin e efektivitetit të mjetit procedural të ushtruar nga palët. Në këtë kuptim, zbatimi i nenit 474 të

KPC-së duhet parë në raport edhe me rregullimet e përgjithshme që disiplinojnë paraqitjen e ankimit, si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursit. Përderisa çështja civile ishte kaluar për shqyrtim në seancë dhe për sa kohë mbrojtësit ligjorë të rekursuesve ishin të pranishëm dhe të pajisur me tagra përfaqësimi në përputhje me formën e përcaktuar nga ligji, çka jo vetëm nuk tregonte neglizhencë të theksuar nga ana e tyre, por, përkundrazi, vullnetin për të vijuar procesin gjyqësor, Kolegji Civil kishte detyrimin t'u jepte mundësinë kërkuesve të shpreheshin mbi shkaqet e rekursit, për të vendosur më pas për pranimin ose jo të tij. Në momentin që çështja kalon për gjykim, prezumohet se kërkuesit i është njohur e drejta për t'u dëgjuar në një seancë publike nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 53, datë 01.12.2014, paragrafët 13-26 të GJK-së*).

➢ *Paraqitja e rekursit brenda afatit ligjor dhe e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë*

65. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2013-2208, datë 14.11.2013, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve për shkak të mosrespektimit të afatit 30-ditor të paraqitjes së tij. Për shkak të një mosveprimi me dashje ose nga pakujdesia e nëpunësit përgjegjës të administratës gjyqësore, atyre u është mohuar e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Gjykata, për të verifikuar pretendimin e kërkuesve, si fakt me natyrë kushtetuese, që lidhet me të drejtën e aksesit në gjykatë të individit, me shkresën, datë 18.03.2014, i ka kërkuar informacionin përkatës Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kjo e fundit ,me shkresë nr. 469 prot., datë 27.03.2014, ka konfirmuar se origjinali i rekursit për zënien e afatit është depozituar nga kërkuesit në datën 02.03.2010 dhe se ai ndodhet në nëndosjen gjyqësore që i përket çështjes në fjalë. Po ashtu, nga fleta e regjistrit të rekurseve, të po asaj gjykate, të datës 02.03.2010 rezulton se kërkuesit kanë paraqitur rekurs. Sipas saj, ndër të tjera, veprimet ose mosveprimet e parregullta të administratës gjyqësore nuk duhet t'i ngarkohen individit, i cili nuk mund të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së saj (administratës) (*shih vendimin nr.48, datë 24.09.2014, paragrafët 12-17 të GJK-së*).

66. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit, pasi edhe pse ai kishte depozituar rekursin brenda afatit ligjor 30-ditor për dorëzimin e tij, Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar, atë, me arsyetimin se ishte paraqitur tej këtij afati. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, mbështetur në aktet e sipër përmendura, ka rezultuar e provuar se rekursi është ushtruar nga kërkuesi në datën 03.08.2009, pra brenda afatit ligjor 30- ditor. Rrjedhimisht, Gjykata e Lartë, duke mos e shqyrtuar rekursin me arsyetimin se ai është paraqitur tej këtij afati, ka cenuar të drejtën e aksesit të kërkuesit në një mënyrë që bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe me KEDNJ-në (*shih vendimin nr.32, datë 22.05.2012 të GJK-së*).

67. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit) në Gjykatën e Lartë për arsye se mosparaqitja e kundërshtimeve në rekursin

e paraqitur përpara Gjykatës së Lartë për pabazueshmërinë e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër ka qenë për shkak të marrjes me vonesë të vendimit të arsyetuar të kësaj të fundit. Dosja me vendimin që kundërshtohej përpara Gjykatës së Lartë ka mbërritur në atë gjykatë rreth 5 muaj me vonesë. Kjo periudhë kohe, sipas kërkuesit, është jashtë çdo afati të arsyeshëm, çka e ka penguar realisht atë në ushtrimin e së drejtës së ankimit përpara Gjykatës së Lartë, duke i cenuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka vepruar në përputhje me rregullat procedurale lidhur me pranimin ose jo të rekursit për shqyrtim, kur ka vendosur pushimin e gjykimit me arsyetimin se nuk ka shkaqe, pasi çështja kishte kaluar në seancë. Në këtë mënyrë, Kolegji nuk i ka dhënë mundësi kërkuesit të dëgjohet lidhur me rekursin, duke i mohuar në këtë mënyrë atij të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës. Është e vërtetë se Kolegji Civil e kishte kaluar çështjen për gjykim, megjithëse kërkuesi nuk i kishte parashtruar shkaqet për shkak të mosmarrjes dijeni të vendimit të arsyetuar të Gjykatës së Apelit Shkodër. Megjithatë, mungesa ose jo e shkaqeve duhej të ishte verifikuar paraprakisht nga Kolegji Civil, sipas detyrimit të nenit 475 të KPC-së. Por, në fakt, Kolegji e ka kaluar çështjen për gjykim dhe pasi ka hapur seancën gjyqësore ka vendosur pushimin për shkak të mosparaqitjes së shkaqeve, çka vjen në kundërshtim me nenet 475, 476 dhe 485 të KPC-së. Kolegji Civil, përderisa kishte kaluar çështjen në seancë, kishte tashmë detyrimin t'i jepte mundësinë kërkuesit të shprehej mbi shkaqet e rekursit, për të vendosur më pas për pranimin ose jo të tij. Në këtë fazë nuk mund të diskutohet nëse janë plotësuar shkaqet për shqyrtim gjyqësor, pasi kjo gjë prezumohet se është kryer në fazën paraprake. Gjykata ka detyrimin të dëgjojë palët në seancën që zhvillohet për këtë qëllim. Kjo rezulton të mos jetë respektuar në gjykimin konkret nga Kolegji Civil, duke passjellë një proces të parregullt në kuptimin kushtetues (*shih vendimin nr.32, datë 22.07.2011 të GJK-së*).

68. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit) në Gjykatën e Lartë për shkak të moszbatimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të vendimit nr. 22, datë 26.07.2006 të Gjykatës. Duke refuzuar të zbatojë këtë vendim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shkelur rregullimin kushtetues, se "vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare" (neni 132 i Kushtetutës). Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka bërë të njëjtin interpretim ligjor për rekursin e kërkuesit, duke e konsideruar atë të paraqitur si jashtë afatit 30-ditor, ndërkohë që me vendimin nr. 22, datë 26.07.2006, Gjykata ka evidentuar parregullsinë e procesit ligjor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për shkak të mohimit të së drejtës për akses. Mbi këtë bazë, Gjykata ka konkluduar se rekursi është paraqitur në afat dhe kërkuesit nuk mund t'i cenohet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimin nr. 14, datë 03.06.2009 të GJK-së*).

69. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit) në Gjykatën e Lartë, pasi kjo gjykatë nuk ka pranuar për gjykim një rekurs të paraqitur brenda afatit ligjor. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Ajo ka

vlerësuar faktet kushtetuese dhe, duke pasur parasysh tërësinë e rrethanave, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë nga pala kërkuese ka qenë brenda afatit ligjor. Për pasojë, Gjykata e Lartë, Kolegji Civil, në dhomën e këshillimit, duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit si të paraqitur jashtë afatit ligjor, ka zhvilluar një proces të parregullt ligjor, sepse nuk ka respektuar të drejtën e aksesit në gjykatë (*shih vendimin nr. 17, datë 19.06.2009 të GJK-së*).

- ***E drejta e aksesit dhe kërkesa për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë***

70. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në kundërshtim me ligjin dhe me parimet e procesit të rregullt ligjor, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim të paraqitur prej tij, edhe pse organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin ka konstatuar në vendimin e pushimit të datës 28.09.2012 se subjekti i interesuar, A.Gj., ka konsumuar elementet e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve. Gjykata nuk e ka pranuar këtë pretendim. Sipas saj, ndër të tjera, interpretimi i ligjit procedural është atribut i gjykatave të sistemit gjyqësor dhe i organeve që e zbatojnë atë. Nisur nga ky parim, edhe sqarimi i kuptimit të çdo dispozite të KPP-së dhe raporti i saj me dispozitat e tjera të përafërta me të për zbatimin e tyre në gjykimet e çështjeve është në kompetencë të gjykatave të sistemit gjyqësor. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë *(shih paragrafin nr. 28)* është brenda kompetencave që ligji procedural i atribuon asaj Gjykate dhe, në këtë kuptim, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit nuk hyn në juridiksionin kushtetues (*shih vendimin nr. 76, datë 22.12.2015, paragrafët 21-30 të GJK-së*).

71. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi edhe pse kërkesa për rishikim ishte përpiluar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit, si nga ana formale, ashtu edhe nga përmbajtja, edhe ajo plotësonte të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga neni 494/a i KPC-së, Gjykata e Lartë nuk e ka marrë atë në shqyrtim. Në rastin konkret, nuk është konstatuar asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 498 i KPC-së për mospranimin e kërkesës për rishikim. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në rastet e paraqitjes së kërkesës për rishikimin e një vendimi të formës së prerë, neni 445 i KPC-së duhet të zbatohet në harmoni me nenin 496 të kodit, për sa i përket afatit prekluziv njëvjeçar. Interpretimi i dispozitave procedurale që rregullojnë institutin e rishikimit të një vendimi të formës së prerë, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me standardet kushtetuese të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të aksesit në gjykatë, ndaj ato mund të bëhen objekt i kontrollit të saj. Në lidhje me kërkesën për rishikim, duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, ligjvënësi ka parashikuar se ajo mund të paraqitet vetëm për shkaqe specifikisht të përcaktuara në ligj dhe brenda disa afateve ligjore, të ndryshme nga ato që zbatohen për mjetet e zakonshme të ankimit. Kjo, sepse ushtrimi i këtij mjeti ankimi lidhet me shkaqe që qëndrojnë jashtë procesit të themelit, të cilat mund të zbulohen rishtazi nga palët dhe që janë të tilla që mund të riçelin një gjykim të mbyllur në mënyrë përfundimtare. Për këto arsye, për shkak se zbulimi i shkaqeve/rrethanave të reja mund të ndodhë në çdo kohë, afati për paraqitjen e

kësaj kërkese nuk mund të jetë i lidhur me marrjen formë të prerë të vendimit që kërkohet të rishikohet. Për më tepër, kërkesa për rishikim mund të ushtrohet vetëm në rast se ankimuesi nuk ka mjet tjetër ankimi të zakonshëm në dispozicion, pasi një mjet si ankimi/rekursi përfshin në të dhe eliminon çdo mjet tjetër kundërshtimi. Në çështjen konkrete, neni 445 i KPC-së duhej interpretuar nga Gjykata e Lartë jo në mënyrë të shkëputur, por duke e parë atë në lidhje me nenin 496 të po këtij kodi që parashikon afatet e posaçme për paraqitjen e kërkesës për rishikim (*shih vendimin nr. 17, datë 24.03.2014, paragrafët 17-26 të GJK-së*).

72. Përpara Gjykatës është pretenduar se Gjykata e Lartë (dhoma e këshillimit), duke shkelur nenin 445 të KPC-së dhe duke mos zbatuar vendimin nr. 8, datë 24.03.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me interpretimin e afatit të paraqitjes së kërkesës për rishikim, i ka mohuar të drejtën për t'u paraqitur përpara gjykatës dhe, si rrjedhojë, dhe të drejtën e pronësisë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në rastet e paraqitjes së kërkesës për rishikimin e një vendimi të formës së prerë, neni 445 i KPC-së duhet të zbatohet në harmoni me nenin 496 të këtij kodi për sa i përket afatit prekluziv njëvjeçar. Pra, ky afat llogaritet ose nga momenti që është shpallur vendimi që ankimohet ose nga momenti që merr formë të prerë vendimi që përmban shkakun e rishikimit të parashikuar nga neni 494 i KPC-së. Nëse nuk do të interpretohej në këtë mënyrë, neni 445 i KPC-së, ashtu si është shkruar, do të ishte i paaplikueshëm, duke ia ngushtuar hapësirat individit për të pasur akses në gjykatë dhe për të shfrytëzuar mjetin procedural të jashtëzakonshëm të kërkesës për rishikim (*shih vendimin nr. 20, datë 29.09.2008 të GJK-së*).

B- PENALE

a) Për gjykatat e faktit

73. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi qëndrimi i kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për mosdërgimin e ankimit dhe të rekursit të paraqitur prej tij, sepse nuk plotësonin kushtet për t'u shqyrtuar nga gjykata e apelit dhe nga Gjykata e Lartë, i ka cenuar të drejtën e aksesit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kryer veprime që bien në kundërshtim me përmbajtjen e rregullave procedurale dhe praktikën gjyqësore që garantojnë kontrollin gjyqësor në gjykatat më të larta të pretendimeve të palëve në proces, lidhje me kompetencën e gjykatës. Aktet e nxjerra prej kancelarit i kanë mohuar kërkuesit të drejtën e aksesit në gjykatë (*shih vendimin 63, datë 4.11.2016, paragrafët 4-12 të GJK-së*).

74. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi gjykatat kanë bërë një interpretim të gabuar të nenit 291 të KPP-së, si edhe kanë anashkaluar nenin 58 të po këtij kodi, i cili i njeh të dëmtuarit ose trashëgimtarëve të tij të drejtën për të kërkuar procedimin e fajtorit. Kjo mënyrë e ndryshme interpretimi dhe zbatimi e dispozitave

procedurale ka sjellë për pasojë përjashtimin e kërkuesit nga e drejta e ankimit kundër vendimit të prokurorisë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, sipas nenit 58 të KPP-së, personi i dëmtuar ose trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të kërkojnë procedimin e autorit dhe shpërblimin e dëmit, të parashtrojnë kërkesa në organin procedues dhe të kërkojnë marrjen e provave. Në këtë kuptim, kërkuesi ose familjarët e tjerë të viktimës nuk kanë pasur asnjë pengesë ligjore që të kërkonin të dhëna dhe informacione nga organi i akuzës apo që të paraqisnin kallëzim për shkak të dyshimeve për shkaqet e vdekjes së viktimës Sh.K. Për sa kohë që kërkuesi nuk ka vënë në lëvizje organin e akuzës për fillimin e procedimit penal, ai nuk legjitimohet në paraqitjen e ankimit ndaj këtij vendimi. Edhe pse në dukje dispozita e nenit 291 të KPP-së cenon të drejtën e aksesit, duke e parë këtë dispozitë në harmoni me dispozitat e tjera të saj, si dhe me përfundimet e vendimit nr.2, datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson se nuk preket në thelb e drejta e aksesit (*shih vendimin nr. 67, datë 17.11.2015, paragrafët 11-20 të GJK-së*).

75. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi gjykata e apelit nuk ka shqyrtuar pretendimin e kërkuesit të ngritur në apelim për padrejtësinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë për refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar. Edhe pse ekzistonin kushtet e nenit 406/1 të KPP-së, gjykata nuk ka zhvilluar një gjykim të shkurtuar, me pasojë mosuljen e dënimit me një të tretën, siç parashikon kjo dispozitë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Ajo e ka shqyrtuar çështjen nëse lënia jashtë kontrollit juridiksional i vendimit të gjykatës së shkallës së parë që refuzon gjykimin e shkurtuar, shkel të drejtën e aksesit të kërkuesit për një gjykim në shkallë të dytë. Sipas saj, ndër të tjera, mungesa e kontrollit në shkallë të dytë të këtij vendimi refuzimi, mohon aksesin për një gjykim në shkallë të dytë lidhur me pretendimet për mosrespektimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e dënimit (*shih vendimin nr. 21, datë 16.04.2012 të GJK-së*).

76. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi Gjykata e Apelit Vlorë dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë kanë interpretuar dhe zbatuar të drejtën procedurale penale (interpretimi i neneve 249 dhe 415/1 të KPP-së) jo në përputhje me të drejtën e aksesit dhe të ankimit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, nisur nga përmbajtja e dispozitave në shqyrtim (nenet 249/1 dhe 415/1 të KPP-së) dhe nga vetë interpretimi që këtyre dispozitave i është bërë nga Gjykata e Lartë afatit dhjetëditor, brenda të cilit duhet bërë ankimi ndaj vendimeve për masat e sigurimit, fillon nga e nesërmja e shpalljes ose njoftimit të vendimit. Sipas këtij interpretimi, në rastin objekt shqyrtimi, rezulton se kërkuesi ka paraqitur ankimin ndaj masës së sigurimit brenda afateve ligjore. Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është rezultat i zbatimit të gabuar të neneve 249 dhe 415/1 të KPP-së, si rrjedhojë e të cilit kërkuesit i është cenuar e drejta e aksesit dhe e drejta e ankimit në këtë gjykatë *(shih vendimin nr. 40, datë 18.07.2012, paragrafët 17-31 të GJK-së*).

77. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe

trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" shkel hapur të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Ky ligj parashikon se kërkesa për vendosjen e sekuestros shqyrtohet nga gjykata në praninë e prokurorit, në bazë të dokumenteve të paraqitura prej tij. Ligji mohon të drejtën e aksesit efektiv në gjykatë, bazuar mbi parimin e kontradiktoritetit, barazinë e armëve dhe të drejtën për t'u gjykuar. Ligji nuk parashikon asnjë kriter ose kusht ligjor që duhet të plotësojë kërkesa e prokurorit për konfiskimin e pasurisë, me qëllim që kjo kërkesë të jetë e vlerësueshme dhe pranueshme prej gjykatës. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, procesi në tërësinë e tij i jep mundësinë personit të prekur që të vërë në vend të drejtën e tij, për shembull, në rast se gjykata e apelit do të arrinte në përfundimin se pretendimi është i bazuar do të vendoste heqjen e sekuestrimit. Prandaj, i parë në tërësinë e vetë, procesi për vendosjen e masës së sekuestros nuk cenon standardin kushtetues të aksesit efektiv në gjykatë, kontradiktoritetit dhe së drejtës për t'u dëgjuar (*shih vendimin nr. 4, datë 23.02.2011, paragrafët 31-34 të GJK-së*).

78. Përpara Gjykatës, në rrugën e kontrollit incidental, është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë nga parashikimi në nenin 329/1 të KPP-së, pjesa e fjalisë "përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston". Sipas kësaj dispozite kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri, përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, neni 329/1 i KPP-së, pjesa e fjalisë "përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston", bie ndesh edhe me përmbajtjen e nenit 17 të Kushtetutës, i cili parashikon kriteret e kufizimeve të të drejtave dhe lirive themelore që duhen respektuar në çdo rast nga ligjvënësi. Ankimimi gjyqësor i vendimeve të prokurorit duhet të garantohet në çdo rast, gjë e cila nuk është respektuar nga ligjvënësi në rastin e nenit 329/1 të KPP-së, duke e bërë përmbajtjen e tij antikushtetuese. Në këtë këndvështrim, dispozita e këtij neni cenon garancinë e vendosur nga neni 42/2 i Kushtetutës, sipas të cilit, kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Përjashtimi i shkronjës "a" të nenit 328 nga rastet e ankimit përbën një kufizim të së drejtës së përgjithshme të aksesit në gjykatë, të parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës (*shih vendimin nr. 5, datë 06.03.2009 të GJK-së*).

b) Për Gjykatën e Lartë

➢ ***Mosshqyrtimi i rekursit për shkak të mospërfaqësimit me mbrojtës***

79. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi qëndrimi i Gjykatës së Lartë, që nuk e ka pranuar rekursin, me arsyetimin se është paraqitur nga një mbrojtës pa tagra, ka sjellë mohimin absolut të së drejtës së tij për t`iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura.

Përfaqësimi i kërkuesit në Gjykatën e Lartë dhe ushtrimi i të drejtave në funksion të mbrojtjes së tij janë realizuar në bazë të prokurës së posaçme nr. 2636, datë 24.09.2020, e nënshkruar nga vetë kërkuesi në IEVP, në prani të punonjësve të këtij institucioni, e cila i është bashkëlidhur edhe ankimit kushtetues individual. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në vështrim të garantimit të standardit të aksesit në gjykatë, dispozitat e KPP-së nuk mund të interpretohen nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në një mënyrë të tillë të ngushtë, që cenon thelbin e së drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykate. Gjykata e Lartë, në kuptim të rrethanave të faktit të evidentuara, kishte të gjitha hapësirat që kërkesat ligjore për elementet formale që duhet të plotësojë rekursi, në përputhje me funksionin e saj të interpretimit të normës dhe në kuptim të parimit të subsidiaritetit e pozicionit të saj në piramidën gjyqësore, t'i interpretonte me qëllim garantimin e të drejtave themelore të individit, konkretisht të së drejtës së aksesit substancial. Duke i vlerësuar veprimet/mosveprimet e konstatuara në procesin gjyqësor në drejtim të garantimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, vendimi i Kolegjit Penal për mospranimin e rekursit, i kundërshtuar nga kërkuesi, është rrjedhojë e një tërësie shkaqesh që lidhen me veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore, duke nisur me mosveprimet e IEVP-së Fushë-Krujë, e cila duhej t`i përcillte një kopje të aktit të përfaqësimit organit procedues (prokurorisë ose gjykatës) dhe, më pas, me mosveprimet e gjykatave, që nuk kanë hetuar dhe verifikuar në mënyrën e duhur përfaqësimin dhe tagrat e mbrojtësit, por edhe me sjelljen e vetë mbrojtësit të kërkuesit (*shih vendimin nr. 6 datë 22.02.2022, paragrafët 18-33 të GJK-së*).

80. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi Gjykata e Lartë, duke mos pranuar rekursin, ka vepruar në kundërshtim me vendimin e saj unifikues nr.1/2014, në të cilin është përcaktuar se mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët në kushtet e kufizimit të lirisë personale të të pandehurit do të konsiderohet, për efekt të ligjit, si mbrojtës i zgjedhur. Kërkuesi vuan nga një sëmundje mendore dhe, për këtë shkak, nuk ka mundur të zgjedhë vetë mbrojtës, prandaj Gjykata e Lartë duhej ta pranonte mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, Gjykata e Lartë në vendimin e saj nuk e ka trajtuar çështjen duke u bazuar në interpretimin e nenit 48, pika 3, të KPP-së dhe në paragrafin 25 të vendimit të saj unifikues nr.1/2014, të cilat i përgjigjen situatës faktike konkrete, por i është referuar paragrafit 54 të vendimit unifikues nr.1/2014. Në rastin konkret, nuk jemi përpara situatës ku i pandehuri i fshihet drejtësisë ose është në mungesë, por jemi në kushtet e pamundësisë së kërkuesit për të zgjedhur mbrojtës për arsye të kufizimit të lirisë së tij personale. Kjo qasje ndaj nenit 48, pika 3, të KPP-së në çështjen konkrete i ka kufizuar kërkuesit aksesin substancial në gjykim, pasi nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij të ngritura në rekurs. Kjo e fundit duket se ka mbajtur një qëndrim formalist për sa i përket mbrojtësit të zgjedhur nga nëna e kërkuesit, duke mos shkuar përtej një kontrolli formal të prokurës, në drejtim të verifikimit nëse zgjedhja e mbrojtësit nga nëna e të gjykuarit ishte rezultat edhe i vullnetit të plotë të këtij të fundit (*shih vendimin nr. 10 datë 12.04.2022, paragrafët 6-13 të GJK-së*).

81. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur

mospranimin e rekursit si të paraqitur nga një avokat pa tagra. Mbrojtësi i kërkuesit e kishte tagrin për të bërë rekurs që buronte nga akti i përfaqësimit të datës 25.09.2016. Gjykata e Lartë ka bërë një arsyetim të kufizuar të vendimit të saj. Gjykata i ka vlerësuar këto pretendime të pabazuara. Sipas saj, ndër të tjera, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në shqyrtimin e çështjes konkrete, ka vlerësuar pretendimet e ngritura në ankim nga kërkuesi, shkaqet e rekursit, si dhe shtesat e saj. Ai kolegj nuk e ka mbështetur arsyetimin e tij vetëm te mospasja e tagrave të përfaqësimit nga ana e mbrojtësit të kërkuesit, por ka vlerësuar edhe shkaqet e rekursit. Edhe pse me një arsyetim të kufizuar, ajo ka parashtruar shkaqet e rekursit dhe i ka vlerësuar ato në përputhje me standardet e mësipërme të arsyetimit në dhomën e këshillimit, duke i dhënë kërkuesit edhe mundësinë e realizimit të aksesit në aspektin formal dhe mbrojtjes efektive, njësoj sikur ajo të ishte bërë nga një avokat (*shih vendimin nr. 14 datë 21.06.2022, paragrafët 28-39 të GJK-së*).

82. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë dhe i marrjes së një përgjigjeje përfundimtare prej saj, për shkak të qëndrimit të Gjykatës së Lartë se rekursi i paraqitur nga avokati V.A. është i paplotë, rekursi i nënshkruar nga avokati A.Ç. është paraqitur nga një subjekt që nuk e kishte tagrin e përfaqësimit, ndërsa parashtrimet e avokatit B.D. përpara shqyrtimit të çështjes në Kolegjin Penal nuk mund të zëvendësojnë shkaqet e rekursit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, pavarësisht se rekursi i paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur nga kërkuesi, avokati V.A., është i paplotë, pasi nuk përmban shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit dhe argumentet përkatëse në lidhje me kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, kërkuesi, si nëpërmjet mbrojtësit që kishte mbrojtur interesat e tij deri në gjykatën e apelit (avokatit V.A.), ashtu edhe nëpërmjet avokatëve të tjerë, ka shprehur qartë vullnetin për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Nga ana tjetër, fakti që ky mbrojtës nuk ka paraqitur rekurs të plotë për të parashtruar shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së, është kushtëzuar nga mosnjoftimi i vendimit të arsyetuar të Gjykatës së Apelit Durrës. Në kushtet kur përfaqësimi me mbrojtës në Gjykatën e Lartë është i detyrueshëm dhe kërkuesi gjendet në kushtet e kufizimit të lirisë personale, ajo duhej ta kishte shqyrtuar në tërësinë e fakteve shkakun e mosparaqitjes së rekursit të plotë kundër vendimit të apelit dhe vullnetin e tij për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kjo e fundit, edhe pse ka legjitimuar mbrojtësin V.A., të zgjedhur fillimisht prej babait të kërkuesit, zgjedhje të cilën edhe vetë kërkuesi e ka konfirmuar, duket se ka mbajtur një qëndrim formalist në vijim, pasi ka vlerësuar se nuk legjitimohet mbrojtësi i dytë i zgjedhur nga babai sërish mbi të njëjtën bazë ligjore (neni 48, pika 3, i KPP-së). Gjykata e Lartë nuk ka shkuar përtej një kontrolli formal të prokurës, në drejtim të verifikimit nëse edhe zgjedhja e mbrojtësit të dytë nga babai i të gjykuarit ishte rezultat edhe i vullnetit të plotë të këtij të fundit. Gjykata e Lartë ka anashkaluar arsyen e mosparaqitjes së shkaqeve, konkretisht mungesën e një vendimi të arsyetuar të gjykatës së apelit, brenda afatit të paraqitjes së rekursit, si dhe vullnetin e kërkuesit, tashmë të manifestuar për kundërshtimin e vendimit dhe ka vendosur apriori mospranimin e rekursit për mungesë të kritereve formale që ai duhet të përmbajë. Gjykata e Lartë kishte të gjitha hapësirat që kërkesat ligjore për elementet formale që duhet të plotësojë rekursi, në përputhje me funksionin e saj të interpretimit të normës, si

dhe në kuptim të parimit të subsidiaritetit e pozicionit të saj në piramidën gjyqësore, t'i interpretonte me qëllim garantimin e të drejtave themelore të individit, konkretisht të së drejtës së aksesit substancial (*shih vendimin nr. 32 datë 03.11.2022, paragrafët 6-22 të GJK-së*).

83. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit i lidhur me të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën e ankimit efektiv, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për përbërjen e kolegjit që do të shqyrtonte rekursin, për procedurën e shqyrtimit të tij, për datën dhe orën e seancës, në përputhje me nenin 436 të KPP-së, si dhe nuk ka publikuar të dhënat e çështjes në faqen zyrtare. Në dosjen gjyqësore të asaj gjykate mungon dokumentacioni që provon caktimin e çështjes me short, njoftimi dhe afishimi i të dhënave të çështjes në faqen zyrtare të gjykatës, me qëllim marrjen dijeni për to nga kërkuesi, mbrojtësi dhe publiku, si dhe procesverbali i seancës së gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, sekretaria e Gjykatës së Lartë nuk rezulton të ketë kryer njoftimin e kërkuesit dhe as të mbrojtësit të caktuar prej tij, me asnjë nga mënyrat e parashikuara në ligj. Për rrjedhojë, kërkuesi, duke mos u njoftuar në përputhje me dispozitat procedurale për datën e shqyrtimit të rekursit së tij, nuk ka pasur mundësi të paraqesë pretendimet e tij për zbatimin e ligjit penal favorizues, të cilat nuk mund të ishin paraqitur prej tij në momentin e paraqitjes së rekursit. Nga ana tjetër, Kolegji Penal nuk ka verifikuar respektimin e procedurave të njoftimit, për rrjedhojë arsyetimin e vendimit e ka bazuar vetëm mbi shkaqet e rekursit, sipas formulimit të tyre në momentin e paraqitjes së tij nga avokati i kërkuesit. Në këtë mënyrë, duke mos e njoftuar për datën e shqyrtimit të rekursit, e ka vënë në pamundësi të paraqesë pretendimet e tij në lidhje me çështje të zbatimit dhe veprimit të ligjit në kohë, duke i kufizuar në këtë mënyrë aksesin substancial në gjykim, për më tepër që ligji penal në kohën e shqyrtimit të rekursit kishte pësuar ndryshime (*shih vendimin nr. 20 datë 22.09.2022, paragrafët 6-14 të GJK-së*).

84. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi GJKKO-ja e Shkallës së Parë, si pasojë e zbatimit të aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar, ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e tij. Këto të drejta janë cenuar edhe nga GJKKO-ja e Apelit, pasi ajo ka mbajtur një qëndrim tejet formalist dhe ka shpërfillur çdo kërkesë të mbrojtësve, edhe pse ishte shkalla e parë *de facto* ku kërkuesi mund t'i ushtronte ato. GJKKO-ja e Apelit kishte detyrimin të bënte një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për faktin nëse ishte lëshuar ose jo prokurë, duke qenë se sekretaria e GJKKO-së së Shkallës së Parë e kishte pranuar ankimin dhe kishte kryer veprimet përkatëse të përcjelljes së ankimit. Për më tepër, edhe gjykimi në Gjykatën e Lartë është bërë në dhomë këshillimi, duke mos i dhënë mundësi korrigjimi parregullsive të procesit, të cilat sjellin pavlefshmërinë absolute të tij. Gjykata i ka vlerësuar këto pretendime të bazuara. Sipas saj, ndër të tjera, Gjykata e Lartë, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, të cilat lidheshin me cenimin e procesit të rregullt ligjor në gjykatën e apelit, sikurse e drejta për t'u dëgjuar, e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe e drejta e ankimit, në kushtet kur cenimi i këtyre të drejtave ishte pasojë e një akti normativ për të cilin ai kishte kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë, ajo nuk ka garantuar të drejtën e kërkuesit për akses në gjykatë. Megjithatë, ndonëse pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit

në gjykatë është i bazuar, Gjykata ka evidentuar se dërgimi i çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk do të sillte ndonjë rezultat konkret për kërkuesin *(shih paragrafin 44 të këtij vendimi)*, pasi masa parandaluese e kufizimit të lëvizjes është ekzekutuar *(shih paragrafin 40 të këtij vendimi).* Për rrjedhojë, Gjykata ka çmuar të shprehet vetëm për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimin 12, datë 24.05.2022, paragrafët 48-57 të GJK-së*).

85. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh faktin se marrëveshja për ekstradimin konkurron me marrëveshjen dypalëshe me Italinë për njohjen e vendimeve penale të huaja mes dy vendeve dhe ekzekutimin përkatës në vendin e origjinës. Konkurrimi mes këtyre dy akteve, bazuar në nenin 29/3 të Kushtetutës, prodhon nevojën e përcaktimit se cili prej tyre është favorizues. Dhe në rastin konkret, marrëveshja e cila mund të veprojë në dëm të kërkuesit është ajo e njohjes së vendimit penal, nëse ekzistojnë kushtet procedurale të nenit 514 të KPP-së. Gjykata e ka vlerësuar pretendimin të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me argumentin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Kërkuesi në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ka ngritur pretendime të natyrës kushtetuese për sa i përket zbatimit të garancive kushtetuese e procedurale penale, të cilat çojnë, sipas tij, në përkeqësimin e pozitës së tij, duke i cenuar lirinë. Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit, duke mos u shprehur dhe mos u dhënë përgjigje këtyre pretendimeve me natyrë kushtetuese. Përderisa në rekurs ishin ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë duhej të shprehej mbi to në respektim të rolit të saj kontrollues dhe parimit të subsidiaritetit (shih vendimin nr.12, datë 15.02.2017, paragrafët 11-21 të GJK-së). Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata në një rast të ngjashëm (*shih vendimin nr.27, datë 27.03.2017, paragrafët 11-21 të GJK-së*).

86. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi gjykatat i kanë mohuar atij të drejtën për të pasur një përgjigje përfundimtare për pretendimet e tij. Kjo e drejtë është cenuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit pa u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në të. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, kërkuesit gjatë procesit të zhvilluar në gjykatat e faktit i është dhënë mundësia që të paraqesë argumente dhe prova në mbështetje të pretendimeve të tij, për të cilat ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat. Po ashtu, edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs, i ka dhënë përgjigje kërkuesit lidhur me to, se nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Kërkuesi e ka ushtruar lirisht të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë nëpërmjet paraqitjes së rekursit, por kjo e drejtë nuk presupozon që gjykata duhet ta kalojë çështjen në seancë ose të pranojë kërkimet e palëve në çdo rast (*shih vendimin nr.21, datë 20.04.2017, paragrafët 13-17 të GJK-së*).

87. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk

e ka marrë në shqyrtim rekursin e paraqitur prej saj dhe e ka zhvilluar gjykimin në mungesë, duke cenuar të drejtën e njoftimit. Gjithashtu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke mos pasqyruar faktin e depozitimit të rekursit të kërkueses, ka cenuar parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjykata i ka vlerësuar këto pretendime të bazuara. Sipas saj, ndër të tjera, mospasqyrimi në vendim i rekursit të depozituar nga kërkuesja dhe shkaqeve të tij përbën një të metë në përmbajtjen e vendimit dhe arsyetimin e tij. Kolegji Penal i ka cenuar kërkueses të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në këndvështrim të së drejtës së aksesit dhe së drejtës për të pasur një vendim përfundimtar, pasi nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në rekurs (*shih vendimin nr. 40, datë 16.05.2017, paragrafët 7-16 të GJK-së*).

88. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e shkaqeve të ngritura në rekurs, pa dhënë argumentim ose arsyetim. Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur funksionin e saj si gjykatë ligji, por ka vepruar si gjykatë fakti. Ajo duhej ta kthente çështjen për rishqyrtim për plotësimin e të metave të vendimeve gjyqësore, pasi nuk mund ta zgjidhte vetë në themel atë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, kërkuesi e ka ushtruar lirisht të drejtën e aksesit nëpërmjet paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë, por kjo e drejtë nuk presupozon që gjykata duhet ta kalojë çështjen në seancë ose të pranojë kërkimet e palëve në çdo rast (*shih vendimin nr. 82, datë 21.12.2017, paragrafët 12-15 të GJK-së*).

89. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, si dhe në shtesën e rekursit të depozituar më pas, janë paraqitur pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor. Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim as pretendimet e rekursit, as ato të parashtruara në shtesën e rekursit, i cili është paraqitur në kohë dhe sipas rregullave procedurale. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, referuar përmbajtjes së rekursit dhe shtesës së rekursit, pretendimet e parashtruara në të dyja këto akte janë të ngjashme dhe nuk rezulton të ketë diferenca thelbësore në shkaqe ose argumente lidhur me parregullsinë e procesit përpara gjykatave më të ulëta. Në të dyja parashtrimet, pra në rekurs dhe në shtesën e rekursit, paraqitet si shkak kryesor argumenti se gjykatat shqiptare kanë llogaritur gabim vitet e burgimit që duhet të vuajë kërkuesi, si rrjedhojë e vendimeve të gjykatave italiane. Megjithëse shtesa e rekursit nuk është marrë në shqyrtim nga Kolegji Penal, kjo mangësi procedurale nuk rezulton të ketë qenë e tillë që të ketë ndikuar në thelbin e vendimmarrjes së atij Kolegji. Jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe do të ndikonte në rezultatin e vendimmarrjes (*shih vendimin nr.88, datë 28.12.2017, paragrafët 8-21 të GJK-së*).

90. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit, pasi Gjykata e Lartë, në kundërshtim me nenin 68/a të KP-së, edhe pse kanë qenë kushtet e zbatimit të gabuar

të ligjit, nuk e ka pranuar rekursin e paraqitur nga kërkuesi. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, kërkuesi në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ka ngritur pretendime të natyrës kushtetuese për sa i përket parashkrimit të ekzekutimit të vendimit, ku si pasojë e moskonstatimit të këtij fakti atij i është cenuar liria e tij. Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit, duke mos u shprehur dhe mos u dhënë përgjigje këtyre pretendimeve me natyrë kushtetuese. Përderisa në rekurs ishin ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë duhej të shprehej mbi to në respektim të rolit të saj kontrollues dhe parimit të subsidiaritetit (*shih vendimin nr. 84, datë 30.12.2016, paragrafët 14-27 të GJK-së*).

91. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi Kolegji Penal ka vendosur për mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë, duke mos respektuar normat e së drejtës ndërkombëtare për ekstradimin, duke i mohuar kërkuesit të drejtën për të pasur një proces të ri gjyqësor, i cili t'i garantojë mundësinë për t'u dëgjuar si rezultat i gjykimit në mungesë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, argumentet e parashtruara nga kërkuesi kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore, analiza e të cilave përbën kompetencë funksionale të Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji. Në këtë kuptim, kërkesa për rishikim e paraqitur nga kërkuesi është marrë në shqyrtim nga Kolegji Penal, i cili ka analizuar pretendimet e tij dhe është shprehur për thelbin e tyre, duke i dhënë çështjes një përgjigje përfundimtare. Për rrjedhojë, kërkuesi e ka realizuar të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë si nga pikëpamja formale, duke përdorur kërkesën për rishikim si mjetin procedural ankimues të përshtatshëm, ashtu edhe në aspektin substancial (*shih vendimin nr.19, datë 01.04.2016, paragrafët 7-13 të GJK-së*).

92. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje dhe nuk e ka marrë parasysh pretendimin për cenimin e prezumimit të pafajësisë të ngritur në rekurs, ai nuk është marrë parasysh dhe nuk i është dhënë përgjigje nga Gjykata e Lartë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs, i ka dhënë përgjigje kërkuesit lidhur me to, se nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Në kushtet kur nuk ka pretendime të natyrës kushtetuese, vetëm fakti i shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit nuk është i mjaftueshëm për të konkluduar se procesi gjyqësor nuk ka qenë i rregullt nga pikëpamja kushtetuese (*shih vendimin nr.8, datë 26.02.2015, paragrafët 16-22 të GJK-së*).

93. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, për arsye se Kolegji Penal i asaj Gjykate, pas kthimit të çështjes për rishqyrtim nga Gjykata Kushtetuese, ka vlerësuar në dhomë këshillimi plotësimin e kërkesave të nenit 432 të KPP-së, edhe pse vendimi i shfuqizuar i përkiste seancës gjyqësore. Ky qëndrim i Gjykatës së Lartë ka shkaktuar mosgjykimin e thelbit të pretendimeve të ngritura në rekurs dhe marrjen e një përgjigjeje përfundimtare lidhur me to. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në procesin gjyqësor të shfuqizuar

prej saj (shih vendimin nr. 505, datë 14.10.2009), edhe pse çështja penale në ngarkim të kërkueses ishte kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka bërë asnjë vlerësim lidhur me themelin e pretendimeve dhe nuk ka dhënë asnjë vlerësim lidhur me shkaqet e paraqitura në atë rekurs, për arsye të konstatimit të mungesës së nënshkrimit të mbrojtësit, çka ka çuar në vendimin e mospranimit të tij. Në këto kushte, për sa kohë që shqyrtimi gjyqësor nuk kishte nisur ende në atë gjykatë, edhe pse formalisht vendimi i shfuqizuar i përkiste seancës gjyqësore, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk kishte asnjë pengesë që, pas kthimit të çështjes nga Gjykata, t`ia nënshtronte vlerësimit të dhomës së këshillimit ekzistencën dhe bazueshmërinë e shkaqeve të paraqitura në rekurs. Po ashtu, Gjykata nuk konstaton cenim të së drejtës së aksesit në gjykatë, për sa kohë që pretendimet e paraqitura në rekurs janë marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit, dhe ajo i ka dhënë kërkueses përgjigje lidhur me to, në rastin konkret, se ato nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së (*shih vendimin nr. 52, datë 14.11.2014, paragrafët 10-16 të GJK-së*).

94. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit për shqyrtim për shkak se rekursi nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi. Mungesa e nënshkrimit të mbrojtësit nuk mund të sjellë detyrimisht mohimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje mbi shkaqet e ngritura në rekurs. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në vështrim të kufijve të zbatimit të nenit 435/2 të KPP-së, të cilët në mënyrë të vazhdueshme janë përkufizuar nga jurisprudenca kushtetuese si mjeti procedural për garantimin e aksesit në gjykatë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka interpretuar nenin 435/2 të KPP-së në mënyrë të ngushtë, jo harmonike dhe të shkëputur nga fryma e Kushtetutës dhe ajo e kuadrit ligjor procedural penal. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi, i ka cenuar atij të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë (shih vendimin nr.21, datë 29.04.2013, paragrafët 10-16 të GJK-së). Ky qëndrim është mbajtur nga Gjykata në disa raste të ngjashme të mëparshme *(shih vendimet nr.54, datë 13.12.2012, paragrafët 10-16; nr.53, datë 05.12.2012, paragrafët 8-13; nr.51, datë 7.11.2012, paragrafët 7-16; nr.22, datë 23.04.2012, paragrafët 5-18; nr.2, datë 25.01.2012, paragrafët 9-13; nr.51, datë 30.11.2011; nr.46, datë 04.11.2011; nr. 41, datë 28.09.2011; nr.39, datë 21.09.2011; nr. 10, datë 29.03.2011; nr.9, datë 29.03.2011; nr.8, datë 16.03.2011; nr.5, datë 02.03.2011; nr.38, datë 30.12.2010 të GJK-së)*. Në një rast tjetër, për të njëjtin pretendim, por me një argumentim të ndryshëm të vendimit të Gjykatës së Lartë për arsyet e mospranimit të rekursit, Gjykata ka vlerësuar se nuk ka cenim të së drejtës së aksesit. Sipas saj, ndër të tjera, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në pjesën arsyetuese të vendimit ka konstatuar faktin e mosnënshkrimit të rekursit nga ana e mbrojtësit në referim të nenit 435/2 të KPP-së dhe, gjithashtu, ka bërë vlerësim për ekzistencën e shkaqeve të parashtruara në rekurs, duke arritur në përfundimin se shkaqet e pretenduara nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Mbështetur në arsyetimin e mësipërm dhe, bazuar në nenin 433 të po këtij kodi, që parashikon se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur

mospranimin e tij. Kolegji Penal nuk i ka cenuar, në thelb, kërkuesit të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë, për arsye se ky Kolegj ka verifikuar nëse ishin shkaqet e kërkuara nga neni 432 i KPP-së *(shih vendimin nr. 8, datë 28.02.2012, paragrafët 23-28 të GJK-së).* I njëjti qëndrim është mbajtur edhe në një rast të mëparshëm (*shih vendimin nr.37, datë 19.09.2011, paragrafët 22-25 të GJK-së*).

95. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë dhe së drejtës së aksesit në gjykatë për shkak të mospranimit të ankimit ndaj vendimit të ndërmjetëm të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, në një gjykatë më të lartë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke arsyetuar se "vendimi i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, në pjesën që bën fjalë për aplikimin e nenit 406/1 të KPP-së, është marrë në kundërshtim me KPP-në" dhe duke vijuar se "pranimi i gjykimit të shkurtuar është atribut i gjykatës së shkallës së parë dhe jo i gjykatës së apelit", ka cenuar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar. Shkelja që i atribuohet Gjykatës së Lartë është kufizimi që ajo i ka bërë ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, duke e bërë këtë vendim të pakontrollueshëm. Shqyrtimi i mjetit procedural ankimues në mënyrë josubstanciale cenon standardin kushtetues të aksesit në gjykatë, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës (*shih vendimin nr. 14, datë 26.03.2012, paragrafët 8-24 të GJK-së*).

96. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatë, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit për mungesë të shkaqeve, ndërkohë që kërkuesi dhe mbrojtësi i tij nuk kanë pasur mundësinë të paraqesin një rekurs të "plotë" për shkak se vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda nuk është shpallur i arsyetuar në seancë gjyqësore si dhe për shkak të vonesës së zbardhjes së vendimit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, nga materialet e dosjes gjyqësore nuk rezulton asnjë shkresë ose dokument tjetër që kërkuesi të jetë njoftuar nga administrata gjyqësore për mungesat në paraqitjen e rekursit, të cilat, në fund të fundit, nuk vareshin prej tij, por prej administratës gjyqësore. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, përpara se të vendosë mospranimin e rekursit, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor për vënien në dijeni të të pandehurit, për të plotësuar rekursin. I dilte si detyrë Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë të verifikonte se përse nuk ishin paraqitur shkaqet nga ana e kërkuesit, sidomos kur provohet shkresërisht se ai kishte paraqitur rekurs për zënien e afatit. Nëse arsyet për mosparaqitjen e shkaqeve të rekursit kishin të bënin me veprimet ose mosveprimet e administratës gjyqësore, atëherë Kolegji duhet të njoftonte kërkuesin, duke i lënë kohën e nevojshme për të plotësuar dokumentacionin. Nëse kërkuesi nuk i kishte paraqitur shkaqet për faj të tij, atëherë Kolegji Seleksionues ishte në kushtet për të mos pranuar rekursin për shqyrtim. Veprimet ose mosveprimet e parregullta të administratës gjyqësore nuk duhet t'i ngarkohen individit, i cili nuk mund të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së saj (administratës). Për më tepër, duke qenë se edhe vetë vendimi i gjykatës së apelit, siç u argumentua më lart, nuk ka përmbushur kriteret që lidhen me standardin e

arsyetimit të vendimeve gjyqësore, kërkuesi ishte në pamundësi të paraqiste shkaqet e plota të ankimit ndaj këtij vendimi (*shih vendimin nr.16, datë 27.03.2012, paragrafët 9-14 të GJK-së*).

97. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë për arsye se, ndonëse rekursi ka qenë i përpiluar në pajtim me kërkesat ligjore dhe në të janë paraqitur pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka pranuar rekursin. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në pjesën arsyetuese të vendimit ka bërë vlerësim mbi ekzistencën e shkaqeve të parashtruara në rekurs, duke arritur në përfundimin se shkaqet e pretenduara nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Mbështetur në këtë vlerësim dhe, bazuar në nenin 433 të po këtij kodi, që parashikon se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij. Për rrjedhojë, Kolegji Penal nuk i ka cenuar, në thelb, kërkuesit të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012, paragrafët 32-35 të GJK-së*).

98. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë për arsye se Kolegji Penal ka vendosur pushimin e çështjes për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9678, datë 13.01.2007 "Për dhënie amnistie", me argumentin se ndodhet para rasteve të parashikuara nga neni 387/1 i KPP-së. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka vlerësuar kërkesën paraprake të të gjykuarit për shtyrjen e seancës gjyqësore për shkak të mungesës së avokatit të tij. Ai nuk është shprehur mbi shkaqet e parashtruara në rekurs nga kërkuesi (rekursuesi), të cilat kanë të bëjnë me pretendimin e tij për pafajësi (nenet 432 dhe 434 të KPP-së) dhe nuk është shprehur për bazueshmërinë në ligj apo jo të vendimit të gjykatës së apelit, i cili ka qenë objekt i kundërshtimit të rekursit (nenet 441 dhe 442 të KPP-së). Gjykata e ka vlerësuar pretendimin të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, amnistia e veprës penale gjen zbatim në të gjitha fazat procedurale të procesit penal, me pasojë pushimin e çështjes për ato vepra penale për të cilat ndjekja penale nuk duhet të fillojë ose të vazhdojë. Kështu, në rastet kur gjykata e shkallës së parë zbaton amnistinë e veprës penale, ajo ka detyrimin të deklarojë pushimin e çështjes. Nëse amnistia e veprës penale zbatohet në procesin gjyqësor në gjykatën e apelit apo në Gjykatën e Lartë, këto të fundit duhet të prishin vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta dhe të pushojnë çështjen penale. Nga ana tjetër, amnistia e dënimit gjen zbatim vetëm pasi vendimi penal bëhet i ekzekutueshëm sipas rregullave të parashikuara në nenet 417, 420/c dhe 462 të KPP-së, duke e përjashtuar të gjykuarin, sipas rastit, nga vuajtja tërësisht ose pjesërisht e dënimit ose zëvendëson dënimin me një lloj dënimi më të butë. Kolegji Penal ka zbatuar gabim nenin 387/1 të KPP-së, pasi kjo normë zbatohet në rastin e amnistisë së veprës penale dhe jo në atë të amnistisë së dënimit, me të cilën kanë të bëjnë faktet e pranuara në vendim. Edhe në rast se Kolegji Penal do të pranonte fakte që kishin të bënin me amnistinë e veprës penale dhe për rrjedhim do të zbatohej neni 387/1 i KPP-së, atëherë, në zbatim të neneve 441, shkronja "c", 442, pikat 1, shkronja "a" dhe 2, të KPP-së, Kolegji duhej të vendoste prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe pushimin e çështjes. Zbatimi

i normës jo në kontekstin e fakteve të pranuara ka kufizuar të drejtën e kërkuesit për gjykim, pasi, në këtë rast, dhënia e vendimit të pushimit të çështjes nuk është në përputhje me detyrimin që ka Kolegji Penal për të dhënë një përgjigje përfundimtare lidhur me pretendimet e ngritura në rekurs. Kolegji Penal duhej të respektonte të gjitha standardet e procesit të rregullt në gjykimin e çështjes, pasi amnistia e dënimit nuk kufizon të drejtën e të gjykuarit për t'u gjykuar në përputhje me rregullat që parashikon KPP-ja për gjykimin në Gjykatën e Lartë. Pushimi i çështjes në Kolegjin Penal, pa u shprehur mbi vendimin e gjykatës së apelit, nuk ka sjellë asnjë pasojë mbi këtë vendim, për rrjedhojë kërkuesi (i gjykuari) quhet ende i dënuar dhe i vetmi efekt i ardhur është përjashtimi nga vuajtja e dënimit (*shih vendimin nr. 16, datë 19.04.2010, paragrafët 1-9 të GJK-së*).

C- ADMINISTRATIVE

a) Për gjykatat e faktit

99. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi në kushtet kur Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konflikteve të Interesit (*ILDKPKI*), në mënyrë të paligjshme, i ka kthyer deklaratën pa veprim, duke i mohuar aksesin në procedurat administrative, duhej të ishte Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (*KED*) që të riparonte këto të meta dhe të pranonte dokumentacionin e vënë në dispozicion nga kërkuesja. Sipas saj, është mohuar e drejta e aksesit në procedurat administrative, si dhe e drejta për të rivendosur gjyqësisht pasojën e ardhur nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, gjatë procesit administrativ të zhvilluar nga KED-ja, kërkuesja e ka realizuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur nëpërmjet komunikimit të akteve, përfshirë ato të ILDKPKI-së. Asaj i është dhënë mundësia të paraqesë shpjegime dhe pretendime me shkrim për shkaqet e mosparaqitjes së deklaratës së pasurisë dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj dhe në përfundim të procedurës administrative, KED-ja ka parashtruar në vendimet për ndalimin e kandidimit të kërkueses jo vetëm procedurën e ndjekur, por edhe bazën ligjore mbi të cilën ka bazuar vendimmarrjen e saj, analizën ligjore, duke u dhënë përgjigje edhe pretendimeve të kërkueses në lidhje me aktet e zbatueshme në rastin konkret, si edhe në lidhje me mospranimin nga ana e ILDKPKI-së të dokumentacionit mbështetës të paraqitur personalisht prej saj. Gjykata Administrative e Apelit, në përputhje me juridiksionin e saj të kufizuar për shqyrtimin e këtyre çështjeve, ka marrë në konsideratë pretendimet e kërkueses që kanë të bëjnë me procedurën e zhvilluar nga KED-ja dhe u ka dhënë atyre përgjigje përfundimtare. Ajo ka shqyrtuar edhe bazën ligjore të zbatueshme në rastin konkret, nga e cila buron detyrimi i subjekteve për të paraqitur dokumentacionin përkatës, rastet përjashtimore në të cilat subjektet nuk kanë detyrimin për t`iu nënshtruar kontrollit të pasurisë, si edhe pretendimin në lidhje me mospranimin e dokumentacionit mbështetës nga ana e ILDKPKI-së (*shih vendimin nr. 23 datë 10.10.2022, paragrafët 40-52 të GJK-së*).

100. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueses dhe vendimi është dhënë në shkelje dhe zbatim të gabuar të dispozitave të ligjit material. Arsyetimi se paditësja nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj padie është në kundërshtim me dispozitat ligjore. Aksesi në gjykatën e apelit ka qenë formal dhe ajo nuk ka marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e saj. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, edhe pse gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga kërkuesja, gjykata e apelit, e vënë në lëvizje mbi bazën e ankimit të palëve të paditura në procesin gjyqësor, ka vendosur ndryshimin e atij vendimi pas një procesi gjyqësor, ku ka administruar dhe dëgjuar palët ndërgyqëse, si dhe duke iu referuar normave ligjore që lidhen me të provuarit e interesit të ligjshëm për të ngritur padinë. Kërkuesja, lirisht, ka ushtruar të drejtën e ngritjes së padisë dhe përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes, me vendim përfundimtar ka marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e saj, përfshirë edhe atë të legjitimimit aktiv (*shih vendimin nr.22, datë 29.04.2021, paragrafët 21-27 të GJK-së*).

101. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi Gjykata Administrative e Apelit në vendim ka arsyetuar se ankimi ishte paraqitur nga përfaqësuesja ligjore pa e pasur këtë tagër. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, kërkuesja ka marrë njoftim për procesin gjyqësor që do të zhvillohej në Gjykatën Administrative të Apelit me fletëthirrjen e datës 08.01.2014, e cila është nënshkruar nga administratorja e shoqërisë pa rezerva. Për më tepër, në përmbajtjen e njoftimit, kërkuesja vihet në dijeni për të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve me shkrim lidhur me shkaqet e ankimit dhe kundër ankim deri në 5 ditë përpara datës së seancës. Nga aktet e dosjes gjyqësore nuk rezulton të jetë paraqitur ankim apo parashtrime shtesë nga kërkuesja, e drejtë e cila është ushtruar nga pala tjetër e paditur në proces (*shih vendimin nr. 3, datë 20.01.2017, paragrafët 6-13 të GJK-së).*

102. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, së drejtës së ankimit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi nuk u është dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit që lidhen me shkelje të ligjit dhe të të drejtave kushtetuese. Konkretisht, nuk u është dhënë përgjigje pretendimeve lidhur me proporcionalitetin e masës disiplinore. Arsyetimet e vendimeve të të dyja gjykatave të faktit nuk mbështeten nga provat e administruara në gjykim dhe urdhri është nxjerrë pa asnjë motiv ligjor. Raporti ku mbështetet urdhri është i sajuar dhe shkelja e pretenduar nuk mund të konsiderohet si shkelje e rëndë. Kërkuesit nuk i është komunikuar zyrtarisht masa disiplinore. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit, sepse vendimi i mospranimit të rekursit nuk përmbush as kërkesat për një arsyetim minimal. Gjykata i ka vlerësuar këto pretendime të pabazuara. Sipas saj, ndër të tjera, vendimi i gjykatës së apelit jo vetëm përmban pjesën hyrëse, pretendimet e parashtruara nga palët, por edhe arsyetimin e gjykatës, me anë të të cilit ajo u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, duke argumentuar se ndodhemi para shkeljes së rregullave të shërbimit dhe masa disiplinore është marrë në respektim të procedurës së parashikuar nga ligji për Policinë e Burgjeve. Vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të

jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër (*shih vendimin nr.26, datë 27.03.2017, paragrafët 12-18 të GJK-së*).

103. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë me argumentin se VKM-ja nr. 1037/2015 cenon të drejtën për ankim efektiv të garantuar nga neni 43 i Kushtetutës, duke argumentuar se normat nënligjore nuk parashikojnë ndonjë mjet ankimi në dispozicion të nëpunësve civilë për të kundërshtuar aktin e Komisionit të Vlerësimit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, përderisa në rastin konkret, të drejtën e ankimit gjyqësor e parashikon ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar ky rregullim ligjor është i mjaftueshëm për nëpunësit civilë për të realizuar të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj akteve administrative që nxjerr Komisioni i Vlerësimit, pavarësisht se VKM-ja objekt shqyrtimi nuk shprehet për të (*shih vendimin nr. 70, datë 24.11.2016, paragrafët 5-8 të GJK-së).*

104. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi gjykata administrative e shkallës së parë e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, duke mos dhënë zgjidhje përfundimtare për çështjen objekt konflikti. Ajo, gjithashtu, nuk ka përcaktuar në vendimin e saj se cila ishte gjykata ose organi kompetent që duhej të zgjidhte konfliktin. Kjo shkelje nuk u riparua as nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili la në fuqi vendimin e ankimuar, duke mohuar përfundimisht aksesin në gjykatë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, gjykata administrative e shkallës së parë nuk e ka marrë fare në shqyrtim pretendimin e kërkueses lidhur me faktin nëse ligji e kufizonte ose jo në mënyrë antikushtetuese të drejtën e aksesit të saj në gjykatë. Kjo gjë vërtetohet nga arsyetimi i vendimit të asaj gjykate, ku nuk pasqyrohet asnjë argument lidhur me këtë pretendim të kërkueses. Ky qëndrim bie ndesh edhe me parimin e disponibilitetit, sipas të cilit gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkimet e paditësit. Gjykata administrative e shkallës së parë duhej t'i kishte bërë të gjitha përpjekjet për t'i dhënë përgjigje kërkueses nëse pretendimet e saj ishin ose jo të bazuara. Vetëm pas dhënies së një përgjigjeje të argumentuar për pretendimet e kërkueses, mund të thuhet se gjykata ka respektuar të drejtën e aksesit në gjykatë të kërkueses. Pavarësisht përfundimit në të cilin do të kishte arritur gjykata, sipas bindjes së saj, e drejta e kërkueses për t'iu drejtuar gjykatës do të konsiderohej e realizuar efektivisht dhe do të kishte çuar në shmangien e situatës aktuale në të cilën ndodhet ajo, e cila nuk ka një vendim përfundimtar për zgjidhjen e konfliktit. Të njëjtën shkelje ka bërë edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë. Kolegji ka arsyetuar se është në vlerësimin e gjykatës ta referojë ose jo çështjen për gjykim në Gjykatë. Natyrisht, është e drejtë e gjykatës, që kryesisht ose me kërkesë të palëve, të vlerësojë kushtetutshmërinë e ligjit të zbatueshëm prej saj, por vetëm pasi ajo të ketë kryer një hetim të plotë të pretendimeve dhe të fakteve të çështjes konkrete dhe, në fund të hetimit gjyqësor, bazuar mbi argumente juridike, të vendosë për dërgimin ose jo të çështjes për shqyrtim në Gjykatë, bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 23, datë 20.04.2016, paragrafët 16-24 të GJK-së*).

105. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi kërkesëpadia është paraqitur brenda afateve ligjore dhe se gjatë hetimit gjyqësor asnjë nga palët nuk arriti të provojë datën e marrjes dijeni prej saj të vendimit të organit administrativ të kundërshtuar. Konflikti gjyqësor i nisur prej kërkueses është një konflikt civil, ndaj kërkesa për zgjidhjen e tij nuk ka afat. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim haptazi të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, objekt i gjykimit të nisur nga kërkuesja është kundërshtimi i një akti administrativ, vendimi nr. 128, datë 31.05.2006 i Komisionit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*KSHKKP*), që ka rrëzuar kërkesën e saj për kthimin si truall të lirë edhe të një sipërfaqeje prej 400m^2, brenda asaj të njohur për kompensim. Duke qenë se kjo padi ka të bëjë me kundërshtimin e një akti administrativ, gjykatat i janë referuar afateve ligjore për kundërshtimin e këtyre lloj aktesh. Lidhur me momentin e marrjes dijeni për aktin, nga ku fillon të rrjedhë edhe afati për ankimin e tij, kërkuesja, edhe pse ka barrën e provës për të provuar pretendimet e saj, nuk ka paraqitur asnjë provë, me anë të së cilës të provojë momentin e marrjes dijeni efektivisht, prej saj, të aktit të kundërshtuar, me qëllim që të argumentojë se ka respektuar afatin ligjor 30-ditor për t`iu drejtuar gjykatës, çka do të sillte, për pasojë, edhe cenimin e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara (*shih vendimin nr. 29, datë 15.05.2014, paragrafët 11-16 të GJK-së*).

106. Përpara Gjykatës, në rrugën e kontrollit kushtetues incidental, është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë nga neni 109/3 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" *(ligji nr.9920/2008)*, që parashikon: "Administrata tatimore, e cila ka nxjerrë vendimin administrativ, objekt ankimi, mund ta apelojë vendimin e drejtorisë së apelimit tatimor brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja dijeni". E drejta e ankimit, në rrugë gjyqësore, të akteve administrative është tagër absolut i individit të cenuar nga një akt i paligjshëm dhe i padrejtë i administratës publike, por parashikimi ligjor i nenit 109/3 e suprimon tërësisht të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, pasi kjo e drejtë transferohet, për një afat të pacaktuar, nga pala private tek organi shtetëror që ka nxjerrë aktin. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, nëse ligjvënësi do të kishte pasur qëllim vendosjen e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve (*DRT*) në varësi hierarkike të Drejtorisë së Apelimit Tatimor (*DAT*) do të kishte parashikuar elementet kryesore që e drejta administrative ka evidentuar për varësinë hierarkike administrative, siç është elementi i llogaridhënies, pra detyrimin e DRT-së të japë informacion dhe të shpjegojë qëndrimin e saj në veprimtarinë e kontrollit. Edhe për sa i përket raportit midis Drejtorisë së Apelimit dhe ministrit të Financave, ky i fundit edhe pse ka kompetencë të emërojë drejtorin e DAT-it, nuk ka forcë vendimmarrëse për të shfuqizuar vendimet e DAT-it. Në mungesë të këtyre karakteristikave, Gjykata vlerëson se pajisja e DAT-it nga ligji, midis të tjerash, edhe me kompetencën e shfuqizimit/revokimit të akteve të DRT-së, nuk është shprehje e varësisë hierarkike midis këtyre organeve, por përfaqëson mekanizmin kontrollues të ushtrimit të veprimtarisë kontrolluese të DRT-së në pajtueshmëri me ligjin (*shih vendimin nr. 39, datë 30.06.2014, paragrafët 12-22 të GJK-së*).

b) Për Gjykatën e Lartë

107. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit, pasi gjykata e apelit e ka pushuar çështjen, duke mos e zgjidhur atë në themel, si dhe Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje kërkesës kryesore të kërkuesve që lidhej me afatin për të ngritur padinë, për të cilën është pushuar çështja nga gjykata e apelit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurs, edhe pse ato kishin të bënin me interpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit material. Ai kolegj nuk ka arsyetuar në lidhje me të drejtën e kërkuesve për t`u njoftuar drejtpërdrejt për vlerën e shpronësimit. Gjykata e ka vlerësuar pretendimin të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit kanë interpretuar dhe zbatuar në mënyra diametralisht të kundërta dispozitat ligjore të nenit 24 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" (ligji nr. 8561/1999). Kërkuesit në rekurs kanë ngritur pretendime me natyrë kushtetuese lidhur me gjykimin në Gjykatën Administrative të Apelit dhe mënyrën e interpretimit të ligjit nr. 8561/1999 prej saj. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka konsideruar këto pretendime të subjektit të shpronësuar si çështje të vlerësimit të provave, edhe pse ato, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit që parashikon mënyrën e njoftimit të individëve për aktin e pushtetit publik për shpronësim (njoftim individual ose nëpërmjet publikimit), prej të cilit varet edhe momenti i fillimit të afatit të ankimit në gjykatë. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, duhej të mbante një qëndrim në lidhje me këtë interpretim të bërë nga gjykatat më të ulëta dhe të ushtronte funksionin e saj subsidiar, duke i dhënë përgjigje të arsyetuar subjektit të shpronësuar për pretendimin e tij. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se arsyetimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i pamjaftueshëm dhe nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, duke pasur parasysh edhe faktin se Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e gjykimit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, ka sjellë si pasojë edhe cenimin e së drejtës së aksesit të kërkuesve (*shih vendimin nr. 29, datë 01.11.2022, paragrafët 17-34 të GJK-së*).

108. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi nuk e ka gjykuar çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Duke zhvilluar gjykimin në dhomë këshillimi, nuk i ka krijuar mundësi kërkuesit të parashtrojë pretendimet e tij, duke i mohuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtur. Gjykata e Lartë e ka kryer njoftimin vetëm me shpallje për kërkuesin, por kjo nuk nënkupton përmbushjen e detyrimit të sekretarisë së Gjykatës së Lartë për njoftimin e rregullt të palëve, në mënyrë që ato të mund të marrin pjesë në gjykim, si dhe të dëgjohen e të mbrohen me anë të paraqitjes së prapësimeve, pasi ajo ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, duke mbajtur në konsideratë që Gjykata e Lartë sipas Kushtetutës vepron si gjykatë ligji (pra, nuk merret me shqyrtim provash, dëgjim dëshmitarësh dhe

përcaktim faktesh), gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë nuk rezulton të jenë cenuar rregullat procedurale për njoftimin e zhvillimit të seancës gjyqësore, si dhe duke pasur parasysh gjykimin e zhvilluar në dhomën e këshillimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, kërkuesit i është krijuar mundësia për të paraqitur argumentet e tij me shkrim. Gjithashtu, edhe në tërësi procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë në një shkallë gjykimi (në gjykatën e apelit) është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës kërkuesi ka qenë i përfaqësuar me avokat, duke i krijuar mundësinë për t'u dëgjuar dhe mbrojtur (*shih vendimin nr. 29, date 01.11.2022, paragrafët 24-31 të GJK-së*).

109. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi gjykata e apelit e ka pushuar çështjen duke mos e zgjidhur atë në themel, si dhe Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje kërkesës kryesore të kërkuesve që lidhej me afatin për të ngritur padinë, për të cilën është pushuar çështja nga gjykata e apelit; Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurs, edhe pse ato kishin të bënin me interpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit material. Ai kolegj nuk ka arsyetuar në lidhje me të drejtën e kërkuesve për t`u njoftuar drejtpërdrejt për vlerën e shpronësimit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, kërkuesi në rekurs ka ngritur pretendime me natyrë kushtetuese lidhur me gjykimin në Gjykatën Administrative të Apelit dhe mënyrën e interpretimit të ligjit nr. 8561/1999 prej saj. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka konsideruar këto pretendime të subjektit të shpronësuar si çështje të vlerësimit të provave, edhe pse ato, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit që parashikon mënyrën e njoftimit të individëve për aktin e pushtetit publik për shpronësim (njoftim individual ose nëpërmjet publikimit), prej të cilit varet edhe momenti i fillimit të afatit të ankimit në gjykatë. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, duhej të mbante një qëndrim në lidhje me këtë interpretim të bërë nga gjykatat më të ulëta dhe të ushtronte funksionin e saj subsidiar, duke i dhënë përgjigje të arsyetuar subjektit të shpronësuar për pretendimin e tij. Arsyetimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i pamjaftueshëm dhe nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, duke pasur parasysh edhe faktin se Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e gjykimit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, ka sjellë si pasojë edhe cenimin e së drejtës së aksesit të kërkuesve (*shih vendimin nr. 29, datë 01.11.2022, paragrafët 22-35 të GJK-së*).

110. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi ajo ka vendosur rrëzimin e padisë, nëpërmjet së cilës kërkuesi ka kundërshtuar masën e shpërblimit për shpronësimin për interes publik, pa shqyrtuar themelin e saj, duke verifikuar dhe vlerësuar të parashkruar të drejtën e padisë së tij për shkak të paraqitjes së saj jashtë afatit. Gjykata e Lartë ka disponuar në kundërshtim me nenet 58 dhe 63, shkronjat "a" dhe "dh", të ligjit nr. 49/2012, pasi nuk e ka gjykuar çështjen mbi bazën e shkaqeve të rekursit, të cilat lidheshin vetëm me përcaktimin e vlerës së pasurisë. Gjykata

e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në përputhje me parimin themelor të sigurisë juridike, e drejta e aksesit në gjykatë e individit të shpronësuar është e kufizuar nga afati ligjor brenda të cilit duhet të paraqitet padia. Ligji nr. 8561/1999 nuk ka përcaktuar shprehimisht njoftimin e të shpronësuarit përmes botimit zyrtar, edhe pse parashikon se vendimi i Këshillit të Ministrave hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare (neni 21, pika 5). Ky parashikim duket se është në linjë me rregullin e përgjithshëm për botimin e akteve individuale të këtij organi sipas ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" (neni 29, pika 3). Ky rregull i shërben transparencës së veprimtarisë shtetërore dhe së drejtës kushtetuese të qytetarëve për informim në kushtet kur sipas nenit 100, pikat 1 dhe 3, të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe i zhvillon mbledhjet e tij të mbyllura. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata çmon se për sa i përket llogaritjes së afatit të paraqitjes së padisë në gjykatë për shpërblimin nga shpronësimi, Gjykata e Lartë në arsyetimin e saj ka vënë theksin në njoftimin e aktit të shpronësimit nëpërmjet botimit të tij në Fletoren Zyrtare, duke zbehur vlerën juridike dhe pasojat që shkakton njoftimi i drejtpërdrejtë individual i tij tek i shpronësuari. Sipas nenit 473/a, paragrafi 2, të KPC-së, në rastet kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtresave të tyre për çështjet e ligjit. Në këto raste, sipas nenit 482/a, pika 1, shkronja "b", të po këtij kodi, parashikohet se Gjykata e Lartë, nëse e vlerëson të nevojshme për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë, duke qenë se e ka shqyrtuar çështjen në lidhje me një shkak që nuk është ngritur në rekurs, për të cilin gjykatat më të ulëta nuk janë shprehur, dhe që ka të bëjë me një kuptim të ri të interpretimit të ligjit nr. 8561/1999, për mënyrën e njoftimit të procedurës së shpronësimit, për të garantuar aksesin e individit në gjykatë, duhej të dëgjonte paraprakisht, qoftë edhe me shkrim, palët ndërgjyqëse në proces (*shih vendimin nr. 40, datë 22.12.2022, paragrafët 21-24 të GJK-së*).

111. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe, më pas, Gjykata e Lartë nuk kanë pranuar t'i shqyrtojnë në themel pretendimet për anulimin e vendimit të DAT-së nr. 15201/2 prot., datë 09.09.2013 dhe shkresës së DRTTM-së nr. 9801 prot., datë 03.07.2013 "Lajmërim për kryerjen e rikontrollit", duke i cilësuar si akte administrative të paankimueshme. Këto pretendime janë të ndërvarura me pretendimin për shpalljen absolutisht të pavlefshëm të "Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore" nr. 9801/12 prot., datë 23.09.2013, dhe, si të tilla, gjykatat nuk duhet t'i shmangeshin vlerësimit të tyre. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, kërkuesja ka pasur akses në gjykatë, duke marrë pjesë në gjykim dhe duke parashtruar pretendimet e saj nëpërmjet përfaqësueses ligjore. Gjatë procesit gjyqësor, kërkuesja i ka kundërshtuar në gjykatë aktet për të cilat pretendohet cenimi i së drejtës së aksesit, në vijim të të cilave është hartuar edhe njoftimi i vlerësimit. Edhe Gjykata e Lartë i ka marrë në shqyrtim këto akte, duke i konsideruar me natyrë njoftuese, duke vijuar me shqyrtimin e njoftimit të

vlerësimit për detyrimet tatimore, i cili është dhe akti që ka prodhuar pasoja për kërkuesen (*shih vendimin nr. 11, datë 21.04.2022, paragrafët 6-11 të GJK-së).*

112. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën e ankimit, sepse vendimi i mospranimit të rekursit nuk përmbush kërkesat as për një arsyetim minimal. Duke mos u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkueses që lidhen me shkeljen e ligjit dhe të të drejtave kushtetuese, vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën e ankimit në kuptimin substancial. Gjykata e ka vlerësuar pretendimin të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs dhe i ka dhënë përgjigje kërkueses se pretendimet e saj nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Gjykata e Lartë, në dhomë këshillimi, ka ushtruar në këtë rast funksionin e saj seleksionues, duke vlerësuar paraprakisht nëse kërkesa i plotësonte kërkesat e ligjit për kalimin në seancë. Edhe pse me një arsyetim të kufizuar, ajo ka parashtruar shkaqet e rekursit dhe i ka vlerësuar ato në përputhje me standardet e arsyetimit në dhomën e këshillimit (*shih vendimin nr.16, date 16.03.2021, paragrafët 33-41 të GJK-së*).

113. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit dhe aksesit në gjykatë nga Gjykata e Lartë, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të kësaj gjykate nuk ka pasqyruar shkaqet e pretenduara dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të paraqitura në rekurs, të cilat kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve të ngritura në rekurs, që lidhen me mosrespektimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe mosmarrjen parasysh të jurisprudencës së Gjykatës , Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhej të kishte vlerësuar bazueshmërinë e tyre dhe të jepte në përfundim një vendim të arsyetuar në lidhje me këto pretendime, për sa i përket "gjykatës së caktuar me ligj" dhe "arsyetimit të vendimit gjyqësor". Vetëm në këtë mënyrë, do të garantohej e drejta e kërkuesit për akses efektiv në gjykatë dhe, lidhur me të, standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor sipas standardeve të vendosura tashmë nga jurisprudenca kushtetuese (*shih vendimin nr.11, datë 16.04.2018, paragrafët 29-31 të GJK-së*).

114. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka bërë një vlerësim të drejtë dhe objektiv të nenit 62/c të ligjit nr.49/2012, në kushtet kur vendimet e gjykatave më të ulëta kanë dhënë zgjidhje ligjore të ndryshme. Ky Kolegj ka përdorur një arsyetim ndryshe edhe nga vetë rrethanat e çështjes të parashtruara në vendimin e tij, nga ku rezulton se kërkuesi e ka fituar pronën në mënyrë të ligjshme, me anë të kontratës së shitblerjes. Ai ka mbajtur qëndrim të kundërt me atë të mbajtur nga Kolegji Civil në një çështje tjetër që i referohet të njëjtit objekt (godinë), ku është pranuar padia me objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor për prishjen e tre kateve të tjera të ndërtuara sipër pronës së kërkuesit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, të

cilat janë brenda juridiksionit të Gjykatës së Lartë, si edhe bazuar jo vetëm në faktin se gjykatat më të ulëta i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme mosmarrëveshjes civile në fjalë, por edhe se gjykimi në gjykatën e apelit është bërë në mungesë të palëve ndërgjyqëse, Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhej t`u jepte përgjigje këtyre pretendimeve. Duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pa u dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të ngritura prej tij, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës (*shih vendimin nr.30, date 30.03.2017, paragrafët 10-18 të GJK-së*).

115. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka njoftuar palën paditëse (kërkuesen) për gjykimin e datës 22.10.2014. Është shkelur parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve, pasi Gjykata e Lartë e shqyrtoi çështjen në mungesë të palëve, pa i njoftuar për datën dhe orën e gjykimit. Gjykata ka vlerësuar se është cenuar e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë. Sipas saj, ndër të tjera, në asnjë pjesë të vendimit të Kolegjit Administrativ nuk përmendet fakti i ushtrimit të rekursit nga kërkuesja. Duke u bazuar në përmbajtjen e vendimit të Kolegjit Administrativ, Gjykata konstaton se pretendimet e kërkueses të paraqitura në rekurs nuk janë marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë. Vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke mos shqyrtuar rekursin e kërkueses në themel dhe në tërësi, ka ndikuar në cenimin e së drejtës së aksesit substancial të saj (*shih vendimin nr. 48, datë 3.07.2017, paragrafët10-16 të GJK-së*).

116. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të gjykatës së caktuar me ligj dhe të aksesit në gjykatë, pasi Gjykata e Apelit Gjirokastër, duke interpretuar gabim ligjin material që i njeh të drejtën atij për kompensim për burgim të padrejtë, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit. Edhe pse ky pretendim është ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, Kolegji Administrativ i saj ka vendosur mospranimin e tij pa u dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në të, duke cenuar krahas standardit të arsyetimit edhe parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe të drejtën e kërkuesit për akses në gjykim. Gjykata ka konkluduar se është cenuar e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë. Sipas saj, ndër të tjera, qëndrimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor, për sa kohë ngre dyshime serioze për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, së drejtës së aksesit në gjykatë dhe së drejtës për ankim substancial (*shih vendimin nr.28, datë 30.03.2017, paragrafët 8-15 të GJK-së*).

117. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi Gjykata e Lartë, duke nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, i ka mohuar kërkueses gjykimin në themel të pretendimeve të saj. Në të kundërt me arsyetimin e gjykatës së faktit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kamatëvonesa e detyrimit kryesor duhet të parapaguhet në shumën e përllogaritur nga organet tatimore, pavarësisht nëse llogaritja është e drejtë apo e gabuar.

Neni 9 i ligjit nr.49/2012 i ka dhënë të drejtë Gjykatës së Lartë që të vendosë për prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit kur ato vendosin nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, por nuk i kanë dhënë të drejtë për të kundërtën, pra për të prishur vendimet e gjykatave të faktit kur e kanë vlerësuar çështjen brenda juridiksionit. Në zbatim të kësaj dispozite, Gjykata e Lartë nuk duhej të pranonte gjykimin e ankimit të veçantë, por të urdhëronte gjykatën administrative të vazhdonte gjykimin e themelit të çështjes. Lidhur me pretendimin se Gjykata e Lartë ka cenuar standardin e aksesit në gjykatë kur ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, edhe për kërkimin që ka si shkak të padisë pavlefshmërinë absolute të akteve administrative, Gjykata ka çmuar se ky pretendim është i bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në rastin konkret, Gjykata e Lartë, referuar objektit dhe shkakut të padisë, si dhe pretendimeve të kërkuesit, ishte e detyruar të merrte në shqyrtim e të verifikonte nëse akti administrativ ishte ose jo absolutisht i pavlefshëm dhe nuk mund të refuzonte shqyrtimin e çështjes me arsyetimin se çështja nuk ishte shqyrtuar në themel nga organi administrativ dhe se pala paditëse nuk kishte respektuar kërkesat e ligjit nr. 9920/2008 (*shih vendimin nr. 56, datë 25.07.2017, paragrafët18-20 të GJK-së).*

118. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit efektiv në gjykatë, pasi Gjykata e Lartë, në mënyrë të pajustifikuar, ka ngushtuar juridiksionin e vet për të kontrolluar nëse të dyja gjykatat e apelit kishin shpallur, në përputhje me ligjin, juridiksionet e tyre ratione materiae. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, kërkuesi ka paraqitur rekurs, brenda afatit ligjor, në të cilin ka parashtruar pretendimet e veta për prishjen e vendimeve gjyqësore të themelit. Këto pretendime janë vlerësuar nga Gjykata e Lartë në këndvështrim të pranisë ose jo të shkaqeve ligjore, bazuar në nenin 58 të ligjit nr.49/2012. Në përfundim, Gjykata e Lartë, brenda kompetencave që i njeh ligji, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi në vlerësimin e saj nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i pop këtij ligji (*shih vendimin nr. 80, datë 18.12.2017, paragrafët 14-17 të GJK-së*).

119. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i të së drejtës së aksesit në gjykatë lidhur me parimin e sigurisë juridike, pasi gjykatat nuk kanë marrë parasysh as vendimin nr. 1585, datë 26.06.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, as vendimin nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës, me të cilin është interpretuar neni 29 i ligjit nr.10142/2009. Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk ka pasqyruar në vendim dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të paraqitura në rekurs, të cilat kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve të ngritura në rekurs, që lidhen me mosrespektimin e vendimit të formës së prerë dhe mosmarrjen parasysh të jurisprudencës së Gjykatës, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhej të kishte vlerësuar bazueshmërinë e tyre dhe të jepte në përfundim një vendim të arsyetuar në lidhje me këto pretendime. Vetëm në këtë mënyrë do të garantohej e drejta e kërkuesit për akses efektiv në gjykatë dhe, i lidhur me të, standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, sipas standardeve të vendosura tashmë nga jurisprudenca kushtetuese (*shih vendimin nr. 81, datë 18.12.2017, paragrafët 9-17 të GJK-së*).

120. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për akses në gjykatë dhe parimit të kontradiktoritetit në Gjykatën e Lartë, pasi Kolegji Administrativ nuk ka marrë masa për njoftimin efektiv individual të saj si palë private, ndërkohë që Avokatura e Shtetit, palë publike dhe me përfaqësi të përhershme pranë Gjykatës së Lartë, ka pasur mundësi të marrë dijeni për zhvillimin e procesit gjyqësor. Si rezultat i mosnjoftimit, asaj i është mohuar e drejta e ballafaqimit të provave apo të opinioneve me palët e tjera të pranishme, sepse Kolegji Administrativ ka gjykuar vetëm mbi pretendimet e palës rekursuese, pa i dhënë mundësi kërkueses të njihet me pretendimet dhe të shprehet në lidhje me to. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar pretendimin e kërkueses në drejtim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim. Sipas saj, ndër të tjera, jo vetëm për shkak të periudhës së gjatë kohore nga marrja dijeni për depozitimin e rekursit në zhvillimin e seancës publike (2009-2014), por, veçanërisht, duke marrë parasysh faktin se rekursi është marrë në shqyrtim sipas një kuadri të ndryshëm ligjor procedural, ka arsye për të arritur në përfundimin se Kolegji Administrativ nuk ka marrë masat e nevojshme për t`i garantuar kërkueses të drejtën për t`u dëgjuar dhe për t`u mbrojtur nëpërmjet dhënies së mundësisë së paraqitjes së prapësimeve të saj, duke mos respektuar, për rrjedhojë, të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtim të respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim. Në rastin konkret, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke vendosur vetëm mbi bazën e pretendimeve të parashtruara në rekurs nga subjekti i interesuar, DRSHTRR-ja, pa i dhënë mundësi konkrete efektive kërkueses që të paraqiste pretendimet e saj në lidhje me çështjen, e ka vendosur atë në një pozitë të pabarabartë në raport me palën tjetër (*shih vendimin nr. 49, datë 22.07.2016, paragrafët 9-19 të GJK-së*).

121. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit dhe i së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi Kolegji Administrativ edhe pse në prani të të dyja vendimeve me vlerësime të ndryshme, nuk i ka dhënë mundësinë kërkuesit të paraqesë argumentet e tij ligjore për pretendimet e ngritura në rekurs. Gjykata e ka vlerësuar pretendimin të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, dy gjykata të niveleve të ndryshme, ajo e shkallës së parë dhe ajo e apelit, i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta zgjidhjes së mosmarrëveshjes midis palëve ndërgjyqëse. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke iu referuar vendimeve unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara, edhe pse pranon se kërkuesi mund të kërkojë në gjykatë dëmshpërblimin, si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punës, vendos mospranimin e rekursit, pavarësisht se dëmshpërblimi i është njohur kërkuesit nga gjykata e shkallës së parë dhe mohuar nga ajo e apelit. Një arsyetim i tillë i Gjykatës së Lartë e bën vendimin e saj kontradiktor dhe alogjik. Gjykata e Lartë, nëpërmjet një vendimi kontradiktor dhe alogjik në arsyetim, që bie ndesh me përfundimin e arritur në dispozitiv për mospranimin e rekursit, i ka mohuar kërkuesit, gjithashtu, të drejtën e aksesit në gjykatë, si dhe të drejtën e ankimit në kuptimin substancial (*shih vendimin nr. 73, datë 16.12.2016, paragrafët 10-23 të GJK-së*).

122. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi duke rrëzuar padinë, Kolegji Administrativ i kësaj gjykate nuk i ka shqyrtuar në mënyrë substanciale pretendimet e tij për rikthim në punë. Një gjë e tillë

ka cenuar në thelb jo vetëm të drejtën e aksesit, por edhe të drejtën e rehabilitimit e të zhdëmtimit të personit për shkak të veprimeve dhe akteve të paligjshme të administratës publike (neni 44 i Kushtetutës). Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, duke pasur parasysh rrethanat faktike të çështjes, Gjykata çmon se në kuptimin kushtetues, kërkuesi ka pasur akses të plotë në gjykatë, në të gjitha shkallët e gjykimit. Ai, jo vetëm ka realizuar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, për t'u dëgjuar prej saj, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje përfundimtare për çështjen. Edhe pse rekursi në Gjykatën e Lartë është paraqitur nga pala e paditur në procesin gjyqësor, kërkuesi është vënë në dijeni për rekursin dhe procesin në atë gjykatë dhe ka pasur mundësinë të paraqesë kundërshtitë e tij për argumentet e palës tjetër (*shih vendimin nr. 83, datë 30.12.2015 të GJK-së*).

III. E drejta për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj: garancitë e përgjithshme/kërkesat institucionale

A. Pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës

1. Gjykatë e pavarur

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse[11]

Neni 42, pika 2, i Kushtetutës:

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

- ***Pavarësia në raport me pushtetet e tjera***

1. Kushtetuta në nenin 135 parashikon se pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Ndërsa, neni 145, pika 1, i Kushtetutës parashikon: *"Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve."*. Pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës, kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat ndërsa japin drejtësi, t'u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve (*shih vendimet nr. 1, datë 26.01.2021, paragrafi 46; nr.5, datë 16.02.2012 të GJK-së*).

2. Parimi i shtetit të së drejtës, ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Disa nga elementet e shtetit të së drejtës janë: parimi i ndarjes së pushteteve, siguria juridike dhe respektimi i të drejtave

[11] Standardet e përmendura në këtë pjesë përfshijnë standardet e evidentuara në jurisprudencën e Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/akteve normave dhe ato nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual.

dhe lirive themelore të njeriut (*shih vendimet nr. 9, datë 26.02.2016, paragrafi 16; nr.29, datë 31.05.2010 të GJK-së*).

3. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve parashikohet në nenin 7 të Kushtetutës, sipas të cilit: *"Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor."*. Ky formulim do të thotë se ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe midis tyre duhet të ketë një balancë. Në varësi të kësaj ndarjeje, fusha e ushtrimit të kompetencave nga institucionet e ndryshme kushtetuese varet nga fakti se cilit pushtet i përket institucioni, nga vendi i tij midis institucioneve të tjera dhe nga raportet e tij me ato të institucioneve të pushtetit shtetëror. Në përputhje me detyrat që u ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ ose institucion tjetër, në përbërje ose jo të njërit prej tre pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimet nr. 9, datë 26.02.2016, paragrafi 18; nr. 16 datë 10.04.2015; nr. 36 datë 01.06.2015; nr.11, datë 02.04.2008 të GJK-së*).

4. Pushteti gjyqësor është i ndarë dhe i balancuar me dy pushtetet e tjera. Pavarësia e gjyqësorit kuptohet si pavarësi funksionale, strukturale organizative dhe financiare (*shih vendimet nr. 20, datë 15.04.2015; nr.11, datë 06.04.2010; nr.11, datë 27.05.2004 dhe të GJK-së*).

5. Parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat, ndërsa japin drejtësi, t'u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Ata duhet të jenë të paanshëm dhe objektivë në gjykimin e çështjeve (*shih vendimet nr.11, datë 2.04.2008, paragrafi4; nr.19, datë 03.05.2007 të GJK-së*).

6. Pavarësia e gjyqësorit ka dy komponentë realë të saj që janë: paanshmëria dhe pavarësia e gjyqtarit dhe e gjykatës. Paanshmëria i referohet një qëndrimi subjektiv të gjyqtarit në lidhje me çështjen dhe me palët pjesëmarrëse në të, ndërsa pavarësia, e cila duhet të bazohet në ekzistencën e disa kushteve dhe të garancive objektive nënkupton jo vetëm një qëndrim të caktuar ndaj ushtrimit të funksionit gjyqësor, por dhe një pozitë ose marrëdhënie në raport me të tjerët, veçanërisht me pushtetin ekzekutiv (*shih vendimet nr.11, datë 02.04.2008, paragrafi4; nr.14, datë 22.05.2006 të GJK-së*).

7. Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave, si dhe autoriteti i tyre gjyqësor, nuk janë një qëllim në vetvete. Respektimi i këtij parimi është një kusht i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në paragrafin e dytë të nenit 42 të Kushtetutës parashikohet: *"Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj."*. Në këtë kuptim, kjo pavarësi nuk është një privilegj, por një nga detyrat themelore të gjyqtarëve dhe të gjykatës, që rrjedh nga të drejtat e njeriut për të pasur një arbitër të paanshëm në një konflikt, të garantuar nga Kushtetuta. Garantimi i një standardi të tillë

përbën dhe kriterin orientues për të vlerësuar pavarësinë e gjyqtarëve dhe të gjykatave (*shih vendimet nr. 1, datë 26.01.2021, paragrafi 48; nr. 11, datë 02.04.2008 të GJK-së*).

8. Me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është "i pavarur", ndër të tjera, duhet konsideruar edhe mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre. Vetëm një gjykatë e pavarur, së cilës i garantohet paprekshmëria e mandatit të anëtarëve të saj, mund të konsiderohet si një gjykatë që administron drejtësinë kushtetuese, në përputhje me parimet kushtetuese. Edhe pse mandati i gjyqtarit kushtetues ka kuptimin e një mandati të dhënë (jo të fituar nëpërmjet votës së zgjedhësve aktivë), parimi i pavarësisë nënkupton, gjithashtu, se gjyqtari në momentin e emërimit duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë (*shih vendimet nr. 55, datë 27.07.2016, paragrafi23; nr.24, datë 09.06.2010; nr.20, datë 09.07.2009 të GJK-së*).

9. Një pjesë të natyrshme të rregullimeve kushtetuese zënë normat e lidhura me mandatin e organeve më të rëndësishme të shtetit, të cilat, në mënyrë të veçantë, krijojnë garancitë e nevojshme për ushtrimin e mandatit sipas konceptit kushtetues. Këto garanci konsistojnë, nga njëra anë, në arsye specifike, shteruese për përfundimin e mandatit të tyre dhe, nga ana tjetër, në procedura të veçanta për përfundimin e mandatit/ve. Këto janë elemente përbërëse të statusit kushtetues të organeve dhe institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta. Kjo do të thotë se zëvendësimi i këtyre procedurave specifike me të tjera, më pak mbrojtëse, dobëson statusin e tyre. Në një shtet demokratik të sunduar nga ligji gjyqtari përmbush një funksion shumë të rëndësishëm. Roli i tij dhe i gjykatave në një shtet të tillë është që, ndërsa ushtrojnë funksionin e drejtësisë, ata duhet të sigurojnë zbatimin e normave të shprehura në Kushtetutë, të ligjeve dhe akteve të tjera ligjore, të garantojnë shtetin e së drejtës dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut *(shih vendimet nr. 55, datë 27.07.2016, paragrafi 22; nr.9, datë 23.03.2010 të GJK-së)*.

10. Kushtetuta e ndalon ndërhyrjen në veprimtarinë e gjykatave dhe gjyqtarëve. Në paragrafin e tretë të nenit 145 të saj parashikohet: *"Ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit."*. Pavarësia procedurale e gjyqtarit është një kusht i nevojshëm për një shqyrtim të pavarur dhe të paanshëm të çështjes. Kjo normë e Kushtetutës ngarkon institucionet dhe pushtetet e tjera me detyrën kushtetuese që të respektojnë pavarësinë e gjykatave (*shih vendimet nr.11, datë 02.04.2008, paragrafi4 të GJK-së*).

11. Statusi ligjor i gjyqtarëve dhe i gjykatave duhet, gjithashtu, t'i shërbejë garancisë së pavarësisë së tyre. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre. Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, me mosndjekjen e tyre penalisht dhe disiplinarisht pa vendim të motivuar të KLD-së, si dhe me garancitë financiare (*shih vendimet nr.11, datë 02.04.2008, paragrafi4; nr.11, datë 27.05.2004 të GJK-së*).

12. Sistemi i garancive të pavarësisë së gjyqtarëve dhe të gjykatave nuk krijon ndonjë parakusht, mbi bazën e të cilit gjyqtari mund t'i shmanget përmbushjes së detyrave të tij në mënyrë të plotë, të shqyrtojë çështjet në një mënyrë të papërshtatshme, të veprojë në mënyrë jo etike me personat që marrin pjesë në çështje, të shkelë të drejtat e njeriut dhe dinjitetin etj. Gjyqtarët duhet të mbrojnë nderin dhe prestigjin e detyrës së tyre. Për rrjedhojë, sistemi i vetëqeverisjes së gjyqësorit duhet të sigurojë që gjyqtarët t'i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë korrekte, me qëllim që çdo veprim joligjor ose jo etik të vlerësohet në mënyrë të përshtatshme (*shih vendimin nr.11, datë 02.04.2008, paragrafi4 të GJK-së*).

13. Pavarësia nuk është qëllim në vetvete ose një mënyrë për të siguruar pozicionin profesional të gjyqtarëve për të mirën e tyre, por është një mjet për të arritur qëllimet e një shoqërie të drejtë dhe të përparuar. Për këtë arsye, pavarësia shoqërohet me mjete për të siguruar, që gjyqtarët dhe gjyqësori në tërësi, të veprojnë në përputhje me parimet dhe interesat legjitimë të një shoqërie demokratike (*shih vendimin nr.11, datë 02.04.2008, paragrafi 6 të GJK-së*).

14. Rrjedhoja më e rëndësishme e parimit të pavarësisë së gjyqtarëve është mospërgjegjësia për vendimet që japin sipas bindjes së tyre, mbështetur në Kushtetutë dhe në ligje. Megjithatë, pasoja e pushtetit dhe besimi që shoqëria u jep gjyqtarëve është e tillë që duhet të ketë disa mënyra për t'i mbajtur gjyqtarët përgjegjës, përfshirë edhe largimin nga detyra, në rast të shkeljeve që justifikojnë këtë veprim (*shih vendimin nr.11, datë 02.04.2008, paragrafi4, të GJK-së*).

15. Parimi i pavarësisë së gjyqtarëve është, gjithashtu, i sanksionuar në një sërë dokumentesh ndërkombëtare, si: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; KEDNJ-ja, Parimet Bazë për Pavarësinë e Gjyqësorit miratuar nga Asambleja e OKB-së, Rekomandimi për Pavarësinë, Eficiencën dhe rolin e gjyqtarëve miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës; Karta Universale e Gjyqtarit etj. Këto dokumente ndërkombëtare, në tërësi, identifikojnë parimet bazë të pavarësisë së gjyqësorit, si: gjyqtari duhet të ketë autoritetin për të vendosur për çështjet i lirë nga çdo ndërhyrje, ndarja e pushteteve dhe pavarësia e gjyqësorit të përfshihen në rendin kushtetues, gjykatat dhe gjyqtarët duhet të kenë pavarësi administrative dhe të përfshihen në procesin buxhetor, mbrojtja e gjyqtarëve nga shfuqizimi arbitrar ose rishikimi i vendimeve të tyre duhet të jetë i garantuar, pavarësia ndërinstitucionale që është e drejta e gjyqtarëve për të marrë vendime pa ndërhyrje të papërshtatshme nga gjykatat më të larta etj (*shih vendimin nr.11, datë 02.04.2008, paragrafi 7, të GJK-së*).

16. Vetëm një gjykatë e pavarur, së cilës i garantohet paprekshmëria e mandatit të anëtarëve të saj, mund të konsiderohet si një gjykatë që administron drejtësinë kushtetuese, në përputhje me parimet kushtetuese. Edhe pse mandati i gjyqtarit kushtetues ka kuptimin e një mandati të dhënë (jo të fituar nëpërmjet votës së zgjedhësve aktivë), parimi i pavarësisë nënkupton, gjithashtu, se gjyqtari në momentin e emërimit duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të

lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë (*shih vendimet nr.55, datë 27.07.2016, paragrafi 23; nr.24, datë 09.06.2011 të GJK-së*).

17. Statusi ligjor i gjyqtarëve duhet të jetë në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Parimi i pavarësisë së gjyqësorit përfshin një gamë të gjerë aspektesh, të cilat, të marra së bashku, krijojnë kushtet e nevojshme që gjykatat të përmbushin rolin dhe detyrat e tyre, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqësorit janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre. Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen kryesisht me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, si dhe me garancitë financiare (*shih vendimet nr. 23, datë 24.04.2015; nr. 5, datë 16.02.2012; nr. 26, datë 24.07.2009; nr. 11, datë 02.04.2008;nr. 11, datë 27.05.2004 të GJK-së*).

18. Parimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor e detyron pushtetin legjislativ të përcaktojë garanci të tilla pavarësie që sigurojnë paanshmërinë e gjykatave në vendimmarrjen e tyre dhe nuk lejojnë ndërhyrjen në këtë veprimtari. Kjo pavarësi mund të sigurohet me mjete të ndryshme, mes të tjerash, duke përcaktuar me ligj pavarësinë e tyre procedurale, organizative dhe vetëqeverisjen e gjykatave, statusin e gjyqtarëve dhe garancitë sociale (materiale) të gjyqtarit (*shih vendimin nr.46, datë 29.06.2015, paragrafi 12, të GJK-së*).

19. Pavarësia e gjyqësorit kuptohet si pavarësi substanciale, që do të thotë "liri e gjykatave për të dhënë vendime, të cilat nuk bazohen në interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit", pavarësi strukturale, që lidhet me parashikimin në Kushtetutë apo në ligj të ekzistencës së institucionit, të mënyrës së formimit të përbërjes së tij, pavarësi organizative, që përfshin strukturimin e brendshëm administrativ të gjykatave, pavarësi financiare, që nënkupton autonomi në hartimin e buxhetit nga vetë institucioni dhe miratimin nga legjislativi, si një zë i veçantë i buxhetit të shtetit, fonde të përshtatshme e të mjaftueshme për të realizuar qëllimin dhe detyrat e institucionit e administrimin e tyre në mënyrë të pavarur, si dhe pavarësi personale, që kërkon emërim në bazë të kritereve objektive, imunitet, garanci ekonomike, garanci për karrierën, sistem të transferimit dhe një sistem disiplinor (*shih vendimet nr.46, datë 29.06.2015, paragrafi 13; nr.11, datë 06.04.2010 të GJK-së*).

20. Roli dhe funksionimi i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor. E konsideruar nga ligjvënësi si pjesë integrale e organizimit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor dhe e interpretuar në jurisprudencën kushtetuese si pjesë organizative dhe funksionale e këtij pushteti, administrata gjyqësore gëzon të njëjtën mbrojtje procedurale kushtetuese, në kuadër të procedurës së miratimit të ligjeve me shumicë të cilësuar, njëlloj siç parashikohet për pushtetin gjyqësor (*shih vendimet nr.46, datë 29.06.2015, paragrafi 14; nr.10, datë 06.03.2014 të GJK-së*). Kushtetuta nuk e lejon vendosjen e administratës gjyqësore nën varësinë e ministrit të Drejtësisë dhe as nuk i njeh këtij të fundit një rol parësor në organizimin dhe drejtimin e këtij shërbimi (*shih vendimet nr.46, datë 29.06.2015, paragrafi 15; nr.10, datë 06.03.2014 të GJK-së*). Po ashtu, shmangia e

kryetarëve të gjykatave nga çështjet që lidhen me organizimin, drejtimin dhe kontrollin e përgjegjshmërisë së administratës gjyqësore, si dhe me emërimin dhe shkarkimin e personelit, krijon rrezikun e një ndikimi të papërshtatshëm në funksionin ekskluziv të gjyqësorit, dhënien e drejtësisë, si dhe i vendos strukturat brenda gjykatave në kushte të papërshtatshme për krijimin e marrëdhënieve të besimit, të cilat janë të nevojshme për ushtrimin normal të funksionit (*shih vendimet nr.46, datë 29.06.2015, paragrafi 15; nr.20, datë 09.07.2009 të GJK-së*).

21. Krijimi i raporteve të balancuara ndërmjet pushtetit ekzekutiv dhe atij gjyqësor duhet të orientohet nga standardi kushtetues i bashkëpunimit. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe fryma e Kushtetutës pranojnë bashkëpunim dhe bashkëveprim ndërmjet gjyqësorit dhe ekzekutivit lidhur me çështjet e administratës gjyqësore, por kjo duhet të organizohet në mënyrë të tillë që pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave të mos shkelet *(shih vendimet nr.46, datë 29.06.2015, paragrafi 16; nr.10, datë 06.03.2014 të GJK-së)*. Për efekt të rëndësisë që paraqet parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, garancitë që ofron ligjvënësi, në kuptim të këtij parimi, duhet të jenë integrale e të përshkallëzuara nga niveli menaxhues deri në atë ekzekutues. Në këtë drejtim, çdo rregullim i ri ligjor nuk është i mjaftueshëm nëse nuk garanton shmangien e ndikimeve që mund të ushtrojë pushteti ekzekutiv në çështje që lidhen me dhënien e drejtësisë nga gjykata (shih vendimet nr.46, datë 29.06.2015, paragrafi 17; nr.10, datë 06.03.2014 të GJK-së). Nën frymën e dispozitave të Kushtetutës për pavarësinë e gjyqësorit dhe ndarjen e pushteteve, pushteti ekzekutiv, nëpërmjet ministrit të Drejtësisë, duhet ta konsiderojë si detyrë të tij garantimin e kushteve të përshtatshme të punës për gjykatat dhe gjyqtarët, në funksion të dhënies së drejtësisë. Ndërsa "kontrolli" ,si i tillë, nuk duhet të cenojë elementet e pavarësisë, të cilat, në thelb, prekin vetë funksionin e dhënies së drejtësisë (*shih vendimet nr.46, datë 29.06.2015, paragrafi 18; nr.20, datë 09.07.2009 GJK-së*).

22. Parimi i pavarësisë së gjyqtarëve është i përfshirë në një sërë dokumentesh ndërkombëtare të cilat identifikojnë parimet bazë të pavarësisë së gjyqësorit, si për shembull, se gjyqtari duhet të ketë autoritetin për të vendosur për çështjet i lirë nga çdo ndërhyrje, ndarja e pushteteve dhe pavarësia e gjyqësorit të përfshihen në rendin kushtetues, gjykatat dhe gjyqtarët duhet të kenë pavarësi administrative dhe të përfshihen në procesin buxhetor, mbrojtja e gjyqtarëve nga shfuqizimi arbitrar ose rishikimi i vendimeve të tyre duhet të jetë i garantuar; pavarësia ndërinstitucionale, që është e drejta e gjyqtarëve për të marrë vendime pa ndërhyrje të papërshtatshme nga gjykatat më të larta etj (*shih vendimet nr.11, datë 06.03.2014, paragrafi7.4.; nr.11, datë 02.04.2008 të GJK-së).*

- ***Pavarësia e brendshme institucionale***

23. Pushteti gjyqësor, përveç pavarësisë së jashtme, ka edhe një pavarësi të brendshme, në kuptimin që gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve (shih vendimet nr. 1, datë 26.01.2021, paragrafi 47; nr. 40, datë 07.07.2014 të GJK-së). Pavarësia e brendshme e pushtetit gjyqësor është po aq e rëndësishme sa edhe pavarësia e jashtme e tij. Një gjyqtar, në ushtrimin e funksioneve të tij, është vartës i askujt. Ai ose ajo është bartës i një

funksioni shtetëror dhe, në këtë kuptim, i shërben dhe i përgjigjet vetëm ligjit. Pavarësia e gjyqësorit nuk është vetëm e pushtetit si një i tërë *vis-à-vis* i pushteteve të tjera të shtetit, sepse ka edhe një aspekt të "brendshëm". Çdo gjyqtar, pavarësisht vendit të tij në sistemin gjyqësor, ushtron të njëjtin autoritet gjykimi (*shih vendimet nr. 1, datë 26.01.2021, paragrafi 47; nr. 34, datë 10.04.2017 të GJK-së*).

24. Sistemi gjyqësor është një sistem korrigjues subsidiar, i cili nga mënyra se si është ndërtuar dhe funksionon, u përgjigjet të gjitha pretendimeve për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore, dhe individi ka mundësinë që në çdo hallkë, fazë ose shkallë të procesit të ngrejë pretendime konkrete për gjykatën e pavarur dhe të paanshme, të krijuar me ligj. Gjithashtu, sipas Gjykatës, parimi i shkallëzimit duhet të interpretohet duke u dhënë kuptim të gjitha normave kushtetuese, në kuptimin që nëse interpretohet vetëm literalisht, ai nuk u jep zgjidhje të gjitha situatave (*shih vendimet nr. 1, datë 26.01.2021, paragrafi 50; nr.12, datë 17.06.2004 të GJK-së*).

b. Precedentë/raste të gjykimit kushtetues ku çështja e cenimit të pavarësisë është vënë në diskutim[12]

25. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi se kolegji në Gjykatën e Lartë ka mbajtur qëndrim të kundërt me atë të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si për sa u përket problemeve ligjore për zgjidhjen e konfliktit, ashtu dhe mënyrës së vlerësimit të provave të paraqitura nga palët gjatë rigjykimit të çështjes. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Ajo e ka çmuar të nevojshme ta trajtojë këtë pretendim në lidhje edhe me një parim tjetër kushtetues, atë të pavarësisë së gjyqtarit në vendimmarrje. Sipas këtij parimi edhe në rishqyrtim, gjykata e mbështet vendimin e saj në ligj, në kritere objektive e në prova, të cilat merren mbi bazën e vlerësimit të vetë gjyqtarëve që janë të pavarur në përmbushjen e detyrës së tyre funksionale. Në rast se ndodhemi para një vendimi gjyqësor të mbështetur mbi shkelje, ai mund të riparohet nëpërmjet apelimit e rishikimit nga instancat gjyqësore që kanë të drejtë të riparojnë shkeljet e ndodhura. Kjo zgjidhje, e cila i shërben parimit të sigurisë juridike, ka si element të tij edhe moskrijimin e kushteve të tilla që mund të bëjnë të vështirë përfundimin e procesit gjyqësor ose, siç quhet ndryshe, një sistem drejtësie pa fund (*shih vendimin nr.32, datë 02.12.2005, të GJK-së*).
26. Përpara Gjykatës nëpërmjet kontrollit kushtetues incidental, është pretenduar se neni 453 i KPP-së, pikat 1 dhe 3, bien ndesh me parimin e pavarësisë në aspektin e kontrollit gjyqësor të shkallëzuar, sanksionuar në nenet 135 dhe 145 të Kushtetutës. Kontrolli i shkaqeve të kërkesës për rishikim dhe, më pas, dërgimi i çështjes për gjykim të rishikimit në shkallën e parë, me trup tjetër gjykues, cenojnë këto parime kushtetuese. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar, duke vlerësuar, ndër të tjera, se gjykata referuese

[12] Precedentët/rastet nga gjykimi kushtetues të përmendura në këtë pjesë, ku çështja e cenimit të pavarësisë është vënë në diskutim, përfshijnë jo vetëm ato të shqyrtuara nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual por edhe ato nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/akteve normave. Ligjet/aktet normative objekt shqyrtimi ose të referuara në precedentët/rastet nga gjykimi kushtetues janë ato akte që kanë në fuqi në kohën e shqyrtimit të këtyre çështjeve.

nuk ka dhënë argumente nga pikëpamja e standardeve kushtetuese të evidentuara nga Gjykata (*shih vendimin nr. 1, datë 26.01.2021, paragrafët 45-51 të GJK-së*).

27. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues incidental, është pretenduar se shtesa që i është bërë nenit 55/2 të KP-së vjen në kundërshtim me nenet 7, 135/1 dhe 145/1 të Kushtetutës, duke cenuar për këtë arsye parimin e ndarjes dhe pavarësisë së pushteteve. Me shtesën e realizuar në paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së ligjvënësi i ka hequr të drejtën pushtetit gjyqësor të japë drejtësi, në përputhje me parashikimet e nenit 47/2 të KP-së, sipas të cilit në caktimin e dënimit ndaj personit gjykata merr parasysh rrezikshmërinë e veprës, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Mjeti që ka përzgjedhur ligjvënësi për të arritur synimin e tij, konkretisht luftën kundër krimit të organizuar, sigurinë e rendit publik dhe shoqëror, si dhe rritjen e efektivitetit të masave shtrënguese ndaj autorëve të veprave penale, bie në kundërshtim me pavarësinë funksionale të gjykatave në atributin që kanë për dhënien e drejtësisë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, duke përcaktuar mënyrën e dhënies së dënimit, sipas metodologjisë së parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 55 të KP-së, ligjvënësi u ka hequr gjykatave të sistemit gjyqësor të drejtën të vlerësojnë pikërisht elementet e parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 47 të KP-së, të cilat janë jo vetëm përcaktuese në individualizimin e drejtë të dënimeve penale, por njëkohësisht janë edhe në kompetencën ekskluzive të gjyqësorit. Ky rregullim i ri përbën cenim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe të pavarësisë funksionale të pushtetit gjyqësor (*shih vendimin nr. 9, datë 26.02.2016, paragrafët 14-26 të GJK-së*).

28. Përpara Gjykatës është pretenduar se paragrafi 3 i nenit 5 të ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar me ligjin nr.151/2013, datë 30.05.2013, cenon edhe parimin e pavarësisë së gjyqtarit/gjykatës. Nëpërmjet dispozitës së kundërshtuar *de facto* kohëzgjatja e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë është lënë në diskrecionin e organit që e ka zgjedhur atë. Këtë diskrecion Kuvendi e ka krijuar nëpërmjet një ligji të miratuar prej tij, jashtë delegimit të dhënë nga vetë Kushtetuta. Në këtë mënyrë pavarësia e gjyqtarit/gjykatës vihet në pikëpyetje, duke u cenuar neni 145/1 i Kushtetutës, sipas të cilit gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Kjo passjell edhe cenimin e nenit 42 të Kushtetutës, i cili sanksionon të drejtën për t`u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Gjykata nuk e ka çmuar me vend të ndalet në vlerësimin e bazueshmërisë së këtij pretendimi në këtë aspekt, për sa kohë ka vlerësuar se dispozita e kundërshtuar, për shkak të mosrespektimit të hierarkisë së akteve dhe tejkalimit të parashikimit kushtetues, bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës, si një nga parimet themelore të shtetit dhe normës së pavarur kushtetuese, nga i cili burojnë edhe parimet e tjera kushtetuese (*shih vendimin nr. 55, datë 27.07.2016 paragrafët21-26 të GJK-së*).

29. Përpara Gjykatës, në rrugën e kontrollit kushtetues incidental, është pretenduar se neni 315 i KP-së, ku parashikohej "Dhënia e një vendimi gjyqësor përfundimtar që dihet se është i padrejtë dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet", cenon parimin e pavarësisë

së gjykatës dhe, për rrjedhojë, është i papajtueshëm me nenet 42 dhe 145 të Kushtetutës. Gjykata e ka vlerësuar pretendim të bazuar dhe ka vendosur shfuqizimin e këtij neni. Ndër të tjera, ajo ka argumentuar se analiza e ndërgjegjes ose e dijenisë do të lidhej me një analizë të bindjes së brendshme të gjyqtarit e krijuar gjatë procesit vendimmarrës dhe e bërë e ditur me shpalljen e vendimit. Kjo analizë e ndërgjegjes së gjyqtarit do të përbënte një ndërhyrje në vetë thelbin e pavarësisë funksionale të gjyqtarit. Paqartësia në përcaktimin e anës subjektive të veprës krijon mundësi që organi i akuzës të fillojë një çështje penale ndaj gjyqtarit mbi bazën e kallëzimit të palëve me pretendimin se vendimi dihet që është i padrejtë, pavarësisht se sa kjo mund të provohet objektivisht. Dispozita penale, objekt shqyrtimi, nuk shmang mundësinë që gjyqtari të vihet në ndjekje penale vetëm për faktin se ai ka dhënë një vendim sipas bindjes së tij të mbështetur në Kushtetutë dhe në ligje. Hapësira që lejon kjo vepër mund krijojë një presion të papërshtatshëm ndaj gjyqtarit, çka do të dëmtonte dhënien e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut (*shih vendimin nr. 11, datë 02.04.2008 të GJK-së*).

30. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së gjykimit nga një gjykatë e pavarur, për shkak se kancelarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ankimin e paraqitur nga ana e Ministrisë së Drejtësisë e ka vendosur në dosjen gjyqësore të themelit brenda afatit, ndërkohë që ankimi ka qenë i depozituar jashtë afatit. Kancelarja ka qenë në varësi të kësaj ministrie. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim se nuk është ngritur në nivel kushtetues. Sipas saj, ndër të tjera, gjyqtari i vetëm ka shqyrtuar kushtet formale të pranimit të ankimit të ministrisë, përfshirë edhe veprimet administrative të kancelares e të sekretarisë gjyqësore, duke mbajtur qëndrim konkret për pranimin e ankimit, ndaj, në rastin konkret, nuk vërehet se si veprimet e kancelares të kenë cenuar pavarësinë e gjykatës (*shih vendimin nr. 27, datë 18.05.2023, paragrafët 21-22 të GJK-së*).

31. Përpara Gjykatës është pretenduar se paragrafi 3 i nenit 5 të ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar me ligjin nr.151/2013, datë 30.05.2013, ndër të tjera, cenon edhe të drejtën për t`u gjykuar nga një gjykatë e pavarur. Nëpërmjet dispozitës së kundërshtuar *de facto* kohëzgjatja e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë është lënë në diskrecionin e organit që e ka zgjedhur atë. Këtë diskrecion Kuvendi e ka krijuar nëpërmjet një ligji të miratuar prej tij, jashtë delegimit të dhënë nga vetë Kushtetuta. Gjykata nuk i ka dhënë përgjigje të drejtpërdrejtë këtij pretendimi, por e ka vlerësuar atë të ndërlidhur me parimin e shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, duke vlerësuar se dispozita e kundërshtuar nuk është në përputhje me këtë parim dhe ka vendosur shfuqizimin (*shih vendimin nr.55, datë 27.07.2016, paragrafët21-25 të GJK-së*).

32. Përpara Gjykatës është pretenduar se nenet 1, 3 dhe 10 të ligjit nr. 97/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8136, datë 31.07.1996 "Për Shkollën e Magjistraturës", të ndryshuar"", që parashikojnë ndryshimin e formulës së përbërjes së Këshillit Drejtues, mënyrën e zgjedhjes së drejtorit dhe rregullat për pranimin në Shkollën e Magjistraturës, cenojnë parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, pasi nuk respektojnë pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër

të tjera, përfshirja e KGJK-së dhe Këshillit të Prokurorisë në kategorinë e organeve që kanë të drejtë të zgjedhin përfaqësues në Këshillin Drejtues të SHM-së nuk vë në dyshim cenimin e parimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Edhe argumentin për ngushtimin e kompetencave të KLD-së për emërimin e drejtorit të SHM-së, Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar. Gjithashtu, lidhur me argumentet se ndryshimet e rregullave të pranimit në Shkollën e Magjistraturës dhe përfshirja e strukturave të Ministrisë së Shëndetësisë në procesin e vlerësimit të aftësive mendore dhe psikologjike të kandidatëve cenojnë pavarësinë e gjyqtarëve, Gjykata ka vlerësuar se këto argumente nuk janë ngritur në nivel kushtetues (*shih vendimin nr. 20, datë 15.04.2015, paragrafët 24-45 të GJK-së*).

33. Përpara Gjykatës është pretenduar se neni 4 i ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, që parashikon rastet e shkarkimit të anëtarëve të KLD-së cenon parimin e ndarjes së pushteteve dhe dobëson vetëqeverisjen e gjyqësorit. Ky ligj nuk bën dallime ose specifikime lidhur me rastet e shkeljes së rëndë të ligjit si shkak për shkarkimin e anëtarit të KLD-së, duke lënë vend për abuzim dhe duke mos garantuar ruajtjen e paprekshmërisë së këtij organi kushtetues. Gjykata ka vlerësuar se shkaqet e parashikuara në nenin 4 të ligjit për shkarkimin e anëtarëve të KLD-së nuk janë të qarta dhe nuk garantojnë procesin e rregullt ligjor gjatë procedurës për shkarkimin e tyre. Në këto kushte, kjo dispozitë nuk është në pajtim me parimin e sigurisë juridike, për sa i takon qartësisë së normës juridike në përmbajtje dhe, si e tillë, është antikushtetuese dhe duhet shfuqizuar. Sipas saj, ndër të tjera, anëtari i KLD-së mban përgjegjësi si çdo funksionar tjetër. Gjatë procesit të verifikimit të veprimtarisë së tij, nëse ka qenë në përputhje ose jo me Kushtetutën dhe ligjet e vendit, ai, ashtu si çdo funksionar tjetër, duhet të gëzojë disa garanci kur ndaj tij fillon një procedurë shkarkimi. Një nga shkaqet e shkarkimit të anëtarit të KLD-së është edhe shkelja e ligjit, rast i cili në këndvështrimin e Gjykatës rezulton të jetë i përgjithshëm dhe evaziv. Neni 4 parashikon si shkaqe për shkarkim të njëjtat shkaqe, të cilat në nenin 7 janë listuar si raste të mbarimit të mandatit të anëtarit të KLD-së. Kështu, neni 7 dhe neni 4, njëkohësisht, parashikojnë si shkak për mbarimin e mandatit dhe për shkarkimin e anëtarit të KLD-së: dënimin me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale; paaftësinë mendore dhe fizike; vërtetimin e rasteve të papajtueshmërisë. Me këtë formulim, kjo dispozitë e ligjit bie ndesh me parimin e sigurisë juridike, pasi rastet për të cilat mund të shkarkohet anëtari i KLD-së janë të paqarta, konfuze. Rastet e mbarimit të mandatit dhe ato të shkarkimit duhet të jenë të dallueshme nga njëra-tjetra, pasi edhe shkaqet që çojnë te përfundimi i funksionit të zyrtarit për secilin rast janë të ndryshme (*shih vendimin nr. 23, datë 24.04.2015, paragrafët 18-33 të GJK-së*).

34. Përpara Gjykatës është pretenduar se përmbajtja e nenit 10/2 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, i cili parashikon pezullimin e gjyqtarit automatikisht nga detyra, kur ai merret i pandehur për një vepër penale, bie ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe sigurisë juridike, duke mos garantuar një proces të rregullt ligjor. Një gjë e tillë prek drejtpërsëdrejti pavarësinë e gjyqësorit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, dispozita ligjore objekt shqyrtimi, duke e lidhur fillimin e procedimit

penal ndaj gjyqtarit me pezullimin e tij nga detyra deri në dhënien e një vendimi të formës së prerë nga gjykata, ka bërë një ndërhyrje në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit dhe ka vlerësuar nëse kjo ndërhyrje e ligjvënësit është e përshtatshme në respektim të kushteve që përcakton Kushtetuta, pra për një interes publik dhe në përpjesëtim me qëllimin që kërkohet të arrihet, rritjen e besimit të publikut në dhënien e një drejtësie të paanshme dhe të pavarur. Gjykata ka vlerësuar se pezullimi i gjyqtarit nga detyra është në funksion të rritjes së besimit të publikut në dhënien e drejtësisë. E drejta e gjyqtarit për të ushtruar detyrën, e pakufizuar në kohë, së bashku me garancitë e tjera që parashikon neni 138 i Kushtetutës, janë pjesë përbërëse të statusit të gjyqtarit dhe, si të tilla, i shërbejnë pavarësisë së gjyqësorit. Krahas këtij aspekti, ligjvënësi duhet të kujdeset edhe për funksionimin sa më mirë të pushtetit gjyqësor, me qëllim realizimin e misionit që ata kanë, pra dhënies së drejtësisë. Drejtësia mund të jetë e besueshme dhe me integritet kur jepet nga gjyqtarë që nuk ngjallin dyshime për sa i takon figurës së tyre. Këtij qëllimi i shërben edhe dispozita e nenit 10/3, e cila zbatohet në bashkëpunim me ligjin për organizimin e pushtetit gjyqësor dhe dispozitat përkatëse të KPP-së *(shih vendimin nr. 23, datë 24.04.2015, paragrafët 41-52 të GJK-së*).

III.

35. Përpara Gjykatës është pretenduar se përmbajtja e neneve 6/1, 6/4 dhe 6/5 të ligjit nr.49/2012 (shtuar me nenin 2 të ligjit nr.100/2014, datë 31.07.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative""), të cilat rregullojnë procedurën e konkurrimit e të emërimit të ndihmësve ligjorë, si edhe përbërjen e komisionit *ad hoc* përgjegjës për zhvillimin e konkursit, nuk respektojnë nenet 7 dhe 145 të Kushtetutës. Për shkak të pozicionit të ndihmësit ligjor, është vetë gjykata që duhet të ketë një rol parësor në procedurën e emërimit, të lirimit dhe të shkarkimit të tij. Përbërja e komisionit *ad hoc* përbën premisa për ndërhyrje të papërshtatshme në pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Gjykata i ka vlerësuar këto pretendime të pabazuara. Ajo i ka vlerësuar ato në këndvështrim të respektimit të parimit të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor dhe atij të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve. Sipas saj, ndër të tjera, parashikimi i së drejtës së ministrit të Drejtësisë për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të organizimit të testimit dhe të rregullave për organizimin dhe funksionimin e komisionit *ad hoc* nuk bie ndesh me parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve. Në kuptim të pozicionit kushtetues të ministrit të Drejtësisë, si përfaqësues i pushtetit ekzekutiv në marrëdhëniet me pushtetin gjyqësor, ai mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë me organet e pushtetit gjyqësor dhe me prokurorinë. Ministri i Drejtësisë nuk ka asnjë kompetencë në procesin e emërimit dhe të shkarkimit të ndihmësve ligjorë as në mënyrë të drejtpërdrejtë, as nëpërmjet kancelarit, pasi kjo është kompetencë e kryetarit të gjykatës. Ndërsa ministri i Drejtësisë ka vetëm kompetenca të natyrës organizative, vlerësimi hap pas hapi i të gjitha kritereve ligjore, zhvillimi i testimit, vlerësimi i kandidatëve, deri në përcaktimin e fituesve sipas numrit të pikëve të marra, është një çështje që i përket ekskluzivisht komisionit të ngritur për këtë qëllim. Në kuptim të pavarësisë organizative të gjykatës, si pjesë e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, parashikimet ligjore të kundërshtuara kanë respektuar detyrimin për përfshirjen e kryetarit të gjykatës në çështjet që lidhen me organizimin, drejtimin dhe kontrollin e përgjegjshmërisë së administratës gjyqësore dhe

i kanë njohur atij instrumentet e duhura ligjore për këtë qëllim. Rregullimet ligjore objekt shqyrtimi kanë përcaktuar qartë mekanizmat dhe nivelin e bashkëpunimit për secilin nga aktorët që marrin pjesë në proces, duke i njohur veçanërisht kryetarit të gjykatës kompetenca të drejtpërdrejta për çështjet organizative dhe funksionale të administratës gjyqësore. Lidhur me pretendimin për përbërjen e komisionit, Gjykata ka vlerësuar se ai është i balancuar dhe garanton jo vetëm paanshmërinë në vendimmarrje, por edhe që procesi i përzgjedhjes së ndihmësit ligjor t`i nënshtrohet një procedure konkurruese rekrutimi, transparente dhe merite, në përputhje me nenin 6, pika 4, të ligjit nr.49/2012 (*shih vendimin nr.46, datë 29.06.2015, paragrafët 8-27 të GJK-së*).

36. Përpara Gjykatës është pretenduar se zbatimi i pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr. 77/2012, datë 26.07.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Konferencës Gjyqësore Kombëtare", edhe ndaj mandateve që ushtrohen përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, i vendos papritmas anëtarët e KLD-së, të zgjedhur nga KGJK-ja, përpara një detyrimi për të bërë një zgjedhje midis vazhdimit të mandatit ose, për hir të karrierës, dorëheqjes nga ky mandat. Shtyrja e këtyre gjyqtarëve drejt dorëheqjes përbën një cenim të institucionit të KLD-së dhe, për rrjedhojë, të pavarësisë së vetë gjyqësorit, pavarësinë e të cilit ai mbron. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, kërkuesit nuk kanë parashtruar argumente lidhur me cenimin e standardeve që lidhen me pavarësinë e gjyqësorit (*shih vendimin nr.11, datë 6.03.2014, paragrafët 7.1.-7.7., të GJK-së).*

37. Përpara Gjykatës, ndër të tjera, është pretenduar se shprehja "(...)nga të cilët, jo më pak se 5 vjet gjyqtar pranë gjykatës së apelit" të shkronjës b/i të pikës 1, neni 3, të ligjit nr. 8588/2000, të ndryshuar, cenon nenin 138 të Kushtetutës dhe garancitë kushtetuese që lidhen me statusin e gjyqtarit (palëvizshmëria, paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera), të cilat kanë ndikimin e tyre që gjyqtari të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë të pavarur. Duke vendosur si kusht "sine qua non" të qenit gjyqtar për 5 vjet në gjykatën e apelit, kjo dispozitë u mohon gjyqtarëve, të cilët i plotësojnë kushtet e tjera, por nuk janë pjesë e trupave gjykues në gjykatat e apelit, për shkaqe objektive, të drejtën për t'u përzgjedhur si anëtarë të Gjykatës së Lartë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, karriera është një nga përfitimet që gjyqtarët e gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe, si e tillë, përfshihet në sferën e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës. Të gjitha këto garanci janë të lidhura ngushtësisht ndërmjet tyre. Dispozita ligjore, objekt shqyrtimi, duke e lidhur emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, me kriterin e ushtrimit të funksionit gjyqësor në apel për një kohë të caktuar (5 vjet) ka vendosur një kufizim të karrierës për gjyqtarët që nuk e përmbushin këtë kriter. Gjykata ka vlerësuar se interesi publik që ka diktuar kufizimin e karrierës në rastin konkret është rritja e cilësisë së trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Nëpërmjet vendosjes së kushtit të punës 5-vjeçare si gjyqtar apeli për t'u emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë, ligjvënësi ka synuar pajisjen e gjyqtarit me një eksperiencë unike që, sipas tij, arrihet vetëm duke shërbyer efektivisht në gjykatën e apelit. Megjithatë, edhe pse ligjvënësi, për të justifikuar ndërhyrjen, e ka lidhur ngushtë rritjen e cilësisë së trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë me eksperiencën gjyqësore efektive në gjykatën e apelit, vetë ligji nr. 8588/2000, i ndryshuar, lejon emërimin si anëtarë në Gjykatën e Lartë të individëve të cilët vijnë nga

jashtë sistemit gjyqësor. Në kushtet kur nuk ka argumente të qarta dhe bindëse në këtë drejtim nuk mund të thuhet se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis kriterit kufizues të vendosur nga ligjvënësi dhe objektivit që ai kërkon të arrijë (*shih vendimin nr. 40, datë 7.07.2014, paragrafët 14-30 të GJK-së*).

38. Përpara Gjykatës, ndër të tjera, është pretenduar se shprehja "të mos ketë konflikt interesi apo lidhje nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm" të shkronjës "b"/ii, të pikës 2 të nenit 3 të ligjit 8588/2000, të ndryshuar, cenon pavarësinë e brendshme të pushtetit gjyqësor, të parashikuar nga neni 145/1 i Kushtetutës, pasi pushteti gjyqësor nuk ka hierarki dhe gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, kufizimi i karrierës nëpërmjet kriterit ndalues të parashikuar nga dispozita, objekt shqyrtimi, nuk është proporcional me qëllimin që kërkohet të arrihet nga ligjvënësi. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, KM-ja, nuk ka parashtruar argumente bindëse për të mbështetur qëndrimin se ky kufizim është i domosdoshëm dhe se qëllimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera më pak kufizuese (*shih vendimin nr. 40, datë 07.07.2014, paragrafët 31-36 të GJK-së*).

39. Përpara Gjykatës është pretenduar se ndryshimet me ligjin nr. 9448, datë 05.12.2005 në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë" cenojnë garancitë për funksionimin e KLD-së dhe, për rrjedhojë, vetëqeverisjen e gjyqësorit. Sipas këtyre ndryshimeve, anëtarët e KLD-së duhet të zgjidhnin një nga funksionet ose të ushtronin efektivisht detyrën e gjyqtarit ose vetëm detyrën me kohë të plotë të anëtarit të KLD-së. Si anëtarë të KLD-së ata do të gëzojnë imunitet nga ndjekja penale. Me përjashtim të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, gjyqtarët e tjerë do të kishin të drejtë të ktheheshin përsëri si gjyqtarë efektivë pas mbarimit të mandatit të tyre si anëtarë të KLD-së. Anëtarët e KLD-së që do zgjidheshin nga Kuvendi nuk duhet të ishin gjyqtarë. Gjykata i ka vlerësuar të bazuara këto pretendime, me përjashtim të pretendimit lidhur me përcaktimin se anëtarët e KLD-së që do të zgjidheshin nga Kuvendi nuk duhet të ishin gjyqtarë. Sipas saj, ndër të tjera, shtesat dhe ndryshimet e ligjit jo vetëm dobësojnë vetëqeverisjen e gjyqësorit, por vijnë në kundërshtim edhe me vetë rregullimin që Kushtetuta u ka bërë përbërjes dhe funksionimit të KLD-së. Detyrimi i anëtarit të Gjykatës së Lartë për të zgjedhur një nga detyrat, pra, ose gjyqtar në detyrë ose anëtar me kohë të plotë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, si edhe përjashtimi i tyre nga e drejta për t'u kthyer si anëtar i Gjykatës së Lartë, vjen në kundërshtim me përmbajtjen e disa dispozitave kushtetuese. Lidhur me përcaktimin se anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë që do të zgjidheshin nga Kuvendi nuk duhet të ishin gjyqtarë, Gjykata ka vlerësuar se një përcaktim i tillë është në pajtim, nga njëra anë, me parimin e balancimit të pushteteve që kërkon kontrollin dhe bashkëveprimin midis tyre, ashtu edhe me formulën e nenit 147 të Kushtetutës, nga ana tjetër, sipas të cilit në KLD do të përfaqësohet jo vetëm gjyqësori me dhjetë anëtarë, por edhe pushteti legjislativ me tre anëtarë. Këta të fundit çojnë në KLD frymën e organit ligjvënës dhe, si të tillë, nuk duhet të zëvendësohen me gjyqtarë (*shih vendimin nr. 14, datë 22.05.2006, të GJK-së*).

40. Përpara Gjykatës, në rrugën e kontrollit incidental, është pretenduar se neni 6, pika 9 dhe neni 11, pika 3, shkronja "b", të ligjit nr.8678 datë 04.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", si edhe neni 31, pikat 1 e 3 dhe nenit 16, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", ku parashikohet e drejta e ministrit të Drejtësisë për të kryer inspektime të gjykatave dhe të gjyqtarëve, si dhe e drejta e tij për të propozuar pranë KLD-së marrjen e masave disiplinore, përfshirë dhe shkarkimin e gjyqtarëve, përbëjnë kompetenca që cenojnë parimin e ndarjes së pushteteve dhe parimin e pavarësisë së gjyqtarëve, përkatësisht të sanksionuara në nenet 7 dhe 145 të Kushtetutës. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar (*shih vendimin nr.11, datë 27.05.2004 të GJK-së*).

41. Përpara Gjykatës, në rrugën e kontrollit incidental, nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë është pretenduar se neni 48 i ligjit nr.8436, datë 25.05.1999 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" vjen në kundërshtim me nenin 147/6 të Kushtetutës. Megjithëse provimi i kualifikimit profesional ka të bëjë me verifikimin e "mjaftueshmërisë apo pamjaftueshmërisë profesionale" "kemi tejkalim të rasteve të parashikuara në Kushtetutë për shkarkim nga detyra të gjyqtarit, kur bëhet fjalë për mosmarrje të provimit"; caktimi i afatit deri 10 vjet punë për të dhënë ose jo provim sjell diferencim në të drejta midis gjyqtarëve. Neni 48 si dispozitë kalimtare e ligjit të lartpërmendur vjen në kundërshtim me kërkesat e nenit 45 që rregullon vlerësimin e aftësisë profesionale të gjyqtarëve. Lidhur me pretendimin se neni 48/1 i ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", që përcakton detyrimin e gjyqtarëve të shkallës së parë me përvojë deri në 10 vjet t'i nënshtrohen një provimi kualifikimi profesional, Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar. Nga ana tjetër, ajo ka vlerësuar se pamjaftueshmëria profesionale është koncept më i gjerë se mosmarrja e një provimi. Ky i fundit nuk mund të jetë tregues i vetëm sintetik i vlerësimit të aftësisë profesionale të gjyqtarit. Vlerësimi vetëm i rezultatit të provimit pa marrë parasysh rezultatet në punë të gjyqtarit dhe kontributin e tij teorik e praktik në fushën juridike, është një qëndrim antikushtetues që del tej përmbajtjes së Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata ka konkluduar se paragrafit i tretë i nenit 48 të këtij ligji ku thuhet: "Pavarësisht nga përcaktimi i nenit 27 të këtij ligji, gjyqtarët që nuk e kalojnë provimin, shkarkohen nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë", duhet shfuqizuar (*shih vendimin nr. 59, datë 05.11.1999 të GJK-së*).

42. Përpara Gjykatës është pretenduar se ndalimi i anëtarit të Gjykatës së Kasacionit për të kryer njëkohësisht dhe detyrën e drejtimit të një organizate me karakter shoqëror-ekonomik bie në kundërshtim me dispozitat kushtetuese. Në ligjin "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese"" dhe në ligjin "Për organizimin e drejtësisë(...)" nuk ka ndonjë dispozitë që të parashikojë papajtueshmërinë e funksionit të anëtarit të Gjykatës së Kasacionit me funksione të tjera, siç është në rastin konkret funksioni i presidentit të shoqërisë së lartpërmendur. Në kundërshtim me këtë pretendim Gjykata ka vlerësuar se funksioni i anëtarit të Gjykatës së Kasacionit, ashtu si dhe i gjyqtarëve të tjerë të të gjitha instancave gjyqësore, është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër publik ose privat që sjell fitime. Në këto raste nuk ka rëndësi vetëm fakti nëse fitimet materiale

apo përfitime të llojeve të tjera sigurohen drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, apo thjeshtë ekziston mundësia e përfitimeve të ndryshme. Rëndësi ka që të mos cenohet parimi kushtetues i pavarësisë dhe paanësisë së gjykatës si institucion dhe i çdo gjyqtari të veçantë. Për rrjedhojë, neni 18 i ligjit "Për organizimin e drejtësisë(...)" nuk mund të interpretohet ngushtë, duke pasur parasysh vetëm përfitimet materiale e monetare të drejtpërdrejta në bazë të marrëdhënies së punës. Duke konkluduar se funksioni i anëtarit të Gjykatës së Kasacionit është i papajtueshëm me funksionin e presidentit të shoqatës në fjalë (*shih vendimin nr. 5, datë 15.08.1992 të GJK-së*).

- ***Pavarësia e brendshme institucionale***

43. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të pavarësisë së gjykatës, pasi KLD-ja ka ndërhyrë në dhënien e drejtësisë dhe ka cenuar fuqinë detyruese të vendimeve të formës së prerë, gjatë procedurave dhe vendimmarrjes disiplinore për kërkuesin. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, sipas nenit 135 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat në bazë të parimit të kontrollit të shkallëzuar të vendimeve të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, gjë që do të thotë se përderisa ato janë në fuqi, asnjë organ tjetër shtetëror, duke përfshirë edhe KLD-në, nuk mund t'i prekë. Por, nga ana tjetër, Kushtetuta ka parashikuar në disa norma detyrimin e gjyqtarëve për të respektuar me përpikmëri Kushtetutën, ligjet dhe për të ruajtur paanësinë e figurën e pastër në funksion të dhënies së një drejtësie më bindëse. Nëse konstatohen raste të inkriminimit të gjyqtarëve, akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e figurën e gjyqtarit ose pamjaftueshmëri profesionale, neni 147/6 i Kushtetutës ka ngarkuar KLD-në të mbajë qëndrimet e duhura deri në shkarkimin nga detyra të gjyqtarit. Në çështjen në shqyrtim, KLD-ja ka konstatuar veprime në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës dhe pasojat e rënda të ardhura nga këto veprime duke përcaktuar sipas kompetencës masën disiplinore që duhet marrë. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata edhe për pretendimin se kontrolli nga Inspektorati i ministrit të Drejtësisë vjen në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve, duke rikonfirmuar qëndrimin e saj të mëparshëm të shprehur në vendimin nr.11, datë 27.05.2004 (*shih vendimin nr.12, datë 17.06.2004 të GJK-së*).

44. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të pavarësisë, paprekshmërisë dhe palëvizshmërisë së gjyqtarit, pasi KLD-ja dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e kanë shkarkuar kërkuesin për çështje që lidhen me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga gjyqtari sipas bindjes së tij të brendshme. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim. Sipas saj, ndër të tjera, dispozita kushtetuese përkatëse, që në thelb është edhe një dispozitë e karakterit procedural, ka për qëllim të përcaktojë në mënyrë taksative rastet e vetme të shkarkimit të gjyqtarit. Ekzistenca e këtyre shkaqeve kushtetuese për shkarkim përbën një garanci më shumë për funksionin që ata kryejnë, por edhe për vetë pushtetin gjyqësor që ata përfaqësojnë. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duke vlerësuar si shkak për shkarkim nga detyra të gjyqtarit mënyrën e gabuar të zbatimit të dispozitave materiale e procedurale për çështje konkrete në gjykim, jo vetëm ushtron atribute që nuk i përkasin, por ka ndërhyrë drejtpërsëdrejti në objektivitetin dhe pavarësinë e gjykatës.

Gjyqtari nuk mund të shkarkohet nga detyra për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat objektive dhe subjektive nuk rezulton se veprimet e tij mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapët dhe flagrant me ligjin apo me praktikat unifikuese të gjykatave më të larta (*shih vendimin nr. 11, datë 12.11.2004 të GJK-së*).

2. Gjykatë e paanshme

a. E drejta për gjykim nga një gjykatë e paanshme: Kuptimi, parimet dhe standardet përkatëse[13]

Neni 42, pika 2, i Kushtetutës:

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

1. Gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr.19, datë 04.04.2023, parag. 43; nr.70, datë 17.11.2015; 12, datë 13.04.2007; nr.31, datë 1.12.2005 të GJK-së*). Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë roli i tij në mënyrë esenciale pasiv dhe super partes (*shih vendimet nr. 5, datë 1.03.2018, paragrafi15; nr. 48, datë 22.07.2016; nr. 23, datë 04.11.2008 të GJK-së*).

2. Gjykata merr parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr. 19, datë 04.04.2023, paragrafi 44; nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 12, datë 13.04.2007 të GJK-së*).

[13] Standardet e përmendura në këtë pjesë përfshijnë standardet e evidentuara në jurisprudencën e Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/akteve normave dhe ato nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual.

3. Në kuptim të nenit 42, pika 2, të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili, në thelb, kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimet nr. 10, datë 12.04.2022, paragrafi 10; nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 11, datë 02.04.2008; nr. 16, datë 25.04.2003 të GJK-së*).

4. Gjykata ka çmuar se paragjykimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën kur gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022, paragrafi 29; nr. 70, datë 17.11.2015; nr. 1, datë 25.01.2010; nr. 4, datë 25.02.2009 të GJK-së*).

5. Jurisprudenca e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit. Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykues në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili në këndvështrimin objektiv nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata ka theksuar se "thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një ose më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje" (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022, paragrafi 24; nr. 21, datë 29.04.2010; nr. 48, datë 30.07.1999 të GJK-së*).

6. Lidhur me papajtueshmërinë për shkak të pjesëmarrjes në procedim, në pikën 2 të nenit 15 të KPP-së parashikohet se nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake ose në seancë paraprake për të njëjtin procedim, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë kod. Ky detyrim parashikohet edhe nga neni 17, pika 1, shkronja "e", i KPP-së, sipas të cilit gjyqtari duhet të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë, të parashikuara nga neni 15 i KPP-së. Në këtë drejtim, edhe Gjykata është shprehur se ligji nuk përjashton që gjyqtari, i cili ka shqyrtuar një kërkesë gjatë hetimit paraprak, të shqyrtojë një kërkesë tjetër të të njëjtit lloj ose të një lloji tjetër në të njëjtin procedim, por parimi është që gjyqtari që ka vleftësuar çdo kërkesë të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, ka papajtueshmëri me gjyqtarin që merr pjesë në gjykimin e

çështjes (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022, paragrafi 26; nr. 18, datë 02.04.2012; nr. 40, datë 22.09.2011 të GJK-së*).

7. Mënyra e vlerësimit të provave të administruara në gjykim nga ana e gjyqtarit apo mënyra e interpretimit dhe zbatimit të ligjit jo vetëm që janë çështje që nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues, por ato nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur pretendimin për paanshmëri. Nga ana tjetër, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Gjykata ndërhyn në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësim të fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të ndryshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 71, datë 30.11.2016, paragrafi 20; nr. 62, datë 23.09.2015 të GJK-së*).

b. Precedentë/ raste nga gjykimi kushtetues ku çështja e cenimit të paanësisë është vënë në diskutim[14]

A- JURIDIKSIONI CIVIL

a) Për gjykatat e faktit

- ***Për pjesëmarrjen dhe rolet e gjyqtarit në procedime/gjykime të mëparshme të lidhura***

8. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi dy gjyqtarë, Z.P. dhe Z.S., të cilët kishin shqyrtuar çështjen në apel, kishin marrë pjesë edhe në gjykime të tjera që lidhen me çështjen objekt shqyrtimi. Sipas kërkuesit këto procese kanë pasur lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen në shqyrtim dhe gjyqtarët edhe pse kishin dijeni për këto fakte nuk kanë dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, çështjet ku kanë

[14] Precedentët/rastet nga gjykimi kushtetues të përmendura në këtë pjesë, ku çështja e cenimit të paanësisë është vënë në diskutim, përfshijnë jo vetëm ato të shqyrtuara nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual, por edhe ato nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/akteve normave. Ligjet/aktet normative objekt shqyrtimi ose të referuara në precedentët/rastet nga gjykimi kushtetues janë ato akte që kanë në fuqi në kohën e shqyrtimit të këtyre çështjeve.

marrë pjesë gjyqtarët Z.S. dhe Z.P. janë çështje me palë, objekt e shkak ligjor të ndryshëm nga çështja objekt shqyrtimi në gjykimin kushtetues (*shih vendimin nr. 46, datë 19.07.2016, paragrafët 21-24 të GJK-së*).

9. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi dy prej gjyqtarëve A.N. dhe A.D. kanë marrë pjesë në një gjykim të mëparshëm për të njëjtën çështje, me të njëjtat palë, për të njëjtin objekt dhe shkak ligjor. Gjykata, për sa i përket pretendimit për pjesëmarrjen e gjyqtarit A.D., ka vlerësuar se kërkuesja, në kërkesën e paraqitur më parë në këtë Gjykatë, nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me cenimin e parimit të paanshmërisë nga gjyqtari A.D. Për këtë arsye nuk e ka legjitimuar kërkuesen, pasi nuk ka respektuar afatin 2-vjeçar të parashikuar neni 30, pika 2, i ligjit nr.8577/2000. Lidhur me pretendimin për paanshmërinë e gjyqtarit A.N., që ka qenë anëtar në dy kolegje në Gjykatën e Lartë, Gjykata, duke pasur parasysh karakteristikat e secilit vendim, ka vlerësuar se pjesëmarrja e tij në këto dy gjykime nuk përbën cenim të parimit të paanshmërisë (*shih vendimin nr. 74, datë 22.12.2015, paragrafët 48-55 të GJK-së*).

10. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi gjykata e shkallës së parë ka analizuar në vendim vetëm prova të shkëputura të njërës palë. Gjyqtarja E.Ll., e caktuar rishtas në trupin gjykues për gjykimin në shkallë të parë të çështjes objekt shqyrtimi, ka qenë e ndikuar subjektivisht dhe objektivisht nga pjesëmarrja në trupin e parë gjykues, në dhënien e dy vendimeve të mëparshme, të pranimit të dorëheqjes së gjyqtares B.M; gjyqtarët A.M. dhe Sh.M., të trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë, ishin përjashtuar nga gjykimi i çështjeve penale në ngarkim të kërkuesit dhe nuk mund të merrnin pjesë përsëri në gjykimin e një çështjeje me të njëjtat palë. Gjykata e ka vlerësuar pretendimin të pabazuar për të tria shkaqet. Lidhur me shkakun e parë, ajo ka të bëjë me mënyrën e shqyrtimit të provave, si dhe për mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të ligjit material dhe procedural nga gjykatat e juridiksionit zakonshëm. Pjesëmarrja në gjykimin civil i gjyqtarëve që ishin përjashtuar nga gjykimi penal nuk cenon parimin e paanshmërisë së gjyqtarit, edhe sepse këta gjyqtarë ishin përjashtuar nga shqyrtimi i dy çështjeve penale të mëparshme, në ngarkim të kërkuesit, pra ata nuk ishin investuar më parë, për shkak të përjashtimit të tyre, për shqyrtimin e fakteve penale. Përveç kësaj, kërkuesi nuk paraqiti në kërkesë asnjë argument për rrethana objektive dhe subjektive, të cilat do të çonin në anësinë e dy gjyqtarëve në fjalë lidhur me çështjen objekt shqyrtimi. Edhe për shkakun e tretë, ndryshe nga sa ka parashtruar kërkuesi, vendimet e datës të përmendura në vendim, të pranimit të dorëheqjes së gjyqtares B.M., janë të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, A.M., dhe jo të gjyqtares që ka gjykuar çështjen, E.Ll (*shih vendimin nr.19, datë 25.04.2013, paragrafët36-40 të GJK-së*).

11. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi dy gjyqtarë të trupit gjykues në gjykatën e apelit kishin marrë pjesë e kishin shprehur mendimin e tyre për zgjidhjen e një çështjeje tjetër me të njëjtat palë e me të njëjtat rrethana dhe se çështja objekt shqyrtimi është gjykuar nga tre gjyqtarë

ushtarakë. Gjykata ka konkluduar se pretendimi është i pabazuar. Në lidhje me shkakun e parë, ndër të tjera, ajo ka arsyetuar se fakti se në të dyja çështjet, interpretimi i ligjit nga gjyqtarët është i njëjtë, nuk do të thotë se është cenuar parimi i paanësisë në gjykim. Ky parim cenohet kur gjyqtarët mbajnë qëndrime duke u pozicionuar në favor të njërës ose tjetrës palë, duke shfaqur mendim jashtë veprimtarisë procedurale të çështjes ose kur kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit etj., por jo në rastet kur gjyqtarët, duke zbatuar rregullat procedurale, bëjnë vlerësimin e interpretimin e problemeve juridike duke mbajtur qëndrime të arsyetuara për to, siç kanë vepruar në çështjen konkrete. Lidhur me shkakun e dytë, sipas Gjykatës, parimi i paanësisë nuk është cenuar as nga pjesëmarrja e gjyqtarëve ushtarakë në gjykimin e kësaj çështjeje civile dhe as nga fakti që çështjen e gjykuan gjyqtarë ushtarakë, kur kishte gjyqtarë të tjerë civilë, të cilët nuk e kishin gjykuar atë më parë. Kjo pjesëmarrje është vendosur nga KLD-ja sipas ligjit. Referimi te vendimi i GJEDNJ-së ("Incal kundër Turqisë, RJD 1998 – IV, datë 09.06.1998), nuk është i saktë, pasi ky vendim ka të bëjë me rastet që civilët e akuzuar për vepra penale, gjykohen nga gjyqtarët ushtarakë, kur duhet të gjykohen nga gjyqtarët civilë. Në çështjen në gjykim, gjyqtarët ushtarakë nuk janë ngarkuar të gjykojnë civilët për vepra penale, pra nuk realizojnë funksionin represiv të shtetit, por zgjidhin mosmarrëveshjet midis subjekteve fizike e juridike (*shih vendimin nr.37, datë 15.10.2007 të GJK-së*).

12. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi gjykata e apelit ka vazhduar gjykimin e çështjes edhe pse u kërkua përjashtimi i trupit gjykues për kushtet e njëanshmërisë në gjykim, sipas nenit 72 të KPC-së. Gjykata e ka vlerësuar pretendimin të pabazuar. Sipas saj, në kundërshtim nga sa ka pretenduar kërkuesi, anëtarët e trupit gjykues kanë marrë pjesë më parë në një çështje tjetër, ku ndryshon objekti dhe palët. Në këto rrethana, ata nuk kishin pengesë ligjore që në kuptim të nenit 72 të KPC-së të merrnin pjesë në gjykimin e çështjes konkrete (*shih vendimin nr. 1, datë 16.01.2006 të GJK-së*).

13. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi në gjykimin në apel ka marrë pjesë gjyqtarë që kishin kërkuar të tërhiqeshin nga gjykimi. Ata jo vetëm kanë kërkuar të largohen nga gjykimi, por kanë kryer edhe veprime që kanë vënë në dyshim paanësinë e tyre. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas Gjykatës, ndër të tjera, Gjykata e Apelit Durrës, nuk u shpjegoi palëve arsyet e riparaqitjes në trupin gjykues të ish-relatorit të çështjes. Ajo, gjithashtu, nuk pranoi të verifikonte pretendimet e kërkuesve për pozicionimin paraprak të gjyqtarëve në favor të palës tjetër. Ndryshimi i relatorit nuk ishte i mjaftueshëm për të bindur palët për objektivitetin e gjyqtarëve përderisa ai merrte pjesë përsëri si anëtar i trupit gjykues me të drejtë vote. Këto janë disa nga arsyet që avokatët e kërkuesve kundërshtuan menjëherë pjesëmarrjen e tij dhe kur kjo kërkesë nuk u pranua, ata të bindur për anësinë e gjykatës, kundërshtuan të gjithë përbërjen e trupit gjykues. Të gjitha seancat e tjera u karakterizuan nga një frymë mosbesimi në paanësinë e gjykatës, nxitur nga vetë qëndrimet e gjyqtarëve. Gjykata konkludoi se janë vetë qëndrimet e gjykatës që krijuan te kërkuesit, të paditur në gjykim, dyshimin e përligjur se gjyqtarët

nuk u rezistonin dot ndërhyrjeve e presioneve dhe, si rrjedhojë, nuk përmbushnin garancitë kushtetuese për të qenë të paanshëm në gjykim (*shih vendimin nr.36, datë 29.12.2005 të GJK-së*).

➢ ***Për shkaqe të tjera që lidhen me raportet dhe sjelljen e gjyqtarit***

14. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi gjykatat nuk e kanë shqyrtuar dhe nuk e kanë marrë fare në konsideratë çështjen e keqbesimit, duke treguar njëanshmëri. Gjykata e apelit kishte detyrimin të merrte në shqyrtim kontratën e shitjes me shumicë lidhur midis palëve në proces, si prova më e rëndësishme e çështjes në gjykim. Gjykata e ka vlerësuar të pambështetur këtë pretendim. Sipas saj, për sa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarëve nuk rezulton që kërkuesja të ketë paraqitur ndonjë provë për të mbështetur pretendimin e saj. Për sa i përket paanshmërisë objektive, Gjykata ka vlerësuar se edhe në këtë drejtim nuk ka vend për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarëve të çështjes. Për më tepër që kërkuesja këtë pretendim e lidh me mënyrën e zgjidhjes së çështjes (*shih vendimin nr. 15, datë 11.03.2021, paragrafët 31-36 të GJK-së*).

15. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi në trupin gjykues ka marrë pjesë gjyqtari A.B., bashkëshortja dhe vajza e të cilit janë mikesha të ngushta me dy nga palët e paditura në proces (N.L. dhe A.B.). Ky fakt, sipas kërkuesit, rezulton nga komunikimet e këtyre të fundit në rrjetet sociale. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim haptazi të pabazuar, pasi kërkuesi nuk ka parashtruar ndonjë argument bindës në mbështetje të këtij pretendimi (*shih vendimin nr. 52, datë 24.07.2017, paragrafët 35-37 të GJK-së*).

16. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë, megjithëse gjyqtari relator i çështjes ka kërkuar të heqë dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, kërkesa e tij nuk është pranuar duke cenuar rëndë procesin. Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim. Sipas saj, kryetari i Gjykatës së Apelit, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e gjyqtarit relator për dorëheqje nga gjykimi i çështjes objekt shqyrtimi, ka vendosur në bazë të nenit 72 të KPC-së të mos ta pranojë këtë kërkesë, pasi shkaqet e paraqitura nuk janë të ligjshme. Kërkuesi nuk parashtron argumente kushtetuese në lidhje me mungesën e garancive procedurale të mjaftueshme nga gjykatat dhe as në lidhje me praninë e ndonjë interesi personal të gjyqtarëve në atë proces (*shih vendimin nr.6, datë 16.02.2015 të GJK-së*).

17. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi gjykatat kanë favorizuar palën që ka qenë më e fortë dhe më e afërt me ta, në shkelje edhe të parimit të barazisë. Gjykata ka vërejtur se kërkuesja nuk ka parashtruar argumente kushtetuese në lidhje me mungesën e garancive procedurale të mjaftueshme nga gjykatat dhe as në lidhje me praninë e ndonjë interesi personal të gjyqtarëve në atë proces. Për rrjedhojë, Gjykata ka vlerësuar se pretendimi i kërkueses për cenimin e një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, që lidhet me besueshmërinë e

gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme në perceptimin e publikut, nuk është ngritur në nivel kushtetues (*shih vendimin nr. 42, datë 07.07.2014 të GJK-së*).

18. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi gjyqtarja e vetme, gjatë gjykimit në shkallën e parë, nuk ka qenë e paanshme, pasi i ka marrë të mirëqena provat e paraqitura nga pala tjetër dhe nuk ka kryer një hetim të plotë gjyqësor. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim haptazi të pabazuar. Gjykata, në jurisprudencën e saj të konsoliduar, është shprehur se vlerësimi i provave mbetet një çështje për t'u trajtuar nga vetë gjykatat e zakonshme dhe nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatë. Kjo e fundit mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët dhe mënyrën e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit *(shih vendimin nr.7, datë 27.04.2005 të GJK-së)*. Sipas saj, kërkesa nuk ngre probleme lidhur me ligjshmërinë e marrjes së provave, por vetëm me pamjaftueshmërinë, si dhe me mënyrën e vlerësimin të tyre nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 31, datë 05.07.2011 të GJK-së*).

19. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi gjykata e apelit ka anashkaluar vërtetimin e falsifikuar. Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim. Sipas saj, nuk është i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se gjykata ka qenë e anshme nisur vetëm nga ky pretendim. Ndër të tjera, gjykata ka arsyetuar se shkaku kryesor i rrëzimit të padisë për anulimin e vendimit të Komisionit nga gjykata e apelit nuk kanë qenë problemet e themelit, por mungesa e legjitimimit, pasi kërkuesit nuk i janë drejtuar më parë organit administrativ (*shih vendimin nr. 7, datë 11.03.2008 të GJK-së*).

20. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi në trupin gjykues të Gjykatës së Apelit Korçë ka marrë pjesë një gjyqtar që ka pasur njohje me palën paditëse. Gjykata ka konkluduar se pretendimi është i bazuar. Gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar se nga këndvështrimi i testit subjektiv, kërkuesit nuk kishin vënë në dyshim bindjen e brendshme të gjyqtarit përkatës për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Prandaj, mbetet të shqyrtohet pretendimi nga pikëpamja e testit objektiv. Gjyqtari A.K., anëtar i trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Korçë, i kishte drejtuar kryetarit të kësaj gjykate një kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi. Ky i fundit, me vendimin, datë 27.04.2005, ka rrëzuar kërkesën, duke arsyetuar se shkaqet e ngritura nga gjyqtari nuk janë të bazuara në nenin 72 të KPC-së dhe shprehet se "është për t'u theksuar se paditësi Zh. B. ka njohje me të gjithë gjyqtarët e apelit, si dhe me personelin e administratës. Kjo lidhje ka të bëjë dhe me natyrën e paditësit, me rrethin e madh shoqëror që ka, si dhe me angazhimet dhe punët që kryen." Sipas Gjykatës, nisur nga rrethanat e çështjes, Gjykata e Apelit Korçë, në përbërje të së cilës ka qenë edhe gjyqtari A.K., nuk i ka ofruar palës së paditur (kërkuesve) garancitë e nevojshme që do t'u largonin dyshimin për njëanshmërinë e gjykatës. Përkundrazi, megjithëse një nga anëtarët e trupit gjykues ka kërkuar të heqë dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, kryetari i gjykatës jo vetëm nuk e ka pranuar këtë kërkesë, por ka deklaruar në vendimin e tij edhe njohjet e palës paditëse me

gjyqtarë të kësaj gjykate, veprim ky që vë seriozisht në dyshim paanësinë e kësaj gjykate (*shih vendimin nr. 23, datë 04.11.2008 të GJK-së*).

21. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi të dyja gjykatat kanë disponuar tej kufijve të shqyrtimit të çështjes dhe e kanë zgjidhur mosmarrëveshjen midis palëve duke u shprehur edhe për ato që nuk janë kërkuar nga pala paditëse. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Ajo ka theksuar se të dyja pretendimet që kanë të bëjnë me shkeljen e parimit të disponibilitetit dhe të barazisë së armëve në proces, janë trajtuar gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese, si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në gjykimet kushtetuese të kësaj natyre, kur janë konstatuar raste të tejkalimit nga ana e gjykatave të kërkesave të parashtruara në një padi, apo të vendosjes së njërës palë në një pozitë të disfavorshme në raport me palën tjetër, ndërkohë që kjo pabarazi është reflektuar edhe në arsyetimin në mënyrë të njëanshme të argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, ato janë konsideruar nga Gjykata si elemente thelbësore që prekin parimin e paanësisë në gjykim dhe cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së. Në rastin konkret, sipas Gjykatës, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit nuk e kanë respektuar parimin e paanësisë në gjykim, pasi të dyja gjykatat kanë disponuar tej kufijve të shqyrtimit të çështjes dhe e kanë zgjidhur mosmarrëveshjen midis palëve duke u shprehur edhe për ato që nuk janë kërkuar nga pala paditëse. Gjykata e shkallës së parë e ka detyruar kërkuesin të bëjë kalimin e pronësisë dhe regjistrimin e apartamenteve në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ndërkohë që një gjë e tillë nuk rezulton e kërkuar shprehimisht nga paditësi. Ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë ka detyruar palën e paditur të paguajë fitimin e munguar për të gjithë paditësit dhe për dy prej tyre edhe kushtin penal, por nuk arsyeton dhe nuk argumenton se në çfarë dispozite ligjore është bazuar për marrjen e një vendimi të tillë, megjithëse një kërkesë e tillë ishte rrëzuar e argumentuar nga gjykata e shkallës së parë me arsyetimin e ekzistencës së gjendjes së jashtëzakonshme. Në vendimin e saj, gjykata e apelit, nuk u jep përgjigje argumenteve të parashtruara në kërkesën ankimore nga pala e paditur, duke krijuar dyshime se ajo në zgjidhjen e kësaj çështjeje ka qenë e njëanshme. Në rastin në shqyrtim, vendimi i gjykatës së apelit merret vetëm me pretendimet e palës paditëse dhe nuk arsyeton për t'i rrëzuar si të pambështetura në ligj dhe në prova argumentet e kërkuesit (*shih vendimin nr. 20, datë 02.07.2003 të GJK-së*).

b) Për Gjykatën e Lartë

- ***Për pjesëmarrjen dhe rolet e gjyqtarit në procedime/gjykime të mëparshme në gjykatat e faktit***

22. Në një rast përpara Gjykatës, për respektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, nga subjekti i interesuar është pretenduar se tre nga anëtarët e Gjykatës nuk duhet të marrin pjesë në gjykimin e kësaj çështjeje, pasi dy nga gjyqtarët kanë marrë pjesë

në dy gjykime të lidhura, në apel dhe në Gjykatën e Lartë, dhe gjyqtari i tretë ka konflikt interesi në shqyrtimin e kësaj çështjeje, pasi ka lidhje të ngushtë me avokatin e kërkueses. Gjykata, në lidhje me mospjesëmarrjen e njërit prej gjyqtarëve, pas kërkesës së bërë nga ky gjyqtar, vendosi pranimin e kërkesës për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes. Lidhur me kërkesën për përjashtimin e dy gjyqtarëve të tjerë, Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës, duke e vlerësuar të pambështetur. Ajo mori në konsideratë situatën që mund të krijohet në qoftë se disa anëtarë të tjerë të Gjykatës nuk marrin pjesë në shqyrtimin e çështjes sipas kërkesës së subjektit të interesuar. Përjashtimi i gjyqtarëve do të çonte në mosarritjen e numrit të nevojshëm për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare (kuorumit) nga Gjykata, duke bllokuar shqyrtimin e kësaj çështjeje dhe, për rrjedhojë, ajo do të bllokohej për të vazhduar shqyrtimin e saj (*shih vendimin nr. 5, datë 01.03.2018, paragrafët 14-18 të GJK-së*).

23. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi dy nga gjyqtarët A.M. dhe M.B., pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen në Gjykatën e Lartë, kanë dhënë më parë vendime ku palë ka qenë subjekti i interesuar E. K. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Ndër të tjera, Gjykata ka vlerësuar se vendimet e pretenduara nga kërkueset janë marrë në përfundim të proceseve gjyqësore që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata dhe vlerësime të ndryshme të gjyqtarëve. Për këto arsye, pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në dy vendimet e dhëna për rrethana të ndryshme të çështjes nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme. I njëjti qëndrim është mbajtur edhe në një rast të ngjashëm të mëparshëm *(shih vendimin nr. 22, datë 20.05.2013 të GJK-së).* Lidhur me pretendimin tjetër për pretendimin e cenimit të parimit të paanësisë nga gjyqtari M.B., i cili ka marrë pjesë në dy gjykime në dhomë këshillimi në Gjykatën e Lartë, ku kërkueset kanë qenë palë, Gjykata ka vlerësuar se çështjet, në shqyrtimin e të cilave në dhomë këshillimi, ka marrë pjesë gjyqtari M.B. janë të ndryshme dhe nuk krijojnë dyshime për cenimin e parimit të paanësisë gjatë procesit gjyqësor (*shih vendimin nr. 6, datë 02.03.2018, paragrafët 11-21 të GJK-së*).

24. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi relatorja e çështjes (gjyqtarja M.F.) në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë duhej të jepte dorëheqjen, pasi ka gjykuar çështjen e themelit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjyqtarja M.F. nuk jepte garanci për paanshmëri në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për arsye se gjatë gjykimit në shkallë të parë ajo ka marrë vendime të ndërmjetme që kanë të bëjnë me thelbin e procesit, si dhe ka marrë në shqyrtim prova të paraqitura nga palët. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas Gjykatës, ndër të tjera, gjyqtarja M.F. ka zhvilluar, gjithsej, 8 seanca gjyqësore nga 11 të planifikuara, gjatë të cilave ajo ka marrë vendime të ndërmjetme në lidhje me kërkesat e palëve dhe provat e paraqitura nga palët, prova mbi të cilat është zhvilluar edhe debati gjyqësor. Nga analiza e fakteve Gjykata ka konstatuar se gjyqtarja M.F. nuk ka dhënë vendim dhe nuk është shprehur për zgjidhjen e çështjes së themelit, për shkak të dorëheqjes së saj përpara përfundimit të hetimit gjyqësor. Kërkuesi nuk

ka sjellë argumente të mjaftueshme dhe bindëse në mbështetje të këtij pretendimi (*shih vendimin nr. 11, datë 03.03.2016, paragrafët 23-29 të GJK-së*).

25. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi gjyqtari A.B., edhe pse hoqi dorë nga gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë, përsëri ka marrë pjesë në shqyrtimin e rekursit në Gjykatën e Lartë dhe ka vendosur mospranimin e tij në dhomën e këshillimit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Ndër të tjera, ajo ka vlerësuar se dorëheqja e gjyqtarit A.B. dhe vendimmarrja e trupit gjykues për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit janë fakte të cilat justifikojnë dyshimin e kërkuesve. Në këtë kuptim, ky dyshim është i bazuar nga pikëpamja objektive, për sa kohë gjyqtari A.B. si pjesë e Kolegjit Civil ka shqyrtuar pretendime që lidheshin me parregullsinë e procesit të zhvilluar në Gjykatën e Apelit, ku vetë më parë ishte dorëhequr dhe përjashtuar. Dyshimi i kërkuesve mund të konsiderohet mjaftueshëm i bazuar për të vënë në diskutim vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë nga këndvështrimi i respektimit të standardeve kushtetuese (*shih vendimin nr.16, datë 10.03.2016, paragrafët 32-37 të GJK-së*).

26. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi gjyqtari A.B., anëtar i Kolegjit Civil, që ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, ka gjykuar një çështje tjetër civile me palë paditëse subjektet e interesuara në gjykimin kushtetues dhe të paditur Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*AKKP*), Tiranë, me objekt shfuqizimin e vendimit nr.200, datë 04.09.2007 të drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Gjykata ka konstatuar se gjyqtari A.B. ka gjykuar në themel çështjen lidhur me shfuqizimin e vendimit nr.200, datë 04.09.2007 të drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, duke vendosur shfuqizimin e këtij vendimi, për rrjedhojë konfirmimin e ligjshmërisë së vendimit nr.321, datë 16.09.2000 të Komisioni i Kthimit dhe Kopensimit të Pronave (*KKKP*) Tiranë. Gjithashtu, ajo ka konstatuar se bazuar në materialet e dosjes subjektet e interesuara F.Ll. etj. i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për gjykimin e çështjes me procedurë të përshpejtuar për shkak se zvarritja e mëtejshme e çështjes do të sillte dëm ekonomik. Në vijim të kësaj shkrese gjyqtari relator A.B., me shkresën drejtuar kryetarit të Gjykatës së Lartë është shprehur se "çështja përfshihet në ato raste për t'u gjykuar me procedurë të përshpejtuar, për faktin se paditësi është njohur pronar për sipërfaqen objekt konflikti dhe për më tepër i është dhënë dhe e drejta e parablerjes të këtyre objekteve dhe zgjatja e mëtejshme e gjykimit do të bënte që subjektet e interesuara të humbasin të drejtat e fituara me vendim të KKKP-së". Gjykata, bazuar në rrethanat e mësipërme të çështjes konkrete dhe në standardet e përcaktuara në jurisprudencën kushtetuese për parimin e paanësisë, ka vlerësuar se pjesëmarrja e gjyqtarit A.B. në dhënien e vendimit nr.364, datë 24.01.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe në dhënien e vendimit nr.00-2015-2565, datë 16.07.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), nuk ka garantuar respektimin e parimit të paanësisë dhe ka krijuar dyshime në këndvështrimin e testit objektiv të këtij parimi (*shih vendimin nr. 46, datë 19.07.2016, paragrafët 22-33 të GJK-së*).

27. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi njëri prej gjyqtarëve në përbërje të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë edhe në trupin gjykues që ka gjykuar çështjen në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Ajo ka konstatuar nga vendimet gjyqësore bashkëlidhur kërkesës, se gjyqtari A.B. ka qenë në përbërje të trupit gjykues i cili ka shqyrtuar çështjen në themel në Gjykatën e Apelit Tiranë (vendimi nr. 240, datë 01.02.2012) dhe në përbërje të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi kundër këtij vendimi. Gjykata ka vlerësuar se është e papranueshme që një gjyqtar që ka marrë pjesë në dhënien e një vendimi në një shkallë të mëparshme të gjykimit të jetë sërish në përbërje të Kolegjit të Gjykatës së Lartë që do të shqyrtojë e vlerësojë shkaqet e rekursit që janë kundër këtij vendimi. Për këtë arsye, pjesëmarrja e gjyqtarit A.B. duhej të ishte mënjanuar nga përbërja e Kolegjit Civil të mbledhur për shqyrtimin e rekursit të kërkuesit. Vetë kërkuesi nuk e ka pasur mundësinë që të kërkonte përjashtimin e gjyqtarit nga trupi gjykues në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, pasi ai nuk ka qenë i pranishëm (*shih vendimin nr. 54, datë 20.07.2015, paragrafët 13-21 të GJK-së*).

28. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, për arsye se në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë kanë marrë pjesë në trupin gjykues dy gjyqtarë, të cilët më parë, në ushtrimin e funksionit të anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (*KKRT*), kanë marrë pjesë në vendimmarrje që lidhen me subjektin e interesuar, shoqëria "Media +" sha (TV Shijak). Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Ndër të tjera, ajo ka vlerësuar se, për sa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarëve F.L. dhe A.Z., pra bindjes së brendshme të tyre për mënyrën e zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk rezulton që kërkuesit të kenë paraqitur ndonjë provë për të vërtetuar këtë pretendim, ndaj ajo prezumohet. Për sa i përket paanshmërisë objektive, duhet shqyrtuar nëse dyshimi i ngritur nga kërkuesi është mjaftueshmërisht i provueshëm dhe ky përfundim varet nga rrethanat e çështjes konkrete. Gjykata ka vlerësuar se qëllimi dhe natyra e veprimeve që dy anëtarët e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë kanë kryer gjatë ushtrimit të funksionit të anëtarit të KKRT-së, nuk janë të tilla që të venë në dyshim paanshmërinë e tyre. Ata nuk rezultojnë që të kenë manifestuar më parë bindjen e tyre, brenda të njëjtit procedim apo që në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të jenë shprehur mbi të njëjtat çështje, të cilat janë bërë më parë objekt i shqyrtimit nga KKRT-ja, gjatë kohës që ata kanë ushtruar detyrën e anëtarit të këtij organi (*shih vendimin nr. 27, datë 9.05.2014, paragrafët 17-23 të GJK-së*).

29. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, për arsye se në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka marrë pjesë në trupin gjykues një gjyqtar (G.Z.), i cili më parë ka ushtruar funksionin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit dhe, në ushtrimin e këtij funksioni, ka vënë në lëvizje procedimin administrativ që ka cenuar të drejtat e kërkuesve. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në ushtrimin e funksionit të Avokatit të Shtetit ky gjyqtar e ka manifestuar bindjen e tij brenda të njëjtit procedim dhe, si përfaqësues i interesave pasurorë të shtetit, ka mbrojtur interesa të kundërta me ato

të kërkuesit. Për pasojë, qëllimi dhe natyra e veprimeve që ai ka kryer gjatë procedimit administrativ janë të tilla që venë në dyshim paanshmërinë e tij. Në rastin konkret, pjesëmarrja e gjyqtarit G.Z. në trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen në Gjykatën e Lartë, ndërkohë që objektivisht kanë ekzistuar mundësitë për shmangien e tij nga gjykimi, ka krijuar një dyshim të justifikuar të kërkuesit, se vendimi i dhënë nuk ka qenë produkt i një procesi të paanshëm (*shih vendimin nr. 25, datë 11.06.2013, paragrafët 10-17 të GJK-së*).

30. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi dy nga gjyqtarët, që kanë shqyrtuar çështjen në Gjykatën e Lartë në dhomën e këshillimit kishin shprehur më parë mendim për themelin e kësaj çështjeje, duke u vënë në kushtet e papajtueshmërisë, në kuptim të nenit 72/4 të KPC-së. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, nisur nga natyra e vendimit nr. 229, datë 23.12.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, gjyqtarët që kanë dhënë këtë vendim, duke përfshirë këtu edhe gjyqtaren për të cilin ngrihet pretendimi për anësi në gjykim, nuk kanë dhënë mendim për zgjidhjen e themelit të çështjes. Për gjyqtaren tjetër, e cila ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilin është vendosur vërtetimi i faktit juridik i qenies pronar i M. B. për pronën objekt gjykimi, ashtu edhe në përbërjen e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që, në dhomën e këshillimit, ka dhënë vendimin e kundërshtuar, Gjykata ka vlerësuar se gjykimi, mbi bazë të së cilit është dhënë ky vendim, ka qenë një gjykim pa palë kundërshtare, pra një gjykim jokontencioz, i mbështetur në nenet 388-392 të KPC-së. Për pasojë, vendimi gjyqësor që është dhënë në përfundim të këtij gjykimi është thjesht deklarativ, i cili, në bazë të nenit 391 të KPC-së ka fuqi provuese vetëm për kërkuesin dhe jo për personat e tjerë që nuk janë thirrur në këtë gjykim. Për këtë arsye, gjyqtarja, për të cilin ngrihet pretendimi i paanësisë në gjykim në dhënien e këtij vendimi, nuk ka shprehur mendim për çështjen në gjykim, në të cilin është dhënë vendimi nr. 1177, datë 16.10.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt i kundërshtimit kushtetues (*shih vendimin nr.22, datë 06.06.2011 të GJK-së*).

31. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi tre gjyqtarë të kësaj gjykate që përbënin dhomën e këshillimit, kanë marrë pjesë në dy gjykime me palë të njëjta. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, tre nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, që kanë shqyrtuar në gjykimin e parë rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar, kanë konkluduar se ai legjitimohej për të ngritur padinë, kanë prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, për këtë arsye, e kanë dërguar çështjen për rigjykim pranë po asaj gjykate. Po këta gjyqtarë, në gjykimin e dytë, kanë shqyrtuar dhe kanë konkluduar për mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila rigjykoi çështjen. Gjykata ka vlerësuar se, pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve të kërkuesit në të dy gjykimet, ato lidhen me shqyrtimin e të njëjtit fakt, me të njëjtët subjekte, pra me të njëjtin konflikt gjyqësor *(shih vendimin nr. 1, datë 25.01.2010 të GJK-së)*. Në një rast të ngjashëm, ku është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi një gjyqtare që ka marrë pjesë në Gjykatën e Lartë në shqyrtimin e rekursit, në një

kohë kur po kjo gjyqtare ka qenë pjesëmarrëse, për më tepër relatore në Gjykatën e Apelit Tiranë, në shqyrtimin e çështjes, Gjykata ka mbajtur të njëjtin qëndrim. Sipas saj, në gjykatën e apelit, gjyqtarja nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin e themelit të çështjes, por për kërkesën për ndreqjen e gabimit material. Në këto kushte, nuk vërtetohen rastet e cenimit të paanësisë së gjyqtarit e, për pasojë, shkaku për përjashtimin e tij sipas neneve 72-74 të KPC-së (*shih vendimin nr. 16, datë 13.07.2005 të GJK-së*).

32. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi një nga gjyqtarët që ka marrë pjesë si anëtare e trupit gjykues në këtë gjykatë, ka marrë pjesë dhe në gjykimin në apel. Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim. Sipas saj, gjyqtarja e pretenduar ka marrë pjesë në përbërjen e trupit gjykues në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë, ku është vendosur mospranimi i kërkesës së kërkuesve për mungesë të shkaqeve ligjore të parashikuara në nenin 472 të KPC-së, ndërsa në gjykatën e apelit ajo ka marrë pjesë në gjykimin e datës 03.10.2002, kur është pranuar ankesa e kërkuesve kundër vendimit të gjykatës së rrethit dhe, për mangësi procedurale, është prishur ky vendim e çështja është dërguar për rigjykim në atë gjykatë. Në gjykimin nga gjykata e apelit, kjo gjyqtare nuk ka qenë në përbërje të trupit gjykues (*shih vendimin nr. 7, datë 11.03. 2008 të GJK-së*).

33. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, për arsye të pjesëmarrjes në kolegjin seleksionues të gjyqtarëve që kanë gjykuar më parë çështjen si dhe të caktimit të relatorit me short nga gjyqtarët që nuk kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjes. Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim. Sipas saj, ndër të tjera, mospjesëmarrja në shqyrtimin e ankimeve të vendimeve të gjyqtarëve të shkarkuar nga detyra në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e disa anëtarëve të kësaj gjykate, të cilët kanë marrë pjesë dhe kanë votuar më parë me cilësinë e anëtarit në mbledhjet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është një çështje paanshmërie që nuk duhet konfonduar me rastet e papajtueshmërisë ndërmjet funksioneve. Interpretimi që u është bërë dispozitave kushtetuese lidhur me parimin e paanësisë në gjykim nga Gjykata dhe respektimi i këtij parimi, nuk duhet të keqkuptohet dhe as të bëhet shkak që çështjet, të cilat paraqiten për shqyrtim pranë Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të mbeten pa u gjykuar me arsyetimin se shkelet parimi i paanësisë në gjykim dhe cenohet procesi ligjor. Parimi i paanësisë në gjykim është i detyrueshëm të respektohet dhe zbatohet nga çdo organ gjyqësor, por kjo nuk duhet të krijojë pamundësi në marrjen e vendimit dhe krizë institucionale për organin gjyqësor, siç janë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili është i vetëm në ushtrimin e kësaj kompetence dhe që detyrë primare ka përmbushjen e funksionit të tij kushtetues (*shih vendimin nr. 15, datë 07.04.2000 të GJK-së*).

➢ *Për pjesëmarrjen dhe rolet e gjyqtarit në procedime/gjykime të mëparshme në Gjykatën e Lartë*

34. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, për shkak të pjesëmarrjes së disa prej gjyqtarëve

të Gjykatës së Lartë në trupin gjykues që ka vendosur për vendimin e pezullimit të ekzekutimit dhe për themelin e kërkesës për rishikim, përmes të cilit është vendosur prishja e vendimit të saj dhe atij të gjykatës së apelit dhe çështja e themelit është kthyer për rigjykim pranë kësaj të fundit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të haptazi të pabazuar. Sipas saj, këto vendime janë marrë në përfundim të proceseve gjyqësore që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata dhe vlerësime të ndryshme të gjyqtarëve (*shih vendimin nr. 11, datë 10.03.2023, paragrafët 33 të GJK-së*).

35. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, për shkak se në dy vendime të Gjykatës së Lartë, që i referohen kësaj çështjeje, në trupin gjykues ka marrë pjesë i njëjti gjyqtar B.I., i cili ka qenë në të dyja rastet edhe kryesues i Kolegjit Civil. Po ashtu, sipas kërkuesve, duke qenë "romë" ata janë ndjerë inferiorë përpara trupës gjykues të Kolegjit Civil, që ka mbajtur ndaj tyre një qëndrim dukshëm të njëanshëm. Gjykata e ka vlerësuar pretendimin të pabazuar për të dyja shkaqet. Lidhur me shkakun e parë, ndër të tjera, ajo ka vlerësuar se fakti i thjeshtë që gjyqtari B.I. ka qenë pjesë e Kolegjit Civil, në të dyja vendimmarrjet, nuk mjafton për të mbështetur objektivisht dyshimet e kërkuesve, në kushtet kur ai nuk e kishte manifestuar bindjen e tij brenda të njëjtit procedim dhe qëllimi dhe natyra e veprimeve që ka kryer gjatë procesit gjyqësor nuk janë të tilla që të vënë në dyshim paanshmërinë e tij. Lidhur me shkakun e dytë Gjykata ka vlerësuar se ai është haptazi i pabazuar, pasi kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë provë për ta mbështetur atë (*shih vendimin nr. 2, datë 22.01.2014, paragrafët 23-30 të GJK-së*).

36. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi tre nga gjyqtarët që kanë marrë pjesë në dhomën e këshillimit, ku është vendosur kalimi i çështjes për gjykim, kanë qenë në trupin gjykues të seancës gjyqësore. Një anëtare e trupit gjykues, e cila është shprehur kundër kalimit të çështjes për gjykim, pa ndonjë arsye, është zëvendësuar me një gjyqtar tjetër. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, duke iu referuar jurisprudencës së saj, sikundër për pranimin ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsyetimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri paraprak në vlerësimin e kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Sigurisht, që palët përpara këtij trupi gjykues, në një numër të madh rastesh *prima facie* i plotësojnë formalisht kriteret që kërkesa e tyre të shkojë në seancë gjyqësore, por kjo nuk mund ta deformojë funksionin vlerësues të dhomës së këshillimit. Ajo ka vlerësuar se pjesëmarrja e tre gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në kolegjin seleksionues e, më pas, edhe në vendimmarrjen përfundimtare, nuk përbën cenim të parimit të paanësisë gjatë gjykimit. Lidhur me pretendimin për mosmarrjen pjesë të gjyqtares, e cila ishte shprehur kundër kalimit të çështjes për shqyrtim gjatë seancave gjyqësore, vlerëson se është i pabazuar, pasi zëvendësimi i gjyqtares është bërë në përputhje me dispozitat e KPC-së, sipas procedurave të shortit dhe sipas grafikut të çështjeve (*shih vendimin nr. 58, datë 05.12.2014, paragrafët 25-29 të GJK-së*).

37. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi katër nga gjyqtarët, në përbërje të Kolegjit

Civil, që ka vendosur mospranimin e rekursit, kanë marrë pjesë edhe në Kolegjin Civil që me vendimin nr.483, datë 18.12.2008, ka vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë, me po të njëjtat palë ndërgjyqëse. Është pretenduar se njëri prej gjyqtarëve në përbërje të Kolegjit Civil ka marrë pjesë edhe në Kolegjin Penal që ka dhënë vendimin nr.77, datë 20.02.2009 (dhomë këshillimi), kurse dy gjyqtarë të tjerë kanë qenë pjesë e Kolegjit Civil që ka vendosur pranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1873, datë 10.07.2008. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Gjykata ka ritheksuar se Kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, është organi që analizon dhe vlerëson nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t'u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsyetimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri paraeliminator të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Nisur nga karakteristikat e shqyrtimit të rekursit në dhomë këshillimi, ajo ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë janë të pabazuara. Gjithashtu, ajo ka vlerësuar se vendimet e pretenduara nga kërkuesi janë marrë në përfundim të proceseve gjyqësore që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata dhe vlerësime të ndryshme të gjyqtarëve. Në këto kushte, pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në dy vendimet e dhëna për rrethana të ndryshme të çështjes, nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme (*shih vendimin nr. 22, datë 20.05.2013 të GJK-së*).

38. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, pasi i njëjti gjyqtar që ka shqyrtuar ankimin e paraqitur nga kërkuesi kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe është shprehur për themelin e kësaj çështjeje (edhe pse ky vendim është prishur më pas nga Gjykata e Lartë dhe çështja është kthyer për rigjykim), ka marrë pjesë edhe në Kolegjin Civil që ka shqyrtuar kërkesën për rishikim për të njëjtën çështje gjyqësore. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve të kërkuesit në të dyja gjykimet, ato lidhen me shqyrtimin në fakt të së njëjtës çështje gjyqësore dhe pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në dy vendimet e dhëna për të njëjtat rrethana të pretenduara (ndërkohë që objektivisht kanë ekzistuar mundësitë për shmangien e tij nga gjykimi) ka krijuar një dyshim të justifikuar te kërkuesi, se vendimi i dhënë ka qenë produkt i një procesi të dyshuar si i njëanshëm (*shih vendimin nr. 7, datë 07.03.2011 të GJK-së*).

39. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, për arsye se i njëjti gjyqtar i Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë si në kolegjin që ka shqyrtuar rekursin e paraqitur prej tij, ashtu dhe në kolegjin që ka shqyrtuar kërkesën për rishikim. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, fakti i pranisë së të njëjtit gjyqtar në të dyja këto kolegje të Gjykatës së Lartë, nuk sjell *apriori* cenim të parimit të paanshmërisë. Bazuar në dispozitat procedurale që rregullojnë procedurat e rekursit dhe kërkesës për rishikim, Kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, verifikon legjitimitetin e kërkuesit, bazueshmërinë në ligj

të ankimit, si dhe praninë e kritereve ligjore për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Gjyqtarit që shqyrton, në dhomë këshillimi, nëse kërkesa për rishikim plotëson ose jo kriteret ligjore, nuk i duhet të përshkojë të njëjtin itinerar logjik, të ndjekur më parë prej tij, gjatë shqyrtimit në dhomë këshillimi të plotësimit ose jo të kërkesave ligjore nga rekursi i paraqitur nga i njëjti kërkues. Pjesëmarrja e së njëjtës gjyqtare në dy Kolegje të Gjykatës së Lartë, që kanë vendosur në dhomë këshillimi për kërkesat e paraqitura nga kërkuesi, nga pikëpamja e testit objektiv, nuk përbën shkak për të vënë në dyshim paanshmërinë e kësaj gjyqtareje në gjykimin e kërkesës për rishikim (*shih vendimin nr.36, datë 26.07.2011, paragrafët 25-33 të GJK-së*). Në një rast të ngjashëm të mëparshëm, Gjykata ka mbajtur qëndrim të ndryshëm duke vlerësuar se pretendimi ishte i bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, dy nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilët kanë shqyrtuar rekursin e paraqitur nga kërkuesi dhe kanë konkluduar për drejtësinë e vendimit të gjykatës së apelit, që ka rrëzuar padinë e kërkuesit, kanë shqyrtuar dhe kanë konkluduar edhe për mospranimin e kërkesës për rishikim të vendimit, të dhënë prej tyre. Gjykata ka vlerësuar se, pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve të kërkuesit në të dyja gjykimet, ato lidhen me shqyrtimin në fakt të së njëjtës çështjeje gjyqësore (*shih vendimin nr. 4, datë 25.02.2009 të GJK-së*).

40. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi në rigjykimin e çështjes në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë si relator i njëjti gjyqtar që ka marrë pjesë si i tillë edhe në gjykimin e mëparshëm në atë kolegj. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas Gjykatës, në vendimin e mëparshëm të Kolegjit është arsyetuar, ndërmjet të tjerave, për problemet e themelit të çështjes që kishin të bënin me zbatimin e ligjit të kohës së lindjes së marrëdhënies juridike apo të kohës së gjykimit të çështjes, me interpretimin e përmbajtjes së këtyre normave, me juridiksionin e gjykatës për shqyrtimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ të birësimit etj. Këto probleme janë diskutuar përsëri në rigjykimin e çështjes në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë. Në rastin në shqyrtim, çështja jo vetëm është shqyrtuar në dy rastet në seancë gjyqësore, me të njëjtin relator, por janë trajtuar të njëjtat probleme të themelit të çështjes. Kjo ka krijuar shqetësimin e kërkuesit për mungesën e garancive të mjaftueshme për paanësinë e gjykatës, aq më tepër, që vendimi është marrë me shumicë të thjeshtë votash. Prandaj, heqja dorë e relatorit nga gjykimi ishte e domosdoshme si për interesin e drejtësisë, ashtu edhe të palëve në gjykim (*shih vendimin nr. 17, datë 30.04.2007 të GJK-së*).

41. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi vendimi i dhënë nga Kolegjet e Bashkuara vjen në kundërshtim me një vendim të mëparshëm unifikues të këtyre Kolegjeve. Gjykata e ka vlerësuar haptazi të pabazuar këtë pretendim. Sipas saj, ky pretendim nuk ka të bëjë me njëanshmërinë e gjykatës. Zbatimi i ligjit dhe unifikimi i praktikës gjyqësore është në diskrecionin e Gjykatës së Lartë. Koherenca e vendimeve të kësaj Gjykate është një aspekt i besueshmërisë në këto vendime, por shmangia e kësaj Gjykate, në ndonjë rast, nga praktika e saj e unifikuar, nuk mund të interpretohet si shkelje e standardit të paanshmërisë së gjykatës. Kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë rrethanë tjetër, që vë në

dyshim paanshmërinë e Gjykatës së Lartë në aspektin objektiv dhe subjektiv, rrethana, që në vija të përgjithshme, përshkruhen në nenin 72 të KPC-së (*shih vendimin nr. 18, datë 03.05.2007 të GJK-së*).

42. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi në përbërje të trupit gjykues të gjykatës që ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit ka marrë pjesë edhe një gjyqtar, i cili në gjykimin e mëparshëm të po kësaj çështje në Gjykatën e Lartë, është shprehur me "mendim pakice", gjë që, sipas tij, bie në kundërshtim me nenin 72/4 të KPC-së. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në dhomën e këshillimit trajtohet vetëm prania ose jo e shkaqeve të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Nëse konstatohet ndonjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 472 të KPC-së, vendoset pranimi i rekursit dhe gjykimi i çështjes në kolegj në seancë të rregullt gjyqësore, ku çështja trajtohet në themel, pra bëhet kontrolli i plotë i bazueshmërisë në ligj i vendimeve të atakuara në rekurs. Duke pasur parasysh se trajtimi i çështjes në dhomën e këshillimit nuk përmban në vetvete të gjitha karakteristikat e një gjykimi, në kuptim të nenit 72 të KPC-së, në rastin konkret nuk mund të pretendohet për shkelje të parimit të paanshmërisë, pra për një proces të parregullt ligjor (*shih vendimin nr. 16, datë 25.04.2003 të GJK-së*).

➢ *Për shkaqe të tjera që lidhen me raportet dhe sjelljen e gjyqtarit*

43. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi çështja e tyre është shqyrtuar jashtë radhës në Gjykatën e Lartë, në më pak se 90 ditë, pa pasur kërkesë për përshpejtimin e saj. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, për sa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarëve, nuk rezulton që kërkuesit të kenë paraqitur ndonjë provë për të mbështetur pretendimin e tyre. Periudha e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë nuk është fakt i mjaftueshëm për të mbështetur pretendimin për paanshmëri, në kuptimin subjektiv, për më tepër që rezulton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me anë të rekursit të ushtruar nga vetë kërkuesit. Për sa i përket paanshmërisë objektive, Gjykata ka vlerësuar se edhe në këtë drejtim nuk ka vend për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarëve të çështjes. Pretendimet e kërkuesve për cenimin e këtij parimi nuk kanë qenë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ka pasur njëanshmëri të gjykatës në shqyrtimin e çështjes, pasi kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë provë tjetër për të mbështetur këtë pretendim (*shih vendimin nr. 2, datë 11.02.2021, paragrafët 40-42 të GJK-së*).

44. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, për arsye se Gjykata e Lartë e ka bazuar vendimin në argumente që nuk janë parashtruar nga subjekti i interesuar, siç është parimi i mirëbesimit kontraktor, mbi të cilat kërkueset nuk kanë pasur mundësi të shprehen. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata ka vlerësuar se argumentet e paraqitura nga kërkueset nuk janë ngritur në nivel kushtetues që të shqyrtohen prej saj (*shih vendimin nr. 30, datë 19.05.2016 të GJK-së*).

45. Në disa raste përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, për arsye se gjykata ka favorizuar palën tjetër në gjykim. Gjykata, në kushtet kur nuk janë sjellë argumente në mbështetje të këtij pretendimi, ka vlerësuar se ai nuk është ngritur në nivel kushtetues (*shih vendimet nr.44, datë 29.06.2015; nr. 42, datë 07.07.2014 të GJK-së*).

46. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi gjatë procesit gjyqësor civil, Gjykata e Lartë ka analizuar në mënyrë të njëanshme vetëm shkaqet dhe provat e paraqitura nga pala e paditur dhe, duke cenuar parimin e kontradiktoritetit, ka anashkaluar aktet dhe vendimet e formës së prerë të palës paditëse, madje ka deformuar përmbajtjen e tyre. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim haptazi të pabazuar. Sipas saj, argumentet e parashtruara nga kërkuesi kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe të zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë. Ajo ka çmuar se mungojnë argumentet kushtetuese për të ngritur në nivel kushtetues pretendimet për cenimin e parimit të paanshmërisë. Gjithashtu, është pretenduar cenimi i parimit të paanësisë në gjykim, së pari, edhe për faktin se në përbërje të Kolegjit Civil që ka zgjidhur çështjen në themel, duke ndryshuar dy vendimet gjyqësore, kanë qenë edhe tre nga gjyqtarët që kanë vendosur në dhomë këshillimi kalimin e rekursit për shqyrtim në seancë plenare dhe, së dyti, për faktin se në vendimin përfundimtar, emri i gjyqtari M.B., i cili ka qenë në përbërje të Kolegjit Civil që ka shqyrtuar çështjen, nuk përputhet me emrin e gjyqtarit F.L., që ka nënshkruar vendimin. Gjykata edhe këtë pretendim e ka vlerësuar të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, çështja objekt gjykimi nuk ka asnjë karakteristikë të përbashkët me vendimmarrjet e kësaj Gjykate, të cilave u është referuar kërkuesi në kërkesë apo gjatë seancës gjyqësore, raste në të cilat cenimi i parimit të paanshmërisë është konstatuar për faktin se gjyqtarët në ato çështje e kanë shqyrtuar, në themel, çështjen në të dyja kolegjet e Gjykatës së Lartë apo në shkallë të ndryshme. Në rastin konkret, paanshmëria objektive dhe subjektive e tre gjyqtarëve, të cilët kanë qenë njëkohësisht të pranishëm si në dhomë këshillimi, ashtu edhe në seancë gjyqësore, nuk lë shkas për dyshime dhe, për rrjedhojë, frika e kërkuesit mbi njëanshmërinë e tyre gjatë procesit gjyqësor është e paarsyeshme dhe dyshimi i tij nuk mund të konsiderohet mjaftueshmërisht i bazuar për të vënë në diskutim vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë nga këndvështrimi i respektimit të standardeve kushtetuese. Për sa i përket argumentit të dytë të kërkuesit që lidhet me nënshkrimin e vendimit nga një gjyqtar i ndryshëm nga ai që është në përbërje të Kolegjit Civil, Gjykata ka vlerësuar se ai nuk është ngritur në nivel kushtetues (*shih vendimin nr. 7, datë 10.02.2014, paragrafët 33-38 të GJK-së*).

47. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, për arsye se një nga anëtarët e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, ka qenë në kushtet e ndalimit të marrjes pjesë në seancën gjyqësore të shqyrtimit të rekursit, në referim të nenit 72, pika 3, të KPC-së. Ekzistenca e kontratës së kredisë dhe kontratës së hipotekës, të lidhur midis gjyqtares M.F. dhe bashkëshortit të saj, nga njëra anë, dhe bankës NBG-së, nga ana tjetër, fakt për të cilin ai ka marrë dijeni në përfundim

të procesit gjyqësor dhe dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë, përbën shkak objektiv të arsyeshëm për të besuar se gjykimi ka qenë i njëanshëm. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, gjyqtarët në përbërje të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë kanë vendosur, me unanimitet, lënien në fuqi të vendimit nr.154, datë 03.02.2010 të gjykatës së apelit, me arsyetimin, midis të tjerash, se: "Pretendimet e paraqitura në rekurs kanë të bëjnë me analizën e provave që ka bërë gjykata e apelit, prandaj ato nuk përbëjnë objekt shqyrtimi në Gjykatën e Lartë, në bazë të nenit 472 të KPC-së.". Nisur nga kushtet e kontratës së kredisë bankare, e cila nuk rezulton të ketë trajtuar në mënyrë preferenciale kredimarrësit (gjyqtaren M.F. dhe bashkëshortin e saj), gjithashtu, në mungesë edhe të provave të paraqitura nga kërkuesi mbi përfitimin e favoreve nga kredimarrësit për shkak të pozicionit të tyre apo të interesave kredimarrëse, paanshmëria objektive e gjyqtares M.F. nuk lë shkas për dyshime dhe, për rrjedhojë, frika e kërkuesit mbi njëanshmërinë e saj gjatë procesit gjyqësor është e paarsyeshme dhe dyshimi i tij nuk mund të konsiderohet mjaftueshmërisht i bazuar për të vënë në diskutim vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë nga këndvështrimi i respektimit të standardeve kushtetuese (*shih vendimin nr. 41, datë 10.10.2013, paragrafët 7-17 të GJK-së*).

48. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka trajtuar haptazi në mënyrë të njëanshme provat e paraqitura. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim. Sipas saj, ndër të tjera, jurisprudenca ka pranuar si elemente të qenësishme të procesit të rregullt ligjor respektimin e parimit të barazisë së armëve lidhur ngushtë me paanësinë në gjykim. Mbi bazën e këtyre standardeve, çdo palë në proces nuk duhet të gjejë avantazhe të konsiderueshme ndaj kundërshtarit, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë midis palëve (*shih vendimin nr. 22, datë 07.06.2007 të GjK-së*).

B- JURIDIKSIONI PENAL

a) Për gjykatat e faktit

- ***Për pjesëmarrjen dhe rolet e gjyqtarit në procedime/gjykime të mëparshme të lidhura***

49. Në një rast, përpara Gjykatës nga ana e kërkuesit është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme për arsye se kërkesat e tij për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së vendosur me vendimin nr. 2, datë 02.03.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër, si dhe për shuarjen e masës së vendosur me vendimin nr. 30, datë 10.03.2022 të saj janë shqyrtuar nga i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër. Gjykata ka konkluduar se në këndvështrimin kushtetues, kërkesat e kërkuesit për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit, si dhe për shuarjen e saj janë shqyrtuar nga një gjykatë e paanshme, e caktuar me ligj dhe se në rastin e tij nuk rezulton të jenë shkelur garancitë e ofruara nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi në këtë drejtim.

Sipas Gjykatës, ligji procedural penal përcakton rregulla të tilla që bëjnë dallim thelbësor mes fazës së hetimit paraprak dhe fazës së gjykimit. Në fazën e gjykimit, gjykata duhet të marrë vendime pa qenë e ndikuar nga vendimmarrja e mëparshme, qoftë edhe kur ato bazohen në dyshime të arsyeshme. Rregullat e KPP-së për gjykatën kompetente që shqyrton kërkesat për masat e sigurimit (nenet 13, 15, 17, 18, 21, 244, pika 1, 246 dhe 260, 261) janë unifikuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 7/2011, sipas të cilit masa e sigurimit mund të caktohet rishtazi edhe në fazën e gjykimit, madje nga e njëjta gjykatë që shqyrton themelin e akuzës, nëse verifikohen kushtet dhe kriteret ligjore për caktimin e masës së sigurimit. I vetmi organ që procedon me çështjen penale të dërguar për gjykim, pra edhe për caktimin e masës së sigurimit, revokimin e zëvendësimin e saj, është gjykata e caktuar për gjykimin e veprës penale në fazën e gjykimit e deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Në këtë kuptim, kur kërkesa është paraqitur për gjykim, kompetenca për të vendosur caktimin, zëvendësimin a revokimin e masave të sigurimit i përket vetëm gjykatës së caktuar për shqyrtimin e çështjes. Me depozitimin e kërkesës për gjykim, kompetenca e gjyqtarit të fazës së hetimeve paraprake për të trajtuar kërkesa lidhur me masat e sigurimit i ka kaluar gjykatës së caktuar për gjykimin e çështjes penale. Gjykata ka evidentuar se çështja penale në ngarkim të kërkuesit i është dërguar për rishqyrtim Gjykatës së Apelit Shkodër me vendimin nr. 00-2022-1 (8), datë 14.01.2022 të Gjykatës së Lartë. Ndërkohë, me vendimin nr. 00-2022-75, datë 10.02.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka përcaktuar si kompetente Gjykatën e Apelit Shkodër, konkretisht trupin gjykues të saj që do të shqyrtonte çështjen në themel, për shqyrtimin e kërkesës së kërkuesit për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës fillestare, pasi në momentin e paraqitjes së kërkesës aktet ndodheshin pranë saj *(shih vendimin nr. 00-2022-787, datë 05.07.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, faqja 3, paragrafi 15).* Në këto kushte, si kërkesa e kërkuesit për konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit të caktuar me vendimin nr. 2, datë 02.03.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër, ashtu edhe kërkesa e tij për shuarjen e masës së vendosur me vendimin nr. 30, datë 10.03.2022 të kësaj gjykate janë marrë në shqyrtim nga i njëjti trup gjykues, i cili ka qenë duke shqyrtuar çështjen penale të themelit (në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga vendimi unifikues nr. 7/2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë -së). Këto vendime janë marrë brenda të njëjtit gjykim/procedim, ndaj, në rastin e kërkuesit, nuk ka papajtueshmëri të trupit gjykues (*shih vendimin nr. 19, datë 04.04.2023, paragrafët 41-49 të GJK-së*).

50. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme për arsye se gjyqtarja F.H., që ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar në shkallë të parë këtë çështje, ka dhënë një vendim ndaj të gjykuarit E.D., me të cilin ka vleftësuar dhe caktuar masë sigurimi "Arresti në burg", nën dyshimin e arsyeshëm se ky shtetas ka kryer veprën penale të trafikimit të narkotikëve, të parashikuar nga neni 283/a/2 i KP-së. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim haptazi të pabazuar. Sipas saj, është i vërtetë fakti se gjyqtarja F.H. ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar në shkallë të parë këtë çështje dhe ka dhënë një vendim, me të cilin ka vleftësuar dhe caktuar masën e sigurimit "Arresti në burg", nën dyshimin e arsyeshëm se ky shtetas ka kryer veprën penale të trafikimit të narkotikëve, të parashikuar nga neni 283/a/2 i KP-së. Ky vendim mban nr.82, datë 09.05.2010 dhe është një procedim i ndarë nga procedimi

që u gjykua nga ky trup gjykues. Duke qenë procedim i ndarë, Gjykata ka vlerësuar se nuk është shkak paanshmërie, pasi sipas nenit 15/2 të KPP-së "nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit ose çdo kërkesë tjetër të prokurorit të paraqitur gjatë hetimit paraprak në të njëjtin procedim" (*shih vendimin nr. 37, datë 25.04.2017, paragrafët24-28 të GJK-së*).

51. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pasi kërkesa për rivendosjen në afat është shqyrtuar nga të njëjtët gjyqtarë që kanë gjykuar çështjen në themel, në kundërshtim me nenin 15 të KPP-së. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, në dispozitat e KPP-së ligjvënësi, në mënyrë të qartë, nuk ka parashikuar asnjë normë apo rast papajtueshmërie lidhur me pjesëmarrjen e gjyqtarit në gjykimin e rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit. Vlerësimi që gjykata bën gjatë shqyrtimit në themel të çështjes (administrimi dhe vlerësimi i provave, analiza e elementeve të veprës penale me qëllim të dhënies së dënimit), është thellësisht i ndryshëm nga vlerësimi që bëhet në rastin e shqyrtimit të kërkesës për rivendosje në afat, i cili bazohet vetëm në vlerësimin e elementeve që kanë lejuar humbjen e afatit të paraqitjes së ankimit. Neni 15/1 i KPP-së parashikon papajtueshmërinë e gjyqtarit kur ai ka dhënë ose ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë tjetër të procedimit. Në rastin konkret, jo vetëm që nuk ndodhemi përpara një shkalle tjetër të procedimit, por ndodhemi përpara dy procedimeve të ndryshme, në të cilat gjyqtarit nuk i duhet të ndalet në të njëjtat vlerësime që kanë të bëjnë me përmbajtjen e të njëjtave fakte. Në këtë kuptim, qëllimi dhe natyra e veprimeve që këta gjyqtarë kanë kryer në të dyja gjykimet, nuk janë të tilla që të vënë në dyshim paanshmërinë e gjykatës (*shih vendimin nr. 8, datë 27.02.2014, paragrafët16-20 të GJK-së*).

52. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme për arsye se në gjykimin në gjykatën e apelit ka marrë pjesë një gjyqtar që kishte marrë pjesë më parë në shqyrtimin e ankimit ndaj masës së sigurimit të dhënë ndaj kërkuesit. Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se i njëjti gjyqtar i Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili ka qenë në përbërje të trupit gjykues që ka shqyrtuar ankimin për themelin e çështjes (vendimi nr.67, datë 02.05.2001), ka qenë më parë në përbërje të trupit gjykues që ka marrë në shqyrtim ankimin e prokurorit ndaj masës së sigurimit për kërkuesin (vendimi nr.23, datë 02.11.1999), vendim me të cilin është vendosur mospranimi i ankimit për shkak të heqjes dorë të prokurorit prej tij. Me qëllim të respektimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, neni 15/2 i KPP-së parashikon se nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit ose çdo kërkesë tjetër të prokurorit të paraqitur gjatë hetimit paraprak në të njëjtin procedim. Ky detyrim parashikohet edhe nga neni 17/1, shkronja "e", i KPP-së, sipas të cilit gjyqtari duhet të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë, të parashikuara nga neni 15 i KPP-së. Ligji nuk përjashton që gjyqtari, i cili ka shqyrtuar një kërkesë gjatë hetimit paraprak, të shqyrtojë një kërkesë tjetër të të njëjtit lloj apo të një lloji tjetër në të njëjtin procedim, por parimi është që gjyqtari që ka vleftësuar çdo kërkesë të prokurorit

gjatë hetimeve paraprake, ka papajtueshmëri me gjyqtarin që merr pjesë në gjykimin e çështjes *(shih vendimin nr.40, datë 22.09.2011 të GJK-së).* Sipas Gjykatës, neni 15/2 i KPP-së shprehet se "nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vleftësuar...", çka do të thotë se kjo dispozitë kërkon që gjyqtari të shprehet lidhur me themelin e masës së sigurimit. Në rastin konkret, pjesëmarrja e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Shkodër në gjykimin e masës së sigurimit ka qenë formale dhe ai nuk ka dhënë asnjë mendim lidhur me thelbin e çështjes, duke qenë se prokurori i çështjes hoqi dorë nga ankimi i paraqitur në atë gjykatë. Në këto kushte, Gjykata ka vlerësuar se ky gjyqtar nuk gjendej në kushtet e papajtueshmërisë, të parashikuar në nenin 15/2 të KPP-së, dhe nuk kishte arsye për të hequr dorë nga gjykimi i çështjes konkrete në themel (*shih vendimin nr. 18, datë 02.04.2012, paragrafët 10-14 të GJK-së*).

53. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme mbështetur në dy argumente. Së pari, gjyqtarët F.P. dhe A. L. kanë qenë në kushte papajtueshmërie për të gjykuar përkatësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda për shkak se kanë gjykuar një proces tjetër me objekt sekuestrimin e pasurive të vëna në kuadër të organizatës kriminale të A. B., në të cilën kërkuesi është deklaruar fajtor si pjesëmarrës dhe anëtar i kësaj organizate. Së dyti, pjesëmarrja në gjykim e gjyqtares S. D., e cila, sipas kërkuesit, ka qenë në kushte papajtueshmërie për shkak se ka gjykuar më parë një çështje që lidhet me anëtarë të tjerë të së njëjtës organizatë kriminale, arsye për të cilat gjyqtarët M. B. dhe Dh. L. hoqën dorë nga gjykimi ndaj kërkuesit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar për të dyja argumentet. Sipas Gjykatës, lidhur me argumentin e parë, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se natyra e përgjegjësisë sipas legjislacionit civil është e ndryshme nga ajo e legjislacionit penal, pasi standarde të ndryshme të të provuarit zbatohen në çështje civile dhe penale; se një dënim penal nuk përjashton gjetjen e një përgjegjësie civile që lind nga të njëjtat fakte dhe se, në të kundërt, ekzistenca e përgjegjësisë civile nuk sjell nevojshmërisht një vendim fajësie sipas ligjit penal, në lidhje me të njëjtat veprime të të pandehurit. Një situatë në të cilën i njëjti gjyqtar shqyrton si çështjen e përgjegjësisë civile, edhe të asaj penale të lindura nga të njëjtat fakte, nuk prek domosdoshmërisht paanshmërinë e gjyqtarit. Megjithatë, nëse frika e të akuzuarit për mungesën e paanshmërisë së gjyqtarit mund të konsiderohet si objektivisht e justifikueshme, kjo varet nga tiparet e veçanta të secilit rast. Thjesht fakti që një gjyqtar është përfshirë edhe në vendimet që lidhen me paraburgimin (masat e sigurisë) për çështjen, nuk mund të justifikojë në vetvete frikën për paanshmërinë e tij/saj (shih Hauschildt kundër Danimarkës, 24 maj 1989, p. 22, 49 § 50). Vetëm rrethanat e veçanta mund të çojnë në një përfundim tjetër. Në këtë drejtim, kanë rëndësi shtrirja dhe natyra e masave të sigurisë që ka marrë gjyqtari (shih Fey p.12 § 30; Ekeberg dhe të tjerë kundër Norvegjisë , 31 korrik 2007). Pyetjet që një gjyqtar duhet t'i përgjigjet kur merr vendime që lidhen me masën e sigurisë nuk janë të njëjta me ato që janë vendimtare kur merret vendimi përfundimtar i fajësisë. Dyshimi dhe fajësia nuk trajtohen sikur të jenë e njëjta gjë (shih çështjen Lutz të 25 gushtit 1987, p. 62; çështjen Hauschildt). Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata ka çmuar se gjyqtarët F. P. dhe A. L. e kanë gjykuar çështjen e sekuestrimit të pasurisë së organizatës së A. B. në kuadrin e një procedimi parandalues lidhur me pasurinë, sipas ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004,

bazuar në dyshimin dhe prezumimin për zotërimin e prejardhjen e paligjshme të pasurisë për shkak e në lidhje me këtë veprimtari kriminale. Kërkuesi nuk ka paraqitur në kërkesë asnjë argument për rrethana objektive dhe subjektive, të cilat do të çonin në anësinë e dy gjyqtarëve në fjalë lidhur me vlerësimin e veprave penale për të cilat është gjykuar kërkuesi. Për më tepër, siç rezulton edhe nga vendimet përkatëse gjyqësore për sekuestrimin e pasurisë, gjyqtarët F. P. dhe A. L. nuk shprehen në asnjë moment për ndonjë fakt që lidhet me kërkuesin dhe vlerësimin e veprimeve ose mosveprimeve në kundërshtim me ligjin për masat parandaluese, të marra ndaj pasurisë së organizatës kriminale.

54. Lidhur me argumentin e dytë për cenimin e parimit të paanshmërisë, Gjykata ka vërejtur se gjyqtarja S. D. ka gjykuar si anëtare e trupit gjykues në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda disa anëtarë të organizatës kriminale në fjalë dhe ka marrë vendimin nr. 20, datë 05.04.2007. Ky vendim paraqitet si shkak objektiv nga kërkuesi për të provuar anësinë e gjyqtares në fjalë në procesin ndaj tij. Ajo ka vlerësuar se duhet përcaktuar nëse, pavarësisht sjelljes personale të gjyqtares S.D., ka fakte të vërtetueshme, të cilat mund të ngrenë dyshime lidhur me paanshmërinë e saj. Gjithashtu, Gjykata niset nga premisa se, nëse ka një arsye legjitime që një gjyqtar i caktuar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i të akuzuarit është i rëndësishëm, por nuk është vendimtar. Ajo që është vendimtare është nëse kjo frikë mund të konsiderohet se është objektivisht e justifikueshme. Nga vendimi nr. 20, datë 05.04.2007, gjyqtarja, si anëtare e trupit gjykues, nuk shpreh asnjë vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e fakteve e rrethanave që lidhen me pjesëmarrjen e kërkuesit në organizatën kriminale, ku u gjetën si pjesëmarrës të gjykuarit në procesin penal që lidhet me këtë vendim të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda (vendimi nr. 20). Vlerësimi i akuzës ndaj kërkuesit është bërë në procesin penal kundër tij me vendimet objekt shqyrtimi kushtetues të gjykatave të shkallës së parë për Krime të Rënda dhe të Apelit për Krime të Rënda. Gjykata e apelit i referohet vendimit nr. 20, datë 05.04.2007, si vendim që ka marrë formë të prerë në kontekstin e nenit 193/5 të KPP-së, duke e vlerësuar këtë vendim si provë për ekzistencën e bashkëpunimit në formën më të lartë të tij, në atë të organizatës kriminale, mes të bashkëpandehurve D. V., E. C., M. C. e P. L. për veprat penale për të cilat ata janë gjykuar. Por ky vendim gjyqësor nuk shprehet për veprën e penale të vënies zjarr të banesës së Sh. H. Në vendimin nr. 20, datë 05.04.2007 dhe në procesin për arritjen e tij, për sa i takon pjesëmarrjes në të njëjtën organizatë kriminale të kërkuesit, gjyqtarja apo trupi gjykues nuk disponon në asnjë vend apo rresht për fakte, apo rrethana që lidhen me kërkuesin E.B., si pjesëmarrës në këtë organizatë. Vlerësimi i veprimtarisë penale dhe i akuzave në ngarkim të kërkuesit janë bërë vetëm në procesin kundër tij dhe vendimeve objekt shqyrtimi (*shih vendimin nr. 33, datë 22.07.2011, paragrafët 6-17 të GJK-së*).

55. Në një rast Gjykata e ka vlerësuar të bazuar pretendimin për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme me argumentin se është cenuar neni 15 i KPP-së, pasi i njëjti gjyqtar që ka bërë sigurimin e provës (dëshmisë) ka caktuar edhe masën e sigurimit për kërkuesin. Sipas Gjykatës, vendimet e gjykatave, që e kanë deklaruar fajtor kërkuesin, kanë si burim vetëm deklarimet e shtetases N. C. të dhëna në seancën për

sigurimin e provës (dëshmisë). Edhe pse kjo dëshmitare ka ndryshuar dëshminë e saj para gjykatës, kjo e fundit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim tjetër për të verifikuar vërtetësinë ose jo të deklarimeve të kësaj shtetaseje. Duke qenë se deklarimet e shtetases N. C., të marra në seancën për sigurimin e dëshmisë, janë prova e vetme mbi të cilën gjykatat ka mbështetur fajësinë e kërkuesit, mosrespektimi nga ana e gjykatës, gjatë procedurës për sigurimin e kësaj prove, të ndalimeve të parashikuara nga neni 15/2 i KPP-së, e bën këtë provë të marrë në mënyrë të paligjshme dhe, në këto kushte, edhe procesin gjyqësor të parregullt nga pikëpamja kushtetuese. Gjykata ka vlerësuar se pretendimi i kërkuesit duhej shqyrtuar edhe në përputhje me parimet që u referohen provave, sipas të cilave vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të Gjykatës, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor (*shih vendimin nr.1, datë 12.01.2007 të GJK-së)*. Gjykata ka ritheksuar se ligji nuk përjashton që gjyqtari, i cili ka shqyrtuar një kërkesë gjatë hetimit paraprak, të shqyrtojë një kërkesë tjetër të të njëjtit lloj apo të një lloji tjetër në të njëjtin procedim, por parimi është që gjyqtari që ka vleftësuar çdo kërkesë të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, ka papajtueshmëri me gjyqtarin që merr pjesë në gjykimin e çështjes. Ajo ka vlerësuar se nuk ka papajtueshmëri, në kuptim të nenit 15 të KPP-së, për sa i përket faktit se i njëjti gjyqtar që ka shqyrtuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj të pandehurit, shqyrton edhe kërkesën e prokurorit, ose njërës prej palëve, për sigurimin e provës, sepse procedura e rregulluar nga neni 320 i KPP-së bën pjesë në kërkesat që mund të shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar gjatë hetimeve paraprake. Papajtueshmëria qëndron në faktin se gjyqtari i hetimeve paraprake nuk mund të marrë pjesë në seancën për marrjen e provës, sepse kjo është pjesë e shqyrtimit gjyqësor të çështjes dhe nuk mund të kryhet nga gjyqtari i hetimeve paraprake (*shih vendimin nr. 40, datë 22.09.2011, paragrafët 20-34 të GJK-së*).

➢ *Për shkaqe të tjera që lidhen me raportet dhe sjelljen e gjyqtarit*

56. Në një rast është pretenduar cenimi i parimit të paanshmërisë në gjykim, për arsye se gjyqtari që ka gjykuar çështjen në gjykatën e shkallës së parë e ka paragjykuar atë, pasi nuk ka pranuar kërkesat e paraqitura në gjykim për administrimin e disa provave. Gjykata ka vlerësuar se mospranimi i këtyre kërkesave nuk është i mjaftueshëm për të konkluduar mbi anshmërinë e gjykatës në shqyrtimin e kësaj çështjeje dhe kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë tjetër për të mbështetur këtë pretendim. Sipas Gjykatës, për sa i përket paanshmërisë objektive duhet shqyrtuar nëse objektiviteti i dyshimit të ngritur nga kërkuesi është mjaftueshmërisht i provueshëm dhe ky përfundim varet nga rrethanat e çështjes konkrete. Ajo ka vlerësuar se edhe në këtë drejtim nuk ka vend për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarit të çështjes. Veprimet e kryera prej tij jo vetëm që gjejnë pasqyrim në aktet e dosjes gjyqësore, por ai ka argumentuar edhe qëndrimin e tij për mospranimin e kërkesave të paraqitura në gjykim për thirrjen e dëshmitarit dhe kryerjen e aktit të ekspertimit (*shih vendimin nr. 21, datë 20.03.2017, paragrafët 18-21 të GJK-së*).

57. Në një rast tjetër, pretendimi për cenimin e parimit të gjykatës së paanshme është mbështetur me argumentin se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është dhënë në kundërshtim me provat që gjenden në fashikullin e gjykimit. Gjykata ka vlerësuar se ky pretendim nuk hyn në juridiksionin kushtetues. Sipas Gjykatës, pretendimi i kërkuesit nuk lidhet me parimin e paanësisë, por me mënyrën e vlerësimit të provave. Ai ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë e ka dhënë vendimin në kundërshtim me provat e administruara gjatë gjykimit. Gjykata ka ritheksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e Gjykatës është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave *(shih vendimin nr.76, datë 04.12.2017, paragrafët 11-15 të GJK-së)*. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata edhe në disa raste të tjera, ku është ngritur i njëjti pretendim në thelb (*shih vendimet nr. 1, datë 20.01.2014; nr. 55, datë 18.12.2012; nr. 16, datë 27.03.2012 të GJK-së*).

58. Cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në një rast është lidhur me pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë. Sipas kërkuesit, gjykata e shkallës së parë në rigjykimin e çështjes ka cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë, sepse e ka filluar procesin me bindjen se kërkuesi e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, pa u bazuar në prova. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim haptazi të pabazuar, sepse i referohet mënyrës së vlerësimit të provave nga ana e gjykatave të zakonshme. Sipas saj, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm vendimet e tyre i kanë bazuar në një sërë provash, të tilla, si, akte shkresore, thënie të dëshmitarëve etj., dhe se gjatë shqyrtimit të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit ato nuk kanë arritur në asnjë konkluzion apriori për fajësinë e tij. Ajo ka vlerësuar se, nisur edhe nga ecuria e procesit në tërësinë e tij, nuk rezulton që gjykata ta ketë nisur procesin me bindjen se kërkuesi është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet (*shih vendimin nr. 82, datë 21.12.2017, paragrafët 16-20 të GJK-së*).

59. Në një rast pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është mbështetur në arsyen se Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka marrë parasysh kërkesën e mbrojtësit të kërkuesit për transferimin e çështjes nga ajo gjykatë në një gjykatë tjetër, për shkakun se vëllai i viktimës I. N., gjyqtari S.N., ushtron detyrën e gjyqtarit në të njëjtën gjykatë. Gjykata e ka rrëzuar këtë pretendim. Sipas saj, gjykata e apelit i ka marrë të gjitha masat e nevojshme në funksion të dhënies së garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm me qëllimin të mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Kryetarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, bazuar në nenin 21 të ligjit 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor", i ka kërkuar KLD-së, delegimin e tre gjyqtarëve për shqyrtimin e çështjes, sepse gjyqtarët e atij institucioni kanë pengesë për shqyrtimin e saj për shkak të detyrës si gjyqtar i asaj gjykate të vëllait të viktimës, S.N.

Me vendimin nr. 254/4, datë 02.11.2009, KLD-ja ka vendosur delegimin e tre gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë në gjykimin e çështjes. Në datën 22.01.2010 kërkuesi, për të njëjtën arsye, bazuar në nenin 94 të KPP-së, ka paraqitur kërkesë për transferimin e çështjes në një gjykatë apeli tjetër. Ndërkohë, Gjykata e Apelit Vlorë, mbështetur në nenin 96 të KPP-së, ka vazhduar gjykimin përderisa "në adresë të saj nuk kishte një vendim pezullimi të gjykimit". Gjykata ka vlerësuar se fakti që çështja në Gjykatën e Apelit Vlorë është shqyrtuar nga tre gjyqtarë të deleguar nga një gjykatë tjetër përmbush elementet e parimit të paanshmërisë (*shih vendimin nr.49, datë 29.09.2014, paragrafët 28-31 të GJK-së*).

60. Përpara Gjykatës, në një rast, është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme bazuar mbi argumentin se refuzimi i kërkesës për përjashtimin e trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe të një anëtari të trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Durrës vërtetoi njëanshmërinë e gjykatës. Vendimi për mospërjashtimin e gjyqtarëve nuk iu komunikua kërkuesit, duke i mohuar atij të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas Gjykatës, pretendimi i kërkuesit nuk është ngritur në nivel kushtetues, për faktin se mungojnë argumentet për të provuar se gjykatat nuk kanë ofruar garanci procedurale të mjaftueshme dhe se kanë pasur interesa personale në çështjen në shqyrtim (testi objektiv dhe subjektiv). Madje, argumentet e parashtruara në mbështetje të pretendimit mbi vlerësimin e njëanshëm të provave janë çështje që i takojnë sferës së kompetencës së gjykatave të zakonshme për interpretimin e dispozitave ligjore dhe vlerësimin juridik të rrethanave dhe provave të parashtruara nga palët dhe jo juridiksionit kushtetues. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Interpretimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, për sa kohë nuk cenon ndonjë element të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 57, datë 21.12.2012 të GJK-së*).

61. Përpara Gjykatës, është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme për arsye se në Gjykatën e Apelit Vlorë në gjykimin e çështjes ka marrë pjesë një gjyqtar, i cili, për shkak të lidhjeve me palën e dëmtuar nga vepra penale, nuk duhet të ishte në përbërje të trupit gjykues. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, në rastin në shqyrtim, kërkuesi ka vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarit, duke pretenduar se ai ka lidhje me personin e dëmtuar nga vepra penale. Për pasojë, respektimi i parimit të paanshmërisë në gjykim duhet të ekzaminohet vetëm nga këndvështrimi i testit objektiv, pra nëse ekzistojnë fakte bindëse të cilat ngjallin dyshim legjitim se ky gjyqtar nuk ka qenë i paanshëm. Kërkuesi ka pretenduar se daja i gjyqtarit dhe personi i dëmtuar nga vepra penale i kanë bashkëshortet motra (janë baxhanakë), dhe për shkak të kësaj lidhjeje ky gjyqtar nuk duhet të merrte pjesë në trupin gjykues që ka gjykuar këtë çështje. Për të provuar sa më sipër, kërkuesi ka paraqitur një dokument të lëshuar nga organet e pushtetit vendor. Sipas Gjykatës, lidhja e pretenduar nga kërkuesi nuk ka qenë e tillë sa të përbëjë shkak për një dyshim të ligjshëm lidhur me paanësinë e gjyqtarit. Në aspektin procedural penal, rastet e papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit në gjykim për arsye lidhjeje familjare, gjinie ose krushqie, janë rregulluar nga KPP-ja dhe

konkretisht neni 16 i këtij kodi. Në mënyrë të përmbledhur, kjo dispozitë përjashton të marrin pjesë si gjyqtarë në të njëjtin procedim, vetëm personat që janë ndërmjet tyre ose me pjesëmarrësit në gjykim, bashkëshortë, gjini e afërt (...), ose krushqi e afërt (...). Nga kategoria e personave krushqi e afërt, kjo dispozitë përjashton ata gjyqtarë që janë midis tyre ose me pjesëmarrësit në gjykim vjehërr, vjehrra, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtër, thjeshtri, njerku, njerka. Në kuptim të kësaj dispozite procedurale, Gjykata konstaton se lidhja e pretenduar nga kërkuesi nuk përfshihet në rastet e papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit, të parashikuar nga neni 16 i KPP-së (*shih vendimin nr. 10, datë 02.04.2009 të GJK-së).*

62. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme për arsye se në shkallë të parë gjykimi është filluar nga një trup gjykues, në përbërje të të cilit ishin tre gjyqtarë civilë, zëvendësimi i një gjyqtari është bërë në kundërshtim me rregullat procedurale, se caktimi i një gjyqtari ushtarak është bërë në kundërshtim me rregullat procedurale. Gjykata e ka vlerësuar pretendimin të pambështetur. Lidhur me pretendimin e kërkuesit për shkelje të parimit të gjykatës së paanshme, për sa i përket përbërjes së trupit gjykues në shkallë të parë, sipas Gjykatës, nenet të cilave u referohet kërkuesi kanë të bëjnë me përjashtimin dhe heqjen dorë dhe nuk kanë lidhje me parashikimin e nenit 342/2. Kërkuesi nuk e ka apeluar vendimin e apelit, për rrjedhojë ai ka marrë formë të prerë. Lidhur me argumentimin se gjyqtari B.K. është caktuar në kundërshtim me kompetencën që kanë gjykatat ushtarake, në bazë të nenit 75 të KPC-së, ky gjyqtar nuk ka kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes, Gjykata ka vlerësuar se kërkuesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike sipas nenit 131/f të Kushtetutës, për shkak se ai nuk e ka kundërshtuar vendimin gjyqësor të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë të datës 24.11.2003, i cili ka rrëzuar kërkesën e tij lidhur me përjashtimin e këtij gjyqtari (*shih vendimin nr. 23, datë 23.07.2009, paragrafët 20-28 të GJK-së*).

b) Për Gjykatën e Lartë

- ***Për pjesëmarrjen dhe rolet e gjyqtarit në procedime/gjykime të mëparshme në gjykatat e faktit***

63. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme për arsye se gjyqtari S.S., pjesëtar i trupit gjykues në Gjykatën e Lartë që ka shqyrtuar rekursin, ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen penale ndaj kërkuesit në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas Gjykatës, parimi i paanshmërisë në gjykim, edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, pra edhe në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë. Kjo do të thotë se gjyqtari i Gjykatës së Lartë nuk mund të jetë anëtar i një kolegji nëse, për të njëjtën çështje, ka marrë pjesë në dhënien e një vendimi në një shkallë të mëparshme të procesit. Në çështjen konkrete, gjyqtari S.S. ka qenë pjesëtar i trupit gjykues në Gjykatën e Shkallës

së Parë për Krime të Rënda, e cila e ka shpallur fajtor kërkuesin për kryerjen e veprave penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare" dhe "Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe të municionit", duke e dënuar përfundimisht me 18 vjet burgim. Sipas procesverbalit të mbajtur në datën 05.07.2021 në Gjykatën e Lartë, rezulton se gjyqtari S.S., për shkak të pjesëmarrjes së tij në trupin gjykues që ka gjykuar kërkuesin në shkallë të parë, është zëvendësuar me gjyqtarin E.P. Gjykata e Lartë në këtë procesverbal, për plotësimin e trupit gjykues që do të shqyrtonte çështjen e kërkuesit, ka pohuar: "Nga verifikimet fizike të dosjes (...) rezulton se gjyqtarët S.S. dhe K.K., kanë qenë pjesë e trupit gjykues në vendimin nr. 103, datë 01.10.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, fakt i cili i përjashton nga gjykimi i çështjes (...), si dhe gjyqtarja A.B. ka qenë pjesë e trupit gjykues në vendimin nr. 114, datë 25.11.2015 në Gjykatën e Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, fakt i cili e përjashton nga gjykimi i çështjes së lartpërmendur." Në kundërshtim me sa është konstatuar më lart, gjyqtari S.S. ka marrë pjesë në trupin gjykues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka gjykuar dhe vendosur mospranimin e rekursit. Gjykata ka vërejtur se megjithëse vlerësimi që gjyqtari S.S. i ka bërë rekursit në Gjykatën e Lartë ka qenë vetëm formal, dyshimi i kërkuesit për njëanshmëri në shqyrtimin e çështjes së tij në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë të mbledhur në dhomën e këshillimit është i bazuar. Gjykata e Lartë duhet të kishte shmangur pjesëmarrjen e gjyqtarit S.S. në Kolegjin Penal, sidomos për faktin se ajo e ka pranuar heqjen dorë të këtij gjyqtari, madje ka caktuar edhe gjyqtarin për zëvendësimin e tij. Në këto kushte, pjesëmarrja e gjyqtarit S.S. në gjykimin e çështjes në Gjykatë të Lartë, pavarësisht se ai nuk është shprehur për themelin e çështjes, krijon dyshim objektivisht të bazuar te kërkuesi për paanshmërinë e tij (*shih vendimin nr. 10, datë 12.04. 2022, paragrafët 6-7 të GJK-së*).

64. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi gjyqtari Sh. S., pjesë e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë, ka qenë pjesë e trupit gjykues edhe në gjykatën e shkallës të parë që ka dhënë vendimin nr. 309, datë 27.12.2005. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim. Sipas saj, në kushtet kur kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë për të vërtetuar se gjyqtari Sh.S. ka pasur bindje personale ose interes në çështjen që ka ndikuar në vendimin e gjykatës, paanshmëria subjektive prezumohet. Për sa i përket paanshmërisë objektive, duhet shqyrtuar nëse dyshimi i ngritur nga kërkuesi është mjaftueshmërisht i provueshëm dhe ky përfundim varet nga rrethanat e çështjes konkrete. Nga rrethanat faktike rezulton se gjyqtari Sh. S. ka qenë pjesë e trupit gjykues në gjykimin e çështjes në shkallë të parë që e ka deklaruar kërkuesin fajtor. Si pjesë e këtij trupi gjykues, gjyqtari Sh.S. ka shqyrtuar dhe zgjidhur çështjen në themel, duke manifestuar bindjen e tij lidhur me fajësinë e kërkuesit. Ai ka qenë, gjithashtu, pjesë edhe e trupit gjykues që ka gjykuar rekursin në dhomë këshillimi në Gjykatën e Lartë. Në këtë rast, si pjesë e trupit gjykues, ai ka vlerësuar në dhomë këshillimi ekzistencën e shkaqeve për të kaluar apo jo çështja për shqyrtim në seancë. Megjithatë, edhe pse si pjesë e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, gjyqtari Sh.S. ka vlerësuar vetëm plotësimin ose jo të kërkesave ligjore për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, Gjykata ka çmuar se në rastin konkret ka vend për dyshime të arsyeshme dhe mjaftueshëm të bazuara, në drejtim të cenimit të paanshmërinë së gjykatës,

në aspektin objektiv. Gjyqtari Sh.S. ka marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes ndaj të njëjtit kërkues, të akuzuar për kryerjen e së njëjtës vepër penale, si në gjykatën e shkallës të parë, ashtu edhe në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 48, datë 22.07.2016 të GJK-së*).

65. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi kryesuesi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka qenë zv/prokuror i Përgjithshëm në kohën kur kërkuesi procedohej penalisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndaj dhe në këtë cilësi ka kryer veprime që lidhen me këtë procedim penal. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim. Sipas saj, kryetari i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në cilësinë e zv/prokurorit të Përgjithshëm, ka firmosur disa shkresa që kanë lidhje me procedimin penal ndaj kërkuesit. Kur ekzistojnë kushtet që justifikojnë një dyshim të përligjur për anshmëri gjatë gjykimit, detyra e çdo gjyqtari është t'i shmanget gjykimit, në mënyrë që të mos cenojë rregullsinë e procesit gjyqësor, për sa i përket aspektit të paanshmërisë së gjykatës. Në çështjen konkrete, Gjykata ka konstatuar se përfshirja e gjyqtarit në procesin penal ndaj kërkuesit, kur ai ka ushtruar rolin e zv/prokurorit të Përgjithshëm, nuk ka qenë e papërfillshme, ndaj edhe dyshimi i kërkuesit është i bazuar nga ana objektive (*shih vendimin nr. 47, datë 07.11.2011, paragrafët 15-21 të GJK-së*).

66. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme për arsye se e njëjta gjyqtare ka marrë pjesë në të dyja gjykimet gjyqësore, në gjykatën e apelit (12.05.2001) dhe në Gjykatën e Lartë (30.05.2005). Relatori i çështjes në Gjykatë të Lartë ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi pasi ka pasur shkaqe subjektive, megjithatë kjo dorëheqje nuk është pranuar. Gjykata e ka vlerësuar pretendimin të pambështetur. Sipas saj, lidhur me arsyen e parë, nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore rezulton se në trupin gjykues, i cili ka zhvilluar seancën gjyqësore dhe ka marrë vendimin, gjyqtarja në fjalë nuk është pjesë e trupit gjykues. Lidhur me arsyen e dytë, vendimi i Kolegjit lidhur me kërkesën e gjyqtarit Y.M., është i drejtë. Pjesëmarrja e gjyqtarit ka qenë vetëm në fazën e pranimit të kërkesës, fazë gjatë së cilës Kolegji ka vlerësuar nëse në rekurs ishin parashtruar shkaqe ligjore sipas KPP-së. Gjyqtari në këtë fazë nuk shprehet lidhur me themelin e çështjes dhe të gjitha diskutimet nuk bëhen publike. Në rrethanat në fjalë mungojnë realisht kushtet objektive, të cilat do të përligjnin që gjyqtari të hiqte dorë nga gjykimi i çështjes në themel ndaj kërkuesit, sipas kritereve të nenit 17/c të KPP-së (*shih vendimin nr. 23, datë 23.07.2009, paragrafët 20-28 të GJK-së*).

- ***Për pjesëmarrjen dhe rolet e gjyqtarit në procedime/gjykime të mëparshme në Gjykatën e Lartë***

67. Në një rast tjetër, përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi të njëjtët gjyqtarë të Kolegjit Penal kanë marrë pjesë në trupin gjykues që ka shqyrtuar më parë rekurset kundër vendimeve penale të dhëna për kërkuesin. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas Gjykatës, bazuar në dispozitat procedurale që rregullojnë gjykimin në Gjykatën e Lartë, rezulton se neni 432 i KPP-së ka parashikuar shkaqet për të cilat mund të paraqitet rekurs, kurse sipas nenit 433, rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet

për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji. Sipas nenit 434 të KPP-së, Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda kufijve të shkaqeve të ngritura. Në rastin konkret, rezulton se Kolegji Penal që ka shqyrtuar rekurset në lidhje me çështjen e kërkuesit rezulton se është vënë në lëvizje fillimisht nga prokurori, pasi ankimi i mbrojtësit nuk është pranuar si i palegjitimuar dhe, më pas, edhe nga kërkuesi. Duke qenë se shkaqet e ngritura në rekurs, brenda të cilave Gjykata e Lartë shqyrton çështjen, kanë qenë të ndryshme, gjyqtarët e Kolegjit Penal që kanë marrë pjesë në trupin gjykues që ka shqyrtuar rekursin e kërkuesit kundër vendimit nr.59, datë 18.05.2015 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, nuk kanë marrë në shqyrtim dhe nuk janë shprehur mbi të njëjtat çështje të marra më parë në shqyrtim prej tyre, kur kanë vlerësuar shkaqet e rekursit të paraqitur nga prokurori kundër vendimit nr.69, datë 07.10.2013 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda (*shih vendimin nr. 8, datë 19.03.2018, paragrafët 28-33 të GJK-së*).

68. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë për arsye se në Kolegjin që ka shqyrtuar kërkesën për rishikim kanë marrë pjesë katër gjyqtarë, të cilët kishin marrë pjesë më parë në Kolegjin që ka shqyrtuar rekursin e paraqitur prej tij. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim. Sipas saj, pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në dy gjykime të iniciuara nga kërkuesi nuk sjell *apriori* cenimin e parimit të paanshmërisë, pasi çdokush mund të iniciojë çështje të ndryshme në të njëjtën gjykatë dhe me të njëjtët gjyqtarë, por i ndryshëm është qëndrimi kur i njëjti gjyqtar ose gjykatë gjykon të njëjtën çështje gjyqësore *(shih vendimin nr.7, datë 07.03.2011 të GJK-së)*. Shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërinë e tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Ndërsa, për sa i përket rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, vlerësimi që bën Kolegji i Gjykatës së Lartë në këto raste është i ndryshëm nga ai që bën kur vihet në lëvizje nëpërmjet rekursit. Kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Për këto arsye, rishikimi i vendimit, si një mjet ankimor kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, është i kufizuar vetëm në shkaqet e rishikimit të përcaktuara me ligj. Natyra e shqyrtimit të çështjes në rastet e rishikimit ka të bëjë jo vetëm me konstatimin e fakteve, por edhe me vlerësimin e tyre *(shih vendimin nr.49, datë 10.07.2015 të GJK-së).* Në rastin konkret, Gjykata ka vlerësuar se pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve të kërkuesit në të dyja gjykimet, ato lidhen, në fakt, me shqyrtimin e së njëjtës çështje gjyqësore. Në këto kushte, pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në këto dy gjykime nuk ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm të kërkuesit në lidhje me paanshmërinë e gjykatës, aq më tepër kur këta gjyqtarë përbëjnë shumicën në numër të trupit gjykues. Kur ekzistojnë kushtet që justifikojnë një dyshim të përligjur për anshmëri gjatë gjykimit, detyra e çdo gjyqtari është t'i shmanget gjykimit, në mënyrë që të mos cenojë rregullsinë e procesit gjyqësor *(shih vendimin nr.49, datë 10.07.2015 të GJK-së)*. Në rastin konkret, pjesëmarrja e gjyqtarëve E.I., Sh.S., T.N. dhe A.Z. në trupin gjykues që ka shqyrtuar kërkesën për rishikimin e vendimit të formës së prerë, ndërkohë

që objektivisht kanë ekzistuar mundësitë për shmangien e tyre nga gjykimi, ka krijuar një dyshim të justifikuar të kërkuesit se vendimi i dhënë nuk ka qenë produkt i një procesi të paanshëm (*shih vendimin nr. 70, datë 17.11.2015, paragrafët 18-25 të GJK-së*).

69. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi i njëjti gjyqtar ka marrë pjesë si në trupën e gjyqtarëve që përbënin Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, që me vendimin nr.266, datë 23.10.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.305, datë 20.12.2001 të Gjykatës së Apelit Vlorë, sikundër dhe në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), që me vendimin nr.14, datë 03.10.2008, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikimin e këtyre vendimeve. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve të kërkuesit në të dyja gjykimet, ato lidhen me shqyrtimin në fakt të së njëjtës çështje gjyqësore. Pjesëmarrja e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë në dy vendimet e dhëna për të njëjtat rrethana të pretenduara (ndërkohë që objektivisht kanë ekzistuar mundësitë për shmangien e tyre nga gjykimi), ka krijuar një dyshim të justifikuar te kërkuesi se vendimi i dhënë ka qenë produkt i një procesi të dyshuar si të njëanshëm (*shih vendimin nr. 21, datë 29.04.2010, paragrafët 14-18 të GJK-së*).

70. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit të paanshëm në Gjykatën e Lartë, pasi tre gjyqtarë të këtij kolegji që gjykuan çështjen kanë marrë pjesë më parë në seancën lidhur me vleftësimin e masës së sigurimit personal për kërkuesin. Në këto rrethana, pretendohet se procesi është paragjykuar, duke shkelur edhe kërkesat e nenit 15/2 të KPP-së, sipas të cilit gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit nuk mund të marrë pjesë në gjykim. Gjykata e ka vlerësuar të pambështetur këtë pretendim. Sipas saj, gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si në rastin e vleftësimit të masës së arrestit dhe në dhënien e vendimit përfundimtar, ka të bëjë me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulëta, të cilat janë marrë duke analizuar në tërësi provat dhe rrethanat e çështjes. Gjykata e Lartë nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen për të kontrolluar ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të ankimuara. Në këtë kuptim, gjykimi i çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk mund të konsiderohet i njëanshëm vetëm për faktin se disa anëtarë të tij kanë marrë pjesë më parë në vleftësimin e masës së arrestit për të njëjtën çështje. Nga kjo analizë arrihet në përfundimin se pjesëmarrja e disa anëtarëve të Gjykatës së Lartë në vleftësimin e masës së arrestit për kërkuesin nuk e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues (*shih vendimin nr. 9, datë 11.05.2006 të GJK-së*).

71. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të paanshmërisë në gjykim në Gjykatën e Lartë, pasi një gjyqtar që ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në gjykatën e apelit ka qenë sërish në përbërje të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar dhe vlerësuar shkaqet e rekursit që janë pikërisht edhe kundër këtij vendimi. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, dyshimi i kërkuesve për njëanshmëri në shqyrtimin e çështjes në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë të mbledhur në dhomën e këshillimit është i drejtë. Një nga gjyqtarët në përbërje të këtij kolegji ka marrë pjesë më parë

në trupin gjykues në Gjykatën e Apelit Durrës, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që i ka gjetur fajtorë dhe dënuar kërkuesit respektivisht me 8 vjet dhe 10 vjet burgim. Madje, në këtë rast, ky gjyqtar kishte qenë edhe relator i çështjes. Mbi këtë bazë duhej të ishte mënjanuar pjesëmarrja e këtij gjyqtari në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, i mbledhur për shqyrtimin e rekursit të kërkuesve. Vetë të gjykuarit apo mbrojtësit e tyre nuk e kanë pasur dhe as nuk mund ta kenë mundësinë ta kërkojnë këtë në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, pasi ata nuk janë të pranishëm. Gjykata ka ritheksuar se shqyrtimi i çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, është pjesë e rëndësishme e procesit gjyqësor në tërësi dhe, si i tillë, në përputhje me natyrën e këtij shqyrtimi në dhomën e këshillimit, duhet të respektojë parimet themelore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Nga shqyrtimi i çështjes ka rezultuar se gjykata e apelit e ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor, që ka shpallur kërkuesin të pafajshëm, duke e deklaruar fajtor dhe dënuar me 9 vjet burgim. Rekursi ndaj vendimit të gjykatës së apelit është shqyrtuar në dhomën e këshillimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka pasur në përbërje të tij gjyqtarin që e ka gjykuar këtë çështje në gjykimin në shkallë të dytë (*shih vendimin nr. 38, datë 15.10.2007 të GJK-së*).

➢ *Për shkaqe të tjera që lidhen me raportet dhe sjelljen e gjyqtarit*

72. Në një rast është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme të lidhur me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit dhe ankimit substancial në Gjykatën e lartë, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk kishte analizuar qëndrimin e ri të prokurorisë të mbajtur gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje të detajuar të gjitha shkaqeve të ngritura në rekurs. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim. Sipas saj, Gjykata e Lartë, duke mos mbajtur asnjë lloj qëndrimi të shprehur lidhur me konkluzionet e reja të paraqitura nga prokuroria, ka cenuar parimin e paanshmërisë në gjykim. Tërheqja e akuzave nga ana e prokurorisë lidhet drejtpërdrejt me pretendimet e parashtruara nga të pandehurit, rrjedhimisht Gjykata e Lartë për të rritur aksesin dhe transparencën në vendimin e saj duhet t'u kishte dhënë përgjigje konkluzioneve të prokurorisë me vendim të arsyetuar (*shih vendimin nr. 79, datë 14.12.2017, paragrafët 25-27 të GJK-së*).

73. Në një rast është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi kjo e fundit ka bërë një vlerësim të gabuar të rrethanave të çështjes dhe provave, si dhe ka shqyrtuar çështjen në momentin kur publikisht ishte i njohur diskutimi në Kuvendin e Shqipërisë i ligjit "Për dhënie amnistie", sipas të cilit amnistoheshin të gjitha dënimet alternative të dhëna me vendim të formës së prerë përpara datës 30.11.2015, sikurse ishte rasti konkret. Gjykata e ka vlerësuar haptazi të pabazuar këtë pretendim. Sipas saj, pretendimet e kërkueses se Gjykata e Lartë ka bërë një vlerësim të gabuar të rrethanave të çështjes dhe provave, si dhe ka shqyrtuar çështjen në momentin kur publikisht ishte i njohur diskutimi në Kuvend i ligjit "Për dhënie amnistie", nuk lidhen me parimin e paanshmërisë së saj. Gjykata ka çmuar se këto pretendime në thelb kanë të bëjnë me çmuarjen nga ana e gjykatës të provave, si dhe me bindjen e saj të brendshme në lidhje me deklarimin ose

jo fajtore të kërkueses. Si e tillë, kjo çështje i takon sferës së kompetencës së gjykatave të zakonshme, të cilat bëjnë vlerësimin juridik të rrethanave dhe provave të parashtruara nga palët dhe jo juridiksionit kushtetues. Ky i fundit nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor, aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Qëndrimi i mbajtur në jurisprudencën e Gjykatës është se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, përderisa pretendimet e kërkuesit nuk lidhen me cenimin e ndonjë standardi kushtetues (*shih vendimin nr. 71, datë 30.11.2016, paragrafët 16-21 të GJK-së*).

74. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim rekursin e paraqitur nga prokuroria në mungesë të kërkuesit apo të mbrojtësit të caktuar kryesisht, duke dhënë në përfundim një vendim që ka rënduar pozitën e kërkuesit. Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim. Sipas Gjykatës, kërkuesi nuk ka parashtruar argumente kushtetuese në lidhje me mungesën e garancive procedurale të mjaftueshme nga gjykatat dhe në lidhje me qëndrimin subjektiv të gjyqtarëve në proces (*shih vendimin nr.35, datë 01.06.2015 të GJK-së*).

75. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimin në gjykim, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të lidhur me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme. Ajo ka konkluduar se kërkuesi nuk e ka argumentuar këtë pretendim në nivel kushtetues. Sipas saj, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, aq më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 19, datë 02.04.2012, paragrafët 24, të GJK-së*).

76. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi Gjykata e Apelit Tiranë dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, përmes deklarimit fajtor të kërkuesit, janë treguar tërësisht të njëanshme, duke paragjykuar fajësinë e të gjykuarit në procesin ligjor dhe duke shkelur të drejtat e tij themelore për një proces të rregullt ligjor. Gjykata e ka vlerësuar të pambështetur këtë pretendim. Sipas saj, kërkuesi nuk ka parashtruar argumente për të mbështetur pretendimin e tij për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykimin në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 30, datë 26.11.2009 të GJK-së*).

77. Në një rast tjetër, pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim në Gjykatën e Lartë është lidhur me faktin e rëndimit të pozitës së kërkuesit nëpërmjet shtimit të dënimit nga ana e kësaj gjykate. Gjykata e ka vlerësuar të pambështetur këtë pretendim. Sipas saj, vetëm fakti se Gjykata e Lartë i ka shtuar masën e dënimit kërkuesit, pa e konkretizuar në ndonjë drejtim tjetër pretendimin për njëanshmëri të gjykatës, nuk përbën për Gjykatën ndonjë bazë të mjaftueshme për të konkluduar për shkeljen e këtij parimi (*shih vendimin nr. 13, datë 21.07.2008 të GJK-së*).

78. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të paanshmërisë në gjykim, pasi Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e paanshmërisë dhe të barazisë para ligjit, sepse ka diferencuar atë nga të pandehurit e tjerë. Kjo Gjykatë, ndërsa ka ulur masën e dënimit për të pandehurit e tjerë, për kërkuesin e ka rritur nga 17 në 20 vjet burgim. Pjesa arsyetuese e vendimit nuk korrespondon me masën e dënimit të dhënë për kërkuesin. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, kërkuesi nuk ka parashtruar argumente për të mbështetur pretendimin e tij për cenimin e parimit të paanshmërisë dhe të barazisë para ligjit, sipas elementeve të përmendura në vendim (*shih vendimin nr. 15, datë 22.07.2008 të GJK-së*).

C- JURIDIKSIONI ADMINISTRATIV

a) Për Gjykatën e Lartë

79. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i barazisë para ligjit, pasi gjykatat kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në çështje të ngjashme me atë të tij. Sipas pretendimit, ndër të tjera, për shtetasen A.K., të dënuar me vendim penal të formës së prerë, i cili, ashtu si në rastin e kërkuesit, është pezulluar, është lejuar vijimi i kandidimit për të ndjekur formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndërsa për kërkuesin është ndaluar. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Ndër të tjera, ajo ka ritheksuar se sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor dhe se, bazuar në parimin e subsidiaritetit, interpretimi i ligjit material ose procedural është, së pari, detyrë e Gjykatës së Lartë. Gjykata ndërhyn vetëm atëherë kur, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese. Vendimi i dhënë nga Gjykata e Lartë ndaj kërkuesit, ashtu edhe ai për shtetasen A.K., janë marrë nga i njëjti trup gjykues. Në të dyja rastet, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se, si para, ashtu edhe pas ndryshimeve të ligjit nr. 96/2016, qëllimi i ligjvënësit ka qenë ndalimi i futjes në sistemin gjyqësor të personave të dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në rastin e kërkuesit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se "Vjedhja" përbën një vepër të rëndë penale, të tillë që diskrediton figurën e funksionarit publik, për më tepër kur i atribuohet figurës së një gjyqtari ose prokurori". Sipas saj, parashikimet në ligjin nr. 96/2016 janë garanci për respektimin e interesit publik dhe vijnë për shkak të nevojës dhe domosdoshmërisë që mbart integriteti si element thelbësor i funksionit të magjistratit. Për shkak të natyrës së funksionit që kryen në shoqëri, integriteti i magjistratit është më shumë se virtyt, është një domosdoshmëri, sepse besimi i publikut tek institucionet e drejtësisë nuk varet vetëm nga profesionalizimi i tyre, por edhe nga integriteti moral. Në rastin e A.K., të dënuar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2019 për veprën penale "Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt", të parashikuar nga neni 291 i KP-së, ekzekutimi i të cilit është pezulluar si në rastin e kërkuesit, Gjykata e Lartë e ka vlerësuar të drejtë vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit për lejimin e kandidimit, ku pasi ka vënë

në diskutim nëse vepra penale në fjalë është e tillë që të konsiderohet e papajtueshme me ushtrimin e detyrës së magjistratit, në kuptim të nenit 28, shkronja "d", të ligjit nr. 96/2016, ka arritur në përfundimin se sjellja e parregullt e paditëses A.K. nuk cenon rëndë besimin e publikut të gjerë në sistemin e drejtësisë (*shih vendimin nr. 17, datë 23.03.2023, paragrafët 35-43 të GJK-së*).

80. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi gjyqtari i Gjykatës së Lartë A.V. ka qenë pjesë edhe e trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë gjatë gjykimit të çështjes me objekt detyrimin për të njohur kërkuesin pronar të sipërfaqes 240 m^2, për të cilën kjo gjykatë ka dhënë vendimin nr. 348, datë 24.11.2020. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Ndër të tjera, ajo ka vlerësuar se vendimet ku ka marrë pjesë gjyqtari A.V. janë marrë në përfundim të proceseve gjyqësore që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata e vlerësime të ndryshme të gjyqtarit. Dy proceset gjyqësore të zhvilluara janë njëri me kërkime të natyrës juridiko-administrative (vendimet e të cilit janë objekt kundërshtimi në ankimin kushtetues individual) dhe tjetri me kërkime të natyrës juridiko-civile. Pjesëmarrja në trupin gjykues e të njëjtit gjyqtar në dy vendime të dhëna për dy procese të ndryshme, nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 24, datë 11.10.2022, paragrafët 32-39 të GJK-së*).

81. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme në Gjykatën e Lartë, pasi çështja është shqyrtuar pas një periudhe shumë të gjatë dhe është zgjidhur në një kohë shumë të shkurtër, duke cenuar aspektin subjektiv të paanshmërisë. Gjithashtu, në kushtet kur gjykata nuk ka ezauruar të gjitha mjetet e njoftimit të parashikuara nga KPC-ja, është cenuar edhe aspekti objektiv. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, për sa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarëve, nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur prova për të mbështetur pretendimin e tij. Periudha e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë nuk është fakt i mjaftueshëm për të mbështetur pretendimin për paanshmëri në kuptimin subjektiv. Edhe për sa i përket paanshmërisë objektive, kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë për të mbështetur këtë pretendim për të arritur në përfundimin se ka pasur njëanshmëri të gjykatës në shqyrtimin e çështjes (*shih vendimin nr. 28, datë 01.11.2022, paragrafët 24-28 të GJK-së*).

82. Përpara Gjykatës, në një rast, është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në praninë e rrethanave serioze të njëanshmërisë për të pestë anëtarët e trupit gjykues, ku një nga të cilët e ka dhënë vetë dorëheqjen, ndërsa për të tjerët ka kërkuar përjashtimin e tyre nga shqyrtimi i çështjes. Ndonëse kërkesa për dorëheqje dhe kërkesat për përjashtim përmbanin shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 72 të KPC-së, ato nuk u pranuan dhe procesi vijoi me të njëjtin trup gjykues. Njëanshmëria e trupit gjykues është reflektuar në disa nga argumentet e parashtruara në vendimin përfundimtar për çështjen e themelit, sikundër edhe në qëndrimin e mbajtur në çështjen tjetër lidhur me masën e sigurimit

të padisë, vendimin nr. 00-2022-3236(415), datë 01.12.2022, i cili është i ndryshëm nga qëndrimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në rastin e vendimit nr. 128 regjistri, datë 06.05.2020, ku në përbërje të trupit gjykues ka qenë edhe një nga anëtarët në çështjen në gjykim, çka përbën tregues të standardit të dyfishtë, për rrjedhojë njëanshmëri serioze të tij në marrjen e vendimit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, argumentet e dhëna nga kërkuesja për secilin prej gjyqtarëve nuk janë të një natyre dhe shkalle të tillë, sa që në kuptim të testit objektiv këta gjyqtarë të paraqisnin kërkesa për dorëheqje, pavarësisht faktit nëse do të pranoheshin apo jo. Po ashtu, po në kuptim të testit objektiv, nuk provohet njëanshmëria e tyre në kuptim të mosdhënies së garancive të duhura për një vendim të drejtë. Ndërsa, në kuptim të testit subjektiv nuk provohen dyshimet në nivel të mjaftueshëm se atyre u mungonte paanshmëria e nevojshme për gjykim. Lidhur me argumentet dhe përfundimet që Gjykata e Lartë ka parashtruar në vendimin përfundimtar, si dhe me qëndrimin e mbajtur nga ajo me vendimin përkatës lidhur me masën e sigurimit të padisë, sipas Gjykatës, ato janë të lidhura me standardin e arsyetimit dhe me interpretimin e ligjit procedural dhe material nga Gjykata e Lartë, funksion parësor dhe i detyrueshëm për gjyqtarët në fjalë, të cilat, për sa nuk provohet se cenojnë standardet kushtetuese, përfshirë edhe parimin e paanësisë, nuk mund të passjellin cenim të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues (*shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023, paragrafët 34-52 të GJK-së*).

83. Në një rast është pretenduar cenimi i procesit të rregullt në Gjykatën e Lartë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Vendimi nr.1114, datë 07.12.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim. Sipas saj, ndër të tjera, duke u përjashtuar nga gjykimi i çështjes, shumica e anëtarëve të Kolegjeve të Bashkuara dhe duke u pezulluar gjykimi i çështjes, nuk i është dhënë përgjigje kërkesës së kërkuesit. Me largimin e tyre, Kolegjet e Bashkuara nuk mund të kryenin dot funksionet dhe krijohet krizë institucionale, sepse është i vetmi organ që ka kompetencë gjykimin e ankesave të gjyqtarëve ndaj vendimeve të KLD-së. Sipas Gjykatës, Kolegjet e Bashkuara e kanë interpretuar në mënyrë të gabuar vendimin e Gjykatës nr.48, datë 30.07.1999, në të cilin kjo Gjykatë nuk trajton papajtueshmërinë e funksionit të anëtarit të KLD-së me atë të anëtarit të Gjykatës së Lartë, por pranon se cenohet parimi i paanësisë nga marrja pjesë e një personi në shqyrtimin e çështjes konkrete si anëtar i Gjykatës së Lartë dhe si anëtar i KLD-së, në të cilin ka votuar për të larguar gjyqtarin nga puna. Cenimi i parimit të paanësisë nga pjesëmarrja e një anëtari në organin që e largon nga puna dhe në organin që gjykon ankesën, merr rëndësi të veçantë gjatë trajtimit të problemit në aspektin kushtetues, sepse ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut. Në një shoqëri demokratike ka shumë rëndësi besimi i individit tek organi i drejtësisë dhe është detyra e Kolegjeve të Bashkuara, si e çdo organi tjetër gjykimi, që ta mbështesë e stimulojë këtë besim, por gjithmonë duke zhvilluar një proces të rregullt ligjor e duke kryer detyrat funksionale e kushtetuese (*shih vendimin nr. 19, datë 18.04.2000 të GJK-së*).

84. Në një rast Gjykata ka vlerësuar se është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme nga Gjykata e Kasacionit, për shkak se në përbërjen e trupit gjykues që ka

shqyrtuar ankimin e kërkuesit, janë përfshirë edhe dy anëtarë të Gjykatës së Kasacionit, të cilët efektivisht janë edhe anëtarë të KLD-së. Të dy këta gjyqtarë kanë marrë pjesë dhe kanë vendosur për çështjen konkrete dhe në kohën kur kjo është shqyrtuar nga KLD-ja. Sipas Gjykatës, pavarësisht nga votat që kanë dhënë, në favor apo në disfavor të kërkuesit, pjesëmarrja e tyre edhe në Kolegjet e Bashkuara ka vënë objektivisht në dyshim paanësinë e Gjykatës në gjykimin e çështjes. Mosrespektimi i këtyre kërkesave me karakter kushtetues dhe ligjor, si nga këta anëtarë të KLD-së që nuk janë tërhequr vetë nga ky gjykim, ashtu edhe nga anëtarët e tjerë të Gjykatës së Kasacionit, që nuk kanë vendosur për përjashtimin e tyre nga trupi gjykues, sjell në mënyrë të pashmangshme shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të sipërpërmendur të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit, pasi një vendim i tillë cenon të drejtat themelore që kanë të bëjnë me një proces të rregullt ligjor dhe një gjykim të drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme (*shih vendimin nr.43, datë 4.06.1999 të GJK-së*). I njëjti qëndrim është mbajtur nga Gjykata edhe në një rast të ngjashëm (*shih vendimin nr. 48, datë 30.07.1999 të GJK-së*).

3. E drejta për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse[15]

Neni 42, pika 2, i Kushtetutës:

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

1. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një "gjykatë e caktuar me ligj". Ky element, në sensin material, karakterizohet, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 27, datë 24.06.2013; nr. 31, datë 01.12.2005 të GJK-së*).

[15] Standardet e përmendura në këtë pjesë përfshijnë standardet e evidentuara në jurisprudencën e Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/akteve normave dhe ato nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual.

2. Një nga elementet e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është edhe kompetenca lëndore e gjykatës, e cila me ligj është kriter përcaktues i gjykatës që do të vendosë për çështjen dhe i procedurës gjyqësore që do të ndjekë gjykimi konkret. Në përputhje me këtë parim, ligji ka parashikuar verifikimin e kompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjes me kërkesë të palëve ose me nismë të vetë gjykatës, së cilës i paraqitet kërkesëpadia, pra nëse ajo është kompetente në lëndë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së paraqitur. Thelbësore në përcaktimin e kompetencës lëndore është identifikimi i natyrës së mosmarrëveshjes, konkretisht objekti dhe shkaku ligjor i saj. Këtij rregulli i nënshtrohen gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat duhet të zbatojnë përcaktimet ligjore materiale dhe procedurale për organizimin dhe funksionimin e tyre (*shih vendimin nr. 3, datë 07.02.2023, paragrafi 22 i GJK-së*).

3. Kuptimi i kompetencës si kufi i juridiksionit lind nga shumëllojshmëria e organeve që ushtrojnë këtë juridiksion të parashikuara nga rendi juridik, si dhe nga kërkesa që rrjedh prej këtij të fundit për të ndarë këtë pushtet midis organeve shtetërore. Në këtë kuadër, kompetenca e gjyqtarit është kufiri i fundit që përcakton fushën e juridiksionit, brenda fushës së cilës ai është i detyruar të procedojë për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar (*shih vendimet nr. 62, datë 04.11.2016 paragrafi 13; nr. 44, datë 16.07.2014 të GJK-së*).

4. Përcaktimi i saktë i kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, sipas të cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit (*shih vendimet nr. 62, datë 04.11.2016; nr. 27, datë 27.07.2009 të GJK-së*).

5. Vetë kompetenca lëndore e gjykatës është e lidhur ngushtë me kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete. Në këtë kontekst, fjala "ligj", sipas nenit 42 të Kushtetutës, përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave, ku kompetenca për gjykimin e çështjeve penale ka të bëjë me rrethin e akuzave, shqyrtimi i të cilave është atribut i gjykatave të llojeve dhe niveleve të ndryshme. Në përputhje me sa më sipër, Gjykata ka vlerësuar se nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar të pandehurin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është "e krijuar me ligj", sipas kuptimit të nenit 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 62, datë 04.11.2016; nr. 11, datë 23.04.2009 të GJK-së*).

6. Parimin e "gjykatës së caktuar me ligj" Gjykata e ka parë të lidhur ngushtë edhe me përbërjen e trupit gjykues, të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 69, datë 17.11.2015 të GJK-së*). Po ashtu, kjo Gjykatë ka theksuar se një gjykatë e caktuar me ligj duhet të plotësojë një sërë kushtesh, si mënyra e emërimit të anëtarëve, kohëzgjatja e funksionit të tyre apo edhe ekzistenca e garancive procedurale (*shih vendimet nr. 15, datë 11.03.2021, paragrafi 39; nr. 20, datë 09.07.2009 të GJK-së*).

7. Gjykata ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard

ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave (*shih vendimet nr. 34, datë 03.10.2007; nr. 34, datë 25.07.2011 të GJK-së*). Në këtë kuptim, e drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur e të caktuar me ligj, kërkon edhe që gjykata t'i krijojë secilës palë të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë, në raport me palën kundërshtare (*shih vendimin nr. 27, datë 24.06.2013, paragrafi 23 të GJK-së*).

8. Gjykata, në jurisprudencën e saj, pavarësisht karakterit civil apo penal të procesit, është shprehur, se në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe, pra kur vetë ligji ka parashikuar dispozita procedurale kalimtare (*shih vendimet nr. 19, datë 25.04.2013; nr. 11, datë 23.04.2009; nr. 11, datë 19.09.1995 të GJK-së*).

9. Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 38, datë 30.06.2014; nr. 3, datë 19.02.2013; nr. 22, datë 22.07.2009 të GJK-së*).

b. Precedentë/ raste nga gjykimi kushtetues ku çështja e cenimit të gjykatës së caktuar me ligj është vënë në diskutim[16]

A- JURIDIKSIONI CIVIL

a) Për gjykatat e faktit

➢ ***Kompetenca***

10. Në lidhje me vlerën e kërkesëpadisë, si një kusht thelbësor në përcaktimin e përbërjes së rregullt të trupit gjykues, sipas dispozitave të KPC-së, Gjykata në jurisprudencën e saj ka çmuar se ajo (vlera e padisë) përbën njëkohësisht një element esencial për të konkluduar mbi gjykatën kompetente. Në këtë drejtim, mosrespektimi nga ana e gjyqtarit të vetëm, në çastin e paraqitjes së padisë, i këtij rregulli procedural që kërkon zhvillimi normal i një procesi gjykimi, mund të sjellë cenimin e elementit thelbësor kushtetues që lidhet me gjykatën kompetente *(shih vendimet nr. 19, datë 25.04.2013; nr. 13, datë 18.05.2006 të GJK-së)*. Verifikimi i kompetencës, i juridiksionit, apo përbërjes së rregullt të trupit gjykues

[16] Precedentët/rastet nga gjykimi kushtetues të përmendura në këtë pjesë, ku çështja e cenimit të gjykatës së caktuar me ligj është vënë në diskutim, përfshijnë jo vetëm ato të shqyrtuara nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual por edhe ato nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/ akteve normave. Ligjet/aktet normative objekt shqyrtimi ose të referuara nëprecedentët/rastet nga gjykimi kushtetues janë ato akte që kanë në fuqi në kohën e shqyrtimit të këtyre çështjeve.

për gjykimin e një çështjeje, si momente thelbësore të një procesi ligjor, të cilat kanë gjetur pasqyrim në pjesë të veçanta të KPC-së, mbeten si një detyrim për t'u zgjidhur nga vetë gjykata dhe që nuk lidhen domosdoshmërisht me disponibilitetin e palëve në gjykim (*shih vendimin nr. 35, datë 12.12.2003 të GJK-së*).

11. Gjykata, në praktikën e saj, ka vlerësuar pretendimin për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj lidhur me mosrespektimin e kompetencës tokësore nga gjykata. Në vështrim të dispozitave procedurale përkatëse që rregullojnë kompetencën tokësore të gjykatës, bazuar në nenet 42 dhe 43 të KPC-së, "Paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku i padituri ka vendbanimin ose vendqëndrimin e tij (...)". "Kur i padituri është person juridik, paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku personi juridik ka qendrën e tij". Ndërkaq, referuar neneve 53 dhe 54 të KPC,-së "Kur janë shumë të paditur, që kanë banimin ose vendqëndrimin e tyre në vende të ndryshme, padia mund të ngrihet në gjykatën e vendit ku ka banimin ose vendqëndrimin cilido nga të padituri(...)". "E drejta e zgjedhjes ndërmjet shumë gjykatave kompetente i takon paditësit, e cila ushtrohet me ngritjen e padisë". Sipas ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", në fuqi në kohën e ngritjes së padisë, "kundër vendimit të AKKP-së, subjekti i shpronësuar ose Avokati i Shtetit ka të drejtë të bëjë ankim (...) pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas rregullave të KPC-së (neni 18 i ligjit). Gjykata ka vlerësuar se, për sa i përket cenimit të kompetencës tokësore, kërkuesja nuk ka parashtruar argumente bindëse në drejtim të natyrës thelbësore të kësaj shkeljeje, ndikimit të drejtpërdrejtë që kjo shkelje ka në procesin ligjor apo cenimit në thelb të të drejtave të saj kushtetuese, duke konkluduar se pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i pabazuar (*shih vendimin nr. 44, datë 16.07.2014 të GJK-së).*

➢ *Formimi i trupit gjykues*

12. Gjykata ka vlerësuar kërkesën për caktimin e gjyqtarit nëpërmjet shortit, në funksion të parimit të një gjykate të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, si një element thelbësor për një proces të drejtë dhe të rregullt ligjor, i cili mënjanon paragjykimin e çështjes, rrit besimin e shtetasve te sistemi i drejtësisë dhe transparencën e këtij të fundit. Sipas Gjykatës, caktimi i gjyqtarit pa short, jashtë kritereve të përcaktuara rigorozisht në ligj, në kuptim të respektimit të parimit kushtetues të një gjykate të caktuar me ligj, ngre probleme serioze kushtetutshmërie. Debati në jurisprudencën dhe doktrinën evropiane, nëse termi "gjykatë" kur flitet për gjykatë të caktuar me ligj, i takon vetëm gjykatës të identifikuar si organi kompetent për lëndë dhe territor për të zgjidhur çështjen konkrete dhe jo gjyqtarëve si persona fizikë është një problem i cili është zgjidhur pikërisht nga neni 154/a i KPC-së. Ky nen ka parashikuar se gjyqtari "natyral", për të zgjidhur çështjen konkrete, është ai që identifikohet pasi është hedhur shorti dhe çdo procedurë e ndryshme ligjore jo vetëm do t'i binte ndesh ligjit, por do të ishte njëkohësisht në kundërshtim me standardin e sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës. Sipas Gjykatës, parimet e përcaktuara në nenin 42 të Kushtetutës nuk mund t'i referohen vetëm organit gjyqësor kompetent, në lëndë dhe territor, për të gjykuar një çështje të caktuar, por i referohen

edhe gjyqtarit ose trupit gjykues, e cili investohet me zgjidhjen e çështjes konkrete. Në këtë kuptim, një procedurë jo korrekte në përcaktimin e gjyqtarit ose trupit gjykues nuk është në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimin nr. 31, datë 05.07.2011 të GJK-së*).

13. Gjykata, në një rast, ka shqyrtuar pretendimin për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj në lidhje me përmbajtjen e nenit 181 të KPC-së, në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes, ku parashikohej se "Gjykata duhet të organizojë punën që gjykimi i çështjes të përfundojë nga i njëjti trup gjykues. Kur për shkaqe të parashikuara nga paragrafi i tretë i nenit 62 të këtij kodi, ose për shkaqe të tjera të përligjura, ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari i ri duhet të njihet me përmbajtjen e procesit gjyqësor, përveç kur kërkohet prej tij që çështja të shqyrtohet nga fillimi. Kur ndryshon më shumë se një nga anëtarët e trupit gjykues, çështja fillon nga fillimi". Gjykata ka konkluduar se pretendimi është i pabazuar duke vlerësuar se në seancat gjyqësore palët kanë qenë dakord me trupin gjykues, nuk kanë pasur kundërshtime ose vërejtje, zëvendësimi i anëtarëve të trupit gjykues, në të dyja rastet, është bërë në bazë të shortit, duke u respektuar dispozitat përkatëse procedurale. Gjithashtu, pretendimi i kërkuesit është marrë në shqyrtim edhe nga Gjykata e Lartë, e cila, në zbatim të kompetencës së saj për interpretimin e ligjit dhe vlerësimit të zbatimit të tij nga gjykatat më të ulëta, ka vlerësuar se "zëvendësimet e anëtarëve janë bërë në kohë të ndryshme dhe jo në të njëjtën seancë gjyqësore dhe nga ana e tyre është deklaruar se janë njohur me materialet e dosjes dhe janë dakord që të vazhdojë gjykimi aty ku ka ngelur. Në asnjë seancë nuk rezulton që të jenë ndryshuar më shumë se një nga anëtarët e trupit gjykues" (*shih vendimin nr. 12, datë 09.03.2021 të GJK-së*).

b) Për Gjykatën e Lartë

- ***Kompetenca***

14. Në jurisprudencën e Gjykatës është konkluduar se "nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë." Sipas nenit 472 të KPC-së, Kolegji civil ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, por pa bërë një rivlerësim të provave në të kundërt me atë që kanë bërë gjykatat e hallkave më të ulëta. Megjithatë, Gjykata ka theksuar se nuk mund të mbahet i njëjti qëndrim lidhur me parregullsinë e procesit ligjor kur në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe të zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Nisur nga natyra e veçantë e këtij gjykimi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk e ka kompetencën të konkludojë për provat, duke u nisur nga një tjetër vlerësim që kanë bërë gjykata e shkallës së parë dhe e apelit (*shih vendimet nr. 7, datë 09.03.2009; nr. 17, datë, 30.04.2007; nr. 31, datë 01.12.2005 të GJK-së*).

15. Gjykata, në një rast, ka shqyrtuar pretendimin për cenimin e parimit të gjykatës kompetente për arsye se gjatë shqyrtimit të rekursit të kërkuesve, Kolegji Civil i Gjykatës

së Lartë vendosi të dërgojë çështjen në Kolegjet e Bashkuara të asaj gjykate për njësimin e praktikës gjyqësore. Këto të fundit, megjithëse vendosën të mos njësojnë praktikën gjyqësore, por vetëm të verifikojnë shkaqet e ngritura në rekurs dhe pretendimet e palëve i dhanë vetë zgjidhje çështjes dhe nuk ia kthyen atë Kolegjit Civil. Gjykata konkludoi se në çështjen në shqyrtim nuk u dhanë argumente të mjaftueshme kushtetuese për të mbështetur këtë pretendim (*shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008 të GJK-së*).

16. Gjykata në praktikën e saj ka vlerësuar se interpretimi i një dispozite të kontratës apo i përmbajtjes në tërësi të saj, ashtu si dhe interpretimi i ligjit, është brenda kufijve ligjorë të shqyrtimit të çështjeve nga Gjykata e Lartë dhe në përputhje me të drejtën e saj për të vlerësuar respektimin e ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata nuk vlerëson nëse interpretimi i kontratës apo i dispozitave të Kodit Civil nga Gjykata e Lartë është i drejtë nga pikëpamja ligjore, por nëse interpretimi sjell si pasojë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 22, datë 22.07.2009 të GJK-së*).

17. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit. Në rast se Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjyqtarit të faktit, por duhet të kthejë çështjen për rishqyrtim me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe të zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.06.2013; nr. 7, datë 09.03.2009 të GJK-së*).

18. Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *apriori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, konkretisht nëse paditësi ndodhet apo jo përpara rasteve përjashtimore që parashikon ligji, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të gjykatave të faktit nuk rezulton që kjo të jetë vlerësuar. Në rast se Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim me qëllim plotësimin e

këtyre të metave të vendimit (*shih vendimet nr. 32, datë 25.05.2015; nr. 27, datë 24.06.2013; nr. 7, datë 09.03.2009 të GJK-së*).

19. Gjykata, në një rast, ka çmuar se Kolegji i Gjykatës së Lartë ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë duke rivlerësuar provat e administruara e të vlerësuara nga këto gjykata. Kolegji, duke arsyetuar se kërkuesi ka pasur përgjegjësi disiplinore, jo vetëm ka arritur në një përfundim të kundërt me atë të gjykatave më të ulëta, por është mjaftuar vetëm me një paragraf në arsyetimin e qëndrimit të tij. Për këtë arsye, në çështjen konkrete, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke bërë rivlerësim të fakteve e provave të vlerësuara nga gjykata e faktit dhe ajo e apelit, ka ndryshuar në themel vendimet e gjykatave më të ulëta, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj (*shih vendimin nr. 53, datë 20.07.2015 të GJK-së*).

20. Në një rast tjetër, Gjykata ka vërejtur se Gjykata e Lartë ka evidentuar mangësitë e hetimit gjyqësor, që, sipas saj, nuk ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm, pasi gjykata e apelit nuk ka sqaruar plotësisht rrethanat ligjore që lidhen me gjykimin e çështjes, nuk ka përsëritur tërësisht apo pjesërisht hetimin gjyqësor dhe nuk ka marrë prova të reja. Megjithëse ka vënë në dukje këto të meta që kërkonin plotësim, Gjykata e Lartë nuk e ka kthyer çështjen për rishqyrtim, por e ka zgjidhur vetë atë, duke prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Lartë, megjithëse ka vendosur në pjesën urdhëruese lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është mbështetur në një arsyetim të ndryshëm nga ai i kësaj Gjykate në lidhje me provat dhe faktet e administruara gjatë gjykimit. Gjykata vlerësoi se në rastet kur Gjykata e Lartë lë në fuqi vendimin e gjykatës së faktit, si në rastin konkret, ajo nuk mund të bëjë një vlerësim të provave dhe fakteve të ndryshme nga vlerësimi që u ka bërë atyre gjykata e faktit, pasi një gjë e tillë jo vetëm nuk është në përputhje me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, por krijon kontradiksion ndërmjet pjesës arsyetuese dhe dispozitivit të vendimit. Bazuar në përmbajtjen e vendimit të kundërshtuar, Gjykata konstaton se pjesa arsyetuese dhe dispozitivi i tij nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që edhe vendimi të mos ketë një harmoni të brendshme. Për këto arsye, Gjykata konkludoi se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është i bazuar (*shih vendimin nr. 11, datë 03.03.2016 të GJK-së*).

21. Po në lidhje me këtë praktikë, në një çështje, Gjykata ka vlerësuar se Kolegji Civil ka rivlerësuar provat e administruara e të vlerësuara nga gjykatat e faktit, duke arritur në një përfundim të ndryshëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë. Kolegji Civil ka arsyetuar se shkak i aksidentit ka qenë tejkalimi i shpejtësisë, pavarësisht se kjo nuk provohet në vendimet e gjykatave më të ulëta të bazuara në një akt zyrtar, procesverbalin e mbajtur nga Policia Rrugore. Gjykata e Lartë, edhe pse nuk ka vënë në dyshim vlerën e këtij akti zyrtar, ka bërë një vlerësim të ndryshëm të faktit dhe për rrjedhojë të provave, duke ndryshuar në themel vendimet e gjykatave më të ulëta. Gjykata çmoi se nëse Gjykata e Lartë do të kishte dyshime për shkeljen e rregullave

të qarkullimit rrugor si pasojë e shpejtësisë së madhe, duhet të kthente çështjen për rishqyrtim në gjykatat e faktit, duke dhënë udhëzimet përkatëse në mënyrë që ato të arrinin në një konkluzion duke ia nënshtruar provat hetimit të plotë gjyqësor. Për pasojë, Gjykata konkludoi se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj (*shih vendimin nr. 44, datë 19.07.2016 të GJK-së*).

Rishikimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë nga Gjykata e Lartë

22. Lidhur me rishikimin të një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga Gjykata e Lartë, Gjykata është shprehur se vlerësimi që bën Kolegji i Gjykatës së Lartë në këto raste është i ndryshëm nga ai që bën kur vihet në lëvizje nëpërmjet rekursit. Kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Për këto arsye, rishikimi i vendimit, si një mjet ankimor kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, është i kufizuar vetëm në shkaqet e rishikimit të përcaktuara me ligj *(shih vendimin nr.49, datë 10.07.2015 të GJK-së)*. Bazuar në standardet e jurisprudencës kushtetuese dhe nisur nga arsyetimi i Gjykatës së Lartë në rastin konkret, Gjykata çmoi se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka vlerësuar shkakun e rishikimit në raport me e parimin sigurisë juridike dhe në lidhje me të drejtën e pronës. Ai nuk ka arsyetuar se neni 494/ç i KPC-së duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me nenin 495 të KPC-së, sipas të cilit rishikimi i vendimeve për rrethanat e parashikuara në shkronjat "b", "c" dhe "ç" të nenit 494 të KPC-së lejohet kur ato rrethana janë vërtetuar me vendim penal të formës së prerë. Pavarësisht kësaj situate, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se shkaku i rishikimit nuk përligj cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës së pronësisë të njohur me vendim të formës së prerë. Kolegji i Gjykatës së Lartë, duke vendosur rrëzimin e kërkesës, ka kapërcyer kompetencat e tij të parashikuara nga neni 498 i KPC-së, sipas të cilit Gjykata e Lartë ose vendos mospranimin e kërkesës kur ajo është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 494, kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë, si dhe kur rezulton haptazi e pambështetur, ose vendos prishjen e vendimit dhe e dërgon çështjen për rigjykim nga një tjetër trup gjykues në gjykatën kompetente. Për këto arsye, Gjykata arriti në përfundimin se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor *(shih vendimin nr. 74, datë 16.12.2016 të GJK-së*).

23. Në një rast tjetër lidhur me kërkesën për rishikim, Gjykata konstatoi se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit është ndalur vetëm në analizën e përmbushjes së kushtit që provat e reja "të mos kenë qenë e as mund të ishin në dijeni të kërkuesit", duke arritur në përfundimin se ky kusht nuk plotësohet. Nisur nga roli i Gjykatës së Lartë që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, Gjykata ka çmuar se në çështje të kësaj natyre, në drejtim të respektimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, por edhe të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, përmbushja e kritereve që duhet të plotësojë prova e re në kërkesën për rishikim, të përcaktuara nga vendimi unifikues, duhet të shqyrtohet në

seancë dëgjimore, pra në seancë gjyqësore. Gjykata theksoi se shqyrtimi i kërkesës për rishikim në seancë gjyqësore, pasi është verifikuar paraqitja e saj sipas kritereve ligjore në dhomën e këshillimit, ka të bëjë me analizimin në thelb të shkaqeve të rishikimit. Ky vlerësim i përket seancës gjyqësore edhe për faktin se vetëm gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, palët kanë mundësi të realizojnë të drejtën e tyre për t'u dëgjuar, si dhe parimin e kontradiktoritetit, si elemente përbërëse të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjykata e Lartë nuk duhet të mjaftohet me një trajtim formal të çështjes, por duhet që pavarësisht situatës juridike të marrë të gjitha masat që e drejta e aksesit të garantohet efektivisht. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë në rastin konkret ishte e detyruar ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimin nr. 52, datë 24.07.2017 të GJK-së*).

- ***Formimi i trupit gjykues***

24. Në një rast përpara Gjykatës u ngrit pretendimi se pjesëmarrja e gjyqtarit A.Ç., të cilit i kishte mbaruar mandati, në trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen në Gjykatën e Lartë, ka sjellë cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj. Gjykata evidentoi se me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, të bëra me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", në nenin 136 të Kushtetutës u shtua pika 5, e cila ka të bëjë me parashikimin e rregullit të vazhdimit të qëndrimit në detyrë të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Aktualisht, neni 136, pika 5, i Kushtetutës parashikon shprehimisht se "Gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 139, paragrafi 3, nënparagrafët "c", "ç", "d" dhe "dh"". Nga ana tjetër, me dispozitat kalimtare të Kushtetutës, konkretisht pikat 1 dhe 4 të nenit 179 të saj, është synuar të rregullohet periudha kalimtare e krijuar për shkak të ndryshimit të formulës dhe procedurës së përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të këtyre gjykatave, duke sanksionuar jo vetëm parimin e vazhdimësisë së mandatit kushtetues dhe të ndalimit të kufizimit apo ndërprerjes së mandatit të mëparshëm, por duke përcaktuar edhe zbatueshmërinë e procedurave të reja të emërimit vetëm për gjyqtarët e zgjedhur pas hyrjes në fuqi të dispozitave kushtetuese. Më konkretisht, pika 4 e nenit 179 të Kushtetutës parashikon: "Anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e tyre sipas mandatit të mëparshëm. Anëtarët e rinj që do të zëvendësojnë anëtarët, të cilëve u mbaron mandati, emërohen sipas dispozitave të këtij ligji.". Kjo dispozitë nuk ndërhyn në përmbajtjen e nenit 136, pika 1, të Kushtetutës, i cili përcakton mandatin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, dhe nga mënyra se si është formuluar ajo nuk përjashton as efektet e rregullimit të ri kushtetues të vazhdimësisë së detyrës së tij deri në emërimin e pasardhësit, sipas parashikimit të nenit 136, pika 5, të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata ritheksoi se fryma që përshkon Kushtetutën, edhe pas ndryshimeve kushtetuese, është vazhdimësia institucionale dhe ushtrimi i funksioneve, me qëllim garantimin e vlerave dhe parimeve që qëndrojnë në themel të shtetit të së drejtës dhe se qëllimi i përmbajtjes së nenit 179, pika 4, është që në respektim të parimit të vazhdimësisë së detyrës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të vijojë normalisht veprimtaria e këtij organi kushtetues *(shih vendimin nr. 34, datë 10.04.2017 të GJK-së)*. Për këto arsye, Gjykata

konkludoi se pjesëmarrja e gjyqtarit A.Ç. në trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen e kërkueses në Gjykatën e Lartë, ka qenë në përputhje me dispozitat kushtetuese në fuqi (*shih vendimin nr. 15, datë 11.03.2021 të GJK-së*).

25. Gjykata në praktikën e gjykimit kushtetues ka konstatuar se neni 13/1 i ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë", të përditësuar, parashikon se Kolegjet e Gjykatës së Lartë gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë, përveçse kur legjislacioni procedural në fuqi parashikon ndryshe. Edhe neni 35/5 i KPC-së parashikon se Gjykata e Lartë gjykon në kolegj me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë të gjitha çështjet që, sipas këtij neni, në gjykatën e shkallës së parë gjykohen nga një gjyqtar. Çështjet e tjera gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Në kuptim të këtyre dispozitave, Gjykata ka vlerësuar se kërkesat për rishikim në Gjykatën e Lartë, duke qenë mjete të jashtëzakonshme ankimi, në çdo rast, duhen shqyrtuar nga një trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Në rastin konkret, Gjykata vërejti se Gjykata e Lartë e kishte shqyrtuar kërkesën për rishikim me një trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Për pasojë, Gjykata vlerësoi se gjatë shqyrtimit të çështjes nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, trupi gjykues nuk është formuar komform parashikimeve ligjore të nenit 13/1 të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000 të lartpërmendur, duke sjellë cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj (*shih vendimin nr. 76, datë 22.12.2015 të GJK-së*).

26. Lidhur me formimin e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë në një rast tjetër, Gjykata, vlerësoi se pjesëmarrja në kolegj e gjyqtarit ishte në përputhje me ligjin përkatës. Neni 13 i ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë", përcakton se "Kolegjet e Gjykatës së Lartë gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Kur trupi gjykues nuk mund të formohet nga gjyqtarët e një kolegji, ai plotësohet me gjyqtarë të kolegjit tjetër. Këta gjyqtarë caktohen me short." Në këto kushte, Gjykata konkludoi, se kërkuesi nuk ka vërtetuar se neni 13 i sipërcituar është shkelur nga Gjykata e Lartë dhe se pjesëmarrja e gjyqtarit tjetër nuk është hedhur në short nga kjo gjykatë. Po ashtu, fakti që ky gjyqtar është anëtar i Kolegjit Penal nuk e bën këtë proces të parregullt në kuptimin kushtetues (*shih vendimin nr. 23, datë 04.11.2018 të GJK-së*).

B- JURIDIKSIONI PENAL

a) Për gjykatat e faktit

➢ ***Kompetenca***

27. Sipas Gjykatës, fjala "ligj" në nenin 42 të Kushtetutës, përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave, ku kompetenca për gjykimin e çështjeve penale ka të bëjë me rrethin e akuzave, shqyrtimi i të cilave është atribut i gjykatave të llojeve dhe niveleve të ndryshme. Në përputhje me sa më sipër, Gjykata ka vlerësuar se nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar të pandehurin në përputhje me

dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është "e krijuar me ligj", sipas kuptimit të nenit 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 16, datë 27.02.2022, paragrafi 33; nr. 62, datë 04.11.2016; nr. 31, datë 01.12.2005 të GJK-së*).

28. Gjykata ka vlerësuar se nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar të pandehurin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është "e krijuar me ligj", sipas kuptimit të nenit 42 të Kushtetutës. Detyrimi i respektimit nga gjyqtari të kufirit të kompetencës është, ndër të tjera, parakusht për të mos lejuar që shumë gjyqtarë të ushtrojnë të njëjtin pushtet me vendime për një fakt të caktuar. Prandaj, për çdo rast dhe çështje të mundshme, ligji ka parashikuar një gjykatë kompetente për të gjykuar. Shqyrtimi i një çështjeje nga një gjykatë jo kompetente nuk përbën në çdo rast vetëm një shkelje procedurale, por ka të bëjë edhe me respektimin e së drejtës kushtetuese për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Marrja nga një gjykatë e kompetencës që i takon me ligj një gjykate tjetër, mund të bëhet vetëm nëse e lejon ligji dhe vetëm nga gjykatat që ai cakton (*shih vendimet nr. 47, datë 11.11.2013, paragrafët 9-10; nr.11, datë 23.04.2009 të GJK-së*).

29. Gjykata, e vënë në lëvizje në rrugë incidentale, ka kontrolluar kushtetutshmërinë e nenit 375 të KPP-së, duke konkluduar se kjo dispozitë është në përputhje me parimet e kushtetuese të zhvillimit të një gjykimi të drejtë nga një gjykatë e paanshme. Sipas saj, neni 375 i KPP-së, në dallim nga neni 372 i KPP-së, parashikon ndryshimin e cilësimit juridik të veprës dhe të drejtën e gjykatës t'i japë faktit një përcaktim juridik të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori. Ky formulim i ndryshëm i këtyre neneve tregon se gjykata nuk është organ akuze, nuk formulon akuzë të re dhe as e ndryshon atë, por mbi bazën e faktit të paraqitur, bën cilësimin e duhur ligjor të veprës, duke i dhënë faktit një përcaktim tjetër. Në këtë rast, gjykata bën një interpretim të ligjit që ajo zbaton dhe që është në kompetencë të saj dhe nuk cenon aspak kompetencat e prokurorit. Gjykata e faktit, duke i dhënë faktit një përcaktim juridik të ndryshëm nga ai i prokurorit, mund të bëjë që cilësimi i ri të jetë një vepër penale më e lehtë ose më e rëndë. Në rastin e fundit, nuk do të thotë se rëndohet pozita e të pandehurit. Rëndimi i pozitës trajtohet në raport me shkallën më të lartë të gjykimit. Kur gjykata bën cilësimin e drejtë ligjor të veprës, pavarësisht nga karakteri i saj më i rëndë, ajo ka bërë një zbatim të drejtë të ligjit dhe duke vënë në dijeni palët u krijon atyre mundësinë për t'u ankuar ndaj vendimit. Për \zbatimin e nenit 375 të KPP-së kërkohen edhe kushte të tjera. Njëri nga kushtet është që gjykata këtë ndryshim mund ta bëjë kur vepra penale është në kompetencën e saj. Në rast se vepra penale nuk është në kompetencë të gjykatës, ajo nuk mund ta bëjë ndryshimin, por ia dërgon çështjen organit kompetent. Kushti tjetër është që për ndryshimin, ajo të verë në dijeni palët. Kur gjykata bën ndryshimin gjatë seancës me vendim të ndërmjetëm, ua komunikon atë palëve. Por, në rast se gjykata konstaton se duhet bërë ndryshimi i cilësimit juridik të veprës pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor kur është tërhequr për vendim, atëherë duhet të riçelë seancën dhe të vërë në dijeni palët, dhe të dëgjojë edhe pretendimet e tyre. Kështu, ajo garanton të drejtën e mbrojtjes dhe të akuzës së prokurorit. Zbatimi në këtë mënyrë i kërkesave të nenit 375 të KPP-së është një garanci për zhvillimin e një procesi të rregullt

ligjor, duke e vënë gjykatën në rolin që i takon për dhënien e drejtësisë (*shih vendimin nr. 50, datë 30.07.1999 të GJK-së*).

30. Gjykata, lidhur me pretendimin e ngritur para saj në rrugën incidentale (kontrolli kushtetues i ligjit nr. 41/2021, datë 23.03.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar"), se pika 2 e nenit 135 të Kushtetutës është shteruese, duke përcaktuar drejtpërdrejt kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme në lidhje me çdo vepër penale të korrupsionit, dhe nuk parashikon delegimin e posaçëm për rregullimin e kësaj çështjeje me ligj, në lidhje me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, ka vlerësuar se ky pretendim nuk është i bazuar. Sipas saj, Kushtetuta nuk ka pasur si qëllim të përfshijë të gjitha veprat penale të korrupsionit në kompetencë të gjykatave të posaçme dhe se, bazuar në këtë qëllim të kushtetutëbërësit, ligjvënësi ka kategorizuar në dispozitën e kundërshtuar ato vepra penale që shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme dhe ato që shqyrtohen nga gjykatat e posaçme, referuar vlerës së përfituar. Edhe në këtë rast, ajo ka vërejtur se është në diskrecionin e ligjvënësit që, duke pasur parasysh natyrën e secilës vepër penale të korrupsionit dhe marrëdhëniet juridike konkrete që synohen të mbrohen, të bëjë edhe kategorizimin e tyre, çka është në linjë edhe me qëllimin e kushtetutëbërësit të evidentuar sa më sipër. Gjykata ka vlerësuar se ndërsa kjo dispozitë kushtetuese përcakton juridiksionin e gjykatave të posaçme, brenda juridiksionit të përgjithshëm penal, vetëm për disa kategori veprash penale, ajo jo vetëm nuk përmban një ndalim të shprehur, por as nuk mund të interpretohet se ky juridiksion përjashton kompetencën e gjykatave të zakonshme për gjykimin e veprave penale që lidhen me korrupsionin. Në lidhje me gjykatat e posaçme, kategoria e veprave penale të parashikuara nga norma kushtetuese duhet të interpretohet në përputhje me qëllimin për të cilin janë ngritur strukturat e posaçme që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, për shkak të rëndësisë së marrëdhënieve të posaçme juridike që cenohen nga këto vepra. Në këtë kuptim, përdorimi i lidhëzës "dhe" në përmbajtjen e pikës 2 të nenit 135 nuk është i paqëllimtë. Qëllimi i normës kushtetuese ka qenë të kategorizojë brenda juridiksionit penal të posaçëm ato vepra penale të të njëjtit nivel për nga rëndësia dhe natyra e tyre. Kushtetuta nuk ka pasur si qëllim të përfshijë të gjitha veprat penale të korrupsionit në kompetencë të gjykatave të posaçme dhe se bazuar në këtë qëllim të kushtetutëbërësit, ligjvënësi ka kategorizuar në dispozitën e kundërshtuar ato vepra penale që shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme dhe ato që shqyrtohen nga gjykatat e posaçme, referuar vlerës së përfituar. Edhe në këtë rast, Gjykata vëren se është në diskrecionin e ligjvënësit që, duke pasur parasysh natyrën e secilës vepër penale të korrupsionit dhe marrëdhëniet juridike konkrete që synohen të mbrohen, të bëjë edhe kategorizimin e tyre, çka është në linjë edhe me qëllimin e kushtetutëbërësit të evidentuar sa më sipër (*shih vendimin nr. 16, datë 27.02.2022, paragrafët 38-43 të GJK-së*).

31. Përpara Gjykatës, në një rast, është ngritur pretendimi se Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, pasi bazuar në nenin 375 të KPP-së, duke i dhënë faktit një përcaktim të ndryshëm nga Gjykata e Shkallës së Parë për

Krime të Rënda, e ka dënuar kërkuesin për një tjetër vepër penale (shpërdorim detyre të kryer në bashkëpunim), të parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të KP-së, e cila sipas nenit 75/a të KPP-së nuk hyn në kompetencën e gjykatës për krime të rënda. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, gjykata për krime të rënda ka qenë kompetente për të shqyrtuar akuzat e ngritura ndaj kërkuesit për arsye se, ndër të tjera, ligji nr.9276, datë 16.09.2004, që ndryshoi kompetencën lëndore të gjykatave të krimeve të rënda, ka parashikuar shprehimisht kompetencën lëndore të gjykatës për krime të rënda në rastin specifik kur gjatë gjykimit në këtë të fundit ndryshohet cilësimi juridik i veprës penale dhe për veprën e re penale kompetente është një gjykatë tjetër (*shih vendimin nr. 16, datë 27.03.2012, paragrafi 19 të GJK-së*).

32. Në një rast tjetër, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe ajo e Apelit për Krime të Rënda, duke gjykuar vetë çështjen për një vepër penale që i takon kompetencës së gjykatave të zakonshme të sistemit gjyqësor, kanë cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Sipas saj, në bazë të nenit 2/2 të ligjit nr.9110, datë 27.07.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda", ato janë hallka të sistemit gjyqësor që shqyrtojnë në shkallë të parë dhe të dytë krimet me rrezikshmëri të lartë, të përcaktuar në ligj. Shqyrtimi i një çështjeje nga një gjykatë jo kompetente nuk përbën në çdo rast vetëm një shkelje procedurale, por ka të bëjë edhe me respektimin e së drejtës kushtetuese për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Marrja nga një gjykatë e kompetencës që i takon me ligj një gjykate tjetër, mund të bëhet vetëm nëse e lejon ligji dhe vetëm nga gjykatat që ai cakton. Ligjvënësi, me shtesat dhe ndryshimet e bëra, ndërsa ka parashikuar në kodet e procedurave penale e civile pasojat e mosrespektimit të kësaj ndarjeje, nuk ka parashikuar ndonjë përjashtim për gjykimin e ndonjë çështjeje nga gjykatat e krimeve të rënda kur ajo sipas ligjit i takon të gjykohet nga gjykatat e zakonshme të rretheve gjyqësore. Mosrespektimi i kompetencës lëndore e bën vendimin gjyqësor absolutisht të pavlefshëm dhe pretendimi për respektimin e kësaj kompetence mund të ngrihet si nga i pandehuri/i gjykuari, ashtu edhe kryesisht në çdo fazë të procesit. Në ndryshim nga kompetenca lëndore, akti i dhënë në mungesë të kompetencës tokësore është një akt relativisht i pavlefshëm dhe deklarohet si i tillë nga gjykata mbi kërkesën e palëve, bërë para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor (*shih vendimin nr. 11, datë 23.04.2009, paragrafi 19, të GJK-së*).

33. Në një rast është pretenduar cenimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj për arsye se kompetente për shqyrtimin e çështjes kanë qenë gjykatat e shkallës së parë dhe apelit për krime të rënda, ndërkohë që çështja është shqyrtuar nga gjykatat e judiksionit të zakonshëm. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, kjo është e qartë nga ligji nr.9110, datë 24.07.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës për Krime të Rënda dhe Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda", që parashikon se këto gjykata e fillojnë veprimtarinë nga data 01.01.2004, pra pasi procesi ndaj kërkuesit kishte filluar. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.215, datë 21.04.2004, në çështjen me objekt: "Zgjidhja e mosmarrëveshjes për kompetencë", të parashikuar në nenin 91/1 të KPP-së shprehet se gjykata kompetente për gjykimin e çështjes është ajo e apelit Tiranë dhe jo Gjykata e Apelit për Krime të Rënda. Referuar dhe në vendimin nr.1, datë

16.04.2004 të Kolegjeve të Bashkuara, nëse vendimi që ankimohet në gjykatën e apelit është dhënë në shkallë të parë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kompetente për shqyrtimin e çështjes është Gjykata e Apelit Tiranë. (*shih vendimin nr. 23, datë 23.07.2009, paragrafët 30-31 të GJK-së*).

34. Në një gjykim incidental përpara Gjykatës është ngritur pretendimi se parashikimet në nenin 147, pikat 4 dhe 6, të KPP-së cenojnë parimin kushtetues të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar pretendimin vetëm për sa i përket pikës 6 të nenit 147 të KPP-së, duke vendosur shfuqizimin si jo në përputhje me Kushtetutën. Gjykata ka vlerësuar se kuptimi/zbatimi jo i drejtë i dispozitës së nenit 147/4 rrjedh pikërisht nga togfjalëshi "në gjykatën e apelit", i parashikuar në nenin 147/6 të KPP-së. Nëse pjesë e këtij togfjalëshi nuk do të ishte "e apelit", atëherë ankimi do të bëhej në gjykatën më të lartë respektive ndaj vendimit të dhënë nga një gjykatë më e ulët, kompetenca e së cilës do të përcaktohej sipas rastit. Në këtë mënyrë, do të garantohej edhe parimi i gjykatës së caktuar me ligj, i parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës (*shih vendimin nr. 31, datë 17.05.2012 të GJK-së*).

- ***Formimi i trupit gjykues***

35. Në një rast është pretenduar cenimi i parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, me argumentin se në caktimin e gjyqtarëve për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Tiranë, në rastin në shqyrtim, KLD-ja ka vepruar në kundërshtim me dispozitën përkatëse. Nuk rezulton se gjyqtarët e caktuar kanë dhënë dorëheqjen për shqyrtimin e çështjes në ngarkim të tyre dhe, për pasojë, nuk është e vërtetë se në Gjykatën e Apelit Tiranë nuk mund të formohej trupi gjykues për gjykimin e kësaj çështjeje. Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim, duke argumentuar se sipas nenit 28/4 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", KLD-ja, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, mund të emërojë një gjyqtar të gjykojë një numër çështjesh në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel, nëse mungojnë gjyqtarët në këtë gjykatë. Në rastin në shqyrtim, siç ka rezultuar edhe nga materialet e dosjes, në kundërshtim me sa pretendojnë kërkuesit, disa nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, kanë dhënë dorëheqjen, e cila është pranuar nga kryetari i kësaj gjykatë në bazë të rregullave të KPP-së. Për pasojë, ka qenë pikërisht rasti që parashikon dispozita e mësipërme e ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor (...)" kur KLD-ja cakton gjyqtarë për të gjykuar për llogari të një gjykate tjetër (*shih vendimin nr. 14, datë 17.04.2007 të GJK-së*).

b) Për Gjykatën e Lartë

- ***Kompetenca***

36. Përpara Gjykatës në një rast, në rrugë incidentale, është pretenduar cenimi i parimit të gjykatës së caktuar me ligj nga parashikimi në nenin 80/2 të KPP-së, me argumentin se juridiksioni fillestar i Gjykatës së Lartë është përjashtim i përcaktuar në nenin 141/1 të Kushtetutës, bazuar vetëm në cilësinë e subjektit të pandehur, ndërkohë që neni 80/2 i

KPP-së bëhet shkak për shtrirjen e juridiksionit fillestar edhe tej subjekteve që parashikon shprehimisht Kushtetuta. Neni 80/2 i KPP-së përbën pengesë për realizimin e një procesi të rregullt ligjor për të pandehurit që nuk janë deputetë. Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim. Ajo ka vlerësuar se në rastet e gjykimit të çështjeve penale ndaj disa kategori funksionarësh publikë Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar, i cili i është njohur nga neni 141/1 i Kushtetutës. Në përputhje me këtë dispozitë kushtetuese, neni 80 i KPP-së ka përcaktuar Gjykatën e Lartë si gjykatën kompetente edhe në rastin e bashkimit të procedimeve që janë në kompetencë të gjykatave të ndryshme. Në kushtet kur në shqyrtimin e këtyre çështjeve kompetenca lëndore e Gjykatës së Lartë është e parashikuar me ligj, nuk ka cenim të standardit të gjykatës së caktuar me ligj (*shih vendimin nr. 62, datë 04.11.2016, paragrafi 15 të GJK-së*).

37. Në një rast është pretenduar cenimi i parimit të gjykatës së caktuar me ligj nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili, pas shpalljes së vendimit nr.47, datë 26.07.2012 të Gjykatës ka vlerësuar se dënimi me gjobë në vlerën prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh, i caktuar nga gjykata e shkallës së parë për kërkuesen, i përgjigjet dënimit plotësues, pasi dënimi me gjobë nuk mund të jepet si dënim kryesor së bashku me dënimin me burgim, duke lënë në fuqi për kërkuesen si dënimin me burgim (si dënim kryesor), ashtu edhe atë me gjobë (si dënim plotësues). Gjykata ka konkluduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me këtë vendim, ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Sipas saj, vlerësimi i tërësisë së faktit penal, në lidhje me të gjitha elementet dhe rrethanat që e përbëjnë atë, me qëllim të individualizimit të shkallës së përgjegjësisë të të pandehurit dhe përshtatshmërisë së dënimit, hyn në fushën e diskrecionalitetit të gjyqtarit të faktit, kurse Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural dhe kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Në këtë kuptim, në rastin konkret, Gjykata e Lartë, duke dhënë për kërkuesen dënimin me gjobë krahas atij me burgim, ndërkohë që gjykata e shkallës së parë nuk ka hetuar nëse plotësoheshin kushtet e nenit 34/5 të KP-së, ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj (*shih vendimin nr. 47, datë 11.11.2013, paragrafët 14-16 të GJK-së*).

38. Në një rast tjetër, është pretenduar cenim i parimit të gjykatës së caktuar me ligj nga Kolegji Penal, pasi ky Kolegj është shprehur me vendim për mosfillimin e procedimit penal, duke marrë një kompetencë që nuk është e tij, por është ekskluzivitet i prokurorisë. Gjykata ka konkluduar se pretendimi është i bazuar. Ajo ka vërejtur se Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar në rastet e parashikuara nga neni 141 i Kushtetutës. Duke qenë se Gjykata e Lartë ka juridiksionin fillestar, ajo zbaton dhe i nënshtrohet të njëjtave rregullave procedurale që do të zbatonte në një rast të tillë një gjykatë e zakonshme. Në kuptim të nenit 148 të Kushtetutës, procedimi penal dhe ngritja e akuzës publike është tagër i prokurorisë, kurse ngritjen e akuzës private ligjvënësi e ka lënë në vlerësim të personit të dëmtuar nga vepra penale dhe është vetëm ky i fundit që vendos nëse do t'i drejtohet

gjykatës për të provuar akuzën e tij dhe për t'u përballur me personin e akuzuar. Gjykata ka ritheksuar se, në ndryshim nga rastet tipike të akuzës publike, ku prokuroria, si organ i specializuar i ndjekjes penale, kryen hetime paraprake me qëllim të vërtetimit të akuzës dhe dërgimin e çështjes për gjykim, në rastet e akuzës private mungon faza e hetimeve paraprake që zhvillohet nga prokurori. Mungesa e fazës së hetimeve paraprake në këtë lloj gjykimi nuk nënkupton që gjykata, gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave, mund të ushtrojë kompetenca të cilat ligjvënësi ia ka njohur specifikisht organit të akuzës, gjatë kësaj faze procedurale. Kompetencat e gjykatës, edhe gjatë shqyrtimit të kësaj kategorie çështjesh, janë të njëjta me ato të cilat ajo ushtron edhe në rastin kur vihet në lëvizje në bazë të akuzës së ngritur nga prokurori. Vendimi për mosfillimin e procedimit penal është kompetencë ekskluzive e organit të prokurorisë. Gjykata e Lartë, nëse vlerëson mungesën e kritereve ligjore për procedim, nuk mund të shprehet me vendim për mosfillimin e procedimit penal, por duhet të bazohet në dispozitat që i janë njohur asaj gjatë fazës së gjykimit. Duke marrë një vendim të tillë, për mosfillimin e procedimit penal, Gjykata e Lartë i ka atribuar vetes një kompetencë, e cila jo vetëm që nuk i njihet nga ligji, por që njëkohësisht i ka cenuar edhe pozicionin e saj si organ që realizon me paanshmëri dhënien e drejtësisë. Në rastet kur gjykata (e zakonshme apo edhe Gjykata e Lartë) vihet në lëvizje me anë të kërkesës së të dëmtuarit akuzues, ajo, njësoj si në rastin kur është vënë në lëvizje nga organi i prokurorisë, është e detyruar të ushtrojë funksionet e saj për dhënien e drejtësisë. Mosfillimi i ndjekjes penale është atribut vetëm i prokurorisë dhe vetëm për çështjet që, sipas KPP-së, janë në kompetencë të saj (*shih vendimin nr. 27, datë 9.05.2012, paragrafët 18-21 të GJK-së*).

III.

39. Në një rast, përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj nga ana e Gjykatës së Lartë, pasi në shqyrtimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit, Gjykata e Lartë (dhoma e këshillimit) nuk duhej të ishte mbështetur tek neni 432 i KPP-së, por tek neni 249 i KPP-së, i cili përcakton shqyrtimin e ankimit brenda 15 ditëve në seancë gjyqësore, për rrjedhojë, edhe procedura e ndjekur nga dhoma e këshillimit nuk është realizuar sipas standardeve të procesit të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim. Sipas saj, kompetenca e Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi për mospranimin e rekursit, jashtë shkaqeve të përcaktuara në nenin 432 të KPP-së pa pjesëmarrjen e palëve, e justifikon të njëjtën procedurë edhe në rast të zbatimit të nenit 249 të KPP-së për ankim ndaj masave të sigurimit. Gjithashtu, Gjykata ka çmuar se mosrespektimi i afatit 15-ditor, të përcaktuar nga neni 249/10 i KPP-së për marrjen e vendimit nga Gjykata e Lartë, në rast rekursi kundër masave të sigurimit, nuk sjell humbjen e fuqisë së masës së sigurimit, në dallim nga mosrespektimi i afatit 10 - ditor për marrjen e vendimit në rast apelimi të masës së sigurimit në Gjykatën e Apelit, sipas nenit 249/5 të KPP-së, dhe kjo për arsye se neni 249/7 i KPP-së ka përcaktuar në mënyrë të shprehur vetëm efektet e mosrespektimit të afatit 10 -ditor në rast mosshqyrtimi të apelit (*shih vendimin nr. 28, datë 23.06.2011, paragrafi 23 të GJK-së).*

C- JURIDIKSIONI ADMINISTRATIV

a) Për gjykatat e faktit

➢ ***Kompetenca***

40. Gjykata ka konstatuar se sipas vendimit unifikues nr. 3, datë 06.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjykatat administrative të të gjitha niveleve, të krijuara me ligjin nr. 49/2012, janë kompetente për çështjet administrative për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 04.11.2013 dhe deri në këtë datë shqyrtimi në gjykata nuk ka përfunduar ende. Ndërsa, sipas vendimit unifikues nr. 4, datë 10.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, shqyrtimi i mosmarrëveshjeve me objekt kundërshtimin e vendimeve të KKKP-ve mund të bëhet vetëm nga gjykatat e zakonshme civile në përputhje me dispozitat e KC-së dhe të KPC-së. Për këto arsye, çështje të këtij lloji do të konsiderohen si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohen nga gjykata që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve civile (*shih vendimin nr. 3, datë 07.02.2023, paragrafi 25, i GJK-së*).

b) Për Gjykatën e Lartë

➢ ***Kompetenca***

41. Gjykata ka pohuar se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme dhe se ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë e ligjit, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 6, datë 16.02.2021 të GJK-së*).

42. Gjykata, në një rast, ka konkluduar se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, duke argumentuar, ndër të tjera, se: "Në kuptim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, si pjesë e pushtetit gjyqësor, organizohet me ligj në tre kolegje me kompetencë lëndore të ndryshme, sipas objektit të mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Për sa i takon kompetencës së kolegjeve, vërehet se Kolegji Civil shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm për çështje tregtare, civile dhe familjare, si dhe çështje të tjera të caktuara në kompetencë me ligj, ndërsa Kolegji Administrativ shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave administrative. Në kontekstin e rrethanave të mësipërme, në rastin konkret, Gjykata konstaton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim dhe ka vlerësuar në themel rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar ndaj vendimeve të gjykatave të juridiksionit civil. Pavarësisht se moskompetenca lëndore shqyrtohet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të procesit, në vendimin e tij Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar se përse ishte kompetent për shqyrtimin e

mosmarrëveshjes, pavarësisht se çështja e kompetencës lëndore ka qenë objekt diskutimi gjatë të gjithë procesit gjyqësor, përfshirë atë në Gjykatën e Lartë"(*shih vendimin nr. 3, datë 07.02.2023, paragrafët 29-30 të GJK-së*).

43. Gjykata, lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës së Lartë, pas ndryshimeve kushtetuese në vitin 2016, në një rast, ka analizuar kuadrin kushtetues dhe ligjor në raport me kohën e procedimit disiplinor (viti 2013), dhënien e masës disiplinore (viti 2014), ankimin kundër vendimit të shkarkimit nga detyra (viti 2014), pezullimin e shqyrtimit të ankimit nga Kolegjet e Bashkuara (viti 2016 - para ndryshimeve kushtetuese) dhe kohën e shqyrtimit të ankimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (viti 2022). Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 është reformuar kompetenca e Gjykatës së Lartë dhe konkretisht e Kolegjeve të Bashkuara, pasi tashmë kjo e fundit shqyrton çështje të caktuara gjyqësore për ndryshimin e praktikës gjyqësore (neni 141, pika 2). Sipas saj, para ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, mosmarrëveshjet e ngritura në bazë të ankimeve ndaj vendimeve të KLD-së për shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve përfshiheshin në juridiksionin gjyqësor (fillestar) të Gjykatës së Lartë, ku kompetenca lëndore dhe ajo funksionale për shqyrtimin e tyre u përkiste Kolegjeve të Bashkuara të saj. Ndërsa pas ndryshimeve të vitit 2016, mosmarrëveshjet e ngritura në bazë të ankimeve kundër vendimeve disiplinore në përgjithësi ndaj gjyqtarëve, përfshirë edhe për shkarkimin e tyre nga detyra, u përfshinë në juridiksionin kushtetues, duke i kaluar kështu juridiksioni gjyqësor për këto çështje Gjykatës dhe për një periudhë të përkohshme një prej kolegjeve të kësaj gjykate (KPA-së). Pra, pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, Gjykatës së Lartë i është hequr e drejta për të shqyrtuar dhe zgjidhur mosmarrëveshjet e ngritura mbi ankimet kundër vendimeve të shkarkimit të gjyqtarëve, duke rënë për pasojë edhe kompetenca e saj lëndore për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të kësaj natyre. Gjithashtu, referuar përmbajtjes së dispozitave kushtetuese, gjatë periudhës kalimtare të ushtrimit të mandatit nga KPA-ja, juridiksioni gjyqësor disiplinor i përket ekskluzivisht kësaj të fundit dhe vetëm në përfundim të këtij mandati kushtetues ky juridiksion do të ushtrohet nga Gjykata. Sipas Gjykatës, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka qenë ndonjëherë gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit të gjyqtarit ndaj vendimit të KLD-së për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit, as para ndryshimeve, as pas ndryshimeve të vitit 2016 (*shih vendimin nr. 36, datë 24.11.2022, paragrafët 29-31 të GJK-së*).

44. Në një rast tjetër, Gjykata ka konstatuar se edhe pse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se veprimet e kërkueses përbëjnë shkelje me faj të rëndë të detyrimeve kontraktuale, për të arritur në këtë përfundim ai nuk e ka shqyrtuar çështjen lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, në kuptimin e respektimit të kufijve të kompetencës kushtetuese të Gjykatës së Lartë. Sipas Gjykatës, Kolegji Administrativ është mjaftuar me referencën ligjore të zgjidhjes së çështjes, pa dhënë kuptimin dhe zbatimin e ligjit material në raport me ndonjë detyrim konkret të kontratës së punës të shkelur nga kërkuesja, si dhe ndonjë element konkret në të cilin është mbështetur për përcaktimin e shkeljes së kryer me faj të rëndë dhe/ose pasojave të ardhura nga veprimet ose mosveprimet e vlerësuara si të tilla, pavarësisht se

largimi nga puna ose zgjidhja e menjëhershme e marrëdhënies së punës është një masë ekstreme dhe, si e tillë, në çdo rast duhet parë si alternativa e fundit për t'u përzgjedhur nga punëdhënësi. Kjo, për më tepër, kur rezulton se gjatë gjykimit në gjykatat e faktit, në vendimet e tyre, Bashkia Tiranë nuk ka arritur të provojë ekzistencën e asnjë rrethane të rëndë që të vlerësohet si shkak i justifikuar për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës, sipas nenit 153, pika 3, të KP-së, për rrjedhojë të argumentojë ligjshmërinë e aktit të saj. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka shqyrtuar dhe vendosur për çështje fakti që nuk janë në kompetencë të saj gjatë procesit të zhvilluar për çështjen e kërkueses, duke mos ndjekur procedurën ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. Ndonëse funksioni i saj kushtetues është gjykatë ligji, Gjykata e Lartë ka ndryshuar vendimet e gjykatave të faktit dhe është shprehur për themelin e çështjes, duke bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta. Ajo ka nxjerrë konkluzion për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta, veprim i cili nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Për pasojë, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe pretendimi i kërkueses për cenimin e këtij parimi është i bazuar (*shih vendimin nr. 15, datë 23.03.2023, paragrafët 25-28 të GJK-së*).

45. Në një rast, përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykatës së caktuar me ligj, në faktin se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2022-1029 (210), datë 26.05.2022, ka rënë ndesh me qëndrimin e po këtij kolegji të shprehur në vendimin nr. 00-2014-730, datë 06.03.2014, ndryshim i cili mund të bëhej vetëm nga Kolegjet e Bashkuara të kësaj gjykate. Gjykata vlerësoi se Kolegji Administrativ nuk kishte tejkaluar kompetencat e saj ligjore. Sipas saj, në vendimin nr. 00-2014-730, datë 06.03.2014, Kolegji Administrativ ka marrë në shqyrtim ankimin e veçantë lidhur me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor ose administrativ, të cilit i përkiste zgjidhja e mosmarrëveshjes objekt i atij gjykimi, mbështetur në kuadrin ligjor për nëpunësin civil, në ndryshim nga vendimi nr. 00-2022-1029 (210), datë 26.05.2022 që kërkuesi kundërshton në ankimin kushtetues individual. Gjithashtu, nuk rezulton që vendimi i referuar nga kërkuesi të jetë njësues për praktikën gjyqësore dhe vendimi i kundërshtuar në ankimin kushtetues individual të ketë ndryshuar praktikën gjyqësore, duke mos qenë kështu përpara rastit të përfshirjes së kësaj çështjeje në kompetencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 29, datë 26.05.2023, paragrafët 35-36 të GJK-së*).

46. Gjykata, në disa raste, ka konkluduar cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj nga Kolegji Administrativ për shkak të rivlerësimit ndryshe të fakteve dhe provave të marra gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta, duke e zgjidhur vetë çështjen në themel (*shih vendimet nr. 10, datë 3.04.2018; nr. 56, datë 25.07.2017; nr. 13, datë 20.02.2017; nr. 87, datë 30.12.2016; nr. 36, datë 30.06.2014 të GJK-së*).

47. Bazuar në standardin e përmendur më sipër, në një rast Gjykata ka konkluduar cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, duke argumentuar, ndër të tjera, se Gjykata e Lartë ka konstatuar kryesisht dhe jashtë kërkimeve të palëve pavlefshmërinë

e kontratës së shitblerjes të datës 31.07.2008 të lidhur ndërmjet kërkuesit dhe Bashkisë Sarandë dhe, gjithashtu, ka konkluduar *apriori* nëse është vërtetuar ose jo një fakt i caktuar, pra nëse kërkuesi ndodhet apo jo përpara rasteve përjashtimore që parashikon ligji, ndërkohë që përmbajtja e vendimeve të gjykatave të faktit tregon se ky fakt nuk u është nënshtruar vlerësimeve të këtyre gjykatave. Nëse Gjykata e Lartë do të kishte dyshime në lidhje me vlefshmërinë e kontratës, ajo duhej ta kthente çështjen për rigjykim, në përputhje me kompetencat e saj të parashikuara në ligjin e posaçëm për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ajo në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel, duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykata e Apelit Gjirokastër (*shih vendimin nr. 27, datë 27.03.2016, paragrafi 16 të GJK-së*).

48.Në një rast tjetër, Gjykata ka konkluduar cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, duke vlerësuar se Kolegji Administrativ për të arritur në përfundimin sipas vendimit, i cili është i ndryshëm nga ai i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatës së Apelit Durrës, ka bërë një rivlerësim të provave të administruara e të vlerësuara nga gjykatat e faktit. Gjykata ka vërejtur se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë edhe pse ka arsyetuar se kërkuesja nuk ka marrë pjesë në fazën e dytë të procesit të kualifikimit, nuk është shprehur për dijeninë apo jo të saj për këtë fazë, edhe pse është pikërisht kjo rrethanë tek e cila gjykatat e faktit mbështesin vlerësimin e tyre. Gjykata e Lartë, pavarësisht se nuk e ka vënë në dyshim vlerën e provave të paraqitura, ka bërë një vlerësim të ndryshëm të tyre, duke ndryshuar në themel vendimet e gjykatave më të ulëta. Gjykata ka çmuar se nëse Gjykata e Lartë do të kishte dyshime mbi dijeninë e kërkueses për fazën e dytë të konkurrimit në testimin e organizuar për avokatët e shtetit jo vetëm duhet të administronte edhe prapësimet e kërkueses, por duhet ta kthente çështjen për rishqyrtim në gjykatat e faktit, me udhëzimet përkatëse, në mënyrë që ato të arrinin në një konkluzion duke ia nënshtruar provat hetimit të plotë gjyqësor *(shih vendimin nr. 69, datë 27.11.2016, paragrafët 17-19 të GJK-së)*. Në një rast të ngjashëm, Gjykata ka konkluduar cenim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, duke argumentuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arritur në konkluzion të ndryshëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, duke konstatuar kryesisht pavlefshmërinë e kontratës së shitjes së datës 16.11.2007 lidhur mes komunës Labinot-Fushë dhe kërkuesit. Sipas Gjykatës, Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë kryesisht nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, konkretisht nëse kontrata e shitjes është lidhur në zbatim të ligjit apo jo, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë rezulton se këto gjykata nuk kanë shqyrtuar vlefshmërinë e kontratës së shitjes *(shih vendimin nr. 87, datë 30.12.2016, paragrafët 11-12 të GJK-së).* Po me të njëjtin argument, në një rast tjetër, Gjykata ka çmuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është bazuar në vendim në një provë (filmimi audio-video), e cila nuk është administruar dhe nuk është debatuar nga gjykatat e faktit. Këtë filmim gjykatat e faktit nuk e kanë konsideruar si provë dhe nuk e kanë administruar si të tillë. Sipas Gjykatës, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arritur në konkluzion të ndryshëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, për sa i përket vlerësimit

të këtij filmimi, për rrjedhojë Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj (*shih vendimin nr. 83, datë 30.12.2015, paragrafët 18-19të GJK-së*).

49. Gjykata në disa raste ka vlerësuar pretendimin për shkelje të parimit të disponibilitetit nga ana e gjykatës të lidhur me parimin e gjykimit nga gjykatë e caktuar me ligj. Gjykata ka theksuar se parimi i disponibilitetit është një parim i rëndësishëm procedural civil, i cili parashikohet në nenin 2 të KPC-së. Pretendimet që kanë të bëjnë me shkeljen e këtij parimi janë trajtuar gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese, si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e janë analizuar bashkërisht edhe në funksion të standardeve të tjera kushtetuese që karakterizojnë këtë të drejtë. E drejta për të disponuar mbi objektin e padisë është një e drejtë e paditësit, i cili e ushtron atë duke bërë ndryshimet, shtesat apo pakësimet e objektit të padisë sipas interesave të tij. Gjykata nuk mund të diktojë objektin e padisë dhe as të pengojë paditësin në ushtrimin e së drejtës për të disponuar mbi këtë objekt *(shih vendimet nr.58, datë 25.07.2017; nr.6, datë 15.04.2005 të GJK-së).* Gjykata ka vlerësuar se një kërkues nuk legjitimohet ratione personae në ngritjen e pretendimit për cenimin e parimit të disponibilitetit në rast se objekti i gjykimit përcaktohej nga një palë tjetër (*shih vendimet nr. 35, datë 27.06. 2016; nr. 16, datë 19.04.2013; nr. 7, datë 09.03.2009; nr. 6, datë 15.04.2005; nr. 20, datë 02.07.2003 të GJK*).

50. Në lidhje me standardin e përmendur më sipër, në një rast, Gjykata ka konkluduar se Kolegji Administrativ ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore, në cenim të parimit të disponibilitetit në gjykim të lidhur me standardin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, me argumentin se ajo ka vlerësuar kontratën e shitblerjes, e cila nuk ka qenë objekt i gjykimit në shkallët më të ulëta. Akti që është kundërshtuar në gjykatat e faktit ka qenë vendimi i kryeregjistruesit dhe jo vlefshmëria dhe ligjshmëria e kontratës së shitblerjes. Gjithashtu, vlefshmëria e kontratës së shitblerjes nuk është ngritur si pretendim në rekurs nga subjekti i interesuar. Gjykata e Lartë, në respektim të parimit të disponibilitetit në gjykim, të parë në kuptim të standardit të gjykatës të caktuar me ligj, duhej të shprehej vetëm mbi kërkimet e subjektit të interesuar në rekurs dhe jo përtej asaj që kërkohej (*shih vendimin nr. 35, datë 27.06.2016, paragrafët 18-19 të GJK-së)*.

➢ *Formimi i trupit gjykues*

51. Në një rast përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjykatës së caktuar me ligj në Gjykatën e Lartë për arsye se nga aktet e dosjes gjyqësore të Gjykatës së Lartë nuk rezultojnë procedurat e shortit për caktimin e trupit gjykues, në zbatim të vendimit nr. 47/2021 të këshillit të kësaj gjykate, çka përbën një garanci procedurale të munguar. Vendimi nr. 47/2021 e kishte humbur fuqinë me emërimin e dy gjyqtarëve të rinj dhe, për rrjedhojë, nuk sillte pasoja juridike. Gjykata vlerësoi se kompetenca dhe juridiksioni i Gjykatës së Lartë në shqyrtimin e çështjes së kërkuesit janë parashikuar në nenin 141 të Kushtetutës, ligjin nr. 49/2012 dhe ligjin nr. 98/2016, datë 06.10.2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" (ligji nr. 98/2016). Vendimi nr. 47/2021 i Këshillit të Gjykatës së Lartë është bazuar në pikat 2 e 3 të nenit 23 dhe shkronjën "ç" të nenit 38 të ligjit nr. 98/2016, që parashikojnë krijimin në çdo gjykatë të

seksioneve dhe trupave gjykues, sipas rregullave të parashikuara në ligjin procedural, si dhe caktimin në to të gjyqtarëve, duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe fushën e tyre të interesit. Gjykata konkludoi se në rastin në shqyrtim trupi gjykues është caktuar në përputhje me këto dispozita dhe se emërimi i gjyqtarëve të rinj nuk përbën shkak për ndryshimin e trupit gjykues (*shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2022, paragrafët 29-30 të GJK-së*).

52. Në një rast, përpara Gjykatës është ngritur pretendimi se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë të caktuar me ligj, pasi nuk ka zbatuar dispozitat ligjore për procedurën dhe llojin e vendimmarrjes në dhomë këshillimi, për shkak të ndryshimeve kushtetuese të kompetencave të Gjykatës së Lartë të vitit 2016. Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim, duke argumentuar se me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 kompetencat e Gjykatës së Lartë janë reformuar, duke përfshirë tashmë në juridiksionin e saj vetëm shqyrtimin e çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin, zhvillimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit (neni 141 i Kushtetutës). Për shkak të delegimit që neni 141 ka bërë te ligji, Kuvendi ka miratuar ndryshimet ligjore të nevojshme për zbatimin e kompetencave të reja kushtetuese të Gjykatës së Lartë. Në këtë kuadër është miratuar edhe ligji nr. 39/2017 (hyrë në fuqi në datën 21.04.2017), me të cilin është amenduar ligji nr. 49/2012 . Këto ndryshime kanë përcaktuar regjim tranzitor të ndryshëm për çështjet në proces, pasi në nenin 11 të ligjit nr. 39/2017 parashikohet: "Çështjet aktualisht në gjykim në Gjykatën e Lartë do të vazhdojnë të gjykohen sipas ligjit në fuqi, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.". Me këtë bazë ligjore, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjatë gjykimit ka zbatuar dispozitat e ligjit nr. 49/2012, përpara ndryshimeve, pasi çështja konkrete u regjistrua në Gjykatën e Lartë, bazuar në rekursin e depozituar në datën 18.12.2014 (*shih vendimin nr. 17, datë 30.03.2022, paragrafët 28-29 të GJK-së*).

53. Në një rast tjetër, lidhur me pretendimin se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi me tre gjyqtarë, edhe pse neni 12/3 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se trupi gjykues në këto raste duhet të përbëhet nga pesë gjyqtarë, Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar. Ajo ka argumentuar se neni 12/3 i ligjit nr. 49/2012 fillimisht parashikonte se Gjykata e Lartë gjykonte në Kolegj Administrativ me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë, me përjashtim të rasteve kur ky ligj parashikonte ndryshe. Me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 100, datë 31.07.2014, neni 12/3 i ligjit nr. 49/2012 aktualisht parashikon se: "Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjykon në dhomë këshillimi me 3 gjyqtarë të gjitha çështjet që në gjykatën e shkallës së parë gjykohen nga 1 gjyqtar, si dhe çështjet që kanë për objekt mosmarrëveshjet e kompetencave. Çështjet e tjera gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë". Ndërkohë, neni 12/1 i ligjit 49/2012 parashikon se "Gjykata administrative e shkallës së parë gjykon me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë mosmarrëveshjet lidhur me kontratat administrative publike dhe kërkesat e paraqitura në zbatim të shkronjave "d" dhe "dh" të nenit 7 të këtij ligji. Të gjitha mosmarrëveshjet e tjera shqyrtohen me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar". Nga dispozitat e lartpërmendura rezulton se është objekti i mosmarrëveshjes së çështjes, i cili përcakton përbërjen e trupit gjykues në gjykatën administrative të shkallës së parë

dhe, për pasojë, atë të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, Gjykata ka vërejtur se ndryshimet të bëra në nenin 12/3 të ligjit nr. 49/2012, me anë të ligjit nr. 100, datë 31.07.2014, kanë hyrë në fuqi në datën 15.09.2014, pra përpara shqyrtimit të çështjes nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi në datën 20.11.2014. Për pasojë, Gjykata ka vlerësuar se përderisa objekti i mosmarrëveshjes në fjalë sipas nenit 12/1 të ligjit nr. 49/2012 duhet të gjykohet nga një gjyqtar i vetëm, kompetenca për shqyrtimin e saj, sipas nenit 12/3 të ligjit 49/2012 i përket një trupi gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015, paragrafët 11-14 të GJK-së*).

IV. Garancitë e përgjithshme (penale/ civile): kërkesat procedurale

A. Proces i drejtë

1. E drejta për t'u njoftuar

Neni 42, pika 2, i Kushtetutës:
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 28, pika 1, i Kushtetutës:
1. Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet.

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. E drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi, për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë, në raport me palën kundërshtare. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, u paraprin të drejtave të tjera, pasi, nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor *(shih vendimet nr. 18, datë 04.04.2023, paragrafi 24; nr. 34, datë 25.07.2011, paragrafët 2.1.–2.2.; nr. 34, datë 03.10.2007, paragrafi 8, të GJK-së).*

2. E drejta e palës për t'u njoftuar për argumentet e faktet e parashtruara në ankimin e palës tjetër, është pjesë e së drejtës së individit për një proces të rregullt nëpërmjet së cilës atij i krijohet mundësia të përgatisë mbrojtjen e vetë e të parashtrojë argumentet ndaj pretendimeve të palës tjetër *(shih vendimet nr. 18 datë 04.04.2023, paragrafi 25; nr. 5, datë 26.01.2007, paragrafi 10; nr.15, datë 13.07.2005, paragrafi 5, të GJK-së).*

3. Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim *(shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2023, paragrafi 22; nr. 21, datë 04.04.2016, paragrafi 15; nr. 18, datë 23.04.2013, paragrafi 11, të GJK-së).*

4. Vetëm njoftimi me shpallje nuk nënkupton përmbushjen e detyrimit të sekretarisë së Gjykatës së Lartë për njoftimin e rregullt të palëve, në mënyrë që ato të mund të marrin pjesë në gjykim, si dhe të dëgjohen e të mbrohen me anë të paraqitjes së komenteve ose prapësimeve, pasi ajo ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim *(shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2023, paragrafi 22; nr. 28, datë 01.11.2022, paragrafi 69 ; nr. 21, datë 04.04.2016, paragrafi 15, të GJK-së).*

5. Përbën cenim të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt gjyqësor, në rastet kur kërkesa për rishikim nuk i dërgohet palës tjetër dhe kur ajo nuk thirret për t'u dëgjuar në Gjykatën e Lartë *(shih vendimet nr. 18, datë 04.04.2023, paragrafi 24; nr. 5, datë 26.01.2007, paragrafi 3; nr. 17, datë 18.07.2005, paragrafi 3.9., të GJK-së).*

6. Në procesin penal, të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij, është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë, që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. E drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij është thelbësore për një proces të drejtë. Shteti ka detyrimin për ta njoftuar të pandehurin në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për seancën, si dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij. Po ashtu, një nga kriteret e gjykimit të drejtë është edhe e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, e drejtë e cila nuk humbet edhe pse personi i akuzuar penalisht nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq *(shih vendimet nr. 84, datë 26.12.2017, paragrafi 13; nr. 26, datë 08.05.2012, paragrafi 22; nr. 30, datë 17.06.2010, paragrafi 29, të GJK-së).*

7. Lidhur me zbatimin e rregullave procedurale të njoftimit në procesin e dënimit të të gjykuarit në mungesë, prevalon qëndrimi se marrja dijeni jo në mënyrë të plotë dhe në rrugë informale, nuk mund të jetë e mjaftueshme. Fakte të ndodhura ose të njohura mund të përbëjnë tregues të padiskutueshëm për gjykatën se i akuzuari ka dijeni për ekzistencën e procedimeve penale kundër tij dhe për natyrën e shkakun e akuzës, siç janë rastet kur i akuzuari deklaron publikisht ose me shkrim se ai nuk do t'u përgjigjet thirrjeve për gjyq për të cilat ai ka marrë dijeni përmes burimeve të ndryshme dhe jo nga autoritetet, ose vijon t'i shmanget përpjekjes për arrestimin e tij, apo kur autoriteteve u paraqiten materiale të cilat tregojnë qartë se ai është në dijeni të procedurave në pritje ndaj tij dhe të akuzave me të cilat përballet. Ndërkohë, thjesht mungesa e ankuesit në shtëpi nuk mjafton për të konsideruar se ai kishte dijeni për procedurat dhe, për rrjedhojë, largohet

(shih vendimet nr. 31, datë 25.05.2015, paragrafi 21; nr. 5, datë 25.02.2013, paragrafi 12, të GJK-së).

8. Kur një person i akuzuar për një vepër penale nuk është vënë në dijeni personalisht, nuk mund të arrihet thjesht në përfundimin se ai ka hequr dorë nga e drejta që të paraqitet në gjyq dhe të mbrohet vetë, nisur nga statusi i tij "në mungesë", që u krijua nga prezumimi me bazë të pamjaftueshme faktike. Para se të thuhet se i pandehuri në mënyrë të nënkuptuar, nëpërmjet sjelljes së tij, ka hequr dorë nga një e drejtë e rëndësishme, sipas nenit 6 të Konventës, duhet të tregohet se në mënyrë të arsyeshme ai mund të kishte parashikuar se cilat do ishin pasojat e sjelljes së tij *(shih vendimin nr. 31, datë 25.05.2015, paragrafi 22, të GJK-së).*

9. Është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë, në mënyrë rigoroze, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i këtyre fakteve, sipas Gjykatës, është detyrë e organeve kompetente. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigoroze të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë, kur janë respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat për njoftimin *(shih vendimet nr. 8, datë 27.02.2014, paragrafi 9; nr. 9, datë 29.02.2012, paragrafi 17; nr. 30, datë 17.06.2010, paragrafi 34, të GJK-së).*

10. Kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit përfshijnë:

Askush nuk duhet të gjykohet pa pasur një thirrje për gjyq në kohë;

kjo thirrje për gjyq duhet të ketë të sanksionuara edhe pasojat nëse i akuzuari nuk vjen në gjykim;

kur gjykata vëren se edhe pse i akuzuari është njoftuar dhe nuk është paraqitur, ajo, nëse çmon se prania e tij në proces është e pazëvendësueshme ose beson se i akuzuari është penguar të paraqitet, duhet të vendosë shtyrjen e procesit;

i akuzuari nuk duhet të gjykohet në mungesë, nëse është e mundur të transferohen procedimet te një shtet tjetër ose të aplikohet për ekstradim;

kur i akuzuari gjykohet në mungesë, provat duhet të merren në mënyrë të zakonshme dhe mbrojtja duhet të ketë të drejtë të ndërhyjë;

një vendim gjykate, i dhënë në mungesë, duhet t'i njoftohet personit sipas rregullave për njoftimet dhe marrjes dijeni brenda afatit të parashikuar për apelim. Ky afat duhet të fillojë që nga dita e marrjes dijeni efektivisht të personit, përveçse kur ai qëllimisht i fshihet drejtësisë;

çdo personi të gjykuar në mungesë, duhet t'i jepet e drejta për apelim, me çdo lloj mjeti ligjor që do t'i ishte dhënë sikur ai të ishte i pranishëm;

për personin e gjykuar në mungesë, të cilit nuk i është bërë njoftimi në mënyrën e duhur, duhet të ketë një mjet ankimi që t'i mundësojë atij shfuqizimin e vendimit;

një person i gjykuar në mungesë, por që njoftimi i është bërë në rregull, duhet të ketë të drejtën e një rigjykimi në mënyrën e zakonshme, nëse ai mund të provojë mungesën e tij para gjykatës për arsye të pavarura nga vullneti i tij *(shih vendimet nr. 5, datë 25.02.2013, paragrafi 10; nr. 26, datë 08.05.2012, paragrafi 20; nr. 30, datë 17.06.2010, paragrafi 27 të GJK-së).*

b. Precedentët ku çështja e cenimit të së drejtës për t'u njoftuar është vënë në diskutim

A- CIVILE

a) Për gjykatat e faktit

11. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u njoftuar, pasi njoftimi i kërkuesit për gjykimin në Gjykatën e Apelit Tiranë është i pavlefshëm, sepse është kryer në kundërshtim me rregullat e procedurës civile. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar pretendimin. Sipas nenit 460/3 të KPC-së, njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve bëhet nga gjykata e apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatat përkatëse të shkallës së parë, jo më vonë se 10 ditë përpara shqyrtimit të çështjes. Përveç njoftimit me shpallje, sipas nenit 143 të KPC-së, gjykata mund të përdorë edhe mënyra të tjera njoftimi, siç është edhe njoftimi me anën e telegramit me përgjigje. Gjykata konstaton se si njoftimi me shpallje, ashtu edhe njoftimi me telegram nuk janë bërë në përputhje me kërkesat e ligjit procedural. Konkretisht, njoftimi me shpallje është i mangët, sepse është bërë vetëm pranë gjykatës së apelit që po shqyrtonte çështjen, por nuk është nxjerrë kjo shpallje edhe pranë gjykatës përkatëse të shkallës së parë, konkretisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Edhe mënyra tjetër e njoftimit e aplikuar nga gjykata e apelit është e parregullt në aspektin procedural, sepse në rastin në shqyrtim është aplikuar telegrami i thjeshtë e jo telegrami me përgjigje, që kërkon dispozita e sipërcituar e KPC-së. Në këto rrethana, Gjykata ka konkluduar se Gjykata e Apelit Tiranë, duke shkelur dispozitat procedurale civile që kanë të bëjnë me mënyrën e njoftimit të palëve, nuk i ka krijuar mundësi kërkuesit të marrë pjesë në gjykimin në apel dhe për këtë shkak, ky gjykim nuk i përmbush standardet e një gjykimi të drejtë në aspektin kushtetues *(shih vendimin nr.31, datë 04.07.2007, paragrafët8-9 të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

- ***Kërkesa për rishikim***

12. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u njoftuar nga Gjykata e Lartë, e cila nuk e ka njoftuar kërkuesen për kërkesën për rishikim të paraqitur nga subjekti i interesuar, ndaj ajo nuk ka marrë dijeni për gjykimin e zhvilluar. Në këtë

mënyrë, ajo nuk ka pasur mundësi të paraqesë argumentet, faktet dhe provat kundër kësaj kërkese, duke iu cenuar e drejta për t'u dëgjuar dhe parimet e kontradiktoritetit dhe të sigurisë juridike. Në këtë rast, Gjykata e ka vlerësuar të bazuar pretendimin, duke arsyetuar në lidhje me cenimin e parimit të kontradiktoritetit, së drejtës së mbrojtjes dhe së drejtës për t'u dëgjuar. Gjykata ka konstatuar se Gjykata e Lartë nuk rezulton t'i ketë komunikuar kërkueses kërkesën për rishikim të paraqitur nga subjekti i interesuar, por është mjaftuar vetëm me njoftimin e kohës së shqyrtimit të kësaj kërkese nëpërmjet shpalljes në ambientet e saj dhe në faqen e internetit. Duke mos marrë njoftim për aktin e ankimit "kërkesë për rishikim", njoftimi për kohën e shqyrtimit të tij ka mbetur formal, pasi kërkuesja efektivisht ka qenë në pamundësi të paraqesë prova, fakte dhe argumente për çështjen në gjykim *(shih vendimin nr. 18, datë 04.04.2023, paragrafi 27, të GJK-së).*

13. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u njoftuar nga Gjykata e Lartë, në rastin kur është vendosur prishja e vendimit të formës së prerë, nëpërmjet kërkesës për rishikim, që është një mjet i jashtëzakonshëm. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Sipas Gjykatës, megjithëse shqyrtimi është bërë në seancë gjyqësore, ku janë vlerësuar dobishmëria dhe rëndësia e provave të paraqitura nga njëra palë, nuk është njoftuar pala tjetër të marrë pjesë në gjykim dhe të japë mendimet e veta për këto prova dhe për ndikimin që ato duhet të kenë në cenimin e vendimit të formës së prerë. Në këtë mënyrë prishja e vendimit të formës së prerë është bërë duke vënë në situatë krejtësisht të pafavorshme palën në favor të së cilës ishte dhënë vendimi dhe duke cenuar ekuilibrin që duhet të kenë ato në proces *(shih vendimin nr. 8, datë 02.05.2006, paragrafi 3.4., të GJK-së).*

B- PENALE

a) Për gjykatat e faktit

14. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u njoftuar, pasi kërkuesi nuk ka marrë efektivisht dijeni për procesin gjyqësor në ngarkim të tij, si rezultat i mospërmbushjes nga ana e autoriteteve të detyrimeve që burojnë nga KPP-ja për njoftimin e të pandehurit që nuk gjendet. Për rrjedhojë, atij i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar pretendimin, me argumentin se moskomunikimi i ankimit ose rekursit kërkuesit, por vetëm mbrojtësit të caktuar kryesisht, mungesa e një prokure të posaçme që të shprehë vullnetin e tij për caktimin e mbrojtësve ligjorë ose për delegimin e këtij vullneti familjarëve dhe përcaktimin shprehimisht të kufijve e tagrave të përfaqësimit në procesin penal, mosrespektimi i procedurave për njoftimin e fletëthirrjeve dhe pasja e të metave formale në përmbajtjen e tyre, përbëjnë fakte bindëse se kërkuesi, në mungesë të njoftimit efektiv dhe zyrtar nga autoritetet, nuk ka pasur asnjë mundësi tjetër për të marrë dijeni për procesin gjyqësor, deklarimin fajtor dhe dënimin e tij. Sipas Gjykatës, për sa kohë Gjykata e Apelit për Krime të Rënda nuk ka marrë masa për përmbushjen efektivisht të standardeve të procesit të rregullt ligjor në drejtim të garantimit të së drejtës së njoftimit efektiv, si kusht

thelbësor për ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes dhe për t'u dëgjuar e për të paraqitur ankim, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda duhet të shfuqizohet si jokushtetues. Në përfundim, Gjykata, bazuar në standardet kushtetuese dhe kërkesat procedurale penale lidhur me njoftimin e të pandehurit, kur ai nuk gjendet, si dhe të rrethanave konkrete të çështjes, ka vlerësuar se organet shtetërore nuk kanë marrë të gjitha masat dhe nuk kanë kryer të gjitha veprimet e duhura për përmbushjen e detyrimeve ligjore për njoftimin e kërkuesit *(shih vendimin nr. 31, datë 25.05.2015, paragrafët 33-39, të GJK-së).*

15. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u njoftuar, si rrjedhim i mosnjoftimit nga Gjykata e Apelit Vlorë të kërkuesit. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Në vlerësimin e Gjykatës, sipas KPP- së, organet dhe mënyrat e njoftimit të akteve janë të përcaktuara në nenin 132 të këtij kodi, ku, ndër të tjera, parashikohet se njoftimet që u bëhen nga gjykata të interesuarve në praninë e tyre shënohen në procesverbal. Referuar procesverbalit është evident fakti që Gjykata e Apelit Vlorë e ka zhvilluar procesin duke administruar vetëm argumentet e prokurorit, pa dëgjuar më parë edhe pretendimet e kërkuesit. Edhe Gjykata e Lartë ka gabuar duke vendosur mospranimin e rekursit, pasi kërkesa për pavlefshmërinë e seancës gjyqësore të zhvilluar në apel jo vetëm që pasqyrohet në rekurs, por është një çështje që duhej të ishte ngritur edhe kryesisht nga Gjykata e Lartë. Gjykata ka vlerësuar se shkeljet procedurale në drejtim të rregullave të njoftimit tregojnë mungesën e njoftimit efektiv dhe zyrtar të kërkuesit gjatë gjykimit *(shih vendimin nr. 13, datë 19.03.2015, paragrafët 19-21, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

16. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u njoftuar, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar kërkuesin për përbërjen e kolegjit që do të shqyrtonte rekursin, për procedurën e shqyrtimit të tij, për datën dhe orën e seancës, në përputhje me nenin 436 të KPP-së, si dhe nuk ka publikuar të dhënat e çështjes në faqen zyrtare. Sipas kërkuesit në dosjen gjyqësore të asaj gjykate mungon dokumentacioni që provon caktimin e çështjes me short, njoftimi dhe afishimi i të dhënave të çështjes në faqen zyrtare të gjykatës, me qëllim marrjen dijeni për to nga kërkuesi, mbrojtësi dhe publiku, si dhe procesverbali i seancës së gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi. Gjykata, e cila e ka vlerësuar këtë pretendim të kërkuesit në lidhje me cenimin e së drejtës së aksesit, i parë së bashku me të drejtën e ankimit efektiv dhe atë për t'u mbrojtur, ka arritur në përfundimin se pretendimi është i bazuar. Gjykata ka vërejtur se sipas rregullave të përgjithshme procedurale për ankimin (nenet 407 e vijues të KPP-së), Gjykata e Lartë duhet të kryejë disa veprime paraprake përpara se të gjykojë çështjen, konkretisht: caktimi i kolegjeve përkatëse për shqyrtimin e rekurseve nga kryetari i kësaj gjykate, caktimi i datës për shqyrtimin e rekursit nga kryetari i kolegjit, njoftimi i palëve për datën dhe orën e gjykimit, të paktën 30 ditë përpara, nga sekretaria e gjykatës, nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare. Kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara ose të njohura, sekretaria kryen njoftimin edhe në këto adresa. Bazuar në sa më sipër, Gjykata ka konstatuar se sekretaria

e Gjykatës së Lartë nuk rezulton të ketë kryer njoftimin e kërkuesit dhe as të mbrojtësit të caktuar prej tij, me asnjë nga mënyrat e parashikuara në ligj. Për rrjedhojë, kërkuesi, duke mos u njoftuar në përputhje me dispozitat procedurale për datën e shqyrtimit të rekursit së tij, nuk ka pasur mundësi të paraqesë pretendimet e tij për zbatimin e ligjit penal favorizues, të cilat nuk mund të ishin paraqitur prej tij në momentin e paraqitjes së rekursit. Nga ana tjetër, Kolegji Penal nuk ka verifikuar respektimin e procedurave të njoftimit, për rrjedhojë arsyetimin e vendimit e ka bazuar vetëm mbi shkaqet e rekursit, sipas formulimit të tyre në momentin e paraqitjes së tij nga avokati i kërkuesit. Në këtë mënyrë, duke mos e njoftuar kërkuesin për datën e shqyrtimit të rekursit e ka vënë atë në pamundësi të paraqesë pretendimet e tij në lidhje me çështje të zbatimit dhe veprimit të ligjit në kohë, duke i kufizuar në këtë mënyrë aksesin substancial në gjykim, për më tepër që ligji penal në kohën e shqyrtimit të rekursit kishte pësuar ndryshime *(shih vendimin nr. 20, datë 22.09.2022, paragrafët 77-78, të GJK-së).*

C- ADMINISTRATIVE

a) Për gjykatat e faktit

17. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u njoftuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila duke mos respektuar rregullat procedurale për njoftimin e palëve i ka hequr kërkueses mundësinë për të paraqitur, deri 5 ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të kërkueses si të pabazuar. Nisur nga fakti se ankimi në gjykatën e apelit është paraqitur nga vetë kërkuesja, e cila ka detyrimin të ndjekë fatin e çështjes së saj dhe se ligji procedural i kohës parashikon, si rregull, shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit dhe njoftimin e palëve me shpallje, Gjykata vlerëson se argumentet e kërkueses për mungesën e njoftimit të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit në Gjykatën Administrative të Apelit janë të pamjaftueshme për të mbështetur pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe të mbrojtjes efektive. Në këtë kuptim, argumenti se njoftimi paraprak do t'i jepte mundësinë dhe të drejtën për të paraqitur parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, është formuluar në mënyrë të përgjithshme dhe hipotetike, pa treguar ndonjë të dhënë ose argument të paparashtruar në ankim, por të lidhur me shkaqet e ngritura në të. Riparashtrimi i të njëjtave pretendime nuk mund të përbëjë argument për cenimin e thelbit të së drejtës së njohur nga ligji për të paraqitur parashtrime deri 5 ditë përpara seancës. Për rrjedhojë, në kontekstin e rastit konkret, mungesa në dosjen gjyqësore të aktit të shpalljes së listës së çështjes për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit nuk mund të konsiderohet si shkelje thelbësore që e bën të parregullt, në kuptimin kushtetues, procesin gjyqësor të zhvilluar në këtë gjykatë *(shih vendimin nr. 5, datë 09.02.2023, paragrafët 40- 42, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

18. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u njoftuar, mbrojtur dhe dëgjuar, si rezultat i pamundësisë së kërkueses për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në Gjykatën e Lartë. Kërkuesja ka pretenduar se mënyra e njoftimit me shpallje, e parashikuar nga nenet 482, paragrafi 3, të KPC-së dhe 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, si dhe mosveprimi në kohën e mënyrën e duhur nga Gjykata e Lartë në lëshimin e njoftimeve, i ka cenuar të drejtat për t'u njoftuar rregullisht, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në Gjykatën e Lartë. Gjykata i ka shqyrtuar pretendimet në këndvështrimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive. Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive, për shkak të përmbajtjes së neneve 482, paragrafi 3, fjalia e parë, të KPC-së dhe 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Gjykata ka çmuar se dispozitat e kundërshtuara nga kërkuesja, që parashikojnë mënyrën e njoftimit me shpallje të palëve për datën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, lidhen në mënyrë të arsyeshme me objektivin e ligjvënësit për të siguruar eficiencën e proceseve gjyqësore, përfshirë shpejtësinë e tyre. Kjo masë nuk duket se vendos ndonjë barrë të tepërt për individin, palë në procesin gjyqësor, duke qenë se detyrimi për publikimin e njoftimeve në faqen e internetit të gjykatës, përveç atij për shpalljen në ambientet fizike të saj, shoqërohet edhe me mundësinë e njoftimit individual, kur vetë individi depoziton të dhënat elektronike të kontaktit të tij. Lidhur me këtë të fundit, në kushtet e zhvillimit të sotëm shoqëror, ku individi ka qasje të lehtë në internet dhe mjete elektronike, Gjykata ka vlerësuar se bëhet fjalë për mundësi reale në dispozicion të individit, i cili me vullnetin e tij të lirë zgjedh që, krahas shpalljes publike, të njoftohet edhe individualisht. Në këto rrethana, mënyrat e parashikuara nga ligji përbëjnë një mjet efektiv për qëllimin e synuar. Duke qenë një masë e arsyeshme dhe e përshtatshme, ajo nuk e shndërron kufizimin e së drejtës së aksesit të lidhur me atë të mbrojtjes efektive, në arbitrar, për sa kohë që nuk cenohet thelbi i saj *(shih vendimin nr. 34, datë 12.06.2023, paragrafi 57 të GJK-së).*

19. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u njoftuar, bazuar në pretendimin se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e ka njoftuar kërkuesin dhe përfaqësuesen e tij as për zhvillimin e gjykimit dhe as për revokimin e vendimit të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore në prani të palëve, si dhe për vijueshmërinë e gjykimit në dhomën e këshillimit, duke i mohuar kërkuesit të drejtën për t'u mbrojtur, nëpërmjet paraqitjes së pretendimeve me shkrim. Në këtë rast, Gjykata e ka çmuar të bazuar pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës së njoftimit, me arsyetimin se kërkuesi, duke mos u njoftuar për vendimin e revokimit, është vendosur në pamundësi për të paraqitur prapësimet e tij për pretendimet e palës tjetër për paraqitjen e padisë jashtë afatit ligjor 30-ditor, pasi, siç është vërtetuar edhe nga procesverbali i seancës gjyqësore, ai nuk ishte njohur me to. Për rrjedhojë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, arsyetimin e vendimit e ka bazuar vetëm mbi shkaqet e rekursit, sipas formulimit të tyre në momentin e paraqitjes së tij nga përfaqësuesja e kërkuesit. Në këtë mënyrë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke mos e njoftuar kërkuesin për vendimin e revokimit, e ka vënë atë në pamundësi për të paraqitur pretendimet e tij në lidhje me

çështjen e zbatimit dhe veprimit të ligjit në kohë, duke i kufizuar në këtë mënyrë aksesin substancial në gjykim *(shih vendimin nr. 22, datë 25.04.2023, paragrafët 26-27, të GJK-së).*

20. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u njoftuar, sepse shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë është bërë në shkelje të nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, pasi kërkuesja nuk është njoftuar për shqyrtimin e çështjes dhe përbërjen e trupit gjykues. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këto pretendime, bazuar në argumentin se, nisur nga fakti se rekursi në Gjykatën e Lartë është paraqitur nga vetë kërkuesja, e cila ka detyrimin të ndjekë fatin e çështjes së saj dhe se ligji procedural i kohës parashikon, si rregull, shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit dhe njoftimin e palëve me shpallje që, sipas kësaj mënyre, rezulton të jetë bërë, Gjykata ka vlerësuar se pretendimi i kërkueses për mungesën e njoftimit të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit në Gjykatën Lartë është i pabazuar *(shih vendimin nr. 5, datë 09.02.2023, paragrafët 43-45, të GJK-së).*

21. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u njoftuar si rezultat i mungesës së njoftimit në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë lidhur me datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes së kërkuesit. Gjykata e ka si të pabazuar këtë pretendim. Në vlerësimin e Gjykatës, mungesa e njoftimit me shpallje në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë nuk rezulton ta ketë vendosur kërkuesin në pozita të pafavorshme lidhur me të drejtën e aksesit në aspektin substancial. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, Gjykata ka mbajtur në konsideratë faktin se, nga njëra anë, kërkuesi ishte njoftuar rregullisht për rekurset e paraqitura nga palët ndërgjyqëse. Po kështu, njoftimi për datën dhe orën e shqyrtimit të procesit të tij ishte afishuar nga Gjykata e Lartë në këndin e njoftimeve në ambientet fizike të saj. Nga ana tjetër, pretendimi se mungesa e njoftimit e ka penguar kërkuesin të paraqiste parashtrime deri 5 ditë para zhvillimit të seancës, është formuluar në mënyrë të përgjithshme, pa treguar ndonjë argument thelbësor të ri të paparashtruar më parë, i cili potencialisht mund të sillte një rezultat të ndryshëm të zgjidhjes së çështjes së tij nga Gjykata e Lartë. Për më tepër, Gjykata ka konstatuar se kërkuesi, ndonëse është njoftuar rregullisht për rekurset, ka zgjedhur të mos paraqesë kundërrekurs, për mbrojtjen eventuale të çështjes së tij. Gjykata ka mbajtur në konsideratë, po ashtu, se, në rekurset e paraqitura janë ngritur të njëjtat pretendime që nuk janë marrë parasysh më parë nga gjykatat më të ulëta, ndërkohë që në rrjedhën e procesit gjyqësor kërkuesi ka pasur mundësinë dhe ka arritur të realizojë mbrojtjen e interesave të veta, ndërsa pretendimet e tij janë gjetur të drejta dhe konsideruar të plota për pranimin e padisë nga ato gjykata. Ndërkohë, nuk rezulton që kërkuesi të ketë argumentuar në mënyrë konkrete pasjen e pretendimeve në drejtim të ndonjë prej anëtarëve të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që kanë shqyrtuar çështjen e tij. Për rrjedhojë, mangësia e konstatuar për sa i përket njoftimit të palëve me shpallje në faqen elektronike, në kontekst të rastit konkret, nuk mund të klasifikohet si shkelje thelbësore që e bën të parregullt në kuptimin kushtetues procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, e për rrjedhim Gjykata ka vlerësuar se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në aspektin substancial është i pabazuar *(shih vendimin nr. 14, datë 21.03.2023, paragrafët 29-30, të GJK-së).*

22. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u njoftuar, pasi Gjykata e Lartë është mjaftuar vetëm me konstatimin e bërë nga shërbimi postar për pamjaftueshmërinë e adresës së kërkuesit. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim dhe është shprehur se Gjykata e Lartë duhej të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme, me qëllim komunikimin e vendimit të revokimit kërkuesit. Në këtë mënyrë, nëse kërkuesi do të ishte vënë në dijeni të këtij fakti, do të kishte marrë masat e nevojshme që prapësimet e tij për rekurset e paraqitura nga subjektet e interesuara, veçanërisht nga ARRSH-ja, t'i paraqiste në Gjykatën e Lartë, duke realizuar të drejtën e tij të mbrojtjes. Gjithashtu, Gjykata vëren se për sa i përket publikimit të njoftimit, për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit, kërkuesit i është lënë një kohë e pamjaftueshme për t'u njohur me të dhe për të paraqitur prapësimet e tij. Bazuar në sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuesi, duke mos u njoftuar për vendimin e revokimit, është vendosur në pamundësi për të paraqitur prapësimet e tij për pretendimet e ARRSH-së për paraqitjen e padisë jashtë afatit ligjor 30-ditor, pasi siç është vërtetuar edhe nga procesverbali i seancës gjyqësore, ai nuk ishte njohur me to. Për rrjedhojë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, arsyetimin e vendimit e ka bazuar vetëm mbi shkaqet e rekursit, sipas formulimit të tyre në momentin e paraqitjes së tij nga përfaqësuesja e kërkuesit. Në këtë mënyrë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke mos e njoftuar kërkuesin për vendimin e revokimit, e ka vënë atë në pamundësi për të paraqitur pretendimet e tij në lidhje me çështjen e zbatimit dhe veprimit të ligjit në kohë, duke i kufizuar në këtë mënyrë aksesin substancial në gjykim *(shih vendimin nr. 22, datë 25.04.2023, paragrafët 25-26, të GJK-së).*

23. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u njoftuar, për shkak të mungesës së njoftimit kërkuesit të datës dhe orës së seancës nga ana e Gjykatës së Lartë. Gjykata konstaton se vetëm njoftimi me shpallje nuk nënkupton përmbushjen e detyrimit të sekretarisë së Gjykatës së Lartë për njoftimin e rregullt të palëve, në mënyrë që ato të mund të marrin pjesë në gjykim, si dhe të dëgjohen e të mbrohen me anë të paraqitjes së komenteve ose prapësimeve, në mënyrë që ato të mund të marrin pjesë në gjykim, si dhe të dëgjohen e të mbrohen me anë të paraqitjes së komenteve ose prapësimeve, pasi ajo ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim. Për më tepër, Gjykata ka vërejtur se gjykimi administrativ bëhet si rregull në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh (neni 61, pika 1, i ligjit nr. 49/2012), dhe në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji (neni 62 i ligjit nr.49/2012) zhvillohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Gjykata ka vlerësuar se gjykimi në seancë gjyqësore ka si qëllim të garantojë të drejtën e palës për t'u dëgjuar në seancën publike për shkak të veçorisë së çështjes. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata ka çmuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhej të marrte masat e nevojshme për t`i garantuar kërkuesit të drejtën për të marrë pjesë në gjykim, si dhe të drejtën për t`u dëgjuar dhe për t`u mbrojtur. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të kërkuesit në drejtim të respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim *(shih vendimin nr. 8, datë 23.02.2021, paragrafët 27-29, të GJK-së).*

2. E drejta për t'u dëgjuar

Neni 42, pika 2, i Kushtetutës:
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 33 i Kushtetutës:
1. Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet.
2. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë.

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. E drejta për t'u dëgjuar, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklarimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore *(shih vendimet nr. 7, datë 12.03.2010, paragrafi 4; nr. 12, datë 06.06.2005, paragrafi 7, të GJK-së).*

2. E drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, nuk nënkupton vetëm atë për t`u dëgjuar personalisht para gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022, paragrafi 40; nr. 41, datë 22.12.2022, paragrafi 40; nr. 38, datë 02.12.2021, paragrafi 38, të GJK-së).*

3. E drejta e individit për proces të rregullt ligjor nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ. Në këtë kuptim, çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike që lidhen me procesin e rregullt, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit me faktet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për proces të rregullt. Gjykata ka pohuar, gjithashtu, se e drejta për t'u dëgjuar, si pjesë e së drejtës së mbrojtjes, garantohet edhe në procesin administrativ përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimit të argumenteve prej tij ose avokatit të zgjedhur *(shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023, paragrafi 58; nr.67, datë 11.11.2016, paragrafi 12; nr. 30, datë 28.12.2006, paragrafi 6, të GJK-së).*

4. Njohja paraprake e personit me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt si një e drejtë themelore *(shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021, paragrafi 34, të GJK-së).*

b. Precedentët ku çështja e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar është vënë në diskutim

A- PËR ORGANET E ADMINISTRATËS PUBLIKE

5. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe për mbrojtje efektive, dhe të parimit të kontradiktoritetit në gjykim, sepse kërkuesi nuk është thirrur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë *(KLP)* për t'u dëgjuar në lidhje me pretendimet e tij. Gjykata i ka vlerësuar pretendimet si të pabazuara. Gjykata ka vërejtur se në procesin administrativ të zhvilluar nga KLP-ja, i gjithë procesi administrativ është realizuar mbi bazë të dokumenteve, të cilat rezulton se i janë bërë të ditura rregullisht kërkuesit, ndërkohë që ai ka paraqitur pretendimet e tij në lidhje me shkakun përjashtues të ngritur, atë të qenies i dënuar me vendim penal të formës së prerë, ndaj dhe Gjykata ka çmuar se nuk verifikohet të ketë cenim të së drejtës për t'u dëgjuar *(shih vendimin nr. 17 datë 23.03.2023, paragrafi 61, të GJK-së).*

6. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe për mbrojtje efektive, si dhe parimi i barazisë së armëve e të kontradiktoritetit, pasi KLGJ-ja nuk e ka njoftuar kërkuesin për gjetjet që çuan në skualifikimin e tij dhe nuk e ka thirrur atë për t'u dëgjuar. Gjykata i ka vlerësuar si të pabazuara këto pretendime. Gjykata vëren se në procesin administrativ të zhvilluar nga KLGJ-ja kërkuesi e ka realizuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur nëpërmjet komunikimit të dokumenteve, raporteve dhe akteve të nxjerra nga organet e përfshira në këtë proces. Atij i është dhënë mundësia disa herë të paraqesë shpjegime me shkrim dhe të depozitojë dokumente në lidhje me rezultatet e hetimit të kryer nga ILDKPKI-ja. Pikërisht, bazuar në pretendimet dhe dokumentet e paraqitura nga vetë kërkuesi, KLGJ-ja i ka kërkuar raporte shtesë ILDKPKI-së, derisa procedura e verifikimit është plotësuar. Po ashtu, siç pranon edhe vetë kërkuesi, ai është njoftuar për datën e zhvillimit të mbledhjes plenare të KLGJ-së dhe i është komunikuar edhe relacioni i relatorit. Ky akt i fundit, në thelb, paraqet në mënyrë të përmbledhur procedurën dhe gjendjen e faktit e të ligjit, me qëllim që anëtarët e KLGJ-së të vendosin në lidhje me çështjen objektivisht. Për sa më lart, Gjykata konstaton se KLGJ-ja ka respektuar të drejtën e kërkuesit për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, sepse ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në nenet 87-89 të KPA-së, sipas së cilës kjo e drejtë ushtrohet në çdo formë të përshtatshme, duke përfshirë paraqitjen e mendimeve, komenteve dhe shpjegimeve për vlerësimin e provave të administruara, rezultatet e hetimit dhe rezultatin e mundshëm të procedurës. E drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, nuk nënkupton vetëm atë për

t`u paraqitur personalisht para organit administrativ, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim gjatë kësaj procedure. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesit nuk i është cenuar nga KLGJ-ja e drejta për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t`u mbrojtur efektivisht *(shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021, paragrafët 37-38, të GJK-së).*

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u dëgjuar, për arsye se në rastin e shkarkimit nga detyra të kryetarit të bashkisë, Këshilli i Ministrave nuk ka bërë asnjë përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjen dhe nuk i ka kërkuar informacion ose sqarim kërkuesit lidhur me shkeljet e pretenduara. Gjykata ka vlerësuar se, duke qenë se qëllimi i Këshillit të Ministrave në këtë procedurë urgjente ka qenë ndërprerja ose parandalimi i veprave penale zgjedhore, duhet vënë në dukje se funksioni i ndërprerjes së veprave penale dhe i parandalimit të tyre i përket sferës juridiksionale të kompetencave publike që ushtrohen nga gjykata, prokuroria dhe Policia e Shtetit, sipas rregullave të KPP-së, të cilat, gjithashtu, respektojnë standardet e procesit të rregullt ligjor, duke përfshirë të drejtën për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar dhe për të dhënë shpjegime. Në këtë situatë, Gjykata çmon se procedura urgjente e shkarkimit nga detyra nuk sillte ndikim, jo vetëm në drejtim të administrimit të Bashkisë së Vaut të Dejës, por as në drejtim të ndërprerjes dhe parandalimit të veprave penale në territorin e kësaj bashkie, për të cilat vepron një mekanizëm i ndryshëm institucional, sipas rregullave ligjore të tjera. Për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se në procesin e shkarkimit të kërkuesit nuk janë respektuar në nivelin minimal e drejta për t'u njoftuar dhe e drejta për t'u dëgjuar, edhe pse nuk rezulton të ketë pasur shkak ligjor për të mos respektuar këto të drejta *(shih vendimin nr. 25, datë 10.05.2021, paragrafët 36–37 të GJK-së).*

8. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe për mbrojtje efektive, pasi vendimi i shkarkimit nga detyra i kryetarit të Bashkisë Dibër është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, pasi nuk është vënë në dijeni për shkaqet e shkarkimit, si dhe nuk i është krijuar mundësia për t'u mbrojtur para organit administrativ. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata vlerëson se për shkarkimin e kërkuesit nga detyra e kryetarit të Bashkisë Dibër, organi administrativ nuk ka respektuar elementet procedurale të procesit të rregullt ligjor si njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi dhe respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes nga organi administrativ. Kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, edhe gjatë zhvillimit të të dyja seancave plenare iu krijua mundësia për të realizuar mbrojtjen në respektim të parimit të kontradiktoritetit, nëpërmjet parashtrimit të argumenteve dhe paraqitjes së provave, duke rivendosur të drejtat dhe interesat e cenuara prej organit administrativ (*shih vendimin nr. 67, datë 11.11.2016, paragrafët 13-15, të GJK-së).*

B- CIVILE

a) Për Gjykatën e Lartë

➢ ***Kërkesa për rishikim***

9. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe për mbrojtje efektive, parimet e kontradiktoritetit dhe të sigurisë juridike, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar kërkuesen për kërkesën për rishikim të paraqitur nga subjekti i interesuar. Duke qenë se se ajo nuk ka marrë dijeni për gjykimin e zhvilluar, kërkuesja nuk ka pasur mundësi të paraqesë argumentet, faktet dhe provat kundër kësaj kërkese. Gjykata çmon se ka pasur cenim të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt gjyqësor, në rastet kur kërkesa për rishikim nuk i dërgohet palës tjetër dhe kur ajo nuk thirret për t'u dëgjuar në Gjykatën e Lartë. Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë nuk rezulton t'i ketë komunikuar kërkueses kërkesën për rishikim të paraqitur nga subjekti i interesuar, por është mjaftuar vetëm me njoftimin e kohës së shqyrtimit të kësaj kërkese nëpërmjet shpalljes në ambientet e saj dhe në faqen e internetit. Duke mos marrë njoftim për aktin e ankimit "kërkesë për rishikim", njoftimi për kohën e shqyrtimit të tij ka mbetur formal, pasi kërkuesja efektivisht ka qenë në pamundësi të paraqesë prova, fakte dhe argumente për çështjen në gjykim. Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të formës së prerë vetëm mbi bazën e pretendimeve të subjektit të interesuar, të parashtruara në kërkesën për rishikim, pa dëgjuar pretendimet e kërkueses, e cila është vënë në pozitë të pafavorshme në raport me palën tjetër *(shih vendimin nr.18, datë 04.04.2023, paragrafi 26-28, të GJK-së).*

10. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimi i kontradiktoritetit nga Gjykata e Lartë, e cila nuk e mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën për rishikim edhe pse ishte përpiluar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit, si nga ana formale, ashtu edhe në përmbajtje, Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka vlerësuar se shqyrtimi i kërkesës për rishikim në seancë gjyqësore, pasi është verifikuar paraqitja e saj sipas kritereve ligjore në dhomën e këshillimit, ka të bëjë me analizimin në thelb të shkaqeve të rishikimit. Ky vlerësim i përket seancës gjyqësore edhe për faktin se vetëm gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, palët kanë mundësi të realizojnë të drejtën e tyre për t'u dëgjuar, si dhe parimin e kontradiktoritetit, si elemente përbërëse të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjykata e Lartë nuk duhet të mjaftohet me një trajtim formal të çështjes, por duhet që pavarësisht situatës juridike të marrë të gjitha masat që e drejta e aksesit të garantohet efektivisht. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë në rastin në shqyrtim ishte e detyruar ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore *(shih vendimin nr. 52, datë 24.07.2017, paragrafi 29, të GJK-së).*

C- PENALE

a) Për Gjykatën e Lartë

11. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u dëgjuar, pasi gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Durrës, kërkuesi ka qenë në mungesë. Sipas kërkuesit, ai nuk ka pasur dijeni se ndaj tij ishte filluar një çështje penale pasi njoftimet e kryera nga gjykata janë bërë në adresa të gabuara dhe se adresa e tij, ka qenë dhe është një banese e ndryshme nga ajo në të cilën gjykatat kanë bërë njoftimet. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se nga dokumentet bashkëngjitur dosjes gjyqësore, rezulton se bashkëshortja e kërkuesit me anë të prokurës së posaçme ka autorizuar avokatin të përfaqësojë gjatë hetimit dhe gjykimit bashkëshortin e saj, i akuzuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës për veprën penale të parashikuar nga neni 143/2 i KP-së. Nga pyetjet drejtuar mbrojtësit të kërkuesit në seancë plenare, Gjykata krijoi bindjen se kërkuesi ka pasur dhe vazhdon të ketë marrëdhënie të mira me bashkëshorten dhe se kjo e fundit ka vepruar gjatë redaktimit të prokurës sipas porosisë të kërkuesit. Nga analiza e fakteve të mësipërme, Gjykata arrin në konkluzionin se kërkuesi ka pasur dijeni për procesin penal në ngarkim të tij dhe së bashku me bashkëshorten e tij, pas redaktimit të prokurës nga kjo e fundit, janë larguar me vullnet të lirë nga RSH-ja, duke zgjedhur gjithashtu me vullnet të lirë të mos marrë pjesë në procesin penal në ngarkim të tij, me qëllim për t'ju fshehur drejtësisë. Duke pasur parasysh se neni 33 i Kushtetutës sanksionon se, nuk mund të përfitojë nga e drejta kushtetuese për t'u dëgjuar nga gjykata personi që i fshihet drejtësisë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të gjykimit në mungesë, është i pabazuar *(shih vendimin nr.45, datë 10.10.2011, paragrafët 24 -28, të GJK-së).*

12. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u dëgjuar, pasi Kolegji Penal, padrejtësisht, nuk ka kaluar çështjen për shqyrtim në seancë të rregullt gjyqësore, edhe pse rekursi përmban shkaqe të parashikuara nga neni 432, pika 1, gërma "a" e KPP-së, "për zbatim të gabuar të ligjit". Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se nga përmbajtja e rekursit të paraqitur Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, del se kërkuesi ka ngritur pretendimin se është zbatuar gabim ligji ndaj tij, shkak ky që parashikohet në nenin 432, shkronja "a" të Kodit të Procedurës Penale. Por, edhe në vendimin e Kolegjit Penal, ndonëse pranohet se kërkuesi ka pretenduar si shkak për prishjen e vendimeve, cilësimin e gabuar të veprës penale nga gjykatat, në dispozitiv të tij është vendosur në Dhomën e Këshillimit, mospranimi i rekursit. Në këto rrethana, çështja duhet të kalonte për gjykim në seancë të rregullt gjyqësore. Duke mos pranuar rekursin në Dhomën e Këshillimit, Kolegji Penal i ka mohuar kërkuesit të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në një proces të rregullt ligjor. Vendimi i Kolegjit Penal i dhënë në Dhomën e Këshillimit, është antikushtetues edhe për faktin se ky kolegj i ka hyrë vlerësimit të vendimit të Gjykatës së Apelit, ku thuhet se "Nga ana e gjykatës në marrjen e vendimit, është zbatuar drejt ligji penal dhe normat e tjera juridike". Ky konkluzion i shprehur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, është atribut i një procesi të rregullt ligjor

me pjesëmarrjen e palëve dhe jo i Dhomës së Këshillimit. Pra, Dhoma e Këshillimit nuk mund të shqyrtojë çështjen në themel dhe as të zgjidhë drejtësinë ose jo të vendimeve të gjykatave më të ulëta, pasi një të drejtë të tillë e ka Kolegji Penal në seancë gjyqësore *(shih vendimin nr.25, datë 24.04.2001, paragrafët 3-5, të GJK-së).*

Ç- ADMINISTRATIVE

a) Për Gjykatën e Lartë

13. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe për mbrojtje efektive, pasi Gjykata e Lartë, duke zhvilluar gjykimin në dhomë këshillimi, nuk i ka krijuar mundësi kërkuesit të parashtrojë pretendimet e tij. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim, duke mbajtur në konsideratë që Gjykata e Lartë sipas Kushtetutës vepron si gjykatë ligji (pra nuk merret me shqyrtim provash, dëgjim dëshmitarësh dhe përcaktim faktesh). Gjykata vlerëson se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë nuk rezulton të jenë cenuar rregullat procedurale për njoftimin e zhvillimit të seancës gjyqësore, si dhe duke pasur parasysh gjykimin e zhvilluar në dhomën e këshillimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, kërkuesit i është krijuar mundësia për të paraqitur argumentet e tij me shkrim. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se edhe në tërësi procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë në një shkallë gjykimi (në gjykatën e apelit) është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës kërkuesi ka qenë i përfaqësuar me avokat, duke i krijuar mundësinë për t'u dëgjuar dhe mbrojtur. Në përfundim, Gjykata ka vlerësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur është i pabazuar *(shih vendimin nr. 28, datë 01.11.2022, paragrafi 63, të GJK-së).*

14. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe për mbrojtje efektive, pasi për shkak të mungesës së njoftimit të datës dhe orës së seancës nga ana e Gjykatës së Lartë, kërkuesi nuk ka mundur të marrë pjesë në gjykim. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim Dhe vëren se njoftimi me shpallje nuk nënkupton përmbushjen e detyrimit të sekretarisë së Gjykatës së Lartë për njoftimin e rregullt të palëve, në mënyrë që ato të mund të marrin pjesë në gjykim, si dhe të dëgjohen e të mbrohen me anë të paraqitjes së komenteve ose prapësimeve, pasi ajo ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim. Gjykimi administrativ bëhet si rregull në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh (neni 61, pika 1, i ligjit nr. 49/2012), dhe në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji (neni 62 i ligjit nr. 49/2012) zhvillohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Gjykata vlerëson se gjykimi në seancë gjyqësore ka si qëllim të garantojë të drejtën e palës për t'u dëgjuar në seancën publike për shkak të veçorisë së çështjes. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata çmon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet të marrte masat e nevojshme për t`i garantuar kërkuesit të drejtën për të marrë pjesë në gjykim, si dhe të drejtën për t`u dëgjuar dhe për t`u mbrojtur *(shih vendimin nr. 8, datë 23.02.2021, paragrafët 27-29, të GJK-së).*

3. E drejta për t'u mbrojtur

Neni 31 i Kushtetutës:
Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:
a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;
b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;
ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij;
d) të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;
dh) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Të drejtat e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt në kuptimin kushtetues. Gjykata e ka vlerësuar të drejtën e mbrojtjes si element thelbësor të një procesi të rregullt. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve *(shih vendimin nr. 73, datë 14.12.2015, paragrafi 12, të GJK-së).*

2. E drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor i ngarkon autoritetet me detyrat që të njoftojnë, në kohë të mjaftueshme, palët dhe mbrojtësit e tyre për datën dhe vendin e mbajtjes së procedurave gjyqësore, për të kërkuar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar ata padrejtësisht nga gjykimi. Do të ishte pa vlerë përshkrimi në detaje i garancive procedurale të palëve në proces në rast se atyre nuk do t'u sigurohej ajo që në fakt bën të mundur respektimin e këtyre të drejtave dhe që është pjesëmarrja në gjykim *(shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013, paragrafi 38; nr. 42, datë 29.09.2011, paragrafi 9; nr. 11, datë 18.05.2005, paragrafi 5, të GJK-së,).*

3. Në nenin 31/ç të Kushtetutës parashikohet se në procesin penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, ndërsa në nenin 33/1, duke iu referuar sërish procesit penal, deklarohet se kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet. Në këtë mënyrë deklarohet një e drejtë kushtetuese me rëndësi thelbësore, e drejta e të pandehurit për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur vetë ndaj akuzës së bërë ndaj tij. Pjesëmarrja e të pandehurit në seancë gjyqësore dhe mundësia e mbrojtjes vetë janë padyshim elemente të rëndësishme të së drejtës për proces të rregullt ligjor në

kuptimin kushtetues. Nga ana tjetër, deklarimet e të pandehurit në seancë, pavarësisht se ai mund të mbrohet njëkohësisht edhe nga një avokat, i shërbejnë vetë gjykimit të çështjes. Ato shërbejnë për të saktësuar e sqaruar më mirë mjaft elemente të veprës penale, si rrethanat e kryerjes së saj, motivet, formën dhe shkallën e fajësisë, të cilat, marrë në tërësi, do të ndikojnë dukshëm edhe në fatin e akuzës, kualifikimin e veprës, si dhe llojin dhe masën e dënimit *(shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022, paragrafi 21; nr. 13, datë 19.03.2015, paragrafi 15; nr. 25, datë 30.07.2003, paragrafi 11, të GJK-së).*

4. E drejta e një personi të akuzuar për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij është thelbësore për një proces të drejtë. Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Shteti ka detyrimin për ta njoftuar të pandehurin në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për seancën, si dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij. Po ashtu, një nga kriteret e gjykimit të drejtë është edhe e drejta e çdokujt, i akuzuar për një vepër penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, e drejtë e cila nuk humbet edhe pse personi i akuzuar penalisht nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq *(shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022, paragrafi 24; nr. 84, datë 26.12.2017, paragrafi 13; nr. 45, datë 10.10.2011, paragrafi 15, të GJK-së).*

5. Veçanërisht në procesin penal, mbrojtja e të pandehurit lidhet ngushtë me barazinë e armëve dhe kontradiktoritetin, të cilat së bashku përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e tyre, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, me synimin kryesor realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori, që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij *(shih vendimet nr. 71, datë 30.11.2016, paragrafi 10 ; nr. 6, datë 26.02.2013, paragrafi B.2; nr. 16, datë 8.6.2006, paragrafi 6, të GJK-së).*

6. Përgjithësisht është pranuar që seancat gjyqësore të mos zhvillohen pa praninë e një avokati. Për shkak të zhvillimit të debatit gjyqësor për çështje të ligjit, pjesëmarrja e të pandehurit në gjykimin e çështjes në gjykatat më të larta nuk është paraqitur e domosdoshme, me përjashtim të rasteve kur cilësitë personale të të pandehurit kanë pasur rëndësi vendimtare për dhënien e drejtësisë. Mbi këtë bazë është konsideruar si i mjaftueshëm njoftimi i avokatit për ankimin e ushtruar në shkallët më të larta të gjykimit. Në rast se as avokati dhe as i pandehuri nuk paraqiteshin në seancë gjyqësore, është konsideruar i palejueshme vazhdimi i mëtejshëm i saj *(shih vendimet nr. 5, datë 04.03.2008; nr. 23, datë 13.10.2005, paragrafi 7; nr. 25, datë 30.07.2003, paragrafët 9-11, të GJK-së).*

7. Prania personale e të pandehurit në seancën gjyqësore, për shqyrtimin e ankimit të paraqitur nga mbrojtësi i tij, nuk është e domosdoshme nëse objekt shqyrtimi janë

trajtimet dhe përfundimet juridike të arritura nga gjykata më e ulët, vendimi i së cilës nuk mund të ndryshohet në disfavor të të pandehurit. Në këto raste, Gjykata e Lartë nuk ka ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes edhe në mungesë të avokatit të palës së akuzuar, për shkak se argumentet ligjore ai i ka depozituar me shkrim në rekursin e paraqitur përpara saj. Ndryshe paraqitet situata kur, si rrjedhojë e një rekursi të paraqitur nga prokurori, që mbart në potencë mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit, gjykimi të zhvillohej pa praninë e të gjykuarit ose të avokatit të tij. Në këtë rast, nëse as avokati dhe as i pandehuri nuk paraqiten në seancë në Gjykatën e Lartë, është e palejueshme që ajo të vazhdojë. Prezumimi se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim me vetëdije, mund të justifikohet vetëm nëse atij i është bërë njoftimi personalisht dhe mund të vërtetohet që ai e ka marrë vetë atë. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Gjykatën e Lartë del e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejojë zhvillimin e seancës në mungesë të përfaqësuesit të interesave të të pandehurit, pasi kjo është e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes figurës përfaqësuese të avokatit, të marrë pjesë në debatet e mundshme *(shih vendimet nr. 57, datë 21.12.2012, paragrafi 45; nr. 13, datë 21.07.2008, paragrafi 3; nr. 23, datë 13.10.2005, paragrafët 13 -15, të GJK-së).*

8. E drejta e të pandehurit për të marrë pjesë në gjykim, si dhe për të zgjedhur përfaqësuesit ligjorë është një e drejtë kushtetuese vetjake, e cila nuk mund të transferohet te familjarët. Po ashtu, parashikimi në nenin 48/3 për mundësinë e familjarëve për të pajisur me prokurë mbrojtësin e të pandehurit nuk nënkupton transferimin e së drejtës për të zgjedhur mbrojtësin nga i pandehuri te familjarët, por nënkupton edhe ushtrimin e vullnetit të këtij të pandehuri nëpërmjet familjarëve. Me fjalë të tjera, i pandehuri e ushtron këtë të drejtë vetjake nëpërmjet familjarëve të tij, të cilët kanë mundësinë objektive për të kontaktuar me avokatë, në mënyrë që këta të fundit të shqyrtojnë mundësinë për të marrë cilësinë e mbrojtësit ligjor të të pandehurit. Në këto kushte, në qoftë se ka mospërputhje ndërmjet vullnetit të të pandehurit dhe vullnetit të familjarëve të tij, që kanë keqinterpretuar vullnetin e të pandehurit ose kanë pasur një vullnet të ndryshëm për mbrojtësin ligjor, duhet të mbizotërojë vullneti i të pandehurit, i cili në çdo rast mund të refuzojë ose shkarkojë mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët *(shih vendimin nr. 30, datë 17.06.2010, paragrafi 44, të GJK-së).*

9. Për sa i përket mbrojtësit të zgjedhur nga familjarët, ai pranohet vetëm nëse provohet se ata po veprojnë në bazë të porosisë që kanë marrë nga i pandehuri. Pra, lejohet zgjedhja e avokatit nga ana e familjarëve vetëm nëse këta të fundit shprehin vullnetin e të pandehurit për të hequr dorë nga pjesëmarrja në proces dhe jo të investohen me këtë zgjedhje nëse ata nuk kanë kontakte me të pandehurin. Sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në radhë të parë, është e domosdoshme që i pandehuri të ketë dijeni nëse ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në radhë të dytë, të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të. Gjykata ka arritur në këtë përfundim, për arsye se heqja dorë nënkupton një akt vullneti nga ana e të pandehurit, që siç është pranuar nga teoria e së drejtës penale, për të pasur një akt vullnetar duhet të ketë në radhë të parë një proces të brendshëm të perceptimit të realitetit nga ana e të pandehurit dhe më pas një proces të brendshëm vendimmarrjeje prej tij *(shih vendimet nr. 49, datë 10.07.2015, paragrafi 40; nr. 26, datë 08.05.2012, paragrafi 18; nr. 30, datë 17.06. 2010, paragrafi 46, të GJK-së).*

10. Qëllimi i së drejtës për t'u informuar për akuzën, i sanksionuar nga neni 6/3/a i KEDNJ-së, është që informacioni i kërkuar t'i jepet të akuzuarit në momentin e ngritjes së akuzës ose në momentin e fillimit të procesit gjyqësor dhe është thelbësor fakti që vepra penale për të cilën dënohet një person është ajo për të cilën ai është akuzuar. Informimi i plotë dhe i saktë për akuzat e ngritura, si dhe për kualifikimin juridik të veprës penale duhet të konsiderohet si kusht themelor për besueshmërinë e procesit dhe për përgatitjen e duhur të një mbrojtjeje efektive, e cila është një nga garancitë themelore për realizimin e së drejtës për një proces të rregull ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së *(shih vendimet nr. 24, datë 30.04.2012, paragrafët 12 – 13; nr. 4, datë 10.02.2012, paragrafi 12, të GJK-së).*

b. Precedentët ku çështja e cenimit të së drejtës për t'u mbrojtur është vënë në diskutim

A - CIVILE

a) Për Gjykatën e Lartë

11. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i ka mohuar të drejtën e përfaqësimit me avokat në shkelje të neneve 31/ç, 33 dhe 42 të Kushtetutës. Kërkuesja ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore për shkak të paraqitjes së dorëheqjes të avokates së zgjedhur prej saj, e cila ia ka komunikuar këtë dorëheqje edhe Gjykatës së Lartë. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim, duke argumentuar se në kushtet kur kërkuesja nuk kishte mundësi të siguronte avokat tjetër brenda një kohe kaq të shkurtër, ky shkak i paraqitur nga ajo ka qenë i arsyeshëm, ndaj Gjykata e Lartë duhej ta shtynte seancën gjyqësore për t'i dhënë mundësi të përfaqësohej me avokat, aq më tepër kur edhe seanca paraardhëse ishte shtyrë dhe kërkuesja nuk kishte pasur mundësi të paraqiste mbrojtjen e saj me anë të avokates. Pjesëmarrja e avokatëve të palëve gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë parashikohet nga neni 483 i KPC - së. Sipas këtij neni, pas relatimit të çështjes nga relatori, avokatët e palëve paraqesin mbrojtjen e tyre dhe në të njëjtën seancë mund t'i paraqesin gjykatës mendimet e tyre, shkurtimisht, me shkrim. Ndryshe nga shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi, ku Kolegji i Gjykatës së Lartë vendos për pretendimet e paraqitura me shkrim të palëve, pa praninë e avokatëve, në rastet e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, prania e avokatëve merr rëndësi të veçantë për të paraqitur mbrojtjen e palës që përfaqësojnë, në respekt të parimeve të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Këto parime i imponojnë Gjykatës së Lartë detyrimin për marrjen e të gjitha masave për garantimin e tyre në mënyrë efektive dhe respektimin e një procesi të rregullt ligjor. Bazuar në këto garanci, në një rast konkret, ku avokatja e kërkueses kishte dhënë dorëheqjen një ditë përpara seancës gjyqësore, Gjykata ka çmuar se, nisur nga rrethanat faktike të çështjes dhe rëndësia që ka e drejta e mbrojtjes në kuadrin e procesit të rregullt ligjor, në rastin konkret Gjykata e Lartë nuk ka marrë të

gjitha masat për të garantuar të drejtën e mbrojtjes *(shih vendimin nr. 73, datë 14.12.2015, paragrafët 15-17, të GJK-së).*

12. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi kërkuesit nuk i është dhënë mundësia të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi gjatë zhvillimit të gjykimeve. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim si të pabazuar, pasi vlerëson se, në kuadrin e këtij procesi, e drejta e individit "për të pasur ndihmën pa pagesë të një përkthyesi nëse nuk kupton ose nuk flet gjuhën shqipe", ndryshe nga kjo e drejtë në procesin penal, është subjekt i kushtit të dhënies së ndihmës juridike falas, të cilën individi, jo vetëm është i detyruar ta kërkojë, por edhe të provojë pamundësinë e tij financiare për të përballuar shpenzimet e gjykimit. Vetëm në këto kushte gjykatat e juridiksionit të zakonshëm janë të detyruara që në përmbushje të detyrimit kushtetues, për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor, t'i caktojnë individit, palë të një gjykimi civil, një përkthyes që zyrtarisht të ketë njohuri për gjuhën e tij, duke qenë formalisht kompetent në njohjen e gjuhës së tij. Në të kundërtën, Gjykata, bazuar në parimin e përgjithshëm të gjykimit civil të vetëpërgjegjësisë së palës, çmon se individi ka të drejtën dhe detyrimin që ta organizojë vetë mbrojtjen e tij, duke caktuar një përkthyes dhe/ose edhe një mbrojtës, duke përballuar paraprakisht/parapaguar shpenzimet e tij. Kështu, nga një sërë dokumentesh të dosjes gjyqësore, si procesverbalet e seancës gjyqësore, prokura e përgjithshme e lëshuar nga kërkuesi për avokatët e tij, ku njëri prej tyre ka shërbyer edhe si përkthyes, akti i vlerësimit psikologjik, Gjykata ka arritur në konkluzionin se edhe kërkuesi personalisht ka qenë mjaftueshmërisht i informuar për natyrën dhe shkaqet e mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Gjykata, gjithashtu, ka vlerësuar se, duke pasur parasysh se kërkuesi ka qenë i përfaqësuar nga avokatët e tij, kërkuesit nuk i është cenuar as e drejta për të përgatitur mbrojtjen, sepse e ka organizuar mbrojtjen e tij, duke caktuar vetë avokatët, njëri prej të cilëve njohës i gjuhës së kërkuesit *(shih vendimin nr. 35, datë 25.07.2011, paragrafët 3, 2.2-2.3, të GJK-së).*

13. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar pa dijeninë e kërkueses, për shkak se "dëftesat e komunikimit" në emrin e saj dhe të bashkëshortit për njoftimin e rekursit të ushtruar nga subjekti i interesuar ishin të falsifikuara. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vë në dukje se, bazuar në legjislacion procedural civil, "dëftesa e komunikimit" të rekursit është një akt procedural, që bashkë me njoftimin me shpallje në Gjykatën e Lartë siguron njoftimin e palëve për të marrë pjesë në gjykim. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se çdo e metë/pavlefshmëri ose çdo falsitet i "dëftesës së komunikimit" të rekursit cenon edhe të drejtën kushtetuese për t'u mbrojtur, gjë që e bën procesin jo të rregullt nga këndvështrimi kushtetues *(shih vendimin nr. 38, datë 20.09.2011, paragrafi 2.3, të GJK-së).*

14. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur në Gjykatën e Lartë, si rrjedhojë e mungesës së komunikimit të kërkesës për rishikim dhe shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata argumenton se këto dy shkelje të pretenduara nga

kërkuesit janë të lidhura e të ndërvarura nga njëra-tjetra dhe kanë të bëjnë me standardet e caktuara për një proces të rregullt në drejtim të pjesëmarrjes në gjykim, së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit. Varësia dhe kompleksiteti i tyre kushtëzohen me faktin se nga domosdoshmëria e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve dhe jo në dhomën e këshillimit, merr rëndësi edhe aspekti tjetër i shkeljes së pretenduar për mosnjoftim të kërkesës për rishikim të vendimit. Kërkesa për rishikim është një mjet ankimi dhe duhet t'i njoftohet palës tjetër sipas rregullave të përgjithshme, aq më tepër që ky mjet përbën në vetvete një kërkesë të re për të cilën, pala e interesuar, jo vetëm që nuk ka dijeni, por është akoma nën përfytyrimin e realizimit konkret të së drejtës së fituar. Duke marrë parasysh natyrën e shqyrtimit të çështjes në rastet e rishikimit, e cila ka të bëjë jo vetëm me konstatimin e fakteve, por edhe me vlerësimin e tyre (shkronjat "a", "b" dhe "e" të nenit 494 të KPC –së), atëherë ky vlerësim duhet të bëhet nga gjykata pasi të ketë zbatuar parimin e kontradiktoritetit në gjykim. Ky moment ka rëndësi, sepse nuk mund të prishen vendimet në dhomën e këshillimit duke prekur standardet e procesit të rregullt ligjor. Në kushte normale të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, sipas përmbajtjes së nenit 447 të KPC-së, është e detyrueshme që palës së interesuar t'i njoftohet më parë kërkesa e paraqitur nga pala tjetër, me qëllim që t'i garantohet në kohë e drejta e mbrojtjes, të cilën do ta realizojë me pjesëmarrjen në gjykim *(shih vendimin nr. 17, datë 18.07.2005, paragrafët 3.12-3.13, të GJK-së).*

15. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka mohuar Avokaturës së Shtetit të drejtën për të përfaqësuar shtetin në gjyq, sepse jo vetëm nuk e ka njoftuar atë për gjykimin e çështjes, por nuk i ka dërguar asaj as aktet e gjykimit për t'i krijuar mundësinë reale për t'u dëgjuar e mbrojtur në gjykatën e rrethit dhe në gjykatën e apelit. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Në rastin në shqyrtim, nuk rezulton që gjykatat e sistemit gjyqësor të kenë plotësuar standardet e gjykimit, sidomos në dhënien e mundësive Avokaturës së Shtetit për të siguruar mbrojtjen e interesave publikë. Kjo e fundit nuk është njoftuar e nuk i janë dërguar aktet për gjykimin në shkallë të parë dhe në këtë mënyrë i është mohuar një shkallë gjykimi për të paraqitur prova, për të dëgjuar pretendimet e palës tjetër e për të bërë prapësimet e duhura ndaj aktit të ekspertimit. Sipas pretendimit të përfaqësuesit të Avokaturës së Shtetit, kjo e fundit nuk kishte dijeni as për gjykimin në apel dhe pjesëmarrja e punonjëses së saj në këtë gjykim ishte rastësore. Por, edhe sikur të ishin dërguar rregullisht kopjet e akteve të gjykimit dhe të ishte njoftuar rregullisht për gjykimin në apel, pjesëmarrja e Avokaturës së Shtetit nuk do të mund të realizonte një mbrojtje efektive, të riparonte mangësitë themelore procedurale që kishin të bënin me mosnjoftimin e pjesëmarrjen e palëve, mosrespektimin e juridiksionit dhe kompetencën, etj., të cilat gjykata e apelit, sipas nenit 467 të KPC-së, nuk mund t'i korrigjojë vetë, dhe për këtë arsye është e detyruar të prishë vendimin e gjykatës së shkallës së parë e të dërgojë çështjen për rigjykim. Pretendimin e shkeljes së juridiksionit gjyqësor dhe të mosnjoftimit të akteve Avokatura e Shtetit e ka ngritur edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila nuk e ka kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore *(shih vendimin nr. 27, datë 27.07.2009, paragrafët 2.7- 2.8, të GJK-së).*

B - PENALE

a) Për gjykatat e faktit

16. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi pas kryerjes së dënimit për veprën penale të armëmbajtjes pa leje kërkuesi është larguar jashtë shtetit, por në këtë kohë organi i akuzës ka filluar veprime hetimore duke mbledhur të dhëna kundër tij, pa njoftuar as atë, as familjen e tij. Kërkuesi pretendon se nuk ka marrë dijeni për këtë procedim dhe, për rrjedhojë, nuk ka pasur mundësi të mbrohet me avokat të zgjedhur as në fazën e hetimeve paraprake, as në gjykimin në shkallë të parë. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata ka konstatuar se vëllai i kërkuesit është paraqitur në seancë gjyqësore, ku ka deklaruar përpara gjykatës se kërkuesi ndodhej jashtë shtetit dhe se familja ka zgjedhur si avokat për mbrojtjen e tij pikërisht avokatin e zgjedhur kryesisht nga gjykata. Ky avokat ka realizuar mbrojtjen e kërkuesit në të gjithë procesin e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë, ka kundërshtuar provat e akuzës, i ka interpretuar ato në favor të klientit të tij, duke i kërkuar gjykatës që përfundimisht të shpallë klientin e tij të pafajshëm. Është po ky avokat që ka ushtruar edhe të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit dhe ka marrë pjesë edhe në seancën e parë të zhvilluar në këtë gjykatë. Më tej, gjatë gjithë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Vlorë rezulton se kërkuesi është përfaqësuar nga avokati i zgjedhur personalisht prej tij me prokurë. Gjykata ka konstatuar se, ndryshe nga sa pretendohet, organi i prokurorisë, gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, gjatë gjykimit të çështjes, kanë përmbushur të gjitha detyrimet ligjore që u ngarkohen atyre për të siguruar njoftimin dhe pjesëmarrjen e të pandehurit në hetim dhe gjykim. Në kushtet kur nuk është bërë e mundur gjetja e kërkuesit, familjarët e tij kanë marrë dijeni për zhvillimin e procesit penal dhe kanë deklaruar se ndodhej jashtë shtetit, duke i caktuar edhe avokat gjatë gjykimit të çështjes, gjykata, bazuar në dispozitat procedurale, ka vendosur zhvillimin e gjykimit në mungesë. Gjykata vlerësoi se kërkuesit i është siguruar efektivisht mbrojtja me avokat gjatë këtij procesi dhe, për rrjedhojë, nuk e gjen të mbështetur pretendimin për cenimin e së drejtës së mbrojtjes *(shih vendimin nr. 10, datë 02.04.2009, paragrafi 2.5. – 2.6, të GJK-së).*

17. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi kërkuesit nuk i janë komunikuar as ankimi i bërë nga prokurori kundër vendimit të gjykatës së rrethit, e cila e kishte deklaruar atë të pafajshëm për veprën penale të "vjedhjes me armë" në bashkëpunim, as rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë nga i bashkëdënuari. Ai pretendon, gjithashtu, se nuk është vënë në dijeni as për datat e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë, të cilat e kanë gjykuar dhe dënuar në mungesë. Gjykata çmon se Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka përmbushur detyrimet për të siguruar të drejtën e mbrojtjes të të akuzuarit në procesin penal. Vetëm nëpërmjet garantimit të së drejtës së mbrojtjes realizohet një debat real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e të vërtetës dhe dhënien e drejtësisë me objektivitet e paanësi. Mossigurimi i pjesëmarrjes në gjykim të të akuzuarit në çdo rast, edhe atëherë kur ky i fundit i fshihet drejtësisë, nuk mund të përligjë zhvillimin

e procesit kundër tij pa pjesëmarrjen dhe dëgjimin e mbrojtësit. Interesat e drejtësisë e kërkonin detyrimisht realizimin e mbrojtjes së kërkuesit, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht, duke pasur parasysh që gjykimi nga Gjykata e Apelit është bërë mbi bazën e ankimit të paraqitur nga prokurori, në të cilin, ndër të tjera, është kërkuar një rëndim i dukshëm i pozitës së kërkuesit në krahasim me vendimin e dhënë për këtë çështje nga gjykata e shkallës së parë. Gjykata e Lartë, në kushtet kur Gjykata e Apelit ka gjykuar kërkuesin në mungesë të tij dhe të mbrojtësit dhe ka rënduar pozitën e tij në krahasim me gjykimin në shkallën e parë, ka pasur detyrimin të siguruar mbrojtjen e kërkuesit në këtë gjykim, qoftë edhe nëpërmjet caktimit të një avokati kryesisht. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë ishte e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejonte zhvillimin e seancës në mungesë të avokatit mbrojtës të të pandehurit, si e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes këtij të fundit, të realizonte të drejtën për t'u mbrojtur *(shih vendimin nr. 30, datë 26.11.2009, paragrafët 8-10, të GJK-së).*

18. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u vënë në dijeni për akuzën që i bëhet kërkuesit, pasi me ndryshimin e cilësimit të veprës penale nga ana e gjykatës, kërkuesit nuk i është komunikuar akuza për veprën e re, të ndryshme nga ajo e paraqitur nga prokurori në kërkesën për gjykim. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata çmon se në thelb të pretendimeve të kërkuesit për cenim të së drejtës për t'u informuar për akuzën e ngritur dhe së drejtës për t'u mbrojtur qëndron e drejta e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale dhe për pasojë për të dënuar të pandehurin për një vepër të ndryshme më të rëndë nga ajo për të cilën është akuzuar nga prokurori në kërkesën për gjykim, kur ndërkohë nga gjykata është proceduar me gjykim të shkurtuar. Gjykata, pasi ka analizuar garancitë që duhet të gëzojë i pandehuri që kërkon gjykim të shkurtuar, vëren se kërkuesi, duke marrë në konsideratë kualifikimin nga prokurori të veprës penale të "vjedhjes me dhunë", si dhe duke vlerësuar dënimin e parashikuar për këtë vepër penale (në rast të deklarimit fajtor të tij nga gjykata), ka kërkuar të procedohet me gjykim të shkurtuar, në gjendjen që janë aktet në lidhje me këtë vepër penale, duke hequr dorë kështu në mënyrë të vullnetshme nga disa të drejta kushtetuese në gjykim (si parimi i barazisë së armëve dhe i formimit të provës në kontradiktoritet), në mënyrë që të përfitojë nga avantazhet (ulja e dënimit) e përcaktuara nga legjislatori për këtë qëllim; ndërsa gjykatat e juridiksionit të zakonshëm edhe pse kanë pranuar kërkesën e kërkuesit për të proceduar me gjykim të shkurtuar në lidhje me veprën penale të "vjedhjes me dhunë", e kanë deklaruar fajtor dhe dënuar për një vepër penale të re, më të rëndë, atë të "vjedhjes me pasojë vdekjen", duke i cenuar kështu kërkuesit të drejtën e mbrojtjes në lidhje me veprën për të cilën është deklaruar fajtor *(shih vendimin nr. 24, datë 30.04.2012, paragrafët 14 & 19, të GJK-së)*

b) Për Gjykatën e Lartë

19. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për të zgjedhur një avokat për ta përfaqësuar në gjykim edhe pse ai ka marrë dijeni pas dhënies së vendimit, në momentin e arrestimit. Prokuroria ka ushtruar rekurs vetëm kundër vendimit të tij, ndërkohë që nuk ka bërë të njëjtën gjë ndaj vendimit gjyqësor për babanë e tij, i cili kishte përfituar në të njëjtën mënyrë nga amnistia. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka mbajtur qëndrimin se në kushtet kur shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë karakterizohet nga debati profesional mbi kuptimin e ligjit, thjesht dhe vetëm "caktimi" i një mbrojtësi nuk mjaftonte për të siguruar ndihmë juridike efektive për kërkuesin. Mbrojtësi i caktuar nuk rezulton të ketë përmbushur përgjegjësinë e tij realisht dhe në interes të kërkuesit, në kuptimin e studimit dhe përgatitjes së mbrojtjes në nivel të përshtatshëm profesional dhe të formulimit të argumenteve ligjore sipas shkaqeve të ngritura në rekurs dhe rrethanave të çështjes konkrete. Kolegji Penal nuk rezulton t'i ketë bërë ndonjë pyetje ose vërejtje mbrojtësit, por e ka konsideruar të realizuar mbrojtjen e individit dhe ka dhënë vendimin përfundimtar, duke pranuar rekursin e prokurorit dhe duke përmbysur në disfavor të kërkuesit rezultatin që ishte vendosur nga gjykata e apelit. Nga shqyrtimi i mendimit me shkrim, pa datë dhe gjithsej 2 fletë, të nënshkruar nga mbrojtësi dhe të administruar në dosjen gjyqësore, konstatohet mungesa e qartë jo vetëm e argumentimit ligjor për çështjen, në kuptim të interpretimit të ligjit sipas rrethanave të çështjes, por edhe e kërkimit/qëndrimit përfundimtar mbi objektin e rekursit të prokurorit. Ndërsa Gjykata e Lartë nuk rezulton të ketë marrë masat e duhura për të riparuar këtë situatë, si për shembull ta kishte ftuar avokatin e caktuar kryesisht që të shtonte ose korrigjonte materialin mbrojtës në vend që të zgjidhte çështjen dhe të arsyetonte vendimin e saj bazuar vetëm në argumentet ligjore të prokurorisë. Gjykata vlerëson se avokati i caktuar kryesisht për kërkuesin ka dështuar në mënyrë të dukshme për t'i ofruar atij mbrojtje efektive dhe se Gjykata e Lartë nuk ka ndërhyrë për marrjen e masave të duhura. Në këtë mënyrë, e drejta e mbrojtjes e kërkuesit është realizuar vetëm formalisht, pa plotësuar standardin substancial të saj, për rrjedhojë ka mbetur një e drejtë iluzive dhe teorike *(shih vendimin nr. 34, datë 17.11.2022, paragrafët 34-36, të GJK-së).*

20. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi gjykimi i iniciuar nga rekursi i prokurorit është zhvilluar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në mungesë të kërkuesit dhe të mbrojtësit të tij. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim si të bazuar. Gjykata konstaton se gjykimi nuk është zhvilluar dhe është shtyrë për mosparaqitje të mbrojtësit të të gjykuarit. Më pas, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar gjykimin në mungesë të të gjykuarit dhe mbrojtësit të tij dhe veprimet e vetme të kryera për lajmërimin kanë të bëjnë me komunikimin e rekursit të të gjykuarit dhe mbrojtësit të tij. Gjykata ka argumentuar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk duhej të zhvillonte gjykimin në mungesë të mbrojtësit të të gjykuarit, por duhej të ushtronte të gjitha mjetet procedurale për të garantuar praninë e mbrojtësit në gjykim, qoftë edhe duke e caktuar atë kryesisht. Vazhdimi i gjykimit të çështjes në mungesë (in absentia)

të tij dhe të mbrojtësit i ka cenuar kërkuesit të drejtën e mbrojtjes, si një element i së drejtës për proces të rregullt ligjor, garantuar nga nenet 31 dhe 42 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Ushtrimi i së drejtës së mbrojtjes jo vetëm do t'i siguronte kërkuesit një mbrojtje efektive, por do t'i jepte mundësinë të gëzonte të gjitha garancitë e gjykimit të rregullt ligjor, të garantuara nga dispozitat e lartpërmendura. Po kështu, cenimi i së drejtës së mbrojtjes ka sjellë si pasojë edhe cenimin e së drejtës për barazi të armëve, dhe të së drejtës për gjykim kontradiktor *(shih vendimin nr. 16, datë 15.06.2009, paragrafët 8-11, të GJK-së).*

C - ADMINISTRATIVE

a) Për gjykatat e faktit

21. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka marrë në shqyrtim apelin kundërshtues të kërkuesve, duke e konsideruar të paraqitur jashtë afatit ligjor. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit, duke mos u shprehur për datën se kur kërkuesit kanë marrë dijeni për paraqitjen e ankimit të plotë nga ana e subjekteve të interesuara dhe duke e konsideruar paraqitjen e apelit të tyre kundërshtues jashtë afatit ligjor, nuk ka respektuar rregullat procedurale në këtë drejtim. Gjithsesi, në këtë këndvështrim, Gjykata është shprehur se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson. Bazuar në këto konsiderata, Gjykata vëren se përderisa në thelb në vendimin e kundërshtuar u është dhënë përgjigje e arsyetuar pretendimeve të kërkuesve të parashtruara në apelin kundërshtues, fakti që Gjykata Administrative e Apelit e ka konsideruar atë si të paraqitur jashtë afatit ligjor, nuk ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe në zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë. Prandaj, Gjykata çmon se thjesht kjo rrethanë nuk është e mjaftueshme për ta konsideruar procesin gjyqësor të zhvilluar në atë gjykatë të parregullt në kuptimin kushtetues *(shih vendimin nr. 24, datë 11.10.2022, paragrafët 44-46, të GJK-së).*

22. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi kërkuesi nuk ka marrë pjesë në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë, për shkak të mosnjoftimit të tij për datën dhe orën e seancës gjyqësore, në përputhje me dispozitat procedurale. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim si të bazuar. Gjykata ka konstatuar se gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë është zhvilluar pa praninë e palëve. Gjykata e Apelit Tiranë, pasi ka bërë verifikimin e paraqitjes së palëve, ka vendosur zhvillimin e gjykimit në mungesë të kërkuesit, me arsyetimin se kërkuesi ka pasur dijeni.

Sipas vërtetimit të lëshuar nga kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, rezulton se në listën e gjyqeve të datës 20.09.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë nuk është listuar çështja civile me palë paditëse kërkuesin. Po ashtu, edhe në materialet e dosjes gjyqësore nuk rezulton i administruar ndonjë njoftim për kërkuesin në lidhje me datën dhe orën e seancës gjyqësore. Gjykata ka vlerësuar se ishte detyrë e Gjykatës së Apelit të Tiranës të verifikonte nëse njoftimi i palëve ishte bërë në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me nenin 460 të KPC-së. Mospërmbushja nga ana e kësaj gjykate e detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat procedurale për njoftimin e rregullt të kërkuesit për datën dhe orën e seancës gjyqësore në atë gjykatë ka sjellë për rrjedhojë cenimin e së drejtës së tij për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u mbrojtur në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së palëve. Po ashtu, Gjykata vëren se ndonëse pretendimi si më sipër është ngritur nga kërkuesi edhe në rekursin drejtuar Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ky i fundit, si gjykatë ligji, duhet t'i konstatonte këto shkelje, duke i korrigjuar ato *(shih vendimin nr. 68, datë 17.11.2015, paragrafët 16-17, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

23. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi edhe pse Gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit e kanë pranuar padinë e kërkuesit për njohjen e së drejtës për pension të parakohshëm në këtë periudhë, Gjykata e Lartë i ka prishur vendimet, duke vendosur pushimin e gjykimit të çështjes. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se gjykimi i çështjes së kërkuesit është pushuar nga Gjykata e Lartë për shkak se nuk janë plotësuar kushtet formale të shqyrtimit në themel të padisë, që lidhen me shterimin e ankimit administrativ dhe afatin e ngritjes së padisë. Ato parashikohen nga ligji si kushte për ngritjen e padisë për të garantuar respektivisht rolin subsidiar të administratës publike dhe parimin e sigurisë juridike, megjithatë duhet mbajtur në konsideratë se në thelbin e tyre, kushtet formale të paraqitjes së padisë kufizojnë me ligj aksesin në gjykatë. Për shkak të natyrës dhe rëndësisë së tyre, ligji përcakton se kushtet formale të ngritjes së padisë janë të verifikueshme nga gjykata edhe kryesisht, pa pasur nevojë për kërkesë paraprake nga palët (shih nenet 16, 18 dhe 19 të ligjit nr. 49/2012). Për shkak të këtyre karakteristikave, është e qartë se verifikimi i kushteve formale të padisë përbën çështje me natyrë ligjore. Gjykata konstaton se në çështjen e kërkuesit shterimi i ankimit administrativ dhe afati i ngritjes së padisë nuk janë paraqitur si shkaqe në rekursin e shqyrtuar në Gjykatën e Lartë. Kjo do të thotë se ato janë verifikuar si çështje ligjore për herë të parë dhe me nismë të vetë Gjykatës së Lartë në procedurën e shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit. Në këtë mënyrë, kërkuesit nuk i është dhënë mundësia të paraqesë paraprakisht mendimin e tij për çështjet ligjore të analizuara nga Gjykata e Lartë. Kërkuesi është vendosur në pozicionin e pamundësisë për t'u mbrojtur efektivisht për to, duke u përballur me një vendim gjyqësor që nuk i jepte përgjigje përfundimtare pretendimit që ai kishte për të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi *(shih vendimin nr. 7 datë 21.02.2023, paragrafët 26 -28, të GJK-së).*

24. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi Gjykata e Lartë, nisur nga natyra e pozicionit të kërkuesit si funksionar publik, duhet ta kthente për rigjykim çështjen dhe jo të ndryshonte vendimet e gjykatave më të ulëta e të rrëzonte padinë. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se kërkuesit i është njohur e drejta për dëmshpërblim me 19 paga mujore nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit. Sipas vendimeve gjyqësore, marrëdhënia juridike rregullohej nga Kodi i Punës dhe subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë, e ka zgjidhur kontratën në mënyrë të menjëhershme dhe pa respektuar afatet e njoftimit të parashikuara nga Kodi i Punës, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur ndryshimin e këtyre vendimeve dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Kërkesëpadia e kërkuesit është rrëzuar nga Gjykata e Lartë për shkak se kjo e fundit ka vlerësuar se në bazë të dispozitave të ligjeve nr. 8652/2000 dhe nr. 8654/2000, natyra e funksionit publik të ushtruar nga kërkuesi tregon qartë se pozicioni i zëvendëskryetarit të bashkisë ose njësisë bashkiake mbështet drejtpërdrejt funksionin politik të kryetarit të bashkisë ose kryetarit të njësisë bashkiake. Duke vijuar më tej në arsyetimin e saj, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se zëvendëskryetari i bashkisë/njësisë bashkiake është funksionar publik që ushtron funksione me natyrë politike. Prandaj, në logjikën juridike të qenies me natyrë politike edhe të këtij funksioni, ndryshe nga nëpunësit dhe punonjësit e tjerë administrativë të bashkisë/njësisë bashkiake, emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë/njësisë bashkiake. Gjykata konstaton se në çështjen e kërkuesit referimi në dispozitat e ligjeve nr. 8652/2000 dhe nr. 8654/2000 nuk është paraqitur si shkak në rekursin e shqyrtuar në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit, duke u shprehur për shkaqe të tjera nga ato të paraqitura në rekurs, ka ndryshuar edhe shkakun e largimit nga puna. Referimi i Gjykatës së Lartë në dispozitat e ligjeve nr. 8652/2000 dhe nr. 8654/2000, dhe arsyetimi për to, është verifikuar si çështje ligjore për herë të parë dhe me nismë të vetë asaj në procedurën e shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit. Në këtë mënyrë, kërkuesit nuk i është dhënë mundësia të paraqesë paraprakisht mendimin e tij për çështjet ligjore të analizuara nga Gjykata e Lartë kryesisht. Ai është vendosur në pamundësi për t'u mbrojtur efektivisht për to, duke u përballur me një vendim gjyqësor të paplotë, alogjik dhe që nuk i jepte përgjigje përfundimtare pretendimeve që ai kishte për të drejtën e dëmshpërblimit si pasojë e ndërprerjes së menjëhershme të marrëdhënieve të punës. Për rrjedhojë, pretendimi i tij për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor lidhur me mbrojtjen efektive është i bazuar dhe vendimi i Gjykatës së Lartë duhet shfuqizuar *(shih vendimin nr. 13, datë 21.03.2023, paragrafët 31-32 & paragrafi 34, të GJK-së).*

➢ *Me avokat të zgjedhur ose të caktuar kryesisht*

a) Për gjykatat e faktit

25. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Shkodër është bërë pa pjesëmarrjen e një mbrojtësi, qoftë edhe të caktuar kryesisht nga gjykata, gjë që sipas kërkuesit përbën proces të parregullt ligjor. Ky pretendim është parashtruar edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, por

Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit. Gjykata i ka vlerësuar të bazuara këto pretendime. Gjykata konstaton se të akuzuarit nuk i janë dhënë këto garanci në gjykimin e bërë në Gjykatën e Apelit Shkodër, duke u cenuar dukshëm e drejta e tij e mbrojtjes. Në fakt, rezulton se Kryetari i Kolegjit të Gjykatës së Apelit Shkodër i ka dërguar njoftim për ditën dhe orën e gjykimit të çështjes edhe Dhomës së Avokatisë Lezhë (mbrojtësit të caktuar kryesisht nga gjykata e shkallës së parë, i cili kishte bërë edhe ankimin kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë), por ky njoftim nuk ka asnjë konfirmim nga marrësi dhe nuk dihet nëse i është komunikuar ose jo mbrojtësit të caktuar kryesisht. Pavarësisht nga kjo, Gjykata çmon se edhe sikur njoftimi i bërë me këtë rast të ishte i rregullt, Gjykata e Apelit Shkodër, në funksion të respektimit të kërkesës për barazinë e armëve dhe të shanseve dhe të parimit të kontradiktoritetit, nuk duhej të kishte vendosur për zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit dhe të mbrojtjes, por duhej ta kishte shtyrë atë dhe të kishte marrë masat e duhura për të siguruar pjesëmarrjen e mbrojtësit, qoftë edhe të një tjetri të caktuar përsëri kryesisht *(shih vendimin nr. 19, datë 12.06.2003, paragrafët 7-9, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

26. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi Gjykata e Lartë, që nuk e ka pranuar rekursin me arsyetimin se është paraqitur nga një mbrojtës pa tagra, ka sjellë mohimin absolut të së drejtës së kërkuesit për t`iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura. Përfaqësimi i kërkuesit në Gjykatën e Lartë dhe ushtrimi i të drejtave në funksion të mbrojtjes së tij janë realizuar në bazë të prokurës së posaçme, të nënshkruar nga vetë kërkuesi në IEVP, në prani të punonjësve të këtij institucioni, e cila i është bashkëlidhur edhe ankimit kushtetues individual. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar pretendimin. Për sa i përket aktit të përfaqësimit, prokurës së posaçme, nuk rezulton që ajo të jetë administruar nga gjykatat dhe as nuk konstatohet të jetë përfshirë në fashikujt e akteve të prokurorisë dhe ato gjyqësore. Gjykata konstaton, gjithashtu, se as në seancë gjyqësore, as në vendimet e këtyre gjykatave nuk është vënë në diskutim përfaqësimi i kërkuesit nga avokati dhe as tagrat e tij. Ky avokat e ka përfaqësuar kërkuesin në çdo shkallë gjykimi (me përjashtim të seancave gjyqësore ku ai ka qenë në mungesë dhe përfaqësimi është bërë nga mbrojtësi i caktuar kryesisht) dhe ankimi në gjykatën e apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë, si dhe ankimi kushtetues individual janë nënshkruar po prej tij. Gjykata ka evidentuar se në situatën që administrata gjyqësore nuk ka evidentuar të metat formale të rekursit në momentin e paraqitjes së tij, duke mos i dhënë mundësinë kërkuesit për ta plotësuar atë, Gjykata e Lartë, pavarësisht se ndodhej para situatës faktike të referuar më sipër, ka vendosur apriori mospranimin e rekursit për mungesë të tagrave të përfaqësimit, pa korrigjuar veprimet e administratës së saj gjyqësore dhe pa i dhënë mundësinë kërkuesit dhe mbrojtësit të tij që të plotësonin këto të meta. Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, në kuptim të rrethanave të faktit të evidentuara më sipër, kishte të gjitha hapësirat që kërkesat ligjore për elementet formale që duhet të plotësojë rekursi, në përputhje me funksionin e saj të interpretimit të normës dhe në kuptim të parimit të subsidiaritetit

e pozicionit të saj në piramidën gjyqësore, t'i interpretonte me qëllim garantimin e të drejtave themelore të individit, konkretisht të së drejtës së aksesit substancial. Gjykata, duke i vlerësuar veprimet/mosveprimet e konstatuara në procesin gjyqësor në drejtim të garantimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, në përfundim ka vlerësuar se vendimi i Kolegjit Penal për mospranimin e rekursit, i kundërshtuar nga kërkuesi, është rrjedhojë e një tërësie shkaqesh që lidhen me veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore, duke nisur me mosveprimet e IEVP-së, e cila duhej t`i përcillte një kopje të aktit të përfaqësimit organit procedues (prokurorisë ose gjykatës) dhe më pas të gjykatave, që nuk kanë hetuar dhe verifikuar në mënyrën e duhur përfaqësimin dhe tagrat e mbrojtësit, por edhe me sjelljen e vetë mbrojtësit të kërkuesit *(shih vendimin nr. 6, datë 22.02.2022, paragrafët 32-33, të GJK-së).*

27. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi kërkuesi vuan nga një sëmundje mendore dhe për këtë shkak nuk ka mundur të zgjedhë vetë mbrojtës, prandaj Gjykata e Lartë duhej ta pranonte mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka konstatuar se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit që gjendej në kushtet e kufizimit të lirisë personale në burg, duke e konsideruar atë si të paraqitur nga një mbrojtës i palegjitimuar, në kushtet kur tagrat i ishin dhënë mbrojtësit nga nëna e kërkuesit dhe jo nga kërkuesi, referuar paragrafit 54 të vendimit unifikues nr.1/2014. Gjykata vlerësoi se në rastin konkret nuk jemi përpara situatës ku i pandehuri i fshihet drejtësisë ose është në mungesë, por jemi në kushtet e pamundësisë së kërkuesit për të zgjedhur mbrojtës për arsye të kufizimit të lirisë së tij personale. Gjykata vlerëson se kjo qasje ndaj nenit 48, pika 3, të KPP-së në çështjen konkrete i ka kufizuar kërkuesit aksesin substancial në gjykim, pasi nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij të ngritura në rekurs. Kjo e fundit duket se ka mbajtur një qëndrim formalist për sa i përket mbrojtësit të zgjedhur nga nëna e kërkuesit, duke mos shkuar përtej një kontrolli formal të prokurës, në drejtim të verifikimit nëse zgjedhja e mbrojtësit nga nëna e të gjykuarit ishte rezultat edhe i vullnetit të plotë të këtij të fundit. Në rastin konkret, me qëndrimin e saj formalist në lidhje me verifikimin e legjitimimit të mbrojtësit, Gjykata e Lartë i ka kufizuar kërkuesit aksesin substancial në gjykim, duke e bërë të pamundur shqyrtimin në themel të shkaqeve të rekursit *(shih vendimin nr. 10, datë 12.04.2022, paragrafët 23-24, të GJK-së).*

28. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, si rezultat i mospranimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, të rekursit të panënshkruar nga mbrojtësi. Sipas kërkuesit, mungesa e nënshkrimit të mbrojtësit nuk mund të sjellë detyrimisht mohimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për shkaqet e ngritura në rekurs. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka konstatuar se kërkuesi, i cili nuk ka qenë i pandehur në procesin gjyqësor penal objekt kundërshtimi, ka depozituar brenda afatit ligjor, pranë sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin, një rekurs i cili nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi i tij. Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e rekursit, në dhomë këshillimi, për shkak se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk përmbante nënshkrimin e mbrojtësit, sipas kërkesave të

nenit 435/2 të KPP-së. Nga materialet e paraqitura para Gjykatës nuk rezulton që Kolegji Penal të ketë vlerësuar detyrimin e sekretarisë gjyqësore përkatëse dhe veprimet e saj për plotësimin e kërkesës formale për nënshkrimin e rekursit nga mbrojtësi i kërkuesit. Gjykata vlerëson se, në vështrim të kufijve të zbatimit të nenit 435/2 të KPP-së, të cilët në mënyrë të vazhdueshme janë përkufizuar nga jurisprudenca kushtetuese si mjeti procedural për garantimin e aksesit në gjykatë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka interpretuar nenin 435/2 të KPP-së në mënyrë të ngushtë, jo harmonike dhe të shkëputur nga fryma e Kushtetutës dhe ajo e kuadrit ligjor procedural penal. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi, i ka cenuar kërkuesit të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë, si një nga standardet për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së *(shih vendimin nr. 21, datë 29.04.2013, paragrafët 15-17, të GJK-së).*

IV.

29. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi gjykimi në Gjykatën e Lartë është bërë në mungesë të të pandehurit dhe të mbrojtësit të tij. Kërkuesi pretendon se nuk ka marrë njoftim për zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë, sepse ai kishte përfituar nga ligji nr. 9678, datë 13.01.2007 "Për dhënie amnistie", duke iu falur pjesa e mbetur e dënimit të dhënë nga gjykata e apelit (prej një viti) dhe nuk kishte dijeni se ndaj tij po zhvillohej një proces gjyqësor në Gjykatën e Lartë. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vlerëson se megjithëse kërkuesit, duke qenë se ka investuar Gjykatën e Lartë me rekurs, i lindte detyrimi të interesohej pranë kësaj të fundit për datën e gjykimit të çështjes penale, rasti në shqyrtim paraqet veçanti, sepse pas depozitimit të rekursit dhe para gjykimit të tij në Gjykatën e Lartë, kërkuesi, me daljen e ligjit për amnistinë, ishte liruar nga vuajtja e dënimit me burgim dhe për këtë shkak ai nuk ka vazhduar të interesohej për fatin e çështjes së tij në këtë gjykatë. Për më tepër, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen jo vetëm në mungesë të kërkuesit, por edhe të mbrojtësit të caktuar prej tij. Në rastin në shqyrtim, pranë Gjykatës së Lartë ka paraqitur rekurs edhe prokurori dhe, siç rezulton nga vendimi i saj, Gjykata e Lartë në përfundim të procesit, bazuar në rekursin e prokurorit, ka ndryshuar cilësimin ligjor të veprës dhe ka rritur masën e dënimit në disfavor të kërkuesit. Për pasojë, Gjykata vlerëson se rasti në shqyrtim është i ngjashëm me ato raste për të cilat ka një jurisprudencë të konsoliduar të kësaj gjykate, pra kur rekursi bëhet vetëm nga prokurori. Në lidhje me çështje të tilla analoge, Gjykata e ka konsideruar cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjykimin pa praninë e mbrojtësit të të gjykuarit. Gjykata, ndërmjet të tjerave, ka arsyetuar se përgjithësisht seancat gjyqësore nuk mund të zhvillohen pa praninë e avokatit dhe se pjesëmarrja e të pandehurit në gjykim në Gjykatën e Lartë nuk është automatikisht e domosdoshme, me përjashtim të rasteve kur cilësitë personale të të pandehurit kanë rëndësi vendimtare për dhënien e drejtësisë, sepse debati zhvillohet për çështje të ligjit. Në rast se as avokati dhe as i pandehuri nuk paraqiten në seancë, është e palejueshme që ajo të vazhdojë. Prezumimi se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim me vetëdije, mund të justifikohet vetëm nëse atij i është bërë njoftimi personalisht dhe mund të vërtetohet

që ai e ka marrë vetë atë. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se interesat e drejtësisë kërkojnë detyrimisht realizimin e mbrojtjes, qoftë edhe me avokat të caktuar kryesisht, të të pandehurit që gjykohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, në të cilin, ndër të tjera, kërkohet një rëndim i dukshëm i pozitës së tij në krahasim me vendimin e dhënë për këtë çështje nga gjykata e apelit. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë dilte e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejonte zhvillimin e seancës në mungesë të avokatit mbrojtës të të pandehurit, sepse ishte e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes këtij të fundit, të realizonte të drejtën për t`u mbrojtur *(shih vendimin nr. 13, datë 21.07.2008, paragrafët 8-10, të GJK-së).*

30. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi gjykatat e zakonshme i kanë caktuar kryesisht kërkuesit si mbrojtës avokatin e të gjykuarve të tjerë me të cilët kërkuesi ka pasur papajtueshmëri interesash. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar pretendimin. Gjykata është shprehur se sipas përmbajtjes së nenit 6, shkronja "b", të KEDNJ-së, dhe neneve 49 e 54 të KPP-së, gjykata duhet të krijojë mundësitë që avokati të bëjë një mbrojtje sa më të efektshme. Ndihma juridike që i jepet të akuzuarit dhe që kërkohet në prizmin e interesit të drejtësisë e të rolit të rëndësishëm për një proces të rregullt ligjor në një shoqëri demokratike duhet të jetë pa paragjykime, praktike e efikase dhe jo vetëm iluzore. Këto kërkesa nuk janë realizuar në shqyrtimin e çështjes në gjykatën e apelit, ku avokati i caktuar kryesisht, menjëherë pas fillimit të seancës gjyqësore, është kufizuar vetëm me kërkesën për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit. Në rekursin e paraqitur para Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kërkuesi ka pretenduar shkelje të rënda të Kushtetutës e KPP-së që kanë të bëjnë me caktimin kryesisht të një mbrojtësi, i cili kishte qenë avokat i një të pandehuri me të cilin ai ka papajtueshmëri interesash, me marrjen e të dhënave kundër tij në prokurori nga personat ndaj të cilëve zhvillohen hetime pa praninë e mbrojtësit etj. Megjithëse këto pretendime mbështeteshin tek të dhënat e dosjes, konstatohet se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka marrë çështjen në shqyrtim në seancë plenare *(shih vendimin nr. 15, datë 10.11.2004, paragrafët 6 – 7, të GJK-së).*

- ***Personalisht***

a) Për Gjykatën e Lartë

31. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi njoftimi për datën e gjykimit nga Gjykata e Lartë nuk është bërë konform dispozitave ligjore nga Kolegji Penal për pasojë kërkuesi nuk ka mundur të marrë dijeni për të, gjë që i ka penguar pjesëmarrjen dhe realizimin e së drejtës së mbrojtjes në gjykim. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka konstatuar se Gjykata e Lartë ka pasur në shqyrtim rekursin e paraqitur nga prokurori dhe kjo mbart në potencë mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit. Megjithëse organet e gjykimit nuk mund të

bëhen përgjegjëse për çdo mosparaqitje në seancë nga ana e të gjykuarit ose avokatit të tij, u takon këtyre organeve të ndërmarrin hapa për të siguruar që ai të gëzojë të drejtat e njohura nga Kushtetuta, siç është e drejta e mbrojtjes dhe barazia e armëve si element i saj përbërës. Gjykata konstatoi se, në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë ka bërë njoftimin e datës së gjykimit të kësaj çështjeje me pasaktësi. Në shpalljen e afishuar publikisht, pranë asaj Gjykate, në kolonën përkatëse të rrethit, është shënuar "Dibër" në vend të "Bulqizë", që në fakt i korrespondon emërtimit real të gjykatës së faktit ku është zhvilluar gjykimi. Nga ana tjetër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke zhvilluar gjykimin e çështjes pa verifikuar më parë shkaqet e mosparaqitjes së përfaqësuesit të të pandehurit, nuk ka ndërmarrë hapat e duhur për të siguruar që ai të gëzojë të drejtat e njohura. Gjykata e Lartë në përgjigje të rekursit, nuk ka pasur të administruar asnjë argument ligjor të parashtruar prej palës së akuzuar dhe gjykimi është zhvilluar vetëm me argumente të paraqitura nga prokurori. Çështja vështirësohet dhe për arsyen se me paraqitjen e rekursit nga prokurori, KPP-ja nuk parashikon mundësinë e paraqitjes së kundërrekursit nga pala kundërshtare. Në këto rrethana, pjesëmarrja e të gjykuarit dhe në mënyrë të veçantë e avokatit të tij kërkohet për të siguruar të drejtën e mbrojtjes dhe respektimin e parimit të barazisë së armëve në një proces gjyqësor *(shih vendimin nr. 7, datë 19.02.2007, paragrafët 5 -7, të GJK-së).*

IV.

32. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, si rezultat i refuzimit nga ana e gjykatës të kërkesës së mbrojtësit për thirrjen si dëshmitarë të tre personave që kanë shërbyer gjatë paraqitjes për njohje. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vlerëson se pretendimi i avokatit të kërkuesit për pavlefshmërinë e kësaj prove, për arsye të moszhvillimit të seancës së paraqitjes për njohje, është i drejtë. Në dosje ndodhet urdhri i prokurorit, nëpërmjet të cilit urdhërohet oficeri i Policisë Gjyqësore për kryerjen e paraqitjes për njohje. Megjithëse procesverbali i paraqitjes për njohje, në kuptim të neneve 171 e 172 të KPP-së, është kundërshtuar në të gjitha shkallët e gjykimit si shkak për pavlefshmërinë e njohjes, gjykatat e kanë konsideruar atë si provë për dënimin e kërkuesit. Gjykata ka ritheksuar se e drejta e palëve për të paraqitur argumente sigurohet vetëm në rastin kur ato dëgjohen realisht, pra kur shqyrtohen nga gjykata në mënyrën e duhur. Nuk mund të thuhet se kjo është bërë, në qoftë se është nënvleftësuar një provë me rëndësi esenciale. Parë nga ky këndvështrim, Gjykata çmon se të pandehurit dhe mbrojtësit të tij nuk u është krijuar mundësia, me gjithë kërkesat e shumta në të gjitha shkallët e gjykimit, t'u drejtonin pyetje dëshmitarëve për të kundërshtuar provën në këtë proces penal, duke cenuar të drejtën e mbrojtjes në një masë të papajtueshme me kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6, paragrafët 1 e 3, shkronja "d", të KEDNJ-së *(shih vendimin nr. 7, datë 27.04.2005, paragrafët 16-18, të GJK-së).*

➢ *Standardet e gjykimit në mungesë*

a) Për gjykatat e faktit

33. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi nuk ka pasur dijeni dhe nuk është njoftuar as nga avokati, as nga gjykata e shkallës së parë se ndaj tij po zhvillohej një proces penal në Shqipëri. Ai nuk është thirrur nga gjykata për t'u dëgjuar për akuzat në ngarkim të tij dhe në gjykimin e çështjes në shkallë të parë i është caktuar kryesisht nga gjykata një avokat pensionist, i paaftë për punë, i cili nuk ka bërë një mbrojtje efektive. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur. Gjykata ka vërejtur se pavarësisht se kërkuesi ka qenë në mungesë dhe është përfaqësuar nga mbrojtësi i caktuar kryesisht, pas kërkesës së tij është rivendosur në afat për të bërë ankim ndaj vendimit të fajësisë të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Pra, me anë të mbrojtësit të zgjedhur nga vetë ai, kërkuesi ka ushtruar të drejtën e mbrojtjes dhe ka pasur mundësinë që të gjitha pretendimet në lidhje me vlerësimin e provave dhe fajësinë e tij të shqyrtoheshin nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, ndaj në këto kushte atij nuk i është cenuar e drejta e mbrojtjes *(shih vendimin nr. 14, datë 21.06.2022, paragrafët 26 -27, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

34. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi gjykimi në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda dhe në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në mungesë të kërkuesit, si rezultat i mosrespektimit të rregullave për njoftimin e të pandehurit, të parashikuara nga KPP-ja. Nga shkresë–përgjigjet e Policisë Gjyqësore pranë Komisariatit të Policisë Fier dhe nga raportet e shërbimit të Punonjësve të Policisë së Zonës (PPZ) rezulton se kërkuesi nuk është gjetur në banesë dhe as në ambientet e tjera të frekuentuara më parë prej tij, por është larguar jashtë shtetit në Belgjikë, pa adresë. Ndërkohë, rezulton se fletëthirrjet e gjykatës, drejtuar kërkuesit, janë marrë ose nga avokati i tij, ose nga të afërmit e tij, konkretisht nga babai dhe xhaxhai. Duke vlerësuar personat marrës të fletëthirrjeve si persona madhorë dhe me aftësi të dukshme intelektuale, si dhe formën e përmbajtjen e fletëthirrjeve, nuk rezulton se ka pasur ndonjë të metë që mund të bënte të pavlefshëm njoftimin në kuptim të neneve 140 dhe 143 të KPP-së. Për sa më lart, Gjykata çmon se organet shtetërore kanë marrë të gjitha masat dhe kanë kryer të gjitha veprimet e mundshme, duke përmbushur të gjitha detyrimet ligjore të parashikuara nga legjislacioni procedural penal si dhe nga KEDNJ-ja në lidhje me njoftimin personalisht të kërkuesit. Nga analiza e fakteve të mësipërme, Gjykata arriti në konkluzionin se kërkuesi ka pasur dijeni për procesin penal në ngarkim të tij, por është larguar me vullnet të lirë nga RSH-ja, duke zgjedhur, gjithashtu, me vullnet të lirë të mos marrë pjesë në procesin penal në ngarkim të tij, me qëllim për t'iu fshehur drejtësisë. Duke pasur parasysh se neni 33 i Kushtetutës sanksionon se nuk mund të përfitojë nga e drejta kushtetuese për t'u dëgjuar

nga gjykata personi që i fshihet drejtësisë, Gjykata vlerësoi se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të gjykimit në mungesë, është i pabazuar *(shih vendimin nr. 26, datë 08.05.2012, paragrafët 26 -29, të GJK-së).*

35. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mbrojtur, pasi gjykimi nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është zhvilluar në mungesë të të gjykuarit dhe të avokatit të tij mbrojtës. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka konstatuar se kërkuesit nuk i është dorëzuar një kopje e rekursit të prokurorit të apelit. Për pasojë, Gjykata vlerëson se në mungesë të marrjes nga ana e kërkuesit të kopjes së rekursit të prokurorit, njoftimi i tij për gjykimin në Gjykatën e Lartë është i pamjaftueshëm në aspektin procedural. Kjo për faktin se, ashtu siç ka pranuar Gjykata edhe në raste të tjera të kësaj natyre, njoftimi i pjesëmarrësit në proces, të cilit i kundërdrejtohet rekursi, është një proces dyfazësh, ku, fillimisht, i dorëzohet një kopje e rekursit të paraqitur nga pala tjetër, dhe vetëm pas konfirmimit të marrjes së rekursit, vendoset shpallja për datën e gjykimit të rekursit. Ndërsa, detyrimi për të ndjekur shpalljen e Gjykatës së Lartë për ditën e gjykimit, pjesëmarrësit në proces i bie vetëm pas marrjes së kopjes së rekursit. Në këto kushte, shqyrtimi i çështjes në mungesë, kur kërkuesi nuk ka marrë njoftim, e bën të parregullt procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë *(shih vendimin nr. 13, datë 13.04.2007, paragrafi 11, të GJK-së).*

4. Parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit

Neni 42, pika 2, i Kushtetutës:

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Çdo palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e saj. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk është formale, ku palëve iu garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit gjyqësor, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe, më pas, gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar procesin e rregullt ligjor *(shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022, paragrafi 65; nr. 34, datë 29.05.2015, paragrafi 17; nr. 34, datë 25.07.2011, paragrafi 6, të GJK-së).*

2. Shqyrtimi i çështjes dhe nxjerrja e konkluzioneve nga gjykata vetëm mbi bazën e provave të paraqitura nga një palë, pa dëgjuar pretendimet e palës tjetër, e bën të cenueshëm procesin gjyqësor. E drejta për proces të rregullt gjyqësor përfshin edhe të drejtën e të dyja palëve në proces për të pasur informacion për argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë që palët në një seancë gjyqësore të kenë njohuri edhe për komentet për provat e nxjerra. Në këtë mënyrë gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë *(shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022, paragrafi 65; nr. 34, datë 29.05.2015, paragrafi 17; nr. 19, datë 12.06.2003, paragrafi 5, të GJK-së).*

3. Mosformimi i drejtë i ndërgjyqësisë është cilësuar si shkelje e standardeve për një proces të rregullt ligjor dhe është analizuar në funksion të cenimit të parimit të kontradiktoritetit në gjykim, si dhe të barazisë së armëve, të cilat kërkojnë që në çështjet civile secilës palë në gjykim t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta. Secila palë duhet të ketë mundësi të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës *(shih vendimet nr. 3, datë 23.01.2014, paragrafi 14; nr. 16, datë 19.04.2013, paragrafi 31; nr. 34, datë 25.07.2011, paragrafët 6-7, të GJK-së).*

4. Veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe, lidhur ngushtë me këto, realizimi i mbrojtjes së të pandehurit, i garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, përbëjnë në vetvete elementet më thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Për respektimin e këtyre parimeve, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të përmbushin një sërë detyrimesh, mes të cilave, sipas rastit, rëndësi të veçantë paraqet edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes etj., me synimin që të realizohet një debat real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata *(shih vendimet nr. 35, datë 01.06.2015, paragrafi 15; nr. 23, datë 23.07.2009, paragrafi; nr. 16, datë 08.06.2006, paragrafi 6, të GJK-së).*

b. Precedentët ku çështja e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është vënë në diskutim

A – CIVILE

a) Për Gjykatën e Lartë

5. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për kërkesën për rishikim të paraqitur nga subjekti i interesuar, ndaj kërkuesja nuk ka marrë dijeni për gjykimin e zhvilluar. Në këtë mënyrë ajo nuk ka pasur mundësi të paraqesë argumentet, faktet dhe provat kundër kësaj kërkese. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka konstatuar se KPC-ja e përcakton kërkesën për rishikim si mjet ankimi, ndërsa nuk e përjashton Gjykatën e Lartë nga detyrimi për t'ia njoftuar këtë kërkesë palës tjetër. Sipas Gjykatës, Gjykata e Lartë nuk rezulton t'i ketë komunikuar kërkueses kërkesën për rishikim të paraqitur nga subjekti i interesuar, por është mjaftuar vetëm me njoftimin e kohës së shqyrtimit të kësaj kërkese nëpërmjet shpalljes në ambientet e saj dhe në faqen e internetit. Duke mos marrë njoftim për aktin e ankimit "kërkesë për rishikim", njoftimi për kohën e shqyrtimit të tij ka mbetur formal, pasi kërkuesja efektivisht ka qenë në pamundësi të paraqesë prova, fakte dhe argumente për çështjen në gjykim. Në këtë rast, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të formës së prerë vetëm mbi bazën e pretendimeve të subjektit të interesuar, të parashtruara në kërkesën për rishikim, pa dëgjuar pretendimet e kërkueses, e cila është vënë në pozitë të pafavorshme në raport me palën tjetër. Në këtë mënyrë, kërkuesja, duke mos u njoftuar për paraqitjen e kërkesës për rishikim dhe shkaqet e paraqitura në të, është vënë në pamundësi të paraqesë pretendimet e saj, ndaj Gjykata ka çmuar se është i bazuar pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës së mbrojtjes, së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të kontradiktoritetit *(shih vendimin nr. 18 datë 04.04.2023, paragrafët 25 - 28, të GJK-së).*

6. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, për shkak të mosformimit drejt të ndërgjyqësisë, si pasojë e mosthirrjes në gjykim të dhurueses tjetër të banesës objekt konflikti gjyqësor. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se edhe pse thirrja e palëve të paditura në proces është lënë në disponibilitetin e paditësit, dispozitat procedurale ia kanë njohur edhe gjykatës këtë të drejtë, duke parashikuar në nenin 193 të KPC-së se ajo vetë, në rast se çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili ka interes në çështje, e thërret atë dhe për këtë qëllim shtyn seancën gjyqësore. Nga materialet e çështjes rezulton se pretendimi për formimin drejt të ndërgjyqësisë është ngritur në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, si një nga shkaqet për cenimin e vendimmarrjes së gjykatave më të ulëta, si dhe gjen pasqyrim edhe në vendimin e asaj gjykate (të dhomës së këshillimit). Për pasojë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm i së drejtës për një proces të rregullt *(shih vendimin nr. 3, datë 23.01.2014, paragrafët 15-17, të GJK-së).*

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi gjykatat e zakonshme i kanë bazuar vendimet e tyre vetëm në provat e palës paditëse dhe nuk kanë administruar e vlerësuar edhe provat e kërkuesit. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka theksuar se në mënyrë të veçantë neni 42 i Kushtetutës i vë detyrë gjykatës së zakonshme të bëjë një shqyrtim të përshtatshëm të pretendimeve, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, pa paragjykuar vlerësimin nëse këto prova janë të rëndësishme për vendimin e saj. Gjykata konstaton se gjykatat e zakonshme nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit në vendimet e tyre. Në mënyrë të veçantë gjykatat nuk kanë administruar si provë dhe nuk kanë arsyetuar në vendimet e tyre nëse vendimi gjyqësor i pretenduar nga ana e kërkuesit ka ndonjë vlerë ligjore (efekt) në gjykimin e padisë për deklarimin e falsitetit të dokumenteve. Ky vendim është paraqitur si provë kryesore në këtë gjykim. Për pasojë, Gjykata konstaton se në këtë rast është shkelur parimi i barazisë së armëve në një proces civil *(shih vendimin nr. 23, datë 08.06.2007, paragrafi 11, të GJK-së).*

8. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk i ka krijuar kërkuesit mundësi të barabarta me palën tjetër për të organizuar mbrojtjen. Për natyrën e gjykimit në këtë shkallë, ai ka qenë i përgatitur vetëm për debat gjyqësor për pretendimet ligjore e jo për debat për provat. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Në vlerësimin e Gjykatës, nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Sipas nenit 472 të KPC-së, ky kolegj ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin e ligjit ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, por nuk mund të bëjë një rivlerësim të provave në të kundërt me atë që kanë bërë gjykatat e hallkave më të ulëta dhe mbi këtë bazë të vendosë rrëzimin e kërkesëpadisë. Në çështjen në shqyrtim jo vetëm është bërë një rivlerësim i tillë, duke u shtrembëruar në ndonjë

rast edhe realiteti i fakteve, por, për më tepër, ky rivlerësim është bërë duke ndërhyrë në kompetencën që kishin gjykatat e faktit për të nxjerrë konkluzione juridike mbi bazën e mendimeve të ekspertëve për rregullshmërinë e vendimit të Komitetit Ekzekutiv dhe të regjistrimit të birësimeve në dokumentet e gjendjes civile, të marra këto në lidhje me të gjitha provat e tjera. Duke i hyrë problemit të rivlerësimit të provave në një kohë kur kërkuesi, ashtu siç pretendon edhe ai vetë, nuk ishte i përgatitur për të paraqitur argumentet e veta lidhur me këtë rivlerësim të tyre dhe kur edhe vetë jurisprudenca e asaj gjykate nuk e ka pranuar shqyrtimin e provave nga kolegjet, Gjykata e Lartë i ka vënë palët në pozita të pabarabarta në gjykim *(shih vendimin nr. 17, datë 30.04.2007, paragrafët 8 -9, të GJK-së).*

9. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, për shkak të mungesës së komunikimit të kërkesës për rishikim dhe shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Lidhur me kërkesat për rishikim, rifillimi i procesit gjyqësor nga e para, pas një periudhe të caktuar kohe nga marrja formë të prerë e vendimit, pa u dhënë mundësi të barabarta palëve për të shprehur e mbrojtur pretendimet e tyre, del haptazi jashtë kufijve të procesit të rregullt. Çdo provë e paraqitur nga pala, që pretendon se mund të çojë në rihapjen e procesit gjyqësor, duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit sipas parimit të kontradiktoritetit, duke i dhënë mundësi palës tjetër të shprehë pretendimet e saj, sepse ajo nuk mund të privohet arbitrarisht nga e drejta që i është njohur me vendim të formës së prerë të gjykatave.Në raste të tilla, standardi minimal që duhet t'i garantohet palës respektive është shansi i barabartë për të qenë e pranishme në një proces ku do të shqyrtohet pozita e saj juridike. Gjykata konstaton se nga ana e Gjykatës së Lartë është pranuar kërkesa për rishikim të vendimit, duke u vlerësuar si të reja provat e paraqitura dhe në kundërshtim me të gjitha standardet e procesit të rregullt ligjor, çështja është zgjidhur në dhomën e këshillimit *(shih vendimin nr. 17, datë 18.07.2005, paragrafët 3.6 -15, të GJK-së).*

IV.

B - PENALE

a) Për gjykatat e faktit

10. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, për shkak të mosrespektimit të rregullave procedurale për marrjen dhe vlerësimin e provave gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Durrës. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka risjellë në vëmendje thirrjen e dëshmitarëve në procesin penal, duke theksuar se refuzimi i kërkesës së mbrojtësit për thirrjen e tyre, me qëllim bërjen e pyetjeve për të kundërshtuar provën në procesin penal, cenon të drejtën e mbrojtjes të të akuzuarit, çka vjen ndesh me kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6, paragrafët 1 e 3, shkronja "d", të KEDNJ-së. Gjykata ka vlerësuar se në procesin penal të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Durrës nuk janë respektuar kërkesat e KPP-së (nenet 132 - 143) për njoftimin e dëshmitarit të kërkuar nga

mbrojtësi i të pandehurit. Gjykata e Apelit Durrës ka ngarkuar mbrojtësin e të pandehurit për njoftimin e dëshmitarit, ndërkohë që sipas nenit 132 të KPP-së, njoftimi i dëshmitarëve përbën një detyrim për gjykatën. Në rast se njoftimi do të rezultonte i pamundur, atëherë gjykata, në zbatim edhe të nenit 164 të KPP-së, duhet të kishte marrë të gjitha masat për shoqërimin e detyrueshëm të këtij dëshmitari. Nga sa më sipër, Gjykata ka vlerësuar se revokimi i thirrjes së dëshmitarit të kërkuar nga mbrojtësi, nuk është rezultat i vlerësimit për parëndësinë e këtij dëshmitari në procesin penal, por është pasojë e shkeljes së detyrimit të Gjykatës së Apelit Durrës për thirrjen e tij, në vështrim të neneve 132 dhe 164 të KPP-së. Në këtë vështrim, Gjykata arriti në konkluzionin se gjatë gjykimit të çështjes janë cenuar standardet e procesit të rregullt ligjor, parashikuar nga nenet 31/d dhe 42 të Kushtetutës, duke i mohuar kërkuesit mundësinë e arsyeshme për të paraqitur dhe ballafaquar pretendimet e tij për veprimet e kryera nga dëshmitari V.P., çka ka sjellë pamundësinë e tij për t'u mbrojtur ndaj akuzave të Prokurorit *(shih vendimin nr. 38, datë 30.12.2010, paragrafët 7-8, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

11. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi gjykatat nuk janë njohur dhe nuk kanë shqyrtuar katër shkresa të institucioneve të ndryshme shtetërore të klasifikuara "sekret" dhe "i kufizuar", sipas ligjit nr. 8457/1999. Gjykata e Lartë, ndërsa pranon të drejtën e palëve në gjykim për t'u njohur me aktet shkresore, provat dhe faktet që administrohen në proces, në mënyrë paradoksale ka vendosur për mospranimin e rekursit. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim. Gjykata thekson se e drejta e kërkuesit për akses dhe për t'u njohur me provat, mbi bazën e të cilave ai është vendosur në regjim të posaçëm në burg të sigurisë së lartë, është e lidhur ngushtësisht me ushtrimin e të drejtave të tij të mbrojtjes, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim. Gjykata vëren se pavarësisht se në ankimin e tij drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kërkuesi kishte ngritur pretendime jo vetëm për procedurat e nxjerrjes së urdhrit nr. 253/2020, por edhe për thelbin, gjykata nuk ka vlerësuar nëse të dhënat e akteve, mbi të cilat është bazuar ky urdhër, janë marrë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, nëse kërkuesi duhej të ishte njohur me këto akte me qëllim garantimin e së drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor në drejtim të kontradiktoritetit, si dhe nëse në nxjerrjen e tyre organet shtetërore kanë vepruar në përputhje me ligjin dhe jo në mënyrë abuzive ose arbitrare. Për pasojë, mungesa e shqyrtimit të elementeve substanciale të urdhrit nr. 253/2020 nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë nuk u konstatua dhe nuk u rregullua nga Gjykata e Posaçme e Apelit ose Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të kërkuesit për vlerësimin nga gjykatat të urdhrit të ministrit të Drejtësisë, me qëllim që, të paktën ato, të njiheshin me përmbajtjen e këtyre akteve *(shih vendimin nr. 5, datë 22.02.2022, paragrafët 48-50, të GJK-së).*

12. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar pa praninë e kërkuesit ose të mbrojtësit të tij. Rekursi i paraqitur nga prokurori nuk i është njoftuar, ndonëse ai ka qenë duke vuajtur dënimin në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale. Gjykata i ka vlerësuar si të bazuara pretendimet dhe ka konstatuar se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë nga prokuroria është dërguar në banesën e kërkuesit dhe dëftesa e komunikimit mban shënimin: "Ndodhet në burg jashtë shtetit". Kërkuesi ka qenë në "arrest në burg" prej datës 23.06.2010 në IEVP-në Kosovë-Lushnjë, ku edhe vazhdon të vuajë dënimin e caktuar, kur është ekzekutuar vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për caktimin e masës së sigurimit personal shtrëngues. Në vlerësimin e Gjykatës, rekursi i paraqitur nga prokurori nuk i është njoftuar kërkuesit, ndonëse ai ka qenë duke vuajtur dënimin në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale. Gjykata vlerësoi se në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, në kushtet kur rekursi ishte paraqitur nga prokurori, për Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë dilte e domosdoshme marrja e masave për të njoftuar kërkuesin, i cili ka qenë duke vuajtur dënimin në IEVP-në Kosovë-Lushnjë dhe jo jashtë shtetit, sikurse është shënimi në fletëthirrje, ose mbrojtësin e tij për të qenë të pranishëm gjatë zhvillimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë. Marrja e dijenisë nga kërkuesi dhe mbrojtësi i tij për rekursin e prokurorit ka qenë detyrim, sidomos në kushtet e një vendimi që ka përkeqësuar pozitën e kërkuesit *(shih vendimin nr. 35, datë 01.06.2015, paragrafët 15 -18, të GJK-së).*

C - ADMINISTRATIVE

a) Për gjykatat e faktit

13. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi akti i ekspertimit i përpiluar nga eksperti i licencuar dhe i paraqitur prej kërkuesit në gjykim nuk është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata është shprehur se Gjykata Administrative e Apelit, ndonëse e ngarkuar me ligj për të shqyrtuar çështjen në mënyrë të plotë nga pikëpamja e fakteve dhe e ligjit, nuk është ndalur në vlerësimin e pretendimit thelbësor të kërkuesit. Edhe pse kërkuesi nuk ka kërkuar shprehimisht thirrjen e ekspertit kontabël si dëshmitar të tij ose kryerjen e një ekspertimi kontabël nga vetë gjykata, kjo e fundit nuk ka vlerësuar nëse pretendimet e kërkuesit ishin të tilla që sillnin nevojën e dëgjimit edhe të një eksperti tjetër të specializuar, aq më tepër kur organi administrativ, KLGJ-ja, ishte asistuar në këtë proces nga një organ me ekspertizë të specializuar, siç është ILDKPKI-ja. Pavarësisht se Gjykata, siç ka arsyetuar më sipër, nuk gjeti shkelje kushtetuese të procesit të rregullt në procedurën e verifikimit të kryer nga KLGJ-ja, mënyra se si ka vepruar Gjykata Administrative e Apelit vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt, në drejtim të garantimit të barazisë së mjeteve të mbrojtjes. Këto dyshime bazohen në rrethanat konkrete të çështjes dhe lidhen në veçanti me faktin që kërkuesi ka qenë në pamundësi të kërkonte ose paraqiste ekspert në KLGJ, për sa kohë që relacioni i relatorit, i cili është akti i fundit që njoftohet përpara vendimit administrativ

të skualifikimit, edhe në kuptim të ligjit, nuk përmbante konkluzione për gjetjet për kriterin e pasurisë. Gjykata ka theksuar se në një gjykim të drejtë, individi mund ta ketë të vështirë të kundërshtojë raportin e një eksperti pa ndihmën e një eksperti tjetër në fushën përkatëse, pasi në të kundërt midis palëve krijohet pabarazi lidhur me mbledhjen dhe paraqitjen e provave në procesin gjyqësor. Për këtë arsye, dhe duke qenë përballë një pretendimi thelbësor të kërkuesit, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata Administrative e Apelit nuk duhej të shpërfillte faktin se kërkuesi pretendonte të kundërshtonte një raport teknik të hartuar nga një organ i specializuar – raporti i ILDKPKI-së, duke e parë këtë pretendim në aspektin e garantimit të aksesit të kërkuesit në procedimin administrativ dhe mundësisë së tij për të kërkuar marrjen e provave ose për të paraqitur të gjitha provat që ai i konsideronte të nevojshme për të mbështetur pretendimet e tij gjatë atij procesi *(shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021, paragrafët 70-72, të GJK-së).*

14. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si rezultat i mosrespektimit nga Gjykata e Apelit Shkodër të orarit të caktuar me shpallje për zhvillimin e seancës gjyqësore civile dhe zhvillimi i procesit gjyqësor pa praninë e tij, edhe pse kërkuesi ka qenë i pranishëm dhe në pritje në ambientet e gjykatës. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata është shprehur se Gjykata e Apelit Shkodër, duke e zhvilluar seancën gjyqësore në një orar të ndryshëm nga ai i njoftuar kërkuesit sipas listës së shpalljes, i ka cenuar këtij të fundit të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur. Gjykata çmon se thjesht dhe vetëm leximi nga Gjykata e Apelit Shkodër i përmbajtjes së ankimit dhe apelit kundërshtues të paraqitur nga kërkuesi nuk është i mjaftueshëm për ta konsideruar të përmbushur detyrimin që buron nga parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Gjykata rithekson se thjesht prania fizike e palëve gjatë procesit civil nuk është e mjaftueshme, sepse është gjyqtari që gjatë gjykimit duhet t'u japë mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se për sa kohë kërkuesi nuk ka qenë i pranishëm në seancën gjyqësore, për shkak të zhvillimit të saj në një orar të ndryshëm nga ai i njoftuar zyrtarisht me shpallje, pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është i bazuar *(shih vendimin nr. 37, datë 30.06.2016, paragrafët 13-14, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

15. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar kërkuesin për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit dhe për shtyrjen e tij. Kërkuesi është interesuar në ambientet e Gjykatës së Lartë, ku ajo bën shpalljen e gjykimeve, si dhe në faqen zyrtare të saj, por në asnjërën prej tyre nuk rezulton të jetë njoftuar data, ora e gjykimit dhe shtyrja e këtij gjykimi për një datë tjetër. Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim. Gjykata ka çmuar se mosshpallja nga Gjykata e Lartë e datës, orës dhe përbërjes së trupit gjykues në faqen e saj të internetit, sipas përcaktimit të nenit 482, pika 3, të KPC-së, nuk përbën shkelje të tillë, ku si pasojë kërkuesit i është cenuar e drejta substanciale e mbrojtjes, për të cilën ai nuk ka sjellë asnjë argument ose provë për të vërtetuar se në ç'mënyrë i është cenuar

ajo. Gjykata e Lartë, nëpërmjet shpalljes në ambientet e saj të datës, orës dhe përbërjes së trupit gjykues, sipas përcaktimit të nenit 61 të ligjit nr. 49/2012, e ka kryer detyrimin për garantimin e zhvillimit të një procesi të rregullt në respektim të elementeve të tij. Gjithashtu, kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument ose provë që të tregojë se ka qenë në pamundësi për t'u paraqitur në ambientet e asaj gjykate për të kontrolluar njoftimin për zhvillimin e gjykimit, duke u privuar nga e vetmja mundësi për t'u njoftuar për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit. Në këtë rast, Gjykata ka çmuar të ritheksojë përsëri qëndrimin e mbajtur edhe më parë prej saj, se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit *(shih vendimin nr. 13, datë 21.03.2023, paragrafi 24, të GJK-së).*

16. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi në një mosmarrëveshje administrative Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë mundësinë kërkuesve të dëgjohen në seancë gjyqësore lidhur me shkaqet e parashtruara prej tyre në rekurs, por e ka shqyrtuar rekursin në dhomën e këshillimit. Gjykata i ka vlerësuar këto pretendime si të pabazuara. Gjykata vlerëson se referuar parashikimeve të dispozitave procedurale të ligjit nr. 49/2012, që rregullojnë procedurën e gjykimit në Gjykatën e Lartë, pikat 1 dhe 2 të nenit 61 parashikojnë se shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, kurse neni 62 ka përcaktuar rastet kur gjykata vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, si dhe procedurën që ndiqet në një rast të tillë. Në vlerësimin e Gjykatës, e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, nuk nënkupton vetëm atë për t`u dëgjuar personalisht para gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse. Për rrjedhojë, në kushtet kur Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale për shqyrtimin e rekursit dhe njoftimin e palëve, vetëm fakti që ky gjykim është zhvilluar në dhomën e këshillimit nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese dhe nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt *(shih vendimin nr. 28, datë 01.11.2022, paragrafi 69, të GJK-së).*

17. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi kërkuesi nuk ka marrë dijeni për rekursin e paraqitur dhe të shqyrtuar nga Gjykata e Lartë. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e subjektit të interesuar, Bashkisë së Tiranës, të datës 27.07.2012. Sipas dëftesës së komunikimit të rekursit të datës 05.12.2012 nuk rezulton që ai t`i jetë njoftuar kërkueses, por është marrë në dorëzim nga një shtetas tjetër (A.K.) dhe nuk ka asnjë shënim për sa i takon lidhjes së tij me kërkuesen. Gjykata ka vlerësuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke vendosur vetëm mbi bazën e pretendimeve të subjektit të interesuar të parashtruara në rekurs dhe duke mos i dhënë mundësinë kërkueses që të paraqiste pretendimet e saja në lidhje me çështjen, e ka vendosur atë në një pozitë të pabarabartë në raport me palën tjetër. Duke mos marrë masat për t`i garantuar kërkueses të drejtën për t`u dëgjuar dhe për t`u

mbrojtur nëpërmjet dhënies së mundësisë së paraqitjes së prapësimeve të saj, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtim të respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim *(shih vendimin nr.29, datë 19.05.2016, paragrafët 16-18, të GJK-së).*

18. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi Kolegji Administrativ nuk ka marrë masa për njoftimin efektiv individual të kërkueses si palë private, ndërkohë që Avokatura e Shtetit, palë publike dhe me përfaqësi të përhershme pranë Gjykatës së Lartë, ka pasur mundësi të marrë dijeni për zhvillimin e procesit gjyqësor. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen civile në dhomë këshillimi, në datën 30.06.2011 ka vendosur kalimin për gjykim të rekursit të paraqitur nga pala e paditur, DRSHTRR-ja. Çështja është gjykuar në seancë plenare publike në datën 25.02.2014 nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore konstatohet se kërkuesja nuk është paraqitur, por "ka dijeni me anë të shpalljes dhe shkak për mosparaqitje nuk ka", kurse dy subjektet e interesuara kanë qenë të përfaqësuara nga Avokatura e Shtetit, përfaqësuesi i së cilës ka lexuar dhe ka dorëzuar parashtresën me shkrim, që është administruar në dosjen gjyqësore. Në përfundim të procesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të Gjykatës së Shkallës së Parë. Gjykata çmon se jo vetëm për shkak të periudhës së gjatë kohore nga marrja dijeni për depozitimin e rekursit në zhvillimin e seancës publike (2009-2014), por veçanërisht duke marrë parasysh faktin se rekursi është marrë në shqyrtim sipas një kuadri të ndryshëm ligjor procedural, ka arsye për të arritur në përfundimin se Kolegji Administrativ nuk ka marrë masat e nevojshme për t`i garantuar kërkueses të drejtën për t`u dëgjuar dhe për t`u mbrojtur nëpërmjet dhënies së mundësisë së paraqitjes së prapësimeve të saj, duke mos respektuar për rrjedhojë të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtim të respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim. Në përfundim, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke vendosur vetëm mbi bazën e pretendimeve të parashtruara në rekurs nga subjekti i interesuar, DRSHTRR-ja, pa i dhënë mundësi konkrete efektive kërkueses që të paraqiste pretendimet e saja në lidhje me çështjen, e ka vendosur atë në një pozitë të pabarabartë në raport me palën tjetër *(shih vendimin nr. 49, datë 22.07.2016, paragrafët 27 – 28, të GJK-së).*

19. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi Gjykata e Lartë u ka cenuar të drejtën e pronës pa një proces të rregullt ligjor, pasi nuk ka bërë kalimin procedural sipas nenit 199 të KPC-së, edhe pse ishte në dijeni të faktit që paditësi kishte ndërruar jetë. Gjykata ka vlerësuar se nisur nga kompetencat që ka Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në shqyrtimin e çështjes edhe në dhomë këshillimi, si dhe bazuar në vendimmarrjen e tij në rastin objekt shqyrtimi (rrëzimin e kërkesëpadisë të trashëgimlënësit të kërkuesve), ky Kolegj, duke mos respektuar detyrimet që burojnë nga neni 199 i KPC-së për kalimin procedural, ka cenuar të drejtën e kërkuesve për të marrë pjesë në gjykim dhe si pasojë ka cenuar edhe parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve *(shih vendimin nr. 34, datë 29.05.2015, paragrafi 22, të GJK-së).*

5. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore

Neni 142, pikat 1 dhe 3, i Kushtetutës:

1. Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.
3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë *(shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2023, paragrafi 33; nr. 3, datë 20.01.2017, paragrafi 33; nr. 38, datë 30.12.2010, paragrafi 2.2, të GJK-së).*

IV.

2. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë *(shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023, paragrafi 52; nr. 12, datë 19.03.2015, paragrafi 29; nr. 33, datë 08.12.2005, paragrafi 8, të GJK-së).*

3. Vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023, paragrafi 29; nr. 21, datë 16.04.2015, paragrafi 28; nr. 37, datë 19.09.2011, paragrafi 20 të GJK-së).

4. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë

gjyqësore. Kjo është edhe përgjigjja që u jep Gjykata e Lartë pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët *(shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021, paragrafi 32; nr. 59, datë 23.07.2015, paragrafi 28; nr. 52, datë 14.11.2014, paragrafi 23, të GJK)*

b. Precedentët ku çështja e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është vënë në diskutim

- ***Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike***

A – CIVILE

a) Për Gjykatën e Lartë

5. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me parimin e sigurisë juridike, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke trajtuar si prova të reja ato të shqyrtuara në gjykimin e mëparshëm, ka vendosur prishjen e vendimit të formës së prerë pas 15 vjetësh. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Sipas Gjykatës, analiza e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në drejtim të rastit të pranuar të rishikimit në raport me dispozitivin, me të cilin disponohet prishja e vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë dhe rigjykimi i çështjes, krijon alogjizëm në vendimin objekt kundërshtimi. Pjesa arsyetuese dhe dispozitivi i këtij vendimi nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda tij, çka bën që ky vendim të mos ketë një harmoni të brendshme. Për të arritur në këtë konkluzion, Gjykata vëren se në vendimin e tij Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i është referuar nenit 485/c të KPC-së, që përcakton mënyrën e vendimmarrjes pas shqyrtimit të rekursit, situatë ligjore kjo e ndryshme nga ajo e procedurës së shqyrtimit të kërkesës për rishikim, duke mos iu referuar kështu dispozitave konkrete (nenit 498 të KPC-së) që rregullojnë në mënyrë të posaçme këtë procedurë të veçantë. Edhe në arsyetimin e vendimit, në funksion të analizës së ndryshimeve ligjore të KPC-së me ligjin nr. 44/2021, në raport me përbërjen e trupit gjykues, procedurën e gjykimit dhe vendimmarrjen, ky kolegj i referohet shqyrtimit të rekursit dhe vendimmarrjes sipas nenit 485 të KPC-së, përmbajtjes së tij aktualisht në fuqi. Në vlerësimin e Gjykatës, arsyetimi i mësipërm krijon paqartësi në drejtim të disponimit për prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë dhe kthimin asaj të çështjes për rigjykim në themel, kur rasti i pranuar i rishikimit lidhet me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë dhe vendimin e saj, duke mos ndikuar kështu procesin dhe vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Korçë. Për më tepër, ky rast rishikimi nuk përmban as nevojën për saktësimin e fakteve të reja nga kjo gjykatë në kuadër të rigjykimit të urdhëruar. Fakti që kërkuesit e rishikimit, krahas rastit të pranuar, kanë ngritur pretendime për ekzistencën edhe të rasteve të tjera për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, raste të cilat lidhen me fakte dhe rrethana të çështjes, nuk do të thotë që kërkesa për rishikim është pranuar edhe në lidhje me to, për sa kohë Kolegji Civil, pavarësisht se i ka pasqyruar në vendim si pretendime të kërkuesve të rishikimit, nuk i ka shqyrtuar dhe as është shprehur për to. Gjykata vlerëson se arsyetimi i Kolegjit

Civil të Gjykatës së Lartë në rastin konkret është i pamjaftueshëm dhe i paqartë dhe nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. *(shih vendimin nr. 11, datë 10.03.2023, paragrafët 44-46, të GJK-së).*

6. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me parimin e sigurisë juridike, pasi Gjykata e Lartë në vendimin objekt kërkese nuk ka marrë parasysh një vendim gjyqësor të formës së prerë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të vitit 2011, që i ka njohur kërkuesit përfundimisht të drejtën e pronës mbi pasurinë objekt konflikti gjyqësor. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë në vendimin objekt kundërshtimi ka trajtuar parimin e sigurisë juridike vetëm në drejtim të pretendimeve të ngritura në rekurs nga subjekti i interesuar, për shkak se vendimi i rekursuar i Gjykatës së Apelit Vlorë është marrë në kundërshtim me vendimin nr. 28, datë 30.05.2002 të Kolegjeve të Bashkuara. Ndërkohë rezulton se ky parim nuk është analizuar nga Gjykata e Lartë për sa u përket të drejtave të kërkuesit të fituara me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Në këtë vështrim, Gjykata arrin në konkluzionin se cenimi i parimit të sigurisë juridike nga ana e Gjykatës së Lartë ka ardhur edhe si rezultat i një arsyetimi i cili nuk përputhet me faktet e mosmarrëveshjes. Konkretisht, pas arsyetimit të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara, Gjykata vëren se Kolegji Civil nuk ndalet në vlerën dhe analizën e vendimit nr. 00-2011-1188 (271), datë 24.05.2011, i cili është një vendim përfundimtar dhe i formës së prerë i Gjykatës së Lartë, por mjaftohet vetëm me faktin se çështjet e trajtuara nga Kolegjet e Bashkuara janë të detyrueshme për t'u zbatuar në çdo proces tjetër, duke mos arsyetuar mbi faktin se tashmë kërkuesi ndodhet në kushte të ndryshme nga ato të përmendura në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara. Kolegji Civil ka anashkaluar mënyrën e fitimit të pronësisë sipas vendimit të Kolegjit Civil të vitit 2011, duke lënë në fuqi një vendim i cili shprehet për një objekt që nuk ekziston. Në pronësi të kërkuesit nuk është i regjistruar objekti "kinkaleri", por një objekt 3-katësh, pronësinë e të cilit kërkuesi e ka fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykata pranon që kompetenca e saj është e kufizuar për të interpretuar / vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve në lidhje me të drejtën e pronës së kërkuesit, pasi kjo është kompetencë e Gjykatës së Lartë. Por kur është rasti që individi (kërkuesi) ka fituar pronësinë me vendim të formës së prerë, i cili aktualisht është në fuqi dhe për të cilin krijohet pritshmëri e ligjshme për pronën në rastin kur vendimi nuk është shfuqizuar, Gjykata ka për detyrë të garantojë zbatimin e standardeve të fuqisë së vendimeve të formës së prerë në aspektin e sigurisë juridike. Për më tepër, në lidhje me cenimin e sigurisë juridike, të krijuar nga vendimet e ndryshme të gjykatave, Gjykata konstaton se edhe institucionet e administratës shtetërore, nëpërmjet sjelljes së tyre, duke pasur parasysh edhe periudhën e gjatë të këtij konflikti, kanë krijuar pritshmëri te subjektet e përfshira, duke e rënduar situatën e pasigurisë juridike *(shih vendimin nr. 22, datë 29.09.2022, paragrafët 51-52, të GJK-së).*

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me parimin e sigurisë juridike, pasi mosmarrëveshja mes palëve është zgjidhur me vendimin nr. 1319, datë 21.11.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për të cilin Gjykata e Lartë nuk shprehet në vendim. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar

këtë pretendim. Gjykata çmon se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk përbën res judicata për mosmarrëveshjen juridiko-administrative të krijuar mes palëve, për rrjedhojë fakti që Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e ka përmendur, nuk përbën mangësi thelbësore në arsyetimin e vendimit. Vendimi i kundërshtuar nga kërkuesi rezulton të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje, duke përmbushur standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhura me parimin e sigurisë juridike *(shih vendimin nr. 28 datë 01.11.2022, paragrafi 50, të GJK-së).*

B - PENALE

a) Për Gjykatën e Lartë

8. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me parimin e sigurisë juridike, pasi Gjykata e Lartë, duke mos pranuar rekursin si të paraqitur nga një avokat pa tagra, ka gabuar në arsyetimin e saj. Sipas kërkuesit, mbrojtësi i tij e kishte tagrin për të bërë rekurs, që buronte nga akti i përfaqësimit. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Edhe pse Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë duhet të jetë më e kujdesshme, veçanërisht në verifikimin e akteve të përfaqësimit si elemente formale që duhet të plotësohen në paraqitjen e rekursit, ajo, në dhomë këshillimi, ka ushtruar në këtë rast funksionin e saj seleksionues, duke vlerësuar paraprakisht nëse kërkesa i plotësonte kërkesat e ligjit për kalimin në seancë. Edhe pse me një arsyetim të kufizuar, ajo ka parashtruar shkaqet e rekursit dhe i ka vlerësuar ato në përputhje me standardet e mësipërme të arsyetimit në dhomën e këshillimit, duke i dhënë kërkuesit edhe mundësinë e realizimit të aksesit në aspektin formal dhe mbrojtjes efektive, njësoj sikur ajo të ishte bërë nga një avokat. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk cenon standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit *(shih vendimin nr. 14, datë 21.06.2022, paragrafët 38 -39, të GJK-së).*

9. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me parimin e sigurisë juridike, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin kushtetues të zbatimit të ligjit penal favorizues, duke zbatuar një ligj që nuk ishte në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes para atij Kolegji. Ky qëndrim i Kolegjit Penal i ka cenuar edhe sigurinë juridike. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh se dispozita ligjore penale që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale ka ndryshuar gjatë kohës së gjykimit të çështjes nga ai kolegj. Pavarësisht se kërkuesi nuk e ka paraqitur këtë pretendim para Gjykatës së Lartë, pasi rekursi është bërë në datën 06.05.2015, pra para ndryshimit të ligjit, i takonte Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të zbatonte ligjin penal të ri, nisur edhe nga fakti se masa e dënimit që parashikonte ishte në favor të të gjykuarit për sa i takon veprës penale të mbajtjes së armëve luftarake pa leje. Në këtë rast, Kolegji Penal duhej të kishte marrë parasysh ndryshimin favorizues të masës së dënimit për

këtë vepër penale në zbatim të një parimi të rëndësishëm kushtetues, siç është siguria juridike. Në këto kushte, ai kolegj, me vendimin e tij, ka cenuar procesin e rregullt ligjor ndaj kërkuesit. Duke marrë parasysh rrethanat më lart, Gjykata konstaton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet ta kishte marrë në konsideratë efektin prapaveprues të ligjit penal favorizues, si një nga elementet themelore të procesit penal të garantuar shprehimisht në nenin 29/3 të Kushtetutës. Në këto kushte, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke mënjanuar respektimin e këtij standardi kushtetues, ka cenuar njëkohësisht edhe parimin e sigurisë juridike *(shih vendimin nr. 61, datë 31.07.2017, paragrafi 13 dhe paragrafi 15, të GJK-së).*

C - ADMINISTRATIVE

a) Për gjykatat e faktit

10. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me parimin e sigurisë juridike, pasi Gjykata Administrative e Apelit në përmbajtjen e vendimit nuk ka pasqyruar pretendimet shtesë të parashtruara nga kërkuesja për hyrjen në fuqi të vendimit nr. 33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese, të depozituara në sekretarinë gjyqësore në datën 27.02.2016. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim dhe ka konstatuar se Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë. Gjykata vëren se edhe pse vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është dhënë pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese, ajo, në vendimin e saj, nuk është shprehur për këtë vendim, edhe pse bazuar në nenin 76 të ligjit nr. 8577/2000 vendimi i Gjykatës ka fuqi prapavepruese, ndër të tjera, ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë. Për sa më lart, Gjykata çmon se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka arritur të përmbushë kërkesat për t`u konsideruar i arsyetuar, në kuptim të standardeve kushtetuese dhe në respektim të kërkesave të dispozitave përkatëse procedurale. Gjykata Administrative e Apelit edhe pse formalisht e ka justifikuar vendosjen e masës së gjobës, duke argumentuar se në rastin konkret do të aplikohej ligji në fuqi në kohën e kryerjes së kontrollit, arsyetimi i saj nuk është i qartë, logjik dhe në analizë të plotë të të gjitha rrethanave faktike e ligjore. Ajo nuk e ka argumentuar qëndrimin e saj se pse duhej të vazhdonte të zbatohej neni 119 i ligjit nr. 9920/2008 edhe pas shfuqizimit të tij nga Gjykata, si dhe pas hyrjes në fuqi të dispozitave të reja ligjore. Gjithashtu, ajo nuk ka analizuar të gjitha pretendimet e parashtruara nga palët, çka e bën vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit me të meta të tilla që nuk çojnë në arritjen e një përfundimi logjik nga ana e saj. Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete zbatimi nga Gjykata Administrative e Apelit i dispozitave të një ligji të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, si dhe moszbatimi i dispozitave të reja ligjore në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes, dëshmon se gjykata nuk ka ushtruar kontroll efektiv për ndërhyrjen që administrata tatimore ka bërë tek e drejta e pronës së

kërkueses, e, për rrjedhojë, ka cenuar parimin e sigurisë juridike *(shih vendimin nr. 18, datë 30.03.2021, paragrafët 46-47, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

11. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me parimin e sigurisë juridike, pasi sipas kërkuesit gjykatat kanë gabuar si në kuptimin e kërkesës, ashtu edhe në arsyetimin e rrëzimit të saj, duke e interpretuar në kundërshtim me ligjin objektin e padisë si "kërkesë për të nxjerrë një urdhër të dytë lirimi". Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk rezulton të jetë alogjik ose të ketë kundërthënie dhe pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv, duke plotësuar kështu kërkesat kushtetuese që kërkon standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor. E drejta e kërkueses për pagesë kalimtare ka qenë objekt i gjykimit të parë që zgjidhi mosmarrëveshjen gjyqësore për urdhrin e lirimit. Në atë gjykim, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit anuluan urdhrin e lirimit, por rrëzuan kërkimet për pagesën kalimtare dhe trajtimin suplementar të kërkueses, ndërsa ajo nuk paraqiti rekurs për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Gjithashtu, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë në gjykimin e parë, duke lënë në fuqi vendimin për anulimin e urdhrit të lirimit, ka pranuar se ndërprerja e marrëdhënieve të punës së kërkueses me Policinë e Shtetit ishte e paligjshme, duke arsyetuar se, si pasojë, kërkueses i lindnin të drejtat e dëmshpërblimit financiar dhe të rikthimit në detyrë. Kjo e drejtë e fundit nuk u rivendos për kërkuesen, për shkak se ajo nuk kishte paraqitur rekurs ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Në këtë mënyrë, marrëdhënia e saj e punësimit nuk u rivendos as *de jure* dhe as *de facto*, që më pas të ndërpritej me shkak të ligjshëm me urdhër lirimi nga detyra, siç pretendon kërkuesja, që të siguronte më pas përfitimet financiare të njohura nga ligji. Në këto rrethana, interpretimi i fakteve dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për nxjerrjen e përfundimit se kërkimi për të drejtën e pagesës kalimtare ishte gjë e gjykuar, nuk rezulton të ketë qenë i padrejtë dhe të ketë ndikuar në të drejtën kushtetuese të kërkueses për të pasur një proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit *(shih vendimin nr. 34, datë 12.06.2023, paragrafi 79, të GJK-së).*

12. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me parimin e sigurisë juridike, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë përllogaritur masën e pensionit të pleqërisë mbi bazën e një page referuese të ndryshme nga ajo e përcaktuar me vendimin gjyqësor përfundimtar të vitit 2008, ndaj paga referuese përbënte të drejtë të fituar. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se vendimi gjyqësor përfundimtar i vitit 2008 nuk përbën "gjë të gjykuar" për pensionin e pleqërisë dhe pensionin suplementar të pleqërisë së kërkuesit, pasi ai ka vendosur për një mosmarrëveshje tjetër gjyqësore, me objekt "të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi" dhe shkak ligjor "veprimet e parregullta të DRSSH-së, Tiranë në llogaritjen e tij sipas ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar". Me fjalë të tjera, "paga referuese", që është përcaktuar në zbatim të këtij vendimi gjyqësor përfundimtar,

është element i skemës së llogaritjes së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas ligjit nr. 8087/1996, i zbatueshëm në kohën e lindjes së kësaj të drejte. Nga ana tjetër, kjo "pagë referuese" nuk është element i skemës ligjore të llogaritjes së pensionit të pleqërisë sipas ligjit nr. 7703/1993. Po kështu, kjo "pagë referuese" nuk është e njëjtë as me përcaktimin e saj dhe skemën ligjore të llogaritjes së pensionit suplementar të pleqërisë sipas ligjit nr. 10142/2009, për më tepër kur, sipas këtij ligji, ky pension suplementar nuk mund të jetë më shumë se 50% e pensionit të pleqërisë që përfituesi gëzon në çastin e lindjes të së drejtës për pension suplementar *(shih vendimin nr. 10, datë 07.03.2023, paragrafi 37, të GJK-së).*

13. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me parimin e sigurisë juridike, pasi gjykatat e zakonshme nuk e kanë marrë parasysh as vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, as vendimin nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin është interpretuar neni 29 i ligjit nr. 10142/2009. Pretendimi në lidhje me cenimin e parimit të sigurisë juridike është ngritur nga kërkuesi edhe në Gjykatën e Lartë, e cila ka vlerësuar se shkaqet e paraqitura në rekurs nuk janë nga ato që parashikohen në nenin 58 të ligjit nr. 49/2002. Gjykata i ka vlerësuar këto pretendime si të bazuara. Gjykata ka theksuar se parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar, është një element themelor i gjykimit të drejtë, që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykata, vendimi i saj nuk vihet më në diskutim. Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë duhej t'i jepte përgjigje këtij pretendimi të kërkuesit, duke i argumentuar atij në këndvështrim të sigurisë juridike dhe të drejtave të fituara, nëse vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit kanë qenë apo jo në përputhje me standardet kushtetuese "të sigurisë juridike" dhe "të arsyetimit gjyqësor". Kjo qasje e Gjykatës së Lartë do të ndihmonte eventualisht edhe një kontroll subsidiar efektiv të Gjykatës për vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë *(shih vendimin nr. 11, datë 16.04.2018, paragrafët 26-28, të GJK-së).*

IV.

- ***Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit substancial***

A – CIVILE

a) Për gjykatat e faktit

14. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi gjykata ka keqinterpretuar nenin 450/ç të KPC-së, duke ngatërruar konceptin e legjitimitetit me përfaqësimin në gjykatë. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka konstatuar se ankimi i depozituar pranë Gjykatës së Apelit nga ana e kërkuesit është

nënshkruar nga avokati i papajisur me prokurë. Referuar procesverbaleve gjyqësore, Gjykata vëren se pavarësisht kësaj të mete nga ana procedurale, Gjykata e Apelit ka zhvilluar gjykimin, duke legjitimuar dhe dëgjuar palët në lidhje me pretendimet e tyre, madje duke administruar edhe pretendimet përfundimtare, të cilat janë paraqitur me shkrim në seancë gjyqësore, gjë që vërtetohet në procesverbalin gjyqësor të kësaj date. Për më tepër, siç rezulton nga procesverbali, gjykimi është shtyrë për t'i dhënë mundësi avokatit për t'u njohur me materialet e dosjes. Gjykata vëren se, edhe pse Gjykata e Apelit ka orientuar procesin në drejtim të shqyrtimit gjyqësor substantiv të çështjes, duke u dhënë mundësi palëve të realizojnë mbrojtjen e tyre në respekt të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit, vendimmarrjen e saj e ka bazuar në moslegjitimimin e kërkuesit, duke u kufizuar në vlerësimin nga ana formale të ankimit dhe pa shqyrtuar çështjen në themel. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit duhej të arsyetonte në mënyrë ezauruese mospranimin e ankimit, duke shpjeguar nëse ky i fundit është bërë nga një person që nuk legjitimohej, apo nuk është bërë në formën e kërkuar nga ligji për shkak të mungesës së nënshkrimit nga vetë pala apo avokati i papajisur me prokurë. Në këtë kuptim, referuar paragrafit "b" të nenit 455 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata e Apelit ka pasur detyrimin ligjor për të njoftuar palën që të ndreqte të metat brenda 5 ditëve, dhe vetëm në rast të mosplotësimit të këtij detyrimi mund të kthente ankimin në bazë të kësaj dispozite. Gjykata konstaton se kjo kërkesë ligjore, e cila garanton realisht të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Apelit, nuk është përmbushur. Gjykata çmon se Gjykata e Apelit ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt në vendimmarrje, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën e kërkuesit për akses efektiv përpara gjykatës, rrjedhojë vendimi duhet të shfuqizohet. Gjykata ka arritur në përfundimin se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë, nuk mund t'i cenohen kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore *(shih vendimin nr. 55, datë 23.12.2013, paragrafët 12 -14, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

15. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi Gjykata e Lartë kishte cituar faktet dhe ligjin e aplikueshëm, por nuk kishte bërë një interpretim ligjor të konfliktit, objekt gjykimi, në raport me faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm dhe nuk u kishte dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të palëve. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata, bazuar në qëndrimin e konsoliduar të jurisprudencës kushtetuese në standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve, çmon se Gjykata e Lartë, edhe pse në arsyetim është shprehur se i është referuar tërësisë së normave që përmban ligji nr. 10428/2011, nuk i ka vlerësuar pretendimet e mësipërme të ngritura nga kërkuesja në shkaqet e rekursit, edhe pse ato kishin rëndësi në përcaktimin e juridiksionit. Konkretisht, ajo nuk ka analizuar nëse veprimet e palëve gjatë gjykimit përmbushin ose jo kriteret e parashikuara në nenin 73, pika 3, të ligjit nr. 10428/2011 ose nëse në çështjen konkrete gjykatat shqiptare kanë juridiksion ekskluziv, sipas nenit 72, shkronja "dh", të ligjit nr. 10428/2011. Gjykata konstaton se këto pretendime të kërkueses,

të cilat kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes së juridiksionit, nuk kanë gjetur përgjigje të arsyetuar në vendimin e Gjykatës së Lartë. Kjo e fundit duhet t'u jepte përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkueses, në funksion të pasjes së një vendimi gjyqësor të qartë dhe të plotë, në përputhje me kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i plotëson standardet e një vendimi të arsyetuar, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Gjithashtu, duke pasur parasysh lidhjen e ngushtë midis standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit në gjykatë, Gjykata vlerëson se standardi i arsyetimit i zbatuar në këtë rast nga Gjykata e Lartë sjell ndikim në të drejtën e aksesit të kërkueses *(shih vendimin nr. 23, datë 29.04.2021, paragrafët 27 -28, të GJK-së).*

16. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi administrata gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë e ka dërguar me vonesë ankimin e kërkuesve në lidhje me vendimin e themelit të çështjes dhe ai nuk i është bashkëlidhur dosjes gjyqësore dhe, për rrjedhojë, nuk është marrë në shqyrtim nga gjykata e apelit. Fakti i lartpërmendur është parashtruar nga kërkuesit edhe në shkaqet e rekursit të paraqitur në Gjykatën e Lartë, por kjo e fundit ka vendosur mospranimin e tij me arsyetimin se është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të KPC-së dhe se gjykatat më të ulëta e kanë respektuar ligjin material dhe procedural duke e interpretuar drejt atë. Në këtë rast, Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar pretendimin. Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, duke mos u shprehur në lidhje me këtë pretendim të kërkuesve, nuk u ka dhënë atyre përgjigje përfundimtare dhe të arsyetuar për shkaqet e ngritura në rekurs, edhe pse ato lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me garantimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar pretendimin e kërkuesit për cenimin e aksesit, me argumentin se janë pikërisht mangësitë ose gabimet e administratës gjyqësore që kanë shkaktuar mosshqyrtimin në gjykatën e apelit të ankimit ndaj vendimit të shkallës së parë të paraqitur nga kërkuesit. Edhe Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj subsidiar, nuk e ka riparuar situatën, edhe pse gjendej përpara një pretendimi me natyrë kushtetuese *(shih vendimin nr. 31, datë 03.11.2022, paragrafët 34 -37, të GJK-së).*

IV.

➢ *Kërkesa për rishikim*

17. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi edhe pse kërkesa për rishikim ishte përpiluar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit, si nga ana formale, ashtu edhe në përmbajtje, Gjykata e Lartë nuk e mori atë në shqyrtim në seancë gjyqësore. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se sipas vendimit unifikues, rrethana ose prova e zbuluar duhet të plotësojë këto kushte: a) të ketë rëndësi esenciale për zgjidhjen e çështjes të tillë që sikur gjykata të kishte qenë në dijeni të saj vendimi që do të jepte do të ishte i ndryshëm nga ai që ka dhënë; b) të jetë zbuluar rishtazi, të mos ketë qenë, as që mund të ishte në dijeni të kërkuesit në kohën e dhënies së vendimit nga ana e gjykatës; c) të jetë një rrethanë në lidhje me një fakt që nuk është

pranuar nga ana e gjykatës. Gjykata ka trajtuar edhe më parë në jurisprudencën e saj rastin kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar në dhomën e këshillimit një kërkesë për rishikim, duke u ndalur vetëm në analizën e përmbushjes së kushtit që provat e reja "të mos kenë qenë e as mund të ishin në dijeni të kërkuesit". Nisur nga roli i Gjykatës së Lartë që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, Gjykata çmon se në çështje të kësaj natyre, në drejtim të respektimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, por edhe të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, përmbushja e kritereve që duhet të plotësojë prova e re në kërkesën për rishikim, të përcaktuara nga vendimi unifikues, duhet të shqyrtohet në seancë dëgjimore, pra në seancë gjyqësore. Gjykata thekson se shqyrtimi i kërkesës për rishikim në seancë gjyqësore, pasi është verifikuar paraqitja e saj sipas kritereve ligjore në dhomën e këshillimit, ka të bëjë me analizimin në thelb të shkaqeve të rishikimit. Ky vlerësim i përket seancës gjyqësore edhe për faktin se vetëm gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, palët kanë mundësi të realizojnë të drejtën e tyre për t'u dëgjuar, si dhe parimin e kontradiktoritetit, si elemente përbërëse të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Gjykata e Lartë nuk duhet të mjaftohet me një trajtim formal të çështjes, por duhet që pavarësisht situatës juridike të marrë të gjitha masat që e drejta e aksesit të garantohet efektivisht. Në këtë kuptim, Gjykata e Lartë në rastin në shqyrtim ishte e detyruar ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore *(shih vendimin nr. 52, datë 24.07.2017, paragrafët 27-28, të GJK-së).*

18. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, përmban në pjesën e tij hyrëse palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatave më të ulëta, ndërkohë që mungojnë shkaqet në bazë të të cilave kërkuesja ka pretenduar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Gjykatës së Apelit Durrës. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Nga përmbajtja e vendimit të Kolegjit Civil konstatohet se në pjesën arsyetuese ai pasqyron vetëm përfundimin se rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së, duke vendosur, në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij. Në të tilla raste, Gjykata ka arsyetuar se nga leximi në tërësi i vendimit, rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Ato nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që përmbajtja dhe arsyetimi i tij të mos kenë një harmoni të brendshme. Për rrjedhojë, mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nga jurisprudenca kushtetuese vlerësohet se përbën një të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës. Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) përbën një të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës, duke krijuar dyshime edhe për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkueses (*shih vendimin nr. 2, datë 26.01.2015, paragrafët 16 -18, të GJK-së).*

19. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi edhe pse kërkesa për rishikim ishte përpiluar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit, si nga ana formale ashtu edhe në përmbajtje, dhe ajo plotësonte të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga neni 494/a i KPC-së, Gjykata e Lartë nuk e ka marrë atë në shqyrtim. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar pretendimin. Në këtë rast, Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se arsyetimi i bërë nga Gjykata e Lartë, duke i dhënë një kuptim të ngushtë përmbajtjes së neneve 445 dhe 496 të KPC-së, përveçse ka cenuar të drejtën e kërkuesve për akses në gjykatë, nuk ka respektuar as kërkesën për dhënien e një vendimi të arsyetuar për shkaqet e ngritura në kërkesën për rishikim. Gjykata ka arritur në këtë përfundim duke vlerësuar se përmbajtja e nenit 445 të KPC-së mund të lexohet vetëm duke e harmonizuar me përmbajtjen e nenit 496 të KPC-së, pasi një interpretim dhe zbatim i ndryshëm i kësaj dispozite (stricto sensu) cenon thelbin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës. Edhe në çështjen konkrete, neni 445 i KPC-së duhej interpretuar nga Gjykata e Lartë jo në mënyrë të shkëputur, por duke e parë atë në lidhje me nenin 496 të KPC-së që parashikon afatet e posaçme për paraqitjen e kërkesës për rishikim. Gjykata ka theksuar se në rastet e paraqitjes së kërkesës për rishikimin e një vendimi të formës së prerë, neni 445 i KPC-së duhet të zbatohet në harmoni me nenin 496 të Kodit, për sa i përket afatit prekluziv njëvjeçar. Për sa u përket afateve për paraqitjen e kërkesës për rishikim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vlerësuar se pavarësisht nga shkaku i rishikimit, fillimi i afatit 30-ditor nga dita e marrjes dijeni për të, si dhe i afatit njëvjeçar nga dita që ka lindur shkaku i rishikimit, është i njëjtë për të gjitha rastet që përbëjnë shkak rishikimi të një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Këto afate, duke qenë afate prekluzive (dekadence), nuk mund të pezullohen, të ndërpriten apo të rivendosen. Gjykata vlerëson se përmbajtja e nenit 445 të KPC-së mund të lexohet vetëm duke e harmonizuar me përmbajtjen e nenit 496 të KPC-së, pasi një interpretim dhe zbatim i ndryshëm i kësaj dispozite (stricto sensu) cenon thelbin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës. Edhe në çështjen konkrete, neni 445 i KPC-së duhej interpretuar nga Gjykata e Lartë jo në mënyrë të shkëputur, por duke e parë atë në lidhje me nenin 496 të KPC-së që parashikon afatet e posaçme për paraqitjen e kërkesës për rishikim *(shih vendimin nr. 17, datë 24.03.2014, paragrafët 21- 26, të GJK-së).*

20. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit çështja në shqyrtim ka për objekt vetëm konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik, nuk është i bazuar në të dhënat që përmban kërkesëpadia, pasi, sipas kërkueses, kërkimi i saj nuk është vetëm pavlefshmëria e kontratës së shitblerjes, por edhe kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme. Në këtë mënyrë, vendimi i Gjykatës së Lartë bie ndesh me parimet e sanksionuara në nenet 299 dhe 6, 16, 20, 28, 29, 32 të KPC-së. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se kërkuesja nuk ka marrë një përgjigje përfundimtare në lidhje me pretendimet e saj, sepse Gjykata e Lartë ka vendosur pushimin e gjykimit me arsyetimin se objekti i padisë është kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik, i cili nuk mund të bëhet si kërkim i mëvetësuar. Si rrjedhojë, Gjykata çmon se në rastin konkret paraqet rëndësi mënyra e përcaktimit apo vlerësimit të objektit të çështjes nga Gjykata e

Lartë. Gjykata ka vlerësuar se përbën cenim të parimit të aksesit edhe rasti kur vendimi i Kolegjit Civil bie ndesh me qëndrimin e një vendimi unifikues. Gjykata vëren se kërkimi përfundimtar i kërkueses dhe i përfaqësuesit të saj është pavlefshmëria e kontratës së shitjes dhe kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme. Në këto kushte, Gjykata çmon se përfundimi i Gjykatës së Lartë se pretendimi i kërkueses për pavlefshmërinë absolute të kontratës nuk është shoqëruar me zgjidhjen e pasojave të ardhura nga ekzekutimi i tij dhe, si i tillë, nuk mund të ngrihet, bie ndesh me përcaktimet e vendimit unifikues nr. 3, datë 29.03.2012, dhe në aspektin kushtetues i ka cenuar asaj të drejtën për të marrë një përgjigje përfundimtare nga gjykata për pretendimet e ngritura *(shih vendimin nr. 22, datë 16.04.2014, paragrafët 22-23, të GJK-së).*

21. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi edhe pse ai kishte depozituar rekursin brenda afatit ligjor tridhjetëditor për dorëzimin e tij, Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar atë me arsyetimin se ishte paraqitur tej këtij afati. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata është shprehur se arsyetimi i Gjykatës së Lartë është haptazi i gabuar, pasi ai ka depozituar rekursin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në datën 03.08.2009 dhe jo në datën 03.01.2010, siç arsyeton Gjykata e Lartë. Faktin se rekursi është depozituar në datën 03.08.2009, kërkuesi e provon me vulën dhe nënshkrimin e kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë që figurojnë në kopjen e rekursit që ai disponon, si dhe me fotokopjen e regjistrit të ankimeve që i është komunikuar kërkuesit nga kjo gjykatë, në të cilin rekursi figuron me numrin rendor 28 dhe datën 03.08.2009. Gjykata, mbështetur mbi aktet dhe elementet e paraqitura nga kërkuesi, dosjen gjyqësore dhe shkresën e Kancelarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, konstaton se rekursi i kërkuesit figuron me numrin rendor 28 dhe është depozituar në datën 03.08.2009. Gjykata në rastet kur ka vlerësuar se rezulton e provuar se rekursi është ushtruar nga kërkuesi në datën 03.08.2009, pra brenda afatit ligjor tridhjetëditor, rrjedhimisht, ka arritur në përfundimin se Gjykata e Lartë, duke mos e shqyrtuar rekursin me arsyetimin se ai është paraqitur tej këtij afati, ka cenuar të drejtën e aksesit të kërkuesit në një mënyrë që bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe me KEDNJ-në *(shih vendimin nr. 32, datë 22.05.2012, paragrafët 2.3 – 2.5, të GJK-së).*

B – PENALE

a) Për gjykatat e faktit

22. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi vendimet gjyqësore janë të kundërligjshme dhe se kërkesës për rivendosje në afat të ankimit i bashkohet ankimi kundër vendimit për të cilin kërkohet rivendosja në afat, vetëm kur ajo bëhet për shkaqet e parashikuara në nenin 420/1 të KPP-së, për rastet fatore ose të forcës madhore. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata ka konstatuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vlerësuar se kërkesa për rivendosjen në afat nuk është

shoqëruar me ankimin kundër vendimit, i cili ka njohur vendimin e huaj, në zbatim të neneve 147 dhe 420/1, pika 1, të KPP-së. Sipas gjykatës së shkallës së parë, nga interpretimi literal i pikës 1 të nenit 420/1 të KPP-së, kërkesa për rivendosjen në afat të ankimit duhet të shoqërohet detyrimisht me ankimin kundër vendimit të gjykatës, i cili kërkohet të ankimohet dhe në rast të mosplotësimit të këtij kushti, ajo nuk duhet të pranohet. Ky interpretim i bërë nga gjykata e shkallës së parë është vlerësuar i drejtë dhe i bazuar në ligj nga gjykata e apelit. Po ashtu, edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë zbatuar dhe interpretuar drejt ligjin procedural. Gjykata vlerësoi se neni 420/1 i KPP-së synon mbrojtjen dhe administrimin e mirë të drejtësisë, përmes plotësimit të kushteve formale të kërkesës për rivendosje në afat. Ky synim balancohet edhe me vetë interesat e kërkuesit, i cili me nismën e tij vë në lëvizje gjykatën. Norma ligjore, në mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit nga gjykatat, plotëson kriterin e qartësisë dhe parashikueshmërisë, ndaj dhe në vlerësimin e gjykatës kërkuesi, përmes përfaqësuesit ligjor, duhet të ishte i qartë paraprakisht për plotësimin e kushteve dhe konkretisht të detyrimit për t'i bashkëlidhur kërkesës aktin e kërkuar nga ligji, sipas formës dhe mënyrës së kërkuar nga ligji. Për sa më lart, duke vlerësuar rëndësinë e administrimit të mirë të drejtësisë, në kuadër të interesit publik dhe në respektim të së drejtës për akses substancial, rezulton se interpretimi i bërë nga gjykatat për nenin 420/1 të KPP-së nuk është arbitrar *(shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023, paragrafët 24-26, të GJK-së).*

23. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër nuk është i arsyetuar, është kontradiktor dhe alogjik, pasi nuk analizon elementet objektive dhe subjektive të veprës penale të "shpërdorimit të detyrës". Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit Shkodër, në arsyetimin e vendimit, nuk ka analizuar elementet e veprës penale dhe më konkretisht anën subjektive të saj. Kjo gjykatë, pasi ka vlerësuar rezultatin provues të aktit të ekspertimit, ka konkluduar se nënshkrimet e porositësve në prokurë nuk janë nënshkrimet origjinale të tyre, duke e konsideruar të konsumuar veprën penale të "shpërdorimit të detyrës". Ajo është mjaftuar me përfundimin se kërkuesja "ka vepruar në kundërshtim me përmbajtjen ligjore të detyrës së noterit dhe ky veprim i saj ka sjellë pasoja në dëm të shtetasve të interesuar", pa analizuar elementet subjektive të veprës penale dhe pa verifikuar ekzistencën e tyre. Detyrë e gjykatës, në këtë rast, ka qenë të vlerësonte provat, sipas kritereve ligjore, duke shpjeguar në arsyetim rezultatet e arritura provuese mbi bazën e të cilave të vërtetohej ekzistenca e elementeve objektive dhe subjektive të veprës penale. Pikërisht ky proces vlerësimi, i pasqyruar në vendim, përbën thelbin e arsyetimit gjyqësor nëpërmjet të cilit gjykata arrin në konkluzionin e shprehur në dispozitiv. Në mënyrë që përfundimi i gjykatës të jetë i mbështetur, arsyetimi i vendimit duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar. Gjykata vlerëson se mungesa e argumentimit ligjor në vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër, në lidhje me përmbushjen e elementeve subjektive të veprës penale, përbën një të metë të pakapërcyeshme të arsyetimit të gjykatës. Nga leximi integral i vendimit Gjykata vëren se rrjedha logjike

e përdorur në arsyetim nuk është e qartë dhe e kuptueshme; argumentet e pjesës arsyetuese nuk janë të lidhura logjikisht dhe nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që arsyetimi të mos ketë një harmoni të brendshme. Për pasojë, në kushtet e mungesës argumentative që vihet re në arsyetim, edhe silogjizmi ligjor, mbi të cilin mbështetet vendimi, është i mangët. Në rastin konkret, Gjykata çmon se duhet të vërë theksin te rëndësia që merr arsyetimi, veçanërisht kur kemi të bëjmë me një vendim penal dhe sidomos kur gjykata e apelit ndryshon vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Nuk mund të vihet në dyshim rëndësia parësore që ka arsyetimi në një vendim penal. Për shkak të natyrës së tyre, llojeve të dënimit dhe pasojave që sjellin për të pandehurin, vendimet penale duhet të jenë të arsyetuara në mënyrë tërësore, mbi bazën e provave dhe argumenteve ligjore bindëse, të cilat mbështesin pjesën urdhëruese të vendimit. Sipas qëndrimit të Gjykatës, arsyetimi është kusht themelor për vlefshmërinë e vendimit penal dhe për drejtësinë e tij. Po në këtë këndvështrim, Gjykata nënvizon detyrimin që ka gjykata e apelit për të arsyetuar vendimin gjyqësor në mënyrë të qartë dhe të detajuar, veçanërisht në rastet kur ajo e ndryshon vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Nëse gjykata e apelit e lë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, arsyetimi edhe mund të jetë minimal apo i reduktuar, ndërsa kur ajo e ndryshon vendimin, është e detyruar të paraqesë dhe të shtjellojë në mënyrë të plotë argumentet ligjore, si pasojë e të cilave ka arritur në një vendimmarrje të ndryshme nga gjykata më e ulët *(shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012, paragrafët 48 -50, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

24. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi GJKKO-ja e Shkallës së Parë, si pasojë e zbatimit të aktit normativ nr. 1/2020, të ndryshuar, ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e kërkuesit. Gjykata ka konstatuar cenimin e procesit të rregullt ligjor. Gjykata konstaton se procesi në GJKKO-në e Shkallës së Parë është zhvilluar në dhomën e këshillimit, ndërsa shqyrtimi i ankimit në GJKKO-në e Apelit është zhvilluar në seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e prokurorit dhe të mbrojtësit ligjor. Pavarësisht se e njëjta prokurë e posaçme autorizonte mbrojtësit ligjorë për të ushtruar si ankimin, ashtu edhe rekursin në emër të kërkuesit, Gjykata e Lartë duket se ka mbajtur një qëndrim formalist në drejtim të vërtetimit nëse e njëjta prokurë ishte paraqitur më herët në GJKKO-në e Shkallës së Parë. Thënë ndryshe, Gjykata e Lartë nuk ka verifikuar nëse GJKKO-ja e Shkallës së Parë kishte treguar kujdesin e duhur në dërgimin e ankimit dhe dokumenteve që i bashkëngjiten atij në gjykatën kompetente ose nëse mbrojtësit e kërkuesit përmbushnin kriteret ligjore për paraqitjen e ankimit. Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, të cilat lidheshin me cenimin e procesit të rregullt ligjor në gjykatën e apelit, sikurse e drejta për t'u dëgjuar, e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe e drejta e ankimit, në kushtet kur cenimi i këtyre të drejtave ishte pasojë e një akti normativ për të cilin ai kishte kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë, ajo nuk ka garantuar të drejtën e kërkuesit për akses në gjykatë. Megjithatë, ndonëse pretendimi i

kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë është i bazuar, Gjykata evidenton se dërgimi i çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk do të sillte ndonjë rezultat konkret për kërkuesin, pasi masa parandaluese e kufizimit të lëvizjes është ekzekutuar. Për këtë arsye, Gjykata vendosi konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor gjatë gjykimit të rekursit ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar *(shih vendimin nr. 12, datë 24.05.2022, paragrafët 57-59, të GJK-së).*

➢ *Depozitimi i rekursit brenda afatit*

25. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka pasqyruar faktin e depozitimit të rekursit të kërkueses. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se, edhe pse kërkuesja e ka depozituar rekursin brenda afatit 30-ditor të parashikuar nga KPP-ja, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendim nuk e ka pasqyruar faktin e depozitimit të rekursit dhe shkaqet e parashtruara në të, por në të gjejnë pasqyrim vetëm shkaqet e rekursit të depozituar nga prokuroria dhe i gjykuari tjetër. Gjykata çmon se mospasqyrimi në vendim i rekursit të depozituar nga kërkuesja dhe shkaqeve të tij përbën një të metë në përmbajtjen e vendimit dhe arsyetimin e tij. Si rrjedhim, Kolegji Penal i ka cenuar kërkueses të drejtën për një proces të rregullt ligjor në këndvështrim të së drejtës së aksesit dhe të së drejtës për të pasur një vendim përfundimtar, pasi nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në rekurs *(shih vendimin nr. 40, datë 16.05.2017, paragrafët 17 -19, të GJK-së).*

26. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi vendimet e gjykatave janë të paarsyetuara dhe alogjike lidhur me përjashtimin e provave të paraqitura gjatë gjykimit. Gjykatat janë kontradiktore në arsyetimin e vendimeve të tyre, duke mbajtur qëndrime të dyfishta dhe duke përdorur dy standarde për të njëjtin arsyetim, dhe kanë dhënë arsyetime të ndryshme lidhur me argumentet për përgjegjësinë penale të të pandehurit. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata arsyeton se, edhe pse kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, brenda afatit ligjor 30-ditor të parashikuar në nenin 435/1 të KPP-së, për shkak të defekteve në sistem dhe në veprimtarinë e administratës së Gjykatës së Lartë, atij i është mohuar e drejta e aksesit si pasojë e moshqyrtimit të tij së bashku me rekurset e të pandehurve të tjerë në dosjen penale. Gjykata vëren se sipas nenit 407/5 të KPP-së kur ankimi bëhet në gjykatën jokompetente, ajo ia dërgon aktet gjykatës kompetente. Në përputhje me këtë dispozitë Gjykata e Lartë kishte detyrimin që t`ia dërgonte rekursin gjykatës kompetente për efekt të regjistrimit dhe komunikimit të tij. Në përfundim, Gjykata konstaton cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, si një nga elementet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës *(shih vendimin nr. 8, datë 26.02.2016, paragrafi 20, të GJK-së).*

C – ADMINISTRATIVE

a) Për gjykatat e faktit

27. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi Gjykata e Apelit e më pas edhe Gjykata e Lartë kanë gabuar në përcaktimin e marrëdhënies juridike ndërmjet palëve. Ato, edhe pse kanë vendosur në bazë të nenit 485/2 të KPP-së, e kanë interpretuar atë në mënyrë të gabuar. Sipas kërkuesve, vendimi i Gjykatës së Apelit dhe ai i Gjykatës së Lartë janë kontradiktorë, sepse edhe pse pranojnë detyrimin për shpërblim të ekspertëve, nuk i japin rrugëzgjidhje mosmarrëveshjes. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata shprehet se Gjykata e Apelit edhe pse ka arsyetuar se çështja nuk hyn në juridiksionin civil, pavarësisht parashikimit të nenit 61 të KPC-së, sipas të cilit kur gjykata konstaton se nuk është kompetente për gjykimin e çështjes kryesisht vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente, jo vetëm nuk ia ka dërguar aktet gjykatës penale, por i ka hyrë shqyrtimit të themelit, duke vendosur pushimin e çështjes. Për më tepër, Gjykata konstaton se pushimi i çështjes nga vendimi i Gjykatës së Apelit, i lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, i ka mbyllur përfundimisht kërkuesve mundësinë e një zgjidhjeje përfundimtare të çështjes, pasi në kushtet kur procesi penal, në të cilin ekspertët janë thirrur, ka përfunduar, ata nuk mund të ankohen më ndaj vendimit penal, sepse nuk janë palë ndërgjyqëse të tij. Gjithashtu, Gjykata vëren se mangësitë e Gjykatës së Apelit nuk janë korrigjuar as nga vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili, në ndryshim nga Gjykata e Apelit, edhe pse çmon se kërkuesit kanë interes të ligjshëm për të paraqitur kërkesëpadinë, në mënyrë alogjike ka vlerësuar se rruga e zgjedhur nga kërkuesit për të realizuar këtë të drejtë është e gabuar. Gjykata konstaton se edhe pse të dyja gjykatat (Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë) në vendimet e tyre arsyetojnë se ekspertët sipas ligjit (nenet 183/2 dhe 485/2 të KPP-së) duhet të shpërblehen për punën e kryer, në mënyrë kontradiktore nuk vendosin në favor të zgjidhjes në themel të çështjes. Bazuar në këto konstatime, Gjykata vlerëson se vendimet e kundërshtuara, duke qenë të pasakta dhe kontradiktore, kanë ndikuar edhe në cenimin e së drejtës së aksesit substancial të kërkuesve *(shih vendimin nr. 25, datë 10.05.2016, paragrafët 23 -24, të GJK-së).*

28. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, për shkak të keqzbatimit të ligjit material nga Gjykata Administrative e Apelit, konkretisht të nenit 91 të ligjit nr. 9662/2006 në drejtim të së drejtës për t'u njohur me të dhënat personale, të garantuar nga neni 35, pika 3, i Kushtetutës. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata shprehet se analiza e pretendimeve të kërkuesit dhe vlerësimi i Gjykatës së Lartë për të, për sa i përket faktit se si duhej kuptuar dhe interpretuar ky nen i ligjit nr. 9662/2006, nuk plotëson standardin minimal të arsyetimit. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se mungesa e një vendimi të arsyetuar nga Gjykata e Lartë për shkaqet e lartpërmendura ka vënë në dyshim të drejtën e kërkuesit për t'u dëgjuar për të gjitha pretendimet e tij. Në vlerësim të Gjykatës, është detyrë e Gjykatës së Lartë që, si gjykatë ligji, të arsyetojë, qoftë edhe minimalisht, në rastet kur pretendimet e ngritura në rekurs kanë të bëjnë me interpretimin

e ligjit, veçanërisht kur interpretimi i ligjit lidhet me të drejta kushtetuese substanciale të individit. Për më tepër, në rastin konkret, thelbi i procesit të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit ka qenë e drejta kushtetuese për informim dhe njohja e kërkuesit me të dhënat e mbledhura rreth tij *(shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2022, paragrafi 47, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

➢ ***Shqyrtimi i shkaqeve të papretenduara në rekurs me nismë të Gjykatës së Lartë***

29. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi Gjykata e Lartë ka verifikuar me nismën e vet, gjatë shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, çështjen e shterimit të ankimit administrativ dhe të afatit të ngritjes së padisë edhe pse nuk ishin paraqitur si shkaqe në rekurs nga pala tjetër. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata evidenton se në procedurën e shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, ligjvënësi ka parashikuar disa kërkesa specifike në nenin 473/a, paragrafi 2, të KPC-së, i cili është i zbatueshëm në gjykimin administrativ, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Sipas këtyre dispozitave, kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit të rekursit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtresave të tyre për çështjet e ligjit. Në këto raste, neni 482/a, pika 1, shkronja "b", i po këtij kodi, në harmoni me nenin 62, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 49/2012, parashikon se Gjykata e Lartë, nëse e vlerëson të nevojshme për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Referuar këtij qëndrimi, Gjykata ka konstatuar se në çështjen e kërkuesit shterimi i ankimit administrativ dhe afati i ngritjes së padisë nuk janë paraqitur si shkaqe në rekursin e shqyrtuar në Gjykatën e Lartë. Kjo do të thotë se ato janë verifikuar si çështje ligjore për herë të parë dhe me nismë të vetë Gjykatës së Lartë në procedurën e shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit. Në këtë mënyrë, kërkuesit nuk i është dhënë mundësia të paraqesë paraprakisht mendimin e tij për çështjet ligjore të analizuara nga Gjykata e Lartë. Ai është vendosur në pozicionin e pamundësisë për t'u mbrojtur efektivisht për to, duke u përballur me një vendim gjyqësor që nuk i jepte përgjigje përfundimtare pretendimit që ai kishte për të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi *(shih vendimin nr. 7 datë 21.02.2023, paragrafët 27 – 28, të GJK-së).*

30. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e padisë, pa shqyrtuar themelin e saj, duke verifikuar dhe vlerësuar të parashkruar të drejtën e padisë së tij për shkak të paraqitjes së saj jashtë afatit. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim me nismën e vet dhe për herë të parë për palët ndërgjyqëse në proces

çështjet e afatit të ngritjes së padisë për kundërshtimin e aktit administrativ të shpronësimit, llogaritjen e tij në çështjen konkrete dhe tejkalimin e tij, me pasojë parashkrimin e së drejtës së padisë. Në këtë kontekst faktesh, Gjykata evidenton se sipas nenit 473/a, paragrafi 2, të KPC-së, në rastet kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtresave të tyre për çështjet e ligjit. Në këto raste, sipas nenit 482/a, pika 1, shkronja "b", të po këtij kodi, parashikohet se Gjykata e Lartë, nëse e vlerëson të nevojshme për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Në këtë kuptim, në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë, duke qenë se e ka shqyrtuar çështjen në lidhje me një shkak që nuk është ngritur në rekurs, për të cilin gjykatat më të ulëta nuk janë shprehur, dhe që ka të bëjë me një kuptim të ri të interpretimit të ligjit nr. 8561/1999, për mënyrën e njoftimit të procedurës së shpronësimit për të garantuar aksesin e individit në gjykatë, duhej të dëgjonte paraprakisht, qoftë edhe me shkrim, palët ndërgjyqëse në proces. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, për shkak të interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, është i bazuar dhe vendimi i saj duhet të shfuqizohet *(shih vendimin nr. 40, datë 22.12.2022, paragrafët 33 -35, të GJK-së).*

31. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij që lidhen me shkelje të ligjit dhe të të drejtave të tij kushtetuese. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Lidhur me vendimet e mospranimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata është shprehur edhe herë të tjera për rolin që ka dhoma e këshillimit në Gjykatën e Lartë, duke vlerësuar se sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsyetimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata. Për më tepër, ligji nr. 49/2012 për gjykatat administrative në nenin 61 ka përcaktuar se shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, kurse në nenin 62 ka parashikuar se cilat janë, përjashtimisht, rastet e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve *(shih vendimin nr. 26, datë 27.03.2017, paragrafët 16 -18 të GJK-së).*

32. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi Gjykata e Apelit Gjirokastër duke interpretuar gabim ligjin material që i njeh të drejtën atij për kompensim për burgim të padrejtë nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit. Sipas

kërkuesit, edhe pse ky pretendim është ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, Kolegji Administrativ ka vendosur mospranimin e tij pa u dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në të. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata referuar jurisprudencës kushtetuese sipas së cilës çështja e pranisë së dy vendimeve diametralisht të kundërta është vlerësuar nga Gjykata nën dritën e së drejtës së aksesit dhe asaj të ankimit në kuptimin substancial, si edhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, nisur nga natyra kushtetuese e pretendimeve të parashtruara në rekurs nga kërkuesi, dhe po ashtu, nisur nga dy qëndrimet e kundërta të gjykatave të zakonshme mbi kuptimin e dispozitave të ligjit nr. 9381, datë 28.04.2005 "Për kompensimin e burgimit të padrejtë", çmon se qëndrimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor për sa kohë ngre dyshime serioze për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, së drejtës së aksesit në gjykatë dhe së drejtës për ankim substancial *(shih vendimin nr. 28, datë 30.03.2017, paragrafi 21 të GJK-së)*

33. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në kuptimin substancial, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka njoftuar palën paditëse (kërkuesen) për gjykimin, kurse Gjykata e Lartë nuk e ka marrë në shqyrtim këtë pretendim. Gjykata i ka vlerësuar si të bazuara pretendimet. Gjykata konstaton se Gjykata Administrative e Apelit e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Pas dhënies së vendimit nga Gjykata Administrative e Apelit, kërkuesja ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Gjykata vëren se në asnjë pjesë të vendimit të Kolegjit Administrativ nuk përmendet fakti i ushtrimit të rekursit nga kërkuesja. Për sa më sipër, duke u bazuar në përmbajtjen e vendimit të Kolegjit Administrativ, Gjykata konstaton se pretendimet e kërkueses të paraqitura në rekurs nuk janë marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë. Në vlerësimin e Gjykatës, vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke mos shqyrtuar rekursin e kërkueses në themel dhe në tërësi, ka ndikuar në cenimin e së drejtës së aksesit substancial të saj *(shih vendimin nr. 48, datë 03.07.2017, paragrafët 15 -16, të GJK-së).*

- ***Për cenimin e standardit të arsyetimit lidhur me zbatimin e parimit të gjësë së gjykuar***

A – CIVILE

a) Për Gjykatën e Lartë

34. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjësë së gjykuar, pasi Gjykata e Lartë ka gabuar në arsyetimin e saj, sepse ka quajtur gjë të gjykuar një çështje e cila nuk ka qenë asnjëherë më parë e tillë. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka çmuar se i takonte Gjykatës së Lartë, në përputhje me rolin e saj subsidiar, të bënte një analizë të plotë dhe shteruese të fakteve dhe qëndrimeve të gjykatave të zakonshme

përgjatë proceseve gjyqësore mes palëve ndërgjyqëse për të arritur në një përfundim të drejtë në lidhje me ekzistencën ose jo të gjësë së gjykuar në rastin konkret, qoftë për kontratën e shitjes së truallit, qoftë për aktin e vlerësimit. Pavarësisht se Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka vlerësuar se kërkimi i kërkuesve për kontratën e shitjes së truallit ka rënë në prekluzivitet, pasi në rastin konkret ndodhemi para "gjësë së gjykuar të heshtur", ajo për të arritur në këtë përfundim i është referuar procesit të parë civil (procesi kryesor me objekt njohjen e bashkëpronësisë), por nuk ka arritur të arsyetojë në drejtim të fakteve të vërtetuara dhe së drejtës së zbatuar që u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj. Për rrjedhojë, Gjykata ka vlerësuar se pretendimi i kërkuesve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e gjësë së gjykuar është i bazuar dhe duhet pranuar *(shih vendimin nr. 28, datë 18.05.2023, paragrafët 39-40, të GJK-së).*

B - ADMINISTRATIVE

a) Për Gjykatën e Lartë

35. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e gjësë së gjykuar, pasi gjykatat u kanë hequr efektet ligjore dy vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata vlerëson se procesi gjyqësor i zhvilluar në të tria shkallët e gjykimit nuk ngre dyshime në lidhje me cenimin e parimit të sigurisë juridike. Vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nuk mund të konsiderohen si gjë e gjykuar, me pasojat që ajo sjell, në procesin gjyqësor të kundërshtuar në këtë gjykim, që lidhet me konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitblerjes së truallit dhe të kontratës noteriale. Gjykata vlerëson se pavarësisht faktit se pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të gjësë së gjykuar nuk ka marrë përgjigje në mënyrë të shprehur në vendimin e Kolegjit Administrativ, ajo, duke e vlerësuar në tërësi procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, arrin në përfundimin se kjo nuk është e mjaftueshme për ta konsideruar atë si të parregullt. Kjo edhe në linjë me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën kushtetuese se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe çdo të drejtë tjetër të njohur me Kushtetutë dhe me ligj. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka bërë një hetim të plotë për çështjen në përputhje me kompetencat e tij ligjore. Ai e ka fokusuar kontrollin në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra për mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta, duke e bazuar vlerësimin e tij mbi provat e administruara në fakt dhe që i janë nënshtruar debatit gjyqësor. Në përfundim të gjykimit Kolegji Administrativ ka dhënë një vendim të arsyetuar në lidhje me shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen e shprehur në dispozitivin e vendimit *(shih vendimin nr. 71, datë 13.11.2017, paragrafët 25-26, të GJK-së).*

- ***Për cenimin e lirisë personale të individit në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit***

A – PENALE

a) Për Gjykatën e Lartë

36. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e lirisë personale të individit në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit nga Kolegji Penal, për shkak të vijimit të zbatimit të masës së sigurimit, pavarësisht ekzistencës së vendimeve gjyqësore që nuk lejonin ekstradimin e kërkuesit. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se liria e kërkuesit është kufizuar në datën 16.04.2022, kur, bazuar në urdhrin e përditësuar të arrestit ndërkombëtar, ai është arrestuar për qëllime të ekstradimit në shtetin italian. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë i ka shqyrtuar pretendimet e ngritura nga kërkuesi gjatë procesit gjyqësor përkundrejt fakteve dhe provave të marra gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta në raport me rregullimet ligjore që përcaktojnë caktimin e masës së sigurimit personal "Arresti në burg" në rastin e tij. Kjo gjykatë ka analizuar ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave më të ulëta, duke argumentuar qëndrimin e saj përmes të cilit i ka gjetur të drejta këto vendimmarrje dhe ka dhënë përgjigje të arsyetuar për vlerësimet e arritura në përfundim të shqyrtimit të çështjes. Gjykata vlerëson se arsyetimi i Gjykatës së Lartë në rastin konkret nuk rezulton të jetë arbitrar në këndvështrimin kushtetues, për rrjedhojë nuk rezulton të ketë cenuar lirinë personale të kërkuesit *(shih vendimin nr. 51, datë 18.10.2023, paragrafi 41, të GJK)*

IV.

37. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e lirisë personale të individit në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit të Kolegjit Penal, pasi me rikthimin e kërkuesit në IEVP, dënimi ka humbur qëllimin e tij ndëshkues dhe rehabilitues, për shkak të vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar pretendimin. Gjykata ka analizuar legjislacionin penal në lidhje me rastet e pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien e të dënuarit në provë, detyrimet e tij gjatë periudhës së provës, si dhe pasojat e shkeljes së kushteve të këtij dënimi alternativ. Gjykata vlerëson se në rastin konkret vlerë përcaktuese në pasojat që vendimmarrja e Gjykatës së Lartë ka sjellë ndaj kërkuesit ka luajtur situata faktike e mbivendosjes së kohës së shqyrtimit të rekursit të prokurorisë me atë të përfundimit nga kërkuesi të ekzekutimit të dënimit alternativ të dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës dhe kryerjes së plotë prej tij të këtij dënimi, sipas urdhërimit të gjykatës, situatë e cila kërkon vlerësim të veçantë kushtetues në drejtim të kufizimit të lirisë personale, si rrjedhojë e përputhshmërisë së kohës së ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit me përfundimin e gjykimit nga Gjykata e Lartë. Gjykata konstaton se në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk del që kjo gjykatë të ketë vlerësuar situatën konkrete të kërkuesit në drejtim të zbatimit prej tij të vendimit dhe urdhërimeve të Gjykatës së Apelit Durrës ose fazën e ekzekutimit nga ai të dënimit alternativ. Po kështu, në këtë vendim, fakti i vuajtjes së dënimit alternativ nga kërkuesi nuk gjen pasqyrim në përmbajtjen e arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë. Në kushtet e mbivendosjes së fazës së gjykimit me atë të ekzekutimit, fakti i vuajtjes së dënimit nga kërkuesi ka qenë relevant për kontrollin rishikues të Gjykatës së Lartë, për

sa kohë objekt i tij ka qenë edhe dënimi alternativ i dhënë nga gjykata e apelit, duke mos qenë e tillë masa e dënimit e caktuar ndaj tij. Në këtë pikëpamje, ndërsa ekzekutimi i dënimit për shkak të kohës së kaluar potencialisht duhet të kishte përfunduar, çka passillte implikime për vendimin që asaj i është kërkuar të jepte, Gjykata e Lartë ka pasur detyrimin për marrjen e informacionit në këtë drejtim, për të shmangur në këtë mënyrë rindëshkimin e kërkuesit pas shlyerjes më parë të dënimit. Gjykata vlerëson se nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Lartë kërkuesi është ngarkuar të vuajë sërish një pjesë të dënimit me burgim të vuajtur më parë prej tij në një prej mënyrave alternative të këtij dënimi. Një vendimmarrje e tillë, e ndërlidhur me një arsyetim të mangët të situatës faktike dhe juridike të kërkuesit, duke mos vënë në diskutim dhe mos marrë në analizë faktin se dënimi me burgim i caktuar ishte ekzekutuar tërësisht, ka cenuar lirinë personale të kërkuesit, si dhe funksionin e dhënies së drejtësisë penale dhe atë riedukative të dënimit, në kushtet kur kërkuesi tashmë e kishte kryer dënimin penal për veprën e kryer *(shih vendimin nr. 24, datë 27.04.2023, paragrafët 29-31, të GJK-së).*

38. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e lirisë personale të individit në lidhje me standardin e arsyetimit, pasi Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues me efekt prapaveprues, duke mos marrë parasysh faktin që gjatë kohës që çështja ndodhej për shqyrtim në Kolegjin Penal, ligji nr. 36/2017 ndryshoi masën e dënimit për veprën penale "Mashtrimi", të parashikuar nga neni 143 i KP-së. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se në vendim Kolegji Penal ka vlerësuar vetëm shkaqet e rekursit, ashtu sikurse kanë qenë të formuluara në momentin e paraqitjes së tyre nga avokati i kërkuesit, për të cilat është shprehur se lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit procedural penal, nenit 152 të KPP-së, nga ana e gjykatës së apelit, e lidhur kjo me vlerësimin e provave të marra e të verifikuara në këtë gjykim, të cilat dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të saj. Në këtë vendim Kolegji Penal nuk ka vlerësuar ndryshimet që kishte pësuar ndërkohë neni 143 i KP-së nga ligji nr. 36/2017 dhe efektet e këtij ndryshimi në çështjen konkrete. Gjykata ka arsyetuar se duke qenë se në rastin konkret çështja ishte ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe dënimi penal i dhënë ndaj kërkuesit lidhej drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit të shfuqizuar (neni 143 i KP-së), Gjykata çmon se ky ndryshim i ligjit penal duhej të ishte arsyetuar nga Gjykata e Lartë nëse bënte të aplikueshëm zbatimin e ligjit penal favorizues. Për rrjedhojë, në kushtet kur në kohën e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë kishte ndryshuar ligji penal, ajo duhej të ishte shprehur për zbatimin e garancive kushtetuese dhe procedurale ndaj kërkuesit *(shih vendimin nr. 20, datë 22.09.2022, paragrafi 86, të GJK-së).*

39. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e lirisë personale të individit në lidhje me standardin e arsyetimit, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh faktin se marrëveshja për ekstradimin konkurron me marrëveshjen dypalëshe me Italinë për njohjen e vendimeve penale të huaja mes dy vendeve dhe ekzekutimin përkatës në vendin e origjinës. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka konstatuar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me argumentin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Po ashtu, Gjykata konstaton se kërkuesi në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ka ngritur pretendime të natyrës kushtetuese për sa i përket zbatimit të garancive kushtetuese e

procedurale penale, të cilat çojnë, sipas tij, në përkeqësimin e pozitës së tij duke i cenuar lirinë. Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit, duke mos u shprehur dhe mos u dhënë përgjigje këtyre pretendimeve me natyrë kushtetuese *(shih vendimin nr. 12, datë 15.02.2017, paragrafët 20 – 21, të GJK-së).*

40. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e lirisë personale të individit në lidhje me standardin e arsyetimit, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh se dispozita ligjore penale që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale ka ndryshuar gjatë kohës së gjykimit të çështjes në atë gjykatë. Gjykata konstaton se ndërkohë që çështja ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, me vendimin nr. 9, datë 26.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese është shfuqizuar paragrafi i pestë dhe i gjashtë të nenit 278 të KP-së, shtuar me ligjin nr. 144/2013, ndryshuar me ligjin nr.98/2014. Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet ta kishte marrë në konsideratë zbatimin e parimit kushtetues të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues. Gjykata vëren se megjithëse është e njohur se fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues përbën një nga parimet themelore të procesit gjyqësor të garantuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka mënjanuar respektimin e këtij standardi kushtetues *(shih vendimin nr. 49, datë 03.07.2017, paragrafi 16 dhe paragrafët 19 -20, të GJK-së).*

41. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e lirisë personale të individit në lidhje me standardin e arsyetimit, pasi Gjykata e Lartë në vendim nuk shprehet për rekursin e kërkuesit. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës kanë ushtruar rekurs të dy kërkuesit, brenda afatit ligjor 30-ditor të parashikuar në nenin 435/1 të KPP-së. Në vendimin e Gjykatës së Lartë, si në pjesën ku parashtrohen shkaqet e rekursit, ashtu edhe në pjesën ku Gjykata shprehet nëse rekursi përmban apo jo shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së, si dhe në dispozitivin e tij gjejnë pasqyrim vetëm pretendimet e ngritura në rekurs vetëm nga njëri kërkues. Fakti që edhe kërkuesi tjetër ka ushtruar rekurs, si dhe nëse shkaqet e paraqitura prej tij janë shqyrtuar apo jo nga Gjykata e Lartë, nuk gjejnë pasqyrim në vendimin e kësaj të fundit. Gjykata vlerëson se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs nga kërkuesi i dytë, si dhe fakti që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk shprehet në vendim për rekursin e tij, krijojnë dyshime të arsyeshme nëse ky Kolegj ka arritur të marrë ose jo në shqyrtim dhe të vlerësojë shkaqet e pretenduara prej kërkuesit, çka përbën një të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës. Duke konsideruar se e drejta e aksesit në gjykatë nuk mund t'i cenohet kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtaritë e vetë organeve shtetërore, gjykatës në rastin konkret, Gjykata vlerëson se i takon Gjykatës së Lartë të marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekursin e paraqitur nga kërkuesi i dytë. Bazuar në rëndësinë e garantimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në proceset penale në të cilat është vendosur burgimi i individit, që passjell sakrifikimin maksimal të lirisë personale të tij, kjo e fundit e mbrojtur si vlerë themelore nga Kushtetuta, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë, në pjesën ku nuk shprehet për rekursin e paraqitur nga kërkuesi i dytë, ka cenuar standardin e

arsyetimit të vendimit, si dhe të drejtën e aksesit në gjykatë të tij *(shih vendimin nr. 68, datë 14.11.2016, paragrafët 16-18, të GJK-së).*

42. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e lirisë personale të individit në lidhje me standardin e arsyetimit, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit edhe pse në të ishin ngritur pretendime të natyrës kushtetuese për sa i përket parashkrimit të ekzekutimit të vendimit. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Në vlerësimin e Gjykatës arsyetimi i gjykatave të faktit e ka vendosur kërkuesin në situatën ku atij i duhet të vuajë një dënim i cili është parashkruar. Këto shkelje të bëra nga gjykatat e faktit nuk janë konstatuar as nga Gjykata e Lartë, e cila në vendimin unifikues të saj nr.7/2002 ka interpretuar parashkrimin e dënimit penal (nenin 68 të KP-së). Gjykata vëren se edhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkuesi ka evidentuar faktin se ekzekutimi i vendimit të dënimit të vitit 1991 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është parashkruar, për arsye se kanë kaluar 20 vjet nga momenti i marrjes formë të prerë të vendimit. Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit, duke mos u shprehur dhe mos u dhënë përgjigje këtyre pretendimeve me natyrë kushtetuese. Gjykata për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt *ligjor (shih vendimin nr. 84, datë 30.12.2016, paragrafët 26 -27, të GJK-së).*

43. Përpara Gjykatës është ngritur pretendimi për cenimin e lirisë personale të individit në lidhje me standardin e arsyetimit, pasi megjithëse në rekurs ishin paraqitur shkaqe ligjore dhe kushtetuese, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka kaluar çështjen për shqyrtim dhe nuk u ka dhënë përgjigje problemeve juridike të ngritura në rekurs. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se zgjidhja e çështjes nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit është rrjedhojë e një arsyetimi dhe interpretimi të kundërt të ligjit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me arsyetimin se kërkuesi ndiqej në Shqipëri për një vepër penale, ka rrëzuar kërkesën për ekstradim, duke çmuar se ajo binte ndesh me dispozitën e nenit 491/c/a të Kodit të Procedurës Penale. Duke arsyetuar të kundërtën, pra që kërkesa nuk bie ndesh me dispozitën e nenit 491/1/c të KPP-së, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe miratimin e ekstradimit të kërkuesit. Gjykata e Lartë ka vendosur, në dhomën e këshillimit, mospranimin e rekursit. Në vlerësimin e Gjykatës, koncepti i institutit të ekstradimit, referuar Konventës Evropiane për Ekstradimin dhe KPP-së, konsiston në një nga format e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ka për qëllim dorëzimin e një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një vepër penale. Gjykata e Lartë, në bazë të normave procedurale, e ka detyrim ligjor interpretimin e ligjeve, për më shumë që kjo çështje ka të bëjë me koncepte të natyrës së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të konventave, palë e të cilave është edhe Shqipëria *(shih vendimin nr. 4, datë 05.02.2014, paragrafët 11-12 dhe paragrafi 19, të GJK-së).*

6. Parimi i gjësë së gjykuar (res judicata)

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj *(shih vendimet nr. 28 datë 18.05.2023, paragrafi 37; nr. 33, datë 10.04.2017, paragrafi 43; nr. 24, 12.11.2008, paragrafi 2.5, të GJK-së).*

2. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës për marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike *(shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022 paragrafi 45; nr. 50, datë 03.07.2017, paragrafi 27; nr. 23, datë 08.06.2007, paragrafi 13, të GJK-së).*

3. Sipas nenit 34 të Kushtetutës, askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj. Ratio i nenit 34 të Kushtetutës është sanksionimi i parimit "të mosgjykimit dhe dënimit dy herë për të njëjtën vepër penale" (ne bis in idem) dhe parimit të "gjësë së gjykuar" (res judicata). Këto dy parime vijnë si garanci të konfirmuara nga kjo dispozitë kushtetuese, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të individit në fushën penale *(shih vendimin nr. 1, datë 26.02.2021, paragrafi 35, të GJK-së).*

b. Precedentët ku çështja e cenimit të parimit të gjësë së gjykuar është vënë në diskutim

A- CIVILE

a) Për gjykatat e faktit

4. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjësë së gjykuar, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për sa u takon vendimeve të KKKP-së, Tiranë, në çështje të ngjashme kanë vendosur në mënyra të ndryshme. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit jo vetëm kanë të bëjnë me çështje gjyqësore të tjera dhe të ndryshme nga çështja e tij, por nuk rezulton që gjykatat të kenë disponuar apo të jenë shprehur në lidhje me pjesën takuese të pasurisë së kërkuesit.

Gjithashtu, vërehet se këto çështje janë akoma në proces shqyrtimi dhe rishqyrtimi në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se këto vendime nuk e vendosin kërkuesin në një situatë të pasigurt nga pikëpamja juridike *(shih vendimin nr. 14, datë 27.02.2017, paragrafi 21, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

5. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjësë së gjykuar, pasi Gjykata e Lartë ka gabuar në arsyetimin e saj duke quajtur gjë të gjykuar një çështje e cila nuk ka qenë asnjëherë më parë gjë e gjykuar në vendimet të cilave u referohet ajo gjykatë. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka çmuar se i takonte Gjykatës së Lartë, në përputhje me rolin e saj subsidiar, të bënte një analizë të plotë dhe shteruese të fakteve dhe qëndrimeve të gjykatave të zakonshme përgjatë proceseve gjyqësore mes palëve ndërgjyqëse, për të arritur në një përfundim të drejtë në lidhje me ekzistencën ose jo të gjësë së gjykuar në rastin konkret, qoftë për kontratën e shitjes së truallit, qoftë për aktin e vlerësimit. Pavarësisht se Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka vlerësuar se kërkimi i kërkuesve për kontratën e shitjes së truallit ka rënë në prekluzivitet, pasi në rastin konkret ndodhemi para "gjësë së gjykuar të heshtur", ajo për të arritur në këtë përfundim i është referuar procesit të parë civil (procesi kryesor me objekt njohjen e bashkëpronësisë), por nuk ka arritur të arsyetojë në drejtim të fakteve të vërtetuara dhe së drejtës së zbatuar që u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj. Për rrjedhojë, Gjykata ka vlerësuar se pretendimi i kërkuesve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e gjësë së gjykuar është i bazuar dhe duhet pranuar *(shih vendimin nr. 28 datë 18.05.2023, paragrafët 39-40, të GJK-së).*

B- PENALE

a) Për Gjykatën e Lartë

6. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjësë së gjykuar, pasi pasuria e konfiskuar është krijuar në mënyrë të ligjshme, me burime të prejardhura nga shitja e një pasurie, e cila i ishte nënshtruar më parë shqyrtimit gjyqësor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, për të cilën kjo gjykatë kishte disponuar se pasuria ishte krijuar me të ardhura të ligjshme. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe GJKKO-ja e Apelit janë shprehur se automjeti i sekuestruar nuk ka qenë objekt verifikimi gjatë procedimit penal të mëparshëm, ndaj dhe nuk mund të konsiderohet gjë e gjykuar. Ndërsa, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka analizuar drejtpërdrejt këtë parim, por ka mbështetur qëndrimin e gjykatave më të ulëta, duke u shprehur: "Pavarësisht se Kolegji nuk i hyn shqyrtimit të provave, ai vlerëson se gjykatat më të ulëta kanë vlerësuar drejt se ekzistojnë kushtet për konfiskimin e pasurisë sipas objektit të kërkesës, referuar aktit normativ nr. 1/2020. Kolegji vlerëson se

të gjitha pretendimet e ngritura në rekurs janë ngritur edhe në shkallët e tjera të gjykimit dhe kanë marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat më të ulëta." *(shih vendimin nr. 4, datë 21.02.2022, paragrafi 55, të GJK-së).*

C- Administrative

a) Për gjykatat e faktit

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjësë së gjykuar, pasi Gjykata Administrative e Apelit në vendimmarrjen e saj nuk ka marrë parasysh vendimin nr. 33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e nenit 14 të ligjit nr. 99/2015, i cili kishte ndryshuar nenin 119 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, që ishte baza ligjore e vendosjes së masës së gjobës ndaj kërkueses. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka vlerësuar se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka përmbushur detyrimin kushtetues për zbatimin e vendimit të Gjykatës për shfuqizimin e ligjit, vendim i cili ka fuqi detyruese të përgjithshme dhe forcën e ligjit, si dhe nuk ka zbatuar as ndryshimet ligjore pas vendimit të Gjykatës, konkretisht ligjin nr. 112/2016. Në çështjen konkrete zbatimi nga Gjykata Administrative e Apelit i dispozitave të një ligji të shfuqizuar nga Gjykata, si dhe moszbatimi i dispozitave të reja ligjore në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes, dëshmon se gjykata nuk ka ushtruar kontroll efektiv për ndërhyrjen që administrata tatimore ka bërë tek e drejta e pronës së kërkueses, e, për rrjedhojë, ka cenuar parimin e sigurisë juridike. Në këtë mënyrë, Gjykata Administrative e Apelit nuk ka përmbushur detyrimin e saj për realizimin e një procesi të rregullt ligjor dhe gjykimi të drejtë, sipas nenit 42 të Kushtetutës *(shih vendimin nr. 18, datë 30.03.2021, paragrafët 37-39, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

8. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjësë së gjykuar, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka pranuar se kërkuesja mund t'i nënshtrohej për herë të dytë kontrollit tatimor për të njëjtën periudhë, megjithëse ky kontroll nuk ishte i parashikuar në dispozitat ligjore përkatëse dhe e drejta e organeve tatimore për të kryer kontroll ishte parashkruar. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata ka vlerësuar se nuk vepron standardi i gjësë së gjykuar, për rrjedhojë pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar, pasi edhe pse ndodhemi para çështjeve me të njëjtat palë, objekti i këtyre vendimeve dhe thelbi i mosmarrëveshjes së shtruar për zgjidhje gjykatës, referuar përmbajtjes së pjesës arsyetuese të vendimeve, është i ndryshëm. Me vendimin e vitit 2013 Gjykata e Lartë ka vendosur përfundimisht pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ të njoftimit të vlerësimit të DRTTM-së, pasi ishte nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji, në referim të shkronjës "c" të nenit 116 të KPA-së. Në këtë vendim Gjykata e Lartë nuk ka bërë asnjë vlerësim në lidhje me ekzistencën e detyrimit të kërkueses ose të drejtën

e organeve tatimore për të ushtruar kontroll ndaj saj në të ardhmen. Në ndryshim nga vendimi i Kolegjit Civil, me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është bërë interpretimi i dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me të drejtën e organeve tatimore që të ushtrojnë kontroll dhe rikontroll ndaj subjekteve tatimore, duke arritur në përfundimin se ndaj kërkueses nuk ka një detyrim tatimor të vlerësuar nga organet tatimore për periudhën tatimore të vitit 2004, ndaj nuk jemi para rastit të rikontrollit sipas nenit 85 të ligjit nr. 9920/2008. Kolegji Administrativ ka arritur në këtë përfundim duke shqyrtuar dhe analizuar të gjitha faktet e rrethanat, si dhe duke marrë parasysh edhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga Kolegji Civil i po asaj gjykate *(shih vendimin nr. 11, datë 21.04.2022, paragrafi 48, të GJK-së).*

9. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjësë së gjykuar, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar fuqinë detyruese të vendimit nr. 17, datë 23.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin janë shfuqizuar kompetencat e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme për fshirjen e regjistrimeve dhe fuqinë e gjësë së gjykuar të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Gjykata i ka vlerësuar si të bazuar këto pretendime. Gjykata ka konstatuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shfuqizimin e akteve administrative të ZQRPP-së dhe të ZVRPP-së, Kavajë, të nxjerra në vitin 2010, duke urdhëruar ZVRPP-në të fshijë regjistrimin e katër pasurive që figuronin në emër të kërkueses. Vendimi gjyqësor i mësipërm është dhënë nga Gjykata e Lartë pas vendimit nr. 17, datë 23.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin u shfuqizua neni 10, paragrafi i dytë dhe paragrafi i tretë, i ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën, duke i hequr zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme juridiksionin për të trajtuar ligjshmërinë e regjistrimit të pasurive. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë të gjitha proceset gjyqësore të zhvilluara midis palëve, vëren se është e qartë që nuk bëhet fjalë për procedurë korrigjimi gabimesh prej zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pasi vetë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij ka shqyrtuar dhe vlerësuar titujt e pronësisë së palëve, duke vendosur se e drejta e pronësisë i takon subjektit të interesuar dhe për këtë shkak zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme duhet të procedojë me çregjistrimin e pasurive në emër të kërkuesve dhe, në vijim, me regjistrimin e tyre në favor të subjektit të interesuar. Gjykata çmon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar fuqinë detyruese të vendimit nr. 17, datë 23.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese. Ndonëse Gjykata Administrative e Apelit ka përdorur gjënë e gjykuar si një prej argumenteve kryesore për rrëzimin e padisë dhe subjekti i interesuar në rekursin e tij e ka kundërshtuar këtë argument shprehimisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit dhe ka heshtur nëse në rastin konkret zbatohej ose jo koncepti i gjësë së gjykuar. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka urdhëruar fshirjen e regjistrimit të pasurive në emër të kërkuesve, me arsyetimin se e drejta e pronësisë së tyre ishte fituar në kundërshtim me ligjin, ka cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi nuk ka respektuar fuqinë e gjësë së gjykuar *(shih vendimin nr. 17, datë 30.03.2021, paragrafët 56 –57, të GJK-së).*

7. Parimi i sigurisë juridike

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Siguria juridike në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë *(shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023, paragrafi 80; nr. 50, datë 03.07.2017, paragrafi 48; nr. 36, datë 25.07.2013, paragrafi 37; nr. 23, datë 08.06.2007, paragrafi 12, të GJK-së).*

2. Jurisprudenca kushtetuese ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës, duke e parë të lidhur me parimin res judicata, sipas të cilit vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka për qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit te shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin *(shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023, paragrafi 73; nr. 14, datë 27.02.2017, paragrafi 16; nr. 23, datë 08.06.2007, paragrafi 12, të GJK-së).*

3. Për sa u përket të drejtave të fituara si elemente të parimit të sigurisë juridike, çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të "procesit të rregullt", përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre *(shih vendimet nr. 31 datë 29.05.2023, paragrafi 51; nr. 10, datë 13.02.2017, paragrafi 42; nr. 20, datë 29.09.2008, paragrafi 3.2; nr. 17, datë 18.07.2005, paragrafi 1.5, të GJK-së).*

4. Gjatë shqyrtimit të ankesave individuale kushtetuese, Gjykata e ka analizuar sigurinë juridike të lidhur edhe me pretendimet për mosrespektimin e vendimeve të kësaj Gjykate nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm *(shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022, paragrafi 53; nr. 17, datë 10.04.2015, paragrafi 20; nr. 5, datë 07.02.2001, paragrafët 11-12, të GJK-së).*

5. Në funksion të parimit të sigurisë juridike, mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve ligjore të përcaktuara. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Mospërcaktimi i këtyre afateve do të çonte në një situatë të tillë, ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes

palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment, një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej ose prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë *(shih vendimet nr.9, datë 07.02.2017, paragrafi 21; nr.5, datë 02.03.2010, paragrafi 3; nr.19, datë 23.12.2004, paragrafi 7, të GJK-së).*

6. Në lidhje me mjetet e tjera ankimore, përmes të cilave individët u drejtohen gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, rishikimi përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse *(shih vendimet nr. 11, datë 10.03.2023, paragrafi 47; nr. 5, datë 01.03.2018, paragrafi 21; nr. 36, datë 26.07.2011, paragrafi 18, të GJK-së).*

b. Precedentët ku çështja e cenimit të parimit të sigurisë juridike është vënë në diskutim

A- CIVILE

a) Për Gjykatën e Lartë

- ***Lënia në fuqi e vendimeve gjyqësore që disponojnë në mënyra të ndryshme***

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të sigurisë juridike, pasi gjykata të ndryshme kanë bërë vlerësime të ndryshme në lidhje me çështjen e shpronësimit të tyre. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Duke iu referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, Gjykata vlerëson të pasqyrojë proceset gjyqësore që janë zhvilluar nga palët ndërgjyqëse të procesit gjyqësor të kundërshtuar. Gjykata vëren se subjektet e interesuara me anë të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kanë privatizuar një banesë nga Ndërmarrja Komunale Banesa (NKB) dhe një sipërfaqe truall që i përket oborrit të shtëpisë. Pas këtyre privatizimeve ndërmjet subjekteve të interesuara dhe NKB-së janë lidhur edhe kontratat e shitjes. Njëri prej kërkuesve ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt "Kundërshtimi i të tretit", duke kundërshtuar kontratën e privatizimit të banesës ndërmjet subjekteve të interesuara dhe NKB-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, por ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se njëri prej kërkuesve legjitimohej t'i drejtohej gjykatës vetëm nëse do të disponontе një vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, që provon titullin e pronësisë mbi pronën e pretenduar. Në vitin 2011 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për rishikimin e vendimit të Gjykatës së

Apelit Tiranë, duke parashtruar si shkak rishikimi zbulimin e disa provave të reja me shkresë, që kishin rëndësi për çështjen, që nuk diheshin gjatë shqyrtimit të çështjes dhe që vërtetonin se vendimi ishte i padrejtë e duhej të prishej. Gjykata e Lartë ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të formës së prerë. Gjykata vëren se proceset gjyqësore të sipërcituara janë të ndryshme nga procesi objekt shqyrtimi në këtë Gjykatë dhe ato janë iniciuar nga kërkuesit me mjetet procedurale të vlerësuara prej tyre, duke pasur si objekt "kundërshtimin e të tretit" dhe kërkesën për rishikim. Për të realizuar pretendimin për të drejtën e pronësisë mbi banesën, përdorimi i mjeteve juridike nga kërkuesit i ka dhënë shkak proceseve të tjera gjyqësore dhe asnjë nga vendimet e dhëna në përfundim të tyre nuk ka qenë përfundimtar për të drejtën e pronës (të ndërtesës). Në mënyrë përfundimtare, Gjykata çmon se nuk kemi të bëjmë me procese paralele dhe as me fakte të vlerësuara në mënyra të ndryshme në proceset gjyqësore *(shih vendimin nr. 2, datë 11.02.2021, paragrafët 36 -38, të GJK-së).*

IV.

8. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të sigurisë juridike, pasi Gjykata e Lartë ka dhënë dy vendime të ndryshme për të njëjtën çështje. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata, referuar edhe vendimeve të GJEDNJ-së në disa çështje kundër Shqipërisë si Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë (datë 13.11.2007), Hamzaraj kundër Shqipërisë (datë 03.02.2009), Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë (datë 31.07.2012), ka evidentuar rëndësinë e sigurisë juridike në procesin e kthimit dhe të kompensimit të pronave, veçanërisht për sa u përket të drejtave të fituara nga vendimet që kanë njohur të drejta pronësie dhe ruajtjes së garancive që lidhen me këto të drejta. Gjykata konstaton se dhënia e dy vendimeve të ndryshme për të njëjtën çështje nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike në vendimet gjyqësore, duke krijuar një situatë të paqëndrueshme dhe të paqartë ligjore për sa u takon pretendimeve të kërkueses. Përveç sa më sipër, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil duke pushuar çështjen ka lënë pa zgjidhje përfundimtare dhe në një situatë të pasigurt juridike kërkuesen, e cila pas më shumë se 20 vjetëve në konflikte gjyqësore, nuk ka ende një vendim gjyqësor të formës së prerë që u jep zgjidhje përfundimtare pretendimeve të saj lidhur me të drejtën e pronës *(shih vendimin nr. 2, datë 29.01.2016, paragrafët 26 -28, të GJK-së).*

9. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të sigurisë juridike, pasi Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, ka lënë në fuqi vendime të cilat bien në kundërshtim me njëra- tjetrën. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në kontrollin e respektimin e standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimin e disponibilitetit, të parashtruara në rekurs nga kërkueset. Në përfundim, Gjykata çmon se nisur nga natyra e pretendimeve, mungesa e arsyetimit të argumenteve në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përbën cenim të procesit të rregullt ligjor *(shih vendimin nr. 12, datë 17.03.2014, paragrafët 31-32, të GJK-së).*

10. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të sigurisë juridike, pasi vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë bien në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 56, datë 23.09.2002. Në këtë vendim është pranuar se e drejta pronësisë dhe pjesët trashëgimore do të rregullohen nga dispozitat e KC-së të vitit 1929 dhe jo nga dekreti "Për trashëgiminë" i vitit 1954 (të ndryshuar). Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka arritur në përfundimin se vendimet objekt kërkese janë rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës e nenit 6 të KEDNJ-së. Ato kanë cenuar parimin e sigurisë juridike duke i hequr efektet ligjore vendimit të formës së prerë nr. 56, datë 23.09.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë. Për sa i përket pjesës trashëgimore, gjykata e apelit i është referuar vendimit të vitit 2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke pranuar indirekt zbatimin e KC-së të vitit 1929, pra që trashëgimtarët e gjakut përfitojnë 2/3-at pjesë dhe jo të dekretit nr. 1892, datë 05.07.1954 "Mbi trashëgiminë" (të ndryshuar), sipas të cilit pjesët trashëgimore duhet të jenë të barabarta. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit. Gjykata, duke i krahasuar vendimet e mëparshme me vendimet objekt kundërshtimi, vëren se gjykimi me objekt njohjen e së drejtës trashëgimore mbi banesën i vitit 2002 është një gjykim njohjeje dhe vërtetimi me qëllim që të krijohet apo të ndryshohet bashkëpronësia, ndërsa gjykimi i fazës së parë të pjesëtimit është një gjykim gjithashtu njohës dhe vërtetues, por që ka qëllim t'i japë fund regjimit të bashkëpronësisë. Megjithatë, thelbi i mosmarrëveshjeve të vendosura me vendimin nr. 56, datë 23.09.2002 të Kolegjeve të Bashkuara dhe me vendimin nr. 4, datë 23.01.2007 të këtyre kolegjeve është i njëjtë. Në të dyja gjykimet palët, objekti dhe shkaku kanë qenë të njëjtë. Por, Gjykata konstaton se zgjidhjet që gjykatat e sistemit gjyqësor u kanë dhënë kanë qenë të ndryshme *(shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008, paragrafët 2.12 – 2.13 dhe paragrafi 2.15, të GJK-së).*

➢ *Vendimi i formës së prerë: mosshqyrtimi i pretendimeve ose prishja e tyre*

A- CIVILE

11. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të sigurisë juridike, pasi konflikti mbi titullin e pronësisë është zgjidhur përfundimisht me vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata çmon se argumentet e kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të ligjit material, si dhe vlerësimin e akteve të tjera të administruara në gjykim nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Nisur nga natyra ligjore e këtyre pretendimeve, Gjykata vlerëson se ato nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues. Për më tepër, referuar vendimit objekt kundërshtimi, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në kontrollin e respektimin e

standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, ka mbajtur një qëndrim të shprehur lidhur me arsyet dhe shkaqet pse në çështjen konkrete nuk gjente zbatim res judicata *(shih vendimin nr. 33, datë 10.04.2017, paragrafi 47, të GJK-së).*

12. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të sigurisë juridike, pasi vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë ishte i formës së prerë për sa u takon të drejtave të fituara ndaj Spitalit Rajonal Vlorë. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vlerëson se prishja e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, pavarësisht se Spitali Rajonal Vlorë nuk kishte paraqitur pretendime në lidhje me detyrimin financiar kundrejt kërkueses, ka krijuar pasoja të tilla që e vendosin kërkuesen në një situatë të pasigurt nga pikëpamja juridike *(shih vendimin nr. 49, datë 22.07.2016, paragrafi 36, të GJK-së).*

13. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të sigurisë juridike, pasi gjykata e shkallës së parë, në kundërshtim me kërkesat e KPC-së, ka prishur vendime gjyqësore të formës së prerë, ka bërë gjykim për herë të dytë mbi pronën, si dhe nuk ka marrë parasysh urdhrat e ekzekutimit që kanë dalë në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Në ankimin e paraqitur përpara Gjykatës së Apelit kërkuesja ka pretenduar cenimin e parimit të gjësë së gjykuar. Sipas saj, çështjet e pozicionimit të pronës dhe kthimit të saj në natyrë janë zgjidhur me vendimin gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Lidhur me pretendimet e ngritura nga kërkuesja, Gjykata e Apelit është shprehur se "janë të pabazuara në ligj dhe prova e nuk ka vend të merren parasysh". Gjykata vëren se edhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkuesja ka evidentuar se "pronësia është fituar përmes një vendimi gjyqësor të formës së prerë, i cili ka saktësuar vendndodhjen e pronës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë pas 10 vjetësh nga vendimi gjyqësor i formës së prerë e ka shfuqizuar atë, duke shkelur haptazi ligjin dhe çdo parim të së drejtës". Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Kërkuesja në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ka ngritur pretendime të natyrës kushtetuese për sa i përket respektimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, vendim i cili ka konkretizuar të drejtën e pronës dhe është shprehur për kthimin e saj në natyrë. Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë ka vendosur në dhomë këshillimi mospranimin e rekursit, duke mos u shprehur dhe mos u dhënë përgjigje këtyre pretendimeve me natyrë kushtetuese. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se përderisa në rekurs ishin ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë duhej të shprehej mbi to, në respektim të rolit të saj kontrollues dhe parimit të subsidiaritetit *(shih vendimin nr. 41, datë 06.07.2016, paragrafët 22-24, të GJK-së).*

14. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të sigurisë juridike, pasi vendimet e KKKP-së, që kanë disponuar për njohjen pronarë të kërkuesve dhe kthimin e pronës trashëgimlënësve të tyre, nuk mund të viheshin më në diskutim nga gjykatat dhe se subjekti i interesuar mund të njihej pronar vetëm në rrugë administrative, pra me vendim të po këtij komisioni. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Njohja, kthimi dhe kompensimi i pronës bëhet nëpërmjet një organi administrativ mbi kërkesën që ish-pronari u drejton organeve përkatëse të administratës publike dhe nëse individi kërkues nuk është dakord me vendimin e komisionit, ai ka të drejtë ta

kundërshtojë këtë vendim drejtpërdrejt në gjykatë. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, përveç të tjerave, hetohet e vërtetohet edhe fakti nëse subjektit i është cenuar apo jo e drejta e pronësisë dhe çdo vendim gjykate që do të anulonte pjesërisht ose plotësisht vendimet e organit përkatës të administratës, duhet të konfirmojë njëkohësisht edhe të drejtën e tij të pronësisë. Prandaj, Gjykata ka vlerësuar se kur shqyrtohet një mosmarrëveshje e tillë, gjykata ka juridiksion dhe kompetencë jo vetëm të anulojë pjesërisht ose plotësisht vendimet e organit administrativ, por njëkohësisht edhe të njohë e të kthejë pjesërisht ose plotësisht pronën në favor të tyre. Në këtë kuptim, Gjykata ka vlerësuar se kthimi i drejtpërdrejtë i pronës nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në rastet kur ajo shqyrton ankesat ndaj vendimeve të KKKP-ve, nuk përbën tejkalim të juridiksionit gjyqësor. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret vlerësimi i ligjshmërisë së vendimeve të KKKP-së nga ana e gjykatës nuk përbën cenim të parimit të sigurisë juridike dhe, për pasojë, ky pretendim i kërkuesve është i pabazuar *(shih vendimin nr. 28, datë 15.05.2014, paragrafët 16 -17, të GJK-së).*

15. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të sigurisë juridike, pasi vendimi i KKKP, Sarandë i vitit 1994 është bërë më parë objekt i shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë në vitin 1999. Vendimet objekt kërkese, sipas kërkueses, bien ndesh me vendimin e mëparshëm nr. 137/1999 dhe po ashtu nuk është krijuar drejt ndërgjyqësia, pasi për këto prona ekziston mbivendosje për zgjidhjen e së cilës ka qenë duke u zhvilluar një gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë i vitit 1999 ka për objekt kundërshtimin e vendimit nr. 17/1994 të KKKP-së. Në këtë vendim gjykata ka vendosur që ish-pronarëve, përveç sipërfaqes së kthyer prej 25,000 m², t'u kthehen edhe 12,500 m² sipërfaqe e lirë, sipas kufijve përkatës, që përfshihet brenda sipërfaqes totale të kthyer me vendimin nr. 17/1994 të KKKP-së. Gjykata konstaton se vendimi i vitit 2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka një objekt të ndryshëm nga vendimi nr. 137/1999 dhe në dispozitivin e këtij vendimi nuk janë përcaktuar konkretisht kufijtë përkatës të sipërfaqes së kthyer prej 7960m² dhe as pjesët takuese për secilin ish – pronar. Në vlerësimin e Gjykatës paqartësia në pjesën urdhëruese të vendimit mund të korrigjohet me mjete të tjera juridike. Kështu, sipas nenit 312 të KPC-së, pas shpalljes së vendimit me kërkesën e palëve ose kryesisht, gjykata mund të ndreqë në çdo kohë vetëm gabimet e bëra në shkrim ose në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit. Gjithashtu, edhe në bazë të nenit 314 të KPC-së, gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët. Për pasojë edhe saktësimi i dispozitivit mund të bëhet me kërkesë të palëve mbi të cilën gjykata vendos duke bërë ndryshimet ose interpretimet përkatëse *(shih vendimin nr. 44, datë 16.07.2014, paragrafët 28-30, të GJK-së).*

B- PENALE

a) Për Gjykatën e Lartë

16. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të sigurisë juridike, pasi kur janë dhënë vendimet gjyqësore nga gjykatat e faktit për shpalljen fajtor dhe dënimin e kërkuesit për kryerjen e veprës penale "Mbajtja pa leje të armëve luftarake dhe municionit", të parashikuar nga neni 278, pika 4, i KP-së në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale (2014), vendimi i Gjykatës Kushtetuese që shfuqizonte paragrafin 5 të nenit 278 të KP-së nuk kishte hyrë në fuqi. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka konstatuar se në kohën e shqyrtimit të rekursit (datë 06.07.2021) në Gjykatën e Lartë, si vendimi nr. 9, datë 26.02.2016 i Gjykatës, ashtu edhe ndryshimet ligjore që u bënë në zbatim të këtij vendimi (ligjet nr. 82/2016 dhe nr. 44/2019), të cilat ndryshuan paragrafin 5 të nenit 278 të KP-së, kishin hyrë në fuqi. Në vlerësimin e gjykatës pretendimi i kërkuesit për cenimin e sigurisë juridike është i bazuar, me argumentin se vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.02.2016 duhej të ishte trajtuar nga Gjykata e Lartë në kuadër të efektit prapaveprues të tij në këtë rast. Kjo do t'i shërbente edhe garantimit të parimit të sigurisë juridike në fushën penale, i cili sipas jurisprudencës kushtetuese është një nga elementet e shtetit të së drejtës dhe duhet të mbahet parasysh nga ligjvënësi në përcaktimin e dënimit, çka i mundëson gjyqtarit të bëjë gjykim të drejtë dhe proporcional në raste konkrete *(shih vendimin nr. 10, datë 12.04.2022 paragrafi 46, të GJK-së).*

C- ADMINISTRATIVE

a) Për gjykatat e faktit

17. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të sigurisë juridike, pasi gjykatat administrative nuk kanë pranuar të shqyrtojnë vendimin e marrë nga Drejtoria Tatimore Rajonale Tiranë për detyrimet tatimore të kërkueses bazuar në një ligj të pezulluar nga Gjykata. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim, duke argumentuar se zbatimi nga administrata tatimore i dispozitave të një ligji të pezulluar nga Gjykata dhe më pas mosriparimi i kësaj situate nga gjykatat, në përmbushje të rolit të subsidiaritetit, dëshmon se gjykatat nuk kanë ushtruar kontroll efektiv për ndërhyrjen që administrata tatimore ka bërë tek e drejta e pronës së kërkueses, për rrjedhojë kanë cenuar sigurinë juridike. Duke cenuar sigurinë juridike, gjykatat administrative nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre për realizimin e një procesi të rregullt ligjor dhe gjykimi të drejtë sipas nenit 42 të Kushtetutës, të lidhur me parimin themelor të shtetit të së drejtës dhe të ligjshmërisë të sanksionuar nga neni 4 i Kushtetutës *(shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021, paragrafi 28, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

18. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të sigurisë juridike, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vitin 2008 e ka kthyer për rishqyrtim vendimin e KSHC-së, ndërsa në vitin 2015 e ka konsideruar titull ekzekutiv. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i viti 2015 nuk e cenon kërkuesin në të drejtat e tij të fituara me vendimet gjyqësore të mëparshme. Në arsyetimin e tij Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në mënyrë të përmbledhur shprehet: "Konflikti i personit të tretë me palën e paditur është zgjidhur administrativisht dhe gjyqësisht në proceset e mëparshme administrative. Për këtë është lëshuar edhe urdhri i ekzekutimit përkatës, si dhe akti i emërimit nga DAP-i. Në kushtet kur ministria nuk ka zbatuar urdhrin e nxjerrë nga DAP-i, vlerësojmë se nuk ka vend për ngritjen e padisë, por për ndjekjen nga personi i tretë (kërkuesi) të procedurave të ekzekutimit të titullit ekzekutiv nga shërbimi përmbarimor". Për sa më sipër, Gjykata konstaton se me këtë vendim Gjykata e Lartë ka rikonfirmuar faktin e të drejtave të fituara të kërkuesit nga vendimet e mëparshme gjyqësore *(shih vendimin nr. 50, datë 03.07.2017, paragrafi 29, të GJK-së).*

19. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të sigurisë juridike, pasi Gjykata e Lartë ka anashkaluar dhe nuk ka pasur parasysh urdhërimet dhe dispozitivin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke anashkaluar edhe të gjitha pasojat ligjore që ka sjellë ky vendim. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se edhe pse Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje për shqyrtimin e një rekursi që kundërshton një vendim gjyqësor, i cili është shprehur në lidhje me respektimin e afateve ligjore të ankimit, ajo ka vendosur pezullimin edhe të vendimit gjyqësor që ka shqyrtuar themelin e mosmarrëveshjes mes palëve, i cili i përket një procesi gjyqësor të ndryshëm nga ai që është në shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Duke vepruar në këtë mënyrë Gjykata e Lartë ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore në kundërshtim me parimin e gjykatës së caktuar me ligj. Gjykata vlerëson se duke u shprehur për pezullimin e ekzekutimit të një vendimi gjyqësore të formës së prerë, i cili nuk është objekt ankimi dhe shqyrtimi para saj, Gjykata e Lartë ka cenuar, në këtë mënyrë, edhe parimin e sigurisë juridike, i cili, mes të tjerash, garanton qëndrueshmërinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si edhe besueshmërinë e individit te shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Në përfundim, Gjykata ka vlerësuar se pezullimi nga Gjykata e Lartë i një vendimi themeli që ka marrë formë të prerë, pa pasur një rekurs nga palët kundër tij, është një vendim arbitrar, që vjen në kundërshtim me ligjin dhe njëkohësisht cenon parimin kushtetues të gjykatës së caktuar me ligj dhe atë të sigurisë juridike *(shih vendimin nr. 62, datë 31.07.2017, paragrafët 16-18, të GJK-së).*

8. Barazia para ligjit dhe ndalimi i diskriminimit

Neni 18 i Kushtetutës:
1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Në nenin 18 të Kushtetutës garantohet shprehimisht barazia e shtetasve para ligjit. Gjithashtu, në paragrafët 2 dhe 3 të tij ligjvënësi ka garantuar se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Krahas kësaj dispozite kushtetuese qëndron edhe neni 14 i KEDNJ-së, i cili u ndalon shprehimisht shteteve anëtare që të drejtat dhe liritë e garantuara nga kjo konventë t'ua nënshtrojë kritereve të tilla, si: gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, gjuha, besimi ose pikëpamjet politike, si dhe prejardhjes sociale e nacionale, si dhe çdo shkaku tjetër *(shih vendimet nr. 21, datë 18.04.2023, paragrafi 82; nr. 2, datë 18.01.2017, paragrafi 76; nr. 9, datë 26.02.2007, paragrafi 6, të GJK-së).*

2. Parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në/përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë *(shih vendimet nr. 31, datë 04.10.2021, paragrafi 47; nr. 34, datë 10.04.2017, paragrafi 93; nr. 71, datë 02.12.1998, paragrafi 4-5, të GJK-së).*

3. Megjithatë, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përligjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive *(shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023, paragrafi 71; nr. 52, datë 24.07.2017, paragrafi 33; nr. 48, datë 15.11.2013, paragrafi 15, të GJK-së).*

4. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk duhet kuptuar se për çështje gjyqësore të pretenduara identike të ketë zgjidhje të njëllojta nga gjykatat. Mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, sepse çdo çështje konkrete është specifike dhe

ka individualitetin e saj të harmonizuar me rrethana, faktorë, motive apo prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë absolutisht të njëllojta. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk ka të bëjë me mënyrën se si është zgjidhur çështja në themel, por me garancitë ligjore, me të drejtat që shteti ka vënë në dispozicion të qytetarëve të tij për zgjidhjen e problemeve të tyre *(shih vendimin nr. 71, datë 02.12.1998, paragrafët 4-5, të GJK-së).*

b. Precedentët ku çështja e cenimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit është vënë në diskutim

A– CIVILE

a) Për Gjykatën e Lartë

5. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së shtetasve para ligjit, pasi Gjykata e Lartë në çështje analoge ka mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me kërkesat për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për sa i përket trajtimit të provave të reja të gjetura e të tërhequra në një kohë të mëvonshme nga AQSH-ja, të cilat qëndrojnë në bazë të kërkesës për rishikim. Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur të provojë se në çështjen objekt shqyrtimi është cenuar parimi i barazisë së shtetasve përpara ligjit *(shih vendimin nr. 52, datë 24.07.2017, paragrafi 34, të GJK-së).*

B – ADMINISTRATIVE

a) Për Gjykatën e Lartë

6. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të barazisë së shtetasve para ligjit, pasi gjykatat kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në çështje të ngjashme me atë të kërkuesit, sepse për një kandidate tjetër, të dënuar me vendim penal të formës së prerë, e cila, ashtu si në rastin e tij, është pezulluar, është lejuar vijimi i kandidimit. Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim. Gjykata arsyeton se si vendimi i dhënë nga Gjykata e Lartë ndaj kërkuesit, ashtu edhe ai për kandidaten tjetër, janë marrë nga i njëjti trup gjykues. Në të dyja rastet, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se si para, ashtu edhe pas ndryshimeve të ligjit nr. 96/2016, qëllimi i ligjvënësit ka qenë ndalimi i futjes në sistemin gjyqësor të personave të dënuar me vendim penal të formës së prerë. Sipas gjykatës, ndryshimet e ligjit kanë parashikuar një element favorizues, duke i dhënë hapësirë diskrecionare organit për të vlerësuar kriterin ndalues vetëm për ato dënime që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose të prokurorit apo dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Po kështu, Gjykata e Lartë ka çmuar se elementet që duhet të merren në konsideratë nga këshilli ose Gjykata Administrative e Apelit, për të vlerësuar nëse ekzistenca e rekordeve penale në ngarkim të kandidatit për magjistrat është ose jo në përputhje me integritetin e nevojshëm për ushtrimin e detyrës, do të çmohen rast pas rasti, duke pasur në vëmendje parimin thelbësor se në një

demokraci funksionale besimi i publikut në integritetin e sistemit gjyqësor është jetik. Gjykata konstaton se specifikat e çështjes së kërkuesit dhe asaj të kandidates tjetër janë të ndryshme. Në rastin e kërkuesit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se "Vjedhja" përbën një vepër të rëndë penale, e cila realizohet me dashje, të tillë që diskrediton figurën e funksionarit publik, për më tepër kur i atribuohet figurës së një gjyqtari ose prokurori. Ndërsa në rastin e kandidates tjetër, të dënuar për veprën penale "Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt", është vlerësuar se për nga efekti, mënyra e kryerjes dhe pasojat nuk reflekton elemente të një sjelljeje diskrediituese të funksionit shtetëror, që mund të përbëjë rrezik për cenimin e interesave shtetërore. Gjykata vlerëson se interpretimi që Gjykata e Lartë i ka bërë nenit 28, shkronja "d", të ligjit nr. 96/2016, në drejtim të kufizimit të së drejtës së kërkuesit për të ndjekur formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për shkak të dënimit penal të tij me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, nuk rezulton të ketë cenuar parimin e barazisë së individëve përpara ligjit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës *(shih vendimin nr. 17, datë 23.03.2023, paragrafët 73 dhe 76, të GJK-së).*

9. E drejta e ankimit

Neni 43 i Kushtetutës:
Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. E drejta e ankimit është vlerësuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individit) të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Pra, me Kushtetutë, kujtdo i garantohet e drejta për t'u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile /penale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë *(shih vendimet nr. 23, datë 25.04.2023, paragrafi 25; nr. 24, datë 25.04.2016, paragrafi 23; nr. 14, datë 05.07.2005, paragrafi 1, të GJK-së).*

2. E drejta e ankimit është një e drejtë procedurale, që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se "...nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit". Në këtë kuptim, në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë para së gjithash në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë. Aksesi në gjykatë është një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për proces të rregullt ligjor *(shih vendimet nr. 10, datë 13.02.2017, paragrafi 65; nr. 14, datë 26.03.2012, paragrafi 10; nr. 7, datë 11.03.2008, paragrafi 10, të GJK-së).*

3. Sipas nenit 43 të Kushtetutës, kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, sipas të cilit kufizimi i të drejtave vendoset vetëm me ligj, për një interes publik dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Rastet dhe mjetet e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore

përcaktohen me ligj, pra është ligji ai që njeh, garanton dhe kufizon të drejtën e palës për të kundërshtuar një vendim të gjykatës më të ulët në një gjykatë më të lartë, duke mos e lënë këtë çështje në diskrecion të gjykatës *(shih vendimet nr. 23, datë 25.04.2023, paragrafi 24; nr. 24, datë 25.04.2016, paragrafi 23; nr.2, datë 18.01.2017, paragrafi 65, të GJK-së).*

b. Precedentët ku çështja e cenimit të së drejtës së ankimit është vënë në diskutim

A- CIVILE

a) Për gjykatat e faktit

4. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së ankimit, pasi Gjykata e Apelit Tiranë gjatë gjykimit të çështjes nuk ka pasqyruar pretendimet për mospërmbushjen e detyrave të lëna pas kthimit të çështjes për rigjykim dhe as i ka analizuar ato. Sipas kërkueses, këto të drejta nuk janë respektuar as gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, gjë që ka sjellë cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim, me argumentin se pretendimi i kërkueses ka të bëjë me çështje të interpretimit të ligjit dhe të zbatimit të tij në çështjet konkrete, si dhe me vlerësimin e fakteve dhe të rrethanave dhe si i tillë i takon juridiksionit të gjykatave të zakonshme *(shih vendimin nr. 10, datë 13.02.2017, paragrafi 31, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

5. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së ankimit efektiv, pasi në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk janë paraqitur në mënyrë të plotë të gjitha shkaqet e ngritura në rekurs, duke krijuar bindjen te kërkuesi se Gjykata e Lartë nuk i ka vlerësuar këto shkaqe. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se Gjykata e Lartë ka paraqitur si shkaqe të rekursit fragmente të marra verbatim/ tekstualisht nga ankimi i bërë nga kërkuesi në gjykatën e apelit. Duke krahasuar shkaqet që kërkuesi ka parashtruar në rekurs me ato që janë paraqitur nga Gjykata e Lartë në pjesën hyrëse të vendimit të saj, konstatohet një mospërputhje në përmbajtje, e cila nuk mund të anashkalohet dhe që qartazi ka rezultuar nga një kopjim tekstual i shkaqeve të ankimit. Gjykata vlerëson se kjo mangësi është një e metë serioze e arsyetimit, që lë shkas për ekuivoke e dyshime në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin e pretendimeve të kërkuesit nga ana e Gjykatës së Lartë. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata konkludon se mënyra e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, jo vetëm nuk përmbush kriteret minimale ligjore të arsyetimit të vendimit gjyqësor, por krijon, gjithashtu, dyshime, ndër të tjera, edhe për realizimin efektiv të së drejtës së ankimit dhe së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata *(shih vendimin nr. 29, datë 22.05.2015, paragrafi 16, të GJK-së).*

6. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së ankimit efektiv, pasi vendimi i Kolegjit Civil për mospranimin e rekursit nuk përmban shkaqet e rekursit. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata çmon se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përbën një të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës. Gjykata, nisur dhe nga sa u argumentua më lart, çmon gjithashtu se prima facie mosparaqitja në vendimin e Kolegjit Civil të shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi në rekurs krijon dyshime edhe për cenimin e së drejtës së ankimit efektiv, si dhe të së drejtës për t'u dëgjuar, të pretenduara nga kërkuesi. Në këtë këndvështrim, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor *(shih vendimin nr. 3, datë 19.02.2013, paragrafët 24 -25, të GJK-së).*

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së ankimit efektiv, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka pushuar çështjen me arsyetimin se mungon ankimi. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka konstatuar se kërkuesi ka bërë rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, me të cilin janë konstatuar si të pavlefshëm titujt ekzekutivë për borxhin doganor të subjektit të interesuar. Rekursi i paraqitur në gjykatë mban datën e përpilimit 27.02.2005, ndërsa administrata gjyqësore, ndonëse e ka marrë rekursin, ka shënuar si datë pranimi datën 28.02.2005, që është ditë e shtunë, pra ditë pushimi, ku institucionet zyrtarisht nuk funksionojnë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke pranuar si ditë paraqitjeje datën 28.02.2005, e konsideron jashtë afatit dorëzimin e rekursit në gjykatë. Gjykata ka theksuar se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë nuk mund t'i cenohen kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë apo gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore. Kështu, vetë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, megjithëse ka pranuar se rekursi është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë në ditë pushimi, se ai mban siglën e punonjësit të gjykatës të ngarkuar me pranimin e rekurseve dhe se administrata gjyqësore nuk e ka evidentuar këtë dorëzim rekursi në regjistrat e saj, në vend që të pranonte shqyrtimin e rekursit në seancë gjyqësore, e ka refuzuar atë duke i mohuar kërkuesit të drejtën e ankimit dhe atë të aksesit në Gjykatën e Lartë. Duke u nisur nga sa më sipër, Gjykata arriti në përfundimin se rekursi duhet konsideruar se është paraqitur në afat dhe si rrjedhojë duhet pranuar për shqyrtim *(shih vendimin nr. 22, datë 26.07.2006, paragrafët 8-10, të GJK-së).*

B- PENALE

a) Për gjykatat e faktit

8. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së ankimit efektiv, pasi Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar pretendimin e kërkuesit të ngritur në apelim për padrejtësinë e vendimit të gjykatës së shkallës së parë për refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar. Gjykata konstaton se shkaku për të cilin Gjykata e Apelit ka vendosur ta konsiderojë të pabazuar pretendimin e ngritur në ankim nga kërkuesi për padrejtësinë e vendimit për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, ka qenë vlerësimi i saj se disponimi në

lidhje me pranimin ose jo të kërkesës për gjykim të shkurtuar është atribut i gjykatës së shkallës së parë. Kjo do të thotë se, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit Durrës, vendimi i gjykatës së shkallës së parë, lidhur me refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, të mos i nënshtrohet kontrollit juridiksional në shkallë të dytë. Në opinionin e Gjykatës, kjo do të thotë që mungesa e kontrollit në shkallë të dytë të këtij vendimi refuzimi mohon aksesin për një gjykim në shkallë të dytë lidhur me pretendimet për mosrespektimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e dënimit. Për pasojë, Gjykata konkludon se, në vetvete, ky qëndrim i gjykatës së apelit i ka cenuar kërkuesit të drejtën kushtetuese të aksesit dhe të ankimit në një gjykatë më të lartë *(shih vendimin nr. 21, datë 16.04.2012, paragrafët 5-6, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

9. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së ankimit efektiv dhe aksesit, pasi megjithëse pretendimet për mbledhjen e provave në mënyrë të paligjshme janë ngritur në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë nga mbrojtësi i kërkuesit, Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e tij. Gjykata ka vlerësuar se në këndvështrim të së drejtës së aksesit, Gjykata e Lartë, rast pas rasti, duhet t'u japë përgjigje problemeve ligjore që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit. Duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, kërkuesit i cenohet jo vetëm e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, por edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës. Në vlerësimin e kësaj Gjykate, kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor *(shih vendimin nr. 8, datë 19.03.2018, paragrafi 25, të GJK-së).*

10. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së ankimit efektiv, pasi edhe pse kishin kaluar 7 muaj nga data e marrjes së vendimit të mospranimit të rekursit nga Kolegji Penal, ky vendim ende nuk ishte zbardhur në momentin e marrjes dijeni prej kërkuesit. Gjykata ka vlerësuar se pretendimi i kërkuesit në lidhje me moszbardhjen e vendimit të Gjykatës së Lartë brenda një kohe të arsyeshme ka të bëjë me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe ankimin efektiv. Pasja e një vendimi të zbardhur e lejon kërkuesin të përdorë mjetet ligjore të disponueshme për ta ankimuar atë në shkallët e tjera gjyqësore. Gjykata ka vlerësuar se kur Gjykata e Lartë vendos mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit, nuk ka një seancë publike, nuk ka shpallje të datës ose të përbërjes së dhomës së këshillimit dhe çështja shqyrtohet pa praninë e palëve. Gjykata është shprehur në vendimet e saj se është detyrë e palëve që të ndjekin ecurinë e gjykimit të çështjes së tyre pranë Gjykatës së Lartë. Në çështjen konkrete, Gjykata e ka vlerësuar haptazi të pabazuar këtë pretendim, me argumentin se kërkuesi nuk ka argumentuar cenimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës apo së drejtës së ankimit efektiv për shkak të moszbardhjes në kohë të vendimit të Gjykatës së Lartë *(shih vendimin nr. 47, datë 06.07.2015, paragrafët 10-12, të GJK-së).*

11. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së ankimit efektiv, si rezultat i mospranimit të ankimit ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës me anë të të cilit nuk është pranuar gjykimi i shkurtuar. Gjykata ka vlerësuar se në rastin në shqyrtim, për arsye se gjykimi në shkallën e parë është zhvilluar me rit të zakonshëm, kërkuesit nuk kanë përfituar nga ulja e dënimit me 1/3-ën. Nëse, sipas linjës së arsyetimit të ndjekur nga Gjykata e Lartë, gjykata e apelit nuk ka të drejtë të aplikojë dispozitat procedurale për dënimin e reduktuar, përkatësisht nenin 406/1 të KPP-së, për arsye se në shkallë të parë gjykimi është bërë me rit të zakonshëm, atëherë ankimi ndaj vendimit të ndërmjetëm të mospranimit të gjykimit të shkurtuar nuk do të kishte asnjë vlerë për të pandehurin në funksion të përfitimit të uljes së dënimit. Gjykata çmon, në rastin konkret, se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke penguar ushtrimin në mënyrë efektive të së drejtës për t'u ankuar ndaj vendimit të ndërmjetëm të mospranimit të gjykimit të shkurtuar, ka cenuar të drejtën e ankimit në aspektin substancial. Parimet kushtetuese që garantojnë të drejtën e ankimit duhen zbatuar jo vetëm për sa u përket shkeljeve procedurale, të cilat cenojnë të drejtën e ankimit nga një këndvështrim formal, por edhe kur jemi përpara cenimeve të karakterit substancial, që lidhen ngushtësisht me efektivitetin e mjetit ankimues. Gjykata në jurisprudencën e saj ka tërhequr vëmendjen se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion edhe të garancive të të drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive. Efekti kryesor që sjell aplikimi i gjykimit të shkurtuar është caktimi i një mase dënimi lehtësuese për të pandehurin. Duke pasur parasysh efektet që sjell gjykimi i shkurtuar, për sa i përket ekonomisë gjyqësore dhe veçanërisht masës së dënimit, Gjykata evidenton domosdoshmërinë e shmangies së kufizimeve arbitrare mbi të drejtën e ankimit ndaj vendimit që refuzon këtë lloj gjykimi. Zgjedhja e gjykimit të shkurtuar, si rit procesual, influencon në përllogaritjen/përcaktimin e dënimit, i cili ulet me 1/3-ën nëse procedohet me gjykim të shkurtuar. Pra, kemi të bëjmë me një aspekt të së drejtës materiale që gërshetohet me të drejtën procesuale. Në rastin në shqyrtim, për arsye se gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar me rit të zakonshëm, kërkuesit nuk kanë përfituar nga ulja e dënimit me 1/3-ën. Nëse sipas linjës së arsyetimit të ndjekur nga Gjykata e Lartë, gjykata e apelit nuk ka të drejtë të aplikojë dispozitat procedurale për dënimin e reduktuar, përkatësisht nenin 406/1 të KPP-së, për arsye se në shkallë të parë gjykimi është bërë me rit të zakonshëm, atëherë ankimi ndaj vendimit të ndërmjetëm të mospranimit të gjykimit të shkurtuar nuk do të kishte asnjë vlerë për të pandehurin në funksion të përfitimit të uljes së dënimit *(shih vendimin nr. 14, datë 26.03.2012, paragrafët 22-23, të GJK-së).*

C- **Administrative**

a) Për gjykatat e faktit

12. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së ankimit efektiv, sepse gjykata për llogaritjen e vlerës së dëmit ose të detyrimit në raport me pagën minimale në shkallë vendi duhet të caktonte një ekspert, duke qenë se shuma reale për t'u paguar ka qenë më e lartë se njëzetfishi i pagës minimale. Gjykata e ka vlerësuar si haptazi të pabazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se kërkuesi i referohet shkresës së Drejtorisë

së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Verior, e cila nuk ka qenë objekt i procesit gjyqësor të kundërshtuar në këtë Gjykatë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër në përcaktimin e vlerës së kërkesëpadisë i është referuar aktit administrativ të DRT-së, Lezhë, objekt i atij gjykimi, në bazë të të cilit është shprehur në lidhje me të drejtën e ankimit gjyqësor të kërkuesit. Për rrjedhojë, Gjykata vëren se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka disponuar për të drejtën e ankimit sipas objektit të kërkesëpadisë së paraqitur përpara saj, bazuar në aktin administrativ objekt gjykimi. Për këtë arsye, pretendimi i tij për vlerën më të lartë të objektit të kërkesëpadisë është haptazi i pabazuar. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë, të lidhur me të drejtën e aksesit, është haptazi i pabazuar *(shih vendimin nr. 9, datë 23.02.2023, paragrafët 54-55, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

13. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së ankimit efektiv, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit, ndonëse në të janë parashtruar shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 që çonin në prishjen e vendimeve të kundërshtuara. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se në ndryshim nga sa parashtron kërkuesja, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pas vlerësimit paraprak të shkaqeve të rekursit, ka çmuar se në të nuk ngrihen shkaqe të bazuara në ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Arritja në një përfundim të tillë nuk bie ndesh, përkundrazi, është në harmoni dhe në përputhje me ligjin procedural dhe jurisprudencën kushtetuese. Gjykata rithekson se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërinë e tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Për më tepër, pas ndryshimeve të bëra në KPC me ligjin nr. 44/2021, të zbatueshme edhe për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, krahas mospranimit të rekursit, mund të vendosë edhe sipas çdo mënyre tjetër disponimi (përcaktuar në nenin 63 të ligjit nr. 49/2012) që më herët ligji ia kishte atribuuar shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Duke u dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura në rekurs nga kërkuesja, në përputhje me detyrimin ligjor, sipas nenit 473/a, pika 1, të KPC-së, Gjykata e Lartë i ka garantuar asaj të drejtën e aksesit në drejtim të së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë dhe të mbrojtjes efektive *(shih vendimin nr. 5, datë 09.02.2023, paragrafi 48, të GJK-së).*

14. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së ankimit efektiv, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet të zbatonte vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të kësaj gjykate nr. 3/2013, sipas të cilit kufizimi i së drejtës së ankimit nuk mund të shtrihet ndaj ankimeve të ushtruara para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se Gjykata Administrative e Apelit, pasi ka pranuar pjesërisht padinë e kërkuesit, ka vendosur se kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë. Ndërkohë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka

vlerësuar se përmbushen kushtet ligjore në lidhje me kufirin monetar të parashikuar nga neni 56, shkronja "ç", i ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit nuk lejohet rekurs ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës Administrative të Apelit për mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi. Ajo ka argumentuar se në kohën e ushtrimit të rekursit, dyzetfishi i pagës minimale ishte në vlerë më të lartë se vlera e objektit të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, për rrjedhojë vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i paankimueshëm në Gjykatën e Lartë. Gjykata konstaton se edhe pse ka qenë Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka orientuar kërkuesin të ushtrojë të drejtën e rekursit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka vlerësuar bazueshmërinë e shkaqeve të ngritura në rekurs nga kërkuesi, por është ndalur në faktin se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i paankimueshëm. Gjykata vlerëson se kufizimi i parashikuar nga neni 56, shkronja "ç", i ligjit nr. 49/2012 nuk është zbatuar nga Gjykata e Lartë në nivel të mjaftueshëm qartësie. Mënyra e zbatimit të ligjit nga ajo gjykatë në dukje është e paarsyetuar dhe ka vendosur ndaj kërkuesit një barrë joproporcionale, e cila nuk respekton në këtë mënyrë balancën e drejtë dhe të nevojshme midis qëllimit legjitim për të garantuar respektimin e kushteve formale për të paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, nga njëra anë, dhe së drejtës për t'iu drejtuar asaj gjykate, nga ana tjetër. Gjykata çmon se Gjykata e Lartë duhet të arsyetonte se përse në llogaritjen e vlerës së mosmarrëveshjes, që përcakton ankueshmërinë ose jo të vendimit të apelit, i është referuar dispozitivit të vendimit të apelit dhe jo vlerës së mosmarrëveshjes që rezulton nga kërkesëpadia. Një arsyetim i tillë, jo vetëm do t`i bënte të kuptueshme arsyet e qëndrimit të Gjykatës së Lartë, por edhe do ta përligjte vendimmarrjen e saj. Prandaj, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë duke mos arsyetuar qëndrimin e tij, si dhe duke mos i dhënë për këtë arsye përgjigje përfundimtare shkaqeve të paraqitura në rekurs, nuk plotëson kërkesat për proces të rregullt ligjor, si dhe krijon paqartësi, duke i cenuar kërkuesit edhe të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë, edhe të drejtën e aksesit *(shih vendimin nr. 23, datë 25.04.2023, paragrafët 33-34, të GJK-së).*

15. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së ankimit efektiv, pasi Gjykata e Lartë nuk e zgjidhi çështjen me arsyetim pavarësisht se gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit kanë dhënë vendime diametralisht të kundërta. Gjykata rikonfirmoi qëndrimin se çështja e pranisë së dy vendimeve diametralisht të kundërta është vlerësuar nën dritën e së drejtës së aksesit dhe asaj të ankimit në kuptimin substancial, si edhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Bazuar në këtë argumentim Gjykata u shpreh se Gjykata e Lartë, në vendimin e mospranimit të rekursit, ka parashtruar rrethanat dhe faktet e çështjes, si dhe ka listuar pretendimet e kërkuesit në rekurs, pjesa më e madhe e të cilave lidhet me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të nenit 314 të KPC-së. Arsyetimi i këtij vendimi është i kufizuar, duke u mjaftuar me qëndrimin se përfundimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, ndonëse gjendej përpara interpretimit diametralisht të kundërt të ligjit prej dy gjykatave më të ulëta, nuk u ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuesit *(shih vendimin nr. 12, datë 15.03.2023, paragrafët 23-24, të GJK-së).*

10. Procedimi/seanca publike

a. Precedentët ku çështja e cenimit të së drejtës për seancë publike është vënë në diskutim

1. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për të pasur një gjykim publik nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë për shkak të gjykimit të çështjes në dhomën e këshillimit. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se nenet 49 dhe 61 të ligjit nr. 49/2012 kanë përcaktuar shqyrtimin e çështjeve nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë, si rregull, në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve dhe në seancë gjyqësore me prani të palëve në rastet e parashikuara nga nenet 51, pika 1 dhe 62, pika 1, të po këtij ligji. Duke pasur parasysh parashikimet ligjore konkrete dhe faktin që pretendimet e parashtruara nga kërkuesja në gjykimin në apel dhe në Gjykatën e Lartë janë marrë parasysh nga këto gjykata, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka arritur të përcaktojë cenimin e së drejtës së aksesit si rrjedhojë e gjykimit të çështjes në dhomën e këshillimit. Nga ana tjetër, ashtu siç Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj, procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt për sa kohë që në një shkallë gjykimi është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës kërkueses i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar dhe mbrojtur *(shih vendimin nr. 27, datë 18.05.2023, paragrafi 21, të GJK-së).*

IV.

2. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për të pasur një gjykim publik për shkak të gjykimit të çështjes në dhomën e këshillimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë, duke zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, nuk i ka krijuar mundësi kërkuesit të parashtrojë pretendimet e tij, duke i mohuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtur. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Duke mbajtur në konsideratë që Gjykata e Lartë sipas Kushtetutës vepron si gjykatë ligji (pra nuk merret me shqyrtim provash, dëgjim dëshmitarësh dhe përcaktim faktesh), Gjykata vlerëson se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë nuk rezulton të jenë cenuar rregullat procedurale për njoftimin e zhvillimit të seancës gjyqësore, si dhe duke pasur parasysh gjykimin e zhvilluar në dhomën e këshillimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, kërkuesit i është krijuar mundësia për të paraqitur argumentet e tij me shkrim. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se edhe në tërësi procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë në një shkallë gjykimi (në gjykatën e apelit) është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës kërkuesi ka qenë i përfaqësuar me avokat, duke i krijuar mundësinë për t'u dëgjuar dhe mbrojtur *(shih vendimin nr. 28, datë 01.11.2022, paragrafi 63, të GJK-së).*

3. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për të pasur një gjykim publik, pasi gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, në dhomën e këshillimit, i ka mohuar kërkuesit të drejtën e një gjykimi publik dhe të drejtën e ankimit. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se verifikimi nëse rekursi i plotëson ose jo kushtet për shqyrtim është atribut i dhomës së këshillimit dhe jo i seancës gjyqësore dhe se veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës

apo të asaj për një gjykim publik, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj *(shih vendimet nr. 4, datë 25.02.2009; nr. 5, datë 26.01.2007; nr. 8, datë 02.05.2006 të GjK-së)*. Gjykata, gjithashtu, konstaton se kërkuesi e ka ushtruar lirisht të drejtën e ankimit nëpërmjet rekursit në Gjykatën e Lartë. Kolegji Penal i kësaj Gjykate ka vendosur mospranimin e rekursit për mungesë të shkaqeve të parashikuara nga ligji. Në këtë këndvështrim, Gjykata e Lartë ka ushtruar funksionin e saj si gjykatë e ligjit. E drejta e ankimit nuk presupozon që gjykata duhet ta kalojë çështjen në seancë ose të pranojë kërkimet e palëve në çdo rast. Si rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit është i pabazuar *(shih vendimin nr. 45, datë 23.07.2012, paragrafët 17–18, të GJK-së).*

B. Afati i arsyeshëm për gjykimin dhe për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë

Neni 42, pika 2, i Kushtetutës:
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. E drejta për një proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme *(shih vendimet nr. 33, datë 01.11.2021, paragrafi 27; nr. 22, datë 20.03.2017, paragrafi 11; nr. 12, datë 05.03.2012, paragrafi 12, të GJK-së).*

2. Në vlerësimin e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) si dhe çfarë përbën rrezik për kërkuesin *(shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023, paragrafi 39; nr. 17, datë 29.06.2022, paragrafi 24; nr. 18, datë 19.07.2005, paragrafi 7, të GJK-së).*

3. Edhe ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre *(shih vendimet nr. 75, datë 23.11.2017, paragrafi 13; nr. 1, datë 19.01.2009, paragrafi 2.1.; nr. 6, datë 31.03.2006, paragrafi 34, të GJK-së).*

4. Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës, që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë edhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ai që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës *(shih vendimet nr. 79, datë 27.12.2016, paragrafët 13 -14; nr. 20, datë 04.04.2014, paragrafi 18; nr. 6, datë 31.03.2006, paragrafi 13, të GJK-së).*

B.1 - Përcaktimi i kohëzgjatjes së procedimeve

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Kohëzgjatja e gjykimit normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi *(shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022 paragrafi 34; nr. 4, datë 20.02.2013, paragrafi 11; nr. 6, datë 31.03.2006, paragrafi 26, të GJK-së).*

2. Në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 25, datë 11.05.2023, paragrafi 57; nr. 2, datë 17.02.2022, paragrafi 2, të GJK-së).*

b. Precedentët ku çështja e cenimit të afatit së arsyeshëm është vënë në diskutim

3. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, pasi proceset gjyqësore kanë zgjatur rreth 19 vjet. Gjykata ka çmuar se ky pretendim i kërkuesve është i pabazuar. Gjykata vëren se procesi gjyqësor për të cilin kërkuesit kanë paraqitur kërkesë në Gjykatë ka nisur në vitin 2014 me kërkesëpadinë e paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka marrë vendimin në vitin 2015. Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim kërkuesit dhe gjykata e apelit, pasi ka përfunduar shqyrtimin e çështjes, ka dhënë vendimin në vitin 2016. Kërkuesit kanë bërë rekurs kundër këtij vendimi dhe Gjykata e Lartë është shprehur për çështjen me vendimin e vitit 2017. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se i gjithë procesi gjyqësor për të cilin kërkuesit kanë paraqitur pretendime nëpërmjet kërkesës së tyre në këtë Gjykatë ka zgjatur rreth 3 vjet. Në vlerësimin e Gjykatës kjo është një periudhë kohore e arsyeshme për shqyrtimin e çështjes nga gjykatat e zakonshme, për më tepër që ajo nuk ka konstatuar cenim të së drejtës së pronës në procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkuesve *(shih vendimin nr. 2, datë 11.02.2021, paragrafi 46, të GJK-së).*

4. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, pasi gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është kryer brenda afatit të përcaktuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon se Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit nga gjykata ku ai është depozituar. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka konstatuar se Gjykata e Lartë kishte marrë vendim për çështjen 3 vjet pas regjistrimit të saj, çka në raport me afatin ligjor 90-ditor është një kohëzgjatje e paarsyeshme *(shih vendimin nr. 16, datë 16.03.2021, paragrafi 32, të GJK-së).*

➢ *Sjellja e kërkuesit*

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Vlerësimi i sjelljes së kërkuesit është element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit, duke analizuar rrethanat nëse kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse ai është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim *(shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022, paragrafi 40; nr. 24, datë 27.04.2015, paragrafi 22; nr. 1, datë 19.01.2009, paragrafi 2.4, të GJK-së).*

b. Precedentët ku sjellja e kërkuesit është vënë në diskutim

2. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm. Gjykata vlerëson se është kërkuesi që është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ai ka ngritur disa herë pretendime të paarsyeshme. Nga njëra anë ka pretenduar disa herë se nuk po i lidhej kontrata, kurse nga ana tjetër nuk e ka argumentuar se pse nuk e lidh kontratën e shitjes përkundrejt vlerës prej 10.889 lekësh për një apartament 2+1, ku ai banon prej më shumë se 17 vjetësh, pa bërë ndonjë pagesë tjetër. Pala shitëse nuk mund të detyrohet të deklarojë në kontratën e shitjes fakte që realisht nuk varen prej saj *(shih vendimin nr.15, datë 30.03.2015, paragrafi 29, të GJK-së).*

3. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm. Gjykata vëren se kërkuesja ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim. Për sa i përket kriterit të interesit për kërkuesen dhe rrezikut që passjell tejzgjatja e procedurave për të, Gjykata vlerëson se çështja konkrete është e një natyre të tillë që interesi i kërkueses nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore nuk rrezikohet në shkallë të konsiderueshme, për sa kohë që në padinë e saj ajo ka kërkuar detyrimin e shoqërisë së paditur, "Banka e Tiranës" sh.a., për shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të shkaktuar nga veprimet me faj dhe fitimin e munguar, si dhe për kamatat ligjore sipas normës Tribor njëditor të vendosur nga Banka e Shqipërisë, deri në datën e ekzekutimit të vendimit të gjykatës *(shih vendimin nr. 34, datë 01.11. 2021, paragrafi 62, të GJK-së).*

4. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm. Gjykata vëren se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim, përkundrazi nuk e ka humbur interesin, madje e ka shfaqur atë në mënyrë të pandërprerë, duke kërkuar edhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes. Për sa i përket kriterit të interesit për kërkuesin dhe rrezikut që passjell tejzgjatja e procedurave për të, Gjykata vlerëson se çështja konkrete është e një natyre të tillë që interesi i kërkuesit nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore rrezikohet në shkallë të konsiderueshme, për sa kohë objekti i kërkesëpadisë së tij ka të bëjë me të drejta vetjake siç është përfitimi i pensionit. Nga ana tjetër, nga pikëpamja e shpejtësisë në gjykim, Gjykata evidenton se në parim çështjet administrative ligjvënësi i ka përcaktuar si çështje që kërkojnë shpejtësi në gjykimin e tyre, duke parashikuar afate më të shpejta gjykimi *(shih vendimin nr. 35, datë 01.11.2021, paragrafët 51-52, të GJK-së).*

5. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm. Gjykata vëren se kërkuesit kanë vepruar në përputhje me të drejtat procedurale dhe nuk rezulton të jenë bërë shkak ose të kenë shkaktuar vonesa në këtë drejtim. Për sa i përket kriterit të interesit për kërkuesit dhe rrezikut që passjell tejzgjatja e procedurave për ta, Gjykata vëren se në

kuptim të dispozitave procedurale të KPC-së, e drejta për shpërblim për shkeljen e afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes lind për secilën palë në proces që provon ardhjen e dëmit pasuror ose jopasuror, pra provon se është viktimë e shkeljes së të drejtave kushtetuese *(shih vendimin nr. 37, datë 05.11.2021, paragrafi 46, të GJK-së).*

➢ ***Kompleksiteti i çështjes***

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumin dhe natyrën e provave, llojin dhe ndërthurjen e ligjeve të zbatueshme, si dhe numrin e palëve pjesëmarrëse në proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, sepse balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë *(shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023, paragrafi 27; nr. 2, datë 17.02.2022, paragrafi 43; nr. 12, datë 05.03.2012, paragrafi 21, të GJK-së).*

b. Precedentët ku kompleksiteti i çështjes është vënë në diskutim

2. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se edhe pse në gjykim janë thirrur një numër jo i vogël palësh ndërgjyqëse, që përkon me numrin e trashëgimtarëve të pasurisë, në thelb, çështja e ndreqjes së gabimeve materiale ka natyrë procedurale civile. Ajo ka vetëm një kërkim në objektin e saj – atë për ndreqjen e gabimit të vendimit gjyqësor përfundimtar bazuar në dispozitat e KPC-së dhe të KC-së. Ky kërkim përfshin verifikimin formal të vendimit gjyqësor përfundimtar dhe numrit të trungjeve të trashëgimlënësit, në raport me pretendimin për përllogaritje të gabuara, që ka shkaktuar përcaktimin e pasaktë të pjesëve të pasurisë trashëgimore. Gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit janë shprehur me vendim rrëzimi për kërkesën për ndreqje gabimi material, me arsyetimin e njëjtë se pretendimet nuk kishin të bënin me gabimet materiale, por lidheshin me themelin e mosmarrëveshjes së zgjidhur me vendim gjyqësor përfundimtar. Gjithashtu, Gjykata vëren se në rekurs janë ngritur pretendime që lidhen me arsyetimin e gjykatave më të ulëta, që sipas rekursuesit është cilësuar i gabuar dhe favorizues për palën kundërshtare. Duke iu referuar aspekteve të mësipërme, Gjykata çmon se çështja e kërkueses nuk paraqitet komplekse që të justifikojë kohëzgjatjen e shqyrtimit të saj prej 5 vjetësh *(shih vendimin nr. 61, datë 20.11.2023, paragrafi 21, të GJK-së).*

3. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë. Gjykata vlerëson të theksojë se kompleksiteti i çështjes nuk mbartet në të njëjtën mënyrë në çdo

shkallë të gjykimit, por varet nga faza në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj dhe shkalla e gjykimit në të cilën kërkohet konstatimi i kohëzgjatjes së paarsyeshme. Me fjalë të tjera, edhe pse kjo çështje, referuar objektit të saj, numrit të palëve ndërgjyqëse dhe volumit të akteve shkresore e dokumenteve të administruara në gjykim, mund të mbartë kompleksitet gjatë gjykimit të saj në gjykatat e faktit, kjo mund të mos jetë e tillë në Gjykatën e Lartë, për shkak të natyrës së atij gjykimi dhe procedurës së gjykimit në dhomën e këshillimit, si dhe funksionit të saj si gjykatë e ligjit, pavarësisht kuadrit ligjor të zbatueshëm dhe ndryshimeve të vazhdueshme e të shpeshta përgjatë viteve si të akteve ligjore, ashtu edhe të atyre nënligjore. Pra, gjykimi në gjykatën e ligjit nuk mund të thuhet se paraqet të njëjtat elemente kompleksiteti si në shkallët e tjera të gjykimit *(shih vendimin nr. 46, datë 03.10.2023, paragrafi 29, të GJK-së).*

4. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit. Për sa i takon kompleksitetit, Gjykata konstaton se nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore konstatohet se çështja ka natyrë administrative, me katër kërkime në objektin e padisë, që përfshijnë zbatimin jo vetëm të rregullave gjyqësore procedurale të ligjit nr. 49/2012, por edhe zbatimin e ndërthurur të një numri të konsiderueshëm ligjesh që lidhen me të drejtat e pronësisë, mënyrat e fitimit të saj, shpronësimin dhe detyrat e disa organeve shtetërore. Gjykata çmon se çështja e kërkueses paraqitet komplekse, por jo në masën që të justifikojë vonesën e gjykimit në shkallë të dytë për më shumë se 4 vjet *(shih vendimin nr. 2, datë 17.02.2022, paragrafi 44, të GJK-së).*

IV.

5. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë. Gjykata, veç faktit se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës civile, vëren, gjithashtu, se palë ndërgjyqëse në këtë proces janë kërkuesja, "Banka … sh.a" dhe KESH-i, të cilët janë persona juridikë që kanë mosmarrëveshje për procedurën e ekzekutimit të një titulli ekzekutiv gjatë një veprimtarie tregtare. Objekti i gjykimit lidhet me pretendimin për shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të shkaktuar kërkueses, fitimin e munguar dhe kamatat ligjore përkatëse, për llogaritjen e të cilave gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje është kryer edhe ekspertizë ekonomike. Gjykata në vijim konstaton se procedurat para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kanë zgjatur përafërsisht 11 muaj, periudhë gjatë së cilës janë zhvilluar 14 seanca gjyqësore. Po ashtu, procedurat para Gjykatës së Apelit Tiranë kanë zgjatur rreth 12 muaj. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë paraqet elemente kompleksiteti *(shih vendimin nr. 34, datë 01.11.2021, paragrafët 21-22, të GJK-së).*

6. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në rastin në shqyrtim vërehet se gjykimi penal i themelit është zhvilluar ndaj gjashtë të pandehurve të cilët janë akuzuar për kryerjen e veprës penale "Vjedhja me dhunë" në bashkëpunim. Nisur nga numri i të akuzuarve dhe provave të administruara për të vërtetuar fajësinë e tyre konkludohet se çështja është komplekse. Gjithashtu, duhet

pasur parasysh se në zgjatjen e procesit ka ndikuar edhe fakti se kjo çështje, mbi bazën e ankimeve/rekurseve, është kthyer për rigjykim. Pra, çështja është gjykuar dy herë në gjykatën e apelit dhe dy herë në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 76, datë 04.12.2017, paragrafi 22, të GJK-së).*

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit brenda afatit të arsyeshëm. Çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë brenda një afati të arsyeshëm në lidhje me dëmshpërblimin që duhet të marrë kërkuesi për shkak të largimit të pajustifikuar nga puna dhe mosrespektimit të procedurave të largimit nga puna. Duke iu referuar materialeve shkresore, Gjykata konstaton se çështja konkrete nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore, çka mund të justifikonte vonesat ose sjelljen mosvepruese të subjektit të interesuar, DPTT-së *(shih vendimin nr. 50, datë 21.11.2013, paragrafi 15, të GJK-së).*

➢ *Sjellja e autoriteteve*

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme *(shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023, paragrafi 48; nr. 12, datë 05.03.2012, paragrafi III.12; nr. 6, datë 31.03.2006, paragrafi 27, të GJK-së).*

2. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre *(shih vendimet nr. 42, datë 19.07.2012, paragrafi 17; nr. 1, datë 19.01.2009, paragrafi 3.2; nr. 6, datë 31.03.2006, paragrafi 34 të GJK-së).*

3. Autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor *(shih vendimet nr. 53, datë 26.07.2016, paragrafi 30; nr. 1, datë 19.01.2009, paragrafi 2.2.; nr. 43, datë 19.12.2007, paragrafi 14 të GJK-së).*

4. Një vonesë në ekzekutim mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës *(shih vendimet nr. 35, datë 18.04.2017, paragrafi 5; nr. 6, datë 07.03.2011, paragrafi II.1.1.; nr. 43, datë 19.12.2007, paragrafi 14 të GJK-së).*

b. Precedentët ku sjellja e autoriteteve është vënë në diskutim

5. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata çmon se edhe pse sistemi gjyqësor në tërësi po përballet me ngarkesë si rezultat i zbatimit të reformës në drejtësi, kjo problematikë e përgjithshme nuk mund të rëndojë ose justifikojë shkeljen e së drejtës kushtetuese të kërkuesve. Sipas Gjykatës, gjykimi administrativ i ankimit të subjekteve të interesuara vazhdon prej më shumë se 3 vjetësh e 7 muajsh pa vendimmarrje në shkallë të dytë, ndonëse ligjvënësi ka parashikuar afate procedurale konkrete në ligjin nr. 49/2012 dhe ndonëse kjo çështje lidhet me shpërblimin e të shpronësuarve padrejtësisht nga shteti. Gjykata arrin në përfundimin se sjellja e autoriteteve shtetërore, në veçanti të atyre që miratojnë ligjet dhe politikat e sistemit të drejtësisë, nuk ka qenë në nivelin e duhur të efikasitetit, duke shkaktuar vonesa të paarsyeshme në gjykimin e çështjes së tyre. Gjykata ka konstatuar cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe ka vendosur detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar brenda 9 muajve çështjen gjyqësore *(shih vendimin nr. 25, datë 11.05.2023, paragrafët 75 -76, të GJK-së).*

6. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit. Gjykata e Lartë e ka rrëzuar kërkesën për përshpejtimin e procedurave. Gjykata vlerëson se argumenti kryesor që qëndron në thelb të interpretimit ligjor të Gjykatës së Lartë për "pamundësinë objektive" që lidhet me ngarkesën e gjykatave, nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë kohëzgjatjen e paarsyeshme të gjykimit. Gjykata rithekson se gjykimi përtej afatit të arsyeshëm, bazuar vetëm në faktin se shteti ka dështuar të marrë masa efikase, që efektet e zbatimit të reformës në drejtësi janë të përkohshme dhe që gjykatat të plotësohen me personel dhe të organizohen në kohën e duhur dhe sipas standardeve kushtetuese, nuk mund të përligjë cenimin e të drejtave kushtetuese të individëve. Për më tepër, mbingarkesa në gjykata është një situatë e njohur dhe e zgjatur në kohë, e cila nuk varet nga kërkuesja, por vetëm nga përgjegjësit e administrimit të sistemit të drejtësisë, detyra e të cilëve është të krijojnë një sistem gjyqësor efikas dhe të pajisur me personel, në mënyrë që t'i përgjigjet më së miri kërkesave të shtetit të së drejtës, ku përfshihet edhe përfundimi i proceseve gjyqësore në përputhje me standardet që imponon e drejta për proces të rregullt, ndërkohë që ky detyrim kushtetues prej tyre nuk rezulton të jetë respektuar. Për rrjedhim, Gjykata ka çmuar se vlerësimi i kryer nga Gjykata e Lartë nuk është në përputhje me Kushtetutën, për këtë arsye vendimi i saj për rrëzimin e kërkesës për përshpejtimin e procedurave duhet të shfuqizohet dhe gjykimi i ankimit të kërkueses nga Gjykata Administrative e Apelit duhet të përshpejtohet duke e gjykuar çështjen brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi *(shih vendimin nr. 2, datë 17.02.2022, paragrafët 57-58, të GJK-së).*

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm në Gjykatën

Administrative të Apelit dhe vlerësimit të kryer nga Gjykata e Lartë në kundërshtim me Kushtetutën. Gjykata ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka rrëzuar kërkesën për përshpejtimin e procedurave, duhet të shfuqizohet dhe gjykimi i ankimit të kërkuesit nga Gjykata Administrative e Apelit duhet të përshpejtohet. Për këtë qëllim të fundit, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata ka çmuar të caktojë afatin 6-mujor, brenda të cilit Gjykata Administrative e Apelit duhet të veprojë. Në vlerësimin e Gjykatës ky afat konsiderohet i arsyeshëm në raport me të drejtën kushtetuese të kërkuesit, por, gjithashtu, u përgjigjet edhe kushteve dhe mundësive aktuale të Gjykatës Administrative të Apelit, e cila është duke shqyrtuar çështjet e regjistruara në periudhën shtator 2016 – shkurt 2017 *(shih vendimin nr. 3, datë 17.02.2022, paragrafi 58, të GJK-së).*

8. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit brenda afatit të arsyeshëm të vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Gjykata ka theksuar se kërkuesit nuk duhet t'i mohohet e drejta për të përfituar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor thjesht duke u mbështetur në argumentin e pamundësisë financiare të shtetit. Në këtë drejtim, në rastet kur debitor është vetë shteti, autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor. Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës *(shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2012, paragrafi 17; nr. 43, datë 19.12.2007, paragrafi 15, të GJK-së).*

- ***Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi***

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Kriteri "interesi i kërkuesit dhe rreziku që passjell tejzgjatja e procedurave për të" përbën një aspekt të rëndësishëm të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit. Disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Në këto raste duhet të merret parasysh ajo çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuesit në procesin gjyqësor, pra rëndësia për kërkuesin e së drejtës objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë" ose kur ekziston mundësia që kërkuesi të ndërrojë jetë deri në përfundim të procedurave, lipset të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë *(shih vendimet nr. 25, datë 11.05.2023, paragrafi 79; nr. 35, datë 01.11.2021, paragrafi 50, të GJK-së).*

2. Për disa çështje ka interes veçanërisht të lartë nisur nga interesi i kërkuesit. Konkretisht, të tilla çështje janë ato që kanë të bëjnë me: mosmarrëveshjet familjare; vërtetimin e amësisë ose atësisë; viktimat e aksidenteve rrugore, të dhunës penale ose dhunës policore; punësimin ose sigurimet shoqërore; heqjen e lejes për të ushtruar profesionin;

qëndrimin e të akuzuarve në paraburgim; çështjet e personave që vuajnë nga sëmundje të pashërueshme; procedurat e kompensimit për dëmtime të shëndetit, në veçanti kur ekziston mundësia që kërkuesi të ndërrojë jetë deri në përfundim të procedurave; mosmarrëveshjet familjare për fëmijët; statusin martesor dhe heqjen ose rivendosjen e aftësisë juridike; çështjet e iniciuara nga të burgosurit për kushte të burgimit, të tilla që cenojnë nenin 3 të KEDNJ-së, të cilat janë edhe më urgjente *(shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2023, paragrafi 58, të GJK-së).*

3. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe verifikimi i interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti. Në zbatim të parimit *minimis non curat praetor*, që pretendimet për cenimin e një të drejte të merren në shqyrtim prej saj, duhet të arrihet një nivel minimal rrezikshmërie. Përcaktimi i këtij niveli minimal është relativ dhe varet nga rrethanat e çështjes konkrete *(shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023, paragrafi 58; nr. 13, datë 26.05.2022, paragrafi 47; nr. 38, datë 02.12.2021, paragrafi 58, të GJK-së).*

b. Precedentët ku vlerësimi i interesit të kërkuesit dhe rrezikut që pasjell tejzgjatja e procedurave është vënë në diskutim

4. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit. Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përshpejtimin e gjykimit. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim dhe ka konstatuar cenimin e së drejtës për proces të rregull ligjor. Gjykata vlerëson se rrethanat familjare të kërkueses janë të veçanta. Ajo është e ve dhe ushtron e vetme përgjegjësinë prindërore për dy fëmijë të mitur. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se çështja e kërkueses lidhet me kompensimin për burgimin e padrejtë të saj gjatë procedimit penal. E drejta e kompensimit të saj gjen mbrojtje specifike edhe nga neni 5, pika 5, i KEDNJ-së. Në këto rrethana, Gjykata çmon se çështja është e një natyre të tillë që vonesa në shqyrtimin e çështjes në vetvete e bën joefektiv mjetin juridik të kompensimit të cenimit të lirisë personale. Gjykata çmon se duhet urdhëruar shqyrtimi i ankimit me përparësi për çështjen e kërkueses, pa pritur radhën sipas kohës së regjistrimit të saj *(shih vendimin nr. 68, datë 07.12.2023, paragrafët 39-40, të GJK-së).*

5. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit brenda afatit të arsyeshëm të vendimit të formës së prerë që parashikon detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë për t'i paguar kërkuesit shumën në të holla si rezultat i ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit në shkelje të ligjit. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se interesi i kërkuesit dhe rreziku që sjell tejzgjatja e procedurave për të përbëjnë një aspekt të rëndësishëm të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurave të ekzekutimit. E drejta e pensionit dhe masa e tij përbëjnë interes vetjakë dhe jetësorë, ndaj një çështje e tillë duhet të trajtohet me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Për më tepër, në rastet e individëve me statusin e ish të përndjekurve politikë dhe të dënuar

padrejtësisht, veprimet e autoriteteve shtetërore, në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe ushtrimit të kompetencave të tyre, duhet të jenë të atilla që të krijojnë lehtësi dhe thjeshtësi për këta individë, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e plotë të tyre në shoqëri. Për rrjedhojë, çështja konkrete është e një natyre të tillë, që interesi i kërkuesit rrezikohet në një shkallë të konsiderueshme nga çdo ditë vonesë e ekzekutimit të vendimit gjyqësor *(shih vendimin nr. 64, datë 30.11.2023, paragrafët 50-52, të GJK).*

6. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë. Kërkuesja pretendon se vonesa e shqyrtimit të çështjes gjyqësore për ndreqjen e gabimeve ka shkaktuar zgjatjen e pezullimit prej 6 vjetësh të çështjes tjetër gjyqësore për pavlefshmërinë absolute të kontratës së dhurimit, duke dëmtuar në këtë mënyrë të drejtën e pronës së saj. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata evidenton se çështjet me objekt ndreqje gabimi janë vlerësuar nga KLGj-ja me natyrë specifike dhe duhet të shqyrtohen shpejt për të shmangur pasojat e rënda për palët në proces dhe për dhënien e drejtësisë dhe kur çështja ka shkaktuar pezullimin e gjykimit të një çështjeje tjetër gjyqësore përbën shkak veçanërisht të rëndë që motivon shqyrtimin e përshpejtuar të saj. Vonesa e shqyrtimit të rekursit për çështjen e ndreqjes së gabimeve materiale ndikon drejtpërdrejt në zgjatjen e pezullimit të shqyrtimit të mosmarrëveshjes për të drejtën e bashkëpronësisë dhe ndarjes së pjesëve takuese mes 11 trashëgimtarëve. Gjykimi i kësaj mosmarrëveshjeje është pezulluar që prej 7 vjetësh në gjykatën e shkallës së parë. Në këtë drejtim duhet vënë në dukje rëndësia e së drejtës së pronës, e cila përbën një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se çështja është e një natyre të tillë që vonesa në shqyrtimin e rekursit sjell dëm jo vetëm për kërkuesen, por për të gjitha palët e përfshira në mosmarrëveshje *(shih vendimin nr. 61, datë 20.11.2023, paragrafët 34 -35, të GJK)*

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i s drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Nga pikëpamja e shpejtësisë në gjykim, Gjykata evidenton se në parim çështjet civile paraqiten më pak prioritare në raport me çështjet penale, që kanë të bëjnë me kufizimin e lirisë së individit, dhe ato administrative, të cilat vetë ligjvënësi i ka përcaktuar si çështje që kërkojnë shpejtësi në gjykimin e tyre, duke parashikuar afate më të shpejta gjykimi. Po ashtu, pa paragjykuar rastet e çështjeve civile, të cilat paraqesin natyrë urgjente, Gjykata konstaton se çështja civile e kërkueses lidhet me shpërblimin e dëmit të shkaktuar gjatë procedurës së ekzekutimit të titullit ekzekutiv midis dy shoqërive tregtare dhe, siç u parashtrua më lart, tejzgjatja nuk paraqet shkallë të konsiderueshme rreziku. Gjykata çmon se në rastin konkret tejzgjatja e procedurave gjyqësore nuk paraqet një shkallë të konsiderueshme rreziku për interesin e kërkueses *(shih vendimin nr. 33, datë 01.11.2021, paragrafët 64 -65, të GJK)*

8. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Për sa i përket kriterit të interesit për

kërkuesen dhe rrezikut që passjell tejzgjatja e procedurave për të, Gjykata vlerëson se çështja konkrete është e një natyre të tillë që interesi i kërkueses nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore nuk rrezikohet në shkallë të konsiderueshme, për sa kohë që në padinë e saj ajo ka kërkuar detyrimin e shoqërisë së paditur, "Banka e Tiranës" sh.a., për shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të shkaktuar nga veprimet me faj dhe fitimin e munguar, si dhe për kamatat ligjore sipas normës Tribor njëditore të vendosur nga Banka e Shqipërisë deri në datën e ekzekutimit të vendimit të gjykatës *(shih vendimin nr. 34, datë 01.11. 2021, paragrafi 62, të GJK-së).*

9. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Për sa i përket kriterit të interesit për kërkuesin dhe rrezikut që passjell tejzgjatja e procedurave për të, Gjykata vlerëson se çështja konkrete është e një natyre të tillë që interesi i kërkuesit nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore rrezikohet në shkallë të konsiderueshme, për sa kohë objekti i kërkesëpadisë së tij ka të bëjë me të drejta vetjake siç është përfitimi i pensionit. Nga ana tjetër, nga pikëpamja e shpejtësisë në gjykim, Gjykata evidenton se në parim çështjet administrative ligjvënësi i ka përcaktuar si çështje që kërkojnë shpejtësi në gjykimin e tyre, duke parashikuar afate më të shpejta gjykimi *(shih vendimin nr. 35, datë 01.11.2021, paragrafët 51 -52, të GJK-së).*

IV.

10. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm. Interesi i kërkuesit është i dukshëm dhe real, për sa kohë që detyrimi i palës debitore lidhet me të drejtën e tij për t'u kthyer në punë dhe për t'u paguar. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për ekzekutimin e detyrimit që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Ai ka shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim *(shih vendimin nr. 49, datë 03.07.2017, paragrafi 42, të GJK-së).*

B.2 Vlerësimi i afatit të arsyeshëm

a. Precedentët ku vlerësimi i afatit të arsyeshëm është vënë në diskutim

1. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm. Gjykata arsyeton se me ndryshimet që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" (ligji nr.38/2017), të cilat hynë në fuqi në datën 05.11.2017, u përcaktua se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), llojet e mjeteve për t'u mbrojtur nga cenimi, si kërkesa për përshpejtimin e procedurave (neni 399/4), kërkesa për dëmshpërblim dhe

çfarë konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7) deri te marrja e vendimit dhe zbatimi i tij (nenet 399/8 – 399/12). Për rrjedhojë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore nëpërmjet të cilave individit i garantohet mbrojtja në rastet e cenimit të së drejtës për gjykimin ose për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda afatit të arsyeshëm *(shih vendimin nr. 2, datë 17.02.2022, paragrafët 21-23, të GJK-së).*

B.3 Efektiviteti i mjeteve të reja juridike

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Legjislacioni vendas parashikon tashmë një mjet juridik ankimi efektiv, i cili garanton si përshpejtimin e procesit gjyqësor, ashtu edhe dëmshpërblimin, pra ofron një rezultat konkret në drejtim të rivendosjes të së drejtës së shkelur për proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme ligjore *(shih vendimet nr. 37, datë 05.11.2021, paragrafi 20; nr. 3, datë 06.02.2018, paragrafi 17; nr. 80, datë 18.12.2017, paragrafi 21, të GJK-së).*

2. Mjetet e reja procedurale të parashikuara nga KPC-ja synojnë të garantojnë të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm jo vetëm në drejtim të përshpejtimit të procedurave, si mjete me natyrë parandaluese, por edhe në drejtim të rivendosjes të së drejtës së shkelur, në rast se është konstatuar me vendim gjyqësor shkelja e afatit të arsyeshëm të gjykimit, përmes jo vetëm urdhërimit të përfundimit të procedurave në një kohë sa më të shpejtë, por edhe caktimit të një shpërblimi të drejtë *(shih vendimin nr. 20, datë 05.04.2023, paragrafi 21, të GJK-së).*

3. Në parim, mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret. Në veçanti, për kërkesën për përshpejtimin e procedurave, ky lloj mjeti është "efektiv" nëse arrin të përshpejtojë vendimmarrjen e gjykatës në fjalë *(shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022, paragrafi 24; nr. 37, datë 05.11.2021, paragrafi 17; nr. 35, datë 01.11.2021, paragrafi 20, të GJK-së).*

4. Në vlerësimin e efektivitetit në praktikë të këtij mjeti juridik analizohet nëse ai është real, i drejtpërdrejtë, konkret dhe i shpejtë në kohë, pra që nuk është një mundësi e tërthortë për kërkuesin. Në këtë kuptim, kur kërkesa për përshpejtimin e procedurave nuk i ka shërbyer qëllimit të saj - përshpejtimit të procedurave ose parandalimit të tejzgjatjes së paarsyeshme të shqyrtimit të çështjes, atëherë ky mjet juridik nuk ka qenë efektiv në praktikë, për rrjedhojë në këto raste Gjykata ka vlerësuar se kriteri i shterimit të mjetit juridik është përmbushur *(shih vendimin nr. 3, datë 17.02.2022, paragrafi 20, të GJK-së).*

b. Precedentët ku efektiviteti i mjeteve të reja juridike është vënë në diskutim

5. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka shqyrtuar kërkesën brenda afatit 3-mujor të parashikuar nga ligji. Gjykata vëren se kërkuesja, edhe pse ka kaluar rreth 1 vit nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka vendosur shpërblimin e dëmit, pra nga dhënia e masës së favorshme ndaj saj, ajo jo vetëm që nuk ka mundur ta ekzekutojë këtë vendim, por është ende në pritje të shqyrtimit të ankimit në gjykatën e apelit, e cila, për më tepër, mban qëndrimin se kjo çështje do të shqyrtohet në përputhje me afatet e përgjithshme procedurale. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim, duke konstatuar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Referuar përmbajtjes së nenit 399/7 të KPC-së, për sa i përket gjykimit të kërkesëpadisë për shpërblimin e dëmit, ai ka përcaktuar një afat të posaçëm prej 3 muajsh nga depozitimi i saj. Edhe pse kjo dispozitë, e parë së bashku me nenin 399/6, pika 3, të KPC-së, shprehet për shqyrtimin e kërkesëpadisë dhe nuk i referohet shqyrtimit të ankimit, qasja e ofruar nga vetë gjykata e apelit për mënyrën e zbatimit të saj nuk përputhet me përmbajtjen dhe qëllimin e dispozitave që kanë rregulluar mjetet mbrojtëse korrigjuese/kompensuese, të cilat kanë synuar që këto lloj gjykimesh jo vetëm të riparojnë shkeljen e së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm, por që kjo të sigurohet në një kohë sa më të shpejtë. Kjo pasi çdo qëndrim i ndryshëm nuk do të përputhej me qëllimin e ligjvënësit dhe do të vinte në dyshim efektivitetin e këtyre mjeteve. Në këtë kuptim, interpretimi i ngushtë që gjykata e apelit i bën përmbajtjes së nenit 399/7 të KPP-së cenon vetë thelbin e së drejtës kushtetuese së një individi për të pasur një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm *(shih vendimin nr. 44, datë 26.09.2023, paragrafi 51, të GJK-së).*

6. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit ankimues. Lidhur me argumentin që përdoret nga Gjykata e Lartë si shkak objektiv që shkarkon gjykatat e zakonshme nga përgjegjësia për tejkalimin e afatit të arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve, Gjykata është shprehur se ndonëse interpretimi rast pas rasti i ligjit, konkretisht nenit 399/2 të KPC-së, i takon vetë Gjykatës së Lartë, qasja për të mos llogaritur efektet e reformës së drejtësisë në kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave nuk përputhet me standardin e "afatit të arsyeshëm" të procesit të rregullt ligjor. Gjykata çmon se kërkesa për përshpejtimin e procedurave, në rastin e kërkuesit e ka humbur qëllimin e saj - përshpejtimin e procedurave ose parandalimin e tejzgjatjes së paarsyeshme të shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit. Pra, mjeti juridik "kërkesa për përshpejtimin e procedurave", që kërkuesi ka pasur në dispozicion sipas dispozitave të KPC-së, nuk ka qenë efektiv, në kuptimin që nuk ka qenë real, i drejtpërdrejtë, konkret dhe i shpejtë në kohë. Ndonëse formalisht kërkuesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon ligji, Gjykata vlerëson se nga mënyra se si është trajtuar ky mjet nga Gjykata e Lartë, ai mbetet sërish një mjet ankimi joefektiv. Në këtë kuptim, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për

rivendosjen e së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual *(shih vendimin nr. 3, datë 17.02.2022, paragrafët 26 -27, të GJK-së).*

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit ankimues. Gjykata ka vlerësuar se kërkesa për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit dhe përshpejtimin e procedurave ndryshon nga rekursi, në pikëpamje të përmbajtjes, të aksesit dhe sidomos të shpejtësisë që duhet të karakterizojë marrjen në shqyrtim të saj. Si i tillë, ky mjet juridik nuk duhet të trajtohet me formalizëm të tepruar nga punonjësit e administratës gjyqësore, veprimet ose mosveprimet e parregullta të së cilës nuk duhet t'i ngarkohen individit, i cili nuk mund të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së saj (administratës). Gjykata e Lartë ka detyrimin të sillet në atë mënyrë që kërkesa për përshpejtim të mos humbasë qëllimin e vet dhe individit të mos i cenohet në thelb e drejta për mjet juridik efektiv *(shih vendimin nr. 3, datë 17.02.2022, paragrafi 23, të GJK-së).*

C. Fuqia detyruese e vendimeve:

C.1. të Gjykatës Kushtetuese

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i garantuar nga Kushtetuta, e cila në nenet 132 dhe 145 të saj sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata ka theksuar se efekti detyrues që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbëjnë edhe një ratio decidendi, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Nga kjo pikëpamje, Gjykata ka theksuar se nga standardi i detyrimit të zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vet Gjykata Kushtetuese *(shih vendimet nr. 20, datë 05.04.2023, paragrafi 18; nr. 44, datë 29.06.2015, paragrafi 15; nr. 5, datë 07.02.2001, paragrafi 12; nr. 57, 04.11.1998, paragrafët 5-6, të GJK-së).*

2. Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale *(shih vendimet nr. 20, datë 05.04.2023, paragrafi 18; nr.78, datë 12.12.2017, paragrafi 14; nr. 5, datë 07.02.2001, paragrafi 14, të GJK-së).*

3. Veçanërisht në rastet kur bëhet fjalë për të drejtat themelore të njeriut, interpretimi përfundimtar i normës kushtetuese është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese. Nëse

kjo e fundit, me vendim, përcakton se një proces gjyqësor i ka cenuar shtetasit të drejtat themelore, duke caktuar edhe detyra për gjykatat gjatë rigjykimit të çështjes konkrete, moszbatimi i këtyre detyrave automatikisht sjell cenim të të drejtave themelore, në rastin konkret të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së *(shih vendimin nr. 20, datë 01.06.2011, paragrafi 4.3, të GJK-së).*

b. Precedentët ku fuqia detyruese e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është vënë në diskutim

4. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i fuqisë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, pasi Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur një qëndrim të njësuar, por e ka gjykuar çështjen në dhomën e këshillimit. Vlerësimi i Gjykatës së Lartë se për kërkuesin nuk është vendosur kthimi si ushtarak aktiv është vetëm konstatues dhe i paargumentuar. Gjykata ka konstatuar se vendimi i saj kishte përcaktuar në mënyrë të qartë detyrën se kishte vend për një qëndrim njësues nga Gjykata e Lartë për shkak të praktikave të ndryshme të njëkohshme. Thënë ndryshe, Gjykata kishte arritur në përfundimin se thelbi që përbënte konfliktin në fjalë kishte marrë zgjidhje të ndryshme nga kolegjet e Gjykatës së Lartë, bazuar në interpretime të ndryshme mbi të njëjtën bazë ligjore, prandaj praktika gjyqësore e krijuar kishte mjaftueshëm arsye për t'u njësuar prej saj. Kjo do të thotë se njësimi i praktikës ishte detyra e lënë për zbatim nga Gjykata, ndërsa përcaktimi i organit (Kolegjet e Bashkuara sipas ligjit të kohës) ishte në funksion të kësaj detyre. Ndërkohë, referuar ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, kompetenca e njësimit aktualisht i përket trupës gjyqësore me 5 gjyqtarë, duke mos qenë më kompetencë e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Pavarësisht këtyre përcaktimeve, Kolegji Administrativ në rishqyrtimin e çështjes vendosi të vlerësojë përsëri nëse praktikat e kundërta, tashmë të konstatuara nga Gjykata, linin vend për njësimin apo për zhvillimin e tyre. Duke vënë në diskutim vendimin e Gjykatës, Kolegji Administrativ ka arsyetuar se nuk ka vend për njësim të praktikës, por vetëm për zhvillimin e saj dhe e ka shqyrtuar çështjen me një trupë me tre gjyqtarë. Gjykata vlerëson se për t'i dhënë zgjidhje situatës së kërkuesit, Kolegji Administrativ, edhe pse nuk mund ta kalonte çështjen për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara, të cilat nuk kanë më kompetencën për njësimin e praktikës gjyqësore, ishte i detyruar të zbatonte vendimin e Gjykatës në lidhje me detyrën thelbësore të lënë prej saj, njësimin e praktikës gjyqësore. Kjo çështje nuk mund të vihej më në diskutim nga Kolegji Administrativ, i cili për të zbatuar detyrën e lënë duhet t'ia kalonte çështjen për shqyrtim organit që sipas parashikimeve të reja ligjore ka tashmë këtë kompetencë, pra trupës me 5 gjyqtarë. *(shih vendimin nr. 66, datë 06.12.2023, paragrafët 31-33 të GJK).*

5. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i fuqisë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, pasi gjykatat administrative nuk kanë arsyetuar në vendimet gjyqësore për vlerën detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e ligjit në raport me veprimet konkrete që ka kryer administrata tatimore gjatë asaj periudhe. Gjykata ka konstatuar se gjykatat administrative nuk e kanë përmbushur detyrimin kushtetues për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e ligjit, vendim i cili ka fuqi

detyruese të përgjithshme dhe forcën e ligjit për të gjitha organet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Gjykata thekson se efekti detyrues dhe *erga omnes* i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ka të bëjë edhe me vendimet për pezullimin e zbatimit të ligjit ose të akteve normative. Gjykata kur vendos një pezullim të tillë ka vlerësuar pasojat që vijnë nga zbatimi i mëtejshëm i tij ndaj interesave shtetërorë, shoqërorë ose të individëve. Ky lloj vendimi nënkupton ndërprerjen në mënyrë të menjëhershme dhe për një kohë të caktuar të efekteve juridike të ligjit ose të aktit normativ të pezulluar, ndërprerje e cila është e detyrueshme për t'u zbatuar jo vetëm nga palët konkrete në gjykimin kushtetues, ku jepet vendimi i pezullimit, por nga të gjitha subjektet e zbatimit të ligjit ose aktit normativ, deri në një vendim përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e dhëna prej tyre përmbajnë fakte pa arsyetim, si dhe nuk kanë respektuar forcën detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, duke sjellë si pasojë cenimin e së drejtës së pronës së kërkueses *(shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021, paragrafët 33-34, të GJK-së).*

6. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i fuqisë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka zbatuar ndryshimet ligjore pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, konkretisht ligjin nr. 112/2016. Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete zbatimi nga Gjykata Administrative e Apelit i dispozitave të një ligji të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, si dhe moszbatimi i dispozitave të reja ligjore në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes, dëshmon se gjykata nuk ka ushtruar kontroll efektiv për ndërhyrjen që administrata tatimore ka bërë tek e drejta e pronës së kërkueses, e, për rrjedhojë, ka cenuar parimin e sigurisë juridike. Në këtë mënyrë, Gjykata Administrative e Apelit nuk ka përmbushur detyrimin e saj për realizimin e një procesi të rregullt ligjor dhe gjykimi të drejtë, sipas nenit 42 të Kushtetutës *(shih vendimin nr. 18, datë 30.03.2021, paragrafët 38 -39, të GJK-së).*

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i fuqisë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, pasi gjykatat nuk kanë respektuar vendimin nr. 14/2011 të Gjykatës dhe detyrimet që rrjedhin prej tij për sa i përket mënyrës së marrjes së provave dhe sqarimit të rrethanave në të cilat ato janë marrë nga autoritetet e hetimit paraprak. Duke pasur parasysh rëndësinë vendimtare të këtyre provave për fajësinë e kërkuesit, si dhe rëndësinë e të drejtave themelore të sipërpërmendura, të garantuara nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja, gjykatat duhej të kishin korrigjuar gjatë rigjykimit shkeljet e evidentuara nga Gjykata në vendimin nr. 14/2011. Për pasojë, në vlerësimin e Gjykatës moszbatimi i vendimit të saj nr. 14/2011 dhe mosriparimi i shkeljeve të konstatuara në këtë vendim e ka bërë të parregullt edhe procesin e rigjykimit ndaj kërkuesit *(shih vendimin nr. 20, datë 04.04.2016, paragrafi 32, të GJK-së).*

8. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i fuqisë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, pasi nga gjykatat janë dhënë dy dënime penale si dënime kryesore. Në vlerësimin e Gjykatës, pavarësisht se kërkuesi nuk e ka parashtruar në rekurs këtë fakt, për shkak se rekursi ishte ushtruar para hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe kërkuesi nuk mund të ishte në dijeni të tij, Kolegji Penal *ex officio* duhej të kishte vlerësuar antikushtetutshmërinë e vendimeve të gjykatave të faktit, pasi çështja ishte ende në gjykim para Kolegjit Penal. Gjykata e Lartë duhet t'i kishte vlerësuar shkaqet e rekursit

jo vetëm në kuadër të mangësive ligjore apo zbatimit të gabuar të ligjit, siç parashikon KPP-ja, por edhe në kuadër të zbatimit të drejtë dhe koherent të dispozitave ligjore për dhënien e dënimit penal, baza ligjore e të cilit, në kohën e shqyrtimit të rekursit në dhomë këshillimi, kishte ndryshuar si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Çështja e zbatimit të drejtë të ligjit procedural është një nga shkaqet për të cilat rekursi duhet të kalojë për shqyrtim gjyqësor në seancë publike në Gjykatën e Lartë *(shih vendimin nr. 12, datë 19.03.2015, paragrafët 22 dhe 28, të GJK-së).*

9. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i fuqisë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, pasi edhe pse Gjykata vendosi shfuqizimin e vendimit Gjykatës së Lartë si të paarsyetuar dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, çështja përsëri u gjykua në dhomën e këshillimit, duke vendosur mospranimin e rekursit. Referuar detyrueshmërisë së vendimeve të Gjykatës, si dhe standardit të arsyetimit, nisur nga vlerësimi i vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata konkludon se në rastin konkret Gjykata e Lartë, edhe pas rigjykimit të çështjes, nuk i ka përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimet e përcaktuara në vendimin nr. 13, datë 17.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese, për sa kohë pretendimet e kërkuesit, në thelb, nuk kanë marrë ende përgjigje të shprehur. Në këto kushte, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe efektin detyrues të vendimeve të saj, vlerëson se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet. Një zgjidhje e ndryshme nga sa ka vendosur Gjykata në vendimin nr. 13, datë 17.03.2014 do të ishte antikushtetuese, pasi nuk do të respektohej një akt parësor i nxjerrë pikërisht nga një burim parësor siç është Gjykata Kushtetuese *(shih vendimin nr. 18 datë 14.04.2015, paragrafi 26, të GJK-së).*

10. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i fuqisë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nga Gjykata e Lartë, për shkak të mospranimit të kërkesës për rishikim të vendimeve nga ana e Kolegjit Penal, në kushtet kur një vendim i Gjykatës ka përcaktuar Gjykatën e Lartë si organin e përshtatshëm për korrigjimin e pasojave që kanë ardhur nga shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Apelit të Durrësit. Gjykata vlerëson se, edhe pse Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 22, datë 09.03.2010 ka çmuar se një shtetasi të caktuar i janë cenuar të drejtat e veta kushtetuese, ky fakt nuk mund t`i nënshtrohet një procesi vlerësimi nga askush, aq më pak nga Gjykata e Lartë, e cila ka për detyrë të garantojë zbatimin korrekt të ligjit penal, procedural dhe material nga të gjitha gjykatat, në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Për sa më sipër, zgjidhja e një konflikti ndërmjet dy vendimmarrjeve të ndryshme të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese ka vetëm një rrugë, e cila është shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë nga Gjykata Kushtetuese. Një zgjidhje e ndryshme do të ishte antikushtetuese, pasi nuk do të respektohej një akt parësor, i nxjerrë pikërisht nga një burim parësor siç është Gjykata Kushtetuese, nga një organ i cili jo vetëm interpreton akte hierarkisht më të ulëta se Kushtetuta, por nuk ka tagër të bëjë interpretimin përfundimtar të tyre në këndvështrimin kushtetues. Në rastin konkret dhunimi i së drejtës së individit për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga Kushtetuta, vjen pa ligj dhe, për më keq, nga një organ i lartë gjyqësor, i cili, veç të tjerash, me qëndrime të kësaj natyre shton pasojat e dëmshme të një procesi tashmë të deklaruar joligjor si nga GJEDNJ-ja, ashtu dhe nga

kjo Gjykatë edhe me elemente të tjera, siç janë zvarritjet e paarsyeshme në zgjidhjen përfundimtare të çështjes *(shih vendimin nr. 20, datë 01.06.2011, paragrafët 4.7.- 4.9, të GJK-së)*

C.2. të GJEDNJ-SË

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Vendimet e GJEDNJ-së janë të detyrueshme për t'u zbatuar, në përputhje me angazhimin që Republika e Shqipërisë, si shtet anëtar i Këshillit të Evropës, ka ndërmarrë sipas nenit 46, pika 1, të KEDNJ-së, që parashikon se palët e larta kontraktuese zotohen t'u binden vendimeve përfundimtare të Gjykatës Evropiane në mosmarrëveshjet në të cilat janë palë *(shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022, paragrafi 61 ; nr. 45, datë 01.11.2013, paragrafi 17; nr. 20, datë 01.06.2011, paragrafi II.4, të GJK-së).*

2. Detyrimet e marra përsipër nga shteti shqiptar në kuadrin e KEDNJ-së janë të zbatueshme nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjitha niveleve *(shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021, paragrafi 39, të GJK-së).*

3. Gjyqtarët e çdo niveli zbatojnë drejtpërsëdrejti vendimet e GJEDNJ-së, në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 dhe 46 të KEDNJ-së, pasi respektimi i KEDNJ-së dhe standardeve kushtetuese është detyrim jo vetëm i kësaj Gjykate, por edhe i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në mënyrë të veçantë i Gjykatës së Lartë, për shkak të kompetencave të veçanta të saj të natyrës rishikuese, por edhe në drejtim të unifikimit të praktikës gjyqësore. Roli i një gjykate të lartë është pikërisht zgjidhja e konflikteve, shmangia e divergjencave dhe qëndrueshmëria *(shih vendimet nr. 18, datë 06.03.2017, paragrafi 14; nr. 45, datë 01.11.2013, paragrafi 11; nr. 20, datë 01.06.2011, paragrafi 8, të GJK-së).*

4. Duke pasur parasysh statusin e veçantë që ka KEDNJ-ja në rendin e brendshëm ligjor, Gjykata ka njohur kompetencën ekskluzive të GJEDNJ-së në sistemin tonë juridik dhe efektin e drejtpërdrejtë të vendimeve të saj në interpretimin e standardeve kushtetuese të të drejtave të njeriut, veçanërisht atyre që i referohen së drejtës për proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Vendimet e GJEDNJ-së kanë vlerën e tyre në dy aspekte: i pari lidhet me natyrën detyruese, që rrjedh nga nenet 1 dhe 46 të Konventës, dhe i dyti me mënyrën e zbatimit të tyre në sistemin e brendshëm. GJEDNJ-ja ka sqaruar parimet që rregullojnë zbatimin e vendimeve të saj, duke i vënë theksin zbatimit efektiv të këtyre vendimeve. Sipas kërkesave të nenit 46 të KEDNJ-së, një shtet palë, për të cilin GJEDNJ-ja është shprehur se ka shkelur Konventën ose protokollet e saj, ka detyrimin të veprojë në përputhje me vendimin e asaj gjykate. Me fjalë të tjera, një dështim tërësor ose i pjesshëm i ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së lind përgjegjësinë ndërkombëtare të shtetit. Shteti në fjalë ka detyrimin jo vetëm të shlyejë dëmin material ndaj personave të interesuar, por edhe të marrë masa individuale dhe/ose, nëse është e përshtatshme, masa të përgjithshme në rendin e vet ligjor, që t'i japë fund shkeljes së gjetur nga gjykata

dhe të rregullojë pasojat e shkeljes, me qëllimin që kërkuesi të rikthehet, për aq sa është e mundur, në gjendjen që ishte para se të bëhej shkelja *(shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021, paragrafi 38; nr. 45, datë 01.11.2013, paragrafi 10, të GJK-së).*

5. Për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GJEDNJ-ja ka në sistemin tonë juridik një kompetencë ekskluzive. Kjo kompetencë është e pranuar nga sistemi ynë i brendshëm juridik për efekt të zbatimit të nenit 122 të Kushtetutës, po edhe të nenit 17/2 të saj, të cilët sjellin si detyrim që vendimet e GJEDNJ-së të zbatohen drejtpërsëdrejti (*shih vendimin nr. 20, datë 01.06.2011, paragrafi 6 të GJK-së).*

b. Precedentët ku çështja e fuqisë detyruese të vendimeve të GJEDNJ-së është vënë në diskutim

6. Përpara Gjykatës është pretenduar mosrespektimi nga gjykatat i vendimit të GJEDNJ-së të datës 8 dhjetor 2016, i cili ka konstatuar se është shkelur neni 6, pika 1, i KEDNJ-së dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj dhe është shprehur se shteti shqiptar duhet të sigurojë, me mjete të përshtatshme, ekzekutimin e vendimit të formës së prerë të datës 11.01.2008 të Gjykatës së Lartë për pushimin e cenimit të pronës së kërkueses. Gjykata, duke pasur parasysh statusin e veçantë që ka KEDNJ-ja në rendin e brendshëm ligjor, ka njohur kompetencën ekskluzive të GJEDNJ-së në sistemin tonë juridik dhe efektin e drejtpërdrejtë të vendimeve të saj në interpretimin e standardeve kushtetuese të të drejtave të njeriut, veçanërisht atyre që i referohen së drejtës për proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Duke pasur parasysh vendin e Gjykatës së Lartë në piramidën gjyqësore, por pa vënë në diskutim kompetencat e këtij organi gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të çështjeve, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë duhet të shfaqë një kujdes të shtuar në përshpejtimin e procedurave, veçanërisht në rastet kur GJEDNJ-ja ka konstatuar cenim të të drejtave të kërkuesve dhe ka rekomanduar marrjen e masave nga shteti shqiptar për rivendosjen e tyre *(shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021, paragrafët 38 – 39, të GJK-së).*

7. Përpara Gjykatës është pretenduar mosrespektimi nga gjykatat i vendimit të GJEDNJ-së, pasi Gjykata e Lartë edhe pse e ka shqyrtuar kërkesën për rishikim në dhomën e këshillimit dhe ka njohur kompetencën e saj për të marrë në shqyrtim kërkesa të tilla, ka vendosur mospranimin e kësaj kërkese, me arsyetimin se shkeljet e konstatuara nga vendimi i GJEDNJ-së "Shkalla kundër Shqipërisë (2010)" i referohen procesit të zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese në vitin 2005 dhe jo atij të zhvilluar në Gjykatën e Lartë. Gjykata shprehet se në kushtet kur shkeljet e së drejtës për proces të rregullt ligjor janë konstatuar nga GJEDNJ-ja në procesin e zhvilluar në gjykatat e faktit, është kompetencë e Gjykatës së Lartë, edhe në kuptim të rolit të saj në sistemin tonë ligjor, që të marrë në shqyrtim dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin e kërkuesit për rishikimin e vendimeve penale që e kanë gjykuar dhe dënuar atë në mungesë. Zbatimi i vendimit të GJEDNJ-së duhet të kryhet në mënyrën më efikase të mundshme dhe duke mos cenuar një element të rëndësishëm të së drejtës për proces të rregullt ligjor, pikërisht kohëzgjatjen

e paarsyeshme të procesit *(shih vendimin nr. 45, datë 01.11.2013, paragrafët 14 dhe 17, të GJK-së).*

8. Përpara Gjykatës është pretenduar mosrespektimi nga gjykatat i vendimit të GJEDNJ-së, që ka konstatuar se rivendosja në afat e prokurorit për të bërë ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit të Durrësit, që shpallte të pafajshëm kërkuesin, ka cenuar parimin e sigurisë juridike, duke i mohuar atij pritshmërinë e ligjshme se vendimi i Gjykatës së Apelit të Durrësit nuk mund të ndryshohej nëpërmjet ankimit në një gjykatë më të lartë, pasi kishin kaluar afatet e ankimit. Gjykata çmon se respektimi i KEDNJ-së dhe standardeve kushtetuese është detyrim jo vetëm i saj, por edhe i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në mënyrë të veçantë i Gjykatës së Lartë për shkak të kompetencave të veçanta të saj të natyrës rishikuese, por edhe në drejtim të unifikimit të praktikës gjyqësore. Gjykata vëren se qëllimi i gjykimit kushtetues në lidhje me të drejtën për proces të rregullt ligjor është të evidentojë shkelje të mundshme të kësaj të drejte. Në kushtet kur nga GJEDNJ-ja janë konstatuar shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor ndaj kërkuesit, për shkak të kompetencës ekskluzive të GJEDNJ-së në këtë drejtim, ky fakt nuk mund të vihet në diskutim. Qëllimi i procesit kushtetues në këtë rast është të shfuqizojë ato vendime gjyqësore që kanë sjellë cenim të kësaj të drejte dhe t'u japë mundësi organeve gjyqësore të veprojnë në përputhje me vendimet e GJEDNJ-së, me qëllim që të arrihet mbrojtja efektive e të drejtave të individit, në rastin konkret siguria dhe liria e tij vetjake *(shih vendimin nr. 20, datë 01.06.2011, paragrafët 11 dhe 13, të GJK-së).*

V. Garancitë në aspektin penal: kërkesat procedurale

A. Garancitë e Përgjithshme

1. E drejta për të qëndruar në heshtje dhe për të mos u vetakuzuar

Neni 32, pika 1, i Kushtetutës:
1. Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij.

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Standardi kushtetues në lidhje me procesin e rregullt ligjor gjatë hetimit penal kërkon që organi procedues të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri e ka kryer veprën penale që i atribuohet. Çdo i pandehur ka absolutisht të drejtë të mos japë asnjë lloj kontributi gjatë hetimit gjyqësor ose gjatë procesit dhe kjo është një e drejtë e pamohueshme *(shih vendimin nr. 14, datë 03.05.2011, paragrafi III.12, të GJK).*

V.

b. Precedentët ku e drejta për të qëndruar në heshtje dhe për të mos u vetakuzuar është vënë në diskutim

2. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i neneve 25, 31 dhe 32 të Kushtetutës, pasi gjatë rigjykimit nuk janë korrigjuar nga gjykatat e zakonshme shkeljet e gjetura nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 14/2011 në lidhje me mënyrën e marrjes së provave. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë e ka përdorur procesverbalin e eksperimentit hetimor si provë kryesore gjatë rigjykimit të kërkuesit, megjithëse në vendimin nr. 14/2011 është konkluduar për paligjshmërinë e mënyrës së marrjes së kësaj prove, në kushtet ku kërkuesi ka inkriminuar veten, pa praninë e mbrojtësit dhe të prokurorit, si dhe në rrethana që ngrinin dyshime për ushtrim dhune ndaj tij e që kërkonin hetim nga autoritetet. Gjykata e shkallës së parë, bazuar në deklaratat e bëra nga kërkuesi gjatë eksperimentit hetimor, ka arritur në përfundimin se është provuar plotësisht që kërkuesi i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Për pasojë, vendimi i gjykatës së shkallës së parë, i cili mbështetej në prova të marra në mënyrë të paligjshme, ka cenuar procesin e rregullt ligjor dhe duhet të shfuqizohej. Megjithëse gjatë gjykimit në shkallën e parë nuk janë respektuar detyrimet që rrjedhin

nga vendimi nr.14/2011 i kësaj Gjykate dhe, për rrjedhojë, është cenuar procesi i rregullt ligjor, siç është vlerësuar më sipër, këto shkelje nuk janë korrigjuar nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë. Gjykata konstaton se pavarësisht konkluzionit të saj në vendimin nr. 14/2011 për paligjshmërinë në lidhje me mënyrën e marrjes së provave në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkuesit, edhe gjatë rigjykimit të çështjes ky aspekt i procesit të rregullt ligjor nuk është korrigjuar. Gjykatat nuk kanë respektuar vendimin nr. 14/2011 të Gjykatës dhe detyrimet që rrjedhin prej tij për sa i përket mënyrës së marrjes së provave dhe sqarimit të rrethanave në të cilat ato janë marrë nga autoritetet e hetimit paraprak. Duke pasur parasysh rëndësinë vendimtare të këtyre provave për fajësinë e kërkuesit, si dhe rëndësinë e të drejtave themelore të sipërpërmendura, të garantuara nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja, gjykatat duhej të kishin korrigjuar gjatë rigjykimit shkeljet e evidentuara nga Gjykata në vendimin nr. 14/2011. Për pasojë, në vlerësimin e Gjykatës moszbatimi i vendimit të saj nr. 14/2011 dhe mosriparimi i shkeljeve të konstatuara në këtë vendim e kanë bërë të parregullt edhe procesin e rigjykimit ndaj kërkuesit (*shih vendimin nr. 20, datë 04.04.2016, paragrafët 24-25 dhe paragrafi 32, të GJK-së).*

2. Ligjshmëria e marrjes së provave

Neni 32, pika 2, i Kushtetutës:

2. Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. Sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues nuk mund të mos nënkuptojnë që procesi ishte i parregullt. Asnjë gjykatë nuk ka mundësi, pa dëmtuar dhënien e "përmasës së duhur të drejtësisë", të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm me metoda të pandershme, por, mbi të gjitha, që janë edhe të kundërligjshme. Në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjykatat e kanë për detyrë të vlerësojnë në tërësi nëse procedurat lidhur me mënyrën se si janë siguruar provat kanë qenë të drejta *(shih vendimet nr. 67, datë 10.11.2017, paragrafi 13; nr. 7, datë 27.04.2005, paragrafi 5; nr. 95, datë 27.07.2001, paragrafi 4, të GJK-së).*

2. Në gjykim provat merren me kërkesën e palëve dhe prova nuk mund të përdoret kur është marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit e nuk ka vlerë të paracaktuar dhe gjykata i vlerëson ato sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi. Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal, pasi sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues e bëjnë procesin gjyqësor të parregullt nga pikëpamja kushtetuese *(shih*

vendimin nr. 8, datë 19.03.2018, paragrafi 19; nr. 9, datë 26.02.2015, paragrafi 27; nr. 7, datë 27.04.2005, paragrafi 5, të GJK-së).

3. Standardi kushtetues në lidhje me procesin e rregullt ligjor gjatë hetimit penal kërkon që organi procedues të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri e ka kryer veprën penale që i atribuohet. Çdo i pandehur ka absolutisht të drejtë të mos japë asnjë lloj kontributi gjatë hetimit gjyqësor ose gjatë procesit dhe kjo është një e drejtë e pamohueshme *(shih vendimin nr. 14, datë 03.05.2011, paragrafi 3.12, të GJK-së).*

b. Precedentët ku deklarimi fajtor dhe dënimi mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme është vënë në diskutim

4. Përpara Gjykatës është pretenduar deklarimi fajtor dhe dënimi mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, pasi shumë nga provat kanë rezultuar të papërdorshme. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata ka konstatuar se në procesin gjyqësor deklarimet e një shtetasi, në të cilat janë bazuar gjykatat që kanë shqyrtuar çështjen penale në ngarkim të kërkuesit për deklarimin e fajësisë së tij, janë deklaruar të pavlefshme, pasi janë marrë në kundërshtim me përcaktimet e KPP-së. Gjykatat edhe pse i referohen vendimit, nuk marrin parasysh përfundimet e arritura prej tij në lidhje me provat kryesore të procesit të zhvilluar ndaj kërkuesit. Deklarimet e shtetasit të pyetur, siç rezulton nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara, janë prova bazë ku mbështetet gjykata për arritjen në një përfundim në lidhje me mekanizmin e ngjarjes dhe autorësinë e saj. Po ashtu, rezulton se gjykata u referohet edhe dëshmive të dhëna nga disa shtetas të tjerë, të cilët referojnë për fakte të mësuara nga persona të tjerë, që kanë ndërruar jetë, të cilat janë përdorur në gjykim në bazë të nenit 154/2 të KPP-së. Gjykata vëren se megjithëse këto pretendime janë ngritur në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë nga mbrojtësi i kërkuesit, Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e tij. Në këtë kuptim, cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, për shkak të mosdhënies së një përgjigjeje përfundimtare ndaj pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs, ka cenuar edhe të drejtën e kërkuesit për të pasur një vendim të arsyetuar *(shih vendimin nr. 8, datë 19.03.2018, paragrafi 23-24, të GJK-së).*

5. Përpara Gjykatës është pretenduar deklarimi fajtor dhe dënimi mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, pasi gjykatat e kanë bazuar vendimin e tyre mbi dëshmitë e disa shtetasve, të cilët kanë dëshmuar për fakte apo ngjarje të dëgjuara ose mësuara nga persona të tretë, për të cilët deklarojnë se nuk i njohin, nuk u mbajnë mend emrat, ose edhe të dëgjuara si thashetheme. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se këto dëshmi janë konsideruar të mjaftueshme nga gjykatat për të formuar bindjen e tyre dhe ato nuk kanë administruar asnjë dëshmi ose provë tjetër për të mbështetur vendimet e tyre. Po ashtu, nuk rezulton të jetë administruar si provë arma e ngjarjes dhe as të jetë provuar se ajo armë i përkiste kërkuesit. Gjykatat janë bazuar, në thelb, në dëshmi të cilat, në kuptim të nenit 154 të KPP-së, ishin të papërdorshme, pasi referonin lidhur me fakte që nuk rezulton të jenë

provuar me prova të tjera të administruara në proces dhe, çka është më e rëndësishmja, nuk i janë nënshtruar debatit gjyqësor në përputhje me parimin e kontradiktoritetit. Edhe pse në gjykimin në apel i pandehuri, i pyetur në seancë gjyqësore, ka mohuar akuzat e ngritura ndaj tij, ajo gjykatë përsëri i ka dhënë vlerë të paracaktuar të njëjtave dëshmi të administruara në gjykatën e shkallës së parë, duke ndërtuar një skemë ngjarjeje të ndryshme nga sa rezulton nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore dhe mbi të cilën ka bazuar vendimin e saj të fajësisë. Gjykata ka interpretuar nenin 427 të KPP-së, sipas së cilit, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor vendoset edhe kryesisht kur gjykata e çmon të domosdoshme, si dhe kur vërtetohet se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në shkallë të parë, sepse nuk ka marrë dijeni ose nuk ka mundur të paraqitet për shkaqe ligjore. Gjykata vlerëson se, në kushtet kur në gjykimin në shkallë të parë vërehen shkelje të dispozitave procedurale që lidhen me provat, mënyrën e marrjes dhe vlerësimit të tyre, Gjykata e Apelit Tiranë kishte detyrimin që, qoftë edhe kryesisht, të përsëriste hetimin gjyqësor dhe të kërkonte paraqitjen në seancë dhe pyetjen e atyre dëshmitarëve, dëshmitë e të cilëve gjykata e shkallës së parë i ka vënë në bazë të vendimit të saj, në mënyrë që në zbatim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit t`ia nënshtronte këto prova debatit gjyqësor dhe t'i jepte mundësi kërkuesit që t'i kundërshtonte ato në seancë gjyqësore. Mospranimi i kërkesës për përsëritjen tërësisht të hetimit gjyqësor e ka vënë kërkuesin haptazi në pozitë të pabarabartë me akuzën, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se duke i kërkuar kërkuesit të paraqesë prova për të provuar pafajësinë e tij, gjykatat e kanë kaluar barrën e provës nga akuza tek i pandehuri. Është detyrimi i organit të akuzës që bashkë me dërgimin e një çështjeje për gjykim të paraqesë edhe provat mbi të cilat e mbështet akuzën *(shih vendimin nr. 50, datë 01.11.2012, paragrafët 12-14, të GJK-së).*

6. Përpara Gjykatës është pretenduar deklarimi fajtor dhe dënimi mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, pasi kërkuesi është marrë në pyetje pa praninë e mbrojtësit. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata argumenton se në bazë të KEDNJ-së, ajo ka për detyrë të vlerësojë në tërësi, nëse ishte e drejtë procedura lidhur me mënyrën se si u siguruan provat. Duke iu referuar KPP-së, dispozitat që rregullojnë marrjen në pyetje të të pandehurit janë nenet 37, 38 dhe 39 të këtij kodi. Të tria këto nene mund të analizohen vetëm në harmoni me njëri-tjetrin dhe në funksion të respektimit të garancive kushtetuese që burojnë nga nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës. Prania e mbrojtësit është një kusht i domosdoshëm për vazhdimin e marrjes në pyetje të personit, pasi ndryshe nuk mund të shpjegohet detyrimi për punonjësin e policisë që të ndërpresë marrjen në pyetje. Kjo e bën mbrojtësin ligjor një subjekt të domosdoshëm dhe të pazëvendësueshëm gjatë kryerjes së këtij veprimi procedural dhe, për rrjedhojë, mungesa e tij çon në cenim të nenit 31 të Kushtetutës. Fakti që neni 37 i KPP-së parashikon ftesën që i bëhet personit që po merret në pyetje që të zgjedhë një mbrojtës, nuk mund të lexohet në mënyrën që e ka interpretuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, sipas së cilës është e mjaftueshme që mbrojtësi të verifikojë në një moment të mëvonshëm nëse deklaratat e personit të ndaluar janë bërë me vullnetin e tij të lirë. Përkundrazi, Gjykata çmon se mbrojtësi ligjor duhet të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje të të ndaluarit, dhe mbi të gjitha, duhet që në çdo rast të kujdeset për interesat e të ndaluarit. Ndërsa

ndalimi i parashikuar nga neni 38/2 i KPP-së, që ndaj personit të marrë në pyetje nuk mund të përdoren metoda ose teknika për të ndikuar mbi vullnetin e lirë të tij, mund të lexohet nga Gjykata vetëm në kuptimin më të gjerë të mundshëm, duke ndaluar çdo lloj sjelljeje nga ana e organeve të zbatimit të ligjit, që mund të lërë shteg për dyshime se vullneti i personit të marrë në pyetje është dhunuar. Në këtë kuptim, pjesëmarrja e mbrojtësit është një garanci serioze jo vetëm për mbrojtjen e interesave të të ndaluarit ose të pandehurit, por edhe për të garantuar një proces të rregullt ligjor në funksion të dhënies të drejtësisë *(shih vendimin nr. 14, datë 03.05.2011, paragrafët 8-12, të GJK-së).*

7. Përpara Gjykatës është pretenduar deklarimi fajtor dhe dënimi mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, pasi provat në ngarkim të kërkuesit janë marrë nëpërmjet dhunës dhe se pranimi i autorësisë të krimit në dhomat e paraburgimit ka ardhur si pasojë e përdorimit të dhunës nga punonjësit e policisë. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se ndonëse të ndodhura para pretendimeve dhe dyshimeve serioze faktike për ligjshmërinë e marrjes në pyetje të kërkuesit në dhomat e paraburgimit, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm dhe të domosdoshëm për të kërkuar dhe sqaruar deri në fund të gjitha rrethanat e çështjes, për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim vërehen dyshime serioze për kushtet dhe rrethanat në të cilat kërkuesi ka pohuar fajësinë e tij për veprën për të cilën akuzohet, për rrjedhojë edhe në përmbushjen e standardeve për proces të rregullt ligjor lidhur me mënyrën e marrjes së provave. Në rastin konkret, jo vetëm që ka dyshime serioze se ndaj kërkuesit është ushtruar dhunë për të marrë pohimin e tij, por pretendohet nga ky i fundit se është detyruar të dëshmojë kundër vetvetes, në kundërshtim me ndalimet që burojnë nga nenet 25 dhe 32 të Kushtetutës. Gjykata çmon se është e papranueshme që në një shtet të së drejtës gjithë akuza të mbështetet kryesisht në deklarimet e një personi, i cili jo vetëm është marrë në pyetje pa praninë e avokatit, por pretendon se këto deklarime janë bërë për shkak të dhunës të ushtruar ndaj tij. Për më tepër, Konventa kundër Torturës dhe Akteve Çnjerëzore dhe Degraduese, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në vitin 1994, detyron vendet anëtare që për çdo rast, ku ka pretendime se është ushtruar torturë nga ana e funksionarëve publikë, lind nevoja e një hetimi të pavarur dhe të gjithanshëm. Funksioni i procesit penal, si u tha më sipër, është hetimi dhe zbulimi i plotë i ngjarjeve që përbëjnë vepra penale dhe si i tillë është në shërbim të së drejtës penale materiale. Në këtë kuptim, që të ketë një dënim penal, duhet patjetër që të zbardhen të gjitha elementet e veprës penale. Për këtë argument Gjykata në jurisprudencën e saj ka konsoliduar qëndrimin se deklarimet e bëra para prokurorit ose Policisë Gjyqësore nuk përbëjnë prova në vetvete. Në rastin e kundërshtimit të këtyre thënieve në gjykatë, në kuptim të nenit 362 të KPP-së, ato nuk janë provë, por vlerësohen nga gjykata për të përcaktuar besueshmërinë e personit të pyetur. Deklarimet e dhëna para organeve të lartpërmendura mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre *(shih vendimin nr. 14, datë 03.05.2011, paragrafët 3.4–3.6 dhe paragrafët 3.13-3.14, të GJK-së).*

8. Përpara Gjykatës është pretenduar deklarimi fajtor dhe dënimi mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, pasi transferimi i procedimit, akteve dhe provave

nga autoritetet gjyqësore italiane tek ato shqiptare është bërë në mënyrë të paligjshme. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim, duke argumentuar se në lidhje me aktet e siguruara me letërporosi, ato kanë vlerën e provës në qoftë se janë marrë në përputhje me normat procedurale shqiptare. Provat trajtohen në Titullin IV të KPP-së. Në gjykim provat merren me kërkesën e palëve. Prova nuk mund të përdoret kur është marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi (neni 152 i KPP). Neni 193 i KPP-së, pjesë e seksionit VIII mbi dokumentet si lloje provash në një procedim penal, parashikon që si të tilla mund të merren edhe procesverbalet e procedimeve të tjera. Kështu, neni 193/1 parashikon se lejohet marrja e procesverbaleve të procedimeve të tjera penale që kanë të bëjnë me sigurimin e provës ose me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Nga shqyrtimi i të gjitha materialeve të dosjes gjyqësore, Gjykata vëren se mënyra e marrjes së provave në procesin gjyqësor në ngarkim të kërkuesit është bërë në përputhje me dispozitat e sipërpërmendura të Konventës për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Fushën Penale dhe me nenet 193, 505 e në vijim të KPP-së *(shih vendimin nr. 23, datë 23.07.2009, paragrafët 11-13, të GJK-së).*

9. Përpara Gjykatës është pretenduar deklarimi fajtor dhe dënimi mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, pasi provat mbi të cilat është bazuar gjykata në dënimin e kërkuesit janë deklarimet e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime dhe procesverbali i paraqitjes për njohje, i mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Nga dosja gjyqësore nuk konstatohet që kërkuesi të jetë pyetur me cilësinë e të pandehurit, por vetëm në një rast ai është pyetur nga oficeri i Policisë Gjyqësore me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Në të njëjtën datë rezulton edhe përpilimi i procesverbalit të paraqitjes për njohje. Këto dy të dhëna janë kundërshtuar si nga kërkuesi, ashtu dhe nga dëshmitarët në gjykatën e rrethit dhe në gjykatën e apelit. Deklarata e dhënë përpara oficerit të Policisë Gjyqësore, pa praninë e mbrojtësit, është kundërshtuar gjatë procesit gjyqësor nga i akuzuari me arsyetimin se është marrë nën presionin e dhunës dhe të torturës. Për vërtetimin e këtij pretendimi, i gjykuari ka paraqitur kartelën klinike dhe epikrizën e mjekut. Gjykata ka arritur në përfundimin se të pandehurit dhe mbrojtësit të tij nuk i është krijuar mundësia, me gjithë kërkesat e shumta në të gjitha shkallët e gjykimit, t'u drejtonin pyetje dëshmitarëve për të kundërshtuar provën në këtë proces penal, duke cenuar të drejtën e mbrojtjes në një masë të papajtueshme me kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6, paragrafët 1 e 3, shkronja "d", të KEDNJ-së *(shih vendimin nr. 7, datë 27.04.2005, paragrafët 9 dhe 18, të GJK-së).*

B. Garanci specifike

1. Mosdënimi pa ligj

Neni 29, pika 1, i Kushtetutës:
1. Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare.

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. E drejta e shtetasve për të mos u dënuar pa ligj, e sanksionuar në nenin 29 të Kushtetutës dhe në nenin 7 të KEDNJ-së, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar *(shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023, paragrafi 11; nr. 16, datë 15.06.2009 paragrafi 2; nr. 14, datë 17.04.2007, paragrafi 1.2, të GJK-së).*

2. Çdo vepër penale duhet të parashikohet me ligj dhe individi duhet të jetë objektivisht në gjendje të kuptojë përmbajtjen e normës penale dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimeve gjyqësore të saj, se çfarë veprimesh ose mosveprimesh do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht. Kur bëhet fjalë për mundësinë e individit për të parashikuar pasojat e veprimeve të tij, nuk është e thënë që të nënkuptohet një qartësi absolute. Ligji duhet të jetë në gjendje të ndjekë rrethanat e ndryshme dhe, për këtë arsye, një standard i një parashikueshmërie të arsyeshme është i mjaftueshëm *(shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023, paragrafi 11; nr. 16, datë 15.06.2009, paragrafi 3, të GJK-së).*

3. Parimi që vetëm ligji mund ta përcaktojë krimin dhe të parashikojë masën e dënimit nënkupton që veprat penale dhe masat e dënimit për ndëshkimin e tyre duhet të jenë të përkufizuara qartësisht me ligj. Nocioni "ligj" nënkupton disa kushte cilësore, sidomos ato të mundësisë së qasjes dhe të parashikueshmërisë. Këto kushte cilësore duhet të përmbushen si për përkufizimin e një vepre penale, ashtu edhe për masën e dënimit që ajo nënkupton ose për shtrirjen e saj *(shih vendimin nr. 32, datë 30.05.2023, paragrafi 12, të GJK së).*

b. Precedentët ku çështja e mosdënimit pa ligj është vënë në diskutim

a) Për Gjykatën e Lartë

4. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mos u dënuar pa ligj, pasi gjykatat e zakonshme kanë interpretuar gabim nenin 186 të KP-së lidhur me ekzistencën ose jo të veprës penale për të cilën është dënuar kërkuesi. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Nisur nga arsyetimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në çështjen konkrete, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe rolin subsidiar të saj në respektimin në tërësi të së drejtës për proces të rregullt ligjor, e në rastin konkret të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me dënimin pa ligj (paragrafi i parë i nenit 29 të Kushtetutës), vlerëson se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk i plotëson standardet e vendosura për arsyetimin e vendimit gjyqësor. Arsyetimi i vendimit për pretendimin kryesor të kërkuesit, atë të dënimit pa ligj, nuk rezulton të jetë i qartë dhe i plotë. Kolegji Penal për këtë pretendim është bazuar në argumente të lidhura me precedentin gjyqësor *(shih vendimin nr. 21, datë 26.09.2022, paragrafi 46, të GJK –së).*

5. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mos u dënuar pa ligj, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, duke e bazuar vendimin e saj në një dispozitë ligjore që nuk ekziston. Konkretisht, ajo gjykatë nuk ka zbatuar vendimin nr. 9, datë 20.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin janë shfuqizuar pikat 5 dhe 6 të nenit 278 të KP-së lidhur me masën e dënimit për veprën penale të armëmbajtjes pa leje. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se ndërkohë që çështja ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, ajo, me vendimin nr. 9, datë 26.02.2016, ka shfuqizuar paragrafin e pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të KP-së, shtuar me ligjin nr. 144/2013, ndryshuar me ligjin nr. 98/2014. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, me ligjin nr. 82/2016 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", neni 278 i KP-së është riformuluar, duke e ulur masën e dënimit për këtë vepër. Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 151, datë 11.08.2016. Kërkuesi është dënuar nga gjykatat e faktit bazuar në një dispozitë penale që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale prej tij. Gjykata e faktit në vendim, në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit, i janë përmbajtur ligjit penal në kohën e kryerjes së veprës. Megjithatë, Gjykata konstaton se gjatë kohës që çështja ndodhej për shqyrtim pranë Kolegjit Penal ka ndryshuar parashikimi ligjor për masën e dënimit lidhur me një nga veprat penale për të cilën është gjykuar kërkuesi. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal duhej ta kishte marrë në shqyrtim pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimit të ligjit penal favorizues dhe fuqisë prapavepruese të tij, pasi dispozita ligjore penale që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale kishte ndryshuar gjatë kohës së gjykimit të çështjes në këtë gjykatë *(shih vendimin nr. 70, datë 13.11.2017, paragrafët 10 – 11, të GJK-së).*

6. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mos u dënuar pa ligj, pasi kërkuesi është dënuar për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", të parashikuar nga neni 283/1 i KP-së, ndërkohë, që mbajtja e një sasie të vogël droge me qëllim përdorimi nuk është veprim i dënueshëm në kuptim të kësaj norme. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se kërkuesi është gjykuar dhe deklaruar fajtor për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", të parashikuar nga neni 283/1 i KP-së. Në këtë dispozitë, elementet e veprës penale dhe dënimi përkatës janë të përcaktuar në mënyrë të arsyeshme dhe të mjaftueshme, duke i dhënë mundësi kërkuesit të dijë se cilat veprime apo mosveprime e bëjnë atë penalisht përgjegjës. Kjo dispozitë ka qenë e tillë që nga viti 2001, pra dhe në kohën e kryerjes së veprës penale. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka interpretuar elementet e veprës penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", të parashikuar nga neni 283/1 i KP-së, në përputhje me interpretimin e bërë kësaj norme nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 1, datë 27.03.2008, në të cilin është sqaruar përmbajtja e dispozitës dhe janë përcaktuar kufijtë e zbatimit të saj *(shih vendimin nr. 16, datë 15.06.2009, paragrafët 4-5, të GJK-së)*

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për t'u mos u dënuar pa ligj, pasi gjykatat i kanë deklaruar fajtorë kërkuesit për organizimin e trafikut të narkotikëve, ndërkohë që kjo vepër penale në kohën e kryerjes së saj nuk parashikohej në KP. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se në kuadrin e pretendimit të tyre për shkeljen e parimit të mosdënimit pa ligj, kërkuesit kanë arsyetuar se vepra penale e "Trafikut të narkotikëve", e cila përfshin edhe trafikun ndërkombëtar të narkotikëve, është shtuar në nenin 183/a të KP-së me ligjin nr.8733, datë 24.01.2001 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë". Gjykata ka vlerësuar si të vërtetë faktin se në vitin 2001 në KP është shtuar neni 283/a, por siç rezulton nga materialet e dosjes, kërkuesit nuk janë deklaruar fajtorë në bazë të kësaj dispozite, por në bazë të nenit 284/a të KP-së, dispozitë kjo që është miratuar në janar 1998. Siç pranohet edhe në doktrinën e së drejtës penale, në këndvështrimin e pasojave kriminale, në varësi të qenies ose jo të pasojës si element i figurës së veprës penale, këto të fundit ndahen në materiale dhe formale. Duke e analizuar në këtë vështrim figurën e veprës penale që parashikon neni 284/a, mund të konkludohet se ajo përfshihet në figurat formale të veprave penale, gjë që do të thotë se kjo vepër konsiderohet e kryer që nga momenti i organizimit dhe i pjesëmarrjes në organizatën kriminale, pavarësisht nga ardhja e pasojave. Kur nga veprimtaria e organizatës kriminale kanë ardhur edhe pasoja, atëherë veprat penale do të konkurrojnë. Në këto rrethana, Gjykata, pa marrë përsipër të vlerësojë cilësimin juridik të veprës, konkludon se vepra penale për të cilën janë deklaruar fajtorë kërkuesit parashikohej me ligj në kohën e kryerjes dhe, për pasojë, pretendimi për shkeljen e ndalimit *nullum crimen nulla poena sine lege* duhet rrëzuar *(shih vendimin nr. 14, datë 17.04.2007, paragrafët 1.4 – 1.6, të GJK-së),*

2. Fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

Neni 29, pika 3, i Kushtetutës:
3. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.

1. E drejta e përfitimit nga efekti prapaveprues i ligjit penal favorizues, e sanksionuar në nenin 29, pika 3, të Kushtetutës, është një parim themelor që ka të bëjë me thelbin e një procesi të drejtë penal dhe, si i tillë, është i rëndësishëm për respektimin e së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor *(shih vendimet nr. 20, datë 22.09.2022, paragrafi 83; nr. 14, datë 17.04.2007, paragrafi 2.3 ; nr. 35, datë 20.12.2005, paragrafi 9, të GJK-së).*

2. Neni 29 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj; se nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale; se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Kjo dispozitë kushtetuese reflektohet edhe në nenin 3 të KP-së, sipas të cilit askush nuk mund të dënohet për një vepër që sipas ligjit të kohës kur është kryer nuk përbënte vepër penale; ligji i ri që nuk dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese; kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale *(shih vendimet nr. 20, datë 22.09.2022, paragrafi 83; nr. 49, datë 15.02.2017, paragrafi 8; nr. 1, datë 20.01.2014, paragrafi 13, të GJK-së).*

3. Parimi kushtetues i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues duhet respektuar nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre. Pra, sigurisht që ky parim duhet të respektohet edhe në gjykimin që mund të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, sepse është pikërisht kjo gjykatë që kontrollon mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta *(shih vendimet nr. 49, datë 15.02.2017, paragrafi 8; nr. 14, datë 17.04.2007, paragrafi 2.3; nr. 35, datë 20.12.2005, paragrafi 9, të GJK-së).*

b. Precedentët ku çështja e përfitimit nga fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues është vënë në diskutim

a) Për gjykatat e faktit

4. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për të përfituar nga fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues, pasi Gjykata e Apelit për Krime të Rënda nuk ka pasur parasysh nenin 3 të KP-së, sipas të cilit zbatohet ligji penal më i favorshëm.

Edhe pse kërkuesi duhej të dënohej në bazë të paragrafit 4 të nenit 278, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, është dënuar në bazë të paragrafit 6 të kësaj dispozite. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se procedimi penal në ngarkim të kërkuesit është regjistruar në vitin 2004, ku ai është akuzuar dhe dërguar për gjykim për veprën penale "Trafikimi i armëve dhe municionit luftarak", parashikuar nga neni 278/a/1 i KP-së. Në përfundim të gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, kërkuesi është dënuar për kryerjen e veprave penale "Trafikimi i armëve dhe municionit luftarak", parashikuar nga neni 278/a/1 i KP-së dhe "Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive", parashikuar nga neni 282/a/1 i KP-së. Gjykata e Apelit, në ndryshim nga sa më sipër, ka vlerësuar se kërkuesi ka konsumuar elementet e veprave penale të parashikuara nga paragrafi i tretë dhe paragrafi i parë i nenit 278 të KP-së. Po ashtu, kjo gjykatë ka arsyetuar se duke konsumuar veprën penale "më shumë se një herë" dhe "në sasi të mëdha", veprimtaria e tij kriminale duhet të kualifikohej sipas paragrafit të fundit të nenit 278 i KP-së . Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit, në lidhje me masën e dënimit, ka vlerësuar se merr parasysh marzhin e masës së dënimit sipas ligjit nr. 144/2013 dhe se nuk mund të caktohet një masë më e rëndë dënimi për kërkuesin, për sa kohë që gjykimi është vënë në lëvizje në bazë të ankimit të tij. Në përfundim të gjykimit kjo gjykatë e ka dënuar kërkuesin me 12 vjet burgim, dhe në zbatim të nenit 406 të KPP-s, përfundimisht e ka dënuar me 8 vjet burgim. Gjykata vlerëson se duke krahasuar parashikimet e dispozitave të KP-së rezulton se neni 278 është ndryshuar me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001, ku pas paragrafit të tretë është shtuar një paragraf me këtë përmbajtje: "Kur vepra kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet." Kurse ndryshimet e tjera që i janë bërë kësaj dispozite janë ato me ligjin nr. 144/2013 e në vijim. Për rrjedhojë, rezulton se Gjykata e Apelit për Krime të Rënda e ka dënuar kërkuesin në përputhje me përmbajtjen e dispozitave penale në fuqi në kohën e gjykimit të tij, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se nuk ka cenim të parimit të zbatimit të ligjit penal favorizues. Për sa u takon pretendimeve në lidhje me kualifikimin e veprës penale ose masën e dënimit, ky është një aspekt që ka të bëjë me zbatimin e ligjit material penal dhe me vlerësimin e provave nga gjykatat e zakonshme, të cilat, si rregull, janë atribut i gjykatës që zgjidh çështjen konkrete dhe nuk mund të jenë objekt i kontrollit të kësaj *Gjykate (shih vendimin nr. 49, datë 03.07.2017, paragrafët 10 – 11, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

5. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për të përfituar nga fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh faktin që gjatë kohës që çështja ndodhej për shqyrtim në Kolegjin Penal, ligji nr. 36/2017 ndryshoi masën e dënimit për veprën penale "Mashtrimi", të parashikuar nga neni 143 i KP-së. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se Kolegji Penal në vendim ka vlerësuar vetëm shkaqet e rekursit, ashtu sikurse kanë qenë të formuluara në momentin e paraqitjes së tyre nga avokati i kërkuesit, për të cilat është shprehur se lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit procedural penal, nenit 152 të KPP-së, nga ana e

gjykatës së apelit, e lidhur kjo me vlerësimin e provave të marra e të verifikuara në këtë gjykim, të cilat dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të saj. Në këtë vendim Kolegji Penal nuk ka vlerësuar ndryshimet që kishte pësuar ndërkohë neni 143 i KP-së nga ligji nr. 36/2017 dhe efektet e këtij ndryshimi në çështjen konkrete. Duke qenë se në rastin konkret çështja ishte ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe dënimi penal i dhënë ndaj kërkuesit lidhej drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit të shfuqizuar (neni 143 i KP-së), Gjykata ka çmuar se ky ndryshim i ligjit penal duhej të ishte arsyetuar nga Gjykata e Lartë nëse bënte të aplikueshëm zbatimin e ligjit penal favorizues. Për rrjedhojë, në kushtet kur në kohën e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë kishte ndryshuar ligji penal, ajo duhej të ishte shprehur për zbatimin e garancive kushtetuese dhe procedurale ndaj kërkuesit *(shih vendimin nr. 20, datë 22.09.2022, paragrafët 84 dhe 86, të GJK-së)*

6. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për të përfituar nga fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues, pasi Gjykata e Lartë e ka gjykuar dhe shpallur fajtor për veprën penale "Mosbindje ndaj urdhrit të punonjësit të policisë", e cila në momentin e gjykimit ishte amnistuar me ligjin nr. 107/2012, i hyrë në fuqi në datën 28.12.2012. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata është shprehur se amnistia e veprës penale gjen zbatim në të gjitha fazat procedurale të procesit penal, me pasojë pushimin e çështjes për ato vepra penale për të cilat ndjekja penale nuk duhet të fillojë ose të vazhdojë. Kështu, në rastet kur gjykata e shkallës së parë zbaton amnistinë e veprës penale, ajo ka detyrimin të deklarojë pushimin e çështjes. Nëse amnistia e veprës penale zbatohet në procesin gjyqësor në gjykatën e apelit apo në Gjykatën e Lartë, këto të fundit duhet të prishin vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta dhe të pushojnë çështjen penale. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se në momentin e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, ligji nr. 107/2012 "Për dhënie amnistie" kishte hyrë në fuqi dhe se vepra penale "Mosbindje ndaj urdhrit të punonjësit të policisë", për të cilën është dënuar kërkuesi, plotëson kriteret për përfitimin e amnistisë. Pavarësisht këtij fakti, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka vendosur pushimin e çështjes për këtë vepër penale. Për pasojë, Gjykata çmon se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues *(shih vendimin nr. 1, datë 20.01.2014, paragrafët 21 -22, të GJK-së).*

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për të përfituar nga fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka zbatuar ndaj kërkuesit dispozitën penale që parashikonte masën më të rëndë të dënimit. Ai është dënuar me 9 vjet burgim, ndërkohë që dispozita ligjore që vepronte në kohën e gjykimit të çështjes ka ndryshuar, duke parashikuar në paragrafin e dytë një dënim më të ulët. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se sipas dispozitës ligjore të kohës së kryerjes së veprës penale (neni 333 i Kodit Penal) pjesëmarrja në bandë të armatosur ose organizatë kriminale dënohej nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kësaj dispozite ligjore i janë referuar me të drejtë gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit në aplikimin e masës së dënimit ndaj kërkuesit. Ndërkohë që çështja ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, me ligjin nr. 9275, datë 16.09.2004, neni 333 i KP-së ka ndryshuar, duke parashikuar në paragrafin e dytë, për pjesëmarrjen në organizatë

kriminale, një dënim më të ulët, nga 4 deri në 8 vjet. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet ta kishte marrë në konsideratë zbatimin e parimit kushtetues të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues *(shih vendimin nr. 14, datë 17.04.2007, paragrafët 2.5 – 2.7, të GJK-së).*

8. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për të përfituar nga fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, përmes të cilit kërkohej prishja e vendimit të dhënë nga gjykata e apelit, që e kishte dënuar me 8 vjet burg dhe lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që e kishte dënuar me 6 vjet në zbatim të gjykimit të shkurtuar. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se ky pretendim nuk është ngritur shprehimisht në rekursin që kërkuesi i ka drejtuar Gjykatës së Lartë. Në kohën e paraqitjes së rekursit nuk ishte aprovuar ende ligji nr. 9275 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i cili, ndër të tjera, ndryshoi edhe nenin 134 të këtij kodi, duke parashikuar masa më të buta dënimi për veprën penale të vjedhjes. Ky ligj është aprovuar në datën 16.09.2004 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 07.10.2004. Megjithatë, Kolegji Penal i kësaj gjykate, në datën 21.01.2005, kur e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, kryesisht dhe vetëm për këtë shkak, duke pasur parasysh se fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues përbën një nga parimet themelore të procesit gjyqësor të garantuar shprehimisht në Kushtetutë, nuk duhet të kishte mënjanuar respektimin e këtij parimi kushtetues *(shih vendimin nr.35, datë 20.12.2005, paragrafi 11, të GJK-së).*

3. Prezumimi i pafajësisë

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

Neni 30 i Kushtetutës:
Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

1. Parimi i prezumimit të pafajësisë buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë. Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t`i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime *(shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023, paragrafi 26; nr. 14, datë 03.05.2011, paragrafi 10; nr. 17, datë 12.11.2004, paragrafi 6, të GJK-së).*

2. Parimi i prezumimit të pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëra prej të cilave është *indubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës *(shih vendimet nr. 13 datë 24.04.2018, paragrafi 8; nr. 23, datë 23.07.2009, paragrafi C.2; nr. 9, datë 28.04.2004, paragrafi 6, të GJK-së).*

3. Është detyrim i organit të akuzës që bashkë me dërgimin e një çështjeje për gjykim të paraqesë edhe provat mbi të cilat e mbështet akuzën. Kuptimi dhe zbatimi i drejtë në praktikë i parimit të prezumimit të pafajësisë është garancia kryesore për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit, sepse ky parim detyron akuzën që të provojë fajësinë e të pandehurit, e çliron këtë të fundit nga barra për të provuar pafajësinë e tij, i jep të drejtë të zgjedhë mbrojtjen më të përshtatshme për të, të bëjë ose jo deklarime, të kërkojë prova dhe të marrë pjesë aktivisht në shqyrtimin e tyre, duke kërkuar që provat e dyshimta të interpretohen gjithmonë në favorin e tij *(shih vendimet nr. 12, datë 24.04.2018, paragrafi 9; nr. 50, datë 01.11.2012, paragrafi 14, të GJK-së).*

4. Parimi i prezumimit të pafajësisë, si një nga elementet e një gjykimi të drejtë, i kërkuar nga neni 6/1 i Konventës, ndalon shprehjen e parakohshme nga vetë gjykata të vlerësimit se personi "i akuzuar për një vepër penale" është fajtor përpara se kjo të provohet në përputhje me ligjin. Gjykatat penale janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t`i paraqesin ato thjesht si aludime apo dyshime *(shih*

vendimet nr. 12, datë 24.04.2018, paragrafi 8; nr. 68, datë 14.11.2016, paragrafi 26; nr. 8, datë 26.02.2015, paragrafi 12, të GJK-së)

5. Prezumimi i pafajësisë kërkon, ndër të tjera, që kryerja e detyrave nga anëtarët e një gjykate nuk duhet të fillojë me idenë e paracaktuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet, se barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të të akuzuarit. Është detyrë e prokurorit të informojë të akuzuarin për çështjen kundër tij, në mënyrë që ai të mund të përgatisë e paraqesë mbrojtjen, si dhe të kundërshtojë provat të cilat mjaftojnë për ta dënuar atë *(shih vendimet nr. 37, datë 25.04.2017, paragrafi 38; nr. 19, datë 02.04.2012, paragrafi 21; nr. 16, datë 15.06.2009, paragrafi C.3, të GJK-së).*

6. Në rastet e shkarkimit të funksionarëve të lartë kushtetues, parimet e prezumimit të pafajësisë dhe të paanësisë nuk mund të zbatohen si parime tipike klasike të proceseve gjyqësore, kur organet e ngarkuara me këto procedura, qoftë në përbërjen dhe organizimin e tyre, qoftë në veprimtarinë e funksionet e tyre, nuk mund të jenë organe gjyqësore, nuk ushtrojnë pushtet gjyqësor, por ushtrojnë pushtete të tjera të ndryshme *(shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022, paragrafi 32; nr. 25, datë 10.05.2021, paragrafi 47-48; nr. 21, datë 01.10.2008, paragrafi V.6, të GJK-së).*

b. Precedentët ku çështja e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë është vënë në diskutim

a) Për gjykatat e faktit

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi organet administrative dhe Gjykata Administrative e Apelit nuk kanë mbajtur parasysh faktin se kërkuesja, për shkak të pozicionit të punës, i është nënshtruar në vijimësi kontrollit të pasurisë nga ILDKPKI-ja dhe as vullnetin e plotë të shfaqur nga ajo për të paraqitur deklaratën dhe dokumentet mbështetëse. Po kështu, sipas saj, procedurat e ndjekura nga KED-ja dhe vendimmarrjet e saj pa një hetim të plotë, bazuar në një "akuzë" ende të pakonfirmuar nga ILDKPKI-ja, kanë paragjykuar çështjen dhe kanë prezumuar paligjshmërinë e veprimit administrativ të kësaj të fundit. Gjykata ka vlerësuar se ky pretendim i kërkueses nuk është arritur të ngrihet në nivel kushtetues. Gjykata çmon se në procedurat administrative që zhvillohen gjatë verifikimit të kritereve ligjore për kandidatët për funksionet kushtetuese KED-ja zhvillon një proces administrativ, i cili ka parimet e veta që lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e shkaqeve konkrete që i shërbejnë për të marrë vendimet përkatëse. Ky proces duhet të respektojë standardet e procesit të rregullt ligjor të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji. Megjithatë, parimi i prezumimit të pafajësisë në këtë procedurë nuk mund të gjejë zbatim si në procesin gjyqësor penal apo atë disiplinor, për shkak të natyrës administrative të saj *(shih vendimin nr. 23, datë 10.10.2022, paragrafi 33, të GJK-së).*

8. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi ministri i Brendshëm ka deklaruar shkarkimin e kërkuesit përmes një deklarate për shtyp. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata çmon se Këshilli i Ministrave kur shkarkon nga detyra organin e zgjedhur të qeverisjes vendore zhvillon një proces administrativo-disiplinor, i cili ka parimet e veta që lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e shkaqeve konkrete që i kanë shërbyer organit kompetent për të marrë masën e shkarkimit. Ky proces duhet të respektojë standardet e procesit të rregullt ligjor të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji. Megjithatë, parimi i prezumimit të pafajësisë nuk gjen zbatim si në procesin gjyqësor penal, jo vetëm për shkak të natyrës administrativo-disiplinore të këtij procesi, por edhe për shkak të përbërjes dhe funksioneve politike të Këshillit të Ministrave *(shih vendimin nr. 25, datë 10.05.2021, paragrafi 49, të GJK-së)*

9. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi gjykata e shkallës së parë në rigjykimin e çështjes e ka filluar procesin me bindjen se kërkuesi e ka kryer krimin për të cilin akuzohet pa u bazuar në prova. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm vendimet e tyre i kanë bazuar në një sërë provash, të tilla si aktet e ekspertimit, thëniet e dëshmitarëve etj. dhe se gjatë shqyrtimit të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit ato nuk kanë arritur në asnjë konkluzion apriori për fajësinë e tij. Për pasojë, Gjykata, nisur edhe nga ecuria e procesit në tërësinë e tij, vlerëson se nuk rezulton që gjykata ta ketë nisur procesin me bindjen se kërkuesi është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet. *(shih vendimin nr. 45, datë 03.07.2017, paragrafi 35, të GJK-së).*

b) Për Gjykatën e Lartë

10. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes nga gjykatat e zakonshme. Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i bazuar. Gjykata vëren se fillimisht prokuroria dhe më pas dy gjykatat e faktit, në deklarimin e fajësisë së kërkuesit janë bazuar në 3 rrethana specifike: (i) prania e kërkuesit gjatë ushtrimit të kontrollit të banesës dhe ambienteve rrethuese të saj; (ii) gjetja dhe sekuestrimi i armëve në ambientet e jashtme të banesës; (iii) gjendja teknike e armëve, sipas akteve të ekspertimit dhe mungesa e lejes për mbajtjen e tyre. Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykatat e faktit kanë çliruar prokurorin nga barra e provës, duke ia kaluar kërkuesit detyrimin për të provuar se armët e sekuestruara nuk i përkisnin atij, me arsyetimin se përgjegjësia penale e veprave penale të mbajtjes së armëve ka natyrë objektive. Me fjalë të tjera, gjykatat e faktit kanë përcaktuar fajësinë e kërkuesit me anë të prezumimeve të faktit. Për të vlerësuar kushtetutshmërinë e qëndrimit të tyre, Gjykata i referohet jurisprudencës së GJEDNJ-së, sipas së cilës Konventa nuk i ndalon prezumimet ligjore ose të faktit në çështjet penale. Megjithatë, prezumimet duhet të jenë brenda kufijve të arsyeshëm, duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e interesit që rrezikohet dhe të sigurojnë të drejtat e mbrojtjes. Nën këndvështrimin e këtij standardi, Gjykata çmon se edhe pse ruajtja e rendit dhe sigurisë publike nga armët është një interes i rëndësishëm, në rastin konkret

prezumimet e faktit nuk rezultojnë të arsyeshme dhe nuk kanë respektuar të drejtat e mbrojtjes së kërkuesit. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, Gjykata mban në konsideratë, nga njëra anë, se prezumimi i faktit konkret është i diskutueshëm dhe, nga ana tjetër, rrethanat mbizotëruese të çështjes janë të tilla që lidhen me dhunën e ushtruar ndaj kërkuesit dhe me cilësinë e hetimit penal. Gjykata çmon se, fillimisht, prokuroria dhe, më pas, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në rastin e kërkuesit nuk rezulton ta kenë filluar procesin me prezumimin se ky i fundit nuk ka kryer veprat penale për të cilat akuzohej. Në vijim, arsyetimi i vendimeve të gjykatave nuk dëshmon që fajësia e kërkuesit të jetë provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ndërsa, Gjykata e Lartë nuk ka kryer rol aktiv për të ndikuar efektivisht në vendimmarrjen e gjykatave të faktit për të synuar të drejtën dhe për të riparuar qëndrimin e tyre, me qëllim që të respektoheshin standardet kushtetuese *(shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023, paragrafët 39 – 40 dhe paragrafi 46, të GJK-së)*

11. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi GJKKO-ja e ka mbështetur argumentimin e saj në parimet procedurale penale lidhur me natyrën e gjykimit, cilësitë e palëve dhe detyrat e secilit subjekt procedural në një proces penal. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata sjell në vëmendje se standardi i prezumimit të pafajësisë është theksuar edhe në gjykimin e ligjit Antimafia, ku Gjykata vlerësoi se "...interpretimi i nenit 30 të Kushtetutës lidhet ngushtësisht me proceset penale. Procedimi i parashikuar në këtë ligj është një procedim i veçantë autonom nga procesi penal, ndaj garancitë e procesit penal nuk mund të gjejnë zbatim në këtë proces të rregulluar nga ligji objekt shqyrtimi". Në analizë të sa më lart, Gjykata vlerëson se ky parim gjen zbatim në proceset me natyrë penale dhe jo ato me natyrë civile *(shih vendimin nr. 4, datë 21.02.2022, paragrafi 63 – 64, të GJK-së).*

12. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi gjatë gjykimit të çështjes në themel gjykatat nuk kanë marrë në shqyrtim provën e ekspertizës mjeko-ligjore, sipas së cilës rezulton që kërkuesi në momentin e kryerjes së veprës penale vuante nga probleme të shëndetit mendor. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vlerëson se për shkak të cenimit të së drejtës së aksesit substancial si rezultat i mosdhënies përgjigje pretendimeve të parashtruara në rekurs, kërkuesi nuk ka marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë. Gjykata e Lartë duhet t'i jepte përgjigje këtij pretendimi të ngritur nga kërkuesi, duke pranuar ekzaminimin e gjendjes mendore të tij, që është kërkuar nga pala gjatë gjykimit në gjykatat e faktit, për të përcaktuar shkallën e përgjegjshmërisë penale të tij. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizimin e këtij pretendimi, për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe si kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, do t'i japë përgjigje të arsyetuar pretendimit të ngritur në rekurs nga kërkuesi *(shih vendimin nr. 10, datë 12.04.2022, paragrafi 39, të GJK-së).*

13. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka krijuar bindjen se kërkuesja e ka konsumuar veprën penale për të cilën akuzohet, duke u bazuar pothuajse ekskluzivisht vetëm në përgjime

bisedash ndërmjet të pandehurve të tjerë, të prezumuar bashkëpunëtorë në krim. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim si të pabazuar. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë e ka bazuar vendimin e saj për deklarimin fajtore dhe dënimin e kërkueses mbi një sërë provash të administruara në gjykim dhe të shqyrtuara e vlerësuara nga ajo gjykatë në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën. Ajo nuk ka arritur në asnjë konkluzion apriori për fajësinë e kërkueses. Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk rezulton që ajo ta ketë nisur procesin me bindjen se kërkuesja është fajtore për veprën penale për të cilën akuzohet. Po ashtu, nuk rezulton se provave dhe dëshmive të administruara në gjykim t'u jetë dhënë një vlerë e paracaktuar, por ato janë vlerësuar në gjykim së bashku dhe në unitet me provat e tjera të administruara në proces *(shih vendimin nr. 12, datë 24.04.2018, paragrafi11, të GJK-së).*

14. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka bazuar vendimin e tij vetëm në përgjimet e bisedave ndërmjet të pandehurve të tjerë. Përgjimet janë të përdorshme dhe sipas kërkuesit duhej të provohej fajësia përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Nga bisedat e përgjuara nuk mund të nxirret asnjë konkluzion që kërkuesi është përfshirë në veprimtari kriminale. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë e ka bazuar vendimin e saj për deklarimin fajtor të kërkuesit dhe dënimin e tij mbi një sërë provash të administruara në gjykim, të shqyrtuara dhe të vlerësuara nga gjykata në tërësi dhe harmoni me njëra-tjetrën. Nga përmbajtja e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk rezulton që procesi të jetë nisur me bindjen se kërkuesi është fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe vleftësimin si të ligjshëm të vendimit të datës 09.07.2016 të prokurorit për lejimin e përgjimit telefonik. Po ashtu, nuk rezulton se provave dhe dëshmive të administruara t'u jetë dhënë një vlerë e paracaktuar, por përgjimet për kërkuesin janë vlerësuar në gjykim së bashku dhe në unitet me provat e tjera të administruara në proces *(shih vendimin nr. 13, datë 24.04.2018, paragrafi 10, të GJK-së).*

15. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi gjykatat e faktit në vendimet e tyre janë bazuar në hamendësime, si dhe në prova të marra në mënyrë të paligjshme. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se gjykatat, vendimet e tyre i kanë bazuar në një sërë provash, të tilla si aktet e ekspertimit, thëniet e dëshmitarëve, rezultatet e përgjimit ambiental etj. Edhe pse akti i ekspertimit biologjik nr. 5983, datë 07.08.2009 përmban disa hamendësime, nuk rezulton që gjykata të ketë nisur procesin me bindjen se kërkuesi është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet. Gjatë shqyrtimit të çështjes penale në ngarkim të tij, gjykata nuk ka arritur asnjë konkluzion apriori për fajësinë e kërkuesit, duke u bazuar vetëm në aktin e ekspertimit biologjik. Këtij të fundit nuk i është dhënë një vlerë e paracaktuar në gjykim, por ai i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor së bashku me provat e tjera të administruara në proces, duke u vlerësuar në unitet me to. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se edhe ky pretendim i kërkuesit nuk është i bazuar *(shih vendimin nr. 68, datë 14.11.2016, paragrafi 27, të GJK-së).*

16. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi gjykatat e zakonshme e kanë nisur çështjen me paragjykimin e fajësisë së kërkuesit. Ato kanë administruar në cilësinë e provës një akt që nuk ka qenë pjesë e shqyrtimit dhe verifikimit në seancë gjyqësore, konkretisht vendimin e formës së prerë që deklaronte fajtorë tre të pandehurit e tjerë, të cilit i janë referuar edhe në arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata është shprehur se në bazë të pikës 5 të nenit 193 të KPP-së, vendimet e formës së prerë mund të merren për qëllime të provës lidhur me ekzistencën e faktit, duke u vlerësuar në unitet me provat e tjera. Edhe në rastin konkret, në zbatim të kësaj dispozite, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, që ka gjykuar çështjen penale në ngarkim të kërkuesit, i është referuar vendimit penal të formës së prerë lidhur me ekzistencën e rrethanave të çështjes dhe vërtetimin e faktit penal që i ngarkohet edhe kërkuesit. Edhe pse vendimi i përdorur si provë në këtë gjykim përmban disa deklarime në lidhje me përfshirjen e kërkuesit në veprimtarinë kriminale, nuk rezulton që gjykata të ketë nisur procesin me bindjen se kërkuesi është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet. Gjatë shqyrtimit të çështjes penale në ngarkim të tij, gjykata nuk ka arritur asnjë konkluzion apriori për fajësinë e kërkuesit, duke u bazuar vetëm në gjykimin penal në të cilin ai nuk ka marrë pjesë. Përkundrazi, përfundimi i gjykatës për fajësinë e kërkuesit është arritur pas një procesi shqyrtimi dhe vlerësimi të provave të administruara në gjykim, duke respektuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim. Gjykata vëren se vendimit të formës së prerë nr. 39/2009 nuk i është dhënë një vlerë e paracaktuar në gjykim, por ai i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor së bashku me provat e tjera të administruara në proces, duke u vlerësuar në unitet me to *(shih vendimin nr. 8, datë 26.02.2015, paragrafi 14, të GJK-së).*

17. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi të gjitha veprimet e organit procedues deri në caktimin e masës së sigurimit personal nga Gjykata e Lartë dëshmojnë haptazi se procedimi penal në ngarkim të kërkuesit është paragjykuar. Prokuroria në këtë mënyrë ka influencuar edhe në procedurat parlamentare, si dhe në vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, duke nxitur dhe krijuar presion mbi këto organe, që nga ana e tyre kanë shkelur normat kushtetuese dhe ligjore. Gjykata i ka vlerësuar si të pabazuara këto pretendime. Gjykata çmon se këto pretendime për nga natyra lidhen kryesisht me garancitë procedurale në një proces gjyqësor. Megjithatë, referuar edhe procedurës së ndjekur nga Kuvendi, nuk rezulton që ky organ të ketë bërë deklarata në lidhje me fajësinë ose pafajësinë e deputetit. Gjithashtu, Gjykata vëren se edhe gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë nuk rezultojnë prova që të pasqyrojnë faktin se anëtarët e Kolegjit Penal të kësaj gjykate, që kanë gjykuar çështjen, e kanë paragjykuar atë. Për më tepër, në caktimin e masës së sigurimit personal për kërkuesin, Gjykata e Lartë nuk ka gjykuar themelin e çështjes, për rrjedhojë nuk mund të shprehej për fajësinë e kërkuesit *(shih vendimin nr. 75, datë 22.12.2015, paragrafi 34, të GJK-së).*

18. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi vendimi i shkallës së parë është mbështetur në prova të pavlefshme apo në fakte dhe

ngjarje të dëgjuara ose mësuara nga persona të tretë dhe se gjykata e apelit ka rrëzuar pa shkaqe të arsyeshme kërkesën për përsëritje të shqyrtimit gjyqësor. Po ashtu, mënyra e arsyetimit të vendimeve të këtyre gjykatave krijon bindjen se ato e kanë paragjykuar kërkuesin, pa u shpallur fajtor, si autor të veprës penale. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata çmon se nuk rezulton asnjë e dhënë e cila të tregojë se gjykatat e zakonshme, që kanë shqyrtuar çështjen, e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesi e ka kryer veprën penale apo e kanë konsideruar të akuzuarin fajtor para dhënies së një vendimi përfundimtar për fajësinë e tij. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se nuk rezulton që gjykatat e zakonshme të kenë kaluar gjatë procesit barrën e provës nga prokurori tek i pandehuri *(shih vendimin nr. 49, datë 29.09.2014, paragrafi 27, të GJK-së).*

19. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi gjykatat, bazuar në faktin e orientimit seksual të kërkuesit, e kanë paragjykuar, qoftë edhe në mënyrë të pavetëdijshme, atë si autor të veprës penale. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se kërkuesi, gjatë gjykimit të zakonshëm, ka ngritur pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u prezumuar i pafajshëm, duke iu referuar një sërë fakteve hetimore dhe gjyqësore, si kryerjes së veprimit procedural të këqyrjes së vendit të ngjarjes gati një 1 muaj pasi kishte ndodhur vepra penale, përdorimit, sipas tij, në arsyetimin e vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë të shprehjeve që sugjerojnë paragjykim, pamjaftueshmërisë së shpjegimit dhe analizimit të provave materiale që mbartin një shkallë të lartë objektiviteti, (tabulateve telefonike), si dhe rrëzimit pa shkaqe të arsyeshme të kërkesës së mbrojtësit të tij për ekspertim mjeko-ligjor mbi vetë kërkuesin. Këto pretendime nuk janë shqyrtuar nga Gjykata e Lartë. Gjykata vlerëson se edhe mbi këto pretendime të kërkuesit, të cilat përbëjnë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, Gjykata e Lartë nuk është shprehur. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor dhe si i tillë duhet të shfuqizohet *(shih vendimin nr. 19, datë 02.04.2012, paragrafi 27, të GJK-së).*

4. Mosgjykimi dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*) & Gjëja e gjykuar (*res judicata*) në aspektin penal.

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

Neni 34 i Kushtetutës:
Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj.

1. Sipas nenit 34 të Kushtetutës, askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj. Ratio i nenit 34 të Kushtetutës është sanksionimi i parimit "të mosgjykimit dhe dënimit dy herë për të njëjtën vepër penale" (*ne bis in idem*) dhe parimit të "gjësë së gjykuar" (*res judicata*). Këto dy parime vijnë si garanci të konfirmuara nga kjo dispozitë kushtetuese, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të individit në fushën penale (*shih vendimin nr. 1, datë 26.02.2021, paragrafi 35, të GJK-së).*

2. Parimi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale (*ne bis in idem*) është njohur si një prej të drejtave të njeriut të mbrojtura nga Kushtetuta dhe një nga instrumentet kryesore juridike të brendshme e ndërkombëtare, sipas të cilit askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht për një vepër penale për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar. Ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron te zbatimi dy a më shumë herë i së njëjtës normë penale, por te mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtin fakt që përbën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kriteri "e njëjta vepër" i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepre penale dhe kualifikim ligjor që formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilën personi është dënuar ose liruar. Nëse gjenden elemente të njëjta, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër ose procedim të mëtejshëm *(shih vendimet nr.8, datë 28.02.2012, paragrafi 10; nr.33, datë 22.07.2011, paragrafi 19; nr.5, datë 08.03.2005, paragrafët 2-4, të GJK-së).*

3. Parimi "*ne bis idem*" që ndalon rigjykimin e ridënimin për të njëjtën vepër, nuk gjen zbatim në rastet kur i njëjti veprim përbën dhunim të dy dispozitave të ndryshme ligjore. Për të njëjtat shkelje mund të zhvillohen procese me karakter të ndryshëm, penal dhe disiplinor. I njëjti veprim mund të konsiderohet si në shkelje të dy ligjeve (normave) edhe në rastet kur njëri prej tyre kërkon provën e një fakti shtesë që ligji (norma) tjetër nuk e ka të nevojshme. Në këtë rast, pafajësia ose dënimi në bazë të njërit ligj nuk e përjashton ndëshkimin sipas tjetrit *(shih vendimin nr. 5, datë 08.03.2005, paragrafi 7, të GJK-së)*

4. Kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj *(shih vendimet nr. 28, datë 18.05.2023, paragrafi 37; nr. 33, datë 10.04.2017, paragrafi 43; nr. 24, 12.11.2008, paragrafi 2.5, të GJK-së).*

5. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës për marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike *(shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022, paragrafi 45; nr. 50, datë 03.07.2017, paragrafi 27; nr. 23, datë 08.06.2007, paragrafi 13, të GJK-së)*

b. Precedentët ku çështja e cenimit të parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale dhe i gjësë së gjykuar është vënë në diskutim

a) Për gjykatat e faktit

6. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër, pasi me vendim penal Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur pushimin e gjykimit për akuzën e krijimit dhe pjesëmarrjen e kërkuesit në një bandë të armatosur, pasi nuk vërtetohej fajësia. Ndryshimet që i janë bërë KP-së me ligjin nr. 9275, datë 16.09.2004 dhe me ligjin nr. 9686, datë 26.02.2007 pothuaj nuk e prekin fare përkufizimin lidhur me bandën e armatosur dhe organizatën kriminale (neni 28). Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se në kohën kur është gjykuar kërkuesi për akuzën e pjesëmarrjes në bandë të armatosur, KP-ja bënte dallim ndërmjet pjesëmarrjes në bandë të armatosur dhe në organizatë kriminale. Neni 28 i KP-së së mëparshme, i zbatuar nga Gjykata e Apelit Durrës, parashikonte se "banda e armatosur dhe organizata kriminale përfaqësojnë forma të bashkëpunimit të veçantë, të cilat dallojnë nga njëra-tjetra jo vetëm nga numri i pjesëmarrësve, por edhe nga shkalla e organizimit dhe e qëndrueshmërisë së tyre për kryerjen e një numri veprash penale". Ligji nr. 9275, datë 16.09.2004 e ndryshoi nenin 28 duke bërë përsëri dallimin ndërmjet organizatës kriminale dhe bandës kriminale, por duke qartësuar dallimet ndërmjet këtyre formave të bashkëpunimit kriminal. Pra, ndryshe nga sa shprehet kërkuesi në kërkesë, pjesëmarrja në organizatë kriminale dhe pjesëmarrja në bandë kriminale janë vepra të ndryshme penale. Gjykata çmon se parimi *ne bis in idem* nuk është shkelur, pasi edhe nëse vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës do të lexohej si vendim pafajësie për pjesëmarrje në bandë të armatosur, vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda

(vendimi i formës së prerë) lidhet me një vepër tjetër penale, që është pjesëmarrja në një organizatë kriminale, dallim i qartësuar nga neni 28 i KP-së *(shih vendimin nr. 33, datë 22.07.2011, paragrafët 21-22, të GJK-së)*

b) Për Gjykatën e Lartë

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjësë së gjykuar, pasi sipas vendimit të dhënë nga gjykata e apelit, kërkuesi e ka shlyer dënimin e dhënë ndaj tij me shërbim prove. Ndërsa, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka vendosur që ai të kryejë dënimin dy herë për të njëjtin fakt penal, duke urdhëruar vuajtjen edhe një herë të dënimit për të. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se sipas vendimit të gjykatës së shkallës së parë, të lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, kërkuesi është dënuar përfundimisht për të vuajtur dënimin e tij me 4 vjet e 8 muaj burgim. Gjithashtu, rezulton se urdhri i ekzekutimit për dënimin e tij me shërbim prove, sipas vendimit të gjykatës së apelit, ka filluar të ekzekutohet në datën 30.06.2017 dhe ka pushuar së ekzekutuari në datën 25.06.2020, për shkak të ligjit nr. 5/2020 "Për dhënie amnistie". Gjykata vëren se nga data kur ka filluar ekzekutimi i dënimit të kërkuesit me shërbim prove deri në datën e pushimit të tij ka kaluar një periudhë prej rreth 3 vjetësh. Gjykata evidenton se ndaj kërkuesit është zhvilluar vetëm një proces penal për akuzën e ngritur nga prokuroria. Nuk rezulton që për të njëjtën sjellje dhe veprim ndaj tij të jetë zhvilluar një proces i dytë gjyqësor ose që ai të jetë gjykuar dhe dënuar më shumë se një herë për të njëjtin fakt penal. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është vënë në lëvizje rregullisht me rekurs brenda të njëjtit procedim penal dhe në përfundim të shqyrtimit të rekursit, ai ka disponuar për cilësimin juridik të veprës penale të kryer dhe alternativën e dënimit me burgim *(shih vendimin nr. 47, datë 05.10.2023, paragrafët 29-30, të GJK-së)*

8. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjësë së gjykuar, pasi gjykatat, duke shkelur detyrimin që rrjedh nga neni 132 i Kushtetutës për fuqinë përfundimtare dhe detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kanë cenuar parimin e sigurisë juridike. Sipas kërkuesit, kjo shkelje lidhet me moszbatimin prej tyre të vendimit nr. 9, datë 26.02.2016 të Gjykatës, i cili ka shfuqizuar nenin 278 të KP-së dhe, për rrjedhojë, kanë dhënë dënim duke u bazuar në dispozitën ligjore të shfuqizuar. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata vëren se kërkuesi është dënuar, ndër të tjera, për kryerjen e veprës penale "Mbajtja pa leje të armëve luftarake dhe municionit", të parashikuar nga neni 278, pika 4, i KP-së në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale (viti 2014). Gjykata konstaton se vendimet gjyqësore të gjykatave të faktit janë dhënë përpara shfuqizimit të paragrafit 5 të nenit 278 të KP-së, përkatësisht në datat 01.10.2015 (vendimi gjyqësor i shkallës së parë) dhe 25.11.2015 (vendimi gjyqësor i apelit). Po kështu, edhe rekursi në Gjykatën e Lartë është ushtruar në datën 23.12.2015, pra përpara datës së hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Në këto kushte, kur janë dhënë vendimet gjyqësore nga gjykatat e faktit për shpalljen fajtor dhe dënimin e kërkuesit, ky vendim i Gjykatës nuk kishte hyrë në fuqi. Në kohën

e shqyrtimit të rekursit (datë 06.07.2021) në Gjykatën e Lartë, si vendimi nr. 9, datë 26.02.2016 i Gjykatës Kushtetuese, ashtu edhe ndryshimet ligjore që u bënë në zbatim të këtij vendimi (ligjet nr. 82/2016 dhe nr. 44/2019), të cilat ndryshuan paragrafin 5 të nenit 278 të KP-së, kishin hyrë në fuqi. Pra, në kohën e shqyrtimit të rekursit ishte në fuqi një dispozitë ligjore penale favorizuese për kërkuesin, për sa i përket masës së dënimit. Siç është përmendur edhe më lart, në kohën e dënimit të kërkuesit nga gjykatat e faktit, masa e dënimit për veprën penale të parashikuar nga paragrafi 5 i nenit 278 të KP-së ishte nga 7-15 vjet burgim, ndërsa pas ndryshimeve ligjore masa e dënimit ishte më favorizuese, nga 5-7 vjet burgim. Bazuar në sa më sipër, duke qenë se në rastin konkret çështja ishte ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe dënimi penal i dhënë ndaj kërkuesit lidhej drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit të shfuqizuar (nenin 278, paragrafi 5, i KP-së), Gjykata çmon se vendimi i saj nr. 9, datë 26.02.2016 duhej të ishte trajtuar nga Gjykata e Lartë në kuadër të efektit prapaveprues të tij në këtë rast. Kjo do t'i shërbente edhe garantimit të parimit të sigurisë juridike në fushën penale, i cili sipas jurisprudencës kushtetuese është një nga elementet e shtetit të së drejtës dhe duhet të mbahet parasysh nga ligjvënësi në përcaktimin e dënimit, çka i mundëson gjyqtarit të bëjë gjykim të drejtë dhe proporcional në raste konkrete *(shih vendimin nr. 10, datë 12.04.2022, paragrafët 43 – 46, të GJK –së)*

9. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjësë së gjykuar, pasi pasuria e konfiskuar është krijuar në mënyrë të ligjshme, me burime të prejardhura nga shitja e një pasurie, e cila i ishte nënshtruar më parë shqyrtimit gjyqësor me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për të cilën kjo gjykatë kishte disponuar se pasuria ishte krijuar me të ardhura të ligjshme. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe GJKKO-ja e Apelit janë shprehur se automjeti i sekuestruar nuk ka qenë objekt verifikimi gjatë procedimit penal të mëparshëm, ndaj dhe nuk mund të konsiderohet gjë e gjykuar. Ndërsa, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka analizuar drejtpërdrejt këtë parim, por ka mbështetur qëndrimin e gjykatave më të ulëta, duke u shprehur në vendim se "pavarësisht se Kolegji nuk i hyn shqyrtimit të provave, ai vlerëson se gjykatat më të ulëta kanë vlerësuar drejt se ekzistojnë kushtet për konfiskimin e pasurisë sipas objektit të kërkesës, referuar aktit normativ nr. 1/2020. Kolegji vlerëson se të gjitha pretendimet e ngritura në rekurs janë ngritur edhe në shkallët e tjera të gjykimit dhe kanë marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat më të ulëta.". Gjykata vlerëson se duke qenë se automjeti nuk ka qenë pjesë e gjykimit penal, kërkuesi nuk ka sjellë prova bindëse për të provuar të kundërtën e konkluzionit të gjykatave të zakonshme për këtë automjet, i cili është blerë pas kontrollit të parë që i është bërë familjes së tij në vitin 2017, kontroll i përfunduar me vendimin nr. 80, datë 03.11.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (*shih vendimin nr. 4, datë 21.02.2022, paragrafët 55-56, të GJK-së*).

10. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjësë së gjykuar, pasi gjykatat e zakonshme kanë refuzuar kërkesën për dërgimin e letërporosisë pranë autoriteteve italiane për të konfirmuar zyrtarisht kallëzimin nga e dëmtuara dhe dënimin për të njëjtën vepër penale në shtetin italian. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se nga dokumentet e ndodhura në dosjen gjyqësore dhe nga argumentet e

parashtruara nga kërkuesi gjatë gjykimit kushtetues, nuk rezulton të ketë nisur ndonjë procedim penal në ngarkim të tij ose ai të jetë dënuar me vendim të formës së prerë për veprën për të cilën ai është dënuar në shtetin shqiptar *(shih vendimin nr. 8, datë 28.02.2012, paragrafi 11, të GJK-së).*

11. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjësë së gjykuar, pasi kërkuesi është ndjekur penalisht dhe është dënuar në mënyrë të përsëritur për të njëjtat vepra penale për të cilat ishte pushuar procedimi penal, pa u shfuqizuar më parë vendimi i pushimit. Po ashtu, kërkuesi pretendon se lidhur me akuzën e armëmbajtjes pa leje ai ishte dënuar më parë me një vendim penal të formës të prerë dhe po për të njëjtën armë është dënuar përsëri nga gjykatat. Gjykata i ka vlerësuar si të pabazuara këto pretendime. Në lidhje me pretendimin e parë, Gjykata vë në dukje se funksioni kushtetues i dhënies së drejtësisë nga gjykatat është i ndryshëm nga funksioni i ndjekjes penale që ushtron prokurori. Kur ushtron ndjekjen penale, prokurori vetëm mbledh provat për të vërtetuar akuzën dhe verifikon nëse ndodhet në kushtet që e detyrojnë të pushojë akuzën ose çështjen penale apo ta dërgojë çështjen në gjykatë. Gjykata, në përfundim të procesit, vendos për deklarimin fajtor ose të pafajshëm të të pandehurit, që do të thotë se në ushtrim të funksionit të dhënies së drejtësisë në kontekstin penal është gjykata që vendos për themelin e akuzës së ngritur nga prokurori. Për pasojë, pushimi i akuzës ose i çështjes penale nga prokurori, në vetvete, nuk barazohet me pafajësinë e të pandehurit. Në rastin e parashikuar nga pika "dh" e nenit 328 të KPP-së, çështja penale është e hapur dhe hetimet vazhdojnë, pasi autori nuk është gjendur ende. Organi i akuzës ka detyrimin të vazhdojë punën për zbardhjen e ngjarjes dhe me gjetjen e provave të reja prokuroria mund të ngrejë akuzë edhe ndaj personit për të cilin kishte pushuar më parë procedimin penal, por është gjykata ajo që do të vendosë për fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit me një vendim përfundimtar. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i prokurorit për pushimin e çështjes penale nuk përfaqëson një vendim përfundimtar të formës së prerë të dhënë nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe në këtë kuptim nuk ka cenim të parimit *ne bis in idem*. Në lidhje me pretendimin e dytë, Gjykata vlerëson se megjithëse kërkuesi ndodhet përpara akuzave të njëjta, ato jo vetëm që i referohen dy ngjarjeve të ndryshme, por madje nuk i referohen as të njëjtës armë për të cilën ai ka vuajtur dënimin e dhënë nga gjykata *(shih vendimin nr. 10, datë 02.04.2009, paragrafët a.5 – a.7 dhe paragrafi b.4, të GJK-së).*

5. Mosrëndimi i pozitës së të pandehurit (Ndalimi i *reformatio in peius*)

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse

1. Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit është i lidhur me garancinë e aksesit në gjykatë si element i procesit të rregullt. Kushtetuta dhe KEDNJ-ja nuk e përmendin në mënyrë të shprehur këtë parim, por ai në vetvete e përmban dimensionin kushtetues. Zbatimi i këtij parimi është një garanci më shumë për të gjykuarin, me qëllim që ai të realizojë në mënyrë efektive të drejtën për t'iu drejtuar me ankim gjykatës. Ekzistenca e këtij parimi u jep mundësi të gjykuarve të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetuta vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre. Nga ky këndvështrim, mosrespektimi i parimit për mosrëndimin e pozitës së të pandehurit do të përbënte njëkohësisht cenim të thelbit të një gjykimi dhe në veçanti të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së *(shih vendimet nr. 45, datë 03.07.2017, paragrafi 19; nr. 15, datë 22.07.2008, paragrafi 3; nr. 13, datë 15.04.2003, paragrafi 4, të GJK-së).*

2. Rasti kur rekursi paraqitet nga individi nuk është i njëjtë me rastin kur rekursi paraqitet nga prokurori. Rekursi i paraqitur nga prokurori mbart në vetvete mundësinë e përkeqësimit të pozitës së individit, ndaj gjykatat duhet të tregojnë kujdes të shtuar për t'i siguruar individit mbrojtje efektive në funksion të gjykimit të drejtë. Kur ekziston mundësia e rëndimit të pozitës së individit, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të mbajnë në konsideratë disa standarde minimale, të cilat përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

- veprimet verifikuese nëse ankimi/rekursi i është komunikuar rregullisht individit dhe mbrojtësit të tij për t'u siguruar që ai ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim dhe zgjedhja e një mbrojtësi;
- zhvillimin e një debati të vërtetë ndërmjet palëve ndërgjyqëse;
- sigurimin që mbrojtësi i caktuar është njohës i çështjes dhe ka shprehur interes për gjendjen dhe situatën e individit nëpërmjet aksesit në dosjen gjyqësore dhe marrjes së informacionit të plotë dhe të saktë për çështjen e tij;
- rolin aktiv të mbrojtësit në kryerjen e veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji që dëshmojnë realisht mbrojtjen e interesit të të gjykuarit;
- kohën e caktimit të mbrojtësit për t'i mundësuar atij kushtet e duhura, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të studiuar dosjen dhe për të përgatitur mbrojtjen;
- mënyrën e paraqitjes dhe artikulimin e argumenteve të përdorura nga mbrojtësi gjatë procesit, për të treguar se ai nuk është në situatën e "dështimit të dukshëm" në përmbushjen e detyrave të tij;
- realizimin e kontakteve të mbrojtësit me individin për t'i siguruar atij ndihmë juridike efektive;
- ndërhyrjen e gjykatës kur ajo vlerëson se përfaqësimi nga ana e avokatit mbrojtës është dukshëm joefektiv ose tepër i dobët *(shih vendimin nr.34, datë 17.11.2022, paragrafi26, të GJK-së).*

b. Precedentët ku çështja e cenimit të parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit është vënë në diskutim

a) Për Gjykatën e Lartë

3. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Lartë në rigjykimin e çështjes kanë rënduar pozitën e tij, pasi e kanë deklaruar fajtor edhe pse ndaj vendimit të pafajësisë të dhënë fillimisht ndaj tij nuk ishte ushtruar rekurs nga prokurori. Sipas kërkuesit, edhe Gjykata e Lartë nuk ka korrigjuar të metat e gjykatave të faktit. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata në këtë drejtim ka theksuar se është kompetencë e Kolegjit Civil/Penal (dhoma e këshillimit) të analizojë dhe vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Megjithatë, ky standard nuk duhet kuptuar sikur i mundëson Gjykatës së Lartë ushtrimin e kompetencës së mësipërme në mënyrë diskrecionale. Gjykata ka theksuar se standardet kushtetuese për proces të rregullt ligjor duhen respektuar në të gjitha fazat e gjykimit, përfshirë këtu shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit. Rekursi është mjeti procedural në dispozicion të kërkuesit, me anë të të cilit ai mund të ketë akses në Gjykatën e Lartë, duke e investuar këtë të fundit me shqyrtimin e pretendimeve të tij. Për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor. Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, në funksionin e saj si gjykatë e ligjit, edhe pse gjatë gjykimit të parë, të paankimuar nga prokuroria, kërkuesi është shpallur i pafajshëm dhe në rigjykim është deklaruar fajtor, nuk e ka shqyrtuar në themel pretendimin e kërkuesit lidhur me cenimin e parimit të mosrëndimit të pozitës. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë i ka mohuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë, si dhe të drejtën e ankimit në kuptimin substancial në këndvështrim të së drejtës për të pasur një vendim përfundimtar që do t'u jepte përgjigje pretendimeve të tij me natyrë kushtetuese *(shih vendimin nr. 45, datë 03.07.2017, paragrafët 28-30, të GJK –së).*

4. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka zbatuar ligjin penal në mënyrë të gabuar duke dhënë një dënim më të lartë për kërkuesin e duke rënduar kështu pozitën e tij, në një kohë që rekursi para Gjykatës së Lartë ishte paraqitur nga kërkuesi. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është vënë në lëvizje vetëm me rekursin e kërkuesit. Ky Kolegj, në përfundim të gjykimit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit për sa i përket deklarimit fajtor të kërkuesit sipas nenit 298/3 të KP-së, si dhe prishjen e këtij vendimi dhe pushimin e gjykimit të çështjes për veprën penale të parashikuar nga neni 297/2 të KP-së, për shkak se fakti nuk përbën vepër penale. Për sa i përket masës së dënimit të kërkuesit, Kolegji ka vendosur dënimin me 20 vjet burgim për veprën penale të parashikuar nga

neni 298/3 i KP-së, ndërkohë që kërkuesi ishte dënuar për këtë vepër me 17 vjet burgim. Siç rezulton nga faktet e mësipërme, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin vetëm të kërkuesit, ka caktuar për veprën penale të parashikuar nga neni 298/3 i KP-së një masë dënimi më të rëndë nga ai i vendimit të apeluar. Në këto kushte, Gjykata e Lartë nuk ka respektuar parimin për mosrëndimin e pozitës së të pandehurit, duke i cenuar kërkuesit të drejtën për t'iu drejtuar me ankim gjykatës si aspekt i procesit të rregullt ligjor në gjykimin në fjalë. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për sa i përket caktimit të masës së dënimit të kërkuesit, është marrë në kundërshtim me kërkesat e një procesi të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe KEDNJ-së *(shih vendimin nr. 15, datë 22.07.2008, paragrafët 7 – 9, të GJK-së).*

5. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, pasi edhe pse kërkuesi ishte deklaruar i pafajshëm me vendim të gjykatës së shkallës së parë, që është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, Gjykata e Lartë, mbi rekursin e prokurorit, pa asnjë provë të re, por me një arsyetim tjetër të vendimit, e ka deklaruar fajtor dhe e ka dënuar atë. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. dhe ka sjellë në vëmendje edhe qëndrimin që kanë mbajtur edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 2, datë 19.04.2001 për unifikimin e praktikës gjyqësore, duke përcaktuar se në rastet e shkeljes së ligjit nga gjykatat më të ulëta në dhënien e vendimeve, Gjykata e Lartë ka detyrimin ligjor t'i prishë këto vendime dhe të disponojë në një nga mënyrat që përcakton neni 441 i KPP-së. Por, në rastin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vepruar në kundërshtim me këtë vendim unifikues, sepse nuk ka disponuar në një nga mënyrat e përcaktuara në nenin 441 të KPP-së, duke e privuar kërkuesin nga e drejta e mbrojtjes si një e drejtë themelore në gjykimin penal, gjë që e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, për të zbatuar drejt kërkesat e Kushtetutës dhe të ligjit procedural, duhej, pas prishjes së vendimeve, ta kthente çështjen për rigjykim për t'i dhënë mundësi kërkuesit të përfitonte të drejtat që garanton neni 31 i Kushtetutës gjatë procesit penal lidhur me kohën dhe lehtësitë e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e vet. Mohimi i së drejtës së mbrojtjes prek standarde kushtetuese të rëndësishme, sepse këto shkelje cenojnë parimin e mbrojtjes në gjyq dhe ndikojë drejtpërsëdrejti dhe negativisht në dhënien e drejtësisë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 442 të KPP-së, ka dalë jashtë juridiksionit që i njeh ligji, gjë që e bën procesin të parregullt në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës *(shih vendimin nr. 9, datë 11.05.2006, paragrafët 6 - 9 të GJK –së).*

6. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat e zakonshme për njohjen e vendimit të gjykatës greke që e ka dënuar me 18 vjet burgim kërkuesin. Ky vendim është marrë bazuar mbi kërkesën e avokatit të caktuar kryesisht nga gjykata, i cili pa dijeni e miratim të kërkuesit ka kërkuar qysh në procesin e njohjes në gjykatën e rrethit, ashtu dhe në ankim e në rekurs aplikimin e dispozitave ligjore dhe të dënimit

në disfavor me interesat e kërkuesit. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë janë vënë në lëvizje e kanë pranuar kërkimet e avokatit, të cilat janë bërë tej tagrave të tij ligjore e etike. Në këto kushte, avokati ka vepruar në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrimeve të tij, ndërsa gjykatat kanë zhvilluar një proces të parregullt gjyqësor në kundërshtim me nenin 42/1 të Kushtetutës. Duke pranuar zhvillimin e një procedure gjyqësore të veçantë, Gjykata vlerëson se në zhvillimin e saj duhet të respektohen një sërë të drejtash të garantuara nga Kushtetuta e ligji procedural penal e sidomos e drejta e mbrojtjes. Gjykimi për njohjen e vendimit penal dhe konvertimin e dënimit të huaj, edhe pse nuk është gjykim themeli, është një gjykim i posaçëm (*sui generis*); se vendimi i dhënë pavarësisht nga natyra e tij është një vendim gjyqësor ndaj të cilit, sipas Kushtetutës, kushdo ka të drejtë të ankohet në një gjykatë më të lartë. Në vendim, lidhur ngushtë me çështjen në shqyrtim, pranohet zbatimi i nenit 425 të KPP-së mbi mosrëndimin e pozitës së të pandehurit *(shih vendimin nr. 6, datë 30.03.2004, paragrafët 13 -17, të GJK –së)*

7. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi bazën e rekursit të ushtruar nga të gjykuarit, ka prishur dy vendimet dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata është shprehur se pretendimi i kërkuesit se gjykatat gjatë rigjykimit të çështjes kanë rënduar pozitën e të pandehurit duhet parë i lidhur ngushtë edhe me kërkesat e nenit 447, pika 2, të KPP-së. Gjykata e rigjykimit ka vetëm kufizimin që t'i përmbahet vendimit të Gjykatës së Lartë për çdo çështje të së drejtës që është vendosur në të. Kjo do të thotë se gjykata e rigjykimit për çdo çështje tjetër që nuk përmbahet në vendimin e Gjykatës së Lartë është e lirë të vendosë vetë. Nga shqyrtimi i rastit konkret nuk rezulton që gjykata e rigjykimit të mos u jetë përmbajtur çështjeve të së drejtës që arsyetohen në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Ajo ka evituar shkeljen procedurale lidhur me mbrojtësin, si dhe ka kryer një hetim në themel të çështjes, duke vlerësuar të gjitha rrethanat e kryerjes së veprës penale, pozitën e të pandehurve në të dhe kualifikimin ligjor të veprës së kryer, mbi bazën e të cilave ka vendosur dhe një masë dënimi *(shih vendimin nr. 13, datë 15.04.2003, paragrafët 8 -9 të GJK–së).*

8. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, pasi çështja në gjykatën e apelit u shqyrtua mbi ankimin e të pandehurve dhe jo mbi ankimin e prokurorit. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata është shprehur se ndryshe nga sa pretendohet në kërkesën drejtuar Gjykatës, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk cenon parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit dhe nuk ka të bëjë me të drejta të fituara. Sipas nenit 43 të Kushtetutës, kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë. Është e vërtetë që me ankimin atij nuk mund t'i rëndohet pozita, por ky parim, pra mosrëndimi i pozitës, shërben si garanci kur mjetin e ankimit e ka përdorur i pandehuri dhe nuk mund të shërbejë si i tillë kur mjetin e ankimit e ka përdorur prokurori. Ky i fundit,

në zbatim të detyrave kushtetuese, përfaqëson akuzën dhe i nënshtrohet Kushtetutës e ligjeve. Prandaj për rastet e shkeljeve ligjore nga gjykatat, të konkretizuara në një vendim të paligjshëm, prokuroria nuk mund të qëndrojë indiferente. Ajo ka detyrë të ushtrojë të gjitha mjetet procedurale për zbatimin e drejtë të ligjit. Atë që nuk mund ta bënte në rastin konkret gjykata e apelit, për shkak të kufizimit procedural të parashikuar në nenin 425, pika 3, të KPP-së, e realizoi Gjykata e Lartë, e cila sipas nenit 432 të KPP-së pranon rekurset kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të apeleve e të rretheve dhe vendos për çështjet ligjore sipas neneve 434 e 441 të KPP-së *(shih vendimin nr. 96, datë 27.07.2001, paragrafët 4-5, të GJK-së).*

VI. Garanci specifike në lidhje me të drejtat substanciale

1. Kufizimi i lirisë

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse[17]

Neni 27, pika 1, i Kushtetutës:
1. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.
2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme:
a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;
b) për moszbatim të urdhrave të ligjshme të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj;
c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;
ç) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;
d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;
dh) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit.

1. Neni 27, pika 1, i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj, të cilat parashikohen në mënyrë të detajuar në KPP. Qëllimi kryesor i kësaj dispozite është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustifikuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një "shoqëri demokratike". Në rastet që kanë të bëjnë me heqjen e lirisë, është thelbësore që kushtet për heqjen e lirisë të jenë qartësisht të përcaktuara sipas ligjit të brendshëm dhe që vetë ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që ai të përmbushë standardin e "ligjshmërisë" të përcaktuar nga Konventa, një standard i cili kërkon që ligji të jetë mjaftueshëm i qartë për t'i mundësuar individit të parashikojë, në një shkallë të arsyeshme, rrethanat, pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar *(shih vendimin nr. 39, datë 15.02.2022, paragrafi 29, të GJK-së).*

2. E drejta e lirisë së individit dhe kufizimet e saj sanksionohen edhe në nenin 5/1, shkronja "c", të KEDNJ-së, sipas së cilës "çdokush ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj... kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent...", si dhe paragrafit 4, ku parashikohet se "çdo

[17] Standardet e përmendura në këtë pjesë përfshijnë standardet e evidentuara në jurisprudencën e Gjykatës nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/akteve normave dhe ato nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual.

person, të cilit i është hequr liria me arrestim … ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë, me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm" *(shih vendimin nr. 19, datë 02.04.2012, paragrafi 12 të GJK-së).*

➢ *1.a - Kontrolli gjyqësor i masave të sigurimit që kufizojnë lirinë*

3. Kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, konkretisht me lirinë e personit dhe këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura sipas llojit të privimit të lirisë *(shih vendimet nr. 19, datë 04.04.2023, paragrafi 30; nr. 40, datë 18.07.2012, paragrafi 19; nr. 28, datë 23.06.2011, paragrafi 12, të GJK-së).*

➢ *1.b - Dyshimet e arsyeshme për kryerjen e veprës penale*

4. "Dyshimet e arsyeshme" për kryerjen e veprës penale, që justifikojnë kufizimin e lirisë personale të individit, nënkuptojnë ekzistencën e fakteve ose informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale. Këto fakte nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, të cilat i përkasin një shkalle të mëvonshme të procesit të hetimit penal. Dyshimi konsiderohet i arsyeshëm për kufizimin e lirisë personale nëse bazohet në fakte dhe informacione, të cilat krijojnë bindjen se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprës penale për të cilën akuzohet. Ai nënkupton bindjen që krijohet në bazë të provave të marra në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat, në unitetin e tyre, tregojnë se vepra penale ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga ai që akuzohet *(shih vendimin nr. 19, datë 04.04.2023, paragrafi 31-32, të GJK-së).*

5. Neni 5/4 i KEDNJ-së siguron një garanci thelbësore kundër arbitraritetit në burgim, duke kërkuar që një individ, të cilit i është kufizuar liria, ka të drejtë të ketë një rishikim të ligjshmërisë së privimit. ... Një person i arrestuar dhe i privuar ka të drejtë që përballë gjykatave të tilla të shqyrtojë ligjshmërinë e burgosjes së tij, nën dritën jo vetëm të kërkesave ligjore kombëtare, por gjithashtu dhe të Konventës, parimeve të përgjithshme të shprehura në të dhe qëllimit të kufizimeve, të lejuara nga paragrafi 1 i nenit 5. Shqyrtimi gjithsesi duhet të jetë i gjerë mjaftueshëm për ato kritere, të cilat janë thelbësore për një masë sigurimi me kufizim lirie. (Hutchison Reid kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 20 shkurt 2003) *(shih vendimet nr. 19, datë 02.04.2012, paragrafi 13; nr. 28, datë 23.06.2011, paragrafi 17, të GJK-së).*

6. Masat përmes të cilave një i paraburgosur ose i burgosur vendoset në regjim të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burg të sigurisë së lartë, në vetvete, nuk kanë karakter ndëshkues, por parandalues. Për rrjedhojë, kufizimet që u bëhen të drejtave të një të

burgosuri si rezultat i vendosjes së tij në regjim të posaçëm burgimi, bien brenda sferës së të drejtave personale dhe, si të tilla, përfshihen brenda konceptit të "të drejtave dhe detyrimeve civile", të parashikuar në nenin 6/1 të KEDNJ-së që garanton të drejtën e procesit të rregullt *(shih vendimin nr. 5, datë 22.02.2022, paragrafi 25, të GJK-së).*

7. Në arsyetimin e vendimit të gjykatës për masat e sigurimit duhet të analizohen në mënyrë ezauruese e reale motivet konkrete të pranimit ose jo të kërkesës/ankesës për revokim a zëvendësim të masës së sigurimit dhe jo të bëhet një përshkrim ritual e formal i shkaqeve e kritereve të parashikuara nga ligji *(shih vendimin nr. 28, datë 23.06.2011, paragrafi 16, të GJK-së).*

➢ *1.c - Kufizimi i lirisë si sanksion penal*

8. Në përputhje me frymën e Kushtetutës, sanksioni penal i cilësdo natyre duhet të synojë vetëm riedukimin dhe më pas integrimin e të dënuarit në jetën shoqërore. Që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën. Në këtë mënyrë, që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën e kryer *(shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023, paragrafi 21; nr. 47, datë 26.07.2012, paragrafi 25; nr. 19, datë 01.06.2011, paragrafi IV.3, të GJK-së).*

b. Precedentët ku çështja e heqjes së lirisë është vënë në diskutim[18]

a) Për Gjykatën e Lartë

9. Përpara Gjykatës është pretenduar heqja e lirisë, pasi në kushtet kur vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër, përmes të cilit kërkuesi ishte deklaruar fajtor, është shfuqizuar nga Gjykata e Lartë, prodhon efekte vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përmes të cilit ai ishte deklaruar i pafajshëm. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata ka vërejtur se kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është vendosur me vendim gjyqësor, bazuar në dyshime të arsyeshme për kryerjen prej tij të veprave penale për të cilat akuzohet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Në këtë drejtim, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë evidentuar në vendimet e tyre ekzistencën e fakteve që mbështesin dyshimin e arsyeshëm se kërkuesi mund të ketë kryer veprën penale. Ndonëse vendimi i fajësisë është prishur dhe çështja është kthyer për rigjykim në shkallën e dytë për të vlerësuar bazueshmërinë e vendimit të pafajësisë, për sa kohë vendimi i shkallës së parë nuk ka marrë formë të prerë, kërkuesi ruan të njëjtin status procedural.

[18] Precedentët/rastet nga gjykimi kushtetues të përmendura në këtë pjesë, ku çështja e cenimit të garancive kushtetuese për kufizimin e lirisë është vënë në diskutim, përfshijnë jo vetëm ato të shqyrtuara nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual, por edhe ato nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/akteve normave. Ligjet/aktet normative objekt shqyrtimi ose të referuara në precedentët/rastet nga gjykimi kushtetues janë ato akte që kanë në fuqi në kohën e shqyrtimit të këtyre çështjeve.

Gjykata e apelit ka analizuar faktet dhe provat në ngarkim të kërkuesit në raport me kushtet dhe kriteret për kufizimin e lirisë personale, duke arsyetuar në vendimin e saj, si për sa u takon pretendimeve të tij për cenimin e lirisë personale, ashtu edhe për sa u përket konkluzioneve të arritura prej saj për ekzistencën e "dyshimeve të arsyeshme" për kufizimin e kësaj të drejte. Po kështu, pretendimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs janë analizuar dhe vlerësuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka arsyetuar gjetjet e saj në drejtim të të drejtave procedurale dhe kushtetuese të tij *(shih vendimin nr. 19, datë 04.04.2023, paragrafi 37, të GJK-së).*

10. Përpara Gjykatës është pretenduar heqja e lirisë, pasi, pas ekzekutimit të vendimit të dënimit alternativ, mbi bazën e rekursit të prokurorit, gati pas 5 vjetësh nga dhënia dhe 2 vjetësh nga vuajtja e tij, vendimi është prishur nga Gjykata e Lartë, çka nënkuptonte vuajtjen nga kërkuesi të një pjese të dënimit me burgim tashmë fizikisht. Gjykata e ka vlerësuar pretendimin e kërkuesit për cenimin e lirisë personale në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në rastin konkret vlerë përcaktuese në pasojat që vendimmarrja e Gjykatës së Lartë ka sjellë ndaj kërkuesit ka luajtur situata faktike e mbivendosjes së kohës së shqyrtimit të rekursit të prokurorisë me atë të përfundimit nga kërkuesi të ekzekutimit të dënimit alternativ të dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës dhe kryerjes së plotë prej tij të këtij dënimi, sipas urdhërimit të gjykatës, situatë e cila kërkon vlerësim të veçantë kushtetues në drejtim të kufizimit të lirisë personale, si rrjedhojë e përputhshmërisë së kohës së ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit me përfundimin e gjykimit nga Gjykata e Lartë. Gjykata ka theksuar se Gjykata e Lartë ka pasur detyrimin për marrjen e informacionit në këtë drejtim, për të shmangur në këtë mënyrë rindëshkimin e kërkuesit pas shlyerjes më parë të dënimit. Nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Lartë, kërkuesi është ngarkuar të vuajë sërish një pjesë të dënimit me burgim, të vuajtur më parë prej tij në një prej mënyrave alternative të këtij dënimi. Një vendimmarrje e tillë, e ndërlidhur me një arsyetim të mangët të situatës faktike dhe juridike të kërkuesit, duke mos vënë në diskutim dhe mos marrë në analizë faktin se dënimi me burgim i caktuar ishte ekzekutuar tërësisht, ka cenuar lirinë personale të kërkuesit, si dhe funksionin e dhënies së drejtësisë penale dhe atë riedukative të dënimit, në kushtet kur kërkuesi tashmë e kishte kryer dënimin penal për veprën e kryer *(shih vendimin nr. 24, datë 27.04.2023, paragrafët 29-31, të GJK-së).*

11. Përpara Gjykatës është pretenduar heqja e lirisë, pasi në shqyrtimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit, Gjykata e Lartë (dhoma e këshillimit) nuk duhej të ishte mbështetur te neni 432 i KPP-së, por te neni 249 i KPP-së, i cili përcakton shqyrtimin e ankimit brenda 15 ditëve në seancë gjyqësore. Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim. Sipas saj, ndër të tjera, kompetenca e Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit për mospranimin e rekursit, jashtë shkaqeve të përcaktuara në nenin 432 të KPP-së, pa pjesëmarrjen e palëve, e justifikon të njëjtën procedurë edhe në rast të zbatimit të nenit 249 të KPP-së për ankim ndaj masave të sigurimit. Mosrespektimi i afatit 15-ditor, të përcaktuar nga neni 249/10 i KPP-së për marrjen e vendimit nga Gjykata e Lartë në rast rekursi kundër masave të sigurimit, nuk passjell humbjen e fuqisë së masës së sigurimit,

në dallim nga mosrespektimi i afatit 10-ditor për marrjen e vendimit në rast apelimi të masës së sigurimit në Gjykatën e Apelit, sipas nenit 249/5 të KPP-së, dhe kjo për arsye se neni 249/7 i KPP-së ka përcaktuar në mënyrë të shprehur vetëm efektet e mosrespektimit të afatit 10-ditor në rast mosshqyrtimi të apelit *(shih vendimin nr. 28, datë 23.06.2011, paragrafi 25, të GJK-së).*

12. Përpara Gjykatës është pretenduar heqja e lirisë, pasi kërkuesi është ndaluar në kundërshtim me ligjin: gjatë gjykimit të zakonshëm ai ka ngritur pretendimin se pa u formalizuar proceduralisht arrestimi ose ndalimi i tij, si dhe pa iu komunikuar akuza ose shkaku i ndalimit, pa iu bërë e njohur asnjë e drejtë, as e drejta për mbrojtje, ai i është nënshtruar veprimit procedural të "njohjes së personit". Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim. Sipas saj, ndër të tjera, ky pretendim, në vetvete, është i lidhur ngushtë dhe në mënyrë të pazgjidhshme me pozitën juridiko-procedurale penale të kërkuesit, deri në momentin që mbi të ka vepruar urdhri i ndalimit i nxjerrë nga prokurori. Përcaktimi i kësaj gjendjeje është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për themelësinë e këtij pretendimi, kur, për më tepër, referuar shkresës të Komisariatit të Policisë Fier, kërkuesi është shoqëruar në këtë komisariat si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të kallëzuar. Gjykata e Lartë, bazuar edhe në vendimin unifikues nr. 3, datë 27.09.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me këtë pretendim, sepse kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta është detyrë dhe funksion i kësaj gjykate *(shih vendimin nr. 19, datë 02.04.2012, paragrafët 14-15, të GJK-së).*

2. E drejta e pronës

a. E drejta e pronës: kuptimi dhe standardet[19]

Nenet 41 dhe 181 të Kushtetutës
Neni 41
1. E drejta e pronës private është e garantuar.
2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.
3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.
4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.
5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

Neni 181
1. Kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41.
2. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të.

Neni 1, Protokolli nr. 1 i KEDNJ-së– E drejta e pronës
1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.
2. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave, të kontributeve ose të gjobave të tjera.

➢ *Për kuptimin e nenit 41 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së*

1. E drejta e pronës, si e drejtë universale e njeriut, përfshin çdo posedim të sendeve ose të drejtave të tjera materiale pasurore. Në një shtet demokratik, individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i së drejtës së pronës.

[19] Standardet e përmendura në këtë pjesë përfshijnë standardet e evidentuara në jurisprudencën e Gjykatës nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/akteve normave dhe ato nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual.

E drejta e pronës në çdo rast shtrihet ndaj sendeve pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se, me gjithë mbrojtjen që ajo gëzon, e drejta e pronës mund t'u nënshtrohet kufizimeve. Këto kufizime duhen bërë sipas disa kritereve të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 17 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 25, datë 28.04.2014, paragrafi 43; nr. 12, datë 28.4.2009; nr. 10, datë 19.03.2008 të GjK-së*).

2. Neni 41 i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës private, si dhe përcakton kritere për shpronësimin apo kufizimin me ligj në ushtrimin e kësaj të drejte. Po ashtu, neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së garanton në substancë të drejtën e pronës. Ky nen mbron gëzimin e qetë të pronës, vendos kushte për privimin nga pasuria, si dhe u njeh shteteve të drejtën, mes të tjerash, të kontrollojnë përdorimin e pasurive në pajtim me interesin e përgjithshëm *(shih vendimin nr. 29, datë 31.05.2010 të GJK-së)*. Me anë të shpronësimit një subjekt mund të privohet nga e drejta e pronësisë që ka në favor të një subjekti tjetër përgjithësisht publik, por jo detyrimisht. Pra, shpronësimi mund të zërë vend edhe në dobi të personave privatë, i bërë mbi bazën e një politike të llogaritur për të arritur drejtësi shoqërore brenda komunitetit. Shpronësimi kërkohet të realizohet me "ligj" dhe "vetëm për interesa publikë". Ai është i lejueshëm "vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë". Shpronësimi është një marrëdhënie midis individit pronar dhe shtetit, ku individi zhvishet nga e drejta e pronësisë sa herë që ndërhyn një interes publik dhe ka të drejtë të ketë pretendime vetëm në lidhje me masën e shpërblimit. Gjithashtu, Gjykata është shprehur se e drejta e pronës private është e garantuar nëse në rastet e shpronësimit shteti merr përsipër të respektojë kufizimin në përmbushje të një interesi publik, kundrejt një shpërblimi të drejtë dhe në respektim të së drejtës së ankimit të individit të cenuar për masën e shpërblimit. Në këto raste, për sa i takon së drejtës së aksesit në gjykatë, neni 42 nuk konkurron me nenin 41, pika 5, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 4, datë 23.02.2016; nr. 17, datë 23.04.2010; nr. 35, datë 10.10.2007 të GJK-së*).

3. Sipas nenit 41 të Kushtetutës: "Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil". Në legjislacionin tonë, sa më sipër, rregullohet përmes nenit 149 të KC-së, i cili parashikon se: "Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji", ndërsa në nenet 164-190 të këtij kodi parashikohen mënyrat përkatëse të fitimit dhe të humbjes së pronësisë. Sipas nenit 169 të KC-së: "Personi që ka poseduar qetësisht e pa ndërprerje, duke u sjellë sikur të ishte pronar për njëzet vjet në një pronë të paluajtshme, bëhet pronar i saj". Parashkrimi fitues (me titull ose pa titull) është një nga mënyrat e fitimit të pronësisë, parashikuar në nenet 168 dhe 169 të KC-së. Në thelb, elementi i përbashkët i parashkrimit fitues me titull dhe atij pa titull është posedimi i qetë dhe pa ndërprerje i sendit. Për parashkrimin fitues me titull (sikurse parashikohet nga neni 168 i KC-së), përveç posedimit të pandërprerë prej 10 vjetësh të sendit të paluajtshëm, kërkohet që të ekzistojë veprimi juridik për kalimin e pronësisë, veprim i cili nuk është i ndaluar nga ligji, si dhe ekzistenca e mirëbesimit (vetëm për kohën e bërjes së veprimit juridik për fitimin e pronësisë), pra që fituesi i sendit nuk ka ditur ose nuk ka qenë i detyruar të dinte që personi nga i cili ka fituar sendin nuk ishte pronar

ose që veprimi juridik për kalimin e pronësisë nuk ishte i vlefshëm. Parashkrimi fitues me titull mbulon çdo lloj pavlefshmërie, si atë relative, ashtu edhe atë absolute, sepse kjo është një mënyrë fitimi pronësie me anë të posedimit dhe një mënyrë primare e fitimit të pronësisë. Ndërsa fitimi i pronësisë me parashkrim fitues pa titull, institut i parashikuar nga neni 169 i KC-së, ka si element thelbësor dhe të vetëm ekzistencën e posedimit qetësisht dhe pa ndërprerje të sendit të paluajtshëm për 20 vjet. Natyrisht që sjellja gjatë këtij posedimi duhet të jetë njësoj sikur poseduesi të ishte pronar i sendit. Nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në këto dispozita, pronari i mëparshëm i sendit humbet të drejtën e tij të pronësisë mbi sendin, pasi parashkrimi fitues në kushtet e përcaktuara në ligj mund të sjellë lindjen ose fitimin e së drejtës së pronësisë *(shih vendimin nr. 4, datë 23.02.2016, paragrafi 13, të GJK-së*).

4. Kushtetuta në nenin 41 parashikon se cenimi i së drejtës së pronës si përjashtim mund të bëhet vetëm në formën e "shpronësimit" dhe të "kufizimit". Kufizimi i ligjshëm që mund t'i bëhet së drejtës së pronësisë, në njërën prej këtyre dy situatave, kërkohet të realizohet me "ligj" dhe "vetëm për interesa publikë". Gjithashtu, nëse kufizimi i së drejtës së pronës është në atë masë sa të barazohet me shpronësimin, atëherë ai është i lejueshëm "vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë". Në terminologjinë e përdorur nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk përmendet termi "shpronësim". KEDNJ-ja i referohet "privimit nga zotërimet", koncept që sipas GJEDNJ-së përfshin si shpronësimin formal dhe atë *de facto (shih vendimin nr. 17, datë 23.04.2010, paragrafi 11, të GJK-së; shih vendimin Sporrong & Lönnroth v. Suedisë (1982) dhe Lithgow v. Mbretërisë së Bashkuar, 1986).*

5. Kushtetuta nuk prezanton ndonjë përkufizim të konceptit të pronësisë, përveçse rregullimit të nenit 41, sipas të cilit: "Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil". Në legjislacionin tonë, sa më sipër, rregullohet përmes nenit 149 të KC-së, i cili parashikon se: "Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji", ndërsa në nenet 164-190 parashikohen mënyrat përkatëse të fitimit dhe të humbjes së pronësisë. Sipas nenit 191 të KC-së, "heqja dorë nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme në dobi të një tjetri, është e vlefshme kur bëhet me akt noterial e regjistrohet". Neni 192 parashikon: "Sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji". Neni 195 i KC-së parashikon: "Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi ato që janë fituar ose njohur sipas dispozitave të këtij Kodi, nuk mund të tjetërsohen dhe kur është rasti, të ngarkohen me barrë, në rast se nuk është bërë regjistrimi i tyre në regjistrat e pasurive të paluajtshme" (*shih vendimin nr. 17, datë 23.04.2010, paragrafi 14, të GJK-së*).

6. Formulimi i parashikuar në nenin 41 të Kushtetutës pranon në mënyrë pohuese se e drejta e pronësisë mund të kufizohet. Termi që përdoret në Kushtetutë është se e drejta e pronësisë është e garantuar, por jo e paprekshme. Kjo e drejtë është e garantuar,

nëse në rast të kufizimit të pronësisë private (shpronësimi apo kufizime që barazohen me shpronësimin) shteti merr përsipër që të respektojë kufizimin në përmbushje të një interesi publik, kundrejt një shpërblimi të drejtë dhe në respektim të së drejtës së ankimit të individit të cenuar për masën e shpërblimit. Në ditët tona, teoria kushtetuese na ofron një përkufizim të tillë të konceptit "shpronësim", sipas të cilit një subjekt mund të privohet nga e drejta e pronësisë që ka në favor të një subjekti tjetër përgjithësisht publik, por jo detyrimisht. Pra, ajo njeh edhe shpronësimin në dobi të personave privatë të bërë mbi bazën e një politike të llogaritur për të arritur drejtësi shoqërore brenda komunitetit. Analiza dhe interpretimi nga Gjykata të disa prej koncepteve kushtetuese që kanë të bëjnë me "interesin publik" dhe me "shpërblimin e drejtë", si dhe respektimi i parimeve të drejtësisë, të proporcionalitetit apo të shtetit social përbëjnë njëkohësisht dhe kufijtë kushtetues të hapësirës së vlerësimit mbi të cilat duhet të orientohet ligjvënësi për respektimin e së drejtës së pronës (*shih vendimet nr. 35, datë 10.10.2007; nr. 30, datë 01.12.2005 të GJK-së*).

7. Neni 1, paragrafi i dytë, i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së njeh të drejtën e shteteve për të miratuar ligjet që ato i çmojnë të domosdoshme për të siguruar pagesën e taksave, të kontributeve të tjera ose të gjobave. Sipas neneve 5, 116 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kjo normë e së drejtës ndërkombëtare është e zbatueshme dhe ka përparësi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Ajo do të thotë se ligjvënësi mund të hartojë ligje që parashikojnë edhe privim të së drejtës së pronës, kur kjo masë çmohet e domosdoshme për të siguruar pagimin e detyrimeve me karakter fiskal. Sipas kuptimit të normave kushtetuese e ndërkombëtare të lartpërmendura dhe vetëm për këto qëllime, prona e sekuestruar trajtohet si pronë e ligjshme shtetërore, e cila gëzon të njëjtën mbrojtje me ligj, ashtu si dhe ajo private, në kuptim edhe të nenit 11 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(shih vendimin nr. 16, datë 17.04.2000 të GJK-së).*

8. Në aspektin konventor e drejta e pronës private mbrohet nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, sipas të cilit çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit të qetë të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Në lidhje me këtë dispozitë, GJEDNJ-ja ka theksuar se ajo përfshin tri garanci që duhet të zbatohen në shqyrtimin e pretendimeve për cenimin e së drejtës së pronës: garancia e parë, e cila ka natyrë të përgjithshme, vendos parimin e gëzimit të qetë të pronës; garancia e dytë ka të bëjë me kufizimet e lejueshme mbi të drejtën e pronës; garancia e tretë u njeh shteteve, ndërmjet të tjerash, të drejtën për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm *(shih Sporrong and Lonnroth kundër Suedisë, 23 shtator 1982, § 61; Kasmi kundër Shqipërisë, nr. 1175/06, datë 23.06.2020, § 70)* (*shih vendimin nr. 53, datë 31.10. 2023, paragrafi 29, të GJK-së*).

9. Konkretizimi me ligj i procedurave të caktimit të taksave e tatimeve, i mbledhjes së tyre apo vendosjes së penaliteteve, në rast mosrespektimi të detyrimeve ligjore, mund të përbëjnë burim për krijimin e një marrëdhënieje të tensionuar midis pushtetit diskrecional

të legjislatorit për vendosjen e tatim-taksave dhe kufizimeve kushtetuese për ushtrimin e këtij pushteti. Akoma më i mundshëm është krijimi i këtij raporti të tensionuar nëse mbahet parasysh që GJEDNJ-ja e ka përkufizuar termin "tatimvënie", në parim, si një ndërhyrje në të drejtën e garantuar nga paragrafi i parë i nenit 1 të Protokollit nr. 1, përderisa e privon personin e interesuar nga një pronë, që do të thotë nga shuma e parave që duhet të paguhet (*shih çështjet Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar, 29 prill 2008, § 59; Orion-Břeclav, S.R.O. kundër Republikës Çeke, 13 janar 2004; shih vendimin nr. 33, datë 8.06.2016, paragrafi 39, të GJK-së*).

➢ *Lidhur me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave*

10. Gjykata ka theksuar se zgjidhja përfundimtare e problemeve që kanë të bëjnë me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, si çështje jo vetëm me interes publik, por, para së gjithash, me natyrë kushtetuese, përbën prioritet, pasi e drejta e pronës përbën një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023, paragrafi 41; nr. 1, datë 06.02.2013, paragrafi 26, të GJK-së*).

11. Dispozitat e ligjit nr. 133/2015 janë analizuar edhe nga GJEDNJ-ja në çështjen Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, vendimi i datës 17.03.2020. Sipas GJEDNJ-së, referenca e zërit kadastral fillestar të pronave të shpronësuara si bazë për kryerjen e vlerësimit financiar nuk është *per se* arbitrar. Me qëllim që të parandalohet një barrë e tepërt për subjektet e shpronësuara, mjeti juridik mund të konsiderohet efektiv nëse shuma totale e kompensimit, pavarësisht formës së kompensimit, arrin të paktën 10% të vlerës që do të ishte përfituar nëse vlerësimi financiar do të ishte kryer duke përdorur si referencë zërin kadastral aktual të pronës së shpronësuar. Pragu minimal 10% për vlerën e kompensimit mund të konsiderohet i arsyeshëm në kontekstin specifik të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave në Shqipëri, për shkak të nivelit të përgjithshëm sakrifikues që skema e re e kompensimit imponon te subjektet e shpronësuara, krahasuar me pritshmërinë e tyre për të marrë kompensim me vlerën e tanishme të tregut që buronte nga legjislacioni i mëparshëm *(shih vendimin Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, vendimi i datës 17.03.2020, paragrafi 196, të GJEDNJ-së; vendimin nr. 4, datë 15.02.2021, paragrafi 15, të GJK-së)*. Pragu i rekomanduar nga GJEDNJ-ja prej 10% të vlerës që duhet përfituar, nëse do të përdorej si referencë zëri kadastral aktual i pronës së shpronësuar, përbën minimumin e garancive që duhet të sigurohen, por nuk e pengon ligjvënësin që të bëjë rregullimet e nevojshme brenda hapësirës së tij të vlerësimit dhe në përputhje me kërkesat e nenit 41 të Kushtetutës dhe faktorët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë që ndikojnë në vendimmarrjen e tij (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022, paragrafi 29; nr. 4, datë 15.02.2021, paragrafi 69, të GJK-së*).

12. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës së pronës ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Edhe pse ka konstatuar ndërhyrje në të drejtën e pronës private përmes miratimit të ligjit nr. 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave",

i cili parashikoi që të shpronësuarit të mos shpërblehen plotësisht, Gjykata ka identifikuar si interes publik zgjidhjen e çështjes së pronave me një kosto financiare dhe kohëzgjatje sa më të arsyeshme, si dhe vendosjen e paqes sociale midis kategorive të ndryshme sociale që prek kjo çështje, e cila ka mbetur e pazgjidhur prej 25 vjetësh (*shih vendimet nr. 25, datë 11.05.2023, paragrafi 23; nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 1, datë 16.01.2017 të GjK-së*).

13. GJEDNJ-ja, në disa çështje kundër Shqipërisë, ka evidentuar rëndësinë e sigurisë juridike në procesin e kthimit dhe të kompensimit të pronave, veçanërisht për sa u përket të drejtave të fituara nga vendimet që kanë njohur të drejta pronësie dhe të ruajtjes së garancive që lidhen me këto të drejta (*shih vendimin nr. 14, datë 27.02.2017, paragrafi 18, të GJK-së; shih vendimet Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 13.11.2007; Hamzaraj kundër Shqipërisë, datë 03.02.2009; Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 31.07.2012, të GJEDNJ-së*).

14. Kuvendi i Shqipërisë, pas ndryshimeve demokratike, miratoi një tërësi ligjesh, me synimin e riparimit të padrejtësive të trashëguara nga regjimi i mëparshëm lidhur me garantimin e të drejtave dhe lirive themelore, veçanërisht të së drejtës për pronë private. Fillesat e kuadrit ligjor janë ligjet nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për rikthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve". Qiramarrësit, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara, pretendonin se rregullimet ligjore ishin diskriminuese. Megjithatë, pas kontrollit të pajtueshmërisë së këtyre ligjeve me Kushtetutën, Gjykata arriti në përfundimin se rregullimet ligjore nuk i diskriminonin qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara, në raport me pjesën tjetër të popullsisë që e realizoi nevojën për strehim në bazë të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" (i ndryshuar), pasi zgjidhja e ndryshme e problemeve të strehimit që kanë këto kategori qiramarrësish nuk vjen për shkak të ndonjë diskriminimi që bëhet ndërmjet tyre, por për shkak të pozitave të ndryshme që kanë ata në fakt, të parët si qiramarrës të banesave të ndërtuara nga shteti, të dytët si qiramarrës të banesave që u kthehen ish-pronarëve *(shih vendimet nr. 1 datë 06.02.2013, paragrafi 27; nr. 11, datë 27.08.1993 të GjK-së*).

15. Nën dritën e jurisprudencës të GJEDNJ-së, për të vlerësuar respektimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, është i nevojshëm një vlerësim i përgjithshëm i interesave të ndryshëm të përfshir, duke pasur parasysh që Konventa ka synim të ruajë të drejtat, të cilat janë praktike dhe efektive. Kur një çështje në interesin e përgjithshëm rrezikohet, u takon autoriteteve publike të veprojnë në kohë të përshtatshme, në mënyrë të duhur dhe të pranueshme *(shih vendimin pilot të GJEDNJ-së në çështjen "Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë", i datës 31.07.2012, §168)*. Kushti i baraspeshës përmbyset kur persona të veçantë ose grupe sociale të veçanta mbajnë një peshë individuale tej masës ose shkallës së duhur, sado i rëndësishëm të jetë interesi i grupeve të tjera ose i komunitetit në përgjithësi (*shih vendimin nr. 1, datë 06.02.2013, paragrafi 34 të GJK-së; shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen "Radovici dhe Stanescu kundër Rumanisë", i datës 02.02.2007*).

16. Legjislacioni i rikthimit të pronës, veçanërisht, nëse shoqërohet me zbatimin e reformave sociale dhe ekonomike, ka pak të ngjarë të realizojë një drejtësi të plotë në kushtet e ndryshme të një numri të madh individësh të ndryshëm të përfshirë. Për këtë arsye, në radhë të parë, është detyrë e autoriteteve përgjegjëse dhe, veçanërisht, e pushtetit ligjvënës të vlerësojnë avantazhet dhe disavantazhet e alternativave legjislative në dispozicion, duke pasur parasysh që ky është një vendim politik. Balancimi i të drejtave në fjalë, si dhe i përfitimeve apo humbjeve të individëve të ndryshëm të prekur nga procesi i transformimit të sistemit ekonomik dhe ligjor të shtetit në fjalë, është një ushtrim jashtëzakonisht i vështirë (*shih vendimin nr. 1, datë 06.02.2013, paragrafi 35, të GJK-së; shih vendimet në çështjet "Olaru dhe të tjerë kundër Moldavisë", i datës 28.07.2009, § 55 dhe "Maria Attanasiu dhe të tjerë kundër Rumanisë", § 170-171 të GJEDNJ-së*).

17. Çdo ndërhyrje në gëzimin e një të drejte ose lirie të njohur nga Konventa duhet të ndjekë një qëllim të ligjshëm. Parimi i "balancës së drejtë", i mishëruar në nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, presupozon në vetvete ekzistencën e një interesi të përgjithshëm të komunitetit. Për shkak të njohurisë së tyre të drejtpërdrejtë mbi shoqërinë dhe nevojat e tyre, autoritetet kombëtare, në parim, janë më të mirëpozicionuara sesa gjykatësi ndërkombëtar për të vlerësuar se çfarë është në "interesin publik", nocion i cili është detyrimisht i zgjeruar. Në veçanti, vendimi për të miratuar ligje, që shpronësojnë pronën ose japin kompensim të financuar publikisht për pronat e shpronësuara, do të përfshijë zakonisht shqyrtimin e çështjeve politike, ekonomike dhe sociale. Duke e konsideruar të natyrshme se shkalla e vlerësimit, e disponueshme nga ligjvënësi për zbatimin e politikave sociale dhe ekonomike, duhet të jetë e gjerë, GJEDNJ-ja ka shpallur se ajo duhet të respektojë vendimin e ligjvënësit se çfarë është në "interesin publik", nëse ai vendim nuk është haptazi i pabazuar (*shih vendimin nr. 1, datë 06.02.2013, paragrafi 37, të GJK-së; shih vendimin pilot në çështjen "Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë", i datës 31.07.2012, §166, të GJEDNJ-së*).

18. Neni 181 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përbën një dispozitë kalimtare, që përcakton detyrimin e Kuvendit për të normuar rregullimin e drejtë të çështjeve që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera përpara miratimit të kësaj Kushtetute. Kjo dispozitë kushtetuese ka për qëllim t'i hapë rrugën ligjvënësit për të ndrequr në afate të arsyeshme kohore dhe brenda të gjitha mundësive që ka shteti, një padrejtësi që i është bërë shtresës së ish-pronarëve. Nga kjo pikëpamje, norma kushtetuese e sipërcituar, e cila nuk mund të ketë fuqi prapavepruese, përbën një orientim për ligjvënësin që çështjet e shpronësimeve dhe të konfiskimeve, t'i rregullojë pa tejkaluar kufizimet e lejueshme dhe duke respektuar standardet kushtetuese (*shih vendimin nr. 30, datë 1.12.2005, të GJK-së*).

19. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në disa vendime të saj, si para, ashtu edhe pas miratimit të Kushtetutës, problemin e së drejtës së pronës, si edhe atë të kthimit e kompensimit të saj i ka trajtuar si çështje të rëndësishme të jurisprudencës kushtetuese. Çështjeve të tilla u është kushtuar një vëmendje e posaçme edhe nga jurisprudenca evropiane. Duke iu referuar kësaj jurisprudence konstatohet se ajo, në çdo rast, ka mbështetur qëndrimin se e drejta për pronë, në kuptimin kushtetues dhe të rregullave

të së drejtës ndërkombëtare, nuk identifikohet me rikthimin e pronës të marrë nga ana e regjimeve totalitare. Procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave në vendet e tranzicionit paskomunist nuk bazohet në të drejtën e pronës, por në parimin e ndershmërisë dhe të drejtësisë dhe, për më tepër, në parimin e shtetit social. Këtij qëndrimi i është përmbajtur përgjithësisht praktika e të gjitha vendeve që janë ndeshur me të njëjtin fenomen. "Parimi i drejtësisë kërkon që të merren në konsideratë jo vetëm interesat e ish-pronarëve dhe të trashëgimtarëve të tyre, por, gjithashtu, edhe ato të anëtarëve të tjerë të shoqërisë, si edhe interesi publik në tërësi. Kështu, parimi i drejtësisë dhe ai i proporcionalitetit nuk kërkojnë të kthejnë të drejtat e pronësisë për të gjithë ish-pronarët a trashëgimtarët e tyre apo t'i kompensojë ata me vlerën e plotë." Objektivi i kthimit të të drejtave të pronës nuk është fshirja e të gjitha padrejtësive, por zvogëlimi i tyre. Kthimi i të drejtave të pronës nuk duhet të shkaktojë padrejtësi të tjera. Nga kjo pikëpamje, rregullimi i kthimit dhe kompensimit të pronës në origjinën e vet, synon të korrigjojë, për aq sa është e mundur "brenda mundësive dhe kushteve ekonomiko-sociale të vendit", padrejtësitë e regjimit të kaluar, të kryera në dëm të pronës private nëpërmjet shtetëzimeve, shpronësimeve, konfiskimeve ose me çdo mënyrë tjetër të padrejtë (*shih vendimet nr. 30, datë 1.12.2005; nr. 26, datë 24.4.2001 të GJK-së*).

20. Kriteret që parashikon neni 41 i Kushtetutës, që janë garantimi i pronës private dhe shpërblimi i drejtë, si dhe koncepti i përcaktuar nga KEDNJ-ja për gëzimin e pronës në mënyrë të qetë, janë orientimet bazë mbi të cilat duhet të zgjidhen të gjitha çështjet që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera përpara miratimit të Kushtetutës, konform edhe nenit 181 të saj. Gjithashtu, Gjykata e ka interpretuar shpërblimin e drejtë lidhur me konceptet kushtetuese që kanë të bëjnë me interesin publik, si dhe respektimin e parimeve të drejtësisë, të proporcionalitetit dhe të shtetit social. Në drejtim të hapësirës së ligjvënësit për të rregulluar çështjen e kompensimit të pronave të shtetëzuara ose konfiskuara gjatë regjimit komunist, Gjykata ka pohuar se e drejta e pronës nuk njësohet me të drejtën e kthimit të saj. Nga kriteret kushtetuese të "rregullimit të drejtë" dhe të "shpërblimit të drejtë", të pranuara në nenet 41 dhe 181 të Kushtetutës, rezulton se kriteri për shpërblimin ose kompensimin në dobi të subjektit të shpronësuar nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë (*shih vendimet 33, datë 14.11.2022, paragrafi 35; nr. 4, datë 15.02.2021, paragrafi 45, të GJK-së*).

21. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenet 41 dhe 181 ka pranuar kriteret e "rregullimit të drejtë" dhe të "shpërblimit të drejtë". Nga këto kritere kushtetuese rezulton se kriteri për shpërblimin ose kompensimin në dobi të ish-pronarit nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë. Ky rregullim kushtetues i detyrohet jo vetëm funksionit të dyfishtë privat dhe shoqëror që mbart në vetvete e drejta e pronës, por edhe rrethanave historike, politike, ekonomike, shoqërore e juridike, të cilat kanë ndikuar në situatën e krijuar dhe, si të tilla, nuk mund të mos i kishte parasysh ligjvënësi (*shih vendimin nr. 30, datë 1.12.2005 të GJK-së*).

➢ *Lidhur me shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*

22. E drejta e individit të shpronësuar për të pasur akses në gjykatë, e cila është e parashikuar shprehimisht në nenin 41, pika 5, të Kushtetutës, është garanci specifike e së drejtës së pronës, kur kjo e fundit kufizohet nga shteti me anë të shpronësimit. Me anë të kësaj garancie procedurale, të shpronësuarit i jepet mundësia të përmbushë edhe garancinë tjetër kushtetuese me natyrë materiale – atë të shpërblimit të drejtë. E thënë ndryshe, e drejta e aksesit lidhet nga pikëpamja organike dhe funksionale me shpërblimin e drejtë. Aksesi në gjykatë i të shpronësuarit duhet të garantojë në nivelin e duhur ushtrimin e të drejtave të tij, si mjeti i vetëm me anë të të cilit ai mund të mbrohet në rast arbitrariteti të ndërhyrjes shtetërore, si dhe për të siguruar që kjo ndërhyrje në të drejtën e pronës private ka qenë proporcionale (*shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023, paragrafi 27; nr. 22, datë 25.04.2023; nr. 40 datë 22.12.2022 të GjK-së*).

23. Neni 41 i Kushtetutës, i cili garanton të drejtën e pronës, në pikën 3 parashikon edhe shpronësimin për interes publik. Ashtu siç është trajtuar në praktikën kushtetuese, koncepti kushtetues i interesit publik është mjaft i gjerë dhe vlerësohet nga Gjykata në këndvështrim të aktit konkret që paraqitet për kontroll përpara saj, pasi është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyes publike që çojnë në kufizimin e një të drejte themelore (*shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023, paragrafi 29; nr. 15, datë 22.06.2022; nr. 16, datë 01.03.2017 të GJK-së*). Nga ana tjetër, koncepti i "shpërblimit të drejtë", i parashikuar në pikën 4 të nenit 41 të Kushtetutës, është interpretuar nga Gjykata në kontekstin e ndërhyrjeve në të drejtën e pronësisë të subjekteve të shpronësuara gjatë regjimit komunist lidhur me konceptet kushtetuese që kanë të bëjnë me interesin publik, si dhe respektimin e parimeve të drejtësisë, të proporcionalitetit dhe të shtetit social (*shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023, paragrafi 29; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 4, datë 15.02.2021 të GJK-së*). Ndonëse neni 41 i Kushtetutës nuk ka përcaktuar kriteret që duhen zbatuar për përcaktimin e "shpërblimit të drejtë", treguesit konkretë për vlerësimin e dëmit të shkaktuar ose mekanizmat e nevojshëm për shpronësimin për interes publik, kushtetutëbërësi i ka lënë në diskrecion të ligjvënësit *(shih vendimin nr. 33, datë 30.05.2023, paragrafi 30, të GJK-së*).

24. Në lidhje me interpretimin e dispozitave të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, që lidhen me njoftimin e aktit të shpronësimit drejtpërdrejt individit të shpronësuar, Gjykata ka pranuar se, në përputhje me parimin themelor të sigurisë juridike, e drejta e aksesit në gjykatë e individit të shpronësuar është e kufizuar nga afati ligjor brenda të cilit duhet të paraqitet padia. Për rrjedhojë, ajo ka vlerësuar nga pikëpamja kushtetuese nëse interpretimi i ligjit për mënyrën e njoftimit dhe llogaritjen e afatit të paraqitjes së padisë ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë të kërkuesit për masën e shpërblimit të drejtë nga shpronësimi (*shih vendimet nr. 22, datë 25.04.2023, paragrafi 35; nr. 40, datë 22.12.2022 të GJK-së*).

25. Aksesi në gjykatë i të shpronësuarit duhet të garantojë në nivelin e duhur ushtrimin e të drejtave të tij, si mjeti i vetëm me anë të të cilit ai mund të mbrohet në rast arbitrariteti të ndërhyrjes shtetërore, si dhe për të siguruar që kjo ndërhyrje në të drejtën e pronës private ka qenë proporcionale (*shih vendimin nr. 40, datë 22.12.2022 të GJK-së*). Ndërsa, për sa i përket ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, Gjykata ka vlerësuar se ai nuk ka përcaktuar shprehimisht njoftimin e të shpronësuarit përmes botimit zyrtar, edhe pse parashikon se vendimi i Këshillit të Ministrave hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare (neni 21, pika 5). Ky parashikim duket se është në linjë me rregullin e përgjithshëm për botimin e akteve individuale të këtij organi sipas ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" (neni 29, pika 3). Ky rregull i shërben transparencës së veprimtarisë shtetërore dhe së drejtës kushtetuese të qytetarëve për informim, në kushtet kur sipas nenit 100, pikat 1 dhe 3, të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe i zhvillon mbledhjet e tij të mbyllura *(shih vendimin nr. 22, datë 25.04.2023, paragrafi 36; nr. 40, datë 22.12.2022 të GJK-së).* Për sa i takon njoftimit të akteve publike të shpronësimit, institucionet shtetërore të përfshira në procesin e shpronësimit duhet të tregojnë kujdes të shtuar dhe duhet të interpretojnë e zbatojnë dispozitat ligjore në atë mënyrë që t'i garantojnë individit garancitë kushtetuese të parashikuara në nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 22, datë 25.04.2023, paragrafi 37; nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 29, datë 01.11.2022 të GJK-së*).

26. Në procedurën e shpronësimit, për shkak se e drejta kushtetuese e pronës preket edhe në funksion të garantimit të aksesit në gjykatë, organet publike kanë detyrimin të realizojnë një njoftim të rregullt efektiv të individit, me qëllim që ai të ketë mundësinë e mbrojtjes për vlerën e pronës në procesin administrativ, përfshirë edhe atë të mbrojtjes gjyqësore në rast të ushtrimit të së drejtës së ankimit për masën e shpërblimit. Për të njëjtat arsye, është e rëndësishme që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, kur shqyrtojnë ankime për vlerën e pasurisë së shpronësuar, të verifikojnë realizimin e njoftimit nga organet publike, për t'i dhënë peshën e duhur vlerës dhe pasojës juridike të tij në drejtim të aksesit të individit në gjykatë, si garanci e posaçme kushtetuese në procedurën e shpronësimit. Një vlerësim i ndryshëm nuk do të garantonte ekuilibrin e drejtë mes të drejtave kushtetuese relevante në një proces shpronësimi, duke krijuar barrë të tepruar për individin në favor të shtetit (*shih vendimet nr. 22, datë 25.04.2023, paragrafi 38; nr. 40, datë 22.12.2022 të GJK-së*).

27. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se arsyetimi i Gjykatës së Lartë për njoftimin dhe llogaritjen e afatit të paraqitjes së padisë në gjykatë për shpërblimin nga shpronësimi ka vënë theksin në njoftimin nëpërmjet botimit të tij në Fletoren Zyrtare, duke zbehur vlerën juridike dhe pasojat që shkakton njoftimi individual i tij tek i shpronësuari (*shih vendimet nr. 22, datë 25.04.2023, paragrafi 39; nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 29, datë 01.11.2022 të GJK-së*).

28. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e saj, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Neni 41 i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës private (pika 1) dhe lejon që ligji të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë (pika 3), të cilat lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë (pika 4). Njëherazi kjo dispozitë e rregullon shprehimisht të drejtën e aksesit në gjykatë për individin e shpronësuar, duke parashikuar se për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë (pika 5). Gjykata ka pohuar se, me anë të shpronësimit, një subjekt mund të privohet nga e drejta e pronësisë që ka në favor të një subjekti tjetër përgjithësisht publik, por jo detyrimisht. Ndër të tjera, Gjykata është shprehur se e drejta e pronës private është e garantuar nëse në rastet e shpronësimit shteti merr përsipër të respektojë kufizimin në përmbushje të një interesi publik, kundrejt një shpërblimi të drejtë dhe në respektim të së drejtës së ankimit të individit të cenuar për masën e shpërblimit. Në këto raste, për sa i takon së drejtës së aksesit në gjykatë, neni 42 nuk konkurron me nenin 41, pika 5, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 16, datë 23.03.2023, paragrafi 31; nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 35, datë 10.10.2007 të GJK-së*).

29. Gjykata ka pohuar se me anë të shpronësimit një subjekt mund të privohet nga e drejta e pronësisë që ka në favor të një subjekti tjetër përgjithësisht publik, por jo detyrimisht. Pra, shpronësimi mund të zërë vend edhe në dobi të personave privatë, i bërë mbi bazën e një politike të llogaritur për të arritur drejtësi shoqërore brenda komunitetit. Shpronësimi kërkohet të realizohet me "ligj" dhe "vetëm për interesa publikë". Ai është i lejueshëm "vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë" *(shih vendimet nr. 40 datë 22.12.2022, paragrafi 17; nr. 17, datë 23.04.2010 të GJK-së)*. Shpronësimi është një marrëdhënie midis individit pronar dhe shtetit, ku individi zhvishet nga e drejta e pronësisë sa herë që ndërhyn një interes publik dhe ka të drejtë të ketë pretendime vetëm në lidhje me masën e shpërblimit *(shih vendimin nr. 4, datë 23.02.2016 të GJK-së)*. Gjithashtu, Gjykata është shprehur se e drejta e pronës private është e garantuar nëse në rastet e shpronësimit shteti merr përsipër të respektojë kufizimin në përmbushje të një interesi publik, kundrejt një shpërblimi të drejtë dhe në respektim të së drejtës së ankimit të individit të cenuar për masën e shpërblimit. Në këto raste, për sa i takon së drejtës së aksesit në gjykatë, neni 42 nuk konkurron me nenin 41, pika 5, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2022, paragrafi 17; nr. 35, datë 10.10.2007 të GJK-së).*

30. E drejta e pronësisë, si një nga të drejtat e mbrojtura nga Kushtetuta, nuk cenohet si pasojë e mosparashikimit të së drejtës së kompensimit të ish-pronarit në rast të transferimit të titullit të pronësisë, si pasojë e zbatimit të nenit 169 të KC-së. Titullari i së drejtës së pronësisë është i mbrojtur në çdo rast kur pretendon cenimin apo kufizimin e kësaj të drejte. Neni 169 i KC-së kërkon posedimin e pronës nga poseduesi jopronar qetësisht e pa ndërprerje dhe duke u sjellë si të ishte i tillë, ndërkohë që çdo veprim i kryer nga pronari i ligjshëm gëzon mbrojtje ligjore dhe sjell efektin e ndërprerjes së efektit të parashkrimit dhe moszbatimin e këtij instituti. Sipas GJEDNJ-së, pretendimi për kompensim në raste të tilla duhet trajtuar në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike. Sipas saj, shuarja

e së drejtës së pronësisë, kur pronari nuk ka mundur të rimarrë tokën e tij si pasojë e zbatimit të ligjit, nuk mund të thuhet se është haptazi pa baza të arsyeshme. Për këtë arsye ka pasur një interes të përgjithshëm për afatet dhe shuarjen e titullit të pronësisë në përfundim të afatit. Kërkesa për kompensim, në rastin kur njëra palë nuk ka arritur të ndërpresë afatin e parashkrimit, bie në kundërshtim me konceptin e "afatit", qëllimi i të cilit është vazhdimësia e sigurisë ligjore që pala tjetër nuk do të paditet pas kalimit të një date të caktuar (*shih vendimin nr. 4, datë 23.02.2016, paragrafi 14, të GJK-së; shih vendimet datë 30 gusht 2007 në çështjen J.A. Pye (Oxford) ltd dhe J.A. Pye (Oxford) Land ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar, të GJEDNJ-së*).

31. Shpërblimi i drejtë është një koncept kushtetues i lidhur me rastet e shpronësimit apo kufizimit të së drejtës së pronës me ligj për interesa publikë, sipas nenit 41 të Kushtetutës. Për pasojë, humbja e pronësisë si pasojë e shpronësimit për interes publik nuk është e njëjtë me kalimin e titullit të pronësisë si pasojë e ndërhyrjes së parashkrimit fitues. Ndërsa në rastin e parë gjendemi përballë një marrëdhënieje midis individit pronar dhe shtetit, ku individi zhvishet nga e drejta e pronësisë sa herë që ndërhyn një interes publik dhe ka të drejtë të ketë pretendime vetëm në lidhje me masën e shpërblimit, në rastin e dytë gjendemi përballë një marrëdhënieje private mes pronarit dhe poseduesit jopronar, individë apo shteti, ku pronari ka të gjitha të drejtat ligjore dhe mundësitë që të pretendojë dhe mbrojë të drejtën e tij (*shih vendimin nr. 4, datë 23.02.2016, paragrafi 16, të GJK-së*).

b. Precedentë ku çështja e cenimit të së drejtës së pronës është vënë në diskutim[20]

➢ *E drejta e pronës e lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor*

32. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së pronës nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 07.09.2022 "Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi" (VKM-ja nr. 589/2022), jo në përputhje me Kushtetutën. Sipas kërkuesit, VKM-ja nr. 589/2022 dhe ligji nr. 107/2014 nuk kanë parashikuar se çfarë ndodh me pronarët e tokës që mund të kenë lidhur një kontratë sipërmarrjeje me zhvilluesin, që i konfiskohen sipërfaqet e ndërtuara pa leje ose personat e tretë, të cilët mund të kenë lidhur kontrata për fitimin e pronësisë së njësive të ndërtimit, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën e pronës të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; në këtë drejtim, nuk respektohen garancitë e nenit 17, për sa i përket parimit të proporcionalitetit, pasi edhe në rast se sipërfaqja e punimeve është në masën 10.01%, merret masa e konfiskimit

VI.

[20] Precedentët/rastet nga gjykimi kushtetues të përmendura në këtë pjesë, ku çështja e cenimit të së drejtës së pronës është vënë në diskutim, përfshijnë jo vetëm ato të shqyrtuara nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual, por edhe ato nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/akteve normave. Ligjet/aktet normative objekt shqyrtimi ose të referuara në precedentët/rastet nga gjykimi kushtetues janë ato akte që kanë në fuqi në kohën e shqyrtimit të këtyre çështjeve.

për të gjithë ndërtimin. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, të drejtat e pronarëve të truallit dhe personave të tretë nuk cenohen, në rastin kur ndërtimet pa leje tejkalojnë në masën 2% sipërfaqen totale ndërtimore (sipas nenit 52, pika 1, shkronja "e", nëndarja "iii", të ligjit), sepse konfiskohet vetëm pjesa e ndërtimit pa leje, ndërkohë që pjesa e ndërtimit të ligjshëm vazhdon të jetë në pronësi të zhvilluesit. Po kështu, në rastin kur ndërtimi i paligjshëm tejkalon masën 10% të sipërfaqes totale ndërtimore (sipas nëndarjes "iv" të të njëjtit nen) dhe konfiskohet i gjithë objekti, konfiskimi nuk shtrihet mbi të drejtën e pronësisë së pronarit të truallit. Gjithsesi, pronarët e truallit dhe personat e tretë, në çdo rast, kanë në dispozicion mjetet e mbrojtjes së të drejtave të tyre sipas legjislacionit në fuqi. Ata kanë të drejtë të kërkojnë në rrugë gjyqësore të drejtat e tyre, sipas rastit, ndaj shtetit, subjektit zhvillues të pronës ose personave të tjerë me të cilët kanë krijuar marrëdhënie juridike, pasi në këtë rast do të gjejnë zbatim parimet dhe parashikimet e legjislacionit civil në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e pronësisë dhe marrëdhëniet e tjera me natyrë kontraktore. Në lidhje me pretendimet e se nuk respektohen garancitë e nenit 17, Gjykata ka vlerësuar se për sa i përket parimit të proporcionalitetit, pasi edhe në rast se sipërfaqja e punimeve është në masën 10.01%, merret masa e konfiskimit për të gjithë ndërtimin, ato kanë të bëjnë me përcaktimin e masës së tejkalimit të lejes së ndërtimit, për të cilën konfiskohet i gjithë objekti i ndërtuar, e cila, sikurse u përmend edhe më sipër, nuk është parashikuar nga VKM-ja, por nga neni 52, pika 1, shkronja "e", nëndarja "iv", i ligjit nr. 107/2014. Duke qenë se ky i fundit nuk ishte objekt i kërkimit të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata çmoi se ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merrej në shqyrtim (*shih vendimin nr. 35, datë 15.06.2023, paragrafët 75-82, të GJK-së*)

33. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së pronës, pasi Gjykata e Lartë e ka zhveshur kërkuesin tërësisht nga pronësia e tij, e fituar me një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe mbi bazën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, Kushtetuta, në nenin 41, pikat 1 dhe 2, ka parashikuar se e drejta e pronës është e garantuar dhe ajo fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në KC. Pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës është i lidhur ngushtë me cenimin e parimit të sigurisë juridike të kërkuesit, për të cilin ajo më lart konstatoi cenimin në kuptim të mosrespektimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, i cili kishte vendosur përfundimisht çështjen e pronës së kërkuesit, ndaj, dhe në këtë drejtim, ajo vlerëson se me të njëjtin arsyetim vendimi objekt kundërshtimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar kërkuesit edhe të drejtën e pronës (*shih vendimin nr. 22, datë 29.09.2022, paragrafët 54-56, të GJK-së*).

34. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së pronës private, pasi vendimi i gjykatës së apelit dhe vendimi i gjykatës së rrethit nuk janë bazuar në provat e administruara gjatë gjykimit; gjykatat pranojnë faktin se pasuria, objekt gjykimi, nuk është shtetëzuar, për rrjedhojë kërkuesit nuk janë subjekt i ligjit, ndërsa provat provojnë të kundërtën, pra që pasuria është shtetëzuar në vitin 1949 nga regjimi i asaj kohe; të drejtat e pronësisë janë fituar sipas ligjit të kohës dhe, si të tilla, ato janë të rregullta;

vetëm fakti se prona nuk është transkriptuar nuk do të thotë se kërkuesit nuk gëzojnë të drejtën e pronësisë mbi të. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, për pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës private kërkuesit kanë paraqitur argumente të përgjithshme, me natyrë ligjore dhe jo kushtetuese. Vlerësimi i fakteve dhe provave, si dhe interpretimi i ligjit janë çështje që nuk hyjnë në juridiksionin e kësaj gjykate, por në atë të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Kërkuesit, për të njëjtat shkaqe të parashtruara për këtë pretendim, kanë kërkuar shfuqizimin e të tria vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Kërkuesit nuk kanë arritur të provojnë cenimin e së drejtës së pronës private nga vendimmarrja e gjykatave të zakonshme (*shih vendimin nr. 2, datë 11.02.2021, paragrafët 22-24, të GJK-së*).

35. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së pronës në lidhje me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ ka interpretuar provat dhe faktet në mënyrë të ndryshme nga dy gjykatat e faktit, duke arritur në një përfundim të ndryshëm, gjë që nuk përputhet me natyrën e gjykimit të Gjykatës së Lartë. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar pretendimin lidhur me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Sipas saj, ndër të tjera, në çështjen konkrete Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka tejkaluar kompetencat ligjore, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i së drejtës për proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 10, datë 03.04.2018, paragrafët 12-20, të GJK-së*).

36. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të gjësë së gjykuar lidhur me të drejtën e pronës, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë për gjysmën tjetër të pronës, e cila i përket vëllait të kërkuesit, në një tjetër proces gjyqësor, kanë vendosur në favor të këtij të fundit, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të pjesshme të vendimit nr. 433, datë 09.08.2006 të KKKP-së, Tiranë; në gjykimin e një tjetër çështjeje (me paditës familjen T. dhe të paditur subjektet e interesuara) me objekt anulimin e vendimeve nr. 463, datë 05.06.1994 dhe nr. 433, datë 09.08.2006 të KKKP-së, Tiranë, Gjykata e Lartë ka vendosur dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim haptazi të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, pretendimet e kërkuesit jo vetëm kanë të bëjnë me çështje gjyqësore të tjera dhe të ndryshme nga çështja e tij, por nuk rezulton që gjykatat të kenë disponuar apo të jenë shprehur në lidhje me pjesën e tij takuese të pasurisë. Gjithashtu, vërehet se këto çështje janë akoma në proces shqyrtimi dhe rishqyrtimi në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte, këto vendime nuk e vendosin kërkuesin në një situatë të pasigurt nga pikëpamja juridike (*shih vendimin nr. 14, datë 27.02.2017, paragrafët 14-21, të GJK-së*).

37. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së pronës, pasi gjykatat i kanë mohuar të drejtën për të poseduar pronën e tij si pronar i ligjshëm; Gjykata e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit Korçë nuk kanë zbatuar drejt ligjin dhe udhëzimet e Gjykatës së Lartë, pasi kjo çështje është kthyer për rigjykim, çka përbën shkelje të parimit të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm. Gjykata e ka vlerësuar pretendimin se i takon juridiksionit të zakonshëm dhe jo kategorisë së çështjeve që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës

Kushtetuese. Ajo, ndër të tjera, ka ritheksuar qëndrimet e mbajtura në vendimmarrjet e saj të mëparshme se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm, dhe si të tilla nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimin nr. 13, datë 10.03.2016, paragrafët 21-23, të GJK-së*).

38. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm lidhur me të drejtën e pronës, pasi çështja e kërkuesve është ende në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, pavarësisht se kanë kaluar mbi 3 vjet e gjysmë nga data e regjistrimit të saj në atë gjykatë, në shkelje të nenit 48, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, duke pasur parasysh ngarkesën e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të gjyqtares relatore në këtë gjykatë, si dhe rrethanat e çështjes konkrete, si: kompleksitetin e saj, rrezikun në një shkallë të konsiderueshme për interesin e kërkuesve dhe sjelljen e autoriteteve, e drejta për proces të rregullt ligjor është cenuar si rrjedhojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm dhe se përmes vendimmarrjes së saj, Gjykata e Lartë u ka kaluar kërkuesve barrën e reformës në drejtësi (*shih vendimin nr. 25, datë 11.05.2023, paragrafët 21-48, të GJK-së*).

39. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të sigurisë juridike në lidhje me të drejtën e pronës, pasi VKM nr.932/2013 i ka dhënë të drejtë INUK të ndërhyjë arbitrarisht edhe në objektet mbi të cilat shtetasit kanë fituar në mënyrë të ligjshme të drejtën e pronësisë; prishja e ndërtimeve me leje, pa vendim gjyqësor të formës së prerë, cenon në thelb të drejtën e pronës së shtetasve, të fituar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit Shtesë Nr.1 të KEDNJ; cenimi i së drejtës së pronës pa një proces të rregullt ligjor bie ndesh edhe me garancitë e nenit 42 dhe 17 të Kushtetutës, duke mosrespektuar kriteret e kufizimeve për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, përfshirja në grupin e objekteve, sipas parashikimeve të VKM-së objekt kundërshtimi, ndaj të cilave mund të ushtrohet kontroll nga INUK për vlerësimin e ligjshmërisë së tyre edhe të ndërtimeve me leje ose të legalizuara sipas ligjit, jo vetëm tejkalon kufijtë e ligjit për inspektimin dhe planifikimin e territorit, por cenon dhe pritshmëritë e ligjshme të pronarëve të këtyre objekteve, të cilët, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kanë fituar tashmë të drejtën e pronësisë mbi këto objekte. Kontrolli administrativ i një organi të pushtetit ekzekutiv mbi ligjshmërinë e ndërtimeve dhe, si rrjedhojë, e të drejtës së pronës mbi to, me pasojë shpronësimin de facto të tyre si masë ekstreme e kufizimit të të drejtës së pronës, krijon situatë pasigurie dhe frike tek të gjithë subjektet potencialë që mund të preken nga ky rregullim. Pronarët e objekteve të ndërtuara me leje ose të legalizuara sipas ligjit, sipas përmbajtjes së VKM objekt shqyrtimi, duhet

të ndjehen gjatë gjithë kohës të kërcënuar nga kontrolli i INUK, i cili mund të vlerësojë ligjshmërinë e pronësisë së tyre dhe të marrë masa për eleminimin e paligjshmërisë së mundshme që ai mund të konstatojë, deri në prishje të objektit, që përbën zhveshje de facto nga e drejta e pronësisë. Një veprim i tillë i një organi administrativ bie ndesh me parimin e sigurisë juridike në gëzimin e së drejtës së pronës së individëve dhe si i tillë është antikushtetues. Kufizimet e të drejtës së pronës nuk janë vendosur në përputhje me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës. Ato nuk respektojnë kriterin formal të parashikimit të kufizimeve me ligj të Kuvendit. Gjithashtu, nuk është i qartë përse Këshilli i Ministrave ka zgjedhur këtë mënyrë për të kthyer ligjshmërinë në zonat ku ka ndërtime të kryera jo në përputhje me kërkesat e legjislacionit për ndërtimet në territor. Interesi publik, i cili pretendohet nga Këshilli i Ministrave si qëllimi që kërkohet të arrihet nëpërmjet kufizimit të së drejtës së pronës, nuk mund të mbrohet me veprime arbitrare të organeve administrative dhe tej parashikimeve të ligjit, siç parashikohet në përmbajtjen e VKM nr. 932/2013 (*shih vendimin nr. 25, datë 28.04.2014, paragrafët 38-48, të GJK-së*)

40. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar se neni 10 i ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" (të ndryshuar nga neni 5, i Ligjit nr. 9701, datë 2.4.2007), cenon të drejtën e pronës; mënyra e fshirjes së regjistrimeve nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (këtu e në vijim: ZRPP), sipas paragrafëve të nenit 10 të ligjit të kundërshtuar, barazohet me "shpronësimin". Gjykata ka vlerësuar se dispozita ligjore e kundërshtuar cenon të drejtën e pronës, të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës. Sipas saj, ndër të tjera, fshirja e regjistrimit, ndonëse nuk e zhvesh plotësisht titullarin nga e drejta e pronësisë, në të vërtetë e privon atë nga e drejta për të disponuar lirisht mbi pronën e tij. Nga ana tjetër, megjithëse interesi i legjislatorit është legjitim, fakti që pronari, i cili e ka regjistruar më pas në kohë titullin e tij të pronësisë, nuk do të mund ta gëzojë pronën në tërësinë e saj për një kohë të papërcaktuar, nuk krijon një situatë të balancuar ndërmjet interesit publik dhe interesave privatë të cenuar, veçanërisht për sa i përket mjetit jo proporcional të përdorur. Në të njëjtën kohë, konstatohet se, në rastin e fshirjes së regjistrimit, megjithëse parashikohet e drejta për ankim në rrugë gjyqësore, sipas ligjit në shqyrtim, ky ankim është i lidhur me kundërshtimin e aktit administrativ dhe jo me thelbin e të drejtës së pronësisë. Duke vlerësuar mjetin e zgjedhur nga legjislatori për të arritur qëllimin e tij, ai është kufizues dhe disproporcional (*shih vendimin nr. 17, datë 23.04.2010, paragrafët 10-19, të GJK-së*).

41. Përpara Gjykatës, është pretenduar se ligji nr. 8115, datë 29.03.1996 "Për përjashtime nga rregullat e parashikuara në lidhje me trashëgiminë ligjore nga Kodi Civil i miratuar me ligjin nr. 6340, datë 26.06.1981", është antikushtetues në lidhje me të drejtën e pronës. Ligjvënësi me ligjin nr. 8115, datë 29.03.1996, për një pjesë të kufizuar pronash dhe pavarësisht nga fakti se trashëgimia është çelur kur ende ishte në fuqi Kodi Civil i miratuar me ligjin nr. 6340, datë 26.06.1981, vendos zgjerimin e trashëgimtarëve, kur si trashëgimtar ligjor i radhës së parë ka mbetur vetëm bashkëshorti pasjetues. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim. Sipas saj, ndër të tjera, është parim i njohur dhe i pranuar nga të gjitha legjislacionet se trashëgimia çelet në kohën kur vdes trashëgimlënësi

dhe rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur. Ky parim është shprehur edhe në nenin 318 të Kodit tonë të ri Civil. Edhe në dispozitat kalimtare të këtij Kodi, në nenin 1162 thuhet se: "... Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë zbatohet për marrëdhëniet juridike të krijuara pas hyrjes në fuqi të tij". Ligji i ri nuk mund të zbatohet në faktet e para hyrjes në fuqi të ligjit të ri ose t'u njohë këtyre fakteve efekte të ndryshme nga ato që kishin kur ishte në fuqi ligji i shfuqizuar, etj. Në kushtet e mësipërme, zgjerimi i rrethit të trashëgimtarëve ligjorë për trashëgimet e çelura në kohën kur ishin në fuqi dhe vepronin rregullat e caktuara nga nenet 104 e 105 të Kodit Civil, të miratuar me ligjin nr. 6340, datë 26.06.1981, vjen në kundërshtim me parimet dhe rregullat ligjore të përmendura më lart. Pranimi dhe zbatimi i ligjit nr. 8115, datë 29.03.1996 do të kishte si efekt krijimin e një gjendjeje pasigurie dhe mungesë stabiliteti në marrëdhëniet trashëgimore dhe në përgjithësi, do të përbënte një precedent pa precedent. Ligjvënësi me ligjin nr. 8115, datë 29.03.1996 nuk ka marrë parasysh parimet e përgjithshme të së drejtës, ka shtuar me një ligj të ri rrethin e trashëgimtarëve duke i dhënë këtij ligji fuqi prapavepruese, duke cenuar rëndë një të drejtë të garantuar me kushtetutën, të drejtën e pronës. Ndryshimi i rrethit të trashëgimtarëve ligjorë, në rastin tonë konkret, nuk është tjetër veçse një deposedim i paligjshëm, është privim i pronarit të ligjshëm nga pasuria e tij, në favor të personave që nuk thirreshin në trashëgim si trashëgimtarë ligjorë me Kodin Civil të vitit 1981, por të cilësuar si të atillë me ligjin nr. 8115, datë 19.03.1996 (*shih vendimin nr. 11, datë 21.05.1997, të GJK-së*).

➢ *Lidhur me shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*

42. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit dhe të drejtën e pronës, pasi vlera e pronës së shpronësuar është disa herë më e lartë sesa ajo e caktuar nga shteti dhe nuk i përgjigjet shpërblimit të plotë të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe neni 153 i KC-së; kompensimi i drejtë është ai sipas vlerës së tregut; në caktimin e vlerës së pronës gjykatat nuk kanë marrë parasysh cilësitë e pronës dhe mundësinë e zhvillimit të saj; për më tepër, gjykatat e kanë dëmtuar më tej, si rrjedhojë e urdhërimit të shtetit për pagimin e shumës me këste. Gjykata ka vlerësuar se pretendimi është i pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në analizë të vendimmarrjeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi në kohën e shpronësimit të pasurisë, objekt i këtij ankimi kushtetues individual, vlerësimi i pasurisë së kërkuesit është bërë në përputhje me këto akte, ndërsa vlera e akorduar atij për shkak të shpronësimit nga gjykatat e zakonshme është e arsyeshme dhe e mjaftueshme, duke pasur parasysh humbjen e pësuar nga shpronësimi. Për sa i përket arsyetimit të vendimit, të lidhur me parimin e kontradiktoritetit, kërkuesit i është dhënë mundësia të parashtrojë pretendimet e tij për sa i përket vlerës së shpronësimit, të cilat janë marrë në shqyrtim nga gjykatat e zakonshme, përkundrejt prapësimeve të paraqitura nga palët e interesuara. Në përfundim të gjykimit të çështjes, bazuar në legjislacionin në fuqi, gjykatat kanë dhënë përgjigje të argumentuara për vendimmarrjet e tyre, qoftë për sa i takon llojit të pasurisë

së kërkuesit, ashtu edhe për sa i takon vlerësimit të saj për qëllime të shpronësimit për interes publik, në garantim të së drejtës së kërkuesit për akses substancial (*shih vendimin nr. 33, datë 30.05.2023, paragrafët 24-36, të GJK-së*).

43. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit lidhur me të drejtën e pronës, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka mohuar atij të drejtën për t'u njoftuar drejtpërdrejt nga autoritetet shtetërore për shpronësimin e realizuar sipas procedurave të ligjit nr. 8561/1999; ky Kolegj, duke arsyetuar se afati i ankimit ndaj vendimit të shpronësimit fillon në momentin e botimit të tij në Fletoren Zyrtare dhe jo në momentin e njoftimit të drejtpërdrejtë nga autoritetet shtetërore, ka keqinterpretuar dispozitat e ligjit nr. 8561/1999, duke cenuar të drejtën e pronës; Kolegji nuk ka arsyetuar shkakun ligjor se përse vendimet e gjykatave më të ulëta duhej të ndryshonin dhe kërkesëpadia të rrëzohej; ai ka mbajtur qëndrime të ndryshme për afatin e paraqitjes së kërkesëpadisë në raport me momentin e botimit të aktit për shpronësimin në Fletoren Zyrtare. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në rastin konkret, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke llogaritur afatin e paraqitjes së padisë në gjykatë për shpërblimin nga shpronësimi me njoftimin nëpërmjet botimit të tij në Fletoren Zyrtare dhe duke mos i dhënë përgjigje pretendimit kryesor të kërkuesit për masën e dëmshpërblimit si pasojë e shpronësimit, i ka cenuar atij të drejtën e aksesit, edhe pse ai e ka paraqitur kërkesëpadinë në gjykatë brenda afatit 30-ditor të njoftimit të VKM-së nr. 408/2011. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë lidhur me të drejtën e pronës, për shkak të interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, është i bazuar dhe vendimi i saj duhet të shfuqizohet (*shih vendimin nr. 22, datë 25.04.2023, paragrafët 28-41, të GJK-së*).

44. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykim, gjykimit brenda një afati të arsyeshëm lidhur me të drejtën e pronës, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka zbatuar vendimin nr. 2/2022 të Gjykatës Kushtetuese, me anë të të cilit i ka lindur e drejta të kërkojë dëmshpërblim sipas nenit 399/6, pika 3, të KPC-së; në kushtet kur nuk është realizuar gjykimi i çështjes brenda afatit 6-mujor të vendosur me vendimin nr. 2/2022, kërkuesja nuk ka mjete të tjera efektive për të kërkuar dëmshpërblimin për shkak të moszbatimit të këtij vendimi dhe për këtë qëllim ajo ka depozituar kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në rastin në shqyrtim pretendimi për konstatimin e vijimit të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të moszbatimit të vendimit të Gjykatës, nuk përbën një shkak të ri ose një mosmarrëveshje të re kushtetuese për shqyrtimin e këtij pretendimi. Prandaj, në lidhje me pretendimin e parë të objektit të kësaj kërkese, vetëm fakti i mosshqyrtimit të çështjes brenda afatit 6-mujor nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të argumentuar pretendimin e cenimit të të drejtave kushtetuese, për sa kohë që vendimi nr. 2/2022 ka dhënë pasojat e tij në drejtim të caktimit të shpërblimit të drejtë të kërkueses. Kërkuesja nuk ka përdorur ndonjë nga mjetet juridike të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së për të kërkuar shpërblimin e dëmit për shkak të vijimit të shkeljes nga Gjykata Administrative e Apelit, që është mosshqyrtimi i çështjes brenda afatit të përcaktuar nga

vendimi nr. 2/2022. Për rrjedhojë, kërkuesja nuk ka arritur të argumentojë mungesën e efektivitetit të këtij mjeti, për më tepër kur kërkesa e parë e saj për shpërblimin e dëmit jopasuror për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes gjyqësore, e shqyrtuar me vendimin nr. 4844, datë 28.09.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka rezultuar të jetë një mjet efektiv për kërkuesen (*shih vendimin nr. 20, datë 05.04.2023, paragrafët 18-27, të GJK-së*).

45. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës, pasi kërkuesja nuk është njoftuar për shpronësimin dhe gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me nenet 6 dhe 14 të ligjit nr. 8561/1999 dhe në asnjë shkallë të gjykimit nuk është provuar se ajo është njoftuar për shpronësimin dhe vlerën e tij. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, shkaqet e parashtruara në rekurs, në thelb, kanë natyrë kushtetuese, pasi lidhen me të drejtën e shpërblimit të drejtë për shpronësimin e pronës, në kuptim të nenit 41, pika 4, si dhe të drejtën për t`u ankuar për masën e këtij shpërblimi, të garantuar nga neni 41, pika 5, i Kushtetutës. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, duhej të shprehej në lidhje me këtë qëndrim të mbajtur nga gjykata më e ulët dhe të ushtronte funksionin e saj subsidiar, duke i dhënë përgjigje të arsyetuar subjektit të shpronësuar për pretendimin e tij. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, ka sjellë si pasojë cenimin e së drejtës së aksesit të kërkueses, si dhe duke mos u kthyer përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs me natyrë kushtetuese, nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së pronës private, Gjykata ka çmuar të mos ndalet në analizimin e tij, për sa kohë që çështja do të merrej përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë *(shih vendimin nr. 16, datë 23.03.2023, paragrafët 14- 31, të GJK-së*).

46. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me të drejtën e pronës, pasi kërkuesi është shpronësuar për interes publik dhe se ka kundërshtuar në gjykatë masën e shpërblimit; Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e padisë, pa shqyrtuar themelin e saj, duke verifikuar dhe vlerësuar të parashkruar të drejtën e padisë së tij për shkak të paraqitjes së saj jashtë afatit; Gjykata e Lartë ka disponuar në kundërshtim me nenet 58 dhe 63, shkronjat "a" dhe "dh", të ligjit nr. 49/2012, pasi nuk e ka gjykuar çështjen mbi bazën e shkaqeve të rekursit, të cilat lidheshin vetëm me përcaktimin e vlerës së pasurisë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, për sa i përket llogaritjes së afatit të paraqitjes së padisë në gjykatë për shpërblimin nga shpronësimi, Gjykata e Lartë në arsyetimin e saj ka vënë theksin në njoftimin e aktit të shpronësimit nëpërmjet botimit të tij në Fletoren Zyrtare, duke zbehur vlerën juridike dhe pasojat që shkakton njoftimi i drejtpërdrejtë individual i tij tek i shpronësuari. Sipas nenit 473/a, paragrafi 2, të KPC-së, në rastet kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtresave të tyre për çështjet e ligjit. Në këto raste, sipas nenit 482/a, pika 1, shkronja "b", të po këtij kodi, parashikohet se Gjykata

e Lartë, nëse e vlerëson të nevojshme për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Në këtë kuptim, në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë, duke qenë se e ka shqyrtuar çështjen në lidhje me një shkak që nuk është ngritur në rekurs, për të cilin gjykatat më të ulëta nuk janë shprehur, dhe që ka të bëjë me një kuptim të ri të interpretimit të ligjit nr. 8561/1999, për mënyrën e njoftimit të procedurës së shpronësimit, për të garantuar aksesin e individit në gjykatë, duhej të dëgjonte paraprakisht, qoftë edhe me shkrim, palët ndërgjyqëse në proces. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, për shkak të interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, është i bazuar. Në kushtet kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar duhet shfuqizuar, pasi ka cenuar procesin e rregullt ligjor në aspektin e aksesit në gjykatë, Gjykata ka vlerësuar të mos të ndalet në analizimin e pretendimit tjetër të kërkuesit për cenimin e së drejtës së pronësisë, për sa kohë që çështja do të rishqyrtohej nga Gjykata e Lartë (*shih vendimin nr. 40, datë 22.12.2022, paragrafët 14-37, të GJK-së*).

47. Përpara Gjykatës, në rrugën e kontrollit incidental, është pretenduar se përmbajtja e nenit 169 të KC-së, në pjesën që nuk parashikon të drejtën për kompensim të ish-pronarit, bie ndesh me nenet 11, 17, 18 dhe 41 të Kushtetutës, si edhe me nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, e drejta e pronësisë, si një nga të drejtat e mbrojtura nga Kushtetuta, nuk cenohet si pasojë e mosparashikimit të së drejtës së kompensimit të ish-pronarit në rast të transferimit të titullit të pronësisë, si pasojë e zbatimit të nenit 169 të KC-së. Titullari i së drejtës së pronësisë është i mbrojtur në çdo rast kur pretendon cenimin apo kufizimin e kësaj të drejte. Neni 169 i KC-së kërkon posedimin e pronës nga poseduesi jopronar qetësisht e pa ndërprerje dhe duke u sjellë si të ishte i tillë, ndërkohë që çdo veprim i kryer nga pronari i ligjshëm gëzon mbrojtje ligjore dhe sjell efektin e ndërprerjes së efektit të parashkrimit dhe moszbatimin e këtij instituti. Në ndryshim nga sa pretendon gjykata referuese, shpërblimi i drejtë është një koncept kushtetues i lidhur me rastet e shpronësimit apo kufizimit të së drejtës së pronës me ligj për interesa publikë, sipas nenit 41 të Kushtetutës. Për pasojë, humbja e pronësisë si pasojë e shpronësimit për interes publik nuk është e njëjtë me kalimin e titullit të pronësisë si pasojë e ndërhyrjes së parashkrimit fitues. Ndërsa në rastin e parë gjendemi përballë një marrëdhënieje midis individit pronar dhe shtetit, ku individi zhvishet nga e drejta e pronësisë sa herë që ndërhyn një interes publik dhe ka të drejtë të ketë pretendime vetëm në lidhje me masën e shpërblimit, në rastin e dytë gjendemi përballë një marrëdhënieje private mes pronarit dhe poseduesit jopronar, individë apo shteti, ku pronari ka të gjitha të drejtat ligjore dhe mundësitë që të pretendojë dhe mbrojë të drejtën e tij. Nga gjykata referuese nuk është arritur të argumentohet mjaftueshëm në nivel kushtetues se mungesa e një parashikimi ligjor në nenin 169 të KC-së për njohjen e së drejtës së kompensimit për ish-pronarin në rastin e kalimit të titullit me anë të parashkrimit fitues bie ndesh me parimet dhe standardet kushtetuese të pretenduara nga gjykata referuese (*shih vendimin nr. 4, datë 23.02.2016, paragrafët 11-17, të GJK-së*).

➢ *Lidhur me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave*

48. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm lidhur me të drejtën e pronës, pasi procesi gjyqësor në tërësi ka zgjatur mbi 14 vjet, nga të cilat mbi 5 vjet në Gjykatën e Lartë; rreziku nga shtyrja e afateve kohore do të sjellë pasoja të parikuperueshme, pasi kompensimi nga zbatimi i projektit "Lungomare 3", që do të fillojë në vitin 2023, do të përfitohet nga familja e shtetasit I.A. dhe persona të tjerë që nuk kanë asnjë dokument autentik të kohës për të provuar se janë pronarët e shpronësuar. Gjykata ka vlerësuar se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor dhe përshpejtimit të procedurave, është i bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, zgjidhja përfundimtare e problemeve që kanë të bëjnë me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, si çështje jo vetëm me interes publik, por, para së gjithash, me natyrë kushtetuese, përbën prioritet, pasi e drejta e pronës përbën një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit *(shih vendimin nr. 1, datë 06.02.2013 të GJK-së)*. Për më tepër, siç evidentohet edhe në vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë dhe siç rezulton edhe nga aktet e dosjes gjyqësore, ka disa procese gjyqësore të iniciuara nga paditësit, ndërkohë që ata nuk kanë ende një vendim përfundimtar të gjykatës në lidhje me të drejtën e tyre të pronësisë të pretenduar të cenuar. Për rrjedhojë, duke mbajtur në vëmendje rëndësinë që ka e drejta kushtetuese e pronës private, nga e cila rrjedh edhe e drejta për ta gëzuar e disponuar atë, si dhe e drejta e kompensimit sipas kuadrit ligjor në fuqi, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në rastin konkret ka rëndësi në drejtim të asaj që rrezikojnë paditësit si palë në procesin gjyqësor. Ajo ka vërejtur se për pjesën takuese të pronës së paditësve, për të cilën është disponuar me vendimin nr. 63, datë 19.10.1997 të KKKP-së, Vlorë, vonesat në këtë gjykim kanë bërë të pazbatueshëm, pjesërisht, edhe vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë (*shih vendimin nr. 46, datë 03.10.2023, paragrafët 20-43, të GJK-së*).

49. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i parimit të sigurisë juridike lidhur me të drejtën e pronës, pasi përmbajtja e aktit normativ me fuqinë e ligjit, e vlerësuar nën dritën e jurisprudencës së mëparshme të kësaj Gjykate lidhur me të drejtat e qiramarrësve, cenon parime të cilat qëndrojnë në themel të shtetit të së drejtës, veçanërisht, parimin e sigurisë juridike; akti normativ, sipas kërkuesit, imponon zgjidhje të reja, haptazi të pafavorshme, diskriminuese, aspak proporcionale, të ndryshme nga praktikat e mëparshme, të cilat përkeqësojnë pozitën juridike, sociale dhe ekonomike të qiramarrësve në shtëpitë e ish-pronarëve. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, hartimi dhe miratimi i legjislacionit që ka për qëllim rregullimin e problemeve ekonomike dhe sociale, në veçanti, të atyre që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronës, janë fenomene të lidhura ngushtë me ndryshimet thelbësore në sistemin e qeverisjes së një shteti, siç është kalimi nga regjimi totalitar në atë demokratik dhe reforma në strukturën politike, ligjore dhe ekonomike *(shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen "Maria Atanasiu dhe të tjerë kundër Rumanisë", i datës 12.01.2011, § 149)*. Për më tepër, natyra e ligjeve që parashikojnë njohjen, rikthimin dhe kompensimin e pronës të konfiskuar nën regjimin e mëparshëm komunist, në vetvete gjeneron një të drejtë të re pronësie në favor të personave

që përmbushin kushtet e titullaritetit të së drejtës, e drejtë kjo që mbrohet nga neni 1 i Protokollit nr.1 të KEDNJ-së, që parashikon se: "çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pronave të tij. Askush nuk privohet nga pronat e tij përveçse në rastet e interesit publik dhe në bazë të kushteve të parashikuara në ligj dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare". Nën dritën e jurisprudencës më të fundit të GJEDNJ-së, për të vlerësuar respektimin e nenit 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së, është i nevojshëm një vlerësim i përgjithshëm i interesave të ndryshme të përfshira, duke pasur parasysh që Konventa ka synim të ruajë të drejtat, të cilat janë praktike dhe efektive. Kur një çështje në interesin e përgjithshëm rrezikohet, i takon autoriteteve publike të veprojnë në kohën e përshtatshme, në mënyrë të duhur dhe të pranueshme *(shih vendimin pilot të GJEDNJ-së në çështjen "Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë", i datës 31.07.2012, §168)*. Në rastin konkret, ballafaqohen interesat e qiramarrësve në banesat e ish-pronarëve për strehim dhe interesat e pronarëve për të gëzuar të qetë pronën e tyre. Konteksti në të cilin është trajtuar më parë e drejta për strehim e qiramarrësve, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara, është i ndryshëm nga konteksti i rastit objekt shqyrtimi, ku e drejta për strehim ballafaqohet me të drejtën legjitime të pronarëve për të gëzuar të qetë dhe pa asnjë kufizim pronën e tyre. Parashikimet ligjore të aktit në shqyrtim synojnë jo vetëm të vendosin një barazpeshë të drejtë në realizimin e interesit social të grupimit shoqëror, atij të qiramarrësve, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara, por mbi të gjitha, këto masa kanë efekt të drejtpërdrejtë në garantimin e të drejtës kushtetuese të pronës. Zgjidhja përfundimtare e këtij problemi, si çështje jo vetëm me interes publik, por, para së gjithash, me natyrë kushtetuese, përbën prioritet, pasi e drejta e pronës përbën një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit. Kriteret dhe masat e parashikuara nga akti objekt kundërshtimi janë proporcionale dhe të arsyeshme për të rivendosur një balancë të drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave të mbrojtjes të së drejtës themelore të pronës së pronarëve të ligjshëm, të cilët për shkak të kufizimit të përdorimit të pronës së tyre për një kohë të gjatë, po mbajnë një peshë individuale tej masës ose shkallës së pranueshme, çka, potencialisht, përbën shkak për cenimin e thelbit të së drejtës së tyre themelore të pronës (*shih vendimin nr. 1, datë 06.02.2013, paragrafët 23-51, të GJK-së*).

50. Përpara Gjykatës është pretenduar se ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" cenon të drejtën e pronës, në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, sepse askush nuk mund të shpronësohet ose t`i kufizohet e drejta e ushtrimit të së drejtës së pronës që barazohet me shpronësimin, përveçse kur këtë e kërkojnë interesat publikë dhe kurdoherë kundrejt një shpërblimi të plotë dhe paraprak; ka shumë subjekte që gjatë viteve 1993-2009 kanë fituar pronësinë e tokës bujqësore me vendime gjyqësore të formës së prerë, të cilat mund të shfuqizohen për efekt të zbatimit të këtij ligji. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, neni 41 i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës private, si dhe përcakton kritere për shpronësimin apo kufizimin me ligj në ushtrimin e kësaj të drejte. Po ashtu, neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së garanton në substancë të drejtën e pronës. Ky nen mbron gëzimin e qetë të pronës, vendos kushte për privimin nga pasuria, si dhe u njeh shteteve

të drejtën, mes të tjerash, të kontrollojnë përdorimin e pasurive në pajtim me interesin e përgjithshëm. Ligji nr. 9948 nuk cenon të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore, të fituar në mënyrë të ligjshme, bazuar në kriteret e vendosura nga legjislacioni në fuqi. Siç është pranuar edhe në pikën 1 të këtij vendimi, ligji i kundërshtuar nuk i ngarkon KV-të apo organet e regjistrimit të anulojnë apo shfuqizojnë titujt e pronësisë apo t`i çregjistrojnë këto tituj nga regjistrat e pasurive të paluajtshme. Verifikimi që kryejnë KV-të, në bazë të këtij ligji, ka karakter konstatues dhe nuk ka si rezultat të drejtpërdrejtë anulimin apo shfuqizimin e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, si dhe çregjistrimin e tyre nga regjistrat përkatës. Siç është përmendur edhe më sipër në këtë vendim, të dhënat e këtij verifikimi mund të shërbejnë vetëm si bazë për ngritjen e padisë në gjykatë (*shih vendimin nr. 29, datë 31.05.2010, pika 3, të GJK-së*).

51. Përpara Gjykatës, në rrugën e kontrollit kushtetues incidental, është pretenduar se nenet 16 dhe nenit 18 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar cenojnë parimin e sigurisë juridike të lidhur me të drejtën e pronës, pasi këto dispozita me kompetencat që i japin drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së cenojnë parimin e sigurisë juridike; subjektet e shpronësuara dhe Avokati i Shtetit nuk mund të kundërshtojnë vendimet e ish-KKKP-ve pa asnjë afat kohor; dispozitat e kundërshtuara kanë sjellë si pasojë mohimin e së drejtës së subjekteve, që janë përfitues nga një vendim i mëparshëm i KKKP-ve, për tu ankuar në gjykatë, në rast se drejtori i përgjithshëm i AKKP-së shfuqizon vendimin dhe kthen dosjen për shqyrtim pranë Zyrës Rajonale të AKKP-së; drejtori i përgjithshëm i AKKP-së, si organ monokratik administrativ në vartësi të Këshillit të Ministrave, merr atributet e një gjykate duke shfuqizuar vendime *quasi* gjyqësore, të konsideruara të tilla nga jurisprudenca e GJEDNJ-së. Gjykata i ka vlerësuar këto pretendime të bazuara. Sipas saj, ndër të tjera, vendimet e organeve administrative, që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompensimin e pronave, në vite, nuk mund të konsiderohen akte administrative, në kuptimin normal juridik të termit (*strictu sensu*), por akte *sui generis* të nxjerra nga një organ *sui generis*, për të cilin Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përdorur termin e ri leksikor, *quasi* gjykatë. Mbështetur edhe në eksperiencën e vendeve të tjera, se në rastet kur kemi të bëjmë me të drejta subjektive, edhe pse enti shtetëror ka shprehur vullnetin e vet nëpërmjet akteve, këto të fundit nuk trajtohen dhe nuk goditen në gjykatë si akte administrative, por, përkundrazi, shtetasi në gjykatë, në një gjykim të zakonshëm kërkon të drejtën e pronës duke paraqitur prova në mbështetje të kësaj të drejte. KKKP-të nuk ishin organe administrative në kuptimin klasik juridik të termit. Ato nuk ishin të përfshira në piramidën e ekzekutivit. Disponimet e këtyre organeve në lidhje me të drejta subjektive të shtetasve dhe vendimet e tyre kontrolloheshin drejtpërsëdrejti nga gjykatat në një gjykim që nuk ishte i njëjtë me atë në lidhje me pavlefshmërinë e aktit administrativ. Për rrjedhojë, edhe vendimet e KKKP-ve nuk ishin akte administrative në kuptimin juridik të termit. E drejta administrative nuk mund të rregullojë me akte detyruese *(imperium)* interesa të privatëve kur nuk ekziston një interes publik. Në rastin konkret, fakti që nuk ekziston një interes publik mund të konstatohet edhe nga analiza e nenit 1 të ligjit objekt shqyrtimi, i cili shprehimisht përcakton se objekti i ligjit është kthimi i pronës ish-pronarëve në përputhje me nenin 41 të Kushtetutës. Zbatimi, nga një organ administrativ si AKKP-ja, i parimeve të revokimit dhe

shfuqizimit të akteve të ish-KKKP-ve është i pabazuar, pasi mungon një interes i ligjshëm shtetëror dhe aktet që shfuqizohen ose revokohen nuk janë akte tipike administrative të një organi tipik administrativ. Drejtori i AKKP-së është një organ në vartësi të Këshillit të Ministrave dhe në këtë kuptim vendimi i marrë prej tij për të ndërhyrë mbi interesa civilë të shtetasve, në kuptim të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, është i pajustifikuar. Vendimet e AKKP-së për të shfuqizuar vendimet e KKKP-ve, përbëjnë cenim të parimit të sigurisë juridike. Nga analiza e nenit 451 të KPC-së del se një vendim gjyqësor i shkallës së parë merr formën e prerë nëse nuk ankimohet ose kur lihet në fuqi nga një gjykatë apeli, që do të thotë se pamundësia për të vënë në lëvizje gjykatën e apelit, ose vendimi i kësaj të fundit në favor të vendimit të shkallës së parë, i jep atij formë të prerë. Në këtë mënyrë, duke arsyetuar *mutatits mutandis*, edhe vendimi i KKKP-ve, i cili nuk është ankimuar brenda afateve ligjore merr formën e prerë. Në këtë konkluzion ka arritur edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen Ramadhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë, duke cilësuar vendimet e paankimuara të Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave si "të formës së prerë dhe të ekzekutueshme" (*shih vendimin nr. 27, datë 26.05.2010, paragrafët 44-61, të GJK-së*).

52. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar se ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", ndër të tjera, cenon të drejtën e pronës private, në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, duke qenë se ligji për legalizimet ka për objekt legalizimin e ndërtimeve të ngritura pa leje dhe sidomos urbanizimin e zonave, blloqeve informale e ndërtimeve informale, si dhe integrimin e tyre në zhvillimin territorial infrastrukturor të vendit, duke përmirësuar kushtet e jetesës, ekziston "interesi publik" që mund të justifikojë shpronësimin e pronarëve të ligjshëm dhe kalimin e pronave të tyre në pronësi të ndërtuesve të ndërtimeve pa leje. Duke pasur parasysh se për kompensimin do të zbatohet e njëjta metodikë vlerësimi si në rastin e kompensimit të ish-pronarëve për pronat e tyre të konfiskuara, shtetëzuara apo shpronësuara, ai është në pajtim me kriterin kushtetues "shpërblim i drejtë". E drejta e ankimit në gjykatë është një e drejtë kushtetuese që sanksionohet nga neni 43 i Kushtetutës, kështu që, për aq kohë sa sipas nenit 4/3 të Kushtetutës dispozitat e saj zbatohen drejtpërsëdrejti, ky ligj edhe pse nuk e ka pranuar në mënyrë të shprehur, nuk ia mohon të drejtën individit për t'u ankuar në gjykatë për çdo aspekt të ligjit, për të cilin mund të lindin mosmarrëveshje mes personave të interesuar *(shih vendimin nr. 35, datë 10.10.2007 të GJK-së).*

53. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar se disa dispozita të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", kanë mohuar dhe kufizuar të drejtën e pronës, në kuptim të neneve 41 dhe 181 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit Shtojcë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata ka konkluduar se dispozitat ligjore të kundërshtuara nuk shkelin kriteret që parashikon neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Sipas saj, ndër të tjera, rregullimi i kthimit dhe kompensimit të pronës në origjinën e vet synon të korrigjojë, për aq sa është e mundur, "brenda mundësive dhe kushteve ekonomiko-sociale të

vendit", padrejtësitë e regjimit të kaluar, të kryera në dëm të pronës private nëpërmjet shtetëzimeve, shpronësimeve, konfiskimeve ose me çdo mënyrë tjetër të padrejtë. Në të gjitha qëndrimet e mbajtura në jurisprudencën kushtetuese evropiane, duke përfshirë këtu edhe atë shqiptare, konstatohet se, në respektim të parimit të drejtësisë dhe të shtetit social, nuk mund të vendosen detyrime për kompensimin tërësor të pronës së shpronësuar apo të shtetëzuar nga regjimet që nuk kanë respektuar standardet minimale të të drejtave të njeriut dhe se "rivendosja e plotë e të drejtave të mëparshme të pronësisë do të ishte në kundërshtim me vet parimin e barazisë.". Mbështetur në këtë këndvështrim të problemit, e drejta e pronës në kuptimin që i jep neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 1 i Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk mund të barazohet me kuptimin që ka në vetvete e drejta për kthimin dhe kompensimin e pronave. Ligji "Për kthimin dhe kompensimin e pronave" nuk ka në përmbajtjen e tij konceptin e shpronësimit të pronës së pronarëve, por respektimin nga ligjvënësi të kritereve që parashikon neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për kthimin e pronave të shpronësuara, të konfiskuara ose të shtetëzuara padrejtësisht (*shih vendimin nr. 30, datë 01.12.2005 të GJK-së*).

54. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar se neni 9 i ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" i diskriminon qiramarrësit në shtëpitë e ish-pronarëve në raport me pjesën tjetër të shoqërisë; shteti, nëpërmjet rregullimeve të ndryshme ligjore, ka krijuar diferencime edhe midis vetë qiramarrësve; kjo dispozitë vë afate kohore të shkurtra për lirimin e banesave, duke krijuar artificialisht pamundësi për Buxhetin e Shtetit për ndërtimin e apartamenteve të nevojshme. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim në lidhje parimin e sigurisë juridike si pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e shtetit të së drejtës, garantuar nga nenet 15, 17 e 18 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë. Sipas saj, ndër të tjera, ndryshimi i ligjit të favorshëm ndaj një grupi të caktuar të popullsisë, nuk justifikohet me ndonjë interes publik të qenësishëm. Është e vërtetë që dispozita e ndryshuar favorizon pronarët e banesave, por nga ana tjetër ajo diskriminon një grup tjetër (dhe pse të vogël në numër), duke i cenuar të drejtën minimale për të jetuar, atë të pasjes të një strehe. T'u mohosh të drejtën shtresës së qiramarrësve për t'u bërë pronarë, t'u ndërpresësh kontratën e qirasë pa garantuar strehë tjetër, janë veprime që nuk mund të përligjen me interesin publik. Dispozita e re (pika 1 e nenit 9 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës") nuk është rezultat i një interesi publik apo i kërkesave të shtetit social. Përderisa në rastin konkret është prekur parimi i sigurisë juridike pa as një shkak të përligjur, kjo dispozitë është antikushtetuese e duhet të shfuqizohet (*shih vendimin nr. 26, datë 02.11.2005 të GJK-së*).

55. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar se pika 1, shkronja "c", e VKM-së nr. 19, datë 18.03.2000 cenon të drejtën kushtetuese të ish-pronarëve të truallit për një shpërblim të drejtë. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim. Sipas saj, ndër të tjera, detyrimeve të shtetit për kompensimin e trojeve të zëna, për aq sa kanë vendosur komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave t'iu korrespondojë e drejta e ish-pronarëve të truallit, e cila duke u vlerësuar ekonomikisht,

të mos jetë nën nivelin e kërkesës kushtetuese për një shpërblim të drejtë. Ish-pronarët, të cilëve ajo ju adresohet, vihen në kushte pabarazie në krahasim me ish-pronarët e tjerë të trojeve të zëna me objekte të ndërtuara nga shteti, ku nuk zhvillojnë aktivitet shoqëritë tregtare të komanduara prej tij. Të dyja këto grupe ish-bashkëpronarësh ndodhen në situata juridike të njëllojta dhe i përkasin së njëjtës kategori. Si njërit, ashtu edhe tjetrit nuk i është kthyer trualli për shkak se ka qenë i zënë dhe komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave ju kanë njohur atyre vetëm të drejtën e kompensimit (*shih vendimin nr. 26, datë 24.04.2001 të GJK-së*).

56. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar se shtesa e parashikuar në nenin 1 të ligjit nr.7916, datë 12.04.1995 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve"", sipas së cilës subjekte përfituese janë edhe personat të cilëve shteti u ka sekuestruar pronat në zbatim të ligjit nr. 37, datë 13.01.1945 "Për tatimin e jashtëzakonshëm", nuk është në përputhje me Kushtetutën; kjo kategori subjektesh që i nënshtrohej këtij ligji nuk është dhe nuk mund të barazohet me ish-pronarët e tjerë, pronat e të cilëve u shpronësuan ose u shtetëzuan jo për një motiv të tillë fiskal. Gjykata e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim. Sipas saj, ndër të tjera, vendosja e ligjit për tatimet e jashtëzakonshme nuk ka qenë një fenomen thjeshtë shqiptar. Një praktikë e tillë është zbatuar pas Luftës së Dytë Botërore edhe në vende të tjera perëndimore dhe ajo është çmuar si masë e marrë në përputhje edhe me normat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare. Shtesa e parashikuar në ligjin nr. 7916, datë 12.04.1995, ku i njihet e drejta e pronësisë edhe atyre personave që u është sekuestruar pasuria nga ligji "Për tatimin e jashtëzakonshëm", e barazon padrejtësisht këtë masë me karakter fiskal me zhveshjen e padrejtë të pronës, njëlloj si dhe në rastet e tjera që parashikon kjo dispozitë. Kur ligjvënësi i ka bërë këtë shtesë nenit 1 të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", ai nuk ka marrë në konsideratë këtë normë të së drejtës ndërkombëtare dhe as ligjin nr. 7941, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", neni 8 i të cilit parashikonte se: "legjislacioni i Republikës së Shqipërisë merr parasysh, njeh dhe respekton parimet dhe normat përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare" *(shih vendimin nr. 16, datë 17.04.2000, të GJK-së*).

57. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar se neni 10 i ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Në paragrafin e parë të nenit 10 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" është bërë rregullimi i problemit të ndërtesave të ish-pronarëve që janë tjetërsuar në persona të tretë; ligjvënësi ka vendosur që këto ndërtesa t'u kthehen ish-pronarëve, ndërsa personat e tretë do të marrin masën e shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit të konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve. Gjykata e ka vlerësuar pjesërisht të bazuar këtë pretendim. Sipas saj, ndër të tjera, pjesa e parë e dispozitës së nenit 10, paragrafi i I-rë, që ligjëron kthimin e ndërtesave ish-pronarëve, nuk vjen në kundërshtim as me dispozitat kryesore kushtetuese që kanë qenë në fuqi në kohën e daljes së ligjit, as me Kushtetutën. Duke vepruar në këtë mënyrë, shteti nuk është se ka marrë nëpër këmbë të

drejtat e ligjshme të personave të tretë dhe as i ka nënvleftësuar ata, por, përkundrazi, i ka marrë në konsideratë dhe ka marrë përsipër detyrimin që për të balancuar interesat dhe për të mos krijuar padrejtësi të reja, kategoria e personave të tretë të kompensohet duke marrë shpërblimin përkatës. Mirëpo, ndërsa kjo vëmendje e shtetit për të shpërblyer personat e tretë nuk ka munguar, mënyra se si është zgjidhur kjo çështje nga neni 10, paragrafi i I-rë, nuk është në përputhje me Kushtetutën. Duke u shpërblyer personat e tretë me çmimin e blerjes të konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve, ligji nuk i ka vënë këto dy kategori personash në një shesh barazie, përkundrazi, kategoria e personave të tretë është vënë në pozita pabarazie dhe diskriminuese, gjë që passjell pamundësinë e saj të hyjë në qarkullimin civil për të siguruar një banesë tjetër. Aq sa është e drejtë dhe kushtetuese kthimi i pronave ish-pronarëve, po aq e drejtë dhe kushtetuese është sigurimi nga shteti i një shpërblimi të drejtë e të plotë të personave të tretë, duke marrë për bazë çmimin e tregut, domethënë vlerën reale që ka ndërtesa në momentin e dorëzimit tek ish-pronari. Kjo zgjidhje, nga njëra anë, nuk lejon të preken interesat e personave të tretë dhe, nga ana tjetër, nuk lejon sigurimin e përfitimeve pasurore të papërligjura, sepse secili do të shpërblehet për aq sa i takon kundrejt objektit që dorëzon, duke marrë në konsideratë edhe shpenzimet e bëra nga personat e tretë për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e ndërtesave (*shih vendimin nr. 12, datë 21.03.2000 të GJK-së*).

58. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar se paragrafi i tretë i nenit 9 të ligjit nr. 7916, datë 12.04.1995 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve" nuk është në përputhje me Kushtetutën; përmbajtja e kësaj dispozite se procesi i kthimit të pronave ish-pronarëve nuk mund të pengohet, se vendimet e komisioneve të kthimit të pronave nuk mund të pezullohen as me vendim gjykate edhe kur ka filluar apo vazhdon procesi gjyqësor, dhe se zbatohen vetëm vendimet e gjykatave që kanë marrë formë të prerë, nuk pajtohet me parimet themelore të organizimit tonë shtetëror mbi ndarjen e pushteteve, cenon pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si edhe të drejtat e liritë themelore të qytetarëve. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të bazuar. Sipas saj, ndër të tjera, me paragrafin e tretë të nenit 9 të ligjit nr. 7916, datë 12.04.1995 për kthimin e kompensimin e pronave, që i heq mundësinë gjykatës të pezullojë zbatimin e vendimit të komisionit të kthimit të pronave, vështirësohet ose bëhet i pamundur realizimi nga qytetarët i një prej të drejtave themelore të pretenduara, siç është e drejta e pronësisë, për shkak se rrezikohet që pasuritë e paluajtshme të zhduken, të dëmtohen ose të tjetërsohen si dhe krijohen kushte për lindjen e konflikteve midis qytetarëve (*shih vendimin nr. 9, datë 31.07.1995 të GJK-së*).

59. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar se neni 10 i ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", bie ndesh me nenin 27 të ligjit kushtetues "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut", që parashikon se askujt nuk mund t'i mohohet e drejta të ketë pronë private vetëm ose së bashku me të tjerë. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, në këtë nen sqarohet se fitimi, gëzimi dhe tjetërsimi i pronës, si edhe e drejta e trashëgimisë rregullohen me ligj dhe është pikërisht ligji nr. 7698, datë 15.04.1993

që ia njeh fitimin dhe gëzimin e pronës ish-pronarit që nga data 29 nëntor 1944. Kështu që parimi kushtetues se askujt nuk mund t'i mohohet e drejta të ketë pronë, mbron në radhë të parë ish-pronarin që shteti i mëparshëm e zhveshi nga pronësia në mënyrë të padrejtë (*shih vendimin nr. 9, datë 30.11.1994 të GJK-së*).

60. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar se ligji nr. 7561, datë 19.07.1991 "Për tokën", ligji nr. 7699, datë 21.04.1993 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore", si edhe nenet 5, 12, 13, 14, 17, 19, 23, 25 e 26 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" bien ndesh me dispozitat kryesore kushtetuese. Gjykata e ka vlerësuar pretendimin të pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, rregullimet e bëra me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" dhe me shtojcat e tij të mëvonshme, si edhe me ligjin nr. 7699, datë 21.04.1993 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore", kanë tiparet e një reforme agrare të mbështetur në parimin e drejtësisë shoqërore, i cili përcaktohet në nenin 2, paragrafi 2, të ligjit nr. 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese". Kjo i shërben realizimit të programit të shtetit tonë të së drejtës për vetëshpronësimin e tij dhe privatizimin e ekonomisë. Në këtë paketë ligjesh synohet që qëllimet e lartpërmendura të gjejnë zbatim në harmoni me kushtet historike e aktuale të Shqipërisë (*shih vendimin nr. 7, datë 14.09.1994 të GJK-së*).

61. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar se nenet 12 dhe 17 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" bien ndesh me dispozitat kryesore kushtetuese: ndër të tjera, me nenin 17 të ligjit në fjalë, në mënyrë arbitrare e pa kurrfarë qëllimi publik, është pranuar bashkëpronësia në pjesë mbi lokalet tona private, që organet kompetente shtetërore na i kanë shitur me kontrata të ligjshme të lidhura pa asnjë lloj barre; parashikimet e neneve 12 dhe 17 përbëjnë në thelb një shpronësim të pronarëve të lirë, që nuk ka qëllime publike dhe, për rrjedhojë, vijnë në kundërshtim me nenin 27 të ligjit nr. 7692, datë 31.03.1993 "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut". Gjykata i ka vlerësuar të bazuara këto pretendime. Sipas saj, ndër të tjera, parashikimet e neneve 12 dhe 17 të ligjit objekt gjykimi vijnë në kundërshtim me disa parime e norma kushtetuese të miratuara me ligjet kushtetuese në fuqi e të gjithëpranuara në aktet juridike ndërkombëtare, të cilat sigurojnë mbrojtjen e pronësisë private nga veprimet e padrejta e arbitrare të shtetit ose të subjekteve të tjera. Sipas nenit 27 të ligjit kushtetues nr. 7692, datë 31.03.1993 "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut: "Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta të ketë pronë private vetëm ose së bashku me të tjerë, si dhe e drejta për të trashëguar. Fitimi, gëzimi dhe tjetërsimi i pronës, si dhe e drejta e trashëgimisë rregullohen me ligj". Pronësia e trojeve dhe e ndërtesave (lokaleve), të përmendura në nenet 12 dhe 17 të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", është fituar sidomos nëpërmjet kontratave të lidhura me agjencitë përkatëse të privatizimit ose, në disa raste, nëpërmjet ndërtimit të lokalit mbi truallin e dhënë në mënyrë të rregullt nga shteti. Ligjvënësi, duke disponuar se "trojet e zëna nga persona të tjerë fizikë ose juridikë, të cilët i kanë blerë nga shteti pas datës 1 janar 1991 për ndërtimin e banesave individuale dhe lokaleve të tregtisë e shërbimeve, i kthehen në pronësi ish-pronarit, ndërsa shteti i kthen personit

fizik ose juridik që e ka blerë, shumën e derdhur për truallin" (neni 12, paragrafi I) dhe se "në trojet, në të cilat janë ndërtuar lokale, ish-pronarit të truallit i njihet pronësia mbi truallin", (neni 17, paragrafi I) në fakt ndërhyn në kontratat e shitjes të lidhura rregullisht, në bazë të ligjit të kohës, dhe, në mënyrë të njëanshme, urdhëron prishjen tërësore apo të pjesshme të këtyre kontratave. Kjo përbën cenim të hapur të së drejtës së pronësisë private, të njohur e të garantuar si e drejtë themelore e njeriut (neni 27 i ligjit "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut"). Krijimi në mënyrë të detyruar i marrëdhënieve juridike sipas nenit 17 të kundërshtuar, në veçanti i një lloji bashkëpronësie të panjohur deri më sot në pikëpamje teorike dhe në praktikë, bie ndesh me normën kushtetuese të lartpërmendur që njeh, mbron dhe garanton të drejtën themelore të pronësisë private, sepse bashkëpronësia në pjesë apo në tërësi në çdo rast krijohet mbi bazën e vullnetit të lirë e të marrëveshjes midis pronarëve të veçantë e jo në mënyrë të detyrueshme me imponim shtetëror, e me forcën e ligjit. Ajo mund të krijohet edhe nëpërmjet një fakti juridik që sjell një suksedim universal, siç është p.sh., trashëgimia, por, në çdo rast, ajo nuk mund të qëndrojë pa vullnetin e bashkëpronarëve. Pushteti ligjvënës apo ai ekzekutiv nuk mund të kalojnë në pronësi apo në bashkëpronësi të të tjerëve, në rastin konkret të ish-pronarëve, pasuri që nuk i përkasin në pronësi vetë shtetit, por subjekteve të tjerë private (*shih vendimi nr. 4, datë 08.04.1994 të GJK-së*).

62. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar se ligji nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për rikthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", në pjesën që ato diskriminojnë qiramarrësit e banesave që iu kthyen ish-pronarëve, në krahasim me qiramarrësit e banesave shtetërore që privatizohen, bien ndesh me dispozitat kryesore kushtetuese. Gjykata i ka vlerësuar këto pretendime të pabazuara. Sipas saj, ndër të të tjera, zgjidhja e ndryshme e problemeve të strehimit që kanë këto kategori qiramarrësish nuk vjen për shkak të ndonjë diskriminimi që bëhet ndërmjet tyre, por për shkak të pozitave të ndryshme që kanë ata në fakt, të parët si qiramarrës të banesave të ndërtuara nga shteti, të dytët si qiramarrës të banesave që ju kthehen ish-pronarëve. Në ligjet objekt gjykimi nuk është bërë asnjë dallim për shkaqet e parashikuara në nenin 25 të ligjit "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut". Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia në ligj dhe para ligjit presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Sipas nenit 25 të ligjit objekt shqyrtimi, shteti në të ardhmen do të marrë pjesë në zgjidhjen e problemit të strehimit të banorëve të qyteteve nëpërmjet institucioneve të specializuara për këtë qëllim dhe se banesa me qira do të përfitojnë edhe qiramarrësit e banesave private, të cilët lirojnë banesën si rezultat i kthimit të saj pronarit. Nga dispozitat që u përmendën më sipër, rezulton se kërkuesve, për zgjidhjen e problemit të strehimit, iu është dhënë alternativa të ndërtojnë banesa me kredi, interesin e së cilës e mbulon shteti, ose të sistemohen si qiramarrës në banesa që do të ndërtojë shteti (*shih vendimin nr. 11, datë 27.08.1993, të GJK-së*).

3. E drejta e jetës private

a. Kuptimi: parimet dhe standardet përkatëse[21]

1. E drejta kushtetuese e jetës private nuk mbrohet nga një dispozitë e vetme e Kushtetutës, por nga disa prej tyre, ndër të cilat përfshihen neni 35 (mbrojtja e të dhënave personale), neni 36 (liria dhe fshehtësia e korrespondencës) dhe neni 37 (paprekshmëria e banesës). E drejta për jetë private nuk ka karakter shterues, por, në thelb, duhet t'i sigurojë individit një hapësirë brenda së cilës ai mund të zhvillojë dhe plotësojë në mënyrë të pavarur personalitetin e tij, ku përfshihet edhe zhvillimi ose ruajtja në një masë të caktuar e marrëdhënieve me njerëzit e tjerë. Respektimi i jetës private kërkon në parim mosndërhyrjen në vendimet që merr vetë individi rreth mënyrës së bërjes së jetës së tij *(shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021, paragrafi 76; nr. 52, datë 01.12.2011, paragrafi 25; nr. 16, datë 11.11.2004, paragrafi 2.4, të GJK-së).*

2. Për sa i përket së drejtës së jetës private, trajtimi i saj parashikon jo vetëm detyrimin negativ të autoriteteve publike për të mos ndërhyrë në jetën private dhe familjare, por edhe detyrimin pozitiv shtetëror për t'i mbrojtur këto të drejta sa më realisht, përmes organeve të të tria pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Respektimi i jetës private kërkon, në parim, mosndërhyrjen në vendimet që merr vetë individi rreth mënyrës së jetesës, bërjes së jetës së tij. Në çdo rast, legjitimimi ose jo i ndërhyrjes do të varej kryesisht nga intensiteti i saj, shkalla e cenimit të jetës private, domosdoshmëria e kësaj ndërhyrjeje në shoqërinë demokratike dhe në realitetin konkret që e ka diktuar atë, efektiviteti dhe proporcionaliteti në raportin e qëllimit që është synuar të arrihet dhe mjetet e përdorura për arritjen e tij. Mbi të gjitha, duhet pasur parasysh se sa më shumë të depërtohet në sferën e jetës intime ose sensitive, aq më shumë rritet edhe detyrimi i pushtetit publik për mbrojtjen e jetës private *(shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021, paragrafi 50; nr. 2, datë 18.01.2017, paragrafi 62; nr. 52, datë 01.12.2011, paragrafi 31, të GJK-së).*

3. Jeta private është një term i gjerë që nuk i nënshtrohet përkufizimit shterues. Ky nen mbron edhe të drejtën e zhvillimit personal, si dhe të drejtën për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me qenie të tjera njerëzore dhe botën e jashtme, si dhe mund të përfshijë aktivitete të një natyre profesionale ose biznesi. Për rrjedhojë, ekziston një zonë ndërveprimi e një personi me të tjerët edhe në një kontekst publik, i cili mund të hyjë brenda fushës së veprimit të "jetës private". E drejta e jetës private e mbron qenien njerëzore në të gjitha rastet dhe lidhet me dinjitetin e saj kudo. Edhe thjesht vëzhgimi në rrethana normale i paraqitjes dhe sjelljes së një personi do të shkaktonte shqetësime të mëdha nëse kjo do t'i shërbente një qëllimi, i cili do të dëmtonte jetën private, nderin dhe dinjitetin e tij *(shih vendimin nr. 30, datë 05.07.2021, paragrafët 46 – 47, të GJK-së).*

[21] Standardet e përmendura në këtë pjesë përfshijnë standardet e evidentuara në jurisprudencën e Gjykatës nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/akteve normave dhe ato nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual.

4. Ndërsa përfitimi ose krijimi i pasurive mund të konsiderohet se është një aspekt i jetës private, nuk është numri ose madhësia e pasurive, apo stili i jetesës në vetvete që mund t'i japin shkak përgjegjësisë disiplinore, por paaftësia e individit për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve për përfitimin ose krijimin e tyre dhe për të siguruar besimin e publikut në integritetin e tij. Në çdo rast, GJENDJ-ja vlerëson se kontrolli i pasurive nuk përfshin një aspekt intim të sjelljes private që trajtohet në vetvete si një shkelje etike *(shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021, paragrafi 77, të GJK-së).*

5. Mosmarrëveshjet e lidhura me punësimin nuk përjashtohen *per se* nga sfera e "jetës private", në kuptim të nenit 8 të KEDNJ-së. Një kufizim në lidhje me aksesin në një funksion publik mund të ketë pasoja në ushtrimin e së drejtës së jetës private, duke pasur parasysh se kjo ndalon kërkuesin të ushtrojë një profesion që i korrespondon kualifikimeve të tij profesionale. Ka disa aspekte tipike të jetës private, të cilat mund të preken në mosmarrëveshjet që lidhen me masat e pavaforshme në punësim, të tilla si: shkarkimi, ulja në detyrë ose mospranimi në një profesion. Këto aspekte përfshijnë për kërkuesin: i) "rrethin e brendshëm" të tij; ii) mundësinë për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me të tjerët; dhe iii) reputacionin shoqëror e profesional. Në këto lloj mosmarrëveshjesh, pretendimet për cenimin e aspekteve të jetës private zakonisht vlerësohen në dy mënyra: si rezultat i shkaqeve kryesore të masës së kundërshtuar - qasja e bazuar mbi shkaqe; ose në disa raste, si rezultat i pasojave që masa e kundërshtuar sjell në jetën private - qasja e bazuar mbi pasoja. Kur çështja vlerësohet sipas qasjes së bazuar në pasoja, është me rëndësi themelore pragu i ashpërsisë së pasojave. Në këtë kuptim, i takon kërkuesit të provojë se ky prag është arritur në çështjen e tij dhe ai duhet të paraqesë prova që vërtetojnë ashpërsinë e pasojave që ka sjellë masa e kundërshtuar. Sipas GJEDNJ-së, neni 8 është i zbatueshëm vetëm kur këto pasoja janë shumë serioze dhe prekin jetën private në një masë shumë domethënëse. Dëmi duhet të vlerësohet duke pasur parasysh jetën e kërkuesit para dhe pas masës së dhënë. Edhe pse Gjykata vlerëson efektin material dhe atë jomaterial të masës së dhënë, i takon kërkuesit të përcaktojë dhe të vërtetojë natyrën dhe masën e dëmit, i cili duhet të ketë një lidhje shkakësore me masën e kundërshtuar *(shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021, paragrafi 78 – 79, të GJK-së).*

6. Respektimi i së drejtës së jetës private në një shoqëri demokratike nuk do të thotë se nuk mund të ketë ndërhyrje në ushtrimin e kësaj të drejte kur kjo është e domosdoshme për sigurinë kombëtare, për sigurinë publike, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, si dhe për mbrojtjen e shëndetit, të moralit ose të të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Pra, siguria publike, parandalimi i veprave penale, si dhe mbrojtja e të drejtave të të tjerëve shërbejnë si premisa për të konsideruar, në përputhje me parimet kushtetuese, një ndërhyrje në të drejtën për jetë private *(shih vendimin nr. 4, datë 23.02.2011, paragrafi 48, të GJK-së).*

7. Mbrojtja e jetës private përfshin mbrojtjen e autonomisë personale dhe mbrojtjen e të dhënave sensitive të një individi. Autonomia personale është një parim i rëndësishëm, i cili nënvizon garancitë për mbrojtjen e jetës private dhe që i jep mbrojtje sferës personale të secilit individ, përfshi të drejtën për të dhënë detaje të identitetit të tyre si qenie njerëzore.

E drejta e respektimit të jetës private ka disa aspekte plotësuese siç janë ruajtja e "sferës private rreth individit", e cila përfshin "të drejtën për një jetë private sociale", "të drejtën e individit për të vendosur dhe zhvilluar marrëdhënie me personat e tjerë të të njëjtit grup", "të drejtën për të mbrojtur të dhënat personale" dhe "të drejtën për autonomi personale". Identiteti etnik është një e dhënë që lidhet me identitetin e individit dhe që bie në fushën e veprimit të nenit 8 të KEDNJ-së për mbrojtjen e jetës private. Duke nënvizuar natyrën "sensitive" të të dhënave mbi përkatësinë etnike, GJEDNJ-ja pohon se identiteti etnik i individit, ashtu si emri, gjinia, feja dhe orientimi seksual, përbën një aspekt thelbësor të jetës së tij private dhe identitetit të tij *(shih vendimin nr. 52, datë 01.12.2011, paragrafi 32 të GJK-së).*

b. Precedentë ku çështja e cenimit të së drejtës për jetë private është vënë në diskutim[22]

8. Përpara Gjykatës është pretenduar cenimi i së drejtës së jetës private, si rezultat i vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që e skualifikuan kërkuesin nga ndjekja e programit të trajnimit fillestar, për rrjedhojë i pamundësuan ushtrimin e profesionit të gjyqtarit, duke e prekur në dinjitetin, personalitetin dhe zhvillimin e marrëdhënieve me botën e jashtme. Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata është shprehur se pretendimi i kërkuesit nuk mund të vlerësohet sipas qasjes së bazuar në shkaqe, pasi skualifikimi i tij kishte të bënte me moskalimin me sukses të procesit të verifikimit të pasurisë, pra nuk bazohej në të dhëna që lidheshin me jetën e tij private. Sipas saj, kërkuesi nuk ka arritur të provojë ardhjen e tyre në aspektet e jetës së tij private për shkak të procesit të verifikimit të kandidaturës së tij, i përmbyllur me skualifikimin si kandidat për magjistrat. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së jetës private në aspektet e dinjitetit, zhvillimit personal dhe të marrëdhënieve me botën e jashtme është me karakter të përgjithshëm dhe ai nuk ka arritur të argumentojë dëmin e pësuar, material dhe jomaterial, në drejtim të rëndësisë dhe seriozitetit të tij, si dhe lidhjen mes pasojës së ardhur dhe vendimit të KLGJ-së. Në këtë kuptim, ai nuk ka arritur të provojë përkeqësimin e situatës së tij ekonomike, shoqërore dhe profesionale, para dhe pas këtij procesi. Pa mohuar pasojat eventuale negative që mund t'i vijnë kërkuesit nga vendimi i skualifikimit në lidhje me karrierën tij të ardhshme, përsëri procesi i verifikimit nuk barazohet me një proces disiplinor të magjistratit në detyrë, për shkak të të cilit këtij të fundit i rrezikohen të drejtat e fituara tashmë. Ashtu siç pranon edhe kërkuesi, ai është kualifikuar profesionalisht për të filluar studimet në Shkollën e Magjistraturës, por ky kualifikim përbën fazën e parë të procedurës së emërimit, që sipas Kushtetutës përmbyllet pas një procesi administrativ të verifikimit të pasurisë dhe figurës. Për rrjedhojë, për kërkuesin nuk kanë lindur të drejta që lidhen me ushtrimin e profesionit

[22] Precedentët/rastet nga gjykimi kushtetues të përmendura në këtë pjesë, ku çështja e cenimit të së drejtës për jetë private është vënë në diskutim, përfshijnë jo vetëm ato të shqyrtuara nëpërmjet kontrollit konkret/ankimit kushtetues individual, por edhe ato nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të ligjeve/akteve normave. Ligjet/aktet normative objekt shqyrtimi ose të referuara në precedentët/rastet nga gjykimi kushtetues janë ato akte që kanë në fuqi në kohën e shqyrtimit të këtyre çështjeve.

ose edhe garancitë që e shoqërojnë atë. Duke qenë një proces verifikimi paraprak, kërkuesi ishte në prag të fillimit të studimeve për t'u pranuar në profesion dhe për t'u bërë pjesë e një komuniteti profesionistësh, pra ende nuk kishte përfituar të drejta me efekt financiar, shoqëror ose profesional, dhe, po ashtu, nuk kishte krijuar reputacion profesional. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka provuar ardhjen e pasojave në aspektet e jetës private që lidhen me: "rrethin e tij të brendshëm", pra të mirëqenies së tij dhe të familjes; mundësinë e krijimit dhe zhvillimit të marrëdhënieve me të tretët; reputacionin shoqëror dhe profesional. Kërkuesi e ka lidhur pretendimin për cenimin e së drejtës së jetës private me pamundësinë e ushtrimit të profesionit të gjyqtarit, e cila jo vetëm nuk është një e drejtë që buron nga normat kushtetuese, por as një e drejtë ligjore të cilën kërkuesi e kishte fituar. Duke mos provuar ardhjen e pasojave, bëhet i panevojshëm vlerësimi i ashpërsisë dhe rëndësisë së tyre, që përbën kriterin tjetër kushtetues që duhet përmbushur kur pretendohet cenimi i së drejtës së jetës private sipas qasjes së bazuar në pasoja. Po ashtu, bëhet i panevojshëm edhe vlerësimi nëse ndërhyrja në jetën private të kërkuesit ka qenë në përputhje me ligjin, për një qëllim legjitim dhe e nevojshme në një shoqëri demokratike *(shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021, paragrafët 80 – 83, të GJK-së).*

9. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar se neni 131 i ligjit nr. 108/2014, i cili parashikon masa të veçanta për përgjimin e individëve, cenon të drejtën e jetës private të garantuar nga nenet 35, 36 dhe 37 të Kushtetutës, si dhe neni 8 i KEDNJ-së, pa zhvilluar proces të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës, në shkelje edhe të nenit 15 të Kushtetutës, sipas të cilit, organet publike kanë detyrimin të respektojnë të drejtat themelore që qëndrojnë në themelet e shtetit të së drejtës. Gjykata e ka vlerësuar si të bazuar këtë pretendim, duke u shprehur se nenet 131 dhe 6, pika 29/1, të ligjit nr. 108/2014 duhen shfuqizuar. Sipas saj, ndër të tjera, çmon se ka ndërhyrje në të drejtën e jetës private edhe në aspektin e korrespondencës, të garantuar nga neni 36 i Kushtetutës, përderisa pjesë e jetës private janë edhe komunikimet e individit në ambiente publike me individë të tjerë në distancë, që ai i bën me mesazhe të shkruara, zanore ose vizuale, duke përdorur pajisje kompjuterike, komunikime të cilat mund të regjistrohen, filmohen ose fotografohen rastësisht gjatë zbatimit të masave të veçanta, veçanërisht të mbikëqyrjes vizuale, sipas shkronjës "b", pika 1, të nenit 131, tek teksti i së cilës nuk përjashtohen komunikimet elektronike. Gjatë mbikëqyrjes vizuale dhe zanore, jo vetëm mund të mblidhen të dhëna nga biseda në publik, por nuk përjashtohet as mundësia që bisedat në distancë të individit përmes aplikacioneve multiplatformë të komunikimit elektronik me zë dhe me figurë, me anë të filmimit të vetes dhe dërgimit të tyre te persona të tretë, të mbikëqyren nga Policia e Shtetit nëpërmjet fotografimit dhe kampionimit të zërit. Gjurmimi i individit, sipas shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 131 të ligjit nr. 108/2014, për lokalizimin ose identifikimin e vendndodhjes së tij, në varësi të llojit të mjetit teknik që përdoret, mund të ndërhyjë në të drejtën e jetës private, në aspektin e paprekshmërisë së banesës, të garantuar nga neni 37 i Kushtetutës, përderisa kjo dispozitë ligjore, në ndryshim nga shkronjat "a" dhe "b", nuk ka asnjë parashikim për llojin e vendeve, pra nuk i përjashton në këtë mënyrë banesat dhe vendet e njësuara me to *(shih vendimin nr. 30, datë 05.07.2021, paragrafët 59-60, të GJK-së).*

10. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar cenimi i së drejtës për jetë private nga parashikimet e të ligjit të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", sipas kërkuesit, ligji nuk ka parashikuar asnjë rrethanë apo kriter për kufizimin neneve 36 dhe 37 të Kushtetutës, që garantojnë lirinë e korrespondencës dhe paprekshmërinë e banesës, me qëllim që ai të jetë i pjesshëm dhe në proporcion me nevojën e realizimit të procesit. Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim në këndvështrim të detyrimit për të respektuar jetën private të individit, duke arritur në përfundimin se është i pabazuar. Sipas saj, ndër të tjera, ndërhyrja në këtë rast justifikohet me interesin publik, që është ulja e nivelit të korrupsionit dhe rikthimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Për rrjedhojë, në rastin konkret ndërhyrja është bërë për një qëllim të ligjshëm, në këndvështrim të paragrafit të dytë të nenit 8 të KEDNJ-së, si dhe në respektim të nenit A të Aneksit të Kushtetutës që kufizon këtë të drejtë. Gjykata ka ritheksuar se është detyrë e organeve të reja kushtetuese të rivlerësimit që gjatë mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së organeve ligjzbatuese të kërkojnë respektimin e standardeve evropiane dhe jurisprudencën e kësaj Gjykate si më lart *(shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, paragrafi 64, të GJK-së).*

11. Përpara Gjykatës, në rrugën e kontrollit kushtetues incidental, është pretenduar se identiteti etnik i një individi duhet të konsiderohet si një e dhënë që i përket jetës së tij private dhe se termi "kombësia", në nenin 6/1 dhe 8, termi "kombësinë në përputhje me kombësinë e prindërve", në nenin 42/2, germa "e" dhe nenit 58 të ligjit për gjendjen civile bien ndesh me nenin 35 të Kushtetutës, në lidhje me të dhënat personale. Gjykata ka rritur në përfundimin se rregullimet e ligjit për gjendjen civile, objekt shqyrtimi, cenojnë garancitë e nenit 35 të Kushtetutës. Sipas saj, ndër të tjera, ligji për gjendjen civile, nuk parashikon garanci për sa i përket marrjes, mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave personale "sensitive". Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk i referohet, në mënyrë eksplicite dhe konkrete, ligjit për të dhënat personale. Në këtë aspekt, ajo e ka konsideruar si thelbësore ekzistencën e një dispozite specifike referuese për shkak të natyrës "sensitive" të të dhënave mbi përkatësinë etnike. Gjykata vë në dukje se ligji për gjendjen civile nuk përmban as parashikime se si do të përdoren këto të dhëna apo mbi përgjegjësinë në rast keqpërdorimi të tyre, gjë e cila do të përbënte një garanci mjaft të rëndësishme për të gjithë shtetasit. Nisur nga kjo premisë, Gjykata ka arritur në konkluzionin se, dispozitat e ligjit për gjendjen civile, objekt i këtij kontrolli kushtetues, duke vendosur detyrimin për regjistrimin e të dhënave mbi 'kombësinë' në regjistrat e gjendjes civile, ndërhyjnë në sferën e jetës private të individit, në kuptim të nenit 35 të Kushtetutës. Kjo ndërhyrje, në vlerësimin e Gjykatës, shkakton një devijim nga parimi kushtetues i mosdetyrimit të bërjes publike të të dhënave personale, ku përfshihen dhe të dhënat personale "sensitive", i cili sanksionohet në nenin 35 të Kushtetutës. Gjykata ka çmuar se mbrojtja e të dhënave "sensitive", si një nga komponentët e së drejtës për respektimin e jetës private, garantohet nëpërmjet shprehjes së lirë të vullnetit për të bërë publike ose jo këto lloj të dhënash, në përputhje me nenin 35 të Kushtetutës. Të dhënat që sigurojnë informacion për analiza demografike, të nevojshme për zhvillim ekonomik dhe social apo për qëllime të politikave

shtetërore për të nxitur ruajtjen e identitetit kulturor e gjuhësor të pakicave etnike, mund të merren nëpërmjet procedurave të tjera përkatëse, në përputhje me garancitë ligjore që parandalojnë shpërdorimin e të dhënave të mbledhura, si dhe përcaktojnë saktësisht rregullat e veçanta të përpunimit *(shih vendimin nr. 52, datë 01.12.2011, paragrafët 33 – 35, të GJK-së).*

12. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar cenimi i së drejtës për jetë private nga parashikimet e ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë". Sipas kërkuesit, neni 6 i ligjit objekt shqyrtimi shkel hapur nenet 35, 36, 37 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së, pasi mungojnë garancitë ligjore që verifikimet të kryhen në përputhje me qëllimin e ligjit; nuk janë përcaktuar kritere objektive për përzgjedhjen e subjekteve, duke lënë shteg për trajtim të pabarabartë të shtetasve, në kundërshtim me nenin 18/1 të Kushtetutës (p.sh. rasti i personave me imunitet). Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Sipas saj, ndër të tjera, neni 6 i ligjit përbën një ndërhyrje në të drejtën e mbrojtur nga neni 37 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ-së. Çështja që shtrohet është nëse kjo ndërhyrje është e justifikueshme, sipas nenit 17 të Kushtetutës dhe nenit 8, paragrafi 2 i KEDNJ-së, pra nëse ajo është "në përputhje me ligjin" ose "e nevojshme në një shoqëri demokratike" për një nga qëllimet e parashikuara. Ligji, këtë proces verifikimi, e lidh me ata persona që bien në fushën e veprimit të nenit 3, pra për të cilët ka një dyshim të arsyeshëm bazuar në indicie për pjesëmarrje në organizata kriminale, terroriste, etj. Ligji ka përcaktuar në mënyrë të qartë fushën e zbatimit, si dhe personat që janë subjekt të dispozitave të tij. Fusha e zbatimit të ligjit është e kufizuar vetëm për personat për të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm për pjesëmarrjen e tyre në veprimtari kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Për rrjedhojë, jo çdo subjekt në Shqipëri është i ekspozuar në verifikimet e organit të akuzës. Në rastin e verifikimit, sipas dispozitave të ligjit objekt shqyrtimi, është prokurori që, pas marrjes dijeni për pasuritë që duhen verifikuar, kryen hetimet përkatëse. Gjykata ka theksuar se parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar është një nga detyrat themelore të shtetit, me qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe të drejtave e lirive themelore të njeriut. Për pasojë është e domosdoshme që të merren masa për verifikimin e të dhënave edhe pa pëlqimin e personit, për subjekte për të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm, bazuar në indicie për kryerjen e veprimeve kriminale, me qëllim parandalimin e krimit të organizuar dhe goditjen e një prej mjeteve kryesore që e mbështet këtë veprimtari *(shih vendimin nr. 4, datë 23.02.2011, paragrafët 46 – 47, të GJK-së).*

13. Përpara Gjykatës, nëpërmjet kontrollit kushtetues abstrakt të normës, është pretenduar cenimi i të drejtës për jetë private nga parashikimet e nenit 34 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë". Gjykata e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Gjykata ka vlerësuar se deklarimi i pasurisë dhe mundësia e publikimit të të dhënave të deklaratës në përputhje me ligjin nr.8503 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", është gjithashtu një ndihmesë për parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesave. Në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve zyrtare, personi i

zgjedhur apo nëpunësi publik nuk duhet të ndikohet nga interesat e ngushta personale. Në këtë kuptim, përmes veprimeve, mosveprimeve apo vendimmarrjes së tij, ai nuk mund të krijojë përfitime apo avantazhe për vete, për familjarët, të afërmit apo personat e tjerë fizike dhe juridikë, me të cilët ndan interesa ekonomike ose politike. Deklarimi dhe regjistrimi i pasurisë së personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, verifikimi i tyre si dhe mundësia e bërjes publike të të dhënave që kanë këto deklarime ndikojnë pozitivisht në identifikimin ose shmangien e rasteve të konfliktit të interesave, pra edhe të rasteve korruptive. Të dhënat personale me karakter pasuror, si rregull, hyjnë në sferën e jetës private, prandaj në rastin konkret gjen zbatim neni 35 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNj-së. Megjithatë, ato nuk kanë atë natyrë dhe atë karakter që kanë të dhënat me karakter sensitiv, të cilat përbëjnë edhe thelbin e jetës private dhe familjare. Janë pikërisht këto të dhëna, të cilat i krijojnë mundësi individit të zhvillojë në mënyrë të pavarur personalitetin e tij dhe që "në mënyrë të bazuar dhe të njohur nga të tretët, nuk mund të jenë nën vëzhgimin e publikut". Të dhënat pasurore në tërësinë e tyre nuk e kanë këtë karakter. Për më tepër, në tërësi shpesh ato janë vetiu nën vëzhgimin dhe vlerësimin e publikut të gjerë. Publikimi i detajeve mbi të ardhurat ose pasurinë personale nuk përbën ndërhyrje në jetën private, veçanërisht nëse personi ushtron funksione publike ose *quasi* – publike". Gjykata ka mbajtur parasysh se kufizimi që i bëhet jetës private në formën e deklarimit dhe mundësisë së publikimit të të dhënave personale me karakter pasuror të subjekteve të caktuara është bërë me ligj, ashtu siç kërkohet edhe nga nenet 17 dhe 35, respektivisht paragrafi i parë dhe i dytë i Kushtetutës sonë, si dhe nga paragrafi i dytë i nenit 8 të KEDNJ-së. Detyrimi për deklarimin e të ardhurave dhe pasurisë personale si dhe mundësia e publikimit të tyre, nuk synojnë dëmtimin apo denigrimin e subjekteve deklaruese, por një transparencë dhe kontroll më rigoroz ndaj pasurimit apo raporteve të tyre financiare me persona të tretë. Nga ky këndvështrim, Gjykata ka çmuar se publiku ka interes të ligjshëm, që përmes transparencës, të informohet më në detaje jo vetëm mbi punën dhe veprimtarinë, por edhe mbi të ardhurat, pasurinë dhe burimet e saj të personave të zgjedhur ose zyrtarë. Pra, balanca e gjetur vlerësohet si e drejtë dhe e bazuar. Për rrjedhojë, është konstatuar se ndërhyrja apo kufizimi i sferës së jetës private, në formën e dhënies së informacionit mbi pasurinë dhe burimet e saj dhe mundësia e publikimit të tyre, të jenë të justifikuara dhe të domosdoshme në kushtet aktuale të shoqërisë shqiptare *(shih vendimin nr. 16, datë 11.11.2004, paragrafët 4.2 – 4.4, të GJK-së).*